Gati ka ekzistuar konsensusi se procesi i formimit të shteteve nacionale kryesisht ka përfunduar me shekullin XIX, për çka edhe e ka marrë emrin "shekulli i nacionaliteteve", kurse për shekullin XX është pohuar se është shekulli i integriteteve transnacionale.

Një nga shpjegimet mund të jetë se sistemi bipolar dhe disiplina bllokiste, derisa kanë zgjatur, i kanë mbajtur nën kontroll konfliktet etnike, secili në bllokun e vet të shteteve. Atëherë është konsideruar se për botën janë shumë të rrezikshme komunizmi sovjetik dhe imperializmi perëndimor, se sa nacionalizmat e llojeve të ndryshme.⁵ Disa autorë shkojnë edhe më thellë në histori prandaj shkaqet i gjejnë në vendimet e fuqive të mëdha pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore (Traktati i Versajës mbi paqen 1919). Me këto vendime, gjoja, territorialisht janë ndëshkuar ose shpërbyler disa vende të caktuara, varësisht se në cilën anë kanë luftuar. Italia, me kalimin në anën e aleatëve jo vetëm që e evitoi ndëshkimin veç se e fitoi edhe shpërblimin në formën e territorit (Tirolin e Jugut, pjesët e bregdetit slloven e kroat). Hungaria, e cila deri në fund mbeti me forcat e qendrës, u ndëshkua në mënyrë drastike: e humbi rreth 70% të territoreve që i mbante vërtet të pushtuara, si bashkëpartner i Perandorisë

¹ Politika, 22.06.1996

² Europe and ethnicity, ed. by Seamus Dunn and T. G. Fraser, London, 1996, fq.8.

³ Will Kymlicka: Multikultural citizenaship, New York, 1995, fq. 2

⁴ E. J. Hobsbawm: Nations and nationalismsince 1780, Cembridge 1990, fq. 170, e 181-82

⁵ Nationalism and nationalities in the new Europe, ed. by Charles A. Kupchan, USA, 1996, fq. 37-38. International organizations and ethnic conflict, ed. by Milton Esman and Shibley Telhami, N. Y. 1995, fq. 87. Gjithashtu në librin tim "Srpsko pitanje izmedju mita i stvarnosti", Beograd, 1997, fq. 195-198

Austrohongareze, por rreth tre milionë hungarezë mbeti të jetojë jashtë shtetit amë. Edhe sot, pas shkatërrimit të bllokut sovjetik, në shtatë vende fqinje jetojnë midis 2.8 dhe 3.5 milionë hungarezë (midis 22 e 26% të të gjithë hungarezëve). Vetëm në Rumani, në rajonin e Transilvanisë (përgjatë kufirit hungarez) është situuar gati pakica dymilionëshe hungareze. Për nga numri i diasporës vetëm Shqipëria gjendet para Hungarisë (rreth gjysma e banorëve të shtetit shqiptar i temeluar pas luftërave ballkanike, ka mbetur të jetojë në dy vende fqinje (në Greqi dhe Serbi, pastaj në Mbretërinë Serbe, Kroate e Sllovene). Me fjalë tjera lufta e madhe e ka investuar vetvetën në kontestet e ardhshme rreth kufijve shtetëror dhe pakicave kombëtare.¹

Ekziston edhe shpjegimi i tretë, i cili shkaqet e riaktualizimit modern të fenomenit nacional i gjenë në zhvillimin e pabarabartë ekonomik të botës e të kombeve.²

Në çdo rast, me shkatërrimin e blloqeve dhe me pushimin e luftës së ftohtë, dolën mbi sipërfaqe si vullkan shumë pakënaqësi dhe frustrime nacionale deri atëherë të lëna pasdore, ndjenja të padrejtësisë kombëtare të shkaktuara në të kaluarën historike, u ngjallën programet e vjetra të bashkimit kombëtar, implikimi i të cilave është revidimi i kufijve ekzistues shtetëror.

Nacioalizmi vërtet u paraqit si fantazmë e cila po shëtitë nëpër Evropë, sepse u paraqit me totalitarizmin e ri, neofashizmin dhe me kërcënimet e reja ndaj paqes botërore. Me këtë rast ka shprehur mundësitë e pashterrura të manipulimit me intresat reale kombëtare për qëllime agresive pushtuese-shoveniste. Aq më tepër u bë tejet vështirë për t'u dalluar intresat e luftës së arsyeshme kundër represionit dhe të pabarazisë kombëtare nga nacionalizmi. As vendet individuale, as bashkësia ndërkombëtare, as bota e shkencës nuk qenë të përgatitur për erupcionin e ngutshëm të konflikteve etnike, për çka kanë munguar përgjigjet në kohë të duhur dhe adekuate ndaj këtyre provokimeve. Për çdo rast, problemet nacionale, përkundër pritjeve të shumë teoricientëve dhe politikanëve, hynë në vetë kreun e politikës botërore. Ndonëse, vërtet, në një formë më shumë të tmerrshme se sa inkurajuese.

Mirëpo, prapa gjërave të dukshme, zhvillohen dy procese botërore në shikim kundërthënës: procesi i globalizimit dhe procesi i shumëzimit të numrit të shteteve të pavarura. Empiria historike flet për atë se në shekullin XX, krahas procesit të globalizimit ka lindur numri më i madh i shteteve. Në fund të Luftës së Dytë Botërore kanë qenë rreth 50 themelues të Kombeve të Bashkuara, kurse sot Kombet e Bashkuara numërojnë rreth 180 - shtete antare. Ballafaqimi i këtyre dy proceseve (globalizimi dhe individualizimi) më qartë manifestohen në Evropë: Evropa Perëndimore disi po integrohet (shtet nacionale po hyjnë në një formë të asociacionit transnacional), Evropa Lindore po çintegrohet. Nga tri ish federata socialiste (jugosllave, çekoslllovakë dhe sovjetike) kanë dalur 22 shtet të reja nacionale.

Edhe këto shtete të posakrijuara gati pa përjashtime në masën e madhe apo të vogël janë shumëkombëshe. Në Federatën Ruse, popullata joruse numëron përafërsisht 28 milionë (gati një e pesta e popullatës së përgjithshme), dhe në 10 nga 21 njësi federale e përbëjnë shumicën: Sllovakia ka rreth gjysmë milion hungarezë; Ukraina rreth 12 milionë rusë; Serbia rreth 35 / të popullatës joserbe, etj.

Këto shtete edhe vetë nuk janë immune nga kërkesat e reja për shkëputje përkatësisht thua se proceset e fragmentimit në truallin e ish Bashkimit Sovjetik dhe të ish Jugosllavisë Socialiste nuk kanë përfunduar. Në të njetën kohë, kur Çeçenia po kërkon të shkëputet nga Federata Ruse, Ingushetia po kërkon të ndahet nga Çeçenia për të mbetur në Federatën Ruse! Gruzia po ballafaqohet me secesionizmin e Abhazisë dhe të Osetisë jugore; Azerbejxhani me kërkesën e popullatës shumicë jermene Nagorni Karabah për t'iu bashkuar Jermenisë; Ukraina me kërkesën e shumicë ruse në Krime që të kthehen nën juridiksionin e Federatës Ruse; Moldovia me secesionizmin e Transilvanisë; Serbia dhe RFJ me kërkesën e shqiptarëve të Kosovës për shtetin e pavarur. Batica e kërkesave të tilla i ka shtyrë disa hulumtues që t'i rradsisin në kategorinë "e

¹ Europe and ethnicity - world war I and contemporary ethnic conflict, ed. by Seamus Dunn and T. G. Fraser, London, 1996.

² International organizations and ethnic conflict, ed. by Milton I. Esman and Shibley Telhami, USA, 1995, fq. 86-88.

matrjoshka nacionalizma".¹

Por nëse shpërthimi i konflikteve etnike në Evropën Lindore e Juglindore deri diku mund të shpjegohet me kombet historikisht të vonuara, me çka të shpjegohet fakti se edhe kombet evropërendimore të formuara në shekullin e XIX-të, por edhe më herët edhe të cilat konsiderohen si djep i demokracisë qytetare - po ballafaqohen me ringjalljen e konflikteve etnike? Nacionalitetit pakicë, qartas, po tregohen rezistuese ndaj proceseve të "unitarizimit demokratik" (të asimilimit në komb të shumicës). Ato po kërkojnë që krahas të drejtave qytetare të kenë të siguruara edhe të drejta të veçanta kolektive. Këto kërkesa sillen në hapësirën prej të drejtave klasike e minoritare, formave të ndryshme të vetëqeverisjes lokale (Uelsi dhe Skocia në Britani të Madhe), deri tek statusi federal (valonët e flamanët në Belgjikë), por edhe të secesionit (Baskia në Spanjë, Irlanda Veriore në Britani të Madhe, Kvebeku në Kanada). Konfliktet valonoflamanë në Belgjikë ose të francezëve të Kvebekut dhe të shumicës anglosaksone në Kanada, po i trondisin seriozisht këto dy federata të botës perëndimore.

II

Shpeshtimi dhe intensiteti i konflikteve etnike gjatë dy tri dekadave të fundit, po e tërheqin vëmendjen edhe të teorisë edhe të organizatave ndërkombtare, shumë më tepër se më përpara. Në fokusin e interesimit gjenden çështjet e të drejtave kolektive të nacionalitetit, veçmas të pakicave kombëtare, prkatësisht të të drejtave qytetare e kombëtare, vetëvendosja, identiteti e ngjashëm. Të shkojmë me radhë.

1. Një kohë të gjatë pas Luftës së Dytë Botërore, qëndrimet e organizatave ndërkombtare lidhur me çështjet e të drejtave individuale e kolektive janë ndërtuar nën ndikimin dominant të teorisë liberale e cila është mbështetur në bindjen se me kodeksin e të drejtave të njeriut mund të apsolvohen edhe të drejtat kolektive të bashkësisë nacionale. Duke u udhëhequr me këtë filozofi Deklarata mbi të drejtat e njeriut e Kombeve të Bashkuara, e bie fjala, fare nuk i prekë edhe të drejtat e veçanta të pakicave kombëtare.² Konsiderohet në të vërtetë se me të drejtat themelore të njeriut siç janë liria e të folurit e bashkimit, e ndërgjegjes e ngjashëm, të cilat u takojnë individëve, sigurohen edhe të drejtat e pakicave kombëtare prandaj nuk ka nevojë që të inaugurohen edhe të drejtat e veçanta kolektive. Nacionaliteti, si edhe religjioni, është vendosur në sferën private të qytetarit. Efektet e kësaj teorie janë manifestuar në asimilimin "demokratik" të pjesëtarit të pakicave etnike, dukuri kjo e cila në teorinë politike është quajtur "etnovrasje".

Por gjatë tri dekadave të fundit, posaçërisht pas thyrjeve së "socializmit real" dhe të federatava socialiste, doktrina mbi të drejtat e njeriut ka evoluuar dukshëm drejtë njohjes së të drejtave të veçanta kolektive të nacionaliteteve. Madje edhe mund të thuhet e që të mos tprohet, se nga dokumenti final i Helsinkut nga vitit 1975 deri të Konferenca e Gjenevës më 1991 dhe të Konferencës në kujdes të Këshillit të Evropës në Strazbur më 1995, pra në distancën prej gjithsej dy dekadash, është bërë shumë më shumë për njohjen e të drejtave kolektive se sa në periudhën e mëparshme gati tetëdhjetë vjeçare. (nga citit 1918). Përveç të drejtave klasike të pakicave kombëtare me të cilat sigurohet rrujtja e identitetit të tyre (e drejta e gjuhës, kulturës e ngjashëm), janë njohur edhe të drejtat politike (e drejta për autonomi, përfaqësim procedural në shtet etj. Përpos kësaj në Konferencën e OSBE-së në Gjenevë (1991) u arrit qëndrimi se problemet e pakicave kombëtare nuk paraqesin më ekskluzivisht çështjen e brendshme të shteteve.

Saksionimi i veçorive të të drejtave kolektive të minoriteteve posaçërisht është i rëndësishëm për vendet të cilat jo vetëm që janë etnikisht të përbëra por edhe me konflikte të mëdha etnike. Në ato vende e midis tyre më së shumti janë vendet e ish "socializmit", në vend të bartjes mekanike të përvojave evropërendimore, lypset të kërkohej zgjidhje specifike të raportit të të drejtave individuale e kolektive dhe konsekuent me këtë edhe të raportit të parimit qytetar e nacional në rregullimin e shteteve të tyre.

¹ Një lloj kukulle ruse e cila mbanë në vete një varg kukllash të vogla.

² Will Kymlicka: Multicultural citizenship, Oxford 1995, fq. 3-4

Shumë në botë dhe tek ne gjenden në sprovë që për shkak të tmerreve të luftës së mëparshme në trojet e ish Jugosllavisë të lënë pas dore çështjet e të drejtave kolektive nacionale. Përse, pyesin ata "të mos e trajtojmë popullin si individ, pavarësisht nga përkatësia e tij kombëtare"? Përse nuk po përqendrohemi në gjërat që për ne janë të përbashkëta si individ? Po harrohet me këtë rast se qëndrimet e tilla, duke marrë parasysh se jeta politike e ka pashmangshëm dimensionin nacional, në mjediset e përziera kombëtare i shkojnë në favor të kombit shumicë.¹ Qasja demokratike sipas mënyrës dhe frymës së liberalizmit klasik nuk do të ishte frytdhënëse me që nuk e nje domosdoshmërinë e dimensionit politik, e në disa raste edhe dimensionet shtetërore të së drejtës nacionale. Insistimi ekskluzivisht në standardet demokratike të të drejtave qytetare duket shumë përparimtare. Por në mjediset e përziera nacionale, të ngarkuara me ndarje të thella etnike dhe me mosbesimin reciprok një qasje e tillë do të ishte kontraproduktive. Kjo do të mund të shndërrohet në një formë të unitarizmit "demokratik".

Nuk është kontestuese se në sistemet demokratike gjenden premisa për zgjidhje të qëndrueshme të çështjes nacionale. Por nuk do të duhej të ishte kontestues se edhe ne sistemet autoritare ekzistojnë rezistenca të shumta (ekonomike, politike, vetëdija autoritare etj) të përparimit më të shpejtë të demokracisë prandaj problemet minoritare duhet të zgjidhen patjetër edhe me anë të të drejtave të veçanta, e jo vetëm me të drejtat kulturore por edhe me zgjidhje politike të të drejtav kolektive. Sa është demokracia si proces afatgjatë premisë për zgjidhjen e qëndrueshme të të drejtave minoritare, aq është për regjimet autoritare premisë e demokracisë zgjidhja politike e problemeve minoritare. Sëkondejmi nuk do të ekzistonte mundësia reale që, bie fjala, problemet e shqiptarëve të Kosovës ose të myslimanëve - boshnjakë në Sanxhak çështjet e bashkëjetesës serbomalazeze ose çështjet e reintegrimit të Bosnjës e Hercegovinës multikulturore, të zgjidhen ekskluzivisht si të drejta individuale qytetare me proklamimin kushtetues të prioriteteve të të drejtave të njeriut pa sigurimin e njëkohshëm edhe të drejtat kolektive nacionale në formën e autonomisë territoriale - politike ose të bashkimit të shteteve (federata, unioni, konfederata, e ngjashëm).

2. Duhet pasur parasysh se kriza bashkëkohore e shteteve të përbëra nacionale, në njëfarë mënyre reflektohet edhe si krizë e identitetit. Kjo krizë në mjediset e përziera nacionale nuk zgjidhet në mënyrën e duhur, duke insistuar ekskluzivisht identitetin qytetar në formën e qytetarit të "përgjithshëm" ose "universal" të privuar nga karakteristikat nacionale. Komponenti nacional nuk është komponenti i vetëm i identitetit, por gjithësesi është një nga përcaktuesit e tij madje edhe në vendet ku procesi i identifikimit transnacional ka shkuar shumë përpara.

Duke jetuar bashkë me shekuj diaspora gjermane, franceze e italiane kanë ndërtuar një identitet të ri - "identitetin zviceran" - i cili i bën më të afër mesveti, se sa që janë lidhjet e tyre të veçanta me shtetet fqinje amë. Përkundër kësaj, "identiteti zviceran" nuk e përjashton pluralitetin e identiteteve të veçanta nacionale. Në Britani të Madhe gjërat qëndrojnë diç më ndryshe: edhe pse kanë kaluar disa shekuj jeta në shtetin e përbashkët, nuk ka pasur sukses me krijimin e "identitetit britanik". Anglezët mund të thonë për vetëvetën se janë britanikë, po jo edhe shumica e skotlandezëve, uelsianëve, e më pak diç të ngjashme mund ta thonë irlandezët.²

Kjo rikujton dukshëm gjendjen e situatës në Jugosllavinë e mëparshme në të cilën serbët më me ëndje ishin deklaruar si jugosllavë se sa popujt tjerë të saj. Sikurse që anglezët në nocionin e "britanizmit" e shohin kuptimin e gjerë të nocionit të "anglizmit", ashtu serbët në "jugosllavizmin" e kanë parë shtrirjen e nocionit të "serbizmit". Problemin e pluralitetit të identitetit në Jugosllavinë e mëparshme e ka shprehur dikur, në mënyrën e vet Koça Popoviqi kur pat thënë se "shqiptarët e Kosovës ende mund t'i paramendoj si jugosllavë, por asesi edhe si serbë".

Ngjashëm është edhe me karakterin e shtetit. Në rregullimin e tij, nëse kombëtarisht është e përbërë,

¹ Will Kymlicka op, cit, fq. 193 - 94

² Nationalism and minorities, ed, by Institute of social sciences and University of Essex; nation and identity in contemporary Europe, ed. by Brian Jnkns and Spyros A. Sofos, London, 1996, fq. 85 dhe 87. Brana Markoviç, Medjunarodni problemi, 3-4, 1992, Beograd.

patjetër duhet të reflektohet edhe parimi qytetar edhe si nacional. Në mungesë të kësaj, popujve pakicë u mbetet zgjedhja midis dy të këqijave: ose të integrohen në kombin shumicë, ose të reduktohen në qytetarë të rendit të dytë.¹ Pra, jo ose ose, por edhe - edhe. Pajtimi i këtyre dy bazave "konkurente" të identitetit - të bazës individuale dhe grupe - paraqet provokimin e qëndrueshëm të botës bashkëkohore.²

Nga ana tjetër, pranimi jo vetëm i dimensionit kulturor veç edhe i dimensionit politik të të drejtave kolektive nuk është dhe nuk duhet të jetë vetvetiu si qëllim në vete. Ajo mund të jetë frytdhënëse nëse të drejtat e grupeve etnike për status autonom i përmbushin dy kushte kyçe: parimin e barazisë (pa mundësi të majorizimit të cilitdo grup nacional) dhe parimi i të drejtave dhe lirive individuale brenda atyre grupeve. Nuk do të ishte rrugë e mirë sikur e drejta kolektive për ndonjë formë të autonomisë do të shfrytëzohet si mbulesë për ruajtjen e sistemit autoritar të marrëdhënieve brenda atyre grupeve, pra sikur të drejtat kolektive do të realizoheshin në dëm të të drejtave dhe lirive individuale. Nëse demokracia do të mbetet e shurdhër dhe e verbër ndaj këtyre problemeve, atëherë grupet etnike mund të bien lehtë nën ndikimin e nacioalistëve, udhëheqësve popullistë dhe regjimeve autoritare.

III

E drejta e popujve për vetëvendosje në të gjitha dokumentat relevante të Kombeve të Bashkuara trajtohet si e drejtë e patjetërsueshme e popujve. Futja e saj në kodeksin e normave ndërkombëtare është arsyetuar si parakusht për shfrytëzimin e plot të të gjitha të drejtave dhe lirive fundamentale si bazë për bashkëpunim të barabartë të popujve dhe stabilitetit të paqes botërore. Mirëpo, ajo njëkohësisht është edhe njëra nga të drejtat më kontraverze në kohën e re.

Kontestet dhe mohimet që e shoqërojnë këtë të drejtë, të shpeshtën lindin për shkak të parprecizitetit të saj, të interpretimeve të njëanshme por edhe të mundësisë së keqpërdorimit për qëllime nacioaliste. Ihtarët e teorisë klasike liberale e konstestojnë atë me argumentin e njëjtë (bollëkun e të drejtave qytetare), me të cilin e kontestojnë çdo veçori të të drejtave kolektive. Një kohë, pas Luftës së Dytë Botërore kjo e drejtë është kuptuar sikur ka të bëjë vetëm ose kryesisht me popujt kolonialë. Duhet të kalojë kohë e gjatë për t'u kuptuar se e drejta për vetëvendosje, sado që është e motivuar, për nevojën e çlirimit të popujve kolonialë, është me vlerë universale për të gjithë popujt e botës bashkëkohore. Me këtë rast kanë mbetur dilema të numërta të tjera aspak naive.

1. Dielamt më të mëdha janë krijuar e po zgjasin ende rreth çështjes se kush mund të jetë subjekt i vetëvendosjes: popujt (kombet), pakicat kombëtare, bashkësitë shtetërore? Në të gjitha dokumentet e KB, populli emërtohet si subjekt i kësaj të drejte. Mirëpo, mungojnë edhe saktësimet lidhur me pakicat kombëtare. Jo pse ato janë radhitur në ndonjë kategori më të uelt të grupit nacional të cilat nuk do ta meritojnë këtë të drejtë, veç për shkaqe praktike e politike. Meqenëse në botë ka vetëm rreth 10% të shtetve homogjene kombëtare (në Evropë vetëm Islanda dhe Portugalia), mbretëron frika se numri i tepruar i subektit të kësaj të drejte mund t'i vë në pikëpyetje kufijtë e shumicës së shtetve, që do të fuste anarkinë në jetën ndërkombëtare dhe do ta rrezikonte paqen botërore.

Kryesisht, për këto shkaqe ka mbisunduar pikëpamja se subjekt i vetëvendosjes mund të jenë popujt (kombet) si tërësi, e jo edhe pjesët e popujve (kombeve) që kanë mbetur jashtë kufijve të shteteve të vetme amë. Por ky nu kështë ndonjë "ligj i hekurt", me të cilin pakicat kombëtre përjashtohen absolutisht nga kjo e drejtë. Bashkësia katolike në Irlandën Veriore është kryesisht pakicë. Mirëpo, asaj në të gjitha negociatat që po zhvillohen me rasti ne fatit politik të Irlandës Veriore, i njihet e drejta për vetëvendosje, që në rastin e saj nënkupton të drejtën për t'iu bashkuar shtetit amë të Republikës së Irlandës. Por për çdo rast, edhe më tutje mbeten paqartësitë se si dhe me se të dallohet populli nga pakica kombëtare? Është e zakonshme që nën

¹ Yeal Tamir: Liberal nationalism, USA, 1993, fq. XV

² Citizenship and national identity, ed. by Oommen N. Delhi 1997, fq. 35

janë shtetet e përbashkëta. Me nocionin "pakicë kombëtare" nënkuptohet pjesa e ndonjë populli (kombi) i cili jeton në kufijtë e shtetit tjetër (jo amë).¹

Se sa disa gjera në këtë aspekt janë relative, përkatësisht se sa jeta reale mund t'u kundërvehet definicioneve, mund të shihet në shembullin e dy ish federatave socialiste - jugosllave dhe sovjetike. Serbët dhe rusët në ato federata kanë pasur statusin e "popullit" (kombi) pavarësisht se në cilën njësi federale kanë jetuar, ndërsa në shtetet e porsaformuara janë sjellur në pozitë të "pakicave kombëtare". Shqiptarët e Kosovës në ish-Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ) kanë pasur statusin e "kombësisë", (termini specifik politik i cili në sistemin e atëhershëm ka nënkuptuar diç më shumë nga pakcia kombëtare, por edhe diç më pak nga statusi i popujve (kombeve) të ish-RSFJ; Myslimanët-boshnjakët të cilët në Jugosllavinë e mëparshme kanë pasur statusin e popullit, në Republikën Federative Jugosllave të tashme nuk kanë trajtimin bile as të pakicës kombëtare; shqiptarët e Kosovës zyrtarisht trajtohen si pakicë kombëtare, por ata këtë status po e refuzojnë duke konsideruar se i kanë të gjitha karakteristikat e një populli (kombi) (numri, kompaktësia etno-territoriale, veçoritë kulturore, etj.) dhe sipas kësaj kanë të drejtën për vetëvendosjen dhe për shtetin e vet.

2. Kontraverze është edhe çështja nëse janë bartës të të drejtës për vetëvendosje vetëm popujt apo edhe bashkësitë e tyre shtetërore politike. Ngatërresa ka lindur për shkak se kjo e drejtë, siç thamë më parë, fillimisht është kuptuar në funksion të përshtetimit të procesit të çlirimit të popujve të kolonizuar, të cilët që me fitimin e pavarësisë janë konstituuar si shtete. Kjo e drejtë më vonë është shtrirë edhe tek popujt që kanë shtetet e veta siç janë, bie fjala, anëtarët e federatës, të unionit e ngjashëm. Prandaj, do të thonim, se interpretimi më origjinal është ai i cili në bartës të së drejtës për vetëvendosje i përfshinë jo vetëm popujt por edhe bashkësitë e tyre shtetërore politike.

Qëndrimi se subjektë të të drejtës për vetëvendosje mund të jenë vetëm popujt e jo edhe bashkësitë e tyre shtetërore-politike (shtetet republikane) në luftën e shkuar në truallin e ish-Jugosllavisë përbënte bazën e platformës për "bashkimin e të gjithë serbëve në një shtet". Mosnjohja e subjektivitetit të shteteve republikane dhe e realitetit të kufijve ndërrepublikanë, do të duhej të justifikohet me shtrirjen e sovranitetit të shtetit serb në territoret e republikave tjera të banuara me etnosin serb. Ndonëse ajo luftë pat filluar me mosnjohjen e kufijve të AVNOJ-it, pra të kufijve të brendshëm ndërrepublikanë, ajo pas shumë viktimitave, ikjeve he shkatërrimeve materiale përfundoi me Marrëveshjen e Dejtonit e të Erdutit, me të cilën pala serbe ishte e detyruar që më në fund t'i pranojë ata kufijë si kufijë midis shteteve sovraane.

3. Dyshimet, por edhe konfuzionet, lidhur me kuptimin e të drejtës për vetëvendosje lindin edhe për shkak të kundërthënive në qëndrimet e organizatave ndërkombëtare (OKB, OSBE, e tjera), midis parimit të integritetit territorial të shteteve dhe të drejtës për vetëvendosje. Me këtë parim, gjoja, kufizohet nëse jo edhe shfuqizohet e drejta për vetëvendosje. Ajo nga njëra anë proklamohet e në anën tjetër kufizohet. Një përshtypje e tillë ka mundur të fitohet edhe me disa shembuj konkretë ku bashkësia ndërkombëtare me mjaft rezervime është sjellur ndaj kërkesave për secesion, duke i dhënë përparësi ruajtjes së integritetit territorial të shteteve. Kombet e Bashkuara, për shembull, i kanë bërë bisht që në fillim të krizës të marrin qëndrim me rastin e shkëputjes së Pakistanit Lindor, e kanë dënuar shkëputjen (secesionin) e turqve qipriotë, në fillim të konflikteve në Jugosllavi e mbrojtën aspektin e ruajtjes së integritetit të saj territorial, nuk u shqetësuan

¹ Mirëpo, duhet thënë se ende nuk ekziston definicioni i gjithëpranishëm për nocionin "pakicat kombëtare". Në një studim të Kombeve të Bashkuara është shfrytëzuar "definicioni i punës" sipas të cilit pakicë konsiderohet "secili grup i individëve, banorë të shtetit sovranë të cilët e përbëjnë më pak nga gjysma e popullatës... dhe pjesëtarët e të cilave kanë karakteristika të përbashkëta etnike, fetre dhe gjuhësore, sipas të cilave dallojnë nga popullata tjetër. (Nacionalne manjine - u medjunardonom i jugoslovenskom pravnom poretku, Bgd. 1997, fq. 53.). Mungojnë edhe dallime e gjithëpranueshme midis "pakicave kombëtare" dhe "popullit pakicë", në çka me të drejtë insiston Sinisha Tataloviç në librin e tij "Manjinski narodi i manjine (SKD "Prosveta", Zagreb, 1997). Sepse, p.sh. ekziston dallimi midis irlandezëve katolikë në Irlandën Veriore të cilët atje janë pakicë, dhe skotlandezëve e uellsianëve të cilët më parë mund të radhiten në popuj pakicë. I ngjashëm është rasti edhe me popujt autoktonë në Kanada dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (indianët, bie fjala.)

shumë me rastin e ndërhyrjes së armatosur të ushtrisë federale ruse në Çeçeni... Sado që e drejta ndërkombëtare nuk e ka zgjidhur saktësisht deri në fund këtë kundërthënie, në organizatën botërore është dominues qëndrimi se e drejta për shkëputje duhet të shfrytëzohet si mjet i fundit vetëm atëherë nëse janë shterrur të gjitha mundësitë tjera për zgjidhje konflikteve ekzistues etnik. Me këtë rat edhe kufijtë mund të ndryshohen, por vetëm në mënyrë paqësore, me anë të negociatave të palëve të interesuara, e asesi me luftë.

4. E drejta për vetëvendosje është e drejtë universale dhe e patjetërsueshme e popujve, por ajo nuk është absolute dhe nuk është njëkuptimshme, pra "nuk do të thotë automatikisht edhe të drejtën për shtetin e pavarur".¹ Ndonjëherë, ndërkaq, me apo pa vetëdije, harrohet se përpos të drejtës për ndarje shtetërore (i ashtuquajtur i jashtëm), vetëvendosja përmban edhe "aspektin e brendshëm", si e drejtë për forma të ndryshme të autonomisë brenda shtetit të përbashkët. Kjo është me rëndësi si çështje teorike, por edhe më shumë si çështje praktike politike. Veçmas për situatat kur për shkaqe të caktura - të brendshme dhe të jashtme - kërkesa për shkëputje nuk është reale, ose kur ekziston mundësia që të drejtat nacionale të shfrytëzohen edhe në mënyrë tjetër përveç me secesion (me autonomi, federalizim e ngjashëm). Kur ndonjë aspekt i brendshëm ose i jashtëm i vetëvendosjes fiton legalitet, varet nga rrethanat konkrete të brendshme e ndërkombëtare. Kjo do të thotë se zgjidhja e çdo rasti veç e veç duhet të jetë adekuate me ato rrethana. Me fjalë të tjera, e drejta për vetëvendosje ndonjëherë është më shumë çështje e pragmatizimit politik, e oportunitetit, e raportit të forcave, se sa çështje e pasimit dhe e normave juridike.

Në kohën e fundit është i pranishëm edhe trendi për t'u inkurajuar aspekti i brendshëm i vetëvendosjes, i nxitur nga vlerësimet se gjatë 25 deri dhjetë vitet e ardhshme mund të ekzistojnë edhe mbi 300 shtete. Sikur të shkatërroheshin vetëm dy federata - India e Zaireja, bie fjala, do të formoheshin mbi njëzet shtete të reja. Duke marrë parasysh faktin se në botë ekzistojnë rreth 5.000 grupe etnike, është reale të supozohet shifra edhe më e madhe e shteteve në shekullin XXI, që si pasojë do të kishte vështirësi shumë më të mëdha në funksionimin e Bashkësisë Ndërkombëtare se sa që ekzistojnë sot. Këtë me siguri e ka pasur parasysh Butros Gali kur tha se "nuk do t'i shihej fundi fragmentizmit dhe do të ishte gjithnjë e më vështirë të sigurohej paqeja, siguria e mirëqenja ekonomike për të gjithë, sikur çdo grup etnik të kërkonte shtetin për vete."²

Pikërisht nga këto frikësime edhe janë motivuar disa ide për riorientimin (jo edhe kufizimin) e të drejtës për vetëvendosje në format e vetësundimit (self-administration) brenda shteteve ekzistuese. Për situatat ku nuk janë të mundshme zgjidhjet interne, mbetet edhe më tutje e drejta legjitime e grupeve nacionale për shkëputje pra, për shtetin e pavarur. Me një nismë të tillë Lihtenshtajni ka dalur edhe para Kombeve të Bashkuara gjatë vitit 1991. Dokumenti me titullin "Projektkonventa për vetëvendosjen me anë të vetësundimit (self-administration)", nuk e ka fituar fuqinë e ligjit ndërkombëtar, por në disa tubime shkencore ka qenë objekt i diskutimit dhe i zbrëthimit të mëtejshëm. Ideja themelore e këtij dokumenti është që e drejta për vetëvendosje të realizohet në format e vetëqeverisjes nacionale brenda integritetit territorial të shteteve ekzistuese. Këto duhet të jenë forma të tilla të vetësundimit të cilat, me përmbushjen e kërkesave të grupeve nacionale, do të mund të ishin zëvendësim vullnetar për pavarësinë e shtetit.³

¹ Dejvid Filips, Naša Borba, 15.04.1998.

² Butros Butros Gali: Agenda za mir, KB. 1945-1995, Beograd, 1995, fq. 67.

³ Self determination - and - Self administration, ed. by Wolfgang Danspeckgruber with ARthur Watts, USA, 1997; Fakti se secesioni përman në vete rreziqe të shumta nga të cilat gjithësesi rreziku më i madh është nga shpërthimi i luftës (për shkak të kufijve e të territoreve), e cila mund të përfshijë jo vetëm rajonet e caktuara, por edhe mbarë botën i motivon disa autorë që "materia e vetëvendosjes" të rregullohet me ligj ndërkombëtar. Një nga ata, Allen Buchanan, bie fjala, konsideron se duhet caktuar kushtet të cilat e arsyetojnë secesionin. Sipas tij, kushte të tilla janë dy, të cilat janë më pak kontestuese kur është fjala për të drejtën për vetëvendosje. Kushti i parë është që ndaj ndonjë grupi etnik zbatohet politika diskriminuese e cila e kërcënon ekzistimin e saj si veçori etnike (shembull drastik është politika gjenocide ndaj kurdve). Kushti i dytë është kur ndaj disa popujve duhet korigjuar padrejtësitë historike të bëra në të kaluarën. Shembulli që i ilustron situatat e tilla janë republikat baltike, të cilat dikur i aneksoi BRSS (The morality of

5. Legjislacioni botëror ka obligim të fus shumë më tepër saktësime jo vetëm lidhur me disa aspekte të parimit të vetëvendosjes, por ndoshta edhe më shumë lidhur me mekanizmat dhe operacionalizimin e kësaj të drejte. Sepse, legjitimiteti i të drejtës për vetëvendosje vetvetiu nuk mjafton nëse nuk janë saktësuar qartë rrugët formale juridike të këtij akti. Si të evitohet lufta në situatat kur njëra bashkësi nacionale synon secesionin, e tjerat e mbrojnë kontinuitetin e shtetit, e nuk mund të pajtohen rreth kushteve për shpërbërje paqësore, siç ndodhi në ish-Jugosllavi? Athua në këtë rast, kur mungon marrëveshja për ndarje paqësore, secesionizmi është i njëanshëm e me këtë edhe akt jolegal, përkatësisht athua pala e cila e mbron integritetin territorial të shtetit ka të drejtë që me armë t'i kundërvehet secesionit? Ky problem në formën e ngjashme frapante po aktualizohet edhe në federatën e Kanadasë, madje ka arritur edhe në gjyqin suprem. Qeveria federale inicion pyetjen se e mundet Kvebeku ta braktisë federatën në qoftë se mungon marrëveshja për ndarje. A nuk do të ishte në këtë rast secesioni i Kvebekut unilateral, e me këtë edhe jolegal. Problemi ka kuptimin universonal i cili i kalon suazat e Kanadasë, sepse shtrohet pyetja se a ka Kvebeku të drejtë fundamentale demokratike për vendim "unilateral" për braktisjen e Federatës nëse paraprakisht dështojnë "me vullnet të mirë" negociatat me qeverinë federale të Kanadasë.

Problem i veçantë është se si të sillemi në situatën kur brenda grupit nacional i cili synon secesionin, ekzistojnë pakicat. Në Kvebekun francez ekzistojnë 11 grupe të tilla minoritare të cilat në rast të shkëputjes së kësaj krahine kanadeze dëshirojnë të mbeten pjesë e Kanadasë. Në ish- Jugosllavinë erdhi deri te lufta etnike për shkak se serbët në Kroaci dhe në Bosnjë e Hercegovinë kërkuan të mbeten në shtetin e vjetër. Janë të mundshme edhe situatat që pakicat nuk dëshirojnë të mbeten pjesë e shtetit të mëparshëm të përbashkët, por duan të shkëputen edhe nga grupi nacional i cili synon secesionin (Ingushia nga Çeçenia, Abhazia dhe Osetia Jugore nga Gruzia, e tjerë). Nëse referendumi është një nga mënyrat që në paqe dhe legalisht të realizohet ndarja (shpërbërja), mbetet pyetja se si të sillemi ndaj grupeve minoritare të cilat nuk pajtohen me shkëputjen, përkatësisht a mund të mbivotohen ato nga ana e grupit shumicë nacionale. Ilustrativ është rasti me Irlandën Veriore. Pakica katolike po kërkon bashkim me Republikën e Irlandës, shumica protestane është për mbetje brenda Mbetërisë së Bashkuar. Anglezët, duke e ditur epilogun, ofrojnë referendumin si rrugë demokratike e ardhjes deri tek vendimi!

6. Mbeten edhe disa paqartësi tjera jo pak të vlefshme në qëndrimet e Kombeve të Bashkuara. Ato, sikurse dihet, e ndalojnë përdorimin e forcës në marrëdhëniet midis shteteve. Por nuk është plotësisht e qartë se a bën pjesë nën indeksin e ndalimeve edhe lufta e armatosur për çlirim kombëtar edhe në rastet kur janë shterur të gjitha mjetet tjera. Terrorizmi po dënohet, por athua çdo luftë e armatosur për pavarësi është e njëjtë me terrorizmin, dhe nëse nuk është në bazë të çkahit të dallohen? Sipas cilave kriteret të eliminohet politika e "kutit të dyfishtë" në këtë aspekt? (për shembull, cili është dallimi midis aksioneve të armatosura të IRA-s në Irlandën Veriore dhe të ashtuquajturës Ushtria Çlirimtare e Kosovës, në Kosovë, ETA-s në Spanjë dhe deri te PLO-së së Arafatit?). Si të trajtohet përdorimi i forcës së policisë, e diku edhe e ushtrisë për t'u shtypur kërkesat për vetëvendosje? (ndërhyrja ushtarake e Britanisë së Irlandës Veriore, e Turqisë, Irani e Iraku kundër kurdëve, kundër tamilëve në Sri-Lanka, kundër shqiptarëve të Kosovës në Serbi, kundër sikëve në Penxhab (Indi), etj.). Si ta dallojmë në këtë rast mbrojtjen legjitime të integritetit territorial të shtetit nga terrorizmi shtetëror ndaj nacionaliteteve pakicë?

IV

Meqenëse konfliktet etnike mund të ndikojnë jo vetëm në stabilitetin e brendshëm të shteteve por edhe ato t'i shkatërrojnë (RSFJ, BRSS, RSÇK), me çka janë prekur edhe marrëdhëniet midis shteteve, është me rëndësi të madhe roli i Kombeve të Bashkuara dhe i organizatave të tjera ndërkombëtare siç janë Bashkimi Evropian dhe OSBE-ja në Evropë. Në këtë plan Bashkësia Ndërkombëtare ka vepruar me sukses

nationaliem, ed. by Robert McKim and Jeff McMahan, New York, 1997, fq. 310.

të ndryshueshëm: diku ka pasur më shumë sukses (Tirol i Jugut), diku jo sa duhet (në trojet e ish-Jugosllavisë) e diku ka pësuar edhe disfata (Somalia). Ka marrë mjaft kritika: ose përse po vonohet me rolin intervenues, ose përse po i tejkalon kufijtë e kompetencave të veta. Nga njëri pjesëmarrës i luftës në ish-Jugosllavi ose është akuzuar se nëse nuk është fajtorë, atëherë gjithësesi ka kontribuar në shpërthimin e konfliktit të armatosur (p.sh. me njohjen e Kroacisë, Sllovenisë dhe të Bosnjës e Hercegovinës), nga pjesëmarrësit tjerë është kritikuar se nuk ka qenë sa duhet e vendosur për pengimin ose për luftimin e flakës luftarake, se me Marrëveshjen e Dejtonit i ka njohur rezultatet e agresionit në Bosnjë e Hercegovinë, e kështu me radhë.

Iniciativat paqësore të bashkësisë ndërkombëtare e kanë ashpërsuar edhe çështjen e marrëdhënieve midis të drejtës ndërkombëtare dhe asaj të brendshme, midis kompetencave të organizatës ndërkombëtare dhe të sovranitetit të anëtarëve të saj. Në këtë terren janë grindur tradiconalisht dy shkolla të mendimeve: njëra e cila insiston përparësinë e të drejtës ndërkombëtare dhe tjera e cila e mbron primatin e të drejtës së brendshme. Me absolutizimin e njërit apo të qëndrimit tjetër, çon ose në mosrespektimin e të drejtës ndërkombëtare ose në përzierjen në çështjet e brendshme të shteteve.

Deri në Luftën e Dytë Botërore ka dominuar pikëpamja mbi primatin e të drejtës së brendshme, sidomos në vendet e "Paktit të trashës" (Italisë, Gjermania, Japonisë). Pas Luftës së Dytë Botërore me kodifikimin e të drejtave të njeriut situata po ndryshon në favor të së drejtës ndërkombëtare. Integrimet e bashkësisë ndërkombëtare përpos që po barten në marrëdhëniet midis shteteve, po barten edhe në disa çështje të brendshme të shteteve. Ligji Ndërkombëtar mbi të Drejtat e Njeriut u mundëson Kombeve të Bashkuara që të intervenojnë kudo që shken të drejtat e njeriut ose ku konfliktet e brendshme (etnike, bie fjala) kërcënojnë ta rrezikojnë paqen botërore. Me këtë relativizohet sovraniteti i shteteve në botën moderne. Shtetet nuk janë më sakrosante siç kanë qenë në shekullin XIX dhe në fillim të shekullit XX. "Koha e sovranitetit absolut dhe ekskluziv ka përfunduar."¹

Qysh në vitet e 20-ta, Shoqata e Popujve bëri presedencë duke ndihmuar zgjidhjen e konfliktit midis pakicës suedeze në Ishujt Olande dhe shtetit të Finlandës. Një rol të ngjashëm e kanë lozur edhe Kombet e Bashkuara pas Luftës së Dytë Botërore, duke ofruar shërbime për zgjidhjen e problemit të Tirolit të Jugut. Në të dy rastet, angazhimi i bashkësisë ndërkombëtare në çështjet e brendshme të anëtarëve të saj, ka kontribuar në qetësimin e tensioneve etnike dhe në normalizimin e marrëdhënieve brenda dhe midis shteteve sovraane. Hyrja e Federatës Ruse në Këshillin e Evropës u dha ndërmjetësuesve ndërkombëtar më shumë mundësi për të ndikuar për procesin negociator me Çeçeninë.²

Në procesin e zgjidhjes së problemeve minoritare ndikojnë mjaft në kuptimin pozitiv apo negativ, kombet më fqinje. Me qëndrimin vet ndaj diasporës fqinjët tregojnë se a kujdesën për diasporën apo kanë pretendime territoriale. Mospajtimet austriako-italiane rreth Tirolit të Jugut, pushuan me nënshkrimin e traktatit bilateral; gjermanët, italianët, francezët nuk i tejkalojnë kufijtë e lejuar ndaj Zvicrës; tani për tani nuk ka përzierje, të paktën të dukshme, të Francës e të Holandës në problemet etnike belge. Me rrugë të ngjashme, pra me marrëveshje për zgjidhjen e pozitës së pakicës hungareze janë nisur Hungaria e Rumania dhe Hungaria e Sllovakia. Nuk duhet theksuar shumë se sa është i rëndësishëm ky qëndrim i shteteve amë ndaj diasporës së vet për marrëdhëniet ndërshtetërore në Ballkan. Është aq i rëndësishëm sa që do të meritonte iniciativën për mbajtjen e Konferencës Ballkanike në të cilën, përveç dakordimit për avancimin e bashkëpunimit të ndërsjellë, pjesëmarrëset e saj do të zotoheshin edhe me qëndrimin për mosndryshimin e kufijve ekzistues në Ballkan.³

Angazhimi paqësor i bashkësisë ndërkombëtare është i arsyeshëm dhe legjitim nga aspekti i të drejtës ndërkombëtare të paktën në dy-tri raste: a) kur është fjala për represionin ,shkaljen e të drejtave nacionale e

¹ B. B. Gali: Agenda za mir, op. cit.

² Proces demokratizacije i etnicki odnosi u SR Jugoslaviji, Deo o SSSR i Ruskoj Federaciji, fq. 40.

³ Një propozim të tillë e kanë paraqitur në dialogun e parë shqiptaro-serb në Ulqin, 23-25 qershor, 1997.

njerëzore të pjesëtarëve të pakicave kombëtare; b) kur aktorët e konflikteve të vendit nuk janë në gjendje ose nuk dëshirojnë zgjidhje kompromise, dhe c) kur gjendja konfliktuoze kërcënon të rritet në konflikt të armatosur i cili do të mund ta rrezikonte paqen në botë. Pra në situatën kur aktorët e vendit të konflikteve sillen tejet me papërgjegjësi edhe ndaj popullit të vet edhe ndaj paqes botërore, bashkësia ndërkombëtare nuk do të mundet të qëndrojë neutrale dhe pasive, veçmas pas përvojave tragjike në Kroaci e Bosnje e Hercegovinë.

V

1. Çfarë është roli historik i vetëvendosjes për zhvillimin e demokracisë dhe të proceseve integruese në botë? Rreth kësaj mendimet janë bukur të ndara. Për një numër të autorëve parimi i vetëvendosjes gjithnjë e më shumë po bëhet faktor i ndarjes së popujve. Asaj i njihet roli pozitiv në shekullin XIX derisa janë krijuar kombet-shtetet e mëdha evropiane. Sot, ndërkaq, në kohën e integrimi tradicioale ky parim vepron ekskluzivisht shkatërrueshëm dhe është në funksion të profilimit të shteteve të vogla të paafta për jetë të pavarur (kleinestaterei).¹

Mendoj se është gabim në proceset integruese e demokratike të idhen me madhësinë e vendit, përkatësisht se të gjitha përparësitë gjenden në anën e të mëdhenjëve, kurse të gjitha negativitetet në anën e shteteve të vogla. Eksperiencia e botës bashkëkohore i kundërshton llojet e tilla të përgjithësimt. Sepse autoritariteti mund të jetë e metë edhe e shteteve të mëdha edhe të vogla, sikur që nuk është privilegj vetëm e shteteve të mëdha aftësia ekonomike dhe hapja për procese integrative.

Gjithashtu është gabim që shkaqet kryesore të çntegrimit të shteteve të përbëra nacionale të gjenden në parimin e vetëqeverisjes dhe shkatërrimin e atyre shteteve apriori ta shpallin si prapambetje shoqërore. Perandoritë e mëdha në të kaluarën vështirë do të ekzistonin në jetë edhe sikur të mos ishte parimi për vetëvendosje i Vilsonit dhe i Leninit, sepse u shkatërruan për shkak të dobësive inherente në vetë sistemin e atyre shteteve. Ngjashëm mund të thuhet edhe për disa ish federata socialiste. Ato, vërtetë u rrënuan nën goditjen e nacionalizmave dhe të kërkesës për vetëvendosje. Por sikur ato federata të kishin aftësi demokratike për jetë, ato do të ekzistonin pavarësisht nga parimi i vetëvendosjes dhe mundësia e keqpërdorimit nga ana e forcave nacionaliste.

E drejta për vetëvendosje është e drejtë fundamentale e popujve ashtu sikurse janë të drejtat dhe liritë individuale për qytetarët - individualë. Të dy këto të drejta sikurse dihet janë promovuar me Revolucionin Francez. Por e drejta për vetëvendosje, tek e fundit, edhe si çdo e drejtë tjetër, mund të instrumentalizohet. Mirëpo, mundësia e instrumentalizimit nuk do të ishte shkak i mirë që kjo e drejtë të kontestohet mbi baza historike, juridike apo mbi çdo bazë tjetër. Prandaj, na duket se, me rastin e dhënies së opinionëve për vlerat e të drejtave të popujve për vetëvendosje duhet të ruhemi nga dy skajshmëri: qoftë që me formën e mbrojtjes së tërësisë shtetërore të justifikohet unitarizmi dhe të fshehet represioni, qoftë që me formën e luftës për lirinë nacionale të fshehen ambiciet lideriste dhe shtetërore të elitave nacionale.

E drejta për vetëvendosje, sipas kësaj, nuk prodhon paraprakisht as vetëm rezultate të këqija as vetëm rezultate të mira. Kjo e drejtë siç vëren Miroslav Hrosh, vetvetiu ose siç thotë ai "në kuptimin shkencor" nuk është as "e mirë" as "e keqe": Ta quajsh parullë të nacionalizmit vetëm për shkak që e shfrytëzojnë forcat nacionaliste paraqet të paktën thjeshtësimin e problemit të ndërlikuar me të cilin po ballafaqohet bota bashkëkohore.²

Pra, ndaj secesionizimit nuk duhet të sillemi as paraprakisht me mohim as paraprakisht me absolutizim. Në disa raste, kur mungojnë mundësitë tjera më e mirë është ndarja se sa mbajtja me dhunën në kufijtë e një shteti. Sidomos në qoftë se kjo dhunë bëhet për t'u ruajtur pozicioni homogjenist të kombit

¹ Eric Hobsbawm, sic.

² Nations of nationalisme, ed. by Sukumar Periwai, London, fq. 65.

shumicë. Nga ana tjetër, secesionizmi mund të veprojë retrogradisht nëse absolutizohet, përkatësisht nëse insiston në të me çdo çmim pavarësisht nga mundësitë dhe zgjidhjet tjetërfaqëse të të drejtave nacionale. Atëherë, referimi në të drejtën për vetëvendosjen e popujve vërtet mund të bëhet parullë e nacionalizmave.

E drejta për vetëvendosje, sipas kësaj, mundet varësisht nga situata konkrete të çojë ose drejtë avancimit të demokracisë dhe në asociacionet e gjera integruese, ose në "ballkanizimin e botës dhe në luftërat e pandërprera".¹ Se cilës rrugë do të nisët realizimi i kësaj të drejte me rëndësi të veçantë janë veprimet e forcave demokratike dhe antinacionale në skenën politike të vendit dhe mbështetja e përcaktuar dhe e vendosur e bashkësisë ndërkombëtare dhënë këtyre forcave. Përvoja tragjike e luftës së porsapërfunduar në trojet e ish-Jugosllavisë, emeton vërejtje të fuqishme për të dy adresat.

VI

Është e vërteta e vjetër se problemi duhet të zgjidhet me njohjen e tij e jo me mohime të thjeshta dhe me dënime. Shkaqet më të shpeshta të konflikteve etnike të cilat po sjellin deri tek secesioni janë diskriminimi etnik, shpresa se shteti i ri do të mundësojë liri më të mëdha ekonomike e politike, dëshira për pushtet dhe prestigj të eliteve nacionale. Me këtë rast shkaqet ekonomike nuk është e thënë të jenë supreme. Sepse secesionizmi lind ehe në bashkësitë e zhvilluara etnike (baskët, katalonët, sllovenët, kroatët në ish-Jugosllavi) dhe në bashkësitë etnike më pak të zhvilluara (shqiptarët e Kosovës).

Meqenëse shkaqet e konflikteve etnike janë të ndryshme dhe duke marrë parasysh rrethanat e brendshme dhe ato ndërkombëtare, edhe format e zgjidhjes së këtyre rrethanave, natyrisht se janë të ndryshme. Ato ose janë paqësore - sikur ndarja e dikurshme e Norvegjisë e Suedisë (1905), dhe "ndarja e kadifit" e tashmë midis çekëve he sllovakëve (1993), ose zgjidhje të dhunshme si në ish-Jugosllavi (1991). Rusia më parë e mbështeti rrënimin paqësor të federatës sovjetike, por më pas, tërësinë e Federatës Ruse e mbrojti me ndërhyrjen ushtarake në Çeçeni (1994).

Perëndimi, bie fjala, përpos ndarjes së Norvegjisë dhe Suedisë më 1905 dhe krijimin e Republikës së Irlandës, më 1921, nuk e njeh më asnjë rast të secesionit gjatë njëqind viteve të fundit. Vërtet Perëndimi nuk është imun nga kërkesat e tilla, pra as nga metodat e terrorizmit çfarë janë në Irlandën Veriore dhe në Baski. Por tendencat e tilla janë pakësuar dukshëm, meqenëse shumë kërkesa nga aspekti i të drejtave nacionale janë përmbushur ose po përmbushen. Secesionizmat shumë me rrallë po paraqiten në Evropën Perëndimore se sa në Evropën Lindore e Juglindore. Demokracia dhe secesionizmi janë në lidhje tjetërfaqëse shkaktues pasojë, se sa në vendet e ish-federatës sovjetike ose jugosllave. Në Evropën Perëndimore demokracia vepron si preventivë kundër secesioneve eventuale, ia del që kërkesat e tilla t'i pacifikojë ose të paktën t'i reduktojë në minimum të mundësisë së shturjeve tragjike çfarë ka ndodhur në ish-Jugosllavi.

Përveç këtij fakti, pakicave evropërimore dhe popujve pakicë kohët e hapet po u hapet edhe perspektiva e asociacioneve rajonale evropiane. Tani më është në qarkullim ideja për bashkimin e Trentit, të Tirolit të Jugut e të Veriut në rajonin autonóm evropian të Tirolit (AERT), i cili do të kishte 1,52 milion banorë. Po hapet mundësia e "evropeizimit" edhe të popujve britanikë siç janë skotët dhe vellsianët, në kuptimin që krahinate tyre duke mbetur në kuadër të Mbretërisë së Bashkuar, të përfaqësohet edhe drejtpërdrejtë në Evropë me anë të formulës "Evropa Rajonale".² Se a do t'i heqin gjasat e tilla edhe definitivisht nga rendi i ditës kërkesat për secesion (shkëputje), mbetet për t'u parë. Por konsiderohet se asociacionet siç është Unioni Evropian, Evropa e Rajoneve, qysh tani po ia presin rrugët "nacionalizmit aventurist".³

Në një numër të vendeve të postsocializmit në Lindje dhe Juglindje në Evropë gjërat qëndrojnë krejt

¹ Sic. fq. 151.

² Brana Marković, op.cit.

³ Tamir, sic, fq.XV.

ndryshe. Proces i tranzicionit po shënohet me vështirësi të kalimit nga demokracia etnike në të qytetare. Elitat në pushtet po e ngadalësojnë procesin e tranzicionit nga frika se demokracia qytetare mund ta trimërojë secesionizmin ose, se grupet shumicë etnike mund të bëhen të barabarta. Sistemet e etnokrasisë nuk kanë vesh jo vetëm për të drejtat qytetarëve veç as për të drejtat kolektive të nacionaliteteve pakicë. Këto sisteme multikulturalizmin e përjetojnë të shpeshtë si e keqe e domosdoshme, e cila nëse nuk mund të eliminohet me spastrimin etnik ose me "transferim human", duhet mbajtur nën kontrollin e shtetit me rregullim centralist. Këto sisteme, meqenëse nuk lënë hapësirë të mjaftueshme për zgjidhjen demokratike të konflikteve etnike, vazhdimisht prodhojnë secesionizme. Tek grupet etnike pakicë krijohet vetëdija për pamundësitë e jetës së përbashkët me pjesëtarët e kombit shumicë, dhe se e vetmja mënyrë e ekzistimit të tyre si etnos është vetëvendosja dhe shteti i veçantë.

Vëmendjen e posaçme në këtë aspekt e tërheqin proceset brenda Federatës të formuara etnikisht nga marrëdhëniet reciproke të të cilave vret integriteti territorial dhe stabiliteti politik i vendit. Rusia në këtë aspekt ka treguar një fytyrë të dyfishtë: atë imperiale dhe demokratike. Përzihen dhe bien në konflikt dy qasje, dy metoda: metoda e forcës përfshirë edhe veprimet luftarake si në Çeçeni dhe metoda e marrëveshjeve demokratike me republikat anëtare të Federatës. Konflikti i armatosur në Çeçeni të cilin sipas analistëve të rrethanave ruse e kanë nxitur "partitë e luftës" si në njërin ashtu edhe në palën tjetër, i ka sjellur dëme të mëdha edhe stabilitetit të brendshëm edhe pozitës ndërkombëtare të Rusisë postsovjetike. Përvojat tragjike të asaj lufte (sipas disa vlerësimeve mbi 100.000 të vrarë, shkatërrimet e Groznit krahasohen me shkatërrimet e Varshavës në Luftën e Dytë Botërore), kanë shërbyer për t'u kuptuar në strukturat udhëheqëse të shoqërisë se arma nuk është mjet më i mirë për t'u mbrojtur integriteti territorial i Federatës Ruse. Përkatësisht se metoda e dialogut dhe e marrëveshjeve mund të shërbejë shumë më mirë për eliminimin e premisave për konflikte në relacionin qendra-republika dhe për neutralizimin e mikroetno-nacionalizmit.¹

Fytyra tjetër e Federatës Ruse pasqyrohet në faktin se qendra federale e ka futur praktikën e lidhjes së një vargu të kontratave me republikat, rajonet autonome dhe rrethet me rëndësi federale të cilët përmbajnë ndarjen e kompetencave midis qendrës dhe njësive federale. Këto kontrata të hartuara posaçërisht me ato republika të cilat janë konfrontuar me qendrën federale (Tatarstani, Bashkorstani, Jakutia, etj.). Kontrata me Tatarstanin përmban elemente të marrëdhënieve federale e konfederale (p.sh. supermacioni i ligjeve të vendit mbi ato federal, themelimi i bankës nacionale e ngjashëm). Këto kontrata, veçmas me Tatarstanin, paraqesin kompromisin me të cilin njëra palë (njësia federale), e njeh kushtetutën e Federatës Ruse, kurse pala tjetër (qendra federale) e njeh shkallën e lartë të mvetësisë së njësive federale.²

VII

Cilat mesazhe mund të nxirren nga përvojat e deritashme evropiane? Mesazhi i parë është gjithësesi se ndaj çështjeve të drejtave dhe lirive nacionale duhet të sillemi pa paragjykime të cilitdo lloji, që ato të mos trajtohen si fetishe, por as si fantazma të së kaluarës, veç si fakte reale të jetës me të cilat do të jetohet gjatë kohë edhe në shekullin që është para nesh.

1. Përvoja evropiane dëshmon se popujt dhe pjesët e popujve nuk munden, në fund të shekullit XX të mbahen të nënshtruar. Metodat e eliminimit të konflikteve etnike me asimilime (të dhunshëm ose "demokratike"), me transferime "humane" të popullatës ose me "spastrime etnike", po zëvendësohen me metodat e drejtimit demokratik të këtyre konflikteve. Të gjitha federatat evropiane bashkë me Kanadanë dhe Britaninë e Madhe, po përjetojnë krizën, sepse praktika po e hudh poshtë centralizmin e unitarizmin si

¹ Proces demokratizacije i etnicki odnosi u SR Jugoslaviji, Deo o SSSR i Ruskoj Federaciji, fq. 73, gjithashtu Nation and identity in contemporary Europe, fq. 246.

² Proces demokratizacije i etnicki odnosi u SR Jugoslaviji, Deo o SSSR i Ruskoj Federaciji, fq. 35-36.

sistem të drejtimit të bashkësisë së përbërë nacioale, kudo që në rend të ditës gjendet kërkesa për devolucionin e pushtetit qendror. Me këtë po ballfaqohen edhe vendet tradicionale demokratike, si Britania e Madhe dhe vendet në tranzicion siç janë Federata Ruse dhe Republika Federale e Jugosllavisë. Botkuptimet e mëparshme konservativo-burkokratike dhe imperiale se devolucionin e pushtetit e dobëson shtetin, po ua lëshojnë vendin bindjeve se me devolucionin e pushtetit krijohen raportet e barazisë nacionale të cilat e forcojnë shtetin.

Brenda teorisë klasike liberale po zhvillohet drejtimi i liberalizimit të ri i cili e bashkon idenë e multikulturalizmit me parimet liberale të lirive individuale. Zgjidhjet për konfliktet etnike të shpeshtë janë kërkuar e po kërkohen në format e ndryshme të autonomive, rregullimet kantonale e federative të shteteve, në kohën e fundit edhe në "Evropën e rajonale".

2. Edhe përkundër dallimeve të ndërsjella, ekziston përvoja e përbashkët edhe e njëres edhe e pjesës tjetër të Evropës se me dhunë nuk mund të shtypen aspiratat e popujve për liri, e as që arma është mjet efikas dhe i sigurt në luftën për të drejtat nacionale sado që ato janë të arsyeshme.

Në Irlandën Veriore, pas gati tetë dekadash të aksioneve të armatosura të IRA-s dhe tri dekadave të interevnimit ushtarak të armatës britanike, Qeveria laburiste me ardhjen në pushtet (maj 1997) i inicoi negociatat paqësore; në Baski aksionet e armatosura të organizatës ETA, që po zgjasin nga zbatimi i diktaturës së Frankos (mbi gjysëm shekulli), po përjetojnë mbështetjen gjithnjë e më të vogël të vetë baskëve, përpjekjet e secesionit të serbëve në Kroaci e Bosnjë e Hercegovinë më parë përjetuan disfatë ushtarake e pastaj edhe politike; në Çeçeni intervenimi ushtarak i ushtrisë federale dy vjet pas luftimeve përfundoi me marrëveshjen e autoriteteve ruse me autoritetet e reja çeçene.

Duket se u ka ardhur fundi strategjive se për zgjidhjet politike të problemeve nacionale më parë duhet luftuar në fushëbetje. Cilido konflikt i armatosur etnik vështir mundet, në kushtet bashkëkohore të ndërlidhjes së përgjithshme dhe varësisë së ndërsjellë të shteteve, të kalojë si "luftë lokale", si ekskluzivisht "çështje e brendshme" e ndonjë vendi. Përveç kësaj, në konfliktet e këtilla të shpesh nuk ka fitimtarë, sepse edhe pas luftës duhet të bisedohet, por vetëm pas shumë viktimeve e shkatërrimeve, dhe gjithësesi në kushte tepër më të pavolitshme për të gjitha palët në konflikt.

3. Është gjithësesi inkurajuese fakti se vatrat e konflikteve etnike po zvogëlohen ose janë në rrugë për t'u sjellur në suaza të durueshme. Tiroli i Jugut i ka sjellur lehtësi Unionit Evropian e janë të mëdha gjasët që në mënyrë të vulltshme të zgjidhet edhe problemi i Irlandës Veriore. Terrorizmi i organizatës ETA po e humb mbështetjen të vetë baskëve. Ka mbetur problemi i Qipros si problem më i ndërlikuar i NATO-s, meqenëse edhe Turqia edhe Greqia janë anëtare të saj. Situatën relativisht të qetë e ka ndryshuar Kosova e cila, pas Dejtonit, po shndërrohet në problem më të ndërlikuar jo vetëm në Evropën Perëndimore veç në mbarë Evropën.

4. Në kërkimet për zgjidhjet e mundshme të problemit të Kosovës përpos atyre botërore nuk duhet harruar as përvojat e vendit të lindura në truallin e ish-Jugosllavisë siç janë plani Z-4, Kushtetuta e Bosnjës e Hercegovinës, e veçmas statusi i Republikës Serbe brenda atij shteti. Planit Z-4, pavarësisht që nuk përjetoi të realizohet, ilustron variantin e mundshëm të zgjidhjes së çështjeve minoritare në shtetin e ndërlikuar etnik. Ky plan i destiuar për rregullimin e statusit kushtetues të "Republikës së Krainës Serbe" në Kroaci, formalisht e juridikisht dhe faktikisht ka parashikuar për serbët në Kroaci "shtetin në shtet".

Nuk duhet lënë pas dore se përvojat (pra si ato pozitive ashtu edhe ato negative) nga Jugosllavia e mëparshme (e AVNOJ-it). Kosova dhe Vojvodina, sikurse dihet, ndonëse jo në kuptimin formal, de facto kanë pasur statusin e njësive federale. Problemet që i ka pasur për këtë shkak Serbia me kompetencat e veta si shtet kanë qenë dashur dhe kanë filuar të shqyrtohen dhe të kërkohen zgjidhje më të mira si në bisedime me Kosovën e Vojvodinën, ashtu edhe në bisedime në nivelin federal. Deri tek disa zgjidhje në ato bisedime erdhi, për këtë ekzistojnë edhe gjurmët e shkruara. Prandaj, do të vlente që të paktën në kuptimin joobjektiv të shihet se çfarë zgjidhjesh të përbashkëta atëherë u arritën, para se kryetari aktual i RFJ Slobodan Milosheviqi t'i ndërprejë ato bisedime dhe me pezullimin me dhunë të dy autonomive dhe me përtëritjen e

centralizmit shtetëror ia doli që "Serbia nga tri pjesë të bëhet e tërë".

5. Problemi i Kosovës është rast i parë individual i cili e ka vënë vetvetën në fokusin e politikës ndërkombëtare, me zgjidhjen e të cilit bukvalisht janë okupuar fuqitë më të mëdha botërore dhe organizatat ndërkombëtare. Unioni Evropian, Kombet e Bashkura e madje edhe NATO. Bota, qartë, e mësuar me përvojat e tragjedisë jugosllave po don të pengojë që me konfliktet e reja luftarake në Ballkan të futet në katastrofën luftarake me përmasa të gjera. Angazhimi i tillë i saj është shprehje edhe e njohurisë në rritje se pa zgjidhjen e vatrave të konflikteve etnike nuk mund të ketë as paqe të qëndrueshme as rezultate më të mëdha në planin e integritimit evropian. Në këto përpjekje të veta, Bashkësia Ndërkombëtare ka ardhur tek qëndrimi: as pavarësia e Kosovës, as status quoja, veç formë e gjerë e autonomisë brenda Serbisë dhe RF të Jugosllavisë. Pra, Bashkësia Ndërkombëtare po qëndron në aspektin që zgjidhja e qëndrueshme nuk gjendet as në rregullimin ekzistues unitaristo-centralist të shtetit serb, por as në formimin e mini-shtetit të pavarur shqiptar, veç në kërkimin e zgjidhjes së tillë e cila shqiptarët e Kosovës i vë në pozitë që të mund të vendosin autonomisht për çështjet e veta dhe në mënyrë të barabartë mbi çështjet e tërësisë së bashkësisë së shtetit. E gjithë kjo, kuptohet duhet të përcillet me proceset e përshpejtuara të demokratizimit në mbarë vendin me qëllim që sistemi i demokracisë etno-autoritare të transformohet në sistem të demokracisë plurale dhe në bashkësinë e popujve të barabartë.

Milenko MARKOVIQ

SHTESA

SPANJA

Spanja është një nga vendet e rralla evropërdimore e cila nu ia ka dalur, si edhe vendet tjera të atij rajoni, të konstituohet si komb-shtet sipas parimit liberal "një komb - një shtet". Prapavija historike e këtij mossuksesit gjendet në renien ekonomike, politike dhe ushtarake të Spanjës nga pozicioni i fuqisë botërore në periferinë e varfër të Evropës Perëndimore në fund të shekullit XIX. Lufta spanjolo-amerikane nga viti 1898 në të cilën Spanja përjeton disfatë të rëndë, merret si datë e kësaj kthese vendimtare.

Bërthamën e shtetit spanjoll në shekullin XIX e përbëjnë Kastila me Madridin si kryeqendër dhe krahinat historike siç janë Katallania, Baskia, Galicia. Këto krahina kanë pasur gjuhë të veçanta në përdorimin e përditshëm, ndonëse gjuha zyrtare në institucionet shtetërore dhe në arsim ka qenë gjuhë kastiliane (spanjole). Përpos dallimeve territoriale e gjuhësore, këto krahina të përmendura janë dalluar nga Kastila edhe në kuptimin ekonomik. Derisa pushteti politik ka qëndruar në qendër, synimi i zhvillimit ekonomik është batur në periferi në shekullin XIX. Veçoritë territoriale, ekonomike dhe kulturore-gjuhësore, posaçërisht të Katallanisë dhe Baskisë krijuan vetëdijen për karakteristikat e identitetit të tyre kombëtar.

Përkundër centralizmit dhe unitarizmit të Qendrës, shumë herët, qysh në fund të shekullit të XIX-të filloi të zhvillohet i ashtuquajti "Nacionalizmi periferik", veçmas në Katallani dhe Baski, e bukur vonë edhe në Galici. Ai nënkuptonte kërkesat për decentralizimin, rajonalizimin dhe përfundimin e dominimit të elitës latifundiste, aristokrate dhe anakronike të Madridit.

Në kohën e Republikës së Dytë (1932-39), shteti spanjoll ishte diç midis shtetit unitar dhe federal. Atë e kanë përbërë tri "kombe historike" (katallanët, baskët dhe galicët si dhe rajonet), në të cilat u bartën pjesët e kompetencave të pushtetit qendror. Statuti i autonomisë së Katallanisë u konfirmua më 1932 me referendumin në atë krahinë dhe nga ana e Madridit; statusi i Baskisë në prag të shpërthimit të luftës civile; statutet e Galacisë, Andaluzisë, Majorkës, Valencisë dhe Asturisë më 1936. Gati në të gjitha autonomitë dhe rajonet në pushtet gjendej e majta dhe republikanët, me çka autonomia rajonale është identifikuar me të majtën. Mirëpo, për funksionimin e autonomisë kishte pak kohë paqësore duke marrë parasysh shpërthimin e luftës civile.

Në kohën e diktaturës së Frankos, autonomizmi bashkë me komunizmin dhe ateizmin janë kualifikuar si armik të përbeuar të shtetit spanjoll kundër të cilëve u zhvillua "lufta e kryqëzatave". Për shembull përdorimi i gjuhës katallane ose baske në vendet publike trajtohej si vepër penale. Përpos masave të represionit, masovikisht janë sjellur kanstilianet me çka dukshëm është ndryshuar struktura etnike e popullatës. Kah fundi i vitit 1970 kolonistët përbënin 37% të popullatës së Katallanisë e Baskisë.

Pas rënies së diktaturës së Franos, procesi i tranzicionit demokratik filloi me përsëritjen e autonomive. Përvoja me diktaturën e Frankos tregoi se çdo kthim i demokracisë është i lidhur ngushtë me përtëritjen e autonomive. Politika e partisë dominuese (UCD centraliste e Adolfo Suaresit dhe PSOE socialiste) duke e kuptuar këtë mesazh, e panë nvojën e përtëritjes së autonomive ndonëse njëkohësisht shpreheshin rezerva ndaj federalizimit të Spanjës, sepse në implikimet federaliste sheh rrezikun nga dobësimi i pushtetit qendror të shtetit. Prandaj, kushtetuta e miratuar më 1978 paraqiti në njëfarë kuptimi kompromisin midis unitarizmit dhe federalizmit, ngjashëm me rregullimin shtetëror nga koha e Republikës së Dytë.

Kushtetuta e re parashikon dy lloje të autonomisë: autonomitë për "kombet historike" - Katallaninë, Baskinë e Galacinë dhe shkallën më të ulët të autonomisë për provincat tjera. QË edhe provincat tjera të mundën të realizojnë shkallën më të lartë të autonomisë duhet ta kalojnë paraprakisht një procedurë tejet të ndërlikuar. Aspekti themelor është që autonomitë të krijohen "nga lartë", që do të thotë se janë "peshqesh i shtetit". Përkundër kësaj, Katallania dhe Baskia qëndrojnë në aspektin se autonomitë e tyre burojnë nga të drejtat thelbësore nacionale.

Këto dhe çështjet e ngjashme janë në fokusin e kontestimeve me rastin e autoive dhe të perspektivave të zhvillimit të tyre. Këto konstatime, do të thoshim, përqëndrohen në kërkimin e përgjigjeve se për cilin model të shtetit të përcaktohem: modelin e decentralizuar (sipas modelit italian), atë federal ose konfederal.

KATALLANIA DHE BASKIA

Separatizmi kurrë nuk ka pasur rrënjë të thella në Katallani. Rryma kryesore në lëvizjen nacionale e proklamoi të drejtën për vetëvendosje, por nuk e njejtëson me separatizmin. Ajo këtë të drejtë të vet e lidh me shumë me kontekstin evropian i cili presupozon më shumë autonomi për Katallaninë por në kuadër të Spanjës. Mbështetja ndaj shkëputjes sillet midis 12 dhe 20% të popullatës. Njëra nga partitë politike e cila në zgjedhjet e vitit 1992 doli me platformën e pavarësisë fitoi gjithsej 10% të viteve. Në Katallani rreth 10% e popullatës insiston në identitetin etnik, por për këtë shkak është në rritje numri i atyre të cilëve e favorizojnë identitetin dual (edhe spanjoll edhe katallan), dhe përdorimin e të dy gjuhëve.

Lëvizja nacionale baske dukshëm dallon nga ajo katalloae, gale dhe e provincave tjera. Me dallim nga vendësit katallanë, borgjezia baske ka refuzuar integrimin në sistemin ekonomik e politik spanjoll. Lëvizja nacionale baske që nga fillimin ka qenë me orientim të theksuar separatist. Në këtë me siguri kanë ndikuar karakteri jolatini i gjuhës, përzierja e fuqishme e katolicizmit dhe ekskluzivitetit racor, për çka kjo lëvizje nuk ka gëzuar simpatitë dhe mbështetjen e forcave majtiste.

Pjesa e saj më militante e përqëndruar në organizatën ETA e ka proklamuar si qëllim të vetin bashkimin e të gjithë baskëve që jetojnë në Spajë dhe Francë në shtetin unik nacional. Vitet e fundit të diktaturës së Frankos nga vitet 1960, ETA vendos për veprime terroriste si metoda të luftës për pavarësi që ruhet deri në ditët e sotme.

Mirëpo, terrorizmi edhe pse po aplikohet tanimë gati katër dekada nuk ka dhënë rezultate të pritura. Edhe në vetë organizatën e ETA-s, terrorizmi nuk e ka mbështetjen e pandarë qysh nga viti 1976. Atë e denojnë të gjitha partitë parlamentare, më 1988, me përjashtim të përfaqësuesit të rrymës pakicë në organizatën ETA. Te populli bask terrorizmi po përjeton dënimin gjithnjë më të shpeshtë e më masiv. Rreth 80% të popullatës baske shpreh dënimin pazezervë të terrorizmit të ETA-s (edhe në Baski ngjashëm si në Katallani po rritet gjithnjë e më shumë disponimi për gjetjen e "modus vivendi" brenda kufijve të shtetit spanjoll).

Sipas mendimit të disa autorëve, Spanjës nuk i kanoset dezintegrimi nacional në saje të përvojave të demokracisë stabile.

TIROLI I JUGUT

Tirolit i Jugut me kontratën e Sen Zhermenit mbi paqen (1919) i është dhënë Italisë si shpërblim për kalimin e saj në anën e Antantës së madhe në Luftën e Parë Botërore. Me kontratën e njëjtë Italisë iu bashkangjiti edhe provinca e Trentinos. Në këto dy raste parimi i Vilsonit mi vetëvendosjen është trajtuar në mënyra të ndryshme. Derisa provincës Trentino iu mundësua që të shfrytëzojë të drejtën për vetëvendosje, pakicës gjermane, e cila përbënte 86% nga 250.000 banorë të Tirolit të Jugut nuk iu dha rasti që ta shfrytëzojë këtë të drejtë. Nuk pati referendum si me rastin e sllovenëve të Korushkës (sipas censurit nga vitit 1991, 66% të banorëve të Tirolit të Jugut i takojnë grupit etnik gjerman, 28% atij italian dhe 4% grupit landin).

Italia, në përpjekjet për ta integruar Tirolin e Jugut në sistemin e vet kushtetuese-juridik bëri çmos për ta ndryshuar strukturën e popullatës në dobi të italianëve. Pakica gjermane, veçmas pas ardhjes së fashistëve në pushtet më 1922, iu ekspozua formave të ndryshme të çkombëtarizimit me çka duhej të realizohej italianizimi i Tirolit të Jugut. Karakteristikat e këtij "spastrimi etnik" manifestohet me ndalimin e organizimit politik e kulturor, me ndalimin e përdorimit të gjuhës gjermane e të toponimeve gjermane, me zëvendësimin e nëpunësve gjermanë me ato italianë në shërbimet publike, me stimulimin e vendosjes së italianëve në territorin e Tirolit të Jugut. Kulmi i kësaj politike u arrit me paktin midis Hitlerit e Musolinit, më 1939, i cili banorët e Tirolit të Jugut i vuri alternativës ose të shpërngulen ose të pajtohen me statusin ekzisites brenda shtetit italian. Me atë rast u shpërngul në Gjermani një numër i konsiderueshëm i gjermanëve me çka dukshëm u ndryshua struktura etnike në favor të Italisë. Në vitin 1943, p.sh. në Tirolin e Jugut kanë jetuar 176.000 gjermanë kundrrull 105.000 italianëve.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, forcat aleate nuk e pranuan idenë për rianeksimin e Tirolit të Jugut në dobi të Austrisë, por i inicuan bisedimet midis Gruberit, ministrit austriak të punëve të jashtme dhe përfaqësuesin e qeverisë italiane Degaspari, të cilat rezultuan me Marrëveshjen e Parisit (1946).

E nxitur nga Marrëveshja e Parisit, Italia miraton statutin e parë mbi autonominë për rajonin e Trentinos-Tirolit të Jugut (1948). Më përpara qeveria italiane i bashkoi Trentinon dhe Tirolin e Jugut në rajonin unik (Trentino-Alto Adidge), me çka u realizua shumica italiane, duke qenë se në Tirolin e Jugut shumicën e përbënte popullata gjermane. Statuti menjëherë hasi në moskënaqësi të pakicës gjermane të cilën e shndërroi në konflikt me qeverinë qendrore në Romë. Kjo moskënaqësi veçmas në vitin 1960 u shndërrua edhe në aksione të numërta terroriste dhe sabotazhe në hapësirën e Tirolit të Jugut.

Kjo e motovioi Austrinë që më 1960, çështjen e Tirolit të Jugut ta nxjerrë para Kombeve të Bashkuara. Kësaj iu kundërvu Italia sepse konsideronte se Tirolit i Jugut është çështje e saj e brendshme. Me Rezolutën nr. 1947 XV, KB e detyruan Italianë që të zhvillojë negociatën me Austrinë mbi të gjitha dallimet që kanë të bëjnë lidhur me interpretimin e Marrëveshjes së Parisit. Me këtë përfunduan pretendimet italiane që autonomia e Tirolit të Jugut të trajtohet si çështje ekskluzive e brendshme italiane.

Pas shumë zvarritjesh, marrëdhëniet e këqia midis Italisë e Austrisë, e madje edhe të kryengritjeve të armatosura të gjermanëve, ia dolën që më 1969 të arrihet ujdia për zgjerimin e dukshëm të autonomisë së Tirolit të Jugut (i. ash. Paket.). Me këtë paket u miratuan 137 masa për t'u inkorporuar në autonominë e Tirolit të Jugut në bazë të të cilave u ndryshua Statuti i autonomisë (1972).

Rajoni Trentino-Alto Adigje përbëhet nga dy provinca: Trento dhe Tirolit i Jugut (Bolzano). Ndryshimi kyç është në transferin e pushtetit legjislativ dhe administrativ nga qeveria rajonale e Trentino-Alt Adigje në dy provinca autonome-Trento dhe Tirolit i Jugut (Bolzano), që e kënaqi pakicën gjermane meqenëse ajo përbënte dy të tretat e popullatës së Tirolit (Bolzano). Pasi që edhe masa e fundit nga 137 të parashikuarat u zbatua në jetë, Austria doli me deklaratën se kontesti i saj me Italinë me rastin e implementimit të Marrëveshjes së Parisit ka përfunduar. Nga paketi i masave dhe statuti i ri atëherë datojnë edhe marrëdhëniet më normale midis Italisë e Austrisë.

Provincat autonome (Trento dhe Tirolit i Jugut) i shfrytëzojnë tri lloje të kompetencave: kompetencat primare (legjislative) kompetencat sekondare të cilat i ndanë me qeverinë qendrore dhe kompetencat tradicionale të cilat i mundësojnë provincës për t'i plotësuar ose dhënë forma konkrete ligjeve të cilët i miraton parlamenti nacional italian. Provinca Tirolit i Jugut (Bolzano) disponon kompetencat primare në shumicën e çështjeve në fushën ekonomike, politike e kulturore. Këtu bie fjala bëjnë pjesë bujqësia, xehetaria, turizmi, zejtaria, zhvillimi urban, institucionet e kulturës, etj. Me kompetencat sekondare mbulohej midis tjerash tregtia, prodhimi industrial, shëndetësia, arsimimi fillor dhe i mesëm. Në çështjet siç janë mbrojtja, sistemi juridik, PTT, sistemi tatimor (të paktën pjesërisht) dhe politika e jashtme, provinca Bolzano posedon vetëm kompetencat terciare, do të thotë që ta plotësojë ose konkretizojë zbatimin e ligjeve nacionale.

Provinca Tiroli i Jugut (Bolzano) ka të drejtën e mbajtjes së 90% të tatimit nga territori i saj. Burimi tjetër i të hyrave të saj janë dotacionet nga buxheti i shtetit i cili është tri herë më i madh se për provincat tjera. Me statut është parashikuar që Tiroli i Jugut (Bolzano) të disponojë pavarësisht të ardhurat e veta.

Në qoftë se shkaktohet konflikti i kompetencave midis autonomisë dhe shtetit, kontestin e zgjedh Gjyqi Kushtetues. Në këto çështje, ndërkaq është e pranishme mungesa e garancave ndërkombëtare për ruajtjen e të drejtave autonome të Tirolit të Jugut.

Sa i përket kohabitimit etnik në parlament, statuti vendos sistemin e kontrollit dhe të garancioneve në forma të ndryshme: parimine votimit diferenciar, formimin e komiteteve për zgjidhjen e kontesteve ndëretnike që janë konstituuar në bazë të paritetit, mundësinë për t'iu drejtuar Gjyqit Rajonal të Drejtës Administrative, dhe si instancë të fudit për t'iu drejtuar Gjyqit Kushtetues të Italisë. Mirëpo, situata legale e autonomisë së Tirolit të Jugut është se ajo nuk është e përfaqësuar edhe në nivelin nacional, prandaj nuk mund të ushtrojë ndikim në vendimet që merren në atë nivel.

Edhe krahas rezultateve të mira të masave të përmendura dhe të aplikimit të statutit, autonomia e Tirolit të Jugut nuk e ka pavarësinë e plotë financiare siç e kanë bie fjala kantonet zvicerane, e as që ka marrë fund praktika që pëlqimin për ligjet e jep Roma. Ky ende nuk është transfer i tillë i pushtetit në autonominë, duke ia lënë Italisë vetëm ato kompetenca që i përkasin mbrojtjes, politikës së jashtme, judikaturës dhe politikës monetare. Me këto deri më tash është arritur që të "jetohej pranë" e jo që të "jetohej me".

Është interesante se pika e fundit nga 137 sa ishin në paketin e përmendur, Italia porsa i ka përmbushur në vitin 1992. Pra, u nvojiten të kalojnë pesë dekada që Tiroli i Jugut të marrë formë të kënaqshme të autonomisë (prej vitit 1919-1969), por edhe 23 vjet tjera për t'iu realizuar edhe pika e fudit e paketit të përmendur (prej 1969 deri më 1992).

BELGJIKA

Territori i tashëm i Belgjikës historikisht ka qenë nën sundimin më parë të Spanjës e pastaj të Perandorisë austriake, që në fund të shekullit XVIII ta aneksojnë francezët. Si shtet i pavarur ekziston ga viti 1830. Me krijimin e Belgjikës së pavarur janë eliminuar pretendimet historike etnike të Francës e të Holandës ndaj territorit të saj. Sepse popullatën dominuese e kanë përbërë franko-romanët (valonët) etnikisht të afërt me francezët dhe flamanët, etnikisht të afërt me holandezët, me një përqindje të vogël të gjermanëve.

Belgjika ka startuar si mbretëri parlamentare dhe në periudhën më të gjatë të ekzistencës së vet rregullimi i saj shtetëror ka qenë kryesisht model centralist-monarhist.

Funksionimin e shtetit belg që nga fillimi e kanë ngarkuar konfliktet etniko-linguiste midis valonëve dhe flamanëve. Një kohë të gjatë hallkat kryesre të pushtetit politiko-administrativ, ekonomik, arsimor i kanë mbajtur valonët. Gjatë shekullit XIX ndonëse flamanët popullatë shumicë (57%) në sferën publike ka dominuar gjuha frenge. Pas një kohe të gjatë të rezistencës së hegjemonisë së valonëve, miratohet ligji (1932) me të cilin pezullohet bilinguizmi në Flandri dhe formohen dy rajone njëgjuhësore (unilinguiste) - Flandria dhe Valonia.

Tek në vitet e 70-ta të shekullit XX fillon federalizimi i Belgjikës, që përfundimisht 1922-23 të formohet si Federatë. Shtetin federativ e përbëjnë dy rajone etno-territoriale (flaman dhe valon) dhe një rajon i përzier (Brukseli). Në krye të këtyre rajoneve gjenden këshillat rajonale (një lloj qeverie), kurse brenda tyre konstituohen edhe komitetet komunale.

Ridistribiuimi i pushtetit është bërë ashtu që shumë kompetenca të qendrës janë bartur në këshillat rajonale dhe në komitetet komunale (mediat, turizmi, shëndetësia, kujdesi social, sfera e kulturës,

urbanizimi, mbrojtja e ambientit, komunaliet, zhvillimi ekonomik rajonal, përgjegjësitë e caktura në fushën e bujqësisë dhe të tregëtisë së jashtme, etj.). Këshillave rajonale u janë dhënë të drejtat që të mundën vetë të lidhin kontrata me shtetet tjera nga fusha e kompetencave të tyre.

Qeveria federale i ka mbajtur kompetencat në fushën e politikës fiskale, mbrojtëse, politikës së jashtme dhe të sigurimit social.

KONFEDERATA ZVICRANE

Zvicra është një ndër konfederatat më të vjetra në Evropë. Pavarësia e konfederatës është njohur me Paqen e Vestfalit në vitin e largët 1648. Nga atëherë daton edhe neutraliteti i saj. Federatë bëhet më 1848, ndonëse e mban emërin e mëparshëm "konfederata". Kushtetuta e miratuar më 1874 është në fuqi edhe sot ndonëse ndërkohë e plotësuar me një numër të madh të ndryshimeve e plotësimeve.

Zvicra përbëhet nga 25 njësi fedetale - 22 kantone dhe katër gjysmëkantone të cilët më pak dallime në kuptimin kushtetues juridik janë plotësisht të barabarta me kantonet. Specifiteti i kantoneve të Zvicrës qëndron në faktin se shumica e tyre është formuar qysh në Mesjetë, për çka "territoret e tyre historike" respektohen dhe garantojnë me Kushtetutën Konfederale. Kantonet dallojnë mes veti edhe për nga madhësia e territorit dhe numri i banorëve. Në raport me madhësinë distanca sillet midis 77 km² dhe 7.106 km², kurse numri i banorëve midis 13.4000 dhe 1.100.000 banorë.

Për nga struktura e popullatës Zvicrane është vend multientnik. Sipas përbërjes etnike më shumë i përngjanë vendeve ballkanike (por vetëm sipas kësaj). Atë e përbëjnë kryesisht gjermanët (rreth 75%), francezët (20%), dhe italianët (4%), diaspora e tri shteteve amë fqinjë. Në 12 kantona dhe 6 gjysmëkantone shumicën e përbën popullata e gjuhëfoljes gjermane (sillet midis 77% dhe 96%), në katër kantone mbisundon popullata e gjuhës italiane (86%), dy kantona janë dygjuhësore (francezo - gjermane), kurse një kantone është tregjuhësor (gjerman - italian - retoroman).

Të tri gjuhët janë të barabarta në përdorimin zyrtar. Me ndryshimin e kushtetutës më 1938, është njohur gjuha retoromane të cilët e flasin gjithsej rreth 1% të zvicranëve.

Sadoqë në një numër të kantoneve mbisundon një gjuhë, në numrin tjetër të kantoneve ndojë gjuhë e dytë apo e tretë, kufij të kantoneve nuk janë shënuar rigorozisht sipas vijave etnoghjuhësore por edhe zhvillimi të pakten tani për tani nuk po shkon në këtë drejtim. Në një pjesë të mirë të Zvicrës banorët e gjuhëve të ndryshme jetojnë të përzier. Barrierat gjuhësore nuk kanë kushte të volitshme edhe për faktin se numri më i madh i banorëve flet të paktën dy gjuhë, të shpesh të gjermanisht dhe frengjisht.

Në bazën e sistemit politik dhe të federalizmit është njeriu qytetari e pastaj përkatësia e tij nacionale. Federalizmi zvicran e respekton përbërjen shumënacionale të popullatës shfaq kujdes për përfaqësimin e barabartë të nacionaliteteve në organin ekzekutiv të Federatës për të drejtat dhe liritë e tyre në sferën e kulturës gjuhës dhe arsimit. Por kushtetuta nuk e lejon edhe supermacinë e parimit nacional në rregullimin e shtetit. Sikur ta lejonte këtë atëherë Federatën Zvicrane do ta përbënin jo 26 kaontone por vetëm tri bashkësi etnike.

Organi më i lartë i Federatës është Parlamenti Federal i cili ka dy dhoma: Dhomen Nacionale dhe Dhomen e Shteteve. Dhomen e parë me 200 deputetë e zgjedhin të gjithë qytetarët, kurse dhomen e dytë me 46 deputet e delegojnë kantonet (kantonet nga 2, gjysmëkantonet nga një deputet). Parlamenti federal (të dy dhomat) e zgjedh organin e vet ekzekutiv - Dhoma Federale (qeverinë) nga shtatë anëtarë të mundshëm. Gjatë zgjedhjes shfaqet kujdes për përkatësinë etno-gjuhësore, rajonale dhe partiake të anëtarëve. Nga vitit 1959, në Dhomen zgjidhen nga dy prej tri partive më të mëdha parlamentare (socialiste, radikale dhe kozervative), dhe një përfaqësues nga partia e katërt bukur të dobësuar agrare. Qeveria nuk funksionon sipas parimit të mandatit imperativ veç sipas parimit të vendosjes së shumicës.

Kantonet në kohën kur Zvicra ishte Konfederatë kishin statusin e mini-shteteve sovraane. Në sistemi bashkëkohor federal, kantonet nuk kanë më sovranitetin burimor (është kufizuar me sovranitetin e shtetit federal) por edhe shumë autorizime ndërkohë kanë kaluar në shtetin federal.

Ndonëse bën pjesë në rradhët e vendeve më stabile demokratike të Perëndimit, Zvicra ka konfliktet e veta të brendshme të cilat nganjëherë i sjellin në pikëpyetje edhe vetë themelet e Federatës.

Karakteristika e këtyre konflikteve qëndron në faktin se të shpeshën janë të natyrës socialo-politike ndonëse në kohë të re këto konflikte po shkaktojnë edhe polarizime etnike. Ndarje të thella ka shkaktuar edhe pyetja nëse duhet Zvicra të anëtarësohet në Bashkimin Evropian. Ata që ishin kundër dolën me argumentimin se anëtarësimi do t'i rrezikonte disa vlera tradicionale zvicerane siç është praktika e demokracisë direkte (referendumi dhe insiativa) e posaçërisht neutraliteti. Deri diku me anë të këtij konflikti u vërejtën kontradiktat midis modernistëve dhe tradicionalistëve dhe që për Zvicrën është dukuri e re, midis bashkësive të caktuara etnike. Në referendumin "pro" ose "kundër" anëtarësimin në fushën ekonomike evropiane (European Economic Area), 80% të popullatës nacionale franceze votuan "pro", por rreth 60% të popullatës gjermane votuan "kundër".

Qëndrueshmëria e bashkëjetesës zvicerane u gjet në provë edhe gjatë dy luftërave të fundit botërore: në Luftën e Parë Botërore u bënë përpjekje që diaspora gjermane të angazhohet në anën e Gjermanisë kurse diaspora franceze në anën e Francës: në Luftën e Dytë Botërore Gjermania hitleriane përbente kërcënimin e vazhdueshëm ndaj neutralitetit zviceran. E mësuan nga këto përvoja të pakëndshme dhe duke qenë besnik gjeloz ndaj ruajtjes së vlerave të sistemit të vet, Zvicra përveç pranimit për t'u angazhuar në disa organizata ekonomike e kulturore ndërkombtare, ka refuzuar anëtarësimin në Kombet e Bashkuara.

Por edhe përkundër këtyre konflikteve, shteti Zviceran po ia del të evitojë sëmundje kryesore të cilat po i sulmojnë të gjitha federatat shumënacionale: separatizmin dhe unitarizmin. Shembulli zviceran e kthen besimin në mundësinë e federalizmit për ta funksionuar si formë e shtetit të përbërë nacional përkatësisht, si metodë e rregullimit (drejtimit) të konflikteve etnike në to.

Në pyetjen se a mund të "eksportohen" modeli zviceran, duhet pasur parasysh disa karakteristika të tij tejet të rëndësishme. Këto parasëgjithash janë aspektet trishtesore të demokracisë plurale ku kombinohet me sukses konsensusi, parimi i shumicës dhe demokracia, direkte, federalizëm i cili i bashkon përfaqsimin etnik, partiak dhe qytetar, besnikëria e qytetarëve ndaj vlerave të politikës zvicerane dhe vullneti politik i shumicës së madhe të njerëzve për ta pranuar koekzistencën e qetë të grupeve të ndryshme etnike si qëllim i përbashkët. Me gjithë këtë natyrisht shkon edhe neutralizeti. Sepse pa neutralitet, Zvicra do të kishte mundur të shkatërrohej qysh në shekullin XVII në kohën e luftërave religjioze ose në dy luftërat e fundit botërore. Ndonëse merita për ruajtjen e këtij neutraliteti në njëfarë kuptimi u takon edhe fuqive luftarake të cilave ashtu ose kështu u leverdiste një shtet neutral në Evropë.

ISHUJT ALANDE

Ishujt Alande gjenden në Detin Baltik, rreth 40 km. nga bregdeti perëndimor i Suedisë, dhe 95 km. nga bregu lindor i Finlandës. Ishulli kap një sipërfaqe prej 12.068 kilometra katror. Popullata është me numër të vogël gjithsej rreth 24.000 banorë. Dominojnë suedezët (95%), kurse finlandezët marrin pjesë me gjithsej 4,5%. Ishujt me shekuj i kanë takuar Suedisë. Mirëpo, më 1809, sovraniteti mbi ishujt u bart nga Suedia në Rusinë, dhe prej atëherë janë të përfshira në perandorinë ruse si pjesë e Dukës së madhe autonome të Finlandës. Pasi që Finlanda e shpalli pavarësinë e vet nga Rusia më 1917 banorët e Ishujve Alande shumicën e të cilëve e përbënin suedezët kërkuan bashkimin e serishëm me Suedinë. Mirëpo, Finlanda edhe më tutje e mbante pushtetin e vet mbi Alandet, ndërsa njëkohsisht si përgjigje ndaj presioneve ndërkombtare, banorëve të tyre u dha autonomia e kufizuar (maj 1920).

Është interesante se si është zhvilluar konteksti midis Suedisë Finlandër rreth Ishujve Alande, deri në arrijten e marrëveshjes. Interesi i Suedisë ishte i motivuar me shkaqet e sigurisë, kurse interesi i Finlandës me shkaqet e integritetit territorial. Më parë Suedia e inicioi çështjen e statusit të Alandeve në Konferencën Ndërkombtare në Paris (prill 1919) me pohimin se fjala është për çështjen ndërkombtare. Pas kësaj, me iniciativën e Britanisë së Madhe kjo çështje u shtrua edhe para Lidhjes së Popujve (1920). Finlanda e kundërshtoi këtë iniciativë me argumentimin se Alandet janë pjesë e territorit të saj, prandaj edhe marrëdhëniet me alandezët janë çështje e saj e brendshme.

Lidhja e Popujve emëroi një komision të veçantë për ta shqyrtuar problemin e Ishujve Alande (korrik 1920), kurse në shtator të vitit të njëjtë Lidhja e miratoi raportin e këtij komisioni. Ky raport më parë konstatoi se statusi i Alandeve është çështje ndërkombtare ngase kur u inicua për herë të parë (1917) Finlanda ende nuk e pat fituar karakterin e shtetit të konstituuar definitivisht (tek më 6 dhjetor është shpallur shtet i pavarur e sovran) së dyti e mbështeti sovranitetin finlandez mbi Alandet por kërkoi që edhe Ligji Finlandez mbi Autonominë (maj 1920) të jap garanca të reja në mënyrë që pakica suedeze të mund të ruaj gjuhën e vet suedeze dhe traditën lokale. Komisioni, ndërkaq, shtoi se e drejta pozitive ndërkombtare nuk e njeh të drejtën e grupeve nacionale për t'u shkëputur nga shteti në të cilin e përbëjnë pjesën e tij me shprehjen e thjeshtë të dëshirës e as që e njeh të drejtën e shteteve tjera që të kërkojnë ndarje të tilla.

Këshilli i Lidhjes në formën e rezolutës së vet (qershor 1921) e konfirmon sovranitetin finlandez, por edhe kërkon nga Finlanda që të ofrojë garanca më të fuqishme për mbrojtjen e të drejtave minoritare, duke paraqitur njëkohësisht qëndrimin se respektimi i këtyre garancave duhet të jetë objekt i kontrollit ndërkombtar. Në bazë të rekomandimit të Këshillit, Finlanda dhe Suedia lidhin një marrëveshje bilaterale mbi çmilitarizmin e arqipelagut dhe mbi neutralitetin e tij në rast lufte. Qëllimi i kësaj marrëveshje ishte që t'a ofrojë garanca alandezëve se do të mund ta ruajnë gjuhën e vet, kulturën dhe traditat lokale. E njohur si Marrëveshja e Alandeve ky dokument ka parashikuar që suedishtja të jetë gjuhë mësimi në shkolla se popullata lokale do të ketë përparësi me rastin e blerjes së pasurisë, se emigrantët do të mund të marrin shtetësinë Alande duke përfshirë edhe të drejtën e votës pas pesë vjet qëndrimi, se kryetari i Finlandës me rastin e emërimit të guvernatorit të Alandeve, duhet të ketë pëlqimin e parlamentit alandez, se alandezët për nevojat lokale mund të marrin përveç të ardhurave të siguruara mbi Ligjin mbi Autonominë edhe 50% të të ardhurave nga tatimi mbi tokën dhe se Lidhja e Popujve do të jetë garantuese e kësaj marrëveshje. Këshilli i Lidhjes së Popujve e miraton unanimisht këtë marrëveshje dhe ia bashkangjiti rezolutës së vet nga qershori. Shpejt pas kësaj, edhe parlamenti finlandez e miratoi këtë marrëveshje me çka edhe formalisht bëhet pjesë e drejtësisë dhe e kushtetutës finlandeze. Kjo gjendje e cila u modifikuar dhe u zgjërua sipas nevojave të krijuara zgjat gati plotë tetë dekada.

Në preambulën e Ligjit mbi Autonominë e Alandeve nga vitit 1920 qëndron: alandezët duhet të jenë të bindur në mundësinë e organizimit të ekzekutimit të tyre vetjak, sa të jetë e mundshme lirisht për provincën e cila nuk paraqet shtetin e pavarur. Kjo maksimumë karakteristike e autonomisë së Alandeve është njëlloj relevante edhe sot. Ndërkohë revizionimi i parë i këtij ligji u bë më 1951 kurse i dyti me 1991, me kusht që ligji i ri të fillojë të vlejë nga një janar i vitit 1993. Për gati tetë dekadat e fundit autonomia e Alandeve edhe është forcuar edhe zgjëruar gjithmonë duke u udhëhequr nga parimet fundamentale se alandezët kanë të drejtë për të drejtuar kushtet e ekzistencës së vet me anë të institucioneve vetjake.

Organet e Alandeve janë parlamenti i cili zgjidhet me vota të drejtëpërdrejta e të fshehta dhe qeveria të cilën e zgjedh parlamenti. Në kompetencat e rëndësishme legjislativë të Alandeve bëjnë pjesë: caktimi dhe përdorimi i simboleve të Alandeve (stema dhe flamuri), sigurimi publik, tatimet, marrëveshjet kolektive mbi rrogat, shëndetësia, arsimit, tregëtia, administrata lokale (komuna), bujqësia, gjuetia e peshkimit, thesari i permendoreve me vlerë kulturore e historike, mbrojtja e ambientit etj.

Sipas ligjit mbi autonominë, alandezët kanë njëfarë lloji të shtetësisë së dyfishtë: përpos shtetësisë finlandeze kanë edhe shtetësinë e tyre të veçantë rajonale. Ajo prodhon disa konsekuenca juridike të qenësishme për sigurinë në mbrojtjen e identitetit të banorëve të Alandeve, siç janë e drejta e votës dhe e

drejta e posedimit të tokës. Vetëm qytetarët me shtetësi alandeze mund të zgjedhin e të zgjidhen në prganet e Alandeve. Pronësinë mbi tokën mund ta realizojnë kryesisht shtetasit e Alandeve me çka u dëshirua që toka të mbetet në duart e alandetëve. Përveç kësaj shtetësia alandeze e liron mashkujt nga obligimi ushtarak në ushtrinë finlandeze.

Nga aspekti i ruajtjes së identitetit nacional të suedezeve të Alandeve, ligji ka parashikuar që gjuha zyrtare në administratë dhe gjuha e mësimi në shkollat publike të jetë gjuha suedeze. Shtetasit e Finlandës të cilët nuk kanë qëndrim të përhershëm në Alande gëzojnë të drejtën për ta shfrytëzuar gjuhën finlandeze paragjyqve por kjo e drejtë nuk vlen edhe për organet e pushtetit të shtetit. Nëse shtetasi finlandez dëshiron qëndrim të përhershëm më parë e merr shtetësinë rajonale. Por, nëse dëshiron të punojë në shërbimet publike duhet që në kursin e organizuar posaçërisht të fitojnë njohuri edhe të gjuhës suedeze.

Ndonëse politika e jashtme gjendet në komptencën e shteti finlandez, Alandet kanë mënyrë dhe mundësi të ushtrojnë ndikim në çështjet të cilat janë me interes të veçantë për atë rajon. Në qoftë se Republika e Finlandës lidh kontratë me shtetin tjetër lidhur me çështjet nga suazat e juidiksionit të Alandeve, atëherë ajo kontratë duhet të miratohet edhe nga ana e parlamentit alandez. Në qoftë se parlamenti do ta hudhte poshtë atë kontratë që përndryshe nuk ndodh atëherë ajo nuk do të ishte obligative për Alandet.

Alandet me pëlqimin e shtetit të Finlandës paraqiten edhe si subjekte në planin e politikës së jashtme. Kështu, më 1970, Parlamenti i Alandeve u bë anëtar i këshillit Nordik i cili ka për qëllim avancimin e bashkëpunimit të vendeve nordike (Danimarka, Finlanda, Suedia, Norvegjia dhe Islanda). Në atë këshill, Parlamenti i Alandeve si përfaqësues i një bashkësi autonome është plotësisht i barazuar me parlamentet e vendeve të pavarura.

Autonomia e Alandeve funksionon pak a shumë si shtet me legjisllacionin dhe administratën e vet dhe me simbolet formale siç janë stema, flamuri dhe festa shtetërore, duke mos sjellur në pikëpyetje sovranitetin dhe integritetin territorial të shtetit të Finlandës. Në kuadër të kësaj është gjetur edhe pika e takimit midis pushtetit autonom dhe atij qendror. Kështu për shembull të gjitha ligjet i miraton Parlamenti i Alandeve duhet t'i paraqiten presidentit të Finlandës për lejim i cili ka të drejtën e vetos. Mirëpo, kjo e drejtë nuk kështë e pakufizuar. Përkundrazi, mund ta shfrytëzojë vetëm në dy raste: kur e vlerëson se ligji del nga suazat e juidiksionit të Alandeve ose kur paraqet kërcënimin për sigurinë e brendshme e të jashtme të shtetit. Mirëpo, kjo ndodh shumë rrallë. Është i njohur rasti nga viti i largët i pesëdhjetë, kur presidenti i shtetit vuri veto mbi ligjin e Alandeve për flamurin, për shkak se pamja e propozuar e flamurit i ngjante tepër shumë flamurit nacional të Suedisë.

Sipas marrëveshjeve midis Suedisë e Finlandës nga viti 1921, presidenti i Finlandës e cakton guvernatorin e Alandeve, por ai mund të jetë vetëm personi të cilin e propozojnë dhe e pranojnë alandezët. Procedura e tillë ka për qëllim të garantojë se guvernatori i Alandeve ka besimin e plotë si të autoriteteve të Alandeve ashtu edhe të shtetit të Finlandës. Në sytë e alandezëve guvernatori nuk është emisar i pushtetit qendror, veç element i ekuilibrit midis dy pushteteve - të shtetit të Finlandës dhe të territorit autonom të Alandeve.

E drejta e popujve të Alandeve që të vendosin për fatin e vet në kuadër të parametrave të gjera të autonomisë e ka forcuar ndjenjën e tyre të identitetit dhe të bashkëjetesës dhe kjo është bërë bazë për zhvillimin e tyre të shumëfishtë ekonomik e kulturor. Përvoja e autonomisë së Alandeve ka dhënë rezultate pozitive në relacionin e autoriteteve qendrore filandeze dhe të qeverisë autonome të Alandeve, gjë që i përshkruhet vullnetit vullnetit aktiv të dy palëve që të bashkëpunojnë dhe të arrijnë kompromise. Të dy palët kanë shkuar rrugës së logjikës, duke evituar qëndrimt ekstreme dhe konfliktet. Sot ishujt Alande, edhe pse të vogla e të izoluara, janë bashkësi në lulzim. Të ardhurat për frymë të popullsisë gati janë diç më të mëdha se në Finlandë. Në një anketë të zbatuar më 1990, vetëm 9.8% është përgjigjur pozitivisht në pyetjen "A duhet Alandet të bëhen vend plotësisht i pavarur".

Alandet paraqesin modelin se si mund të zgjidhet problemi i pakicave dhe si mund të vendoset raporti

i autoriteteve qendrore dhe të territorit autonom pa fërkime serioze. Në këtë ka kontribuar parimi i konsensusit i cili ka peshuar në raportet midis shtetit dhe Alandeve që vetëm e ka shtuar prestigjin dhe autoritetin ndërkombëtar të Filandës.

FEDERATA RUSE

Federata ruse u formua me shkatërrimin e ish-Bashkimit Sovjetik (BRSS). Krahas Rusisë edhe 15 ish-republika të tjera sovjetike fituan pavarësinë e shtetit. Ky shkatërrim formalisht është zyrtarizuar më 21 dhjetor të vitit 1991, në Alma Ata, me formimin e Bashkësisë së Shteteve të Pavarura (BSHP). Me atë rast, përveç disa marrëveshjeve tjera, u arrit edhe ujdia që Federata Ruse të vazhdojë subjektivitetin ndërkombëtar-juridik të ish-Bashkimit Sovjetik.

Federatën Ruse e përbëjnë 21 njësi federale me status të republikave autonome. Rusët, si edhe në ish-federatën sovjetike, nuk kanë njësinë e veçantë federale. Rusët e përbëjnë shumicën në 10 republika dhe pakicën e numër të gjitha republikat. Sipas të dhënave nga viti 1989, në Federatë kishte 80% rusë dhe 20% popullatë joruse.

Konstitiumit të Federatës Ruse i parapriu Kontrata Federale (31 mars 1992) të cilën e nënshkruan të gjitha njësitë federale përpos Çeçenisë dhe Tatarstanit. Në bazë të kësaj kontrate është hartuar Kushtetuta e re e Federatës (e miratuar në dhjetor të vitit 1993), për të cilën, megjithatë refuzuan të votojnë madje 12 njësi federale!

Me këtë Kushtetutë, në përpjekje për të siguruar funksionimin e bashkësisë shtetërore me theksim heterogjen etnike (rreth 150 bashkësi etnike) në disa aspekte janë forcuar autorizimet e qendrës. Është shtuar, bie fjala, vëllimi i kompetenave të presidentit të Federatës. Ai mund t'i suspendojë vendimet e qeverive të njërive federale dhe të arbitrojë midis qendrës dhe anëtarëve të Federatës dhe midis anëtarëve të Federatës. Kushtetuta nuk ia ndalon qendrës që unilateralisht të radifinojë autorizimet e republikave autonome, u jep përparësi të drejtave individuale në raport me ato kolektive, por nuk është përfshirë e drejta për vetëvendosje, ndonëse ajo ka ekzistuar në Kontrantën Federale.

Mirëpo, me kushtetutat e republikave definohej ndryshe raportet me qendrën dhe janë ranguar në forma të ndryshme për nga shkalla e autonomisë, kështu që mund të flitet për karakterin e llojit të vet asimetrik të Federatës Ruse. Në kushtetutat e shumicës së republikave qëndron se janë shtete sovraane, edhe pse Kushtetuta Federale nuk e përmend sovranitetin shtetëror të republikave. Në kushtetutën e Republikës Tiva proklamohet e drejta për vetëvendosje dhe për dalje nga përbërja e Federatës Ruse. Kurse në kushtetutat e disa republikave shpallet përparësia e ligjeve republikanë territorin e tyre në raport me ligjin federativ.

Me zgjidhjen asimetrike po bëhen përpjekje për t'i zbatuar konfliktet etnike dhe të mundësohet niveli i tillë i mëvetësisë së popujve joruse të cilët mund t'i mbajë në suazat territoriale të Federatës. Sidomos kur jetojnë të rrethuar nga ish republikat sovjetike të cilat kanë fituar pavarësi. Se kjo do të jetë vështirë, ka dëshmuar edhe shembulli i Çeçenisë e cila as me armë nuk mund t'i largohet nga kërkesa për pavarësi. Intervenimi i armatosur i ushtrisë federale i cili zgjati gati dy vjet (nga fundi i vitit 1994 - në shtator të vitit 1996) përfundoi me mospas të plotë. Pas kësaj, Rusia arriti marrëveshje me autoritetet e reja çeçene me anë të së cilës, çështja e pavarësisë nuk do të hapet gjatë pesë vjetëve të ardhshme, kurse ndërkohë autonomia e Çeçenisë u ngrit në shkallën më të lartë të mëvetësisë se sa e kishte deri atëherë.

Problemi tjetër i madh ka të bëjë me pjesët e popullit rus i cili pas rrënimit mbeti në kufijt e shteteve të posaformuara dhe i cili po ballafaqohet me vështirësi në rregullimin e statusit të ri dhe të drejtave të veta si pakica kombëtare. Jashtë Federatës kanë mbetur të jetojnë rreth 25 milionë rusw. Federata Ruse po përpiqet që me anë të marrëveshjeve bilaterale ndërshtetërore të ndihmojë në zgjidhjen e problemeve të diasporës së vet të cilat potencialisht mbajnë edhe kërcënime të konfliktit të armatosur.

BRITANIA E MADHE

Britaninë e Madhe (Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe të Irlandës Veriore) e përbëjnë Anglia, Skocia dhe Uells (në ishujt britanikë) dhe Irlanda Veriore. Anglia ka 49.089.000 banorë; Skocia - 5.149.000; Uells - 2.921.000 dhe Irlanda Veriore - 1.663.000 banorë (sipas të dhënave nga viti 1986).

Britania e Madhe është krijesë e fundit shtetërore në Evropë e krijuar në bazë të pushtimeve imperialiste, me bashkangjitje (ose me bashkime të territoreve). Me ligjet mbi bashkimin më parë është bashkuar Uells (1536-43), pastaj Skocia (1707) dhe më në fund Irlanda (1800). Në kuptimin e tashëm gjeografik, Mbretëria e Bashkuar ekziston nga viti 1921, kur pjesa jugore e ishullit të Irlandës u nda në shtet të veçantë të (Republika e Irlandës), kruse pjesa veriore (Alsteri) mbeti në përbërje të Mbretërisë së Bashkuar.

Britania e Madhe përngja përbërja e popullit është shumënacionale, kurse është e rregulluar si shtet unitar me të drejta të caktuara të bartura në krahina. Sistemi i njeh të drejtat individuale të qytetarëve në frymën e demokracisë vestminstrove, por jo edhe të drejtat kolektive të bashkësive etnike. Në përputhje me këtë, edhe sistemi zgjedhor mbështetet mbi parimin "një njeri një votë". Nuk ekzistojnë, pra, kurrfarë pengesash sistimore të majorizimit anglez.

Në kuadër të të drejtave të bartura, të gjitha tri krahinat (Skocia, Uells dhe Irlanda Veriore) kanë sekretarët e vet të veçantë të shtetit përgjegjës për punët e krahinës të cilët janë anëtarë të kabinetit britanik. Ata kanë kompetenca të caktuara kryesisht në sferën ekonomike, shëndetësore, sociale, arsimore, ekologjike dhe në disa sfera tjera. Edhe pse shtet unitar Mbretëria e Bashkuar lejon manifestimin e specificiteteve të caktuara të krahinave të veta në sferën e legjislacionit, arsimit, sistemit monetar, sport, etj.

Irlanda Veriore ka pasur parlamentin e vet dhe qeverinë, por më 1972, pas një rrebelimi u suspenduan, kështu që Londra drejton direkt këtë krahinë. Dy krahinat tjera - Skocia dhe Uells nuk kanë pasur parlamentet e veta. Me ardhjen e sërishtme të laburistëve në pushtet në fillim të vitit 1977, u hodh iniciativa ligjore që këto dy krahina, për herë të parë qysh se janë në përbërje të MB, t'i fitojnë parlamentet me autorizime legjislative.

IRLANDA VERIORE

Hapin e parë drejtë pavarësisë e bënë irlandezët. Ata ia dolën që pas luftimeve të gjata për çlirim nacional, ta detyrojnë Anglinë që ta njohë shtetin e lirë të Irlandës (1921), në fillim me status të dominimit britanik, që më 1949, definitivisht dhe me të drejtë ndërkombëtare u pranua si shtet i pavarur me emrin Republika e Irlandës. Mirëpo, gjashtë rrethe të Irlandës Veriore ka shumicën e banorëve e përbëjnë anglezët e skotlandezët (shumica protestante) u deklaruan më 1921 për të mbetur në përbërje të Britanisë. Prej atëherë vazhdon lufta civile midis shumicës protestante dhe pakicës (katolike) irlandeze, e cila mori shumë jetëra si në njërin ashtu edhe në palën tjetër. Prej vitit 1969, forcat e armatosura e ndihmojnë policinë në ruajtjen e "rendit e të qetësisë", kurse nga viti 1972 qeveria britanike zbaton administrimin imediat mbi Republikën e Irlandës. Armata Republikane e Irlandës (IRA) e cila u formua kah fundi i Luftës së Parë Botërore, e vazhdoi aktivitetin e vet edhe pas themelimit të Republikës së Irlandës, kësaj radhe në çlirimin e Irlandës Veriore.

Rrënjët e konflikteve janë tejet të thella e të ndërlikuara. Ato ndodhin në kushtet e diskriminimit fetar e nacional në të gjitha sferat e jetës shoqërore të cilat mund të krahasoheshin me kushtet e apartejdit e të sundimit kolonial. Këto kushtet pjesërisht janë përmirësuar, por nuk e kënaqë pakicën katolike, sepse nuk e ndryshon qenësisht statusin e saj të nënshtruar. Përpjekjet për t'u gjetur ndonjë zgjidhje qetësuese nuk japin

suksese sepse nuk mundin t'i kapërcejnë pozicionet e kundërta - njëra palë (shumica protestante) për të mbetur në Britani, kurse pala tjetër (pakica katolike) që Irlanda Veriore t'i bashkohet Republikës së Irlandës.

Qeveria britanike në shikim të parë ofroi zgjidhje demokratike: le të vendos populli! Kjo ofertë tingëllonte me cinizëm në kushtet në të cilat, duke marrë parasysh raportin e forcave, dihej se çfarë vendimi "demokratik" do të mund të ishte.

Me ardhjen në pushtet, në maj të vitit 1972, Qeveria laburiste e përsërit iniciativën për zgjidhjen politike të çështje së Irlandës Veriore. Pas shumë zvarritjeve, ndërprerjesh të negociatave dhe të rrezikut nga përsëritja e aktivitetit terrorist, definitivisht, në prill të vitit 1998, u lidh marrëveshja gjithëpartiake e paqes me ndërmejtësimin e senatorit aemrikan Miçell (Mitchell). Kjo marrëveshje u verifikua edhe me referendum të irlandezëve nga të dy anët e kufirit, më 22 maj të vitit 1998.

Marrëveshja nuk i kënaqi protestantët (unionistët), sepse me të dukshëm është përmirësuar statusi i pakicës irlandeze në Irlandën Veriore. Nuk e pranoi lehtë as pakica irlandeze, meqenëse marrëveshja e shtynë çështjen e bashkimit të Irlandës Veriore me Republikën e Irlandës, që ndërkaq është kërkesë kyqe e luftës së saj shumëdekadash. Kjo mundësi vërtetë nuk është mbyllur, por në të ardhmen - dhe kjo është pika më e rëndësishme e marrëveshjes - fati definitiv i kësaj krahine do të zgjidhet jo me armë, por me negociata dhe mjetet legaliste (referendum e ngjashëm).

SKOCIA

Autonomia e Skocisë si një nga Krahinat e Mbretërisë së Bashkuar ka të bëjë me zgjedhjen e kuotës së deputetëve të vet (72) të cilët i delegon në parlamentin britanik dhe në atë që të ketë sekretarin e "vet" të shtetit në qeverinë britanike. Sekretari i shtetit për Skocinë ka autorizime të caktuara për formulimin dhe zbatimin e politikës në sferën e bujqësisë dhe peshkatarisë, industrisë, arsimit, çështjeve sociale e shëndetësisë, qeverisjen lokale, ekologjinë, etj.

Mirëpo, kjo suazë e autonomië është tepër e ngushtë për të mundur të kënaq vetëdijen në rritje gjatë disa dekadave të fundit për nevojën e shkallës më të madhe të pavarësisë - nga forma e zgjeruar e autonomisë e deri tek pavarësia e shtetit. Margjinalizimi shekullor i veçorive nacionale skotlandeze nuk ka mundur ta shtyp vetëdijen mbi identitetin skotlandez. Ai kohët e fundit po kultivohet gjithnjë e më shumë me theksimin e llojllojshmërive të zhvillimit historik, të traditës kulturore dhe të ringjalljes së intresimit për rrënjët e veta gjuhësore - gale dhe skotlandeze.

Nxitjet politike dhe historiko-kulturore ndaj shkallës më të madhe të mëvetësisë nacionale po shtohen edhe me argumentet ekonomike, veçmas pas zbulimit të burimeve të mëdha të naftës në Detin Verior, parasëgjithash pranë bregdetit skotlandez. Kah fillimi i viteve të shtatëdhjta u inicua edhe fushata masive me parullën e njohur "kjo është nafta skotlandeze".

Anketa që u zhvillua gjatë vitit 1990, tregoi rritjen e disponimit jo vetëm për autonomi të gjerë brnda MB, por edhe për pavarësinë shtetërore të Skotlandës. Për pavarësinë e plotë të saj u deklaruan 39%, kurse për autonomi të zgjeruar brenda Mbretërisë së Bashkuar (MB) 44% të të anketuarëve.

Në referendumin e mbajtur në shtator të vitit 1977, në pyetjen e parë se a duhet Skocia të ketë parlamentin e vet - pozitivisht u përgjigjen 74,3% të votuesve (kundrull 25,7%, kundër), kurse në pyetjen e dytë mbi autorizimet tatimore të parlamentit, 63,5% u përgjigj me po dhe 36,5% kundër. Zgjedhjet për parlamentin e parë të Skotlandës, ndërkaq, duhet të mbahen në pjesën e parë të vitit 1999.

Sipas ligjit mbi devolucionin e pushtetit qendror të miratuar kah fundi i vitit 1997, parlamenti i ardhshëm i Skocisë do të kishte pushtetin legjislativ (legjislacioni primar) në sferat e shëndetësisë, arsimit, pushtetit lokal, në ndërtimtari, zhvillimin ekonomik, transport, ekologji, bujqësi, peshkari, pyllëtari, art dhe sport, pastaj autorizime të kufizuara në politikën tatimore dhe kontrollin demokratik mbi përgjegjësitë

që ka Kancelaria e Skocisë (Scottish Office). Ingerencat e parlamentit qendror (vestminsterit) do të mbeteshin të pandryshuara në sferën e ekonomisë globale dhe të politikës monetare, në sferën e mbrojtjes e të politikës së jashtme. Skocia do të ketë pushtetin e vet ekzekutiv në formën e qeverisë dhe të kryeministrit i cili zgjidhet nga radhët e partisë e cila do të kishte shumicën në parlament. Mirëpo, mbetet praktika e vjetër që intresat e Skocisë në Qeverinë e Britanisë edhe më tej t'i përfaqësojë sekretari i shtetit për Skocinë! Ka mbetur e paqartë se si zgjidhet apo emërohet ai sekretar, dhe ndaj kujt e mbanë përgjegjësinë primare.

Me këtë ligj, ndërkaq, parashikohet që Skotlanda, ngjashëm me qeveritë rajonale brenda Bashkimit Evropian, të ketë përfaqësiën e vet në Bruksel e cila do të ketë fuqinë për të ndikuar në ato fusha të politikës ekonomike të BE të cilat janë në kompetencat e Skotlandës.

UELLSI

Uells si edhe Skotlanda e ka kuotën e deputetëve të vet (38) të cielt i "delegon" në Dhomën e Jashtme dhe sekretarin e "vet" të shtetit për Uellsin i cili është anëtar i qeverisë britanike. Në Uells, shumica dërmuese e banorëve flasin anglisht, kurse gjuhën uellsane që është me prejardhje kelte, e flasin gjithësej 19%. Përndryshe, të dy gjuhët njihen si gjuhë zyrtare para gjyqeve të Uellsit. Ekzistojnë edhe programe të posaçme televizive të cilat emetohen në kanaline katërt të Uellsit.

Uells i ka shkaktuar shumë më pak kokëqarje pushtetit qendror të MB, se sa Irlanda Veriore dhe Skotlanda, meqenëse sipas disa treguesve, numri më i madh i uellsianëve është i kënaqur me vëllimin ekzistues të autonomisë. Në referendumin e vitit 1979, uellsianët e kanë hudhur poshtë propozimin që Uellsi të fitojë paralemntin e vet i cili do të kishte pushtetin legjislativ. Mirëpo, pamja e tillë të paktën sa u përket ndryshimeve më të fundit, nuk i përgjigjet gjendjes reale të gjërave. Sepse, ndonëse jo aq e theksuar si edhe në Irlandën Veriore dhe në Skotlandë, edhe në Uells po shtohet angazhimi për afirmimin identitetit nacional uellsian, prandaj në këtë kontekst edhe për shkallën më të lartë të autonomisë së Uellsit.

Në referendumin e përsëritur në shtator të vitit 1997, propozimi për fitimin e parlamentit të vet mori mbi 50% të votave (50,3% kundruall 497% vota kundër). Kjo megjithatë ishte e mjaftueshme për hapjen e rrugës legale të mbajtjes së zgjedhjeve për parlamentin e Uellsit të cilat, sipas planit të qeverisë, duhet të mbahet në të njëjtën kohë kur edhe zgjedhjet për parlamentin e Skotlandës (në pjesën e parë të vitit 1999).

Në kompetencat e parlamentit të ardhshëm (sfera e legjislacionit sekondar) barten të gjitha përgjegjësitë të cilat deri atëherë i ka pasur sekretari i shtetit për Uellsin: zhvillimi ekonomik, bujqësia, pyllëtaria, industria, planifikimi, arsimit, shëndetësia, shërbimi social, ultura, turizmi, ekologjia, sporti, qeverisja lokale, etj. Mirëpo, si edhe në rastin e Skotlandës, interesat e Uellsit në qeverinë britanike do t'i përfaqësojë sekretari i shtetit për Uellsin.

Kërkesat në rritje për zgjidhjen e çështjes nacionale mund të sjellin deri tek ajo që, ose në mënyrën plotësisht të re të rregullohen marrëdhëniet midis Anglisë dhe krahinave të saj në formën e federatës ose konfederatës, ose do të ndodh "shpërbërja" e perandorisë së fundit në Evropë. Ekziston edhe mundësia e "evropeizmit" të problemit britanik në kuptimin që krahinat e saja duke mbetur në kuadër të Mbretërisë së Bashkuar, të përfaqësohen drejtpërdrejt në Evropë me anë të formulës "Evropa e Rajoneve"

Për çdo rast, ajo që është e sigurtë është se proceset e amacipimit nacional nuk mund të luftohen me forcë.

Anglia do të duhej që atë të cilën po e kërkon për vete në kuadër të Bashkimit Evropian t'ua mundësojë edhe krahinave të veta brenda MB. Nuk do të mundet më të zbatohet dy kute: një për vete në Evropë, e tjetrën për Irlandën, Skotlandën dhe Uellsin në territorin e Britanisë së Madhe.

UKRAINA

Ukraina për nga numri i popullatës është e dyta nga ish-Bashkimi Sovjetik (rreth 52 milionë banorë). Ukrainasit përbëjnë 72,7% rusët - 22.1% dhe të tjerët - 5.2% të popullatës së përgjithshme (të dhënat nga viti 1989).

Në pjesën më të madhe të historisë së vet, Ukraina nuk ka pasur shtetin e pavarur. Gjithnjë, deri në pjesën e parë të shekullit XVII Ukraina ka qenë nën administrimin e Polonisë, që pas kësaj të pranojë sovranitetin e Moskës. Nën sundimin e Petrit të Madh filloi procesi i integritit të Ukrainës në mbretërinë ruse. Rusët i kanë shikuar ukrainasit ("maloruset" dhe "beloruset") si popull i njëjtë por me dialekt tjetër gjuhësor.

Rilindja nacionale e Ukrainës filloi si edhe tek popujt tjerë në shekullin e XIX. Ndaj lindjes së Lëvizjes Nacionale Ukrainase, Rusia cariste reagoi me ndalimin e gjuhës ukrainase në fushën e arsimit e të shtypit dhe me politikën e rusifikimit.

Në kohën e Luftës së Parë Botrore dhe të revolucionit boleshevik për pushtet mbi Ukrainën luftuan polakët, gjermanët, rusët - të kuqët e të bardhët - dhe natyrisht edhe vetë ukrainasit. Me fitoren e Revolucionit të Tetori, Ukraina hyri në Federatën Sovjetike si Republika Socialiste Sovjetike e Ukrainës.

Në kohën e Stabilizmit Ukraina ishte e ekzpozuar procesit të rusifikimit si edhe gjatë carizmit. Me këtë mund të shpjegohet se për çfarë arsye pati njëherë bashkëpunimi të Ukrainës me Gjermaninë fashiste gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Gjatë shkatërrimit të Bashkimit Sovjetik, Ukraina e shpallë pavarësinë shtetërore (1991), që diç më vonë ndonëse jo me vullnet të hyjë në Bashkësinë e Shteteve të Pavarura. Me këtë Ukraina për herë të parë në historinë e vet të gjatë e fitoi pavarësinë shtetërore.

Ukraina ka mjaft probleme serioze me Rusinë me rastin e Krimesë. Krimea e cila tradicionalisht është pjesë e territorit rus iu dha më 1954 nën juridiksion Ukrainës me rastin e 300-vjetorit të unionit të saj me Rusinë. Për shkak të shumicës ruse e cila e popullon Krimesë iu dha statusi special (i republikës autonome), më 1991. Mirëpo, kjo nuk e eliminon pakënaqësinë e shumicës ruse e cila kërkon që asaj t'i njihet e drejta për vetëvendosje duke kërkuar kështu që t'i bashkohet Rusisë.

KANADAJA

Popullësinë e Kanadasë e përbëjnë anglezët (që janë me shumicë), francezët (25.1%) dhen një përqindje e vogël (rreth 5%) popullata vendëse, kryesisht me prejardhje indiane. Kanada bën pjesë në radhët e federatave më të vjetra (1867) krahas federatës amerikane dhe zvicrane dhe është ndër vendet e para i cili krahas standardeve të vestminsterit të demokracisë të mbështetura mbi parimin e shumicës, filloi të aplikojë edhe metoda e demokracisë konsociative të mbështetur në konsensus dhe ndarjen e pushtetit (poW er sharing), midis bashkësive etnike. Sikurse që ekziston tensioni i parreshtur midis anglezëve etnikë dhe francezë reth grumbullimit të shtetit, ashtu edhe sistemi politikë është arenë e rivalitetit të demokracisë vestminstere dhe konsociative. Shumica federaliste angleze vazhdimisht është përpjekur që nga kushtetuta dhe federata të eliminohen elementet e konsociacionit dhe të forcohet dominimi i anglezëve. Ky ishte një nga shkaqet kryesore përse ligjin kushtetues nga vitit 1982 nuk e miratuan as Kueboku as popullata vendëse. Vendësit posaçërisht për shkak se ai ligj kushtetues ata nuk i ka njohur si veçori etnike.

Në jetën e përditshme të Federatës megjithatë përkundër dispozitave kushtetuese u ruajt praktika e ndarjes së pushtetit midis anglezve dhe francezve sado që francezët janë pakicë në raport me numrat e anglezëve (pjesëmarrja proporcjonale në pushtet rotacioni etj). Kjo dysi midis normave kushtetuese dhe praktikës vazhdon me modifikime të caktuara praktikisht gjithnjë deri me sot.

Marrëveshja e Mech Lake (1987) që është përshëndetur si masë "e pajtimit kombëtar", ka parashikuar një varg amandamentesh kushtetuese me të cilët rehabilitohen dhe forcohet parimi i konsociacionit. Kuebeku u njoh si shoqëri distinkte". Veçmas është parashikuar parimi i vetos si mbrojtje e heqjes eventuale nga kushtetuta të parimit të konsociacionit. Mirëpo, kjo marrëveshje hasi në rezistenca të gjëra, veçmas jashtë Kuebekut dhe ai më 1990 pushoi të vlejë ngase nuk ia doli të fitojë mbështetjen e njëzëshme të të gjitha provincave.

Charlottetown Accord (1992), krahas njohjes së Kuebekut si "shoqëri distinkte", e pëfshiu për herë të parë edhe njohjen e popullatës vendase "të drejtave inherente për vetëqeverisje".

Mirëpo, edhe kjo Marrëveshje në referendumin e tetorit të vitit të njejtë u hudh poshtë njëlloj në Kuebek dhe në pjesën angleze të Kanadasë. Kjo për shkak se kuebekasve u dukej se po fitojnë pak kurse anglezve kanadezë se Kuebeku po fiton për së tepërmi.

Shembulli i Kanadasë tregon se nuk është i mundshëm asnjëri i nga këta dy koncepte të demokracisë në formë të pastër.

Parimi i shumicës i aplikuar rigorozisht nuk është i pranueshëm jo vetëm për francezët kanadezë të Kuebekut, por as për të ashtuquajturën popullatë vendëse (kryesisht indiane), pavarësisht që marrin pjesë me gjithsej 50% në numrin e përgjithshëm të popullatës.

Konflikti i këtyre dy formave të demokracisë (vestministere dhe konsociative), sipas gjasëve do të zgjidhet në ndonjë formë të "kompromisit historik".

Ky kompromis së pari do të duhej që nga njëra anë ta bind Kuebekun se është në interesin e tij nacional që të vazhdojë me partneritein në Federatën Kanadeze, por edhe t'i kënaq edhe nëntë provincat tjera se marrëveshjet e përbashkëta nuk janë lëshime të përhershme dhe vetëm për Kuebekun së dyti - do të lypset të shtrihet baza e ndarjes së pushtetit duke përfshirë edhe pjesën e popullatës vendase, dhe së treti - para saj gjendet obligimi që t'i bind shumë kanadezë të cilët nuk janë as anglezët francezë, se Federata e Kanadës nuk është monopol i elitës anglezo - franceze.

Shumë kanadet nuk e dëshirojnë coptimin e vendit. Edhe pse nuk mund të jenë politikisht të bashkuara me bazë të një identiteti nacional ashtu siç po vepron Amerika fqinje, ata janë të gatshëm në ndarjen e atillë të pushtetit midis tri etnitetëve e cila do të mundësojë funksionimin e federatës.

LITERATURA

01. The politic of ethnic conflict regulation, ed. by John Mc Garry and Brendan O'Leary, Lodon, 1993.
02. Europe and ethnicity, ed. by Seamus Dunn and. T. G. Fraser London, 1966, p. 77.
03. Stefan Bockler: The South Tyrol:75 years of ethnic conflict and peaceful coexistence, i Polozaj manjina u Saveznoj Republici Jugoslaviji, SANU, Beograd, 1996, str. 598.
04. Nina Dobrkovic: Iskustvo Juznog Tirola i resavanje polozaja nacionalnih manjina, i Polozaj manjina u SRJ, SANU, Beograd, 1996.
05. European political cultures-conflict or convergence? ed. by Roger Eatwell, London, 1977, p. 19.
06. Sulejman Redzepagic: Suzivot u Svajcarskoj, i Polozaj manjina u SRJ, SANU, Beograd 1996.
07. Elizabeth Kopp: Die Schweiz: Ein modell fur andere staaten, i Polozaj manjina u SR Jugoslaviji, SANU, Beograd, 1996.
08. Federalism -The multiethnic challenge, ed. by Graham Sith, N. Y. 1995.
09. Post sovjet republics - A. Systematic geography, ed. by Denis, J. B. Shaw, London, 1995.
10. The nationalites question in the post soviet states, ed. by Graham Smith, London, 1996.
11. J. F. Brown: Hpoes and shodows Eastern europe after communism, USA, 1994.
12. Proces demokratizacije i etnicki odnosi u SR Jugoslaviji, Centar za strategijske studije i Forum za atnice odnose, Beograd, 1997.
13. Brana Markovic: Nacionalni problemi u Velikoj Britaniji, Medjunarodni problem, 3-4, 1992, Beograd.
14. Britain 1998, an official handbook, London, 1998.
15. nacioalism and nationalites in the new Euroe, ad. by, Charles A. Kupchan, USA, 1996.
16. Miodrag Jovicic Veliki ustavni sistemi, Beograd, 1984.
17. Nationalism and minorites. Institut of science and Unvers it of Essex.
18. Polozaj manjnia u SR Jugoslaviji, SANU, Beograd, 1996.
19. Nation and identity in contemporary Europe d. by, Brian Jenkins and Spyros, A. Sofos, USA, 1996.
20. The rights of minorities culture, ed. by WILL Kymlicka, N. Y. 1995.
21. WillKymlicka: Multicultural citizenship, Neuw York, 1995.
- 22.E. J. HobsbawM: Nations and natioalism since 1780, Cembridge, 1990.
23. International organizations and ethnic conflict, de. byMilton J.Easman andShibley Telhami, USA, 1995.
24. Milenko Markovic: Srpsko pitanje izmedju mita i stvarnosti, Beograd, 1997.
25. European political cultures-Conflict or convergense, e, by, Roger Eatwel, New York, 197.
26. The morality of natioalism, ed. by Robert McKim and JeffMc Mahan, New York, 1997.
27. Yeal Tamir: Liberal nationalism, USA, 1993.
28. Citizenship and natioal identity, ed. by Oommen, N. Delhi, 1997.
29. Butrso Butros Gali. Agenda za mir, i Ujedinjenje Nacije - Izmedju priznanja i ponuda, Beograd, 1995.
30. Seldetermination and self-administration, ed. by. Wolfgang Denspeckgruber with Arthur Watts, USA, 1997.
31. Atios of nationalism, ed. by Sukumar Periwal, London, 1995.
32. Procesi demokratiziacije i etnicki odnosi u SR Jugoslaviji (deo o SSSR i Ruskoj Federaciji) Centar za strategijske studije i Forum za etnicke odnose, Beograd, 1997.
33. Medjunarodnja Zizn. 1, 1995, Moskva(tematski broj o Tatarstanu).
34. Ethnic conflict andRussian intervention in the Caucasus, ed ba Fred Wehling, University of California, USA, 1995.
35. The rights of minority culture, ed. by. Will Kymlicka, N. Y. 1995.

DOKUMENTE
TË KOMBEVE TË BASHKUARA
(pjesë të zgjedhura)

1. KARTA E KOMBEVE TË BASHKUARA

Neni 1

Objektivat e Kombeve të Bashkuara janë:

1. ruajtja e paqes dhe sigurisë ndërkombtare dhe për këtë qëllim: marrja e masave efektive kolektive për pengimin dhe eliminimin e kërcënimeve ndaj paqes dhe luftimit të akteve të agresionit apo të shkeljeve të tjera të paqes, si dhe arritjen me mjete paqësore, e në përputhje me parimet e drejtësisë dhe të drejtës ndërkombtare të rregullimit të zgjidhjes së kontesteve ose situatave ndërkombtare të cilat mund të sjellin shkeljen e paqes;
2. zhvillimin e marrëdhënieve miqësore midis kombeve të mbështetura në respektimin e parimeve të barazisë e të vetëvendosjes së popujve dhe marrjen e masave të tjera adekuate me qëllim të forcimit të paqes së përgjithshme;
3. arritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me zgjidhjen e problemeve ndërkombëtare të natyrës ekonomike, sociale, kulturore e humanitare, dhe avancimin e nxitjes e respektimit të të drejtave të njeriut dhe të lirive elementare për të gjithë, pavarësisht nga raca, gjinia, gjuha apo feja; dhe
4. të bëhet qendër për harmonizimin e aksioneve të ndërmarra për realizimin e këtyre objektivave.

KREU VII

AKSIONET ME RASTIN E KËRCËNIMIT TË PAQES, CENIMIT TË PAQES DHE TË AKTEVE TË AGRESIONIT

Neni 39.

Këshilli i Sigurimit e përcakton nëse ekziston kërcënim i paqes, cenimi i paqes ose agresioni dhe jep rekomandime ose vendos se cilat masa do t'i marrë në përputhje me nenet 41 e 42, me qëllim të ruajtjes ose të vendosjes së paqes e të sigurisë.

Neni 40

Për ta penguar keqësimin e situatës, Këshilli i Sigurimit mund, para se të ofrojë rekomandimin ose të vendos për masat e parashikuara me nenin 39, t'i thërrisë palët e interesuara që t'u nënshtrohen atyre masave të përkohshme për të cilat ai konsideron se janë të nevojshme e të dëshirueshme. Masat e tilla të përkohshme nuk guxojnë të ndikojnë në të drejtat kërkesat ose pozitën e palëve të interesuara. Këshilli i Sigurimit është i obligueshëm të shfaqë kujdes për mospërbushjen e këtyre masave të përkohshme.

Neni 41.

Këshilli i Sigurimit mund të vendos se çfarë masash duhet të aplikohen të cilat nuk kërkojnë përdorimin e forcës së armatosur, me qëllim të zbatimit të vendimeve të tij dhe mund t'i thërrasë anëtarët e Kombeve të Bashkuara që t'i zbatojë masat e këtyre. Ato mund të mbajnë ndërprerjen e plotë ose të pjesërishtme të marrëdhënieve ekonomike, dhe të lidhjeve hekurudhore, detare, ajrore, postare, telegrafike, radiografike dhe të lidhjeve tjera, por gjithashtu edhe ndërprerjen e marrëdhënieve diplomatike.

Neni 42.

Në qoftë se Këshilli i Sigurimit konsideron se masat e parashikuara me nenin 41 nuk përgjigjen ose nuk tregohen se janë të pamjaftueshme ai mund të marrë aksionin e tillë të forcave ajrore, detare, ose tokësore, që është i nevojshëm për hir të ruajtjes ose vendosjes së paqes dhe sigurisë ndërkombtare. Aksioni i tillë mund ta përfshijë demonstrimin, bllokadën dhe operacionet tjera të forcave ajrore, detare ose tokësore të anëtarëve të Kombeve të Bashkuara.

2. PAKTI NDËRKOMBËTAR MBI TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE.¹

PJESA E PARË.

Neni 1.

1. Të gjithë popujt kanë të drejtën për vetëvendosje. Në bazë të kësaj të drejte, ata e caktojnë lirisht sundimin e vet politik dhe realizojnë lirisht zhvillimin e vet ekonomik, shoqëror e kulturor.

PJESA E DYTË

Neni 2.

1. Shtetet kontraktuese të këtij fakti detyrohen se do t'i respektojnë dhe garantojnë të drejtat e njohura në këtë Pakt të gjithë individëve që gjenden në territorin e tyre dhe bëjnë pjesë nën pushtetin e tyre pa kurrfarë dallimi, veçmas lidhur me racën, ngjyrën, gjininë, gjuhën, predikimin fetar, bindjen politike ose tjetër, prejardhjen nacionale ose shoqërore, pasurinë, lidhjen ose të rrethanave të tjera.

PJESA E TRETË.

Neni 25.

Secili qytetar, pa kurrfarë diskriminimi me të cilin ka të bëjë neni 2 dhe pa kufizime të pakuptueshme, ka të drejtë dhe mundësi.

a) të marrë pjesë në udhëheqjen e punëve publike, qoftë drejtpërdrejtë qoftë me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht;

b) të zgjedh e të zgjidhet në zgjedhjet e mbajtura kohë pas kohe dhe në rregull, me të drejtë të barabartë e të përgjithshme zgjedhore, të zbatuar me votim të fshehtë, me çka sigurohet shprehja e lirë e vullnetit të zgjedhësve;

c) që nën kushtet e përgjithshme të barazisë t'i mundësohet shërbimi publik në vendin e tij.

Neni 26.

Të gjithë para ligjit janë të barabartë dhe kanë të drejtë për mbrojtjen e njëjtë ligjore pa kurrfarë diference. Lidhur me këtë ligj do të ndalojë çdo diskriminim dhe u garanton të gjithë personave mbrojtjen e njëjtë dhe të suksesshme kundër çdo diskriminimi, veçmas mbi baza racore, ngjyre, gjinie, gjuhe, predikimi fetar, të mendimit politik apo të cilit do mendim tjetër, të prejardhjes nacionale e shoqërore, të pronës, lindjes apo të ndonjë gjendje tjetër.

Neni 27.

Në ato shtete ku ekzistojnë pakicat etnike, nacionale, fetare ose gjuhësore, personat që u takojnë atyre pakicave nuk do të privohen nga e drejta, bashkë me anëtarët e tjerë të grupit për t'i praktikuar kulturën vetjake, predikimin e fesë së vet dhe për t'u shërbyer me gjuhën e vet.

¹ I miratuar me rezolutën APKB 2200 A (XXI, 16 dhjetor 1966. Hyri në fuqi më 23 mars 19761 (Documents on autonomy and minority rights, ed By Hurst, HNNn USA, 1993).

3. KOMENTI I PËRGJITHSHËM I KOMITETIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT NR. 23(50), ME RATIN E NENIT 27, TË PAKTIT NDËRKOMBËTAR MBI TË DREJTAT QYTETARE E POLITIKE¹

1. Sipas nenit 27. të Paktit, në ato shtete ku ekzistojnë pakicat etnike, fetare ose gjuhësore, personat që u takojnë atyre pakicave nuk do të privohen nga e drejta që, në bashkësi me anëtarët e tjerë të grupit, të shfrytëzojnë kulturën e vet, ta shprehin besimin e vet ose ta shfrytëzojnë gjuhën e vet. Komiteti konsideron se ky nen vendos dhe e njeh të drejtën që ka të bëjë me individët të cilët u takojnë grupeve të pakicave, që është karakteristike dhe i është bashkangjitur të gjitha të drejtave të cilat individët, në bashkësi me të gjithë të tjerët, tani më i gëzojnë sipas dispozitave të Paktit.

2. Në disa parashtrës, paraqitur Komitetit në harmoni me dispozitat e protokollit fakultativ e drejta që është e mbrojtur me nenin 27. është përzier me të drejtën që është e mbrojtur me nenin 27. është përzier me të drejtën e popujve për vetëvendosje të cilën e proklamoi neni 1,1 Paktit. Përveç kësaj, në raportet që shtetet anëtare i paraqesin sipas nenit 40 të Paktit, detyrimet që u janë imponuar shteteve anëtare sipas nenit 27, nganjëherë përzihen me detyrimet e tyre ndaj nenit 2. (1), që të sigurojnë shfrytëzimin e të drejtave të garantuara me Paktin pa kurrfarë diskriminimi, si dhe me parimet e barazisë dhe me mbrojtjen e njejtë para ligjit të cilët e siguron neni 26.

3.1. Pakti vendos dallimin midis të drejtës për vetëvendosje dhe të drejtës mbrojtëse, me nenin 27. E drejta për vetëvendosje është e drejtë që u takon popujve dhe e përmban pjesa e veçuar (Pjesa I) e Paktit. Vetëvendosja nuk mund të mbrohet sipas protokollit fakultativ. Neni 27, nga ana tjetër, ka të bëjë me të drejtë që u janë dhënë individve dhe si i tillë është përfshirë edhe në të gjitha nenet tjera që garantojnë të drejtat personale që u janë ndarë individve, në pjesën III të Paktit, dhe mund të mbrohet me protokollin fakultativ.

3.2. Shfrytëzimi i të drejtave për të cilat flet neni 27, nuk guxon asesi të çrregullojë sovranitetin dhe tërësinë tokësore të shtetit anëtar. Në të njejtën kohë, aspektet e caktuara të të drejtave të individëve të cilat mbrohen me këtë nen - p.sh. e drejta për shfrytëzimin e kulturës së caktuar - mund të përbëhet nga mënyra e jetës e cila është e lidhur ngusht me territorin dhe me përdorimin e resurseve të tij. Kjo, posaçërisht ka të bëjë me anëtarët e bashkësisë autoktone të cilët përfaqësojnë pakicën.

4. Pakti, gjithashtu bën dallimin midis të drejtave të mbrojtura me nenin 27, në raportet me garancat që ekzistojnë sipas nenit 2 (1) dhe nenit 26. Autorizimet, që sipas nenit 2(1) të gjitha të drejtat e parashikuara me Paktin shfrytëzohen pa kurrfarë diskriminimi, aplikohet në të gjitha individët brenda territorit të shtetit anëtar ose nën juridiksionin e tij pavarësisht nga fakti nëse individ i takon apo jo grupit minoritar. Krahas kësaj, ekziston edhe një e drejtë tjetër të cilën e parashikon neni 26, dhe e cila flet për barazinë para ligjit mbrojtjen e njejtë para ligjit, dhe për mosdiskriminimin në raport me të drejtat që janë ndarë dhe detyrimet që u janë imponuar shteteve anëtare. Ky nen rregullon shfrytëzimin e të gjitha të drejtave pavarësisht se a janë ato të mbrojtura me Pakt apo jo të cilat shtete anëtare ua garantojnë me ligj individëve që gjenden në territorin e tyre ose nën juridiksionin e tyre, pavarësisht nga fakti nëse ata u takojnë ose jo pakicat për të cilat flet neni 27. Disa shtete anëtare të cilat pohojnë se nuk ushtrojnë kurrfarë diskriminimi mbi baza të përkatsisë etnike, fetare ose gjuhësore gabojnë kur vetëm në bazë të kësaj konkludojnë se fare nuk kanë minoritete.

5.1. Terminet që përdoren në nenin 27, vënë në dukje faktin se personat të cilët duhet të mbrohen janë ato që i takojnë grupit të njejtë dhe që ndajnë kulturë, fenë dhe gjuhën e përbashkët. Këto shprehje gjithashtu vënë në dukje faktin se individët të cilët duhet të mbrohen në këtë rast, nuk është e

¹ Komenti i përgjithshëm është miratuar me 26 prill 1994 (Nacionalne manjine - u medjunarodnom Jugoslovenskom pravnom poretku, Beograd - 1997.

domosdoshme të jenë shtetasë të shtetit anëtar. Lidhur me këtë, me rëndësi janë edhe detyrimet që dalin nga neni 2 (1), duke marrë parasysh faktin se shteti anëtar është e detyruar sipas këtij neni të sigurojë që të gjitha të drejtat e parashikuara me Paktin t'u jenë të afërta të gjithë individëve të cilët gjenden në territorin e tij ose që janë nën juridiksionin e tij, me përjashtim të së drejtave që ekskluzivisht kanë të bëjnë me shtetasit e tij, siç janë bie fjala, të drejtat politike të parashikuara me nenin 27. vetëm për shtetasit e vet.

5.2. Neni 27 flet për të drejtat e personave të cilët u takojnë pakicave që "ekzistojnë" në shtetin anëtar. Duke marrë parasysh natyrën dhe vëllimin e të drejtave që janë parashikuara me këtë nen, nuk është relevante të caktohet gama e qëndrueshmërisë të cilën shprehja "ekzistojnë" e nënkupton. Këto të drejta, thjesht flasin se individët që u përkasin këtyre pakicave nuk mund të privohen nga e drejta që në bashkësi me anëtarët e tjerë të grupit të vet që shfrytëzojnë kulturën e vet, të predikojnë fenë dhe të flasin gjuhën e vet. Sikur që nuk janë të detyruar të jenë shtetas të shtetit anëtar, ata nuk janë të detyruar që në atë të kenë qëndrim të përhershëm. Për këtë shkak punëtorët emigrantë, ose madje vizitorët e ndonjë shteti anëtar paraqesin pakicën e tillë dhe janë të autorizuar që të mos jenë të privuar nga shfrytëzimi i këtyre të drejtave. Si edhe cilido individ tjetër në territorin e shtetit anëtar, në këtë kuptim, ata do të kishin të drejtat e përgjithshme, siç janë, liria e tubimit, liria e bashkimit dhe e shprehjes. Ekzistimi i pakicës etnike, fetare dhe gjuhësore në shtetin e caktuar anëtar, nuk varet nga vendimi i shtetit anëtar, por duhet të formohet me kriteret objektive.

5.3. E drejta e individëve të cilët i takojnë pakicës gjuhësore që midis tyre në jetën private ose publike, të shfrytëzojnë gjuhën e vet, dallohet nga të drejtat tjera gjuhësore të mbrojtura me Pakt. Posaçërisht duhet dalluar nga e drejta e përgjithshme e shprehjes së lirë, të cilën e mbron neni 19. Kjo e drejtë e është e afërt të gjithë personave pavarësisht nëse ata janë apo jo pjesëtarë të pakicave. Krahas kësaj, e drejta e mbrojtur me nenin 27, duhet të dallohet nga e drejta të cilën neni 14 (3) (f), i Paktit, e parashikon për personat e akuzuar për t'u siguruar përkthimi në situata kur nuk mund ta kuptojnë ose nuk e flasin gjuhën që përdoret në gjyq. Neni 14 (3) (f) nuk ka të bëjë me faktin se personat e akuzuar kanë të drejtë gjatë procedurës gjyqësore.

6.1. Ndonëse neni 27, është shprehur me përcaktues negative, ai pavarësisht nga kjo, vërtet e vendos ekzistimin e kësaj të "drejte", dhe urdhëron se kjo e drejtë nuk mund të privohet. Në përputhje me këtë, shteti anëtar ka detyrim të sigurojë se ekzistimi dhe shfrytëzimi i kësaj të drejte do të sigurohet nga çafërdo privimi ose shkelje. Prandaj, masat pozitive mbrojtëse janë të nevojshme jo vetëm kundër akteve të vetë shtetit anëtar qoftë se fjala është për pushtetin e tij legjislativ, gjyqësor apo administrativ, veçse edhe kundër akteve të personave të tjerë të cilët veprojnë në territorin e shtetit anëtar.

6.2. Ndonëse të drejtat e mbrojtura me nenin 27, janë të drejtat individuale ato në njëfarë mënyre varen nga aftësia e grupit minoritar për ta ruajtur kulturën, fenë dhe gjuhën e vet. Në përputhje me këtë masat pozitive nga ana e shtetit anëtar mund të jenë të domosdoshme për t'u mbrojtur identiteti i pakicës dhe të drejtat e anëtarëve të saj për t'a shfrytëzuar dhe zhvilluar kulturën e gjuhën dhe për ta mbrojtur fenë e vet në bashkësi me anëtarët e tjerë të grupit. Lidhur me këtë, duhet vërejtur se këto masa pozitive duhet t'i respektojnë dispozitat e neneve 2 (1) dhe 26. të Paktit si për nga çështja e trajtimit të më shumë pakicave të ndryshme ashtu edhe të trajtimit të personave që u takojnë pakicave në raport me pjesën tjetër të popullatës. Derisa këto masa kanë për qëllim korrigjimin e kushteve të cilat pengojnë ose nuk mundësojnë shfrytëzimin e të drejtave të garantuara me nenin 27, ato mund të paraqesin diferencimin legjitim ndaj Paktit, me kusht që të jenë të mbështetur në kriteret logjike e objektive.

7. Kur është fjala për shfrytëzimin e të drejtave kulturore të mbrojtura me nenin 27, Komiteti konsideron se kulturat manifestohen në shumë mënyra, duke përfshirë këtu edhe mënyrën karakteristike të jetesës e cila mund të lidhet me mënyrën e përdorimit të tokës dhe të resurseve të tjera, veçmas në rastet e popullatës autoktone. Kjo e drejtë mund të nënkuptojë edhe aktivitete të atilla tradicionale siç kanë peshkimi ose gjuetia, si dhe e drejta për të jetuar në rezervate të mbrojtura me ligj. Shfrytëzimi i

këtyre të drejtave mund të kërkojë masa pozitive mbrojtëse juridike dhe masa për t'u siguruar pjesëmarrja efektive e anëtarëve të bashkësisë monitorare në të gjitha vendimet të cilat ato i godasin.

8. Komiteti konsiderohen se asnjëra nga të drejtat e mbrojtura me nenin 27, të Paktit nuk guxon të përdoren sipas mënyrës apo shkallës e cila nuk është në përputhje me dispozitat tjera të Paktit.

9. Komiteti konkludon se neni 27, ka të bëjë me të drejtat, mbrojtja e të cilave imponon detyrime specifike për shtetet anëtare. Mbrojtja e këtyre të drejtave ka për qëllim që të sigurojë ekzistimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të identitetit kulturor fetar e shoqëror të pakicës së caktuar, duke begatuar kështu mbarë shoqërinë. Në përputhje me këtë, Komiteti konsideron se këto të drejta duhet të jetë të mbrojtura dhe se nuk guxojnë të përzihen me të drejtat e tjera personale të cilat sipas dispozitave të Paktit janë të garantuara për çdo individ. Për këtë shkak, shtetet anëtare kanë detyrim të sigurojnë që shfrytëzimi i këtyre të drejtave të sigurohet plotësisht dhe në raportet e veta duhet të vënë në dukje masat që i kanë miratuar për këtë qëllim.

4. DEKLARATA PËR DHËNIEN E PAVARËSISË VENDEVE DHE POPUJVE KOLONIALE¹

Asambleja e Përgjithshme,

E vetëdijshme për vendosmërinë që kanë shprehur popujt e botës në Kartën e Kombeve të Bashkuara për ta riafirmuar fenë në të drejta elementare të njeriut, në dinjitet dhe vlerë të qenies njerëzore, në të drejta të barabarta për meshkujt, femrat e popujt e vegjël e të mëdhenj dhe për ta avancuar progresin shoqëror dhe standardin e jetesës në liri më të madhe.

E vetëdijshme për nevojën e krijimit të kushteve për stabilitet e mirëqenie dhe për marrëdhënie paqësore e miqësore të mbështetura në respektimin e parimit të të drejtave të barabarta e të vetëvendosjes së të gjithë popujve, dhe të respektimit e ruajtjes universale të të drejtave të njeriut e të lirive elementare pavarësisht nga raca, gjinia, gjuha dhe feja.

Duke respektuar aspiratën e flaktë për liri të të gjithë popujve të varur dhe rolin e vendosur të popujve të tillë për realizimin e pavarësisë,

E vetëdijshme për konfliktet në rritje që rezultojnë nga shkurtimi apo vendosja e pengesave në rrugën e popujve të tillë për liri, që paraqet kërcënimin serioz për paqen botërore,

Duke marrë parasysh rolin e rëndësishëm të Kombeve të Bashkuara në dhënie e ndihmës lëvizjeve për pavarësi në rajonet jovetëqeverisëse dhe territoret nën mbikqyrje (patronat),

Duke respektuar se popujt e botës dëshirojnë thellësisht përfundimin e kolonializmit në të gjitha manifestimet e veta,

Të bindura se vazhdimi i kolonizimit pengon zhvillimin e bashkëpunimit ndërkombëtar ekonomik dhe nuk mundëson zhvillimin social, kulturor e ekonomik të popujve të varur dhe i kundërvehet paqes universale si ideal i Kombeve të Bashkuara,

Duke konfirmuar se popujt për qëllimet e veta mund të disponojnë pasurinë natyrore dhe resurset pa dëm ndaj çdo detyrimi që del nga marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare të mbështetura mbi parimet e dobisë reciproke dhe të drejtës ndërkombëtare,

Duke besuar se procesit të çlirimit nuk mund t'u kundërvehen dhe se është irevizibile, dhe për t'u anashkalur krizat serioze, duhet të përfundojnë kolonizimi dhe të gjitha format e segregacionit dhe të diskriminimit që janë në lidhje me to,

Duke respektuar kalimin e numrit të madh të territoreve të varura, gjatë viteve të fundit, në territore të lira e të pavarura dhe duke njohur rritjen e vazhdueshme të aspiratave për liri të atyre territoreve që ende nuk janë pavarësuar,

Të bindura se të gjithë popujt kanë të drejtën e patjetërsuar për liri të plotë, për realizimin e sovranitetit dhe të integritetit të territorit të tyre nacional,

Proklamojnë solemnisht nevojën për përfundimin e përshpejtuar të kolonializmit në të gjitha format e veta,

Dhe për këtë qëllim:

Proklamon:

1. Nënshtrimi i popujve nga nënshtrimi i huaj, dominimi dhe eksploatimi paraqesin marrjen e të drejtave elementare të njeriut, janë në kundërshtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe paraqesin pengesën për avancimin e paqes e të bashkëpunimit botëror.

2. Të gjithë popujt kanë të drejtën për vetëvendosje; në bazë të kësaj të drejte ata mund të

¹ G.A.Res. 1514(XV), 15 UN GAOR, SUPP (No.16), UN Doc. A/4684 (1960) at 66.

përcaktojnë lirisht rregullimin e vet politik dhe të synojnë lirisht zhvillimin ekonomik, social e kulturor.

3. Përgatitja joadekuate politike, ekonomike, shoqërore apo arsimore kurrë nuk guxon të shërbejë si arsytim për shtyerjen e pavarësisimit.

4. Të gjitha aksionet e armatosura dhe masat represive të çdo lloji të drejtaur kundër popujve të varur, do të pushojnë për t'u mundësuar atyre që në paqe dhe liri të realizojnë të drejtën e vet për pavarësi të plotë, kurse integriteti i territoreve të tyre nacionale do të respektohet.

5. Do të merren menjëherë të gjitha masat në territoret jovetëqeverisëse dhe në territoret nën patroant ose në të gjitha territoret tjera që ende nuk kanë fituar pavarësinë, që t'i bartin kompetencat në popujt e këtyre territoreve pa kurrfarë kushtesh dhe rezervash, në harmoni me vullnetin dhe dëshirën e tyre të hprehur lirisht, pavarësisht nga raca, prejardhja ose ngjyra, me qëllim që atyre t'u mundësohet që në tërësi ta gëzojnë pavarësinë dhe lirinë.

6. Çdo përpjekje e orientuar drejtë përdhosjes së pjesërishme a të plotë të unitetit nacional dhe integritetit territorial të vendit është inkompatibil me objektivat dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara.

7. Të gjitha shtetet do të respektojnë me besim të mirë dhe rigorozisht dispozitat e Kartës së Kombeve të Bashkuara, të Deklaratës universale mbi të drejtat e njeriut dhe të kësaj Deklarate mbi bazat e barazisë, të mospërzierjes në punët e brendshme të cilitdo shtet dhe të respektimit të të drejtave sovraane të të gjithë popujve e të integritetit të tyre territorial.

5. KONVENTA E UNESKO-S KUNDËR DISKRIMINIMIT¹

Neni 1.

1. Në këtë Konventë shprehja "diskriminim" nënkupton çdo dallim, përjashtim, kufizim apo anim i cili mbështetet në racën, gjininë, gjuhën, fenë, bindjen politike e tjetër, në zanafillën nacionale e shoqërore, kushtet ekonomike të lindjes dhe ka për qëllim apo pasojë mohimin ose shkurtimin e trajtimit të barabartë në arsim, e sidomos:

- (a) moslejimi i cilitdo individ apo grup personash për arsim të çdo lloji dhe shkalle;
- (b) kufizimi i cilitdo individ apo grup personash për arsimim të standardit të ulët;
- (c) është kryesore që t'u njihet e drejta pjesëtarëve të pakicave kombëtare, për t'i realizuar aktivitetet e veta të obligueshme, duke përfshirë këtu edhe hapjen e shkollave dhe, në varësi nga politika arsimore e shtetit, përdorimin dhe mësimin në gjuhët e tyre amëtare, mirëpo me kusht:
 - (I) që kjo e drejtë të mos realizohet në mënyrën e cila i pengon pjesëtarët e kësaj pakice për ta kuptuar kulturën dhe gjuhën e bashkësisë në të cilën jetojnë dhe nga pjesëmarrja në aktivitetet e saj, apo të rrezikojë sovranitetin nacional;
 - (II) që standardi i arsimit të mos jetë më i ulët nga standardi i përgjithshëm i përcaktuar nga autoritetet kompetente, dhe;
 - (III) se ndjekja e shkollave të tilla është sipas zgjedhjes.

¹ Miratuar më 14 dhjetor 1960, hynë në fuqi më 22 maj 1962, 429 UNTS 93.

6. DEKLARATA MBI TË DREJTAT E PERSONAVE TË CILËT U TAKOJNË PAKICAVE NACIONALE, ETNIKE, FETARE E GJUHËSORE¹

Neni 1.

1. Shtetet do të mbrojnë ekzistimin e pakicave nacionale ose etnike, kulturore, fetare e gjuhësore në territoret e veta dhe do t'i inkurajojnë kushtet për avancimin e identitetit të tyre.

Neni 2.

1. Personat të cilët u takojnë pakicave nacionale ose etnike, fetare e kulturore (në tekstin e mëtejshëm: personat që u takojnë pakicave) kanë të drejtë që, duke shprehur kulturën e vet, të predikojnë dhe praktikojnë fenë e vet dhe të përdorin gjuhën e tyre, privatisht e publikisht, lirisht dhe pa kurrfarë përzjerje ose çfarëdo forme të diskriminimit.

2. Personat të cilët u takojnë pakicave kanë të drejtë që vërtet të marrin pjesë në jetën kulturore, fetare, shoqërore, ekonomike e publike.

3. Personat që u takojnë pakicave kanë të drejtë që të marrin pjesë efektive në vendosjen edhe atje ku kjo është përkatëse për pakicën kombëtare të cilës i takojnë, në nivelin lokal ose në rajonin ku jetojnë në mënyrën e cila është në harmoni me ligjshmërinë nacionale.

4. Personat të cilët u takojnë pakicave kanë të drejtë të formojnë dhe t'i ruajnë shoqatat e veta.

5. Personat të cilët u takojnë pakicave kanë të drejtë të formojnë dhe ruajnë, pa kurrfarë diskriminimi, lidhjet e lira dhe paqësore me anëtarët e tjerë të grupit të vet, me personat që u takojnë pakicave tjera si dhe lidhjet përtej kufirit me qytetarët e shteteve tjera me të cilën kanë lidhje nacionale e etnike, fetare a gjuhësore.

Neni 4.

1. Shteti do të marrë masat, kur ndihet nevoja, për të siguruar që personat të cilët u takojnë pakicave të mund t'i ushtrojnë plotësisht dhe me efikasitet të gjitha të drejtat njerëzore dhe liritë elementare pa kurrfarë diskriminimi dhe në barazi të plotë para ligjit.

2. Shtetet do të marrin masa për të krijuar kushte më të mira për t'u mundësuar personave që u takojnë pakicave që t'i shprehin veçoritë e tyre dhe të zhvillojnë kulturën, gjuhën, fenë, traditën dhe zakonet e veta, përveç kur në rastet e veçanta kjo paraqet shkeljen e ligjit nacional dhe është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare.

3. Shtetet duhet të marrin masa përkatëse në mënyrë që, sa herë që nevojitet, personat të cilët u takojnë pakicave të kenë mundësi përkatëse për ta mësuar gjuhën amëtare dhe të djekin mësimin në gjuhën amëtare.

4. Shtetet, kur kjo është e rëndësishme, duhet të marrin masa në fushën e arsimit, në mënyrë që të inkurajojnë më mirë njohjen e historisë, traditës, gjuhës dhe të kulturës së pakicave të cilat jetojnë në territoret e tyre. Personat të cilët u takojnë pakicave duhet të kenë mundësi përkatëse për të fituar njohuri për shoqërinë në tërësi.

5. Shtetet duhet të shqyrtojnë mundësinë e aplikimit të masave përkatëse në mënyrë që personat të cilët u takojnë pakicave të mund të marrin pjesë në masë të plotë në progresin ekonomik dhe në zhvillimin e vendit të tyre.

¹ Me rezolutën 1992/16 nga 21 shkurti i vitit 1992 e miratuar në komisionin e KB për të drejtat e njeriut botuar në raportin e grupit të punës për të drejtat e personave që u takojnë pakicave kombëtare, etnike, fetare e gjuhësore, UN Doc. E/CN.4/1992 48-COR (1992) fq. 16-19.

Neni 5.

1. Politikat dhe programet nacionale duhet të planifikohen e të aplikohen ashtu që t'u kushtojnë kujdesin meritor interesave legjitime të personave të cilët u takojnë pakicave.

2. Programi i bashkëpunimit dhe i ndihmës midis shteteve duhet të planifikohen e të aplikohen me kujdes meritor ndaj interesave të personave të cilët u takojnë pakicave.

Neni 6.

Shtetet duhet të bashkëpunojnë rreth çështjeve që u përkasin personave të cilët u takojnë pakicave, përfshirë këtu edhe këmbimin e informacioneve e të përvojave me qëllim të avancimit të mirëkuptimit e të besimit të ndërsjellë.

Neni 7.

1. Ushtrimi i të drejtave të inaguruara me këtë Deklaratë nuk do të pengojnë që të gjithë personat t'i gëzojnë të drejtat e njohura universale të njeriut dhe liritë themelore.

2. Masat që po i marrin shtetet me qëllim të sigurimit të gëzimit të vërtetë të të drejtave të inaguruara me këtë Deklaratë nuk do të konsiderohen **prima facia** si në kundërshtim me parimet e barazisë që i përmban Deklarata universale mbi të drejtat e njeriut.

3. Në këtë Deklaratë asgjë nuk do të interpretohet sikur lejon çdo aktivitet i cili është në kundërshtim me objektivat dhe parimet e Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë barazinë sovraane, integritetin territorial dhe pavarësinë politike të shteteve.

7. DEKLARATA MBI PARIMET E TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE QË KA TË BËJË ME MARRËDHËNIET MIQËSORE DHE BASHKËPUNIMIN MIDIS SHTETEVE NË PËRPUTHJE ME KARTËN E KOMBEVE TË BASHKUARA

Pasi që shqyrtoi parimet e të drejtës ndërkombëtare që kanë të bëjnë me bashkëpunimin midis shteteve.

Proklamon solemnisht këto parime:

Parimin se shtetet do të përmbahen në marrëdhëniet e veta ndërkombëtare nga kërcënimi apo përdorimi i dhunës kundër integritetit territorial dhe pavarësisë politike të cilitdo shtet apo nga çdo mënyrë tjetër e cila nuk është në përputhje me objektivat e Kombeve të Bashkuara.

Çdo shtet ka obligim që në marrëdhëniet e veta ndërkombëtare të përmbahet nga kërcënimet apo përdorimi i dhunës kundër integritetit territorial dhe pavarësisë politike të cilitdo shtet apo nga çfarëdo mënyrë e nuk është në përputhje me objektivat e Kombeve të Bashkuara. Kërcënimi i tillë apo përdorimi i dhunës paraqet shkeljen e të drejtës ndërkombëtare dhe të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe kurrë nuk do të përdoret si mjet për zgjidhjen e çështjeve ndërkombëtare.

Lufta agresive paraqet krim kundër paqes për të cilën ekziston përgjegjësia sipas të drejtës ndërkombëtare.

Në përputhje me objektivat dhe parimet e Kombeve të Bashkuara, shtetet kanë obligim që të përmbahen nga propaganda e luftës agresive.

Çdo shtet ka obligim që të përmbahet nga kërcënimet dhe përdorimi i dhunës të orientuar në shkeljen e kufijve ekzistues ndërkombëtar të shtetit tjetër, apo si mjet për zgjidhjen e kontesteve ndërkombëtare, duke përfshirë edhe kontestet territoriale dhe problemet që u përkasin kufijve të shteteve.

Çdo shtet, gjithashtu ka obligim që të përmbahet nga kërcënimet apo përdorimi i dhunës të orientuara në shkeljen e vijave ndërkombëtare të demakracionit, siç janë vijat e armëpushimit kontraktuese të të cilave janë ato, ose që në mënyrë tjetër janë obliguese që t'i respektojnë. Asgjë që është lëshuar me qëllim nuk do të interpretohet si sjellje dëm pozicionit të palës në fjalë në raport me statusin dhe efektin e linjave të tilla nën regjim të posaçëm, apo sikur të ndikojë në karakterin e tyre të përkohshëm. Shtetet kanë obligim që të përmbahen nga aktet e hakmarrjes të cilët mbështesin aplikimin e forcës.

Çdo shtet ka obligim që të përmbahet nga çdo aksion dhune ndaj popujve për të cilët është menduar me rastin e formulimit të parimit të pavarësisë dhe të vetëvendosjes do t'i privojë nga e drejta për vetëvendosje, liri e pavarësi.

Çdo shtet ka obligim që të përmbahet nga organizimi, nxitja ndihma dhe pjesëmarrja në aktet e konflikteve civile dhe në aktet terroriste në shtetin tjetër ose nga pajtimi i heshtur për organizimin e aksioneve në territorin e tij të cilat janë të orientuara në kryerjen e veprave të tilla kur aktet për të cilat mendohet në këtë paragraf, përfshijnë kërcënimin apo përdorimin e forcës.

Territori i shtetit nuk do të jetë objekt i okupimit ushtarak si pasojë e përdorimit të forcës në kundërshtim me dispozitat e Kartës. Territori i shtetit nuk do të jetë objekt i fitimit nga ana e shtetit që është pasojë e kërcënimit të përdorimit të forcës. Kurrfarë shtrirjesh territoriale, që janë pasojë e kërcënimeve apo e përdorimit të forcës, nuk do të njihen si legale. Asgjë nga kjo që u theksua nuk do të interpretohet sikur i godet:

(a) dispozitat e Kartës apo cilëndo marrëveshje tjetër ndërkombëtare që i paraprinë regjimit të Kartës dhe është e vlefshme sipas të drejtës ndërkombëtare.

(b) teorizimet e Këshillit të Sigurimit të rregulluara me Kartën.

Të gjitha shtetet me besim të plotë do t'i fillojnë negociatat për lidhjen sa më parë të kontratës universale mbi çarmatimin e përgjithshëm e të plotë nën kontrollin efikas ndërkombëtar dhe do të synojnë miratimin e masave përkatëse lidhur me zvogëlimin e tensioneve ndërkombëtare dhe për forcimin e besimit midis shteteve.

Të gjitha shtetet do të pajtohen me besë të plotë me obligimet e veta që dalin nga parimet përgjithësisht të njohur dhe rregullat e të drejtës ndërkombëtare e për hirë të ruajtjes së paqes dhe sigurisë ndërkombëtare dhe do të bëjnë përpjekje që sistemi i sigurisë së Kombeve të Bashkuara i mbështetur në Kartën të bëhet më efikas.

Asgjë në paragrafët e mësipërme nuk do të konsiderohet zvogëlim apo shtrirje, në çfarëdo mënyrë, të vëllimit të dispozitave të Kartës kur është fjala për përdorimin e forcës e cila konsiderohet e ligjshme.

Secili shtet do t'i zgjidh kontestet me shtetin tjetër me mjete paqësore ashtu që paqja ndërkombëtare, siguria dhe drejtësia të mos sillen në rrezik.

Shtetet, në përputhje me këtë, do të synojnë zgjidhjet me kohë dhe të drejta të kontesteve të tyre ndërkombëtare me anë të negociatave, anketave, ndërmjetësimeve, pajtimeve dhe arbitrazhës, me mbështetje juridike, me ndihmën e agjencive e aranzhmaneve rajonale apo me përdorimin e mjeteve të tjera paqësore sipas zgjedhjes së tyre. Në kërkim të zgjedhjeve të tilla palët do të merren vesh për mjetet e atilla paqësore të cilat mund të jenë adekuate me rrethanat dhe natyrën e kontestit.

Palët në kontest kanë obligim, në rast të mosuksesit në arritjen e zgjidhjes me cilin do mjet paqësor të përmendur, që të vazhdojnë të kërkojnë zgjidhje të kontestit me mjete tjera paqësore për të cilat do të dakordohen.

Kontestet ndërkombëtare do të zgjidhen mbi baza të barazisë sovraane të shteteve dhe në përputhje me parimin e zgjedhjes së lirë të mjeteve.

Përdorimi a pranimi i procedurës së zgjedhjeve që janë harmonizuar lirisht midis shteteve lidhur me konfliktet ekzistuese a të ardhshme në të cilat gjenden ato palë, nuk do të konsiderohet se është kompaktibil me barazinë sovraane. Asgjësimi në paragrafin e mëparshëm nuk u sjell dëm ose i dërgon dispozitat e kartës që mund të aplikohen veçmas ato që kanë të bëjnë me zgjidhjen paqësore të kontesteve ndërkombëtare.

Asnjë shtet a grup shtetesh nuk ka të drejtë të ndërhyjë drejtë apo tërthorazi, nga çfarëdo shkaku në punët e brendshme a të jashtme të cilitdo shtet tjetër. Për këtë shkak, ndërhyrja e armatosur dhe të gjitha format tjera të përzierjes apo të përpjekjes së kërcënimit kundër subjektivitetit të shtetit tjetër ose kundër elementeve të tij politikë, ekonomikë e kulturorë, paraqesin shkeljen e të drejtës ndërkombëtare.

Asnjë shtet nuk mund të përdorë apo të inkurajojë format e ndryshme të masave ekonomike, politike e tjera për ta detyruar shtetin tjetër për nënshtrim në kryerjen e të drejtave të veta sovraane dhe me këtë të sigurojë çfarëdo dobie. Gjithashtu asnjë shtet nuk do të organizojë, ndihmojë, ushqejë, financojë, nxisë dhe tolerojë aktivitetet subverzive, terroriste dhe të armatosura të drejtuara për përmbysjen me dhunë të regjimit të shtetit tjetër ose për përzierje në konfliktet civile në shtetin tjetër.

Përdorimi i dhunës, me qëllim të privimit të popullit nga identiteti kombëtar, paraqet shkeljen e të drejtave të patjetërsueshme dhe të parimeve të mosndërhyrjes.

Secili shtet ka të drejtën e patjetërsueshme që të zgjedhë rendin e vet politik, ekonomik, shoqëror e kulturor pa kurrfarë forme të përzierjes së shteteve tjera.

Në paragrafët e mësipërme asgjë nuk do të interpretohet në dëm të dispozitave relevante të Kartës që kanë të bëjnë me ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare.

PARIMI I BARAZISË DHE I VETËVENDOSJES SË POPUJVE

Në bazë të parimeve të barazisë e të vetëvendosjes së popujve që i përmban Karta e Kombeve të Bashkuara, të gjithë popujt kanë të drejtë që ta zgjedhin lirisht rregullimin e vet politik dhe të ndjekin zhvillimin e vet ekonomik, shoqëror e kulturor dhe secili shtet ka obligim të respektojë këtë të drejtë në

përputhje me dispozitat e Kartës.

Secili shtet ka obligim që të avancojë me anë të aksionit të përbashkët apo të veçantë, realizimin e parimit të barazisë e të vetëvendosjes së popujve në përputhje me dispozitat e Kombeve të Bashkuara dhe t'u japë ndihmë Kombeve të Bashkuara për realizimin e përgjegjësisë që u është besuar me Kartën lidhur me zbatimin e parimeve, e me qëllim:

- (a) që të avancohen marrëdhënit miqësore dhe bashkëpunimi midis shteteve;
- (b) që të arrihet përfundimi i shpejtë i kolonizimit duke shfaqur kujdes meritator ndaj vullnetit të shprehur lirisht të popujve në fjalë; dhe duke pasur parasysh se nënshtrimi i këtyre popujve nënshtrimit të huaj, dominimit e eksploatimit paraqet shkeljen e parimeve si dhe mohimin e të drejtave themelore të njeriut dhe është në kundërshtim me Kartën.

Secili shtet ka obligim që me anë të aksioneve të përbashkëta e të veçanta të avancojë respektimin universal dhe realizimin e të drejtave të njeriut e të lirive elementare në haromi me Kartën.

Formimi i shteteve sovraane e të pavarura, bashkimi i lirë dhe integrimi bashkangjitja shtetit të pavarur ose paraqitja në çfarëdo forme tjetër të statusit politik të cilit populli e zgjedh lirisht, paraqet mënyrën e zbatimit të të drejtës për vetëvendosje të atij populli.

Secili shtet ka obligim që të përmbahet nga çfarëdo aksioni të dhunës i cili privon popujt e lartpërmendur nga pjesëmarrja në zhvillimin e këtij parimi për të drejtën e tyre për vetëvendosje, liri dhe pavarësi. Në aksionet e veta kundër dhe rezistimin ndaj aksioneve të tilla të dhunës, dhe në përpjekje për të realizuar të drejtën e tyre për vetëvendosje, popujt e tillë kanë të drejtë të kërkojnë e të marrin mbështetjen në përputhje me objektivat dhe parimet e Kartës.

PARIMI I BARAZISË SOVRANE TË SHTETEVE

Të gjitha shtetet gëzojnë barazinë sovane. Ato kanë të drejta dhe obligime të njëjta dhe janë anëtare të barabarta të bashkësisë ndërkombëtare pavarësisht nga dallimet në sferën ekonomike, shoqërore, politike e të tjera.

Veçmas, barazia sovraane nënkupton këto elemente:

- (a) shtetet janë të barabarta juridikisht;
- (b) secili shtet gëzon të drejtat që janë inhereente me sovranitetin e plotë;
- (c) secili shtet ka obligim që të respektojë subjektivitetin e shtetit tjetër;
- (d) integriteti territorial dhe pavarësia politike të shtetit janë të paprekshme;
- (e) secili shtet ka të drejtë që të zgjedh lirisht dhe të zhvillojë rregullimin politik, shoqëror, ekonomik e kulturor;
- (f) secili shtet ka obligim që plotësisht dhe me besim të mirë t'u nënshtrohet detyrimeve ndërkombëtare dhe të jetojë në paqe me shtetet tjera.

PARIMI QË SHTETET ME BESIM TË MIRË T'I PËRMBUSHIM OBLIGIMET QË I KANË MARRË NË PËRPUTHJE ME KARTËN

Secili shtet ka obligim që me besim të mirë t'i përmbush obligimet që i ka marrë në përputhje me Kartën.

Secili shtet ka obligim që me besim të mirë t'i përmbush obligimet në kuadër të parimeve të gjithëpranueshme dhe të rregullave të të drejtës ndërkombëtare.

Secili shtet ka obligim që me besim të mirë t'i përmbush obligimet sipas marrëveshjeve të vlefshme ndërkombëtare në kuadër të parimeve gjithëpërfshirëse dhe rregullave të së drejtës ndërkombëtare.

Në rastet ku obligimet që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare janë në kundërshtim me obligimet e anëtarëve të Kombeve të Bashkuara që dalin nga Kombet e Bashkuara, përparësi do të kenë obligimet nga Karta.

8. MËNYRAT DHE MJETET E MUNDSHME TË LEHTËSIMIT TË ZGJIDHJES PAQËSORE E KONSTRUKTIVE TË PROBLEMEVE QË U PËRKASIN PAKICAVE

HYRJE

1. Ky studim mbi zgjidhjet paqësore e konstruktive të situatave të pakicave, mbështetet mbi parimet që i përmbajnë normat univesale të të drejtave të njeriut të cilat, parasëgjithash, kanë të bëjnë me barazinë dhe dinjitetin e sëcilës qenie njerëzore.

2. Të drejtat e njeriut vendosin kufij në raport me të drejtat grupore si të shumicës ashtu edhe të pakicës. Ky studim nisët nga botëkuptimi se shkaku, përse kërkon të drejta për pjesëtarët e pakicave, qëndron në faktin se ato vendosin kufij rigorozë në raport me fuqinë e grupeve shumicë, të cilat ehe ashtu mund ta shfrytëzojnë pozitën e tyre të shumicës se si të krijojnë ose t'i ruajnë privilegjet e tyre.

3. Mirëpo, të drejtat e pakicës kurrë nuk mund të vendosen në atë mënyrë që të prishen parimet kryesore të barazisë. Shteti duhet të jetë shtëpi e përbashkët për të gjitha grupet etnike, fetare e gjuhësore që gjenden në të, e të cilat gëzojnë barazinë ashtu që askush të mos konsiderohet qytetar i rendit të dytë. Aparteji në Afrikën Jugore ka dëshmuar se si një pakicë intolerante dhe e papajtueshme mund t'i pengojë pjesëtarët e shumicës për ta shfrytëzuar të drejtën për bazi.

4. Gati të gjitha shtetet janë polietnike dhe shumëkonfesionale dhe të tilla do të mbeten. Nëse asgjë tjetër, shoqëritë nacionale do të bëhen më shumë e jo më pak pluraliste, në saje të ndikimit të të drejtave të njeriut dhe të demokracisë. Zgjidhja e problemeve të pakicave nuk mund dhe nuk duhet të jetë themelimi i një shteti "të pastër" ose kuazi-shteti të një grupi etnik pakicë, siç po dëshirohet me përkufizimin e tashëm të Bosnjës.

5. Nënkomisioni për pengimin e diskriminimit dhe mbrojtjen e pakicave është formuar me qëllim të gjetjes së mënyrave sipas të cilave shtetet dhe bashkësia ndërkombëtare do të mund ta zgjidhin deyrën e dyfishtë: së pari, të pengojnë diskriminimin dhe kështu ta mbështesin parimin e barazisë së të gjitha qenieve njerëzore, dhe së dyti t'i mbrojnë pakciat ashtu që secili anëtar i çfarëdo grupi mund ta ruajë identitetin e vet në masën e cila është në harmoni me të drejtat e njeriut. Detyra jonë është që t'u kundërvehem autorëve të urrejtjes e të ksenofobisë, dhe të vëmë në dukje mënyrën sipas të cilës barazia dhe dinjiteti mund të sigurohen në suazat e tërësisë tokësore dhe të stabilitetit politik.

6. Gjendemi në epiqendrën e periudhës së bujshme ku konfliktet etnike e fetare po manifestohen në format shumë më serioze se në dekadat e kauara. Forcat etnocentrike të çliuara gjatë këtyre viteve, janë bërë iracionale në urrejtjen e tyre dhe po i përdorin barbarizmat më ekstreme. Proceset vijuese të spastrimit etnik dhe të "pastërtisë" territoriale paraqesin provokim imediat për themelet e të drejtave të njeriut - për parimin se të gjitha qeniet njerëzore kanë lindur të lira e të barabarta në dinjitetin dhe në të drejtat e veta, dhe se nuk guxon të ketë diskriminim në bazë të racës, bojës e të prejardhjes etnike ose nacionale.

7. Vështir mund të parashikohet se kurdo të luftohet vala e tashme e dhunës. Bashkësia ndërkombëtare është ballafaquar me dy detyra më urgjente. E para është që të zhvillojë aftësinë e veprimit preventiv, të ruajtjes së paqes dhe të konsolidimit të sajë kur kjo është e nevojshme. Rekomandimet mbi mënyrën se si të forcohet aftësimi i Kombeve të Bashkuara në këto fusha, i ka paraqitur sekretari i përgjithshëm më 1992 në "Agjenden për paqe" të tij. Këto rekomandime duhet të aplikohen urgjentisht nëse dëshirojmë të evitojmë përsëritjen e mossuksesit pikllues për t'u ndalur agresioni dhe pësimet në Bosnjë e Hercegovinë.

8. Detyra e dytë është të nxiten shtetet që në bazë të së drejtës ndërkombëtare, t'i harmoizojnë grupet e ndryshme etnike, fetare dhe gjuhësore me qëllim që të gjitha ato të ndihen si në shtëpinë e vet,

dhe që askush të mos trajtohet si banor apo qytetar i rendit të dytë. Studimi i është kushtuar kësaj detyre të dytë.

Si anëtarë, ekspertët e këtij trupi të Kombeve të Bashkuara do të duhet t'i mbindërtojnë parimet themelore të rendit botëror që i përmban Karta e Kombeve të Bashkuar dhe instrumentet universale nga fusha e të drejtave të njeriut.

9. Nuk guxon të lejohet që konfliktet e grupeve, të cilët sot coptojnë ose destabilizojnë shtetet sovraane në anë të ndryshme të botës duke bartur me vete shkelje masive të të drejtave të njeriut, të errësojnë faktin se në shumicën e shteteve jetojnë grupe të ndryshme etnike e fetare dhe këtë e bëjnë në mënyrë tejet paqësore. Vëmendja që mediat po ua kushtojnë rasteve më dramatike, ndonëse vërtetë është e domosdoshme, nuk duhet të na çojë në përfundim të gabueshëm se nuk mund të bëhet asgjë, ose vazhdimisht jemi të shtrenguar për urrejtje e ksenofobi. Përkundrazi, motivacionin më të madh duhet marrë nga shembujt pozitivë nga shumë pjesë të ndryshme të botës ku grupet e ndryshme i janë adaptuar njëra-tjetrës, jetojnë rehat njëra pranë tjetrit, e ruajnë identitetin e vet, por megjithatë i përshtaten kushteve moderne e të reja dhe zhvillojnë lidhje me martesë të përziera dhe me mirëkuptim reciprok. Materiali i grumbulluar për këtë studim tregon se ekziston, gatishmëria në rritje e shteteve nga të gjitha kontinentet që t'u dalin në ballë interesave legjitime të pakicave. Si kompensim, anëtarët e shumë grupeve pakicë bëhen më pak militante, dhe e fillojnë dialogun konstruktiv me qeverinë dhe me grupet tjera etnike.

10. Në të kaluarën jo aq të largët, ndërtuesit e urave nga të dy anët do t'i zëvendësojnë ithtarët e ashpër të ksenofobisë dhe etnonacionalistët, pavarësisht nëse i takojnë shumicës apo pakicës. Do të zgjasë një kohë, kurse lufta do të jetë e vështirë. Shumçka duhet të bëhet për t'u krijuar kushte të atilla ku konfliktet e grupeve do të rregullohen në mënyrë paqësore duke respektuar tërësinë tokësore të shteteve sovraane. Shpresojmë se ky studim mund të jetë kontribut për këtë objektiv.

2. KUR EKZISTIMI I PAKICËS NUMERIKE E KRIJON "SITUATËN"?

44. Thënë në përgjithësi situata krijohet kur ekziston ndjenja e përhapur gjegjësisht e frustrimit midis anëtarëve të grupit pakicë, e frustrimi është në lidhje me përkatësinë e tyre atij grupi. Nëse ka apo jo bazë oër frustrim, duhet të shqyrtohet për së afërmi.

Në disa raste ai mund të jetë produkt i grupit të emisarëve ambiciozë interesi i të cilëve nuk është promovimi i të drejtave të njeriut, veçse fuqia, ekskluziviteti dhe domonimi. Sëkëndejmi lypset shqyrtuar për së afërmi gjërat. Frustrimi mund të analizohet në kontekst të kërkesave që shtrohen.

45. Një lloj i kërkesave të grupit pakicë që janë të arsyeshme paraqitet në situatat ku pjesa tjetër e shoqërisë e izolon grupin e njerëzve për shkak të veçorive të tija fizike ose kulturore i jep atij trajtim tjetër dhe të pabarabartë, prandaj këta njerëz ndihen si objekt të diskriminimit në shoqërinë në të cilën jetojnë. Diskriminimi që e përjetojnë ata mund të ketë forma të ndryshme: kërcënimi ndaj sigurisë personale (p.sh. sulmet kundër punëtorëve emigrantë në Evropë), diskriminimi me rastin e punësimit, banimit, mundësia e shfrytëzimit të pasurisë, etj. Si shembull mund të përmendet pozita e amerikanëve me prejardhje afrikave në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ose e romëve në shumë vende evropiane. Në rastet e këtylla, personat për të cilët konsiderohet se i takojnë pakicës si individë kërkojnë barazi me pjesëtarët e tjerë të shoqërisë. Rast i veçantë janë individët të cilëve u shkurtohet shtetësia pas fitimit të pavarësisë dhe për këtë shkak ndihen se janë objekt i diskriminimit në shumë fusha. Ky problem mund të vërehet në shumë shtete të formuara pas shkatërrimit të Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë, por ka ekzistuar edhe në disa raste tjera në periudhën pas çkolonizimit. Kategorinë tjetër e përbëjnë punëtorët emigrantë dhe personat me qëndrim më të gjatë huajt në ndonjërin nga shtetet e pavarura për të cilën dinë se nuk është shteti i tyre. Ata, gjithashtu, kohë pas kohe i janë të nënshtruar diskriminimit të vrazhdë. Shteti në të cilën kanë qëndrim nuk ka vazhdimisht mundësi që t'u sigurojë mbrojtje të plotë.

46. Lloji i dytë i kërkesave janë ato kërkesa të grupit pakicë anëtarëve të të cilit nuk i janë lejuar ose nuk kanë kushte të duhura për ruajtjen e identitetit të vet (gjuhësor, fetar, kulturor). Në disa raste kërkesat shkojnë edhe më larg kur anëtarët e grupit kërkojnë shkallë të caktuar të autonomisë për çështjet që u përkasin (pa pretendime territoriale). Për shembull, aplikimi i dispozitave civile - juridike që e kanë pikënisjen në religjionin e atij grupi (marrëdhëniet familjare, trashëgimia etj) në vend të dispozitave që i përmbajnë legjislacionet kombëtare.

4. Në llojin e tretë të kërkesave janë ato territoriale: për vetëqeverisje lokale të vëllimit të gjerë apo të ngushtë duke përfshirë ndojëherë edhe të drejtën për nxjerrjen e ligjeve të veta ose për autonomi të gjerë territoriale të grupit e cila nënkupton institucionet e veta të pushtetit (legjislativë ekzekutive duke përfshirë policinë, forcat lokale të sigurisë dhe gjyqësinë).

48. Në fund, me ekstreme janë kërkesat për coptime territoriale dhe secesion, qoftë për qëllim të bashkëngjijtes shtetit tjetër apo për qëllim të formimit të shtetit sovran në pjesën e territorit të shtetit sovran në të cilin jetojnë.

B. KUR JANË ZGJIDHJET PAQËSORE DHE KONSTRUKTIVE?

1. Kur ekziston "zgjidhja" për situatat që u përkasin pakicave?

49. Disa konflikte të grupeve mund të "zgjidhen" plotësisht. Ndonëse mund të jetë e rrezikshme të kërkojnë zgjidhje definitive.

Për këtë na paralajmërojnë shembujt nga e kaluara.

Disa pohojnë se grupet homogjene etnike paraqesin zgjidhje më të mira. Nganjëherë janë përdorur masa drastike në situatat kur grupet nuk duan të jetojnë bashkë. Spastrimi etnik, transferimi masiv i popullatës dhe lufta e cila kulminon me gjenocid, janë disa forma të epilogut të një konflikti të tillë. Disa këtë mund ta konsiderojnë "zgjidhje", por kjo do të ishte qartë e papranueshme nga aspekti i të drejtës dhe moralit të tashëm ndërkombëtar. Kërkimi i zgjidhjeve të përsosura paraqet rrezikun serioz dhe mund të ketë për pasojë shkelje masovike të të drejtave të njeriut.

50. Bashkëzistimi i grupeve të ndryshme etnike, fetare e gjuhësore në kuadër të shtetit sovran më parë është rregulluar se sa përjashtim.

Vetëm dhuna masovike mund ta ndryshojë këtë fakt. Bashkëzistenca e grupeve mund të urrehet nga ana e disa anëtarëve më pak tolerantë të grupeve të ndryshme. Disa tensione mund të shpërthejnë kohë pas kohe. Mirëpo, ky studim nisat nga aspekti se shumica e njerëzve në distancat më të mëdha kohore, dëshironi të jetojë atje ku jeton pavarësisht që përbenë pakicën e shoqërisë së gjërë, në qoftë se u janë siguruar të drejtat e barabarta të cilat i shfrytzojnë edhe pjesëtarët e shumicës. Në kushtet e tilla për dhunë me qëllim të ndryshimit të kufijve, të dëbimit të grupeve tjera të secesionit apo të bashkimit me shtetin tjetër, mjafton të mobilizosh vetëm një grusht të (senkserëve) etnik ose fetar.

51. Problemi i veçantë paraqitet në periudhat e ndryshimeve thelbore, çfarë ndodh, bie fjala, paradokohe me shkatërrimin e Bashkimit Sovjetik dhe të Jugosllavisë. Shkatërrimi i tillë ka rastisur kohësisht me transformime dramatike politike të shkatërruara me kolapsin e ideologjive në pushtet e cila ka shërbyer për ta justifikuar forcën e shtetit dhe ndryshimet afatgjata të sistemeve ekonomike. Duke vepruar njëkohsisht, këta faktorë krijuan situatë të veçantë të pasigurisë për grupe të ndryshme etnike, të cilat në nivele të ndryshme u mundësuan emisarëve etnikë për të kryer mobilizimin për konflikte me dhunë dhe për spastrime etnike. Mirëpo, këto nuk janë rrethana normale dhe në bazë të tyre nuk mund të konkludohet për paevitueshmërinë e dhunës etnike.

52. Madje edhe në rrethanat normale ekziston mundësia për paraqitjen e tensioneve të caktuara midis grupeve të ndryshme etnike e fetare të cilat jetojnë bashkë. Konflikti është karakteristikë e marrëdhënive midis grupeve ashtu siç është edhe bashkëpunimi.

Format joviolente të konflikteve ndonjëherë bile edhe janë të nevojshme për kuptimin e nevojës së eliminimit të pengesave e me qëllim të bashkëpunimit më të mirë në të ardhmen. Nga kjo esenca e problemit nuk është në ekzistimin e shkallës së caktuar të konfliktit por në mënyrën sipas të cilës ai zgjidhet dhe a do të ketë për pasojë gatishmërinë për ndërtimin e urave të mbështetura mbi barazinë ose do të shkallëzohet në dhunë të hapur.

53. Njerëzit e ndryshëm reagojnë ndryshe ndaj tensioneve të paevitueshme. Disa përcaktohen për provime, militarizëm dhe konflikte. Të tjerët kërkojnë rrugë që dukuritë e tilla të tejkalohen. Mirëpo, kur dhuna fillon ajo shpejt mund të marrë hovin e vet dhe atëherë grupet e pajisura e grindavece e shfrytëzojnë dhunën të cilën e nis pala tjetër, si vërtetim për aplikimin e mëtejme të dhunës.

54. Që procesi i tillë të pengohet duhet të merren të gjithë hapat e disponuar për të siguruar që secili grup të ketë mundësi ta ruaj identitetin e vet dhe vetërespektimin e të realizojë detyrën e përbashkët - ndërtimin e shoqërisë nacionale e cila i përfshinë të gjithë banorët e shtetit në fjalë, pavarësisht nga karakteristikat e tyre.

55. Sipas teorisë mbi kontratën shoqërore, shtetet dhe qeveritë legjitime janë prezantuar mund të thuhet idealisht si rezultat i marrëveshjes reciproke të qenieve të lira njerëzore me qëllim të zgjidhjes së problemit me ç'rast këto liri mbeten në fuqi sepse ato vetë populli i ka harmonizuar me veprimin e qeverisë. Por realiteti është krejtësisht ndryshe. Shtetet janë krijuar kurse kufijtë e tyre janë siguruar me faktorë të numërt duke përfshirë pushtimin, kolonializmin dhe luftërat feudale.

Bile edhe në numrin më të vogël të rasteve kur shtetet janë krijuar me aksionin e përbashkët të lirë të grupeve vetëzgjedhëse të qenieve njerëzore, brenda atyre kufijve gjenden disa grupe të cilat nuk kanë pasur zgjidhje tjetër veçse të kyçen me dhunë kështu që tani jetojnë në ato suaza.

56. Me miratimin e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe të Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut, janë hedhur themelet e reja të rënda botërore. Shtetet sovraane do të duhej të ishin të mbrojtura nga agresioni dhe intervencioni, kurse territoreve jove të qeverisë nën okupimin e huaj kolonial do të duhej dhënë pavarësia, nëse këtë e dëshirojnë. Detyra e shteteve sovraane, pavarësisht nga mënyra se si janë krijuar, është që të sigurojnë drejtësi të mirë dhe barazi për anëtarët e të gjitha grupeve etnike racore e fetare të cilat jetojnë brenda kufijve të tyre.

57. Në periudhën pas vitit 1945 të cilin e karakterizon kujdesi për të drejtat e njeriut dhe për ruajtjen e paqes e të sigurisë ndërkombtare, ishet e nevojshme të gjendej në kompromis i atillë që demokratizimi i shoqërisë të kryhet sipas mënyrës që të gjitha grupet të kenë mundësi të pjesëmarrjes e të ndikimit adekuat dhe të vërtetë në të gjitha vendimet e qeverisë veçmas në ato që u përkasin drejtpërdrejt atyre si dhe t'u mundësohet që ta ruajnë dhe zhvillojnë identitetin e vet në bazë të të drejtave të përgjithshme njerëzore, pa diskriminimi.

C. Ç'ËSHTË ME TË DREJTËN E POPUJVE PËR VETËVENDOSJE?

73. Kur grupi pakicë jeton si bashkësi kompakte në pjesën e territorit të një shteti, përfaqësuesit e saj pohojnë ndonjëherë si ai grup paraqet popullin ose kombin dhe në bazë të kësaj ka të drejtë për vetëvendosje.

74. Të gjithë popujt kanë të drejtë për vetëvendosje. Në bazë të kësaj të drejte ata lirisht e caktojnë pozitën e vet politike dhe e zbatojnë lirisht zhvillimin e vet ekonomik shoqëror e kulturor. Kjo thuhet në të dy Paktet nga viti 1966 dhe është konfirmuar si parim i përgjithshëm në Deklaratën e Vjenës dhe në Programin e Veprimit nga viti 1993 (Pjesa I.2. parag.1).

75. Mirëpo, ekzistojnë mospajtme të numërta rreth këtyre dy çështjeve thelbësore: së pari, kush e përbën "popullin"; dhe së dyti cili është vëllimi i të drejtave për vetëvendosje në rrethanat e ndryshme. Konferenca Botërore mbi të Drejtat e Njeriut ka kontribuar në sqarimin e pjesërishëm të kësaj çështjeje:

"Duke pasur parasysh rrethanat e veçanta në të cilat gjenden popujt nën kolonizim ose në format tjera të dominimit apo okupimit të huaj, Konferenca Botërore mbi të Drejtat e Njeriut ua njehtë drejtën e popujve që të marrin çfarëdo aktesh legjitime në harmoni me Kartën e Kombeve të Bashkuara, në mënyrë që të realizojnë të drejtën e vet të patjetërsueshme për vetëvendosje.

Konferenca Botërore mbi të Drejtat e Njeriut e konsideron shkelje të të drejtës së njeriut mohimin e të drejtës për vetëvendosje dhe e thekson rëndësinë e realizimit të njëmendtë të kësaj të drejte". (Deklarata e Vjenës dhe programi i veprimit Pjesa I. 2, paragrafi i dytë).

76. Ky studim nuk merret me rastet e popujve të cilët jetojnë në territorin nën sundimin kolonial as me popujt të cilët gjenden nën pushtimin e huaj jolegal të vendosur pas miratimit të Kartës së Kombeve të Bashkuara e me të cilën shkilen parimet e Kartës.

Këta popuj, qartë, kanë të drejtën për vetëvendosje duke përfshirë edhe pavarësinë, nëse për këtë përcaktohen. Kur këtu po përdoret termi "popull", ai nënkupton popullatën e përhershme e cila qëndron në territorin në fjalë, e jo grupet e caktuara etnike ose fetare pavarësisht nëse janë dominante apo jo në territorin në fjalë. Ai përket "demosit" e jo etnosit. Gjatë procesit të çkolonizimit, fjala "popull" është shfrytëzuar me konsekuencë për ta shënuar popullatën në tërësi.

77. Ky studim merret vetëm me grupet që jetojnë në shtetet bashkëkohore dhe në territorin për të cilin shumica në bashkësinë ndërkombëtare konsideron se i takon shtetit sovran, jo si territor i varur kolonial ose i pushtuar, veçse si pjesë e territorit të tij sovran. Për grupet e tilla aplikohen këto paragrafe të Pjesës I.2, të Deklaratës së Vjenës dhe të Programit të veprimit:

"Në harmoni me Deklaratën mbi parimet e të drejtës ndërkombtare që kanë të bëjnë me marrëdhëniet miqësore dhe bashkëpunimin midis shteteve në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara nga viti 1970 kjo nuk do të konsiderohet si dhënie e autorizimeve ose si inkurajim për marrjen e çfarëdo akti me të cilin do të coptohej ose rrezikohej plotësisht a pjesërisht integriteti territorial ose uniteti politik i shtetit sovran e të pavarur i cili sillet në përputhje me parimet e barazisë dhe të së drejtës për vetëvendosje dhe sëkëndejmi e ka qeverinë e cila e përfaqëson mbarë popullin që i takon territorit të dhënë pa kurrfarë diskriminimi".

78. Konfirmimi i serishëm i marrëdhënieve midis të drejtës për vetëvendosje të përmbajtur në paktet nga viti 1966 dhe të parimit të vetëvendosjes siç është parashtruar në Deklaratën nga viti 1970, është i mirëseardhur. Kjo tani më është shprehur në Deklaratën për dhënie e pavarësisë vendeve dhe popujve kolonial:

"Ç'farëdo përpjekje që ka për qëllim shkatërrimin e pjesërishëm apo të tërësisht të unitetit nacional dhe të tërësisë tokësore të një vendi, është në kundërshtim me objektivat dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara". (Rezoluta e Asamblesë së përgjithshme 1514 (XV), parag.6).

III ROLI I BASHKËSISË NDËRKOMBËTARE

Mosndërhyrja

319. Për mbajtjen e paqes e të bashkëpunimit ndërkombtar është me rëndësi thelbësore evitimi i intervenimit të jashtëm dhe i nxitjes së urrejtjes e të ksenofobisë. Në këtë rast zgjidhja e konfliktit në nivelin nacional bëhet më shumë e ndërlikuar.

Me siguri është e paevitueshme që qeveritë e vendeve të huaja, ndonjëherë nën presionin e opinionit të vet publik, kyçen në situatën kur pakicave në vendin fqinj u imponohet diskriminimi i vrazhdë ose u mohohet identiteti. Ky presion do të jetë veçanërisht i fuqishëm kur pakica për të cilën është fjala, i takon grupit të njëjtë etnik ose gjuhësor si dhe shumica e shtetit në fjalë.

Mirëpo, përdorimi i presionit të tillë si dhe nxitja e inkurajimi i pakicave në shtetin tjetër që të përdorin dhunën, çon në destabilizimin dhe nga ai duhet hequr dorë. Natyrisht se përmbajtja e tillë

kërkon alternativë të arritshme konstruktive për aksion në kuadër të organizatave rajonale ose të Kombeve të Bashkuara.

320. Kombet e Bashkuara kanë rol të rëndësishëm për avancimi e stabilitetit politik e shoqëror të shtetit. Deklaratat mbi të drejtat e personave të cilët u takojnë pakicave nacionale ose etnike fetare ose gjuhësore nga viti 1992, në paragrafin e vet preambular thotë se avancimi dhe mbrojtja e të drejtave të personave që u takojnë pakicave kontribuon në stabilitetin e shtetit në të cilin ato jetojnë. Detyra e Kombeve të Bashkuara dhe e organizatave rajonale është që të kontribuojnë në mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të pakicave ashtu që stabiliteti politik e shoqëror i shtetit në fjalë të përmirësohet e jo të dobësohet. Këtë udhëzimi duhet t'i përmbahen edhe organizatat joqeveritare.

Pjesa nga deklarata e lartmëdhërisë të tij Princ Hans Adami i Dytë prej Lihtenshtajnit, shef i shtetit të Lihtenshtajnit Komiteti i III-të, Kombet e Bashkuara Nju Jork, 25 tetor 1993.

Të gjithë ne jemi dëshmuar se konfliktet civile brenda shteteve shpesh po nxisin vuajtje të madhe: ndonëse shkaqet dhe rrënjët e konflikteve të tilla gjenden në vetë shtetin, gjithmonë ekziston rreziku që ato të shtrihen jashtë kufijve të tij dhe me këtë të rrezikojë sigurinë e mbarë rajonale, por edhe më gjerë, bashkësinë ndërkombtare. Ne nuk mund të shikojmë rehat, e më pak të pranojmë një zhvillim të tillë të ngjarjeve. Mirëpo, ne mund të vërejmë se shkaqet shpesh të konflikteve civile janë tensionet shoqërore të cilat po rriten kur grupeve të ndryshme në kuadër të shtetit nuk u lejohet që me mjete adekuate të shprehin identitetet e veta të ndryshme. Sikur të kishim mundësi të gjenim mjete përmes të cilave do të kishim mund të nxisnim një vetëshprehje të tillë, në masë të mirë do të na shkonte për dore që konfliktet e tilla t'i paksonim e në disa raste madje edhe t'i evitonim si dhe dukuritë e tyre shoqëruese vuajtjen dhe reziqet tjera. Me këtë do të ishte shumë më mirë që të vendosim ndonjë aranzhman adekuat para se të tensionet të shpërthejnë në konflikte, në vend që të presim të ndodhë kjo e pastaj orvatemi të bëjmë diçka nga thyerja e posakrijuara. Sekretari i përgjithshëm na rikujton gjithë neve për rëndësinë tejet të theksuar të diplomacisë preventive e cila dallon dukshëm nga diplomacia jonë e zakonshme reaktive.

Sipas mendimit tonë parimi i vetëvendosjes që e përmban Karta e Kombeve të Bashkuara dhe instrumentet tjera të rëndësishme ndërkombtare ende ka potencial të pahulumtuar i cili ofron mundësi të përparimit në drejtimin për të cilin po angazhohemi ne, kurse autonomia paraqet mjet të veçantë praktik që mund të zhvillohet në kuadër të vëllimit të gjërë të vetë atij parimi.

E gjithë kjo na ka shtyrë të propozojmë që Bashkësia Ndërkombtare të rishikojë dhënien e shkallës së caktuar të autonomisë disa bashkësive. Ky koncept është shumë fleksibil dhe mund të shfrytëzohet konstruktivisht në mënyrë që të mbulojë aspektet e ndryshme të vetëvendosjes dhe dretpërdrejtë do të mundësonte dhënien e shkallës së atillë të shprehjes disa bashkësive çfarë i përgjigjet në rrethanat e tyre të veçanta. Ne parashikojmë disa mekanizma dhe procedura minimale të cilat do të duhej t'u ndihmojnë shteteve dhe bashkësive në kërkimin e tyre por modelet e autonimive të cilat do t'u përgjigjeshin nevojave të tyre.

Kjo, zoti kryetar, është esenca e ideve dhe rezonimeve tona të cilat ajo i ka mishëruar. Meqenëse ato për herë të parë i janë propozuar Asamblesë së Përgjithshme me 1991, ne nga atëherë kemi pasur rastin të dëgjojmë komente tejet konstruktive të një numri të shteteve të interesuara. Veçmas kanë qenë interesante pikëpamjet e paraqitura në sesionin jozyrtar të ekspertëve të cilin Lihtenshtajni pati nderin dhe privilegjin ta organizojë në mars të këtij viti. Këto komente e pikëpamje me mendimet tona të mëtejshme na kanë ndihmuar që edhe më shumë t'i kristalizojmë idetë tona për vetëvendosjen. E duke marrë parasysh faktin se tani po i shqyrtojmë idetë tona në kontekst të rendit të ditës kaptina 108 b) unë dua që t'i zërthej edhe më shumë:

Qysh në fillim dua t'i theksoj katër pika të cilat e bëjnë bazën e propozimit tonë.

Së pari timoni fillestar i parimit të vetëvendosjes është shënuar në periudhën e çkolonizimit. Ndonëse ky proces ende nuk ka përfunduar pjesa më e madhe e tij është e kënaqur me rolin që ka luajtur në të. Mirëpo, vetëvendosja është parim me vlerë të qëndrueshme. Edhe pse ne nuk duam të nënçojmë

karakterin relevant të situatave të kolonizimit ose të dominimit të huaj që ndoshta ende ekzistojnë, propozimet tona sillen në drejtim tjetër, sepse orvaten të vënë theks të ri mbi këtë parim si faktor të rëndësishëm në kontekstin e ri.

Së dyti, vetëvendosja është një parim shumë i gjerë i cili lejon forma të ndryshme të zhvillimit duke përfshirë edhe pavarësinë: në kontekstin e çkolonizimit pavarësia vërtet ka qenë zakonisht qëllim primar. Mirëpo, shikuar nga perspektiva jonë pavarësia nuk është qëllim primar: do të ishte gabim të përjashtojmë në parim, por ne besojmë se qëllimi i qetësimit të tendosjeve të rrezikshme, të cilën e synojnë dhe shumë të tjerë, kryesisht mund të arrihet me anë të konceptit të autonomisë. Edhe ai është koncept fleksibil por në esencë ka të bëjë me atë që mund të quhet "vetëqeverisje niterne". Ai lejon shkallë të caktuar të vetëshprehjes e cila mund të jetë e mjaftueshme për ndonjë bashkësi që me anë të saj të shpreh ndjenjën e vet të identitetit: ai gjithashtu lejon që të merren parasysh rrethanat e veçanta e të ndryshme që ekzistojnë në kuadër të shumë shteteve; e lojon edhe zhvillimin shkallë - shkallë, ashtu siç e diktojnë rrethanat. Mirëpo, më me rëndësi është fakti që ky koncept nuk lon drejtë fragmentimit të shteteve ose drejte krijimit të entiteteve të numërta të vogla të pavarura. Se vlera e autonomisë është koncept i cili mund të jetë i dobishëm për ne, të gjithë neve na treguan ngjarjet e afërta, veçmas ato në Lindje të Afërt.

Së treti theksi i ynë mbi autonominë si koncept ofron zgjidhje më të mirë ka lidhje me bindjen tonë se ne duhet parasëgjithash të jemi të interesuar për pozitën e bashkësive të ndryshme në kuadër të shteteve për shkak se frustrimet e atyre bashkësive të shpeshten çojnë kah ai lloj i tensioneve e pastaj të konflikteve të cilat ne në fakt po duam t'i evitojmë.

Së katërti ne besojmë se nuk mjafton që vetëm t'i shprehim ndjenjat e vërteta: ne duhet patjetër të ofrojmë dispozita përkatëse të cilat do të mundësojnë që epilogu të jetë i frytshëm në praktikë. Natyrisht se ne nuk po mendojmë në ndërtimin e ndonjë strukture organizative të komplikuar e të shtrenjtë veç parashikojmë mekanizmin e thjeshtë i cili do të mundësojë që propozimet për te cilat në fund do të harmonizohemi të zbatohen me efikasitet në praktikë.

Zoti president, më lejoni tani që të bëj një vështrim më të hollësishëm të disa elementeve kryesore të ideve tona. Në bazë të asaj që thash deri më tash, është e qartë se ne jemi përqëndruar në tendosjet që po lindin midis bashkësive. "Bashkësia", ndërkaq është term të cilin, sipas mendimit tim, të gjithë ne e kuptojmë përgjithësisht, por të cilin nganjëherë vështirë mund ta shpjegojmë me precizitet ligjor. Formula klasike të cilën shpesh e shfrytëzojmë Kombet e Bashkuara në një kontekst tjetër ka të bëjë me grupin i cili ka bazën e njëjtë gjuhësore, fetare, kulturore ose etnike për identitetin e vet unik. Ndonëse ne nuk po propozojmë që kjo formulë të pranohet në këtë kontekst, ajo megjithatë na ndihmon për të identifikuar kahet drejt të cilave duhet të shkojnë mendimet tona.

Mirëpo, unë këtu dua të theksoj se koncepti ynë i "bashkësisë" nuk është identik me konceptin e "pakicës". Kuptohet se shumë gjera të dobishme në favor të statusit të pakciave i kanë bërë Kombet e Bashkuara, veçmas mendoj në Deklaratën e cila u miratua vitin e kaluar, si edhe trupat tjerë, bie fjala OSBE-ja, e kohët e fundit edhe Këshilli i Evropës në samitin e vet në Vjenë. Mirëpo, ndonëse idetë "bashkësia" dhe "pakica" deri diku përputhen, ato në esencë dallojnë. Ne parasëgjithash jemi të interesuar për aspirata politike e kulturore të bashkësive të cilat i poseodjnë - për dallim nga pakicat - shkallën e kohezionit territorial e shoqëror.

Ne besojmë se në kaudër të parimit të gjerë të vetëvendosjes, bashkësive të tilla duhet njohur si legale synimet e tyre drejt shkallës përkatëse të autonomisë, e cila duhet të sigurohet dhe repsektohet. Atyre duhet mundësuar, me anë të zgjedhjes së tyre të lirë vetjake, që të shprehin në mënyrë adekuate synimet e veta politike, ekonomike e kulturore në përputhje me intresat më të mirë të anëtarëve të tyre.

Këto objektiva sipas mendimit tim duhet të arrihen me fleksibilitet maksimal. Rrethanat e secilës bashkësi dhe secilit shtet janë tejet të dallueshme. Për këtë dallueshmëri duhet të shfaqet kujdes. Sipas mendimit tonë rrugëdalja gjendet në njohjen e llojeve të ndryshme të autonimive për bashkësitë e

ndryshme. Format e autonomisë lejojnë fleksibilitet të madh; shumë elemente të saj lejojnë një varg kombinimesh. Por shikuar globalisht ekzistojnë disa nivele të gjera të autonomisë, prej të cilave çdo njëri nga ata kontribuon në shtimin e shkallës së lartë atje ku ndonjë bashkësi i udhëheq punët e veta.

Por në të njëjtën kohë, për shkak të respektimit të integritetit territorial të shteteve, ne nuk propozojmë që ato nivele suksesive të autonomive duhet ta shoqërojnë njëra-tjetrën në ndonjë proces automatik ose obligativ. Përkundër kësaj, ato duhet të varen nga kërkesa e vetë bashkësisë dhe lejimi i shtetit në të cilin jeton ajo bashkësi, kështu që përparimi drejt ndonjë autonomie më të madhe në të vërtetë të bëhet ndonjë mënyrë e procesit zgjedhor.

Mirëpo, niveli i parë dhe shumë kryesor i autonomisë, sipas mendimit tonë, do të duhej t'u njihet të gjitha bashkësitë të cilat kanë shkallë të mjaftueshme të identitetit unik. Me këtë do të mbulohehin disa nevoja shumë modeste dhe themelore, siç janë mosdiskriminimi dhe liria e bashkësisë për të praktikuar dhe shfrytëzuar karakteristikat e veta unike. Në disa sfera të administratës publike, anëtarëve të bashkësisë të tilla duhet garantuar rolin përkatës, për shembull pjesëmarrjen në punët publike, bie fjala me anë të votimit të zgjedhje dhe shpalljen e kandidaturës për pozitën publike; në nivelin lokal dhe nacional duhet të ekzistojnë trupat e administratës publike të cilat do të merren me çështjet e rëndësishme për bashkësinë; bashkësia do të duhej të angazhohet në mënyrë përkatëse në marrjen e vendimeve të qeverisë që kanë të bëjnë me interesat e saj.

Rrethanat e veçanta, natyrisht, mund të vënë në dukje se ekziston nevoja për kënaqjen edhe të nevojave të shkallës së dytë. Kuptohet se kjo ndodh atëherë kur bashkësia piqet dhe e tregon gatishmërinë e vet për ta pranuar autonominë edhe në sferat tjera. Zhvillimi i tillë i ngjarjeve kërkon zgjidhje individuale dhe në shkallë procesive të decentralizimit.

Por më lejoni të përsëris se njohja e shkallës së mëtejshme të autonomisë sipas mendimit tim varet ekskluzivisht nga vendimi i vetë shtetit. Ne, vëret, parashikojmë se të gjitha niveleve të autonomisë duhet t'u paraprijnë aranzhmanet për implementimin e tyre të arritura midis shteteve dhe bashkësisë relevante.

Ne nuk themi se ekziston ndonjë reçetë e shpejtë dhe efikase për elementet që do të ndihmonin në vendosjen e niveleve suksesive të autonomisë. Sikurse që e përmenda, është qenësore që aranzhmanet të jenë fleksibile dhe kështu të ndihmojnë në rrethet ekstremisht të ndryshuara që me siguri do të vijnë. Por sa për ilustrim, më lejoni të them se stadiumin relativisht të hershëm, bashkësië duhet lejuar, me anë të përfaqësuesve të saj mbrojtës, që të disponojë mjetet që i janë ndarë asaj. Bashkësia do të duhej të japë kontributin e vet personal në ruajtjen e rendit dhe zbatimin e drejtësisë në shtet. Bashkësisë madje duhet lejuar që t'i drejtojë shkollat në territorin e vet.

Në nivelet më të larta të autonomisë, bashkësia do të duhej të kishte të drjeta të ndryshme plotësuese, siç janë ato për vendosjen e trupit lokal legjislativ e përfaqësues me kufizim të caktuar të pushtetit mbi bashkësinë. Bashkësisë gjithashtu duhet dhënë disa të drejta të caktuara lidhur me ushtrimin e funksioneve të shtetit në territorin e saj, por kuptohet se jo ato lidhur me politikën e jashtme apo mbrojtjen.

Dhe definitivisht, por sipas mendimit tonë në disa raste relativisht të rralla kur shteti pajtohet me këtë, bashkësisë duhet dhënë mëvetësinë. Shteti dhe bashkësia duhet të merren vesh për detajet e tranzicionit paqësor drejt pavarësisë. Por edhe njëra palë edhe tjetra në këtë kontekst duhet të shfaqin kujdes për faktin se sistemi i pushtetit të bashkësië duhet t'i inkuadrojë garancat për respektimin e demokracisë, si dhe obligimin e saj se do t'i respektojë standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Mirëpo, pavarësia nuk është qëllimi kryesor i iniciativës sonë; ne jemi të interesuar për format të cilat mund të quhen "vetëvendosje interne", se sa për proceset të cilat kanë për qëllim arritjen e pavarësisë.

Sikurse që theksova, zoti kryetar, këto faza suksesive të autonomisë, pas fazës së parë, do të ishin opsionale. Me këto është e dëshirueshme që ato të mbajnë garancione të caktura lidhur me pozicionin e shtetit. Sipas mendimit tim, bashkësisë duhet lejuar kaliminnë shkallën më të lartë të autonomisë nëse

tregohet se ajo i ka udhëhequr punët mirë në nivelin më të ulët të mëparshëm. Me këtë, kuptohet, se bashkësia e tillë do t'i shfrytëzonte të drejtat e veta në nivele të ndryshme të autonomisë, por vetëm në suazat e kushtetutës e të ligjit të shtetit.

Disa forma modeste dhe themelore të ndihmave duhet t'i afrohen me anë të procedurës së pavarur, në mënyrë që të sigurohet zbatimi efektiv në praktikë i këtij yrrneku të shkallëve fleksibile dhe të shkallëshkallshme të autonomisë. Ndryshe fjala është për tri komponente:

* së pari, duhet të ekzistojë trupi, përgjegjësia e të cilit do të ishte që të sigurojë implementimin e një politike të tillë, dhe i cili nëse ka nevojë, do të ishte përgjegjës për rregullimin e aspekteve financiare të punës së vet.

* së dyti, do të duhej të ekzistonte ndonjë autoritet i cili do të kishte rolin aktiv e pozitiv në operacionalizimin e aranzhmaneve të parashikuar për realizimin efikas të niveleve të ndryshme të autonomisë. Ai autoritet do të mund të ndihmonte në rastin e vështirësive, bie fjala me anë të mbështetjes ose ndërmjetësimit. Krahas tij duhet të ekzistojë edhe qendra ndërkombëtare kërkimore e këshilldhënëse e cila do të bashkëpunonte ngusht me të.

Zoti kryetar, ne besojmë fuqimisht se parimi fundamental i vetëvendosjes mund të avancohet sipas mënyrës të cilën pikërisht e parashitrova. Zhvillimi i koncepteve specifike të autonomisë do të hapte më tutje sferën në të cilën e drejta për vetëvendosje në praktikë do të zbatohet me efikasitet, pa paragjykime ndaj asaj që tanimë është arritur dhe ndaj asaj që sapo duhet të arrihet në shumë fusha tradicionale. Ne gjithashtu mësojmë se në këtë mënyrë do të evitoheshin konfliktet e mëtejshme të shkaktuara me vendosje midis bashkësisë në shtet. Ngjarjet e afërta na treguan në mënyrë tragjike se kjo çështje duhet të zgjidhet urgjentisht.

Në parashtrimin tim të parë para Asamblesë së Përgjithshme në sesionin e saj të dyzetegjashtë, kam thënë se projekti të cilin e paraqita mund të kyçet eventualisht në ndonjë konventë. Unë e kuptoj se fjala është për qëllim ambicioz, por ne besojmë se kjo është mënyrë e mundshme për realizimin e përparimit në ndonjë kohë të ardhshme, të caktuar.

DOKUMENTET
E ORGANIZATËS PËR SIGURI E
BASHKËPUNIM NË EVROPË
(Pjesë të zgjedhura)

1. AKTI FINAL I KSBE-SË NGA HELSINKU, 1975¹

Deklarata mbi parimet në të cilat udhëhiqen shtetet pjesëmarrëse në marrëdhënie reciproke.

I. BARAZIA SOVRANE, RESPEKTIMI I TË DREJTAVE QË JANË KARAKTERISTIKË E SOVRANITETIT

Shtetet pjesëmarrëse do të respektojnë mesveti barazinë sovranë dhe individualitetin, si dhe të gjitha të drejtat që janë karakteristike e sovranitetit të tyre, dhe me këtë janë përfshirë, duke e inkuadruar veçmas, të drejtën e çdo shteti për barazi juridike, tërësi tokësore, liri dhe pavarësi politike. Ato, gjithashtu, do të respektojnë të drejtën e secilit që zgjedh dhe të zhvillojnë lirisht sistemin e vet politik, shoqëror, ekonomik e kulturor, si dhe të drejtën për t'i rregulluar ligjet dhe dispozitat e veta.

Në kuadër të së drejtës ndërkombëtare, të gjitha shtetet pjesëmarrëse kanë të drejta dhe detyrime të njëjta. Ato do të respektojnë në mes veti të drejtën e secilit që sipas dëshirës së vet të caktojë dhe të mbajë marrëdhënie me vendet jera, në harmoni me të drejtën ndërkombëtare dhe frymën e kësaj Deklarate. Ato konsiderojnë se kufijtë e tyre mund të ndryshohen në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, me rrugë paqësore e me marrëveshje. Ato gjithashtu kanë të drejtë t'u takojnë ose të mos u takojnë organizatave ndërkombëtare, të marrin ose të mos marrin pjesë në kontratat dypalëshe ose shumëpalëshe, duke përfshirë edhe të drejtën për të marrë ose për të mos marrë pjesë në kontratat mbi aleancat, ato gjithashtu kanë të drejtën për neutralitet.

III. MOSCENUESHMËRIA E KUFIJVE

Shtetet pjesëmarrëse i konsiderojnë në mes veti të pacenueshëm të gjithë kufijtë e tyre si dhe kufijtë e të gjitha shteteve të Evropës, prandaj, tani dhe në të ardhmen, do të përmbahen nga çdo mësyerje ndaj atyre kufijve.

Në përputhje me këtë, ato gjithashtu do të përmbahen nga çdo kërkesë ose akt të pushtimit e të uzurpimit të pjesës ose të mbarë territorit të cilitdo shtet pjesëmarrës.

IV. TËRËSIA TOKËSORE E SHTETEVE

Shtetet pjesëmarrëse do të respektojnë tërësinë tokësore të secilit shtet pjesëmarrës.

Në përputhje me këtë, ato do të përmbahen nga çdo aksion i shpërputhshëm me objektivat dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, orientuar kundër tërësisë tokësore, pavarësisë politike ose të unitetit të cilitdo shtet pjesëmarrës, e sidomos nga çdo aksion i tillë i cili paraqet kërcënim me forcë ose përdorimin e forcës.

Shtetet pjesëmarrëse, gjithashtu, do të përmbahen nga ajo që territorin e shtetit tjetër pjesëmarrës ta bëjnë objekt të okupimit ushtarak, apo nga masat tjera të përdorimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të forcës në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, ose objekt të përvetësimit me anë të masave të tilla apo të kërcënimit me to. Asnjë pushtim apo përvetësim i tillë nuk do të pranohet si i ligjshëm.

V. MOSNDËRHYRJA NË ÇËSHTJET E BRENDSHME

Shtetet pjesëmarrëse do të përmbahen nga çdo ndërhyrje të drejtë apo të tërthortë, individualisht ose kolektivisht, në çështjet e brendshme ose të jashtme të cilat bëjnë pjesë në kompetencën nacionale të

¹ Dokumenti KEBS-1975-1995, Beograd.

shtetit tjetër pjesëmarrës, pavarësisht nga marrëdhëniet e tyre të ndërsjella.

Ato, në bazë të kësaj, do të përmbahen nga çdo formë e intervenimit ushtarak ose të kërcënimit me interveni mtë tillë kundër shtetit tjetër pjesëmarrës.

Ato, gjithashtu, në të gjitha rrethanat do të përmbahen nga çdo akt tjetër të dhunës ushtarake ose politike, ekonomike apo tjetër, të orientuar në atë që ushtrimin e të drejtave që paraqesin karakteristikë të sovranitetit të ndonjë shteti tjetër pjesëmarrës, t'ia nënshtojë interesave të veta personale dhe me këtë të sigurojë për vete çfarëdo lloji të përfitimit.

Në bazë të kësaj, ato përveç tjerash do të përmbahen nga ndihma, e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, e aktiviteteve terroriste, apo aktiviteteve subverzive e të tjera të orientuara për largimin me dhunë të regjimit të shtetit tjetër pjesëmarrës.

VI. RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE TË LIRIVE THEMELORE, DUKE PËRFSHIRË LIRINË E MENDIMIT, TË VETËDIJES, TË PREDIKIMIT FETAR DHE TË BINDJES

Shtetet pjesëmarrëse do të respektojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, duke përfshirë edhe lirinë e mendimit, të ndërgjegjës, predikimit fetar dhe bindjet për të gjithë, pa dallim race, gjinie, gjuhe dhe feje.

Ato do të avancojnë dhe do të nxisin realizimin e të drejtave dhe lirive qytetare, politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, e të tjera, të cilat rezultojnë nga dinjteti i natyrshëm i persoalitetit të njeriut dhe të cilat janë me rëndësi thelbësore për zhvillimin e tij të lirë dhe të plotë.

Në kuadër të kësaj, shtetet pjesëmarrëse do të njohin dhe do të respektojnë të drejtën e individit që të predikojë, vetëm ose në bashkësi me të tjerët, fenë ose bindjen, duke vepruar në harmoni me atë që ia thotë ndërgjegja e tij personale.

Shtetet pjesëmarrëse në territorin e të cialve ekzistojnë pakicat nacionale, do të respektojnë të drejtën e personave që u takojnë këtyre pakicave për barazi në kuadër të ligjit, do t'u ofrojnë mundësi të plotë për shfrytëzimin e vërtetë të të drejtave të njeriut e të lirive themelore dhe në këtë mënyrë do t'i mbrojnë interesat e tyre legjitime në këtë sferë.

Shtetet pjesëmarrëse e njohin rëndësinë universale të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, respektimi i të cilave është faktor thelbësor për paqen, drejtësinë dhe mirëqenien, të domosdoshme për sigurimin e zhvillimit të marrëdhënieve miqësore dhe të bashkëpunimit midis tyre si dhe midis gjithë shteteve.

Ato do t'i respektojnë vazhdimisht këto të drejta dhe liritë në marrëdhëniet e veta të ndërsjella dhe do të përpiqen bashkarisht e individualisht duke përfshirë edhe bashkëpunimin me Kombet e Bashkuara, ta avancojnë respektimin e tyre universal e efikas.

Ato e konfirmojnë të drejtën e individit që t'i njohë të drejtat dhe detyrimet e veta në këtë fushë dhe të veprojnë në harmoni me to.

Në serën e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore të shteteve pjesëmarrëse do të veprojnë në përputhje me objektivat dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe me Deklaratën Universale mbi të Drejtat e Njeriut. Ato gjithashtu do t'i përmbushin detyrimet e veta të përmbajtura në dekaltrat ndërkombëtare dhe me marrëveshjet nga kjo fushë, duke përfshirë midis tjerash edhe paktet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, nëse janë të lidhura me këto.

VII. BARAZIA DHE E DREJTA E POPUJVE PËR VETËVENDOSJE

Shtetet pjesëmarrëse do të respektojnë barazinë e popujve dhe të drejtën e tyre për vetëvendosje, duke vepruar gjithmonë në harmoni me objektivat dhe parimet e kartës së Kombeve të Bashkuara dhe të normave përkatëse të drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me integritetin

territorial të shteteve.

Në përputhje me parimet e barazisë dhe të drejtës së popujve për vetëvendosje, të gjithë popujt kanë gjithmonë të drejtën që në liri të plotë të caktojnë, kur dhe si e dëshirojnë këtë, statusin e vet të brendshëm e të jashtëm politik, pa përzierje nga jashtë, dhe që sipas dëshirës së vet të realizojnë zhvillimin e vet politik, ekonomik, shoqëror e kulturor.

Shtetet pjesëmarrëse rikonfirmojnë rëndësinë universale të respektimit dhe të realizimit të plotë të barazisë dhe të drejtës që popujt për vetëvendosje, për zhvillimin e marrëdhënieve miqësore midis tyre si dhe midis gjitha shteteve; ato gjithashtu rikujtojnë rëndësinë e eliminimit të të gjitha formave të shkeljes së këtij parimi.

2. DOKUMENT NGA Mbledhja e Dytë e Konferencës Mbi Dimensionin Njerëzor të KSBE-SË, KONPENHAG (1990)

Shtetet pjesëmarrëse janë të vetëdijshme se çështjet që kanë të bëjnë me pakicat kombëtare mund të zgjidhen kënaqshëm vetëm në suazën politike demokratike të mbështetur në sundimin e ligjshmërisë bashkë me funksionimin e gjyqësisë së pavarur. Kjo suazë garanton respektimin e plotë të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore; të drejtat që njëjtësohen me pozitën e të gjithë qytetarëve, garanton lirinë e të shprehurit të të gjitha interesave dhe synimeve të tyre legjitime, pluralizmin politik dhe tolerancën shoqërore si dhe zbatimin e akteve juridike me të cilat vendosen kufizime efikase kundër këqpërdorimit të pushtetit.

Ato gjithashtu janë të vetëdijshme për rolin e rëndësishëm të organizatave joqeveritare duke përfshirë partitë politike, sindikatat, organizatat për të drejtat e njeriut e grupet fetare në avancimin e tolerancës dallimeve kulturore dhe zgjidhjen e çështjeve që kanë të bëjnë me pakicat kombëtare.

Ato konfirmojnë edhe më tutje se respektimi i të drejtave të pjesëtarëve të pakicave kombëtare, si pjesë e të drejtave të gjithpranueshme njerëzore, është faktor thelbësor i paqes, drejtësisë, stabilitetit dhe i demokracisë në shtetet pjesëmarrëse.

(31) Pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtë që plotësisht dhe me efikasitet të realizojnë të drejtat e veta njerëzore dhe liritë elementare pa kurrfarë diskriminimi dhe me barazi të plotë pra ligjit.

Shtetet pjesëmarrëse do të miratojnë, atje ku ndihet nevoja, masa të veçanta për sigurimin e barazisë së plotë për pjesëtarët e pakicave kombëtare me qytetarët e tjerë në realizimin dhe gëzimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive elementare.

(32) Përkatësia e pakicës kombëtare është çështje e deklaramit të individit dhe deklarimi i tillë nuk mund të sjellë kurrfarë problemesh.

Pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtën e shprehjes së lirë ruajtjes dhe të zhvillimit të identitetit të vet etnik, kulturor, gjuhësor apo të atij fetar dhe të kultivimit e të zhvillimit të kulturës e asimilimit kundër vullnetit të tyre.

Posaçërisht kanë të drejtë:

(32.1) - që lirisht ta përdorin gjuhën e tyre amëtare privatisht dhe publikisht;

(32.2) - që t'i themelojnë dhe ruajnë, në përputhje me ligjmërinë kombëtare institucionet e veta arsimore, kulturore dhe fetare, organizatat dhe shoqatat të cilat mund të kërkojnë kontribute vullnetare financiare e tjera si dhe ndihmën e opinionit në përputhje me pakicat kombëtare;

(32.3) - ta predikojnë besimin e tyre dhe të kryejnë ceremonitë fetare duke përfshirë fitimin, posedimin dhe përdorimin e materialit fetar dhe të ushtrimit të aktiviteteve arsimore fetare në gjuhën amëtare;

(32.4) - të vendosin dhe mbajnë kontakte të papengueshme reciproke në vendin e tyre si dhe kontakte jashtë kufijve me qytetarët e shteteve tjera me të cilët kanë prejardhje të përbashkët etnike apo kombëtare trashëgimi kulturor ose bindja fetare.

(32.5) - të përhapin marrin dhe këmbëjnë informat në gjuhën e vet amëtare;

(32.6) - të themelojnë dhe mbajnë organizata apo shoqata në vendin e tyre dhe të marrin pjesë në organizatat ndërkombëtare joqeveritare.

Pjesëtarët e pakicave kombëtare mund t'i realizojnë dhe gëzojnë të drejta e tyre në mënyrë individuale si dhe në bashkësi me pjesëtarët tjerë të grupit të vet. Personi që i takon pakicës kombëtare nuk mund të ketë kurrfarë problemesh për shkak të realizimit apo mosrealizimit të cilësdo nga këto të drejta.

(33) Shtetet pjesëmarrëse do të mbrojnë identitetin etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të pakicës kombëtare në territorin e vet dhe do të krijojnë kushte për avancimin e këtij identiteti.

Do të marrin masa të domosdoshme në këtë kuptim pas konsultimeve përkatëse duke përfshirë kontaktet me organizatat apo shoqatat e këtyre pakicave në përputhje me procedurat e vendosjes në secilin shtet.

Të gjitha masat e tilla do të janë në përputhje me parimet e barazisë dhe të mosdiskriminimit të qytetarëve të shtetit përkatës pjesëmarrës.

(34) Shtetet pjesëmarrëse do të përpiqen të sigurojnë që pjesëtarët e pakicave kombëtare, pavarësisht nga nevoja që ta mësojnë gjuhën zyrtare apo gjuhën e shtetit përkatës të kanë mundësi adekuate për mësimin gjuhën amëtare, apo në gjuhën amëtare si dhe ku ekziston mundësia e ndihet nevoja, për përdorimin e kësaj gjuhe para organeve publike në përputhje me ligjmërinë përkatëse nacionale.

Në kontekst të mësimin të historisë dhe kulturës në institucionet arsimore, do të merret parasysh edhe historia e kultura e pakicave kombëtare.

(35) Shtet pjesëmarrëse do të respektojnë të drejtën e pakicave kombëtare që vërtet të marrin pjesë në jetën publike, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen në punët që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe përparimin e identitetit të pakicave të tilla.

Shtetet pjesëmarrëse konstatojnë përpjekjet për mbrojtjen dhe krijimin e kushteve për përparimin e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor e fetar të organeve përkatëse administrative lokale ose autonome të cilat u përgjigjen kushteve konkrete historike e territoriale të atyre pakicave dhe që janë në përputhje me politikën e shtetit gjegjë, si një nga format e mundshme për realizimin e këtyre objektivave.

(36) Shtetet pjesëmarrëse janë të vetëdijshme për rëndësinë e veçantë të bashkëpunimit sa më të madh reciprok konstruktiv lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me pakicat kombëtare. Bashkëpunimi i tillë është i orientuar drejt avancimit të mirëkuptimit dhe të mirësjellë, drejt marrëdhënieve miqësore dhe të fqinjësisë së mirë, drejt paqes ndërkombëtare, sigurisë dhe drejtësisë.

Secili shtet pjesëmarrës do të avancojë atmosferën e respektimit reciprok, të mirëkuptimit, bashkëpunimit dhe të solidaritetit midis të gjithë personave që jetojnë në territorin e tij, pavarësisht nga përkatësia etnike apo kombëtare ose besimi fetar, dhe do të nxisë zgjidhjen e problemeve me anë të dialogut të mbështetur mbi parimet e ligjit.

(37) Asnjë nga këto detyrime nuk mund të interpretohet në atë mënyrë që nënkuptojnë të drejtën e marrjes me çfarëdo aktiviteti apo me çdo sjellje që do të ishte në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara si dhe me detyrimet tjera në bazë të së drejtës ndërkombëtare apo të dispozitave të aktit final, duke përfshirë edhe parimin e tërësisë tokësore të shtetit.

(38) Shtetet anëtare në përpjekjet e veta për të mbrojtur dhe përparuar të drejtat e pjesëtarëve të pakicave kombëtare do të respektojnë në tërësi detyrimet e veta nga konventat ekzistuese mbi të drejtat e njeriut dhe instrumentet tjera përkatëse ndërkombëtare dhe do të shqyrtojnë mundësinë e bashkëpunimit konventave gjegjëse nëse këtë ende nuk e kanë bërë duke përfshirë ato me të cilat sigurohet e drejta për ankesa nga ana e individëve.

(39) Shtetet pjesëmarrëse do të bashkëpunojnë ngusht në organizatat kompetente ndërkombëtare do të bashkëpunojnë ngusht në organizatat kompetente ndërkombëtare të cilave u takojnë duke përfshirë Kombet e Bashkuara dhe, sipas nevojës, Këshillin e Evropës duke pasur parasysh punën që është në zhvillimin e sipër lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me pakicat kombëtare.

Ato do të shqyrtojnë thirrjen e mbledhjeve të ekspertëve për shqyrtimin e hollësishëm të çështjeve të pakicave kombëtare.

(40) Shtetet pjesëmarrëse dënojnë qartë dhe pamedyshje totalitarizmin, urrejtjen racore, e etnike, antisemitizmin, ksenofobinë dhe diskriminimin kundër cilitdo person, si dhe ndjekjet mbi baza fetare e ideologjike. Në këtë kontekst pranohen problemet e veçanta të romëve.

Ato deklarojnë objektimin e tyre të vendosur për të shtuar përpjekjet në luftë kundër këtyre dukurive në të gjitha format e veta prada do të:

(40.1) - marrin masa efikase, në përputhje me sistemet e veta kushtetuese dhe detyrimet ndërkombtare përfshirë edhe miratimin e ligjeve të atilla që mund të jenë të domosdoshëm për sigurimin e mbrojtjes nga të gjitha veprat eventuale me të cilat nxitet dhuna kundër personave apo grupeve e mbështetur në diskriminimin kombëtar, racor, etnik dhe fetar, në armiqësi ose urrejtje duke përfshirë antisemitizmin;

(40.2) - do t'i përkushtohen marrjes së masave të përshtatshme eadekuate për mbrojtjen e personave apo grupeve të cilët mund t'u ekspozohen kërcënimeve apo akteve të diskriminimit, armiqësive ose dhunës për shkak të identitetit racor, etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar si dhe për mbrojtjen e pasurive së tyre;

(40.3) - marrin masa efikase në harmoni me sistemet e veta kushtetuese në nivelin kombëtar, rajonal e lokal, me qëllim të avancimit të mirëkuptimit dhe të tolerancës, veçmas në fushën e arsimit, kulturës dhe informimit;

(40.4) përpiqen të sigurojnë që në kuadër të objektivave të arsimit kujdes i veçantë t'i kushtohet problemit të paragjyqimeve racore, urrejtjes dhe zhvillimit të respektimit të civilizimeve e kulturave të ndryshme;

(40.5) - njohin të drejtën e individit për ankesa efikase dhe do të orvaten të pranojnë në përputhje me ligjshmërinë nacionale të drejtën e personave dhe grupeve të interesuara që të paraqesin dhe argumentojnë akuzat kundër veprave të diskriminimit, përfshirë edhe veprat raciste e ksenofobike;

(40.6) - shqyrtojnë mundësinë e bashkangjites në kuadër të instrumenteve ndërkombtare që kanë të bëjnë me problemet e diskriminimit, nëse këtë nuk e kanë bërë ende për të siguruar respektimin e plotë të detyrimeve të përmbajtura në to, duke përfshirë edhe ato mbi paraqitjen e raporteve periodike;

(40.7) - shqyrtojnë gjithashtu mundësinë e pranimin të atyre mekanizmave ndërkombtare me të cilat u mundësohet shteteve e individëve që para qarqeve ndërkombtare të paraqesin kumtesat që kanë të bëjnë me diskriminimin.

3. KARTA E PARISIT PËR EVROPËN E RE SAMITI I KSBE-SË PREJ 19-21 NËNTOR 1990 TË DREJTAT E NJERIUT, DEMOKRACIA DHE SHTETI LIGJOR

Detyrohem se do ta ndërtojme forcojmë dhe konfirmojmë demokracinë si sistem të vetëm të sundimit të popujve tanë. Për këtë qëllim detyrohem më sa vijon:

Të drejta e njeriut dhe liritë themelore janë karakteristike për të gjithë qenjet njerëzore, të patjetërsueshme dhe të garantuara me ligj. Është detyrë kryesore e qeverive që ato t'i mbrojnë dhe avancojnë. Respektimi dhe ushtrimi i tyre i plotë bëjnë themelin e ligjit, të drejtësisë dhe të paqes.

Pushteti demokratik bazohet në vullnetin e popullit të shprehur në distancat e rregullta kohore me anë të zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. Demokracia mbështetet në respektimin e personalitetit të njeriut dhe të shtetit ligjor. Ajo është garant më i mirë i lirisë së shprehjes dukurimit ndaj të gjitha grupeve shoqërore dhe të mundësive të njejta për të gjithë.

Karakterit reprezentativ dhe pluralist i demokracisë nënkupton përgjegjësinë ndaj zgjedhësve detyrimin e autoriteteve publike që ta respektojnë ligjin dhe ushtrimin e pranueshëm të drejtësisë. Askush nuk është mbi ligjin.

Përcaktojmë se çdo individ pa diskriminim, ka të drejtë për:

*lirinë e mendimit, ndërgjegjes, fesë dhe bindjes.

*lirinë e të shprehurit,

*lirinë e bashkimit dhe të takimit paqësor,

*lirinë e qarkullimit,

*se askush nuk mund t'i nënshtrohet

*burgosjes ose arrestimi të paarsyeshëm,

*mundimit, si dhe çdo sjelljes tjetër të vrazhdë jonjerëzore dhe përbuzës e se secili, përveç kësaj,

ka të drejtë

*të njohë dhe t'i shfrytëzojë të drejtat e veta,

*të marrë pjesë në zgjedhjet e lira dhe të ndershme,

*të gjykohet drejtë dhe publikisht nëse është akuzuar për ndonjë krim,

*të posedojë të mira vetë ose në shoqëri dhe të drejtojë ndërmarjet e caktuara,

*të gëzojë të drejta ekonomike, sociale e kulturore që i takojnë.

Në konfirmojmë se do të mbrohet identiteti etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar i pakicave nacionale dhe se personat që u takojnë atyre pakicave kanë të drejtë të shprehin ruajnë dhe zhvillojnë këtë identitet pa kurrfarë diskriminimi dhe në barazi të plotë para ligjit.

Do të kujdesemi që secili të ketë të drejtë efikative për ankesë kundër çdo shkelje të këtyre të drejtave në suazat nacionale ose ndërkombëtare.

Respektimi i plotë i këtyre parimeve e bën bazën mbi të cilën do të përpiqemi ta ndërtojme Evropën e re.

Shtetet tona do të bashkëpunojnë dhe do të ndihmohen reciprokisht për ruajtjen e qëndrueshme të këtyre të arriturave demokratike.

Marëdhëniet miqësore midis shteteve pjesëmarrëse

(...) Në momentin kur po përfundon ndarja e Evropës ne do të përpiqemi tu japim cilësi të re marëdhënieve tona në fushën e sigurisë duke respektuar lirinë e zgjedhjes të secilit lidhur me këtë. Siguria është e pandashme dhe siguria e çdo shteti pjesëmarrës është pandashëm e lidhur me sigurinë e të gjithë të tjerëve. Prandaj zotohem se do të bashkëpunojmë për forcimin e mirëbesimit dhe të sigurisë

midis veti dhe për kufizimin e mëtejshëm të armatimit e për qarmatim.

E përshëndesim deklaratën e përbashkët të njëzet e dy shteteve për përmirësimin e marrëdhënieve të ndërsjella.

Marrëdhëniet tona do të mbështeten në pranimin tonë të përbashkët të vlerave demokratike të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore. Ne jemi të bindur se avancimi i demokracisë si dhe respektimi dhe ushtrimi i vërtetë i të drejtave të njeriut, janë të domosdoshme për forcimin e paqes e të sigurisë midis shteteve tona. Ne rikonfirmojmë barazinë e të drejtave të popujve dhe të drejtën e tyre për vetëvendosje në harmoni me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe me normat përkatëse të së drejtës ndërkombëtare në atë fushë, duke përfshirë edhe ato dokumente që kanë të bëjnë me moscenueshmërinë e territoreve të shteteve.

Ne jemi të vendosur për t'i shtuar konsultimet politike dhe ta shtrijmë bashkëpunimin për zgjidhjen e problemeve ekonomike, sociale, ekologjike kulturore dhe humanitare. Kjo vendosmëri e përbashkët dhe varshmëria jonë reciproke gjithnjë e më e madhe do të na ndihmojë për ta përballuar mosbesimin që është grumbulluar me dekada, për ta shtuar stabilitetin dhe ta ndërtojmë Evropën e bashkuar.

Ne duam që Evropa të bëhet burim i paqes, e hapur për dialog e bashkëpunim me vendet tjera, e disponuar për këmbim dhe e përkushtuar për kërkimin e përgjigjeve të përbashkëta në provokimin e ardhmërisë. (...)

Dimensionin njerëzor

(...) Deklarojmë se respektimi i të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore nga ne është i parevokueshëm. Do t'i aplikojmë dhe zhvillojmë në tërësi dispozitat e KSBE-së që kanë të bëjnë me dimensionet njerëzore.

Duke u mbështetur në Dokumentin e mbledhjes së Konferencës mbi Dimensionet Njerëzore në Kopenhagë, ne do të bashkëpunojmë për forcimin e institucioneve demokratike dhe për aplikimin më të mirë të parimeve të shtetit ligjor. Për këtë qëllim kemi vendosur të konvokojmë seminarin e ekspertëve për këtë çështje në Oslo prej 4 deri më 15 nëntor të vitit 1991.

Të vendosur për të mbështetur kontributin e vlefshëm të pakicave kombëtare në jetën e shoqërive tona zotohemi se edhe më tutje do të përmirësojmë pozitën e tyre. Rikonfirmojmë bindjen tonë të thellë se marrëdhëniet miqësore midis popujve tanë si dhe paqja, drejtësia, stabiliteti e demokracia kërkojnë që të mbrohet identiteti etnik, kulturor, gjuhësor e fetar i pakicave kombëtare dhe që të krijohen kushte më të volitshme për ruajtjen e këtij identiteti. Deklarojmë se çështjet rreth pakicave kombëtare mund të zgjidhen në mënyrë të volitshme në suazat politike demokratike.

Konstatojmë, përpos kësaj, se të drejtat e personave që u takojnë pakicave kombëtare duhet të respektohen në tërësi si pjesë e të drejtave të përgjithshme të njeriut. Të vetëdijshëm për nevojën dhe urgjencën e shtimit të bashkëpunimit lidhur me pakicat kombëtare si dhe për përmirësimin e pozitës së tyre, vendosim për të konvokuar mbledhjen e ekspertëve për këto çështje e cila do të mbahet në Gjenevë prej 1 deri më 19 korrik të vitit 1991.

Shprehim vendosmërinë tonë që të luftojmë kundër të gjitha formave të ksenofobisë dhe diskriminimit ndaj çdo kujt, si dhe kundër ndjekjeve për shkaqe fetare ose ideologjike.

Në përputhje me zotimet tona në kuadër të KSBE-së theksojmë se liria e lëvizjes dhe e kontakteve midis qytetarëve tanë si dhe qarkullimi i lirë i informacioneve dhe ideve janë të qenësishme për qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e shoqërive të lira dhe të kulturave në lulëzim. E përshëndesim përparimin e turizmit dhe vizitat midis vendeve tona.

Mekanizmi për dimensionin njerëzor u dëshmuar në praktikë prandaj jemi të vendosur që ta zhvillojmë duke përfshirë edhe procedura të reja midis tyre dhe shërbime të ekspertëve apo të ndonjë kolegji të personalitetëve të shquara të cilët kanë përvojë lidhur me çështjet e të drejtave të njeriut të

cilat mund të paraqiten në kuadër të këtij mekanizmi. Në kuadër të mekanizmit do të shfaqim kujdes që individët të jenë të pranishëm kur është fjala për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Prandaj, zotohemi se do të zgjerojmë edhe më shumë detyrimet tona në këtë aspekt, veçmas në takimin e Konferencës mbi Dimensionin Njerëzor në Moskë, duke mos sjellur, ndërkaq, në pikëpyetje detyrimet nga instrumentat ekzistuese ndërkombëtare të cilat ndoshta i posedojnë disa shtete tona.

E njohim kontributin e rëndësishëm të Këshillit të Evropës, për avancimin e të drejtave të njeriut, të parimeve të demokracisë e të shtetit ligjor, si dhe për zhvillimin e bashkëpunimit kulturor. Përshëndesim interesimin e treguar të shumë shteteve pjesëmarrëse për të hyrë në Këshillin e Evropës dhe në Konventën e tij mbi të Drejtat e Njeriut. Përshëndesim faktin që Këshilli i Evropës është i gatshëm ta vë përvojën e vet në shërbim të KSBE-së.

Siguria

(...) Ndonëse rreziku nga konfliktet në Evropë është pakësuar, stabilitetin e shoqërive tona po e rrezikojnë rreziqe tjera. Jemi të vendosur që të bashkëpunojmë për mbrojtjen e institucioneve demokratike nga veprimet me të cilat konfirmohet pavarësia, njëjtësia sovrane ose tërësia tokësore e shteteve pjesëmarrëse. Parasëgjithash vepohet kundër veprimeve ilegale siç janë dhuna, zubverzionet ose presionet e faktorëve të jashtëm.

Dënojmë pazezërë si kriminele të gjitha veprat terroriste, metodat e praktikën dhe shprehim vendosmërinë tonë që të punojmë drejtë çrrënjësjes së terrorizmit, si në bashkëpunimin bilateral ashtu edhe në atë multilateral. Gjithashtu do t'i bashkojmë forcat tona në luftë kundër tregimit menarkotikë.

Të vetëdijshëm se zgjidhja paqësore e kontesteve është plotësisht i qenësishëm i detyrave të të gjitha shteteve që të përmbahen nga përdorimi i kërcënimit ose i dhunës dhe se të dyja janë elemente të qenësishme të ruajtjes dhe konsolidimit të paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare, ne jo vetëm që do të kërkojmë masa efikase për pengimin me mjete politike të konflikteve të cilat do ta kërcënonin të shpërthejnë, veçse, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, do të përcaktojmë mekanizma përkatëse për zgjidhje paqësore të çdo konflikti i cili mund të shpërthejë. Prandaj, zotohemi se do të kërkojmë forma të reja të bashkëpunimit në këtë fushë, veçmas shkallën e metodave që do të mund të aplikohen për zgjidhjen paqësore të konflikteve, duke përfshirë edhe ndërhyrjen e detyrueshme të një pale të tretë.

(...)

4. RAPORTI NGA MBLEDHJA E KSBE-SË MBI PAKICAT KOMBËTARE (GJENEVË - 1991)¹

II

(...) Shtetet pjesëmarrëse e theksojnë rëndësinë e qëndrueshme të përcjelljes së themeltë të zbatimit të detyrimeve të veta në kuadër të KSBE-së që kanë të bëjnë me pjesëtarët e pakicave kombëtare.

Ata theksojnë se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore paraqesin bazën për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të pjesëtarëve të pakicave kombëtare. Ato gjithashtu janë të vetëdijshme se çështjet që kanë të bëjnë me pakicat kombëtare, mund të zgjidhen në mënyrë të kënaqshme vetëm në suazat demokratike politike, në bazë të sundimit të drejtësisë dhe me funksionimin e gjyqësisë së pavarur. Këto suaza garantojnë respektimin e plotë të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore; të drejtat e statusit të barabartë për të gjithë qytetarët, duke përfshirë pjesëtarët e pakicave kombëtare, deklarimin e lirë të të gjithë interesave dhe aspiratave të tyre legjitime, pluralizmin politik, tolerancën sociale dhe zbatimin e normave juridike të cilat e kufizojnë efektshëm keqpërdorimin e pushtetit shtetëror.

Çështjet e pakicave kombëtare si dhe respektimi i detyrimeve dhe deklarimeve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e pjesëtarëve të tyre janë çështje të interesit legjitim ndërkombëtar, prandaj edhe nuk janë ekskluzivisht çështje e brendshme e shtetit respektiv.

Ato konstatojnë se të gjitha dallimet etnike, kulturore, gjuhësore ose fetare nuk është e thënë që me doemos të kushtëzojnë krijimin e pakicave kombëtare.

III

Duke respektuar të drejtën e pjesëtarëve të pakicave kombëtare për pjesëmarrje efikase në punët publike, shtetet pjesëmarrëse konsiderojnë se kur diskutohet për problemet e pakicave kombëtare në vendet e tyre ato duhet të kenë rastin e vërtetë për pjesëmarrje në këtë në harmoni me procedurën e vendosjes në secilin shtet. Ato konsiderojnë më tej, se pjesëmarrje adekuate demokratike e pjesëtarëve të pakicave kombëtare ose të përfaqësuesve të tyre në vendosjen në grupet konsultative, paraqet element të rëndësishëm të pjesëmarrjes efikase në punët publike.

Ato konsiderojnë se duhet bërë përpjekje të veçanta për zgjidhjen e problemeve konkrete në mënyrë konstruktive dhe me dialog - me anë të negociatave e konsultimeve me qëllim të përmirësimit të të pozitës së pjesëtarëve të pakicave kombëtare. Ato janë të vetëdijshme se avancimi i dialogut midis shteteve dhe, ndërmjet shteteve e pjesëtarëve të pakicave kombëtare, do të jetë më i suksesshëm atje ku ekziston qarkullimi i lirë i informacioneve dhe i ideve midis të gjitha palëve. Ato nxisin përpjekje njëpalëshe, dypalëshe e shumëpalëshe të qeverive për t'u shqyrtuar rrugët për avancimin e efektivitetit në zbatimin e detyrimeve në kuadër të KSBE-së të cilat kanë të bëjnë me pakicat kombëtare.

Shtetet pjesëmarrëse konsiderojnë se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore duhet të respektohen mbi baza të mosdiskriminimit në mbarë shoqërinë. Në rajonet të cilat kryesisht janë të banuara me pjesëtarë të pakicave kombëtare, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të pjesëtarëve të asaj pakice të pjesëtarëve të popullatës shumicë të shtetit respektiv dhe të pjesëtarëve të pakicave të tjera nacionale që banojnë në ato rajone, do të respektohen njësoj.

Ato konfirmojnë se pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtë që të shprehen, ta ruajnë e zhvillojnë lirisht identitetin e vet etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar dhe të kultivojnë e zhvillojnë kulturën e vet në të gjitha aspektet e saj, pa kurrfarë orvatjesh të asimilimit kundër vullnetit të tyre.

¹ Dokumenti KEBS 1975-1995, Beograd, 1995.

Ato do t'u mundësojnë organeve kompetente që ta njoftojnë zyrën për zgjedhje të lira për të gjitha zgjedhjet e përgjithshme të planifikuara në territoret e tyre, duke përfshirë ato të nivelit më të ulët nga ai nacional. Shtetet pjesëtare me dashamirësi do të shqyrojnë, në kufij të ligjit, praninë e vëzhguesve në zgjedhjet që nuk janë nacionale, duke i përfshirë edhe në rajonet e banuara me pakica kombëtare, dhe do të përpiqen që ta lehtësojnë ardhjen e tyre.

IV

Shtetet pjesëmarrëse do të krijojnë kushte që pjesëtarët e pakicave nacionale të kenë mundësi të njëjta për pjesëmarrje efikase në jetën publike, në aktivitetet ekonomike dhe në ndërtimin e shoqërisë.

Në harmoni me pikën 31. të Dokumentit të Kopenhagës, shtetet pjesëmarrëse do të ndërmarrin masa të nevojshme me qëllim të pengimit të diskriminimit të individëve, veçmas lidhur me punësimin, banimin e arsimimin, mbi baza të përkatësisë dhe mospërkatësisë të pakicës kombëtare. Në këtë kontekst, ato do të parashikojnë, nëse këtë nuk e kanë bërë këshillë efikase juridike për individët që janë diskriminuar në baza të përkatësisë ose mospërkatësisë të pakicës nacionale, duke përfshirë vënien në dispozicion të spektrit të gjerë të këshillave efikase administrative e gjyqësore për viktimat e caktuara të diskriminimit.

Shtetet pjesëmarrëse janë të bindura se ruajtja e vlerave të trashëgimisë kulturore të pakicave kombëtare, kërkon pjesëmarrjen e pjesëtarëve të atyre pakicave, dhe se toleranca e respektimi i kulturave të ndryshme janë me rëndësi esenciale në këtë aspekt. Në harmoni me këtë ato konfirmojnë rëndësinë e përbajtjes nga pengimi i krijimit të të mirave kulturore që u përkasin pakicave kombëtare, duke përfshirë edhe ato që i krijojnë pjesëtarët e tyre.

Shtetet pjesëmarrëse konfirmojnë se pjesëtarët e pakicës kombëtare do t'i gëzojnë të drejtat e njëjta dhe do të kenë detyrime të njëjta qytetare si edhe popullata tjetër.

Shtetet pjesëmarrëse rikonfirmojnë rëndësinë e miratimit, ku kjo është e nevojshme, të masave të veçanta në mënyrë që pjesëtarëve të pakicave t'u sigurohet barazia e plotë me qytetarët e tjerë në realizimin dhe gëzimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore. Ato më tej rikujtojnë nevojën e marrjes së masave të nevojshme me qëllim të mbrojtjes së identitetit etnik, kulturor, gjuhësor e fetar të pakicave nacionale në territorin e vet dhe të krijimit të kushteve për avancimin e këtij identiteti; masat e tilla do të jenë në përputhje me principet e barazisë dhe të mosdiskriminimit në raport me qytetarët tjerë të shtetit përkatës pjesëmarrës.

Ato konfirmojnë se masat e tilla, të cilat, midis tjerash, marrin parasysh prejardhjen historike e territoriale të pakicave nacionale, janë veçanërisht të rëndësishme në viset ku vendosen institucionet demokratike, për çështjet e pakicave nacionale shfaqet kujdes i posaçëm.

Të vetëdijshme për sistemet e ndryshme dhe heterogjene kushtetuese midis tyre, për çka asnjë qasje individuale nuk është e domosdoshme të jetë i gjithëpranueshëm, shtetet pjesëmarrëse konstatojnë me interesim se disa nga ato kanë arritur rezultate pozitive, në mënyrën adekuate demokratike, midis tjerash me anë të:

- * grupeve këshilldhënëse dhe grupeve në të cilat merren vendimet ku janë të përfaqësuara pakicat, veçmas lidhur me arsimin, kulturën dhe fenë,
- * grupeve të zgjedhura dhe të kuvendeve çër çështjet e pakicave nacionale,
- * administratës lokale e autonome, si dhe të autonomisë mbi baza territoriale, duke përfshirë ekzistimin e grupeve konsultative, legjislativë e ekzekutive të zgjedhur me anë të zgjedhjeve të lira e periodike,
- * vetëqeverisjes së pakicës kombëtare lidhur me çështjet që i përkasin identitetit të saj në situatat kur autonomia mbi baza territoriale është e papranueshme,
- * të formave të decentralizuara ose lokale të pushtetit,

* marrëveshjeve bilaterale e multilaterale dhe të aranzhmaneve të tjera lidhur me pakicë nacionale,

* të sigurimit për anëtarët e pakicave nacionale lloje dhe nivele adkuate të arsimimit në gjuhën amtare, me respekt meritore të numrit dhe shpërndarjes gjeografike të traditave kulturore të pakicave nacionale,

* të financimit të mësimin në gjuhët e pakicave nga ana e popullatës tjetër, si dhe të përfshirjes së gjuhëve të pakicave në endet për shkollimin e kuadrit arsimor, veçmas në viset e banuara me pakicat nacionale,

* në rastet ku mësimi nga lënda e caktuar në territorin e tyre nuk është siguruar në gjuhën e pakicës në të gjitha nivelet, lypsen masa të domosdoshme për gjetjen e mnyrës për njohjen e diplomave të lejuara në botën e jashtme për studimet e kryera në atë gjuhë,

* të themelimit të agjencive kërkimore qeveritare për shqyrtimin e legjislacionit dhe për distribuimin e informacioneve që kanë të bëjnë me të drejtat e barabarta dhe me mosdiskriminimin,

* të sigurimit të ndihmës financiare e teknike për pjesëtarët e pakicave nacionale të cilët dëshirojnë ta realizojnë të drejtën e vet për formimin dhe drejtimin e enteve të veta arsimore, kulturore e fetare, të organizatave e të shoqatave,

* të ndihmës qeveritare për zgjidhjen e vështirësive lokale lidhur me praktikën diskriminuese (p.sh. servisi për marrëdhënie midis qytetarëve),

* të nxitjes së përpjekjeve të bashkësive lokale për vendosjen e marrëdhënieve elementare midis bashkësive të pakicave, midis bashkësive të shumicës e të pakicës dhe midis vendeve fqinje të cilat kanë kufij të përbashkët, me qëllim që të kontribuohet në pengimin e krijimit të tendosjes lokale në zgjidhjen e konflikteve me rrugë paqësore në rast se deri tek ai vihet, dhe

* të nxitjes së formimit të komisioneve të përhershme të përziera, ndërshtetërore ose rajonale, me qëllim të lehtësimit të dialogut të qëndrueshëm midis rajoneve të interesuara kufitare.

Shtetet pjesëmarrëse kosdierojnë se këto apo qasjet tjera individualsisht ose në kombinim, mund të jenë ndihmesë për përmirësimin e gjendjes së pakicave nacionale në territoret e tyre.

V

Shtetet pjesëmarrëse respektojnë të drejtën e pjesëtarëve të pakicave kombëtare që të realizojnë dhe shfrytëzojnë të drejtën pavarësisht ose në bashkësi me të tjerët, për të themeluar dhe udhëhequr organizata dhe shoqata në kuadër të vendit të vet dhe të marrin pjesë në organizatat ndërkombëtare joqeveritare.

Shtetet pjesëmarrëse konfirmojnë, dhe nuk do të rëndojnë realizimin e të drejtave të pjesëtarëve të pakicave nacionale, që i themelojnë dhe i udhëheqin entet e veta arsimore, kulturore e fetare, organizatat e shoqatat.

Lidhur me këtë, ato janë të vetëdijshme për rolin e rëndësishëm e vital të cilin e kanë individët, organizatat joqeveritare dhe grupet fetare e tjera, në nxitjen e mirëkuptimit midis kulturave të ndryshme he për përmirësimin e marrëdhënieve në të gjitha nivelet e shoqërisë si dhe përtej kufijve ndërkombëtar.

Ato konsiderojnë se vëzhgimet nga dora e parë dhe përvojat e organizatave, grupeve dhe individëve të tillë mund të jenë me vlerë të madhe për avancimin e realizimit të detyrimeve në kuadër të KSBE-së që kanë të bëjnë me pjesëtarët e pakicave nacionale. Prandaj, ato do të nxisin dhe nuk do të rëndojnë punën e organizatave, grupeve e individëve të tilla dhe e përshëndesin kontributin e tyre në këtë fushë.

VI

Shtetet pjesëmarrëse, të brengosura për shkak të shtrirjes së akteve të urrejtjes racore, e etnike e fetare, të antisemitizmit, ksenofobisë dhe diskriminimit, e theksojnë vendosmërinë e vet që të dënojnë përgjithmonë aktet e tilla kundër çdo kujt.

Në këtë kontekst, ato konfirmojnë njohjen e problemeve të posaçme të romëve. Ato janë të gatshme të marrin masa efektive me qëllim të ofrimit të mundësive plotësisht të njëjta romëve të cilët qëndrojnë rregullisht në shtetin e tyre si edhe popullatës tjetër. Gjithashtu do të nxisin kërkimet dhe studimet lidhur me romët dhe me problemet e veçanta me të cilët ballafaqohen ata.

Ato do të marrin masa efektive për avancimin e tolerancës, mirëkuptimit, të mundësive të njëjta dhe të marrëdhënieve të mira midis individëve të prejardhjeve të ndryshme në kuadër të vendit të tyre.

Përveç kësaj, shtetet pjesëmarrëse do të marrin masa efektive duke përfshirë miratimin e ligjeve me të cilat ndalohen aktet që nënkuptojnë provokimin e dhunës të mbështetur në diskriminim nacional, racor, etnik ose fetar, armiqësinë ose urrejtjen përfshirë antisemitizmin si dhe masat për aplikimin e këtyre ligjeve, nëse këtë nuk e kanë bërë deri më tash në harmoni me ligjin e vet kushtetues dhe me detyrimet ndërkombëtare.

Krahas kësaj, me qëllim të arritjes së nivelit më të lartë të vetëdijes publike për paragjykimet dhe urrejtjen, të përmirësimit të zbatimit të ligjit kundër veprave penale të kryera nga urrejtja dhe të avancimit, në mënyrë tjetër, të përpjekjeve për zgjedhjen e problemit të urrejtjes e të paragjyqimeve në shoqëri, ato do të bëjnë përpjekje për grumbullimin, shpalljen e rregullt dhe publikimit të të dhënave mbi veprat penale në territoret e veta që janë mbështetur në paragjykimet racore, etnike e fetare, duke përfshirë direktivat të cilat shfrytëzohen për grumbullimin e të dhënave të tilla. Këto të dhëna nuk do të duhej të mbanin kurrfarë shënimesh personale.

Ato do të konsultohen dhe do t'i këmbëjnë pikëpamjet e informatat në nivelin ndërkombëtar, duke përfshirë edhe takimet e ardhshme të KSBE-së mbi veprat penale të cilat paraqesin dëshmi mbi paragjykimet dhe urrejtjen.

VII

Të bindura se për mbrojtjen e të drejtave të pjesëtarëve të pakicave kombëtare është i domosdoshëm qarkullimi i lirë i informacioneve dhe këmbimi i ideve, shtetet pjesëmarrëse theksojnë rëndësinë e komunikimit midis pjesëtarëve të pakicave kombëtare pa ndërhyrjen e organeve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Realizimi i të drejtave të tilla mund t'u nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve të cilat janë parashikuar me ligj dhe janë në harmoni me standardet ndërkombëtare. Ato konfirmojnë se asnjë pjesëtarë i pakicës nacionale, vetëm për shkak që i takon asaj pakice nacionale, nuk do t'i nënshtrohet sanksioneve penale ose administrative për shkak të kontaktit në kuadër të vendit të vet ose jashtë tij.

Sa i përket qasjes së mjeteve të informimit, ato nuk do të kryejnë diskriminim kundër kujdoqoftë në bazë të kritereve etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar. Ato do të vëhen në dispozicion informatat të cilat u ndihmojnë mjeteve elektronike të informacionit që në programet e veta të marrin parasysh identitetin etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar të pakicave nacionale.

Ato konfirmojnë se vendosja dhe mbajtja e kontakteve pa pengesa midis pjesëtarëve të pakicave nacionale si dhe të kontakteve përtejkuftare të pjesëtarëve të pakicave nacionale me personat që kanë prejardhje të njëjtë etnike e nacionale, trashëgimi kulturor ose bindja fetare, kontribuon në mirëkuptimin reciprok dhe në avancimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë.

Për këtë shkak ato nxisin aranzhmane mbi bashkëpunimin përtejkuftar në nivelin nacional, fetar dhe lokal, midis tjerash, në vendkalimet lokale kufitare, ruajtjen dhe vizitat e përmendoreve kulturore e historike, turizmin, përmirësimin e trafikut, ekonominë, këmbimin e rinisë, mbrojtjen e

ambientit të njeriut dhe formimin e komisioneve rajonale.

Ato, gjithashtu, do të nxisin aranzhmanet joformale punuese (p.sh. seminarët, komitetet në shtetet pjesëmarrëse dhe midis tyre) atje ku jetojnë pakicat nacionale, për shkak të shqyrtimit të çështjeve, të këmbimit të përvojave dhe të paraqitjes së propozimeve mbi çështjet që kanë të bëjnë me pakicat nacionale.

Me qëllim të përmirësimit të informimit të vet mbi gjendjen e vërtetë të pakicave nacionale, shtetet pjesëmarrëse do t'u distribuojnë mbi baza vullnetare, nëpërmjet Sekretariatit të KSBE-së shteteve tjera pjesëmarrëse, informata mbi gjendjen e pakicave nacionale në territoret e veta, si dhe deklaratat për politikën nacionale në këtë aspekt.

Shtetet pjesëmarrëse do të deponojnë në Sekretariatit të KSBE-së ekzemplarët e propozimeve të paraqitura në seancën plenare të mbledhjes së ekspertëve të KSBE-së mbi pakicat nacionale për të cilat dëshirojnë që t'u jepen në disponim opinionit.

DOKUMENTET
E KËSHILLIT TË EVROPËS
(Pjesë të zgjedhura)

1. KONVENTA SUAZË E KËSHILLIT TË EVROPËS PËR MBROJTJEN E PAKICAVE KOMBËTARE¹

KAPITULLI I

Neni 1.

Mbrojtja e pakicave kombëtare dhe e të drejtave e të lirive të pjesëtarëve të atyre pakicave, është pjesë përbërëse e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, dhe si e tillë bën pjesë në sferën e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Neni 2.

Dispozitat e kësaj Konvente aplikohen në besim të mirë në frymën e mirëkuptimit e të tolerancës, dhe në përputhje me parimet e fqinjësisë së mirë, të marrëdhënieve miqësore dhe të bashkëpunimit midis shteteve.

Neni 3.

1. Secili anëtar i pakicës kombëtare ka të drejtë të zgjedh lirisht që ndaj tij të sillen ose të mos sillen si të tillë, dhe nuk do të bie në pozitë të pavolitshme për shkak të përcaktimit të tillë ose të kryerjes së të drejtave që burojnë nga ai përcaktim.

2. Pjesëtarët e pakicave kombëtare mund të ushtrojnë ato të drejta dhe t'i shfrytëzojnë liritë që dalin nga parimet e përmbajtura në këtë konventë suazë, individualisht ose në bashkësi me të tjerët.

KAPITULLI II

Neni 4.

1. Shtetet kontraktuese zotohen që t'u garantojnë pjesëtarëve të pakicave kombëtare barazi para ligjit dhe mbrojtje të njëjtë ligjore. Në këtë kuptim është i ndalur çfardo diskriminimi mbi baza të përkatësisë të pakicës kombëtare.

2. Shtetet kontraktuese zotohen të miratojnë, atje ku është e nevojshme, masat përkatëse për avancime në të gjitha fushat e jetës ekonomike, sociale, politike e kulturore, për barazi të plotë efektive midis pjesëtarëve të pakicës kombëtare dhe atyre që i takojnë shumicës. Në këtë aspekt, do të shfaqet kujdes për kushtet e veçanta të pjesëtarëve të pakicave kombëtare.

3. Masat e miratuara në bazë të pikës dy nuk konsiderohen akt i diskriminimit.

Neni 5.

1. Shtetet kontraktuese zotohen të avancojnë kushtet e nevojshme për ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës së pjesëtarëve të pakicave kombëtare, dhe për ruajtjen e elementeve të domosdoshme të identitetit të tyre: fesë, gjuhës, traditës dhe të trashëgimisë kulturore.

2. Pa dëm për masat e marra në kuadër të integritetit të tyre të përgjithshëm, shtetet kontraktuese do

¹ Savet Evropë 1949-1996 (Dokumenti, Beograd, 1996).

të përmbahen nga politika dhe praktika e asimilimit të pjesëtarëve të pakicave kombëtare kundër vullnetit të tyre, dhe do t'i mbrojnë ata nga çdo aksion i drejtuar kah asimilimi i tillë.

Neni 6.

1. Shtetet kontraktuese duhet të nxisin frymën e tolerancës dhe të dialogut ndërkulturor dhe të marrin masa efikase për avancimin e repsektimit, të mirëkuptimit e të bashkëpunimit midis gjithë njerëzve të cilët jetojnë në territorin e tyre, pavarësisht nga identiteti i tyre etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar, veçmas në fushën e arsimit, kulturës dhe të mediave.

1. Shtetet kontraktuese zotohen të marrin masa përkatëse të mbrojtjes së personave të ekspozuar kërcënimeve dhe diskriminimit, armiqësive ose dhunës për shkak të identitetit të tyre etnik, kulturor, gjuhës ose fetar.

Neni 7.

Shtetet kontraktuese do të sigurojnë respektimin e të drejtave secilit pejsëtar të pakicës kombëtare për lirinë e tubimit të qetë, lirinë e bashkimit, lirinë e shprehjes dhe lirinë e mendimit, të ndërgjegjës dhe të predkimit fetar.

Neni 8.

Shtetet kontraktuese zotohen që t'ia njohin secilit pjesëtar të pakicës kombëtare të drejtën e shprehjes së lirë të bindjeve të veta dhe të formojë institucione, organizata e shoqata.

Neni 9.

1. Shtetet kontraktuese zotohen të praojnë se e drejta e çdo pjesëtarit të pakicës kombëtare për lirinë e shprehjes përfshinë lirinë e bindjes, të marrjes e të dhënies së informacioneve e të ideve në gjuhën e pakicës, pa pengesa nga ana e pushtetit dhe pavarësisht nga kufijtë. Shtetet kontraktuese do të sigurojnë, në kuadër të sistemeve të veta juridike, që pjesëtarët e pakicave kombëtare të kenë afirim në mjetet e informacionit publik pa diskriminim.

2. Pika 1, nuk i pengon shtetet kontraktuese që të kërkojnë leje pa diskriminim dhe në bazë të kriterëve objektive për emetimin e emisioneve të radiove e të televizioneve ose për hapjen e ndërmarrjeve të kinemave.

3. Shtetet kontraktuese nuk do të pengojnë krijimin dhe shfrytëzimin e mjeteve të informimit publik nga ana e pjesëtarëve të pakicave kombëtare. Në suazat ligjore për emisionet e radios e të televizionit do të sigurohet sa është e mundshme, e duke pasur parasysh dispozitat e pikës 1, që pjesëtarët e pakicave kombëtare të fitojnë mundësinë e krijimit e të shfrytëzimit të mjeteve të veta të informimit publik.

4. Në kuadër të sistemeve të veta juridike, shtetet kontraktuese do të miratojnë masa adekaute që pjesëtarëve të pakicave kombëtare t'u lehtësohet afrimi në mjetet e informimit publik me qëllim të avancimit të tolerancës dhe të mundësit të pluralizmit kulturor.

Neni 10.

1. Shtetet kontraktuese zotohen ta njohin të drejtën e secilit pjesëtar të pakicës kombëtare të shfrytëzimit të lirë dhe pa pengesa të gjuhës së vet të të pakicës, privatisht e publikisht, me gojë e me shrim.

2. Në viset që janë tradicionalisht ose me numër të konsiderueshëm të banuara me pjesëtarë të

pakicës kombëtare, në qoftë se ata pjesëtarë e kërkojnë këtë, dhe kur ajo kërkesë i përgjigjet nevojës së vërtetë, nënshkruesit do të përpiqen t'i sigurojnë, aq sa kjo është e mundur, kushtet të cilat do të mundësonin që gjuha e pakciës të shfrytëzohet në raportet midis atyre pjesëtarëve dhe organeve të administratës.

3. Shtetet kontraktuese zotohen të garantojnë të drejtën secilit pjesëtar të pakicës kombëtare që të njoftohet menjëherë, në gjuhën të cilën e kupton, mbi shkaqet e burgosjes dhe mbi natyrën dhe arsyet e akuzës kundër tij dhe të mbrohet në atë gjuhë, nëse nevojitet, me ndihmë pa pagesë të përkthyesit.

Neni 11.

1. Shtetet kontraktuese zotohen ta njohin të drejtën e secilit pejsëtar të pakicës kombëtare që të shfrytëzojë mbiemrin dhe emrin e vet në gjuhën e pakicës dhe të drejtën e njohjes së tyre zyrtare sipas modaliteteve të caktura në sistemin e tyre juridik.

2. Shtetet kontraktuese zotohen të njohin të drejtën e secilit pjesëtar të pakciës kombëtare që në vendet e dukshme për opinion të vendos simbolet, mbishkrimet dhe informatat tjera të karakterit privat të shkruara në gjuhën e tij amëtare.

3. Në viset tradicionalisht të banuara me numër të konsiderueshëm që i tkajonë pakicës kombëtare, shtetet kontraktuese do të përpiqen, në kuadër të sistemeve të veta juridike, duke përfshirë atje ku është e përshtatshme kontratat me shtetet tjera, e duke marrë parasysh kushtet e veta të veçata, që emërtimet lokale tradicionale, emrat e rrugëve dhe shenjat tjera topografike që i destinohen opinionit të shkruhen në gjuhën lokale kur ekziston kërkesa e mjaftueshme për shenjat e tilla.

Neni 12.

1. Shtetet kontraktuese, ku është e përshtatshme, do të marrin masa në fushën e arsimit dhe të kërkimeve për kultivimin e kulturës, të historisë, gjuhës e të fesë së pakicës e të shumicës së vet nacionale.

2. Lidhur me këtë, shtetet kontraktuese do të sigurojnë, midis tjerash, mundësi përkatëse për aftësimin e arsimtarëve dhe sigurimin e teksteve, dhe do të lehtësojnë kontaktin midis nxënësve e arsimtarëve të bashkësive të ndryshme.

3. Shtetet kontraktuese zotohen të avancojnë mundësitë e njëjta të arsimit në të gjitha shkallët për pjesëtarët e pakicave kombëtare.

Neni 13.

1. Në kuadër të sistemit të arsimit, shtetet kontraktuese do të njohin të drejtën e pakicave kombëtare për themelimin dhe drejtimin e institucioneve të veta private për arsim dhe aftësim.

2. Kryerja e kësaj të drejte nuk tërheq kurrfarë detyrimi financiar për kontraktueset.

Neni 14.

1. Shtetet kontraktuese zotohen ta njohin të drejtën e secilit pejsëtar të pakicës kombëtare për të mësuar gjuhën e vet të pakicës.

2. Në viset që tradicioalisht ose me numër të konsiderueshëm janë të banuara me pjesëtarë të pakicave kombëtare, nëse ka kërkesa të mjaftueshme, shtetet kontraktuese do të përpiqen, sado që është e mundshme dhe në kuadër të sistemeve të veta të arsimit, që pjesëtarët e atyre pakicave të kenë mundësi përkatëse për mbajtjen e mësimin në gjuhën amëtare ose të marrin orët e atyre gjuhëve.

3. Pika dy e këtij neni do të zbatohet pa dëme për mësimin e gjuhës zyrtare apo të mësimin në atë gjuhë.

Neni 15.

Shtetet kontraktuese do të krijojnë kushte të domosdoshme për pjesëmarrje efektive të pjesëtarëve të pakicave kombëtare në jetën kulturore, sociale ekonomike dhe në punët publike, sidomos në ato që u përkasin atyre.

Neni 16.

Shtetet kontraktuese do të përmbahen nga masat të cilat e ndryshojnë proporcionin e popullatës në viset e banuara me pjesëtar të pakicave kombëtare e kanë qëllim kufizimin e të drejtave e të lirive që dalin nga parimet e përmbajtura në këtë Konventë suazë.

Neni 17.

1. Shtetet kontraktuese zotohen që të mos pengojnë të drejtën e pjesëtarit të pakicës kombëtare për të vendosur dhe mbajtur kontakte të lira e paqësore përtej kufirit me persoant të cilët ligjshëm qëndrojnë në shtetet tjera, veçmas me ata metë icëlt kanë identitet të përbashkët etnik, kulturor, gjuhësor e fetar ose trashëgimi të përbashkët kulturore.

2. Shtetet kontraktuese zotohen të mos shkelin të drejtën e pjesëtarit të pakicës kombëtare për të marrë pjesë në punën e organzative joqeveritare, si në planin nacional ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Neni 18.

1. Shtetet kontraktuese do të përpiqen të lidhin, ku është e domosdoshme, marrëveshje dypalëshe e shumëpalëshe me shtetet tjera, veçmas me ato fqinje, për të siguruar mbrojtjen e pjesëtarëve të pakicave kombëtare respektive.

2. Atje ku është e nevojshme, shtetet kontraktuese do të marrin masa për nxitjen e bashkëpunimit përtejkuftar.

Neni 19.

Shtetet kontraktuese zotohen të respektojnë dhe të zbatojnë parimet e përmbajtura në këtë Konventë si suazë dhe, atje ku ndihet nevoja, të fusin vetëm ato kufizime, resktrikcione ose pezullime të cilat janë caktuar me instrumentet ndërkombëtare, veçmas me Konventën mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut e të Lirive Themelore, në masën në të cilë janë me rëndësi për të drejtat dhe liritë që dalin nga parimet e përmendura.

KAPITULLI III

Neni 20.

Në ushtrimin e të drejtave dhe të lirive që dalin nga parimet e përmbajtura në këtë konventë, secili pjesëtar i pakicës kombëtare do të respektojë legjislacionin nacional dhe të derjtat e të tjerëve, veçmas të pjesëtarëve të shumicave ose të pakicave të tjera kombëtare.

Neni 21.

Asgjë nga kjo Konventë suazë nuk do të interpretohet ashtu që të mund të kuptojë të drejtën për marrjen e veprimeve ose të kryerjes së veprave në kundërshtim me parimet themelore të së drejtës

ndërkombëtare, e veçmas të sovranitetit të barabartë, integritetit territorial dhe të barazisë politike të shteteve.

Neni 22.

Asgjë në këtë Konventë suazë nuk do të interpretohet si kufizim ose pezullim i cilëdo të drejte të njeriut apo të lirive themelore, të cilat mund të sigurohen me ligjet e palëve kontraktuese ose mendonjë marrëveshje tjetër të nënshkruar.

2. PROPOZIMI I PROTOKOLLIT PLOTËSUES I KONVENTËS MBI MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE TË LIRIVE THEMELORE QË KANË TË BËJNË ME PERSONAT TË CILËT U TAKOJNË PAKICAVE KOMBËTARE

(...) PJESA 2 - PARIMET E PËRGJITHSHME

(...) Neni 2.

1. Përkatësia pakicës kombëtare buron nga zgjedhja e lirë e personalitetit.
2. Kurrfarë dëmi nuk mund të shkaktohet nga zgjedhja e përkatësisë ose heqja dorë nga ajo.

Neni 3.

1. Çdo person që i takon pakicës kombëtare ka të drejtë ta shprehë, ruajë dhe zhvillojë plotësisht në liri identitetin e vet fetar, etnik, gjuhësor e kulturor, e që me këtë rast, kundër vullnetit të tijë, të mos u nënshtrohet kurrfarë përpjekjeve për asimilim.
2. Çdo person që i takon pakicës kombëtare mund t'i realizojë dhe t'i shfrytëzojë të drejtat e veta individualisht, ose bashkërisht me të tjerët.

Neni 4.

Çdo person që i takon pakicës kombëtare ka të drejtën ebarazisë para ligjit. Është i ndalur çdo diskriminim i mbështetur në përkatësiën e personit të ndonjëres pakicë kombëtare.

Neni 5.

Janë të ndaluara ndryshimet e qëllimta të përbërjes demografike të rajonit ku është e vendosur pakica nacionale, e që janë të dëmshme për atë pakicë nacionale.

PJESA 3 - TË DREJTAT MATERIALE

Neni 6.

Të gjithë personat që i takojnë pakicës kombëtare kanë të drejtë të themelojnë orgaizatën (organizatat) e vet (të veta), duke përfshirë edhe partinë politike.

Neni 7.

1. Çdo person që i takon pakicës kombëtare ka të drejtë të shërbehet lirisht, privatisht e publikisht, me gjuhën e vet amëtare, si me gojë ashtu edhe me shkrim. Kjo e drejtë aplikohet edhe me rastin e gjuhës së vet në formë të shkruar apo audiovizuale.
2. Çdo person që i takon pakicës kombëtare ka të drejtë që të shfrytëzojë emrin dhe mbiemrin e vet në gjuhën e tij amëtare, dhe ka të drejtë të njohjes zyrtare të emrit dhe të mbiemrit të vet.
3. Në viset ku në numër të madh banon pakica kombëtare, personat që i takojnë asaj pakice kanë të drejtë të shërbehen në gjuhën e vet amëtare në kontakte me organet administrative dhe në procedurat

para gjyqeve dhe institucioneve të legjislacionit.

4. Në viset ku në masë të konsiderueshme banon pakica kombëtare, personat që i përkasin asaj pakice kanë të drejtë t'i qesin në gjuhën e vet emërtimet lokale, emrat e firmave, mbiskrimet dhe njoftimet tjera analogje për opinion.

Kjo nuk paraqet pengesë për të drejtën e pushtetit që njoftimet e lartpërmendura t'i paraqesin në gjuhën zyrtare apo në gjuhët zyrtare të shteteve.

Neni 8.

1. Çdo person që i takon pakicës kombëtare ka të drejtë të mësojë gjuhën e vet amëtare dhe të arsimohet në gjuhën e vet amëtare në numrin përkatës të shkollave e të enteve për arsimim publik dhe për përsosje, për lokacionin e të cilave duhet shfaqur kujdes mbi shkapërderdhjen gjeografike të pakicës.

Neni 9.

2. Personat që i takojnë pakicës kombëtare kanë të drejtë të themelojnë dhe të drejtojnë shkollën (shkollat e veta) e vetë dhe institucionin (institucionet) për arsimim dhe përsosje në kuadër të sistemit juridik të shtetit.

Neni 10.

Çdo person që i takon pakicës kombëtare ka të drejtë, në bazë të respektimit rigoroz të tërësisë tokësore të shtetit, të ketë kontakte të lira e të papengueshme me shtetasit e ndonjë shteti tjetër me të cilat ajo pakicë ndanë veçoritë etnike fetare ose gjuhësore apo identitetin kulturor.

Neni 11.

Në viset ku janë në shumicë, personat që i takojnë pakicës kombëtare kanë të drejtë të disponojnë administratën përkatëse lokale ose autonome, ose kanë të drejtën e statusit special, e që i përgjigjet pozitës specifike historike e territoriale, e në përputhje me legjislacionin nacional të shtetit.

Neni 12.

1. Asnjë dispozitë e këtij protokollit nuk mund të interpretohet si dispozitë e cila kufizon ose e pakëson të drejtën individuale të ndonjë personi që i takon pakicës kombëtare, ose të drejtën kolektive të pakicës kombëtare të futur në legjislacionin e shtetit kontraktues ose në ndonjë marrëveshje ndërkombëtare ku ai është palë.

Neni 13.

2. Nuk konsiderohen diskriminuese masat që merren vetëm për qëllim të mbrojtjes së pakicave kombëtare, të nxitjes së zhvillimit të tyre përkatës dhe të sigurimit të barazisë e të trajtimit të njëjtë në raport me popullatën tjetër në sferat administrative, politike, ekonomike, sociale, kulturore e të tjera.

Realizimi i të drejtave dhe i lirive të përmendura në këtë protokoll aplikohet në tërësi për personat që u takojnë grupit i cili është shumicë në mbarë shtetin, por në pakicë në një apo më shumë vise të tjera.
(...)

Neni 14.

Realizimi i të drejtave dhe lirive të përmendura në këtë protokoll nuk mund të kufizojë detyrat dhe përgjegjësitë që janë të lidhur me shtetësinë e një shteti. Mirëpo, ky realizim mund t'u nënshtrohet vetëm formaliteteve, kushteve dhe kufizimeve ose sanksioeve të parashikuara me ligj dhe të domosdoshme në një shoqëri demokratike për sigurinë kombëtare, tërësinë tokësore ose për sigurinë publike, për mbrojtjen e rendit dhe për pengimin e kriminalitetit, për mbrojtjen e shëndetit apo të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

3. MENDIMI I KOMISIONIT EVROPIAN PËR DEMOKRACI ME ANË TË SË DREJTËS MBI INTERPRETIMIN E NENIT 11 TË PROJEKTPROKOLIT ME KONVENTËN EVROPIANE MBI TË DREJTAT E NJERIUT TË PLOTËSUAR ME REKOMANDIMIN 1201¹

HYRJE

Komiteti për çështje juridike dhe i të drejtave të njeriut i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, me letrën e vet të datës 24 nëntor 1995, ka kërkuar nga Komisioni Evropian për Demokraci me anë të të drejtës (Komisioni i Venedikut), ndihmë në përgatitjen e mendimit mbi interpretimin e projektprotokollit me Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut të plotësuar me rekomandimin 1201 (1993), veçmas mbi nenin 11 të projektit.

Nënkomisioni për mbrojtjen e pakicave, në bazë të raportit të cilin e kanë përgatitur z. Milinvern dhe z. Matscher, ka shqyrtuar këtë çështje në mbledhjen e mbajtur më 29 shkurt 1996 në Venedik.

Mendimi i dhënë, që në këtë fazë kufizohet në nenin 11. është miratuar në mbledhjen e 26 të komisionit plenar (1 e2 mars, 1996).

1. OBJEKTI I KËRKESAVE

Asambleja Parlamentare me rekomandimin e vet 1201 (1993) ka kërkuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës që të miratojë protokollin plotësues me Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut dhe të miratojë tekstin e propozuar i cili është pjesë përbërëse e rekomandimit. Teksti i propozuar është një nga dokumentet shoqëruese i shfrytëzuar në punën e Komitetit të Eskerptëve për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (CAHMIN), të cilit iu besua detyra të hartojë protokollin plotësues me Konventën mbi të Drejtat e Njeriut, qëllimi i të cilit do të ishte garantimi i të drejtave individuale në sferën e kulturës, sidomos për pakicat kombëtare. Përpos kësaj, ai ende shërben si dokument referent për Asamblesë Parlamentare sa herë që i shqyrton kërkesat e shteteve për praninë në anëtarësi të Këshillit të Evropës. Dhe në fund, të referuarit në tekstin e propozuar ekzisotjnë në disa kontrata bilaterale me të cilat rregullohen marrëdhëniet e mira fqinjësore midis shteteve anëtare të Këshillit të Evropës.

Në letrën, me të cilën Komiteti për Punë Juridike dhe të drejta të njeriut kërkon ndihmë nga komisioni, vëhet në dukje ky fakt si dhe vështirësitë që në atë kontekst të interpretohen si projektprotokollin në tërësi ashtu edhe neni i tij i 11, i cili thotë:

"Në rajonet ku janë shumicë, pjesëtarët e pakicave kombëtare do të kenë të drejtën të disponojnë pushtetin përkatës lokal ose autonom, ose të drejtën e statusit special, ashtu që ai t'i përgjigjet

¹ Nacionalne manjine, Beograd, 1997.

pozitës specifike historike e territoriale dhe të jetë në harmoni me legjislacionin e brendshëm të shtetit në fjalë".

Fakti se kjo dispozitë nuk paraqet rregull operativ në të drejtën ndërkombëtare, por vetëm propozim në të cilin, ndërkaq, shpiejnë kontratat tjera ndërkombëtare, ka krijuar një situatë të posaçme e cila e rëndon interpretimin e këtij teksti. Komisioni konsideron se me këtë rast duhet marrë parasysh jo vetë mdomethënien e zakonshme të termave të shfrytëzuara, por edhe punimet relevante përgatitore, punët tjera që janë bërë brenda Këshillit të Evropës lidhur me mbrojtjen e pakicave kombëtare, praktikën e shteteve anëtare lidhur me të drejtën e pakicave në pushtetin lokal ose autonom, si dhe qëndrimet që i kanë marrë anëtarët e Këshillit të Evropës ndaj këtyre dispozitave (shih mutatis mutandis, nenet 30. dhe 31. të Konventës së Vjenës mbi të Drejtën e Kontraktuar, 1969).

Të gjitha këto elemente e zbulojnë esencën e të drejtave të pakicave për të disponuar pushtetin lokal ose autonom ashtu sikurse e kuptojnë dhe e aplikojnë shtetet evropiane.

2. ELEMETNET QË DUHET TË MERRREN PARASYSH ME RASTIN E INTERPRETIMIT TË NENIT 11 NË TËRËSI

a. Punët përgatitore:

Raporti me të cilin propozohet miratimi i rekomandimit 1201 (1993)

(Raporti i Wormsit)

Raporti hyrës i z. Worms nuk është me ndihmesë të madhe për interpretimin e nenit 11. Ai, thjesht, vë në dukje se "nenet 10 e 11 u përkasin të drejtave të cilat mund të kenë pasoja politike. Ata janë hartuar duke pasur parasysh nevojën që në çdo rast të ruhet integriteti i shtetit. Kontaktet me qytetarët e vendeve të tjera duhet të realizohen me "repsketim meritor të tërësisë tokësore të shtetit përkatës". Sa i përket statusit të pushteteve përkatëse lokale të cilave u është lejuar një shkallë e caktuar e autonomisë administrative në viset ku pakica e përbën shumicën, këto pushtete mund të vendosen vetëm në harmoni me legjislacionin e brendshëm të shtetit përkatës".

b. Punët e ndërmarra brenda Këshillit të Evropës lidhur me mbrojtjen e të drejtave të pakicave

Propozimi i Komisionit të Venecias mbi Konventën Evropiane për Mbrojtjen e Pakicave nuk e parashikon të drejtën për pjesëtarët e pakicave kombëtare që të disponojnë pushtetin lokal ose autonom. Në paragrafin 1, të nenit 14. të këtij propozimi të komisionit thuhet se "shtetet do të mbështesin pjesëmarrjen aktive të pakicave në punët publike, e sidomos në marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me sferën e jetës, ose me gjërat që u përkasin atyre".

Në Deklaratën e Vjenës të shefave të shteteve ose të qeverive të vendeve anëtare të Këshillit të Evropës, nga 9 tetori i vitit 1993, është konfirmuar krijimi i atmosferës së tolerancës dhe i dialogut të domosdoshëm për të siguruar pjesëmarrjen e të gjithëve në jetën publike. Vendosja e pushtetit lokal e rajonal mund të paraqet kontribut të rëndësishëm për këtë qëllim.

Konventa suazë për mbrojtjen e pakicave kombëtare nuk e ka huazuar nga neni 11. të propozimit të Asamblesë Parlamentare, idenë për t'iu ofruar, personave të cilët u takojnë pakicave kombëtare në viset ku e përbëjnë shumicën, "të drejtat për të pasur në disponim pushtetin përkatës lokal ose autonom apo statusin special". Në këtë Konventë, e drejta për statusin special, vërtet është zëvendësuar me dispozitën e cila pjesërisht mbështetet në propozimin e Komisionit të Venecias - me nenin 15. Konventa suazë garanton të drejtën për pjesëmarrje aktive të personave të cilët u takojnë pakicave kombëtare në punët publike që u përkasin atyre.

Mirëpo, nuk bëhet kurrfarë fjale për pushtetin lokal. Nga aspekti i Konventës suazë, pjesëmarrja në punët publike është para së gjithash çështje e autonomisë personale e jo lokale.

As praktika gjyqësore, e cila buron nga Konventa Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, nuk nënkupton që me referimin në ndonjë dispozitë të kësaj konvente mund të kërkohet statusi special. Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut ka konfirmuar dy herë se Konventa nuk përman çfarëdo të drejtë të pakicave kombëtare për vetëvendosje. (Nr. 6742/75, DR/3 fq. 98), u përket gjermanëve të cilët më përpara kanë jetuar në Çekoslovaki; dhe nr. 7230/75, DR/7 fq. 109, i përket popullatës së Surinamit). Neni 3. i protokollit të parë (me të cilin garantohen të drejtat elektorale) nuk aplikohet për zgjedhejt e trupave ligjdhënëse, siç janë këshillat komunale (Nr. 10650/83, Dr/42, fq. 212), e as që garantojnë çfarëdo të drejthe të pakicave kombëtare për përfaqësim të veçantë politik (Nr. 9278/81 dhe 9415/81, të vendimit prej 3.10.1993, DR/35 fq. 30).

Në bazë të gjithë kësaj, del se e drejta ndërkombëtar, në parim, nuk mund t'u urdhërojë shteteve çfarëdo zgjidhjesh territoriale për problemet e pakicave, e as që nga shtetet, në parim të kërkojë të fusin çfarëdo formash të decentralizimit për pakicat (shih edhe nenin 35, paragrafi 2. Deklarata nga Kopenhaga).

c. Sjelljet e shteteve në raport me nenin 11.

Kontratrat midis Hungarisë dhe Kroacisë, nga 5 prilli i vitit 1995, shpie në rekomandimin 1201, kurse palët kontraktuese nuk kanë dhënë kurrfarë deklarate me rastin e ratifikimit.

Kontrata midis Slovakisë dhe Hungarisë mbi marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe bashkëpunimin miqësor, nga 19 marsi i vitit 1995 (neni 15. paragrafi 4 (b), shpie në rekomandimin 1201, kurse qeveria sllovaqe me rastin e ratifikimit dha këtë deklaratë: "Qeveria e Republikës Sllovaqe deklaronte se kurrë nuk e ka pranuar ose futur në kontratë çfarëdo formulimi të mbështetur në njohjen e parimit të drejtave kolektive të pakicave, apo që i është lejuar krijimi i strukturave autonome në bazë të përkatësisë etnike".

Definitivisht, duket se të referuarit Rekomandimit 1201, veçmas nenit të tij të 11, është në qendër të procesit negociator të përgatitjes së kontratës bilaterale midis Hungarisë dhe Rumanisë.

Vërtet, duket se shtetet frikësohen se e drejta për administrim përkatës lokal ose autonom, në kombinim me të drejtën për kontakte përtejkuftare (neni 10. i projektprotokollit), mund të nxisë tendenca secesioniste. Madje edhe ato shtete që duke iu përmbajtur parimit të unitaritetit ofrojnë shkallë të lartë të autonomisë rajonale, ngurrojnë të pranojnë instrumentet detyruese ndërkombëtare mbi të drejtën e pakicave për autonomi të caktuar. Sikurse thekson H. Klebes, në shumë shtete ende ekziston shkallë e lartë e ndieshmërisë lidhurme çfarëdo forme të autonomisë për pakciat kombëtare, përkatësisht është e pranishme frika se autonomia kulturore çon në autonomi administrative, pas të cilit pastaj pason secesioni.

d. Praktika e shteteve evropiane lidhur me të drejtën e pakicave që të disponojnë pushtetin lokale ose autonomi

Gjatë punës së vet komisioni ka vërejtur llojllojshmëri të modeleve juridike të mbrojtjes së pakicave në Evropë. Këto dallime shprehin ndërlikueshmërinë e situatave, prej nga rrjedhin zgjidhjet e ndryshme të cilat i pranojnë shtetet duke u marrë me këtë problem. Puna e komisionit, si dhe studimi i sistemeve nacionale për mbrojtjen e pakicave, nuk tregojnë ekzistimin e çfarëdo praktike unike lidhur me autonomitë territoriale, madje as në kuptimin më të gjerë.

Sipas mendimit të komisionit elementet e përmendur tregojnë se:

- çdo përpjekje për interpretimin e nenit 11, të rekomandimit 1201 (1993) duhet qasur tejet me kujdes; dhe
- duke pasur parasysh gjendjen e tashme të së drejtës ndërkombëtare, qasja e gjerë e problemit të të

drejta të pakicave që të disponojnë pushtetin lokal ose autonom, është e mundshme vetëm në qoftë se ekzistojnë instrumentet detyruese të së drejtës ndërkombëtare, që nuk është rasti në këtë situatë.

3. INTERPRETIMI I NENIT 11 TË PËRMBAJTUR NË REKOMANDIMIN 1201 (1993)

a. "... pjesëtarët e pakicave kombëtare..."

Sipas kuptimit të Komisionit, bartësit e të drejtës të parashikuar me nenin 11 janë "pjesëtarët e pakicave kombëtare", e jo pakicat si të tilla. Përkundër këtij formulimi, e drejta për autonomi është e realizueshme vetëm si e drejtë e cila ushtrohet në bashkësi me tjerët. Së këndejmi, e drejta respektive nuk nënkupton se shteti duhet të pranojë ekzistimin e entitetit të organizuar etnik në territorin e vet, e as të jenë të pëlqimit me konceptin e pluralizmit etnik si komponentë e popullit ose e kombit, e cila mund të ndikojë në unitetin e shtetit. Kuptimi i fenomenit të pakicave në nenin 11, nuk dallon nga ai që gjendet në dispozitat tjera të tekstit të propozuar në rekomandimin 1201. Ajo është dhënë indirekt dhe mbështetet në njohjen e të drejtave individuale, ndonëse ato shfrytëzohen në bashkësi me të tjerët (pra, koelktivisht) - që është karakteristikë e qenësishme e cila përmendet vetëm në deklaratën sllovaqe gjatë ratifikimit të Kontratës mbi fqinjësinë e mirë me Hungarinë. Këtë element, gjithësesi, duhet marrë parasysh me rastin e interpretimit të esencës së të drejtave të prashikuara me nenin 11.

Neni 1. e jep definicionin e nocionit "pakica kombëtare". Ajo shënon grupin e personave në një shtet të cilët: qëndrojnë përherë në territorin e atij shteti dhe janë shtetas të tij; mbajnë lidhje të fuqishme dhe të qëndrueshme me shtetin që ekziston qysh më parë; i shprehin karakteristikat e veçanta etnike, kulturore, fetare ose gjuhësore; janë mjaft të përfaqësuar, ndonëse numerikisht më të pakët në raport me popullatën tjetër të shtetit respektiv ose të rajonit në atë shtet; dhe janë të motivuar me interesat që ta ruajnë bashkërisht identitetin e vet.

Nga ky definicion del se persoant të cilëve u garantohen të drejtat që i mbanë rekomandimi 1201, janë shtetas të shtetit respektiv, e jo emigrantë të huaj. Kjo është fuqizuar me faktin plotësues se këto të drejta mund t'i shfrytëzojnë vetëm personat të cilët u takojnë pakicave "historike" (që të kenë, nga "ato ekzistuese më parë, lidhje të fuqishme e të qëndrueshme" me shtetin respektiv).

Shprehja "nga ato ekzistuese më parë, lidhje të fuqishme dhe të qëndrueshme me atë shtet" duhet interpretuar ashtu që të nënkuptojë lidhjet me territorin e shtetit respektiv si komponentë e tij përbërëse. Për këtë arsye, pjesëtarët e një pakice nuk do të humbasin statusin e pakicës në rastin kur ai territor i takon shtetit tjetër ose shtetit të ri, kurse rekomandimi 1201, merastin e kalimit të tillë të territorit ose të suksesionit do të mbetet relevant për ata, kuptohet, me kusht që personat në fjalë të mbeten në pakicë.

b. "... në viset ku janë me shumicë..."

Që të aplikohet neni 11. pakica duhet të paraqet shumicën në ndonjë "vis". Mirëpo, vështirë është të definohet nocioni "vis" në kontekst të kësaj dispozite.

Në parim, ky nocion do të duhet të kuptohet në kuptimin e tij gjeografik, e jo në kuptimin administrativ ose politik. Mirëpo, ai gjithashtu, ka dimensionin historik i cili lidhet me krijimin e grupeve të ndryshme në territorin e caktuar.

Në të vërtetë, shtetet kanë një diapazon tejet të shtrirë të vlerësimit kur e definojnë atë që ata e konsiderojnë "vis". Megjithatë, definimi i një territori si "vis" për aplikimin e nenit 11, duhet të bëhet me besim të mirë. Ai, sidomos, nuk guxon të ketë për qëllim pengimin e aplikimit të nenit 11, e as që guxon të jetë i trilluar (në këtë kontekst shih nenin 16, të Konventës suazë). Përkundrazi, ai duhet të mbështetet mbi kriteret objektive dhe të shfaq kujdes për fenomenin e pakicës. Gjatë punës së vet, Komisioni ka theksuar kategorikisht se shtetet, me rastin e ndarjes së territorit të vet në njësi politike ose administrative, patjetër duhet të shfaq kujdes për praninë e një ose të më shumë pakicave në territorin e

vet, që vlenë edhe për formimin e njërive elektorale (arsyetimi i Komisionit të Venedikut bashkuar propozimin e Konventës Evropiane mbi Mbrojtjen e Pakicave, parag. 42).

Termi "në shumicë", gjithashtu duhet të interpretohet në kontekst të qëllimit i cili arrihet me nenin 11. Mundësimi i vendosjes së pushtetit lokal ose autonom, paraqet kënaqjen më gjithpërfshirëse të kërkesave të pakicave koherente në kuadër të një shteti unitar. Shtetet federale, faktikisht, mund të shkojnë edhe më larg në këtë plan (për këtë të shihet Raporti i Komisionit të Venecias mbi mbrojtjen e pakicave në shtetet federale e rajonale).

Përpos kësaj, këtë term nuk duhet kuptuar vetëm si induktim në raportin numerik, veçse me këtë nënkuptohet se pakica qëndron dhe është e koncentruar në rajonin në fjalë.

c. "... do të kenë të drejtë të disponojnë pushtetin përkatës lokal apo autonom ose të kenë status special..."

Neni 11. parashikon të drejtën e shfrytëzimit të autonomisë së caktuar dhe përmend tri forma të saj (pushtetin lokal, pushtetin autonom dhe statusin special) që nuk janë definuar posaçërisht.

Thënë përgjithësisht mund të pohohet se e drejta e garantuar me nenin 11, nuk mund të interpretohet si e drejtë realizimi i të cilës kërkon masat që do të ndikojnë dukshëm në strukturën e shtetit, ndonëse struktura federale ose rajonale u mundëson pakicave, me qëndrim të përhershëm në territorin e një shteti, që të fitojnë një shkallë të caktuar të autonomisë memarrjen e territorit të caktuar si bazë në të cilën mund të zhvillojnë politikë me anë të institucioneve autonome. Me nenin 11, nuk është krijuar ndonjë model i veçantë i institucioneve të autonomisë lokale, sepse llojllojshmëria e modeleve në Evropë është e atillë sa që asnjë nga ato nuk mund të rekomandohet si model i vetëm të cilin do ta miratonin të gjitha vendet.

Nisur nga kjo, secili shtet ka në disponim një zgjidhje tejte të gjerë të mundësive për përmbushjen e detyrimeve të veta nga neni 11.

Të drejtat përkatëse lokale ose autonome

Disa indikacione të rëndësishme mbi esencën e të drejtës për shfrytëzimin e shkallës së caktuar të autonomisë, mund të gjenden në Kartën Evropiane mbi Vetëqeverisjen Lokale. Sipas këtij instrumenti, autoritetet lokale duhet të jenë në gjendje që të "rregullojnë dhe drejtojnë pjesët e qenësishme të punëve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të popullatës lokale". (Neni 3.1 i Kartës). Përpos kësaj, Karta përmban një varg elementesh që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave për "të rregulluar dhe drejtuar pjesën qenësore të punëve publike". Kështu:

- këtë të drejtë do ta ushtrojnë këshillat ose komunat e përbëra nga anëtarët të cilët janë zgjedhur lirisht me vota të fshehta në bazë të së drejtës imediate, të barabartë dhe universale të votimit, dhe të cilat mund të kenë organe ekzekutive që u përgjigjen atyre (neni 3.2, i Kartës),

- autoritetet lokale duhet të jenë në gjendje t'i realizojnë iniciativat e veta lidhur me çdo çështje e cila nuk është e përjashtuar nga kompetencat e tyre; nuk i është ndarë ndonjë shkallë tjetër, duke pasur parasysh se punët publike kryesisht i drejtojnë ato organe të pushtetit që u janë më të afërt qytetarëve (neni 4. parag. 2 e 3 i Kartës).

- autoritetet lokale duhet të jenë të afta për të caktuar strukturën e vet të brendshme administrative në mënyrë që t'ia përshtasin nevojave lokale dhe të sigurojnë administratë efikase (neni 6. i Kartës).

- çfarëdo kontrolli administrativ mbi organet lokale të pushtetit mund të realizohet vetëm në harmoni me procedurën dhe në rastet e parashikuara me kushtetutë ose statut; ky kontroll do të ketë qëllim vetëm të sigurojë harmonizimin me ligjin dhe me parimet kushtetuese; instancat më të larta të pushtetit mund ta ushtrojnë këtë nga aspekti i përshtatshmërisë të kryerjes së detyrave që u janë besuar

organeve lokale të pushtetit (neni 8 i kartës),

- organet lokale të pushtetit kanë të drejtë që me anë të gjyqit, të sigurojnë ushtrimin e lirë të pushtetit të vet dhe të respektimit të parimit të vetëqeverisjes lokale, të cilat janë inkorporuar në kushtetutën ose legjislacionin lokal (neni 11. i kartës).

Këto, shkurt, janë direktivat të cilat duhet të motivojnë praktikën e shtetit kur i realizon detyrimet e veta nga neni 11, sepse nuk është fjala për kërkesat që dalin nga ky nen.

Statusi special

Domethënia e "statusit special", duhet pranuar, është bukur e paqartë, por shpreh dëshirën e autorit të nenit 11, që t'u mundësojë shteteve heqje dorë nga modelet tradicionale të administrimit lokal. Në këtë kuptim, mbetet në shtetet që të caktojnë lirisht vëllimin e statusit special. Në mungesë të çfarëdo praktike të përbashkët e cila do të mundësonte që të caktohet të paktën minimumi i kërkesës për ekzistimin e statusit të tillë, vëllimi i të drejtave për status special do të duhej të përcaktohej me anë të objektivave që dalin nga neni 11, në përgjithësi, dhe nga vullneti i supozuar i shtetit anëtar të Këshillit të Evropës. Disa shembuj mund të gjenden në rastet e statusit special që ekzistojnë në Itali dhe Spanjë, gjë që nuk përjashton zgjidhjen e autonomisë personale.

Sipas mendimit të komisionit, çdo status special duhet të mbështetet në dëshirën që pjesëtarëve të pakicave t'u mundësohet të marrin pjesë efektive në miratimin e vendimeve të cilat kanë të bëjnë me visin në të cilin jetojnë, ose me çështjet që u përkasin atyre. Institucionet që e formojnë statusin special do të duhej të jenë të afta për t'i përfaqësuar pakicat dhe të sigurojnë pjesëtarëve të pakicave:

- se do të konsultohen çdo herë kur miratohen masat ligjore ose administrative të cilat u përkasin atyre;

- se do të përfshihen në përgatitjen, vlerësimin dhe aplikimin e planeve dhe të programeve zhvillimore nacionale e rajonale të cilat u përkasin atyre drejtpërdrejtë;

- se do të marrin pjesë efektive në procesin e miratimit të vendimeve dhe në trupat elektroale në nivelin nacional e lokal, sidomos në sferën e çështjeve kulturore, arsimore, fetare, informative e sociale.

Këto janë vetëm kërkesa minimale. Statusi special, natyrisht mund të shtrihet edhe më tutje duke ua ndarë viseve, në të cilat pakica e përbën shumicën, pushtetin e tyre legjislativ dhe ekzekutiv lidhur me punët rajonale dhe kështu futet në sistemin e ngjashëm me federalizimin e pjesërishtëm të shtetit.

d. "... që i përgjigjet pozitës përkatëse specifike historike e territoriale..."

"Shprehja që i përgjigjet pozitës specifike historike e territoriale" ka funksion të dyfishtë:

- Së pari, me atë kërkohet nga shtetet që të kenë parasysh traditën e pakicave përkatëse dhe nevojat e tyre specifike. Në këtë kuptim, ajo i përgjigjet mbiemrit "përkatës", që gjendet në dispozitën e njëjtë.

Së dyti, me atë futet mundësia se aplikimi i kësaj të drejte ndryshon nga shteti në shtet, e madje edhe nëse ajo aplikohet ndryshe për pakicat e ndryshme në kuadër të shtetit të njëjtë. Sipas nenit 11, pra, nuk do të jetë unike, por do t'u përshtatet diferencave të mëdha që ekzistojnë në rastet e secilës pakicë. Me praktikën e institucioneve të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, është vendosur ekuilibri midis autorizimeve diskrete të shteteve për të vlerësuar rrethanat individuale të secilit rast veç e veç, dhe të mekanizmit evropian të mbikëqyrjes sipas konventës, prandaj ekziston kushti për supozim se ekuilibri i njëjtë do të vendoset edhe në rastin e nenit 11.

e. "... në harmoni me legjislacionin e brendshëm të shtetit respektiv..."

Para së gjithash, fakti se pushteti lokal e autonom dhe statusi special të cilët duhet t'i gëzojë pakicat, duhet të jetë në harmoni me legjislacionin e brendshëm të shtetit respektiv, e kufizon këtë të

drejtë. Shteti është ai i cili e rregullon suazën juridike brenda të cilës mund të realizohet kjo e drejtë, kurse mbrojtja ndërkombëtare jepet vetëm në qoftë se e drejta realizohet legalisht.

Njëkohësisht, ndërkaq, kjo shprehje përmbanë garancën e ekzistimit të suazës juridike për realizimin e kësaj të drejte.

Përpos kësaj, sipas praktikës së themeluar të institucioneve të konventës evropiane mbi të drejtat e njeriut, autorizimet diskrete që i kanë shtetet për krijimin e sistemit juridik në fjalë, janë të kufizuara me faktin se vetë ai sistem duhet të jetë i harmonizuar me konventën dhe me protokollet e saj. Ato, veçanërisht, nuk guxojnë të kenë si pasojë humbjen e çdo kuptimi të nenit 11.

4. NENI 11. REKOMANDIMET 1201 (1993) NËBASHKËVEPRIM ME NENET 13 E 14 TË REKOMANDIMIT TË NJËJTË

Nenet 13 e 14 thonë:

Neni 13.

"Realizimi i të drejtave dhe i lirive të theksuara në këtë protokoll, aplikohet plotësisht për personat që i takojnë grupit i cili është në shumicë në mbarë shtetin, por është në pakcië në një apo më shumë vise të tij".

Neni 14.

"Realizimi i të drejtave dhe lirive të theksuara në këtë protokoll, nuk ka për qëllim të kufizojë detyrat dhe përgjegjësitë e qytetarëve të një shteti. Mirëpo, ky realizim mund t'u nënshtrohet formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve që janë parashikuar me ligj dhe janë të domosdoshme në shoqërinë demokratike për shkak të sigurisë nacionale, integritetit territorial ose të sigurisë publike, të pengimit të trazirave ose të kriminalitetit, të mbrojtjes së shëndetësisë apo të moralit, ose për shkak të mbrotjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve".

Nuk mund të përjashtohet mundësia e aplikimit të nenit 13 në kombinim me nenin 11 të rekomandimit 1201.

Sa i përket nenit 14, ai lejon se shfrytëzimi i të drejtave të garantuara, duke përfshirë edhe atë nga neni 11 mund të kufizohet me masat e rregulluara me ligj, të cilat janë të domosdoshme në shoqëritë demokratike, prë hir të realizimit të qëllimeve të cilat sipas konventës janë legjitime, e midis të cialve gjendet edhe siguria sociale edhe tërësia tokësore. Në këtë kuptim është e rëndësishme praktika e Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut lidhur me interpretimin e qëndrimeve të jera të neneve prej 8 - 11 e veçmas parimi i proporcionalitetit.

4. UDHËZIME PËR NJOHJEN E SHTETEVE TË REJA NË EVROPËN LINDORE DHE NË BASHKIMIN SOVJETIK, QË I KA APROVUAR KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPINA, MË 17 DHJETOR TË VITIT 1991, TË BOTUAR NË EUROPA (NO.5632, N.S.), MË 18 DHJETOR 1991.

Bashkësia dhe shtetet e saj anëtare e konfirmojnë besnikërinë e tyre ndaj parimeve të Aktit të Helsinkit dhe Kartës së Parisit, veçmas të drejtën për vetëvendosje. Ato konfirmojnë gatishmërinë e vet për të njohur, që është objekt i standardeve normale të praktikës ndërkombëtare dhe e realitetit të saj politik në secilin rast veç e veç, ato shtete të reja të cilat duke pasur ndryshimet historike në rajon, janë konstituuar mbi baza demokratike dhe kanë pranuar obligimet përkatëse ndërkombëtare dhe janë zotuar

në besim të mirë për proces paqësor e negociata.

Për këtë shkak miratojnë pozicionin e përbashkët lidhur me procesin e njohjes së shteteve të reja i cili kërkon:

- respektimin e dispozitave të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe obligimet që i përmban Akti final i Helsinkit dhe Karta e Parisit, sidomos lidhur me sundimin e drejtësisë, demokracisë dhe të drejtave të njeriut;

- garantimin e të drejtave grupeve etnike e nacionale dhe pakicave, në përputhje me obligimet që i përmbajnë suazat e KSBE-së;

- respektimin e mosprekshmërisë së të gjitha kufijve, që mund të ndryshohen vetëm me mjete paqësore dhe me marrëveshje të përbashkët;

- pranimin e të gjitha obligimeve përkatëse lidhur me çarmatimin dhe mosshtrirjen e armatimit bërthamor si dhe sigurimin e stabilitetit rajonal;

- obligimin që me marrëveshje të inagurojnë, e atje ku ndihet nevoja edhe të zbatojnë arbitrazhin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me suksesionin e shteteve e të kontesteve rajonale.

Bashkësia dhe anëtarët e saj nuk do t'i njohin entitetet që janë formuar si pasojë e agresionit. Ato do të shfaqin kujdes për efektet e njohjes në shtetet fqinje.

Besnikëria ndaj këtyre parimeve hap rrugën për njohjen nga ana e bashkësisë dhe shteteve të saja dhe për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Kjo mund të përcaktohet me marrëveshje.

KUSHTETUTAT
DHE STATUSET E AUTONOMIVE
(Pjesë të zgjedhura)

1. REPUBLIKA E ITALISË

A. PJESË NGA KUSHTETUTA

Pjesa e V

RAJONET, KRAHINAT DHE "KOMUNAT" (Ky term i përfshinë qytetet dhe rajonet urbane e rurale)

Neni 114.

Republika është e ndarë në rajone, krahina dhe "komuna".

Neni 115.

Rajonet janë të konstituuar si njësi autonome territoriale me kompetencat dhe funksionet e veta të harmonizuara me parimet e paraqitura në Kushtetutë.

Neni 116.

Format dhe kushtet e veçanta të autonomisë: në përputhje me statutet speciale të pranuar nga ana e të drejtës kushtetuese i janë ndarë Sicilisë, Sardinisë, Trentino-Aldo Adigjes, Friuli - Venecia Gjulia dhe Vale d'Aostës.

Neni 117.

Në kuadër të punimeve fundamentale të vendosura me ligjet e shtetit, rajonet kanë të drejtë të nxjerrin ligje në këto fusha, në qoftë se ligjet e tilla nuk janë në kundërshtim me interesat e kombit apo të rajoneve të tjera:

- Organizimi i kancelarive lokale dhe i trupave administrative;
- Kufijtë e qytetit;
- Policia urbane dhe rurale;
- Panairot dhe tregjet;
- Manifsetimet publike bëmirëse, ndihma shëndetësore e spitalore;
- Arsimimi i orientuar i artistëve dhe i zanatçinjve dhe ndihmave shkollore;
- Muzetë dhe bibliotekat e trupave lokale drejtuese
- Urbanizimi;
- Turizmi dhe industria hoteliere;
- Tramvajet dhe shërbimet e autobusve me interes rajonalë;
- Rrugët, ujësjellsat dhe punët publike me interes rajonalë;
- Komunikacioni i liqejve dhe portet;
- Ujërat minerale dhe të banjave;
- Gurthyerjet dhe xeheroret;
- Gjuetia;
- Peshkimi në liqene e lumenj;
- Bujqësia e pylltaria;
- Zejtaria;

Sferat tjera të përmendura në ligjet kushtetuese.

Ligjet e Republikës mund t'i bartin kompetencat në rajone lidhur me nxjerrjen e normave për zbatimin pikërisht të këtyre ligjeve.

Neni 118.

Funksionet administrative që u takojnë subjekteve të përmendura në nenin e mësipërm i ushtrojnë rajonet, kurse ato më interes ekskluziv lokal, sipas ligjeve të Republikës, mund të barten në krahina, "komuna" ose në autoritet tjera lokale.

Në bazë të ligjit, shteti mund të delegojë ushtrimin e funksioneve tjera të natyrës administrative në ndonjë krahinë.

Rajoni i ushtron normalisht funksionet e veta administrative ashtu që ato i delegon në krahina, "komuna" ose në autoritetet tjera lokale, apo që i ushtron nëpërmjet kancelarive të veta.

Neni 119.

Rajonet kanë autonominë financiare në kuadër të formës dhe kufizimeve të normës me ligjet e Republikës të cilët e koordinojnë këtë autonomi rajonale me financat e shtetit, të krahinave dhe "komunave".

Rajoneve u janë normuar tatimet e tyre vetjake dhe kuotat e tatimeve të Ministrisë së Financave, në bazë të funksioneve të tyre normale.

Shteti, me anë të ligjit normon fondet e posaçme për rajonet e caktuara me destinime specifike, e veçanërisht për zhvillimin e Italisë Jugore dhe të ishujve.

Në bazë të ligjit të Republikës, provincat kanë tokën dhe trashëgimitë e veta.

Neni 120.

Rajonet nuk guxojnë t'i mbledhin taksat si të importit ashtu edhe të eksportit dhe tatimet për vetëm për tranzit midis provincave.

Rajonet nuk guxojnë të miratojnë norma të cilat e pengojnë qarkullimin e lirë të personave ose të mallrave midis provincave.

Rajonet nuk guxojnë të kufizojnë të drejtën e qytetarëve për ta ushtruar zëjtarinë e vet, për t'u punësuar ose për të punuar në cilëndo pjesë të territorit nacional.

Neni 121.

Trupat zyrtare të rajonit janë: Këshilli rajonal, Këshilli Ekzekutiv Rajonal dhe kryetari i tij.

Këshilli Rajonal ushtron kompetencat legjislativë dhe administrative që i janë ndarë rajonit dhe të gjitha funksionet tjera që janë parashikuar për atë në bazë të kushtetutës dhe ligjit. Ai mund t'i propozojë parlamentit ligje.

Këshilli Ekzekutiv është trup ekzekutiv i rajonit.

Kryetari i Këshillit Ekzekutiv e përfaqëson rajonin; miraton ligje rajonale e dispozita, dhe drejton funksionet administrative të cilat shteti ia ka ndarë rajonit në përputhje me udhëzimet e qeverisë qendrore.

Neni 122.

Ligji i Republikës e cakton sistemin zgjedhor, numrin e deputetëve në rajon, s' idhe rastet kur ata nuk mund të zgjidhen për shkak të përshtatshmërisë për ato funksione.

Asnjë person nuk mund të jetë njëkohësisht anëtar i Këshillit Rajonal dhe deputet të cilëndo dhomë të parlamentit, apo të ndonjë këshilli tjetër rajonal.

Këshilli e zgjedh kryetarin nga radhët e anëtarëve të vet dhe kancelarinë e kryetarit për kryerjen e funksioneve relevante.

Anëtarët e Këshillit të Rajoneve nuk janë të obligueshëm të mbajnë përgjegjësi për mendimet që i kanë paraqitur apo për votimin që e kanë kryer gjatë ushtrimit të detyrave të veta.

Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Ekzekutiv i zgjedh Këshilli Rajonal nga radhët e anëtarëve të vet:

Neni 123.

Secili rajon ka statutin e vet i cili, në harmoni me kushtetutën dhe ligjet e Republikës vendos normat lidhur me organizimin e vet intern. Statuti rajonal kontrollon të drejtën e iniciativës dhe referendumin mbi ligjet dhe dispozitat e natyrës administrative në territorin e rajonit si dhe shpalljen e ligjeve e të dispozitave rajonale.

Projektstatutin e jep dhe e miraton Këshilli Rajonal me anë të shumicës absolute të anëtarëve të vet, kurse atë më vonë e fuqizon ligji republikan.

Neni 124.

Përfaqësuesi i qeverisë, i cili jeton në kryeqytetin e rajonit, mbikëqyr funksionet administrative që i ushtron qeveria qendrore dhe i koordinon ato me funksionet që i ushtron rajoni.

Neni 125.

Kontrollin e legjitimitetit të vendimeve administrative në rajon e kryen, në formë të decentralizuar, organi i qeverisë qendrore sipas mënyrës dhe suazave të kufizuara e të rregulluara me ligjet e republikës. Në rastet specifike, ligji lejon rishikimin e validitetit të rasteve, por vetëm në kuptimin e rekomandimeve me anë të kërkesës së motivuar, që Këshilli Rajonal ta rishikojë vendimin kontraverzë.

Rajonet kanë gjyqet e veta të shkallës së parë për aksionet administrative në përputhje me nevojat e ligjit të Republikës. Ato gjyqe mund të kenë degë edhe në vendet tjera të rajonit, e jo vetëm në kryeqytetin e tij.

Neni 126.

Këshilli rajonal mund të shpërndahet nëse vepron në kundërshtim me dispozitat kushtetuese, nëse ka bërë shkelje serioze të ligjeve, ose nuk ia del të përmbush kërkesën e qeverisë për ta shkarkuar Këshillin Ekzekutiv, apo të kryetarit të tij në qoftë se ata kanë bërë shkelje të ngjashme.

Ai mund të shpërndahet (peuzollohet), kur më nuk ka mundësi për t'i përmbushur detyrimet e veta nëse disa nga anëtarët e tij kanë dhënë dorëheqje nga funksionet e veta, ose për shkak që nuk ekziston mundësia për t'u formuar shumica.

Këshilli mund të pezullohet edhe për shkaqe të sigurisë.

Këshilli rajonal pezullohet me dekretin e kryetarit të Republikës kur komisioni i përbërë nga senatorët dhe deputetët e që është formuar në bazë të ligjeve rajonale të Republikës, jep mendimin se kjo duhet bërë.

Pas marrjes së dekretit mbi pezullimin, emërohet komisioni të cilin e përbëjnë tre qytetarë të përshtatshëm për t'u zgjedhur në Këshillin Rajonal. Ai komision shpallë se zgjedhjet e reja do të mbahen në afatin prej tre muajve, dhe ushtron punët e zakonshme administrative që janë në kompetencë të Këshillit Ekzekutiv dhe miraton vendime të pashtyeshme: vendimet e tilla janë objekt i ratifikimit nga ana e Këshillit të ri Rajonal.

Neni 127.

Secili ligj të cilin e miraton Këshilli Rajonal do t'i bartet përfaqësuesit të qeverisë i cili duhet ta miratojë në afatin prej tridhjetë ditësh nga paraqitja e tij, përpos në rastet kur atë e kundërshton qeveria.

Ligji miratohet në fatin prej dhjetë ditësh nga dita kur është lejuar, kurse hyn në fuqi pesëmbëdhjetë ditë nga shpallja e tij. Nëse Këshilli Rajonal konsideron se ligji është i rëndësishëm dhe urgjent, e me këtë pajtohet edhe qeveria e Republikës, atëherë miratimi i ligjit dhe hyrja e tij në fuqi nuk u nënshtrohen afateve të caktuara kohore.

Qeveria e Republikës, kur konsideorn se ligji i miratuar nga ana e Këshillit Rajonal i tejkalon kompetencat e rajonit ose bie në konflikt me interesat e kombit apo me ato të rajoneve tjera, ia kthen ligjin Këshillit Rajonal në periudhën e parashikuar për miratim.

Kur shumica absolute e anëtarëve të Këshillit Rajonal e miraton serish ligjin, qeveria e Republikës mundet, në afatin prej pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e komunikimit të këtij fakti, t'i drejtohet Gjyqit Kushtetues me kërkesën që ai ta rishikoj ligjshmërinë e atij vendimi, kurse në rast të konfliktit të interesave t'i drejtohet Dhomës së Përfaqësuesve dhe Senatit për ta vlerësuar validitetin e tij. Në rast të dyshimit Gjyqi Kushtetues merr vendimin final.

Neni 128.

Krahinat dhe "komunat" janë trupa autonome në bazë të parimit të paraqitura në ligjet e përgjithshme të Republikës të cilat i caktojnë funksionet e tyre.

Neni 129.

Krahinat dhe "komunat" gjithashtu janë njësi territoriale të shtetit dhe të decentralizimit rajonal.

Territori që e përbën krahinën gjithashtu mund të ndahet në rrethe me funksione ekskluzive administrative, me qëllim të decentralizimit të tyre të mëtejshme.

Neni 130.

Në disa raste të cilat i ka caktuar ligji, kontrolli i çështjes së validitetit mund të kryhet në formë të kërkesës së menduar mirë që i paraqitet dhomës kompetente për rishikimin e vendimeve të miratuara më herët.

Neni 131.

Formohen këto rajone:

Piemont; Vale d'Aosta; Lombardia; Trentino-Alto Adigje; Friuli-Venecia, Gjulia; Liguria; Emilia-Romania; Toskana; Umbria; Marke; Abruco; Molize; Kompania; Pula; Bazilikata; Kalabria; Sicilia; Sardinia.

Neni 132.

Në bazë të ligjit kushtetues, kur dëgjohe mendimi i Këshillit Rajonal, atëherë mund të fillojnë aranzhmanet për bashkimin e rajoneve ekzistuese ose për formimin e rajoneve të reja me minimum për një milion banorësh, në qoftë se një kërkesë të tillë e shtrojnë këshillat të cilët e përfaqësojnë të paktën një të tretën e popullatës së interesaur, dhe nëse propozimi është miratuar në referendum në të cilin ka votuar shumica e popullatës së interesaur.

Pas referendumit dhe paraqitjes së mendimit të Këshillit Rajonal, e në bazë të ligjit të Republikës, mund t'u jepet pëlqimi krahinave dhe "komunave" që të ndahen nga një rajon për t'iu bashkuar raportit tjetër.

Neni 133.

Ndryshimet e kufijve të krahinave dhe formimin e krahinave të reja në kuadër të territorit të rajonit, janë parashikuar me ligjet e Republikës, kur "komunat" e drejtojnë kërkesën në këtë kuptim dhe rajonet e miratojnë.

Pasi e ka dëgjuar mendimin e popullatës së interesaur, rajoni mundet, në bazë të zgjidhjeve të veta ligjore, që në territorin e vet të formojë "komuna" të reja, dhe t'i modifikojë kufijtë dhe emrat e tyre.

b) KONTRATA PAQËSORE ME ITALINË, E NËNSHKRUAR MË 10 SHKURT 1947.
(49UNTS 3, ANEKS IV, NENI 1)

Neni 1.

Popullatës së provincës Bolcano dhe qyteteve fqinje dygjuhësore në provincën Trento e cila flet gjermanisht, do t'i sigurohen të drejtat e njëjta si edhe banorëve që flasin italisht në kuadër të dispozitave të veçanta të cilat duhet të ndihmojnë për ruajtjen e karakteristikave etnike dhe zhvillimin kulturor e ekonomik të popullatës e cila flet gjermanisht.

Në harmoni me legjislacionin i cili tanimë ka hyrë në fuqi ose që duhet të miratohet, qytetarët gjuha e të cilëve është gjermanishtja, kanë të drejtën për:

- a) arsim fillor e të mesëm në gjuhën amtare;
- b) përdorim të gjuhës gjermane dhe italiane në organet e pushtetit publik dhe në dokumentat zyrtare si dhe për emërtimet dygjuhësore të emrave topografike;
- c) gjermanizimin e sërishëm të mbiemrave të cilat janë italizuar gjatë viteve të fundit;
- d) të drejtat e barabarta lidhur me punësimin në shërbimet publike me qëllim të realizimit të sistemit më të mirë të vendeve midis grupeve etnike.

c) STATUSI I AUTONOMISË I TIROLIT TË JUGUT 3136 (1972) NR. 670.G. ZYR.

KREU I
FORMIMI I RAJONIT TRENTO - ALTO ADIGJE/TIROLI I JUGUT DHE
PROVINCA TRENTO E BOLCANO/BOZEN

Kapitulli I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Trentino-Alto Adigje/Tiroli i Jugut përfshinë territoret e provincave Trenti dhe Bolcano/Bozen, dhe themelohet si pushtet autonom i cili ka autoritetin juridik brenda unitetit politik të Republikës së Italisë të vetëm e të pandarë, e që mbështetet mbi parimet të cilat i përmbajnë kushtetuta dhe ky statut. Kryeqyteti i provincës autonome Trento-Alto Adigje/Tiroli i Jugut është Trento.

Neni 2.

Njihet barazia e të gjithë qytetarëve, pa marrë parasysh se cilit grup gjuhësor i takojnë, e me qëllim të ruajtjes së veçorive të tyre etnike e kulturore.

Neni 3.

Pushteti autonom përfshinë provincat Trento dhe Bolcano/Bozen.
Komunat Proves/Proveis, Senale/Unsere, liebe Frau im Walde, Termeni/Trami, Ora/Auer, Bronzolo/Brancol, Valdanjo/Aldein, Laurenjo/Laurein, Sa Felizhe/St. Feliks, Kortazhina/Kurtasht, Egna... dhe nën distrikti Sinablana/Tonna në komunën Rumo, provinca Trento i takojnë provincës Bolcano/Bozen.

Në këtë statut caktohen forma dhe kushte të reja të autonomive për privincat Trento dhe Bolcano/Bozen.

Normat të cilat rregullojnë përdorimin e flamurit kombëtar mbeten në fuqi, kurse pushteti autonom dhe provincat Trento dhe Bolcano/Bozen do të kenë flamujt dhe stemat e veta të cilat do t'i kofirojë kryetari i Republikës.

Kapitulli II - KOMPETENCAT E PUSHTETIT AUTONOM

Neni 4.

Në harmoni me kushtetutën, sistemin gjyqësor të shtetit dhe me detyrimet ndërkombëtare e interesat nacionale që nënkuptojnë edhe ruajtjen e pakicave lokale gjuhësore - si dhe në harmoni me parimet themelore të rregullimit ekonomik e social të Republikës, Rajoni ka kompetencat legjislative në këto fusha:

1. rregullimin e organeve të rajonave dhe të pozitës së të punësuarëve në ato organe;
2. rregullimin e pozitës së organeve pararajonale;
3. kufijtë e komunave;
4. ekspropriimin me interes publik duke përfshirë punët që janë në kompetencat dhe drejtimin e shtetit, ose gjenden në kompetencat e provincës;
5. formimin dhe mbajtja e librave të katastrit;
6. shërbimet e zjarrfikësve;
7. rregullimin e punës së agjencive të ngarkuara për shëndetësi dhe spitale;
8. rregullimin e punës së odave ekonomike;
9. zhvillimin e shoqatave kooperative dhe mbikëqyrjen e punës së kooperativeve;
10. kontributin për përparime me anë të punëve publike të cilat i organizojnë shërbimet tjera në territorin e rajonit.

Neni 5.

Rajoni, në suazat e caktuara me dispozitat e nenit të mëparshëm dhe me parimet themelore të ligjeve të shtetit, miraton normat juridike në këto fusha:

1. rregullimin e bashkësisë;
2. rregullimin e punës së institucioneve publike chëritable;
3. rregullimin e punës së agjencive kreditore, të institucioneve kreditore bujqësore, shërbimve të kursimit dhe të institucioneve kursimore bujqësore si dhe të organizatave kredituese me rëndësi rajonale.

Neni 6.

Në punët që kanë të bëjnë me ndihmën publike dhe sigurimin social, rajoni ka të drejtë të miratojë norma juridike me qëllim të përshtatjes me dispozitat e ligjeve të cilat i nxjerrë shteti si dhe të formojë institucionet përkatëse autonome ose të lehtësojë formimin e tyre.

Institucionet ekzistuese të sigurimit shëndetësor në rajon, që kanë hyrë në përbërje të Këshillit të Rajonit mund t'i themelojë përsëri, përveç kur është fjala për rregullimin e të drejtës së pronës.

Beneficionet që u janë lejuar persoanve të siguruar nuk mund të jenë më të vogla nga ato që ua ka njohur instituti i lartpërmendur.

Neni 7.

Në përputhje me normat juridike të rajonit, pas konsultimeve me popullatën e interesuar, mund të themelohen komuna të reja, kurse kufijtë ekzistues dhe emrat nuk mund të ndryshohen.

Ndryshimet e tilla, për çdo rast, kur është fjala për kompetencat e organeve të shtetit, nuk mund të

hyjnë në fuqi para skadimit të afatit prej dy muajve nga dita e shpalljes në gazetën zyrtare të Rajonit.

Kapitulli III - KOMPETENCAT E PROVINCAVE

Neni 8.

Provincat kanë të drejtë të miratojnë normat juridike në suazat e caktuara me nenin 4. me të cilin rregullohen këto fusha:

1. rregullat që kanë të bëjnë me organet e provincave dhe me të punësuarit në ato organe;
2. toponimet, duke shfaqur kujdes për nevojën e ruajtjes së dygjuhësisë në provincën Bolcano/Bozen;
3. mbrojtja dhe ruajtja e thesarit historik, artistik e nacional;
4. traditat lokale dhe institucionet e kultuës; bibliotekat, akademitë, institutet dhe muzeumet me interes për provincë: manifestimet dhe aktivitetet lokale artistike, kulturore e arsimore, kurse në rastin e provincës Bolcano/Bozen edhe emetimin e tyre me anë të radios e televizionit por të të drejtës së themelimit të stacioneve radiotelevizive;
5. planifikimin e përgjithshëm në nivel të qytetit dhe të rrethinës;
6. mbrojtjen e ambientit;
7. rregullat e përbashkëta;
8. rregullimin e trashëgimive më të vogla kulturore në përputhje me nenin 847 të kodeksit civil; rregullimin e "të mirave shëndetësore" dhe të bashkësisve familjare të cilat drejtohen në bazë të statuteve të vjetra dhe zakoneve;
9. zëjtarinë;
10. ndërtimtarinë, të subvencionuar plotësisht dhe pjesërisht nga ana e shtetit, duke përfshirë stimulimet për ndërtimin e shtëpive komunale në viset e goditura nga katastrofa dhe aktivitetet që i kryejnë jashtë - trupat krahinore në provincat në bazë të fondeve të shtetit;
11. portet nëpër liqene;
12. panairët dhe tregjet;
13. preventivat dhe masat e jashtëzakonshme në rastet e katastrofës;
14. minierat, duke përfshirë ujërat mineralë e termalë, gurthyerjet dhe minierat;
15. gjuetinë dhe peshkimin;
16. kulturën alpine dhe parqet për mbrojtjen e florës e të faunës;
17. rrugët, ujësjellsin dhe punët publike në Krahinë;
18. komunikacionin dhe transportin në Krahinë, duke përfshirë rregullimin teknik dhe punën e teleferikve;
19. angazhimin direkt të shërbimeve publike dhe udhëheqjen e tyre me anë të agjencive speciale;
20. turizmin dhe hotelerinë, duke përfshirë ciceronët malorë, bartësit aplikë, instruktorët e skijimit dhe shkollën e skijimit;
21. bujqësinë, pyjet dhe komisionet e pyjeve, fondin e bagëtive e të peshqëve, institutin për patologjinë e bimëve, konzorciumet bujqësore dhe fermat eksperimentale, shërbimet për luftën kundër breshërit, reklamimin e tokës;
22. blerja e dhunshme e të gjitha sendeve me dobi publike të cilat bëjnë pjesë në kompetencën e Krahinës;
23. arsimit dhe puna e komisioneve lokale e krahinore të cilat i ndihmojnë dhe i këshillojnë punëtorët lidhur me punësimin;
24. kategoria e tretë, e katërt dhe e pestë e puënve hidraulike;
25. ndihma publike dhe manifestimet bëmirëse;
26. entet parashkollorë;

27. ndihma shkollorë në sektoret e arsimit në të cilat provinca kompetencat legjislativë;
28. godinat shkollorë;
29. aftësimet profesionale.

Neni 9.

Provincat miratojnë normat legjislativë lidhur me fushat e përmendura më poshtë, në suazat e kufizive të përmendura në nenin 5;

1. policia urbane e rurale;
2. arsimimi fillor dhe i mesëm (shkollat e mesme, gjimnazet, shkollat e larta shkencore, pedagogjike, teknike, të arsimimit të lartë dhe shkollat artistike);
3. tregtia;
4. praktikantizmi: libreza e punës, kategoritë dhe kualifikimet e punëtorëve;
5. arsimimi dhe puna e komisioneve komunale të provincave për punësim;
6. siguria publike lidhur me mbajtjen e manifestimeve dhe kremtave publike;
7. dyqanet dhe firmat tregtare, rregulaltligjore të shtetit lidhur me fitimin e lejeve, autorizimet shtetërore lidhur me sigurinë publike dhe të drejtat e Ministrisë së Punëve të Brendshme që t'i pezullojë zyrtarisht dispozitat lidhur me të përmendurat më lartë të cilat në bazë të legjislacionit të shtetit ende janë në fuqi. Ankesa e zakonshme lidhur me këto dispozita ushtrohet në nivelin e krahinës autonome;
8. shtimi i prodhimtarisë industriale;
9. shfrytëzimi i rezervave publike të ujit, përpos në rastin e derivaciveve më të mëdha të sistemeve hidroelektrike;
10. higjiena dhe shëndetësia, duke përfshirë mbrojtjen shëndetësore dhe trajtimin spitalor;
11. sportet dhe rekreacioni me të gjitha volitshmëritë dhe pajisjen relevante.

Neni 10.

Me qëllim të plotësimin të dispozitave të ligjeve shtetërore, provincat kanë të drejtë të miratojnë normat ligjore lidhur me punësimin dhe fillimin e marrëdhënies së punës, me ç'rast mund të konsultohen me kancelaritetë e jashtme të Ministrisë së Punës derisa të mos i formojnë kancelaritetë e veta rreth kryerjes së detyrave administrative lidhur me kompetencat legjislativë që u janë ndarë provincave nga aspekti i kushteve të punës.

Nëpunësit komunalë për punësim i zgjedhin dhe emërojnë trupat shtetërore me konsultimin paraprak me kryetarin e Këshillit Ekzekutiv dhe prefektet e qyteteve.

Qytetarët që kanë banim të përhershëm në provincën Bolcano kanë përparësi në punësim në territorin e vet provincës pavarësisht nga dallimet gjuhësore dhe ato që kanë të bëjnë me gjatësinë e qëndrimit.

Neni 11.

Provinca mund të lejojë hapjen ose transferin e bankave dhe të institucioneve tjera lokale kreditore me karakter rajonal ose krahinor, në konsultime paraprake me Ministrinë e Financave.

Lejen për hapjen dhe transferin e bankave të lartpërmendura dhe të institucioneve kreditore e jep Ministria e Financave në konsultimin paraprak me vetë krahinën.

Krahina e emëron kryetarin dhe nënkryetarin e Bankës së Kursimit (Cassa di Risparmio) në konsultime paraprake me Ministrinë e Financave.

Neni 12.

Kur janë në pyetje derivacionet e mëdha për destinime hidroelektrike dhe kohëzgjatja e tyre, provincat me kompetenca territoriale kanë të drejtë të japin komentet e veta ose të shprehin kundërshtimet gjithnjë deri në momentin derisa Këshilli i Lartë i Punëve Publike nuk merr vendimin e vet definitiv.

Krahinat, gjithashtu kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë në Gjyqin e Lartë të Punëve Publike kundër dhënies së koncesioneve për destinime hidroelektrike dhe për kohëzgjatjen e tyre.

Kryetari i Këshillit Ekzekutiv Provincial me kompetenca territoriale ose delegatët e tij ftohen për të marrë pjesë, me të drejtë të votës konsultative, në mbledhjet e Këshillit të Lartë për Punëve Publike në të cilat rishikohen të gjitha dispozitat e përmendura në paragrafin e parë.

Ministri relevant i miraton dispozitat lidhur me aktivitetin e Drejtorisë Nacionale për Elektroenergjinë (ENEL) në rajon me konsultime paraprake me provincën e interesuar.

Neni 13.

Sa u përket koncesioneve për derivacione më të mëdha për destinime hidroelektrike, bartësit e koncesioneve janë të obligueshëm që provincave Bolcano dhe Trento t'u japin gratis çdo vit nga 22 kw/h për çdo kw të kapacitetit minimal mesatar për shërbime publike dhe kategoritë e shfytëzuesve të cilën do ta caktonte ligji krahinor, e që duhet bartur me makinat prodhuese ose meanë të kablllove përçuese e distributive të tensionit të lartë të lidhura për ato makina, në vendin i cili më shumë i konvenon provincës.

Në bazë të ligjit të provincës, gjithashtu vendosën kriteret për fiksimin e çmimeve të energjisë së lartpërmendur e cila u lehet në obligim agjencive distributive, dhe kriteret për këstet e konsumatorëve të cilat në asnjë mënyrë nuk mund të jenë më të mëdha ng ato të fiskuara nga ana e Komitetit Ministror për Çmime (CIP).

Bartësit e koncesioneve për derivacione të mëdha për destinime hidroenergjetike, duhet çdo gjashtë muaj ta paguajnë nga 6.20 lira provincave për çdo kw/h të energjisë së pashfrytëzuar. Kompensimi i lartpërmendur unitar do të silllet në proporcionin me variacionet jo më pak se 5% të çmimit mesatar të shitjes së ENEL-it, i cili fitohet në bazë të llogarisë përfundimtare të drejtorisë nacionale për elektroenergjinë.

Lutjet për fitimin e koncesioneve për derivacione të mëdha për destinime hidroelektrike në provincat Trento dhe Bolcano në konkurrencë me ENEL-in dhe organizatat lokale, të caktuara në bazë të ligjit të mëvonshëm shtetëror, i jep Ministria e Punëve Publike bashkë me Ministrinë e Industrisë, Tregtisë dhe Zejtarisë dhe në marrëveshje me provincën e interesuar territoriale.

Neni 14.

Mendimi i provincës kërkohet për koncesione në planin e komunikacioneve dhe të transportit të cilët kalojnë nëpër territorin e krahinës.

Mendimi i provincës kërkohet gjithashtu për kategorinë e parë e të dytë të punëve hidraulike. Shteti dhe provinca harmonizohen paraprakisht rreth zbatimit të planit koordinues vjetor të kompetencave për punët hidraulike.

Shfrytëzimi i ujërave publike nga ana e shtetit dhe e krahinës, në suazat e kompetencave të tyre përkatëse, mbështetet në planin e përgjithshëm për të cilin janë harmonizuar përfaqësuesit e shtetit e të provincës në komitetin "ad hoc".

Neni 15.

Përpos, nëse normat e përgjithshme për planifikimin ekonomik nuk sigurojnë sistem tjetër të financimit, Ministria e Industrisë, Tregtisë dhe Zejtarisë ia ndanë kuotat provincave Trento dhe Bolcano për kontributet vjetore në buxhet, me të cilin në përputhje me ligjet e shtetit, financohen rritjet në aktivitetin industrial. Kuotat fiksohet pas konsultimeve me provincën dhe pas marrjes parasysh të shumës së destinuar buxhetit dhe nevojave të popullatës së provincës. Për shfrytëzimin e shumës së destinuar harmonizohen shteti dhe provinca. Në qoftë se shteti intervenon me fondet e veta për zbatimin e planeve të veçanta nacionale për ndërtimin e godinave shkollore në provincat Bolcano dhe Trento, këto fonde shfrytëzohen në marrëveshje me krahinën.

Provinca Bolcano i shfrytëzon alokacionet e veta për qëllime sociale e kulturore në përpjestim direkt me përbërjen e secilës bashkësi gjuhësore dhe duke marrë parasysh nevojat e asaj bashkësie, përpos në rastet speciale të cilat kërkojnë intervenimin urgjent nga shkaqet e veçanta.

KAPITULLI IV Dispozitat e përbashkëta për rajonin dhe krahinat

Neni 16.

Rajoni dhe provinca mund të nxjerrin ligje dhe kanë fuqinë e caktuar administrative në numrin e kufizuar të territoreve për të cilat dikur ka qenë kompetent shteti.

Kompetencat e krahinës në bazë të ligjeve me vlerë, ende janë valide në qoftë se janë kompatible me këtë statut.

Aq më shumë, shteti në bazë të ligjit mund të delegojë funksione administrative në rajon, provincë dhe në trupat tjera lokale publike. Me këtë rast çmimin e ushtrimit të këtyre funksioneve e bart shteti.

Kjo bartje e funksioneve administrative shtetërore, ndonëse është e lejuar në bazë të ligjit në fuqi, mund të modifikohet ose të revokohet me ligj të zakonshëm të Republikës.

Neni 17.

Me ligjin shtetëror, rajonit dhe provincës mund t'i jepet e drejtë për të nxjerrë normat ligjore lidhur me shërbimet që kanë të bëjnë me çështjet jashtë kompetencave që janë rregulluar me këtë statut.

Neni 18.

Rajoni i ushtorn normalisht funksionet administrative ashtu që ato i bart në provinca, "komuna" dhe në autoritetet tjera lokale, ose që për ato i shfrytëzon kancelaritë dhe shërbimet e tyre. Shërbimet zjarrfikëse medoemos barten në provinca. Nga ana tjetër, provincat mund të delegojnë ndonjë nga funksionet e veta administrative në "komuna" ose në autoritetet tjera lokale apo të shfrytëzojnë kancelaritë e shërbimet e tyre.

Neni 19.

Në provincën Bolcano në entet parashkollore, si dhe në arsimin fillor e të mesëm, mësimi zhvillohet në gjuhën italiane e gjermane, domethënë në gjuhën amtare të nxënësve me anë të mësuesve të cilët flasin gjuhën e njëjtë amtare. Duke filluar ngaklasa e dytë apo e tretë e shkollës fillore është i obligueshëm edhe mësimi i gjuhës tjetër në bazë të ligjit krahinor dhe të propozimit obligues të

bashkësisë së interesuar gjuhësore.

Gjuha ladine shfrytëzohet në kopshtet dhe çerdhet e fëmijëve kurse mësohet në shkollat fillore të bashkësisë ladine. Gjuha ladine është edhe gjuhë kryesore mësimore në të gjitha shkollat në kuadër të bashkësisë. Gjuha italiane dhe gjermane kanë numër të njëjtë të orëve dhe hyjnë në mënyrë të barabartë në notën përfundimtare.

Regjistrimi i nxënësve në provincën Bolcano, bëhet në bazë të lutjeve të cilat i paraqesin babai ose kujdestari. Ata mund t'i ankohen degës së gjyqit rajonal të autonomisë për të drejtën administrative të Bolcanos në rast se lutjet e tyre refuzohen.

Administrimi i shkollave në gjuhën italiane dhe supervizioni i shkollave në gjuhën gjermane apo ladine në ato bashkësi, të përmendura në paragrafin e dytë, bëjnë pjesë në kompetencat e mbikëqyrësit të shkollës të cilin e emron Ministria e Arsimit pas konsultimeve me Këshillin Ekzekutiv Krahinor të Bolcanos.

Administrimi çerdheve, kopshteve, i shkollave fillore e të mesme në gjuhën gjermane, bën pjesë në kompetencat e inspektorit të shkollës të cilin e emëron Këshilli Ekzekutiv i Bolcanos pas konsultimeve me Ministrinë e Arsimit, nga lista e shkurtër e kandidatëve gjermanofil të cilën e ka paraqitur Këshilli krahinor i shkollës.

Administrimi i shkollave të përmendura në paragrafin e dytë të këtij neni bënë pjesë në kompetencën e inspektorit të shkollës të cilën e emëron Ministria e Arsimit nga lista e shkurtuar e kandidatëve të bashkësisë së gjuhës ladine, të paraqitur nga këshilli për provime në shkollat jogjermane.

Këshilli i lartë i arsimit duhet të konsultohet lidhur me çështjen e planeve e programeve arsimore dhe me provimet në shkollat e Krahinës së Bolcanos si edhe lidhur me barazinë e diplomave përfundimtare.

Personale administrativ në kancelarinë arsimore dhe në shkollat e mesme, si edhe personale administrativ i inspekcioneve të shkollave dhe kancelarive të shkollave, bënë pjesë në kompetencën e Provincës së Bolcanos. Ai zgjidhet në përputhje me gjuhën amtare.

Duke marrë parasysh faktin se edhe arsimtarët edhe profesorët janë nënpunës të shtetit, inspektori për gjuhën gjermane dhe i shkollës së përmendur në paragrafin 2, merret me çështjet e transferimit, mungesës së përkohshme dhe me masat disiplinore duke përfshirë edhe suspensimin njëmuor papagesë.

Në përputhje me paragrafin e mësipërm, është e lejueshme ankesa në Ministrinë e arsimit kundër normave që miratojnë inspektorët e shkollave. Ministria merr vendimin definitiv pas konsultimeve me mbikëqyrësin e shkollës.

Bashkësitë gjuhësore italiane, gjermane dhe ladine janë të përfaqësuara në shkollat krahinore ose në këshillat disiplinore për mësuesit e shkollave fillore.

Përfaqësuesit e mësuesve në pleqësitë e shkollave krahinore i zgjedhin vetë mësuesit dhe atë proporcionalisht me numrin e mësuesve në bashkësitë eaktuara gjuhësore. Mirëpo, për bashkësinë ladine është parashikuar minimumi i obligueshëm prej tre anëtarëve të pleqësisë.

Pleqësia e shkollës, përveç që ushtron detyrat e parashikura me ligj, duhet të paraqes edhe mendimin e vet lidhur me hapjen dhe mbylljen e shkollave, me programet dhe planet mësimore, orarin e mësimave, mësimin për lëndët eaktuara dhe grupimin e tyre.

Për formimin e universitetit në krahinën Trentino-Alto Adige, shteti duhet të marrë pëlqimin e rajonit dhe të krahinës.

Neni 20.

Kryetari i Këshillit Ekzekutiv Krahinor e kryen detyrën e organit për sigurinë publike ashtu sikurse e ka parashikuar ligji, në rastet e industrisë së rrezikshme, profesioneve të zhurmshme e të rrezikshme, dyqaneve e biznesit, të agjencive, shtypshkronjave, tregtive shetitëse, të punëtorëve dhe shërbtorëve të

shtëpive, të të sëmureve mentale, narkomanëve, lypësve dhe të rinisë me moshë nën 18 vjeç.

Për t'i kryer detyrat e lartpërmendura, kryetari i Këshillit Ekzekutiv Krahinor, ka gjithashtu në disponim shërbimin e policisë së shtetit apo të forcave policore lokale, qytetare e provinciale.

Detyrat tjera të cilat sipas ligjit mbi sigurinë publike janë parashikuar për prefektet e rretheve, u besohen drejtuesve të stacioneve policore.

Prefektet edhe më tutje e mbajnë funksionin e oficerëve kryesor për sigurinë publike kurse atyre u ndihmojnë oficerët tjerë për sigurinë publike.

Neni 21.

Dispozitat e organeve të shtetit që janë miratuar nga shkaqet e rendit dhe qetësisë publike, e të cilat ndikojnë, suspendojnë ose kufizojnë efikasitetin e autorizimeve të kryetarit të Këshillit Ekzekutiv Krahinor lidhur me çështjet policore ose normat tjera që bëjnë pjesë në kompetencat e krahinës, miratohen pas konsultimeve me kryetarin e Këshillit Ekzekutiv Krahinor i cili ftohet të paraqesin mendimin e vet sipas mënyrës së theksuar në kërkesë.

Neni 22.

Në emër të respektimit të ligjeve dhe dispozitave rajonale e krahinore, kryetari i Këshillit Ekzekutiv Rajonal dhe kryetarët e këshillave ekzekutive krahinore, mund të kërkojnë intervenimin dhe ndihmën e policisë së shtetit, ose të forcave policore lokale, qytetare ose provinciale.

Neni 23.

Rajonet dhe krahinat (për mbrojtjen e normave që i përbëjnë disa ligje) i shfrytëzojnë sanksionet ndëshkuese të cilat ka parapërcaktuar shteti për rastet e posaçme.

KREU II ORGANET RAJONALE E KRAHINORE

KAPITULLI I ORGANET RAJONALE

Neni 24.

Organet zyrtare të rajoneve janë: Këshilli Rajonal, Këshilli Ekzekutiv Rajonal dhe kryetari i tij.

Neni 25.

Këshilli Rajonal zgjidhet në bazë të sistemit proporcional, dhe të drejtës së votës direkte, universale e të fshehtë në përputhje me rregullat ligjore të rajonit.

Ekzekutojnë shtatdhjetë (70) këshilldhënës rajonalë. Vendet u ndahen njësisht zgjedhore ashtu që me numrin shtatdhjetë ndahet numri i banorëve në rajon, në bazë të regjistrimit të fundit të popullatës, në proporcion me popullatën e secilës njësi elektorale, sipas shumës së përgjithshme dhe të shumës më të madhe të mbetur.

Territori rajonal ndahet në njësi zgjedhore krahinore të Trentos dhe të Bolcanos.

Që dikush të fitojë të drejtën e votës lypset që të ketë qëndrim të pandërprerë prej katër vjetësh në Bolcano. Emri i votuesit i cili e përmbush këtë të drejtë regjistrohet në listën elektorale të "komunës" krahinore ku votuesi e ka lejen e qëndrimit. Mirëpo, kur është fjala e zgjedhjeve për këshillat rajonale e krahinore dhe këshillat e "komunave" të përmendur në nenin 63, në periudhën prej katër vjetësh, votuesi ka të drejtë të votojë në "komunën" në të cilën ka qëndruar dikur.

Nenin 26.

Këshilli rajonal ushtron pushtetin rajonal i cili i është ndarë rajonit dhe të gjitha funksionet tjera të parashikuara me kushtetutë, me këtë statut dhe ligjet tjera shtetërore.

Neni 27.

Këshilli rajonal zgjidhet në afatin prej pesë vjetësh. Mandatin e vet e plotëson me anë të dy kuvendeve të barabarta të cilët mbahen alternativisht në Trento dhe Bolcano.

Kryetari i Këshillit Ekzekutiv Rajonal i shpallë zgjedhjet për këshillin e ri një muaj para skadimit të mandatit pesëvjeçar.

Këshilli i ri mbledhet në afatin prej 20 ditësh pas zgjedhjes së këshilltarëve të ri dhe atë me ftesë të kryetarit në kancelarinë e Këshillit Ekzekutiv Rajonal.

Neni 28.

Anëtarët e Këshillit Rajonal e përfaqësojnë rajonin në tërësi. Ata nuk mund të përgjigjen për mendimet që i kanë paraqitur ose për mënyrën sipas të cilës kanë votuar gjatë zgjatjes së mandatit të tyre.

Nenin 29.

Këshilltarët rajonalë, pra zgjedhjes në atë funksion, duhet të japin betimin e besnikërisë ndaj Republikës dhe të garantojnë se detyrën e vet do ta kryejnë në të mirë të shtetit e rajonit.

Neni 30.

Këshilli Rajonal e zgjedh kryetarin, nënkryetarin dhe sekretarët nga radhët e anëtarëve të vet. Kryetari dhe nënkryetari kanë mandatin dy vjet e gjysmë.

Gjatë tridhjetë muajve të parë të mandatit të Këshillit, kryetari zgjedhet nga radhët e këshilltarëve italianë, kurse nënkryetari nga radhët e këshilltarëve gjermanofonë. Në periudhën e ardhshme kryetari zgjedhet nga radhët e gjermanofonve kurse nënkryetari nga radhët e italofove.

Në rast të vdekjes apo të dorëheqjes së kryetarit të këshillit rajonal apo të braktisjes së funksionit për ndonjë shkak tjetër, Këshilli mundëson që zgjedhja e kryetarit të ri të bëhet nga radhët e këshilltarëve të bashkësisë së njëjtë gjuhësore cilës i ka takuar kryetari i mëparshëm. Nominimi kryhet në sesionin e ardhshëm dhe mbetet valid deri në fund të periudhës së tashme prej dy vjetë e gjysmë.

Neni 31.

Disponimi me të cilat disiplinohet aktiviteti i Këshillit Rajonal, janë caktuar me normat të brendshme të miratuar nga shumica absolute e këshilltarëve.

Dispozitat e brendshme gjithashtu vendosin normat për caktimin e këshilltarëve të bashkësisë gjuhësore.

Neni 32.

Me vendimin e shumicës së anëtarëve të Këshillit, mund të shkarkohen kryetari dhe nënkryetari i Këshillit Rajonal i cili nuk i përmbush detyrat e veta. Për këtë qëllim Këshilli Rajonal mund të konvokohet jashtëzakonshëm me kërkesën, të paktën, e një të tretës së këshilltarëve.

Nëse kryetari ose nënkryetari i Këshillit Rajonal nuk e konvokojnë Këshillin Rajonal në afatin prej 15 ditësh nga paraqitja e kërkesës, atëherë atë e konvokon kryetari i Këshillit Ekzekutiv Rajonal.

Neni 33.

Këshilli Rajonal mund të shpërndahet kur kyen vepra në kundërshtim me kushtetutë apo kur bëjnë shkelje serioze ligjore.

Këshilli gjithashtu mund të shpërndahet për shkaqe të sigurisë nacionale ose kur për shkak të dorëheqjes së dikujt apo të pamundësisë për t'u formuar shumica, këshilli më nuk është në gjendje t'i përmbush obligimet e veta.

Shpërndarja e Këshillit Rajonal kryhet në bazë të dekretit të presidentit të Republikës, me shqyrtim paraprak të Këshillit të Ministrave, përpos në rastet e jashtëzakonshme, me komisionin parlamentar mbi bashkëpunimin rajonal.

Dekretin për shpërndarje e shoqëror emërimi i komisionit prej tre anëtarësh, nga të cilët një duhet të jetë gjermanofon të cilët zgjedhen nga radhët e qytetarëve të përshtatshëm për rolin e këshilltarëve në Këshillin Rajonal. Komisioni e zgjedh kryetarin nga radhët e anëtarëve të vet, kurse ai pastaje ushtron funksionin e kryetarit të Këshillit Ekzekutiv Rajonal. Komisioni i cakton zgjedhjet për Këshillin Rajonal në afatin prej tre muajsh dhe miraton dispozitat në kuadër të kompetencave të Këshillit Ekzekutiv Rajonal, si dhe ato të pashtueshmet. Këto dispozita bëhen joefektive nëse nuk i ratifikon Këshilli Rajonal në afatin prej një muaji nga dita e formimit të tij.

Këshilli i ri konvokohet nga ana e komisionit njëzet ditë pas formimit të tij.

Shpërndarja e Këshillit Rajonal nuk tërheq me ete shkarkimin e Këshillit Krahinor. Anëtarët e Këshillit të shpërndarë vazdojnë t'i ushtrjnë detyrat e veta të këshilltarëve krahinor deri në zgjedhjen e Këshillit të ri rajonal.

Në rast të shpërndarjes së Këshillit Krahinor, mbahen zgjedhjet plotësuese për këshilltar rajonal të Këshillit Krahinor.

Anëtarët e Këshillit të shpërndarë krahinor vazhdojnë t'i kryejnë detyrat e veta si këshilltarë rajonal gjithnjë deri në zgjedhjet e parashikuara me paragrafin e mësipërm.

Neni 34.

Kryetari e konvokon seancën e zakonshme të Këshillit Rajonal çdo javë të parë në muaj gjatë gjashtë muajve të ardhshëm kurse seancën e jashtëzakonshme e konvokon me kërkesë të Këshillit Ekzekutiv Rajonal apo me kërkesë të vet kryetarit, ose me kërkesën e të paktës një të pestës së këshilltarëve të zgjedhur, si edhe në rastet tjera të rregulluara me këtë statut.

Neni 35.

Këshilli Rajonal mund të votojë dhe të formulojë plane për çështjet që nuk bëjnë pjesë nën juridikcionin e rajonit, por megjithatë janë çështje me rëndësi të veçantë. Të gjitha këto çështje kryetari i Këshillit Ekzekutiv Rajonal ia paraqet qeverisë qendrore për t'i shqyrtuar në parlament, kruse kopjet e të njëjtave u paraqiten përfaqësuesit fuqiplotë të qeverisë.

Neni 36.

Këshilli Ekzekutiv Rajonal përbëhet nga kryetari, nënkryetari dhe nga funksionarët e përhershëm e të përkohshëm. Kryetari, nënkryetari dhe funksionarët zgjidhen me vota të fshehta dhe me shumicën absolute.

Përbërja e Këshillit Ekzekutiv Rajonal duhet t'i përgjigjet përbërjes së bashkësive etnike të përfaqësuar në vetë atë. Njëri nënkryetar është italoфон kurse tjetri gjermanofon.

Kryetari e zgjedh nënkryetarin i cili do ta zëvendësojë në rast të mungesës ose të pengimit të tij për të marrë pjesë në punën e Këshillit.

Funksionarët e përkohshëm të bashkësisë së caktuar gjuhësore i zëvendësojnë funksionarët e përhershëm të bashkësisë së njëjtë kru kjo nevojitet.

Neni 37.

Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Ekzekutiv Rajonal mbeten në ato funksione deri në zgjatjen e mandatit të Këshillit Rajonal, e kur aiskadon ata kryejnë vetëm detyra rutine derisa Këshilli i ri nuk e emëron kryetarin dhe anëtarët e Këshillit Ekzekutiv.

Neni 38.

Këshilli Rajonal e shkarkon kryetarin e Këshillit Ekzekutiv Rajonal ose funksionarët të cilët nuk i kryejnë detyrat e veta të rregulluara me ligj.

Nëse Këshilli Rajonal nuk i kryen funksionet e veta ai shpërndahet në bazë të dispozitave të nenit 33.

Neni 39.

Në qoftëse për shkak të vdekjes, dorëheqjes ose shkarkimit të Këshillit Ekzekutiv Rajonal ose të funksioneve të tij, lypset zëvendësimi i tyre, kurse kryetari i Këshillit Rajonal e konvokon mbledhjen e tij në afatin prej 15 ditësh.

Neni 40.

Kryetari i Këshillit Ekzekutiv Rajonal e përfaqëson rajonin. Ai merrë pjesë në mbledhjet e Këshillit të Ministrave kur duhet t'i shqyrtoj çështjen që kanë të bëjnë me rajonin.

Neni 41.

Kryetari i Këshillit Ekzekutiv Rajonal i drejton funksionet administrative të cilat shteti ia delegon rajonit në harmoni me udhëzimet e qeverisë qendrore.

Neni 42.

Kryetari i Këshillit Ekzekutiv Rajonal vendos për sistemin e vëllimit të punëve të funksionarëve të përhershëm, me miratimin e dekretit i cili botohet në gazetën zyrtare rajonale.

Neni 43.

Kryetari i Këshillit Ekzekutiv Rajonal lëshon rregulla me anë të dekreteve për të cilat vendos Këshilli Ekzekutiv.

Neni 44.

Këshilli Ekzekutiv Rajonal është trup ekzekutiv i rajonit i cili është përgjegjës për:

1. shqyrtimin e normave lidhur me zbatimin e ligjeve të miratuar nga ana e Këshillit Rajonal;
2. administrimin e çështjeve me rëndësi rajonale;
3. administrimin e pasurive të rajonit me kontrollin e drejtorive të shërbimeve publike rajonale të natyrës industriale ose tregtare, me anë të agjencive të veçanta;
4. detyrat tjera të cilat i janë besuar në bazë të ligjeve në fuqi apo të dekreteve tjera;
5. miratimin, në rastet e jashtëzakonshme e dispozitave në kuadër të kompetencave të Këshillit që i parashtrihen për ratifikim vetë Këshillit, në sesionin e tij të ardhshëm.

Neni 45.

Këshilli Ekzekutiv Rajonal duhet të konsultohet lidhur me formimin dhe rregullimin e komunikacioneve nacionale dhe të shërbimeve të transportit me rëndësi rajonale.

Neni 46.

Këshilli Rajonal mund t'ia delegojë zgjidhjen e çështjeve nga kompetencat e veta Këshilli Ekzekutiv rajonal, përpos kur është në pyetje nxjerrja e ligjeve.

KAPITULI II Organet krahinore

Neni 47.

Organet zyrtare të krahinës janë: Këshilli Krahinor, Këshilli Ekzekutiv Krahinor dhe kryetari i tij.

Neni 48.

Secili këshill krahinor përbëhet nga anëtarët e Këshillit Rajonal të zgjedhur në krahinën respektive; Në rast të vdekjes së kryetarit ose të dorëheqjes, Këshilli Krahinor në sesionin e ardhshëm e siguron zgjedhjen e kryetarit të ri.

Nënkryetari i ndihmon kryetarit dhe e zëvendëson në kohën e mungesës së tij ose në ndonjë rast tjetër kur ai është i penguar për të marrë pjesë në punën e Këshillit.

Neni 49.

Dispozitat e neneve 27, 28, 29, 31, 32,33 dhe 34 aplikohen në qoftë se janë kompatible me Këshillat Krahinore.

Në tridhjetë muajt e parë të aktivitetit të Këshillit Krahinor të Bolcanos, kryetari zgjidhet nga radhët

e këshilltarëve gjermanofonë, kruse nënkryetari nga radhët italofoon; në periudhën e ardhshme kryetari zgjidhet nga radhët e këshilltarëve italofoon, kurse nënkryetari nga radhët e atyre gjermanofon.

Përbërja e komisionit për krahinën Bolcano i rregulluar me nenin 33 duhet t'i përgjigjet gjuhës së bashkësive të cilat e përbëjnë popullatën e krahinës.

Neni 50.

Këshilli Ekzekutiv Krahinor i Trentos përbëhet nga kryetari dhe nga anëtarët e përhershëm e të përkohshëm të cilët zgjidhen në sesionine parë të Këshillit Krahinor me vota të fshehta.

Këshilli Krahinor vendos se cilës anëtar të Këshillit Ekzekutiv mund ta zëvendësojnë kryetarin kur mungon, ose në rastin kur është i penguar për të marrë pjesë në seancë.

Në krahinën Bolcano, Këshilli Ekzekutiv Krahinor përbëhet nga kryetari, dy nënkryetar dhe nga anëtarët e përhershëm e të përkohshëm të cilët Këshilli Krahinor i zgjedh me vota të fshehta dhe shumicë absolute.

Përbërja e Këshillit Ekzekutiv Krahinor i Bolcanos duhet t'i përgjigjet përbërjes së bashkësive etnike të përfaqësuara në Këshillin Krahinor. Njëri nënkryetar është italofoon kurse tjetri gjermanofon. Kryetari e zgjedh nënkryetarin i cili do ta zëvendësojë në rast të mungesës së tij, ose kur ai është i penguar të marrë pjesë në seancat e Këshillit.

Anëtarët e përkohshëm të Këshillit Ekzekutiv të Bolcanos i zëvendësojnë anëtarët e përhershëm në detyrat e tyre sipas bashkësisë gjuhësore të cilës i takojnë.

Neni 51.

Dispozitat e neneve 37, 38 dhe 39 janë të aplikueshme për kryetarin e Këshillit Ekzekutiv Krahinor dhe anëtarët e tij.

Neni 52.

Kryetari i Këshillit Ekzekutiv Krahinor e përfaqëson Krahinën.

Ai miraton dispozitat të mundshme të jashtëzakonshme për çështjet e sigurisë dhe të higjienës publike me interes të popullatës së dy apo më shumë "komunave".

Kryetari i Këshillit Ekzekutiv Krahinor merr vendime lidhur me sistemin e vëllimit të punëve të anëtarëve të përhershëm të Këshillit, me anë të dekretëve të shpallura në gazetën zyrtare të rajonit.

Ai merrë pjesë në mbledhjet e Këshillit të Ministrave kur i njëjti i shqyrton çështjet me interes për rajonin.

Neni 53.

Kryetari i Këshillit Ekzekutiv Krahinor me anë të dekretëve merr vendime për të cilat ka vendosur Këshilli Ekzekutiv.

Neni 54.

Këshilli Ekzekutiv Krahinor është përgjegjës për:

1. shqyrtimin e normave për zbatimin e ligjeve të cilët i ka miratuar Këshilli Krahinor;
2. shqyrtimin e normave mbi çështjet të cilat në bazë të dispozitave momentale bartën në kompetencat e krahinës;

3. administrimin lidhur me çështjet që janë me rëndësi për krahinën;

4. administratën e pasurisë së krahinës, bashkë me kontrollin e drejtorive të organizatave speciale krahinore për shërbimet publike;

5. supervizionin dhe mbrojtjen e administratave komunale, të institucioneve bëmirëse dhe të atyre për mbrojtjen sociale, të konzorciumeve dhe të autoriteteve e institucioneve tjera lokale, me të drejtë që i suspendojnë ose pezullojnë në përputhje me ligjin. Në rastet e lartpërmendura dhe në rastet kur administrata për shkaqe të ndryshme nuk është e aft për t'i kryer detyrat eveta. Këshilli Ekzekutiv Krahinor duhet patjetër t'i emëroj përfaqësuesit e plotëfuqishëm të cilët do t'i zgjedh nga bashkësia gjuhësore me numër më të madh të administratorëve në trupin më të lartë delegates.

Normat e jashtëzakonshme të lartpërmendura hyjnë në fuqi kur për këtë të vendos shteti dhe atë për shkak të rendit publi k dhe kur kanë të bëjnë me "komunat" me më shumë se 20.000 banorë.

6. detyrat tjera të besuara krahinës në bazë të këtij statuti apo të ligjeve tjera të republikës ose të rajonit;

7. miratimin në rastet e jashtëzakonshme, të dispozitave që janë në kompetencën e Këshillit, e të cilat vetë Këshilli i paraqet për ratifikim në sesionin e tij të ardhshëm.

KAPITULLI III

MIRATIMI, ZBATIMI NË VEPËR DHE SHPALLJA E LIGJEVE DHE NORMAVE RAJONALE E KRAHINORE

Neni 55.

Propozimet ligjore të cilët i miraton Këshilli Rajonal ose Këshilli Krahinor i bartë përfaqësuesit të plotëfuqishëm të qeverisë në Trento, nëse kanë të bëjnë me rajonin ose krahinën Trento dhe me përfaqësuesin fuqiplot të qeverisë në Bolcano nëse kanë të bëjnë me krahinën Bolcano. Tridhjetë ditë nga ky komunikim, këto propozimligje miratohen, përpos në qoftë se qeveria atë nuk ia kthen Këshillit Rajonal ose Këshillit Krahinor me vërejtjen se i tejkalojnë kompetencat e tyre apo janë në kundërshtim me interesat nacionale ose me interesat e njëres apo të krahinës tjetër.

Në qoftë se këto propozimligje i miraton shumica absolute e anëtarëve të Këshillit Rajonal ose të Këshillit Krahinor, ato hynë në fuqi pesëmbëdhjetë ditë pas shpalljes së tyre nga qeveria, domethënë nëse ajo në atë afat nuk e shtron pyetjen e ligjshmërisë së tyre para Gjyqit Kushtetues dhe pyetjen e konfliktit të interesit para parlamentit. Në rastet kontestuese gjyqi merr vendimin final.

Në qoftë se shumica absolute e Këshillit Rajonal apo Krahinor vendos të miratojë dhe zbatojë këto propozimligje kurse qeveria ka ra dakord me këtë, atëherë procedura e lartpërmendur nuk zbatohet.

Ligjet rajonale dhe krahinore i zbatojnë kryetari i Këshillit Ekzekutiv Rajonal ose kryetari i Këshillit Ekzekutiv Krahinor, i miraton edhe përfaqësuesi fuqiplot kompetent i qeverisë.

Neni 56.

Nëse konsiderohet se propozimligji është anues në raport me të drejtën e ndonjëres bashkësi gjuhësore dhe të karakteristikave etnike e kulturore të këtyre bashkësive, shumica e këshilltarëve të njëres bashkësi etnike në Këshillin Rajonal apo Krahinor në Bolcano, mund të kërkojë votim të veçantë.

Nëse nuk lejohet kërkesa për votim të veçantë ose në qoftë se propozimligji miratohet përkundër kundështimeve të dy të tretave të anëtarëve të bashkësisë e cila ka ushtruar kërkesën, shumica e atij grupi mund të kontestojë ligjin para Gjyqit Kushtetues në afatin prej tridhjetë ditësh nga proklamimi i tij nga shkaqet e përmendura në paragrafin e mëparshëm. Ankesa nuk ka efekt suspensiv.

Neni 57.

Ligjet dhe normat rajonale e krahinore botohen në gazetën zyrtare të rajonit në gjuhën italiane e gjermane dhe hyjnë në fuqi 15 ditë pas botimit, përpos nëse këtë ligjet e normojnë ndryshe.

Në rastet konteste, interpetimi i normave kryhet në bazë të tekstit italian. Kopja e gazetës zyrtare i dërgohet përfaqësuesit fuqiplotë të qeverisë.

Neni 58.

Ligjet dhe dekretet e republikës që kanë të bëjnë me rajonin gjithashtu botohen në gjuhën gjermane në gazetën zyrtare, me hyrjen e tyre në fuqi.

Neni 59.

Ligjet të cilat i miraton Këshilli Rajonal e Krahinor dhe normat e nxjerra nga ana e këshillave ekzekutive rajonale e krahinore, për shkak të informimit duhet të botohen në kaptinën e veçantë të Gazetës zyrtare të Republikës.

Neni 60.

Ligjet rajonale rregullojnë çështjet e referendumit lidhur me ligjet rajonale e krahinore.

KAPITULLI IV**ORGANET LOKALE***Neni 61.*

Në normat e autoriteteve lokale publike vendosen normat të cilat sigurojnë përfaqësimin proporcional të bashkësive gjuhësore në raport vetëm me konstituimin e organeve të pushtetit.

Në "komunat" e krahinës Bolcano, secila bashkësi gjuhësore ka të drejtë të përfaqësohet në organin ekzekutiv komunal (1) nëse anëtar të këshillit komunal të paktën janë dy këshilltarë që i takojnë asaj bashkësie.

(1) Giunta comunale: Këshilli ekzekutiv i "konmunave" (i qyteteve dhe i provincave urbane e rurale)

(2) Consiglio comunale: Këshilli i "komunave".

Neni 62.

Ligjet për zgjedhjen e Këshillit Rajonal dhe të Këshillit Krahinor të Bolcanos me normat për përbërjen e organeve konstituive të pushteteve lokale në krahinën Bolcano, garantojnë përfaqësimin e bashkësisë gjuhësore ladine.

Neni 63.

Për t'u zbatuar e drejta aktive zgjedhore për zgjedhjen e këshillave komunale në krahinën Bolcano, aplikohen normat e përmendura në pasusin e fundit të nenit 25.

Neni 64.

Përgjegjësia e shtetit është që të organizojë dhe disiplinojë autoritetet publike të cilët operojnë madje edhe jashtë rajoneve.

Neni 65.

Vetë "komunat" e organizojnë personelin e tyre në "komuna" dhe miratojnë norma lidhur me këtë, e krahas kësaj i përbahen parimit të përgjithshëm të ligjeve të miratuara rajonale.

KAPITULLI V**PRONËSIA DHE PASURIA E RAJONEVE DHE E KRAHINAVE***Neni 66.*

Rrugët, autostradat, hekurudha dhe ujësjellësi në rajon, të caktuar në rregullat për implementimin e këtij statuti, e përbëjnë pronësinë rajonale.

Neni 67.

Pyjet shtetërore në rajon, minierat, gurëthyerjet dhe xeheroret që i janë marrë pronarit, ndërtesat që shfrytëzohen për kancelari publike rajonale me të gjitha mobiljet e veta dhe pronësia tjetër e destinuar për servis publik rajonal, paraqesin pasurinë e patjetërsueshme të rajonit.

Pasuria shtetërore në rajon bartet në pronësi të rajonit.

Shteti i cakton kushtet për transferin e pasurisë së lartë përmendur në rregullat e veta për implementimin e ligjit në fuqi.

Pasuria rajonale e cila nuk ka pronar bëhet pronësi e rajonit.

Neni 68.

Krahinat, duke marrë parasysh kompetencat e tyre të reja në territorin e vet, e marrin pasurinë dhe pronësinë shtetërore, përpos pasurisë ushtarake, të shërbimeve nacionale dhe çështjet që janë në kompetencën rajonale.

KAPITULLI VI**FINANCAT RAJONALE E KRAHINORE***Neni 69.*

Rajonit i takojnë të ardhurat nga tatimet e pasurisë hipotekare të cilat grumbullohen nga pasuria që gjendet në territorin e tij.

Kuotat e mëposhtme të fitimeve shtetërore nga tatimet gjithashtu u takojnë rajoneve:

a) 9/10 nga tatimet mbi trashëgiminë, donacionet dhe vlera neto totale e trashëgimisë;

- b) 2/10 e tatimit të përgjithshëm mbi të ardhurat në shkallë rajonale, shuma neto e kuotave të cilat sipas ligjit u takojnë autoriteteve lokale;
- c) 9/10 e të ardhurave nga lotaria - neto fitimet.

Neni 70.

Të ardhurat nga tatimi mbi shpenzimin e gazit dhe të energjisë që grumbullohet në territorin e krahinës u takojnë krahinave.

Neni 71.

Në bazë të ligjit shteti ia lejon 9/10 e kësteve vjetore krahinës për koncesionet ekzistuese për derivacionet e mëdha të ujërave publike në territorin e saj për çka është arritur pëlqimi ose kjo do të arrihet më vonë.

Neni 72.

Rajoni mund të imponojë tatimin "turistik".

Neni 73.

Rajoni gëzon të drejtën ligjore për ta imponuar tatimin në bazë të pasimit të sistemit fiskal shtetëror dhe të imponojë ekstra tatimin mbi tokën dhe ndërtesat.

Krahinat gëzojnë të drejtën që të caktojnë tatime më të mëdha nga ato që i ka normuar rajoni, por në suzat e kufizimeve të normuara me ligjin rajonal të përmendur në pasusin e mëparshëm.

Neni 74.

Rajoni dhe krahinat kanë të drejtë të japin hua dhe kredi ekskluzive të garantuar (të cilat nuk i tejkalojnë të ardhurat e zakonshme), me qëllim të përmirësimit të investimeve në punët afatgjata.

Neni 75.

9/10 e tatimit mbi të ardhurat nga tokat dhe ndërtesat si dhe nga të ardhurat bujqësore të territoreve krahinore, u takojnë vetë krahinave.

Neni 76.

9/10 e tatimit mbi të ardhurat të grumbulluara në territoret e krahinave, u takojnë vetë krahinave.

Kur është fjala të kompanitë industriale e krahinore të cilat kanë fabrika dhe stabilimente në njërin krahinë të rajonit por selitë i kanë në krahinën tjetër ose në shtetin tjetër, me rastin e vlersimit të të ardhurave nga kapitali duhet të përcaktohen edhe kuotat e fitimeve të fituara në bazë të aktiviteteve të ndryshme të vetë fabrikave dhe stabilimenteve.

Tatimet mbi kuotat e përmendura të fitimeve shënohen në librat zyrtare të organeve tatimore në provincën në të cilën gjendet fabrika ose stabilimentet, dhe ato i mbledhë krahina në shumën e përmendur në pasusin e parë të këtij paragrafi.

Përcaktimi i kuotave të fitimeve duhet të bëhet edhe për aktivitetet e fabrikave dhe të

stabilimenteve të cilat gjenden në rajon, por të cilat i drejtojnë kompanitë selia e të cilave gjendet në të. Tatimet nga ato kuota i mbledh shteti, kurse ato regjistrohen në librat zyrtarë të organeve tatimore të provincës në të cilën gjenden fabrikat dhe stabilimentet.

9/10 të tatimeve mbi të ardhurat e nëpunësve të kompanive industriale e tregtare të përmendura në pasusin e mëparshme, të cilat operojnë në territoret e krahinave, gjithashtu u takojnë vetë krahinave.

Neni 77.

Kuotat e mëposhtme të tatimeve shtetërore mbi të ardhurat urbane në territoret e krahinave u takojnë vetë krahinave:

a) 9/10 e tatimit progresiv komplementar mbi të ardhurat e përgjithshme, të tatimit të kompanive dhe tatimeve mbi fletëobligacionet;

b) 9/10 e tatimeve të regjistrimit dhe të markave të taksave me tatimin e koncesional të qeverisë;

c) 9/10 e neto tatimeve të udhëtimit për automjetet e regjistruara në territorin e krahinave, sipas ligjit u takon krahinave.

Neni 78.

Për t'u pështatur financat e krahinave lidhur me arritjen e qëllimeve të dëshiruara dhe për ushtrimin e funksioneve të normuar me ligj, secila krahinë autonome ka të drejtë në kuotën e shumës së përgjithshme tatimore e cila mblidhet në bazë të të ardhurave në rajon dhe në bazë të tatimeve afariste, të cilat nuk janë përmendur në nenin e mëparshme. Kur caktohen kuotat e përmendura (në bazë të parametrave të popullatës dhe territorit), merret parasysh edhe shpenzimi i intervenimit të përgjithshëm të shtetit në pjesën tjetër të territorit nacional, në provincat e njëjta ku kompetencat i kanë krahinat. Në rastin e caktimit të kuotave për krahinën Bolcano, merren parasysh përgjegjësitë speciale të krahinës ndaj personelit administrativ nëpër shkolla. Këto kuota caktohen njëherë në vit në marrëveshje midis qeverisë dhe kryetarit të Këshillit Ekzekutiv Krahinor.

Neni 79.

Neni 119, paragrafi tre i Kushtetutës, gjithashtu ka të bëjë edhe me Krahinat Autonome Trento dhe Bolcano.

Neni 80.

Krahina ka kompetencat legjislative në kuadër të limitit të vendosura me nenin 5., do me thënë kompetencat për t'i drejtuar financat lokale.

Neni 81.

Me qëllim të kënaqjes së nevojave dygjuhësore, krahina e Bolcanos mund të ndajë kuotën integrative për "komunat".

Në rastet e jashtëzakonshme kur financat e "komunave" duhet t'u përshtaten arritjes së qëllimeve dhe ushtrimit të funksioneve të vendosura me ligj, Krahina e Trentos dhe Bolcanos gjithashtu mundën të ndajnë kuota "integrative" për "komunat".

Neni 82.

Rajonet dhe krahinat mund të mbikqyrin operacionet e vlerësimeve që kryen organi tatimor i shtetit dhe atyre t'u japin të dhëna dhe informacione.

Këto kancelari detyrimisht duhet të sillen në përputhje me dispozitat e miratuara, pas dërgimit të informacioneve rajonet dhe krahinës.

Neni 83.

Rajoni, krahinat dhe "komunat" kanë buxhetin e vet për vitin financiar i cili përputhet me vitin solar.

Neni 84.

Buxhetet që i përgatisin këshillat ekzekutive rajonale e krahinore dhe gjendjen financiare të llogarive, me raportin e Këshillit, i lejojnë ligji rajonal dhe krahinor.

Votimi për çdo kapitull të buxhetit të rajonit ose krahinës së Bolcanos me kërkesë të shumicës së një bashkësie gjuhësore bëhet në suazat e vetë bashkësisë.

Pjesët e buxhetit që nuk kanë fituar shumicën e votave të secilës bashkësie gjuhësore, i paraqiten pas tri ditësh komisionit të cilin e përbëjnë katër këshillëtar rajonal e krahinor, të zgjedhur nga ana e Këshillit në fillim të mandatit të tij për tërë afatin e tij. Dy këshilltarë e përfaqësojnë grupin italoфон kurse dy të tjerë atë gjermanofon.

Komisioni i përmendur në pususin e mësipërm në afatin prej 15 ditësh duhet të kryej denominimin final të pjesëve dhe shumën e alokacioneve relative, me kusht që vendimi i tillë i tij të bëhet obligativ për Këshilin. Ky vendim pastaj miratohet me shumicën e thjeshtë, sepse vota e asnjërit këshilltar nuk mund të mbipeshojë.

Nëse komisioni nuk e arrinë shumicën lidhur me propozimin final, kryetari i Këshillit Rajonal ose Krahinor atëherë në afatin prej shtatë ditësh ia dërgon projektbuxhetin dhe gjithë dokumentacionin dhe procesverbalin e diskutimeve të zhvilluara në Këshill dhe në Komision - degës autonome të gjyqit rajonal të drejtës administrative të Bolcanos, i cili në afatin prej 30 ditësh duhet të vendos me anë të arbitrazhit mbi denominimin e pjesëve (kaptinave) të palejueshme dhe shumën e alokacioneve.

Procedura e lartpërmendur nuk aplikohet për pjesët hyrëse, për pjesët e shpenzimeve që i mbajnë alokacionet të cilat do të futen në bazë të dispozitave të veçanta ligjore në shumën e caktuar paraprakisht për vitin financiar, dhe në pjesët që kanë të bëjnë me shpenzimet normale të punës së organeve dhe të kancelarive të pushtetit.

Vendimet e përmendura në paragrafin katër dhe pesë të këtij neni nuk mund të jenë objekt i ndonjë kontesti apo i ankesës në Gjyqin Kushtetues.

Duke përjashtuar pjesët (kaptinat) e definuara me procedurën e përmendur në pasusin e mësipërm, ligji me të cilin lejohej buxheti i qeverisë mund të shtyhet ose të kontestohet vetëm në bazë të pohimeve se ai paraqet shkeljen e kushtetutës ose të këtij statuti.

Epilogu i volitshëm i votimit të shumicës së këshilltarëve të krahinës në Trentos dhe Bolcanos është i nevojshëm për akordimin e buxhetit dhe të deklaratave financiare e të gjendjes së rajonit. Nëse nuk arrihet shumica, atëherë organi rajonal jep lejen e nevojshme. Ky organ nuk mund të modifikojë vendimet që kanë të bëjnë me pjesët (kaptinat) buxhetore të cilat mund të kontestohen në bazë të dispozitave të paragrafit 3.4 dhe 5 të këtij neni dhe t'i definojë në bazë të procedurës që ai e parashikon.

Neni 85.

Ndonëse tregita e jashtme është objekt i kufizimit dhe i akordimeve shtetërore, rajoni ka fuqi të lejojë operacione të tilla në kuadër të marrëveshjes së arritur midis qeverisë dhe rajonit.

Në rastin e tregtisë së jashtme e cila mbështete në kuotat që e godasin ekonomin rajonale, rajonit mund t'i ndahet pjesa e kuotës importuese-eksportuese e cila vendoset me anë të marrëveshjes së përbashkët midis qeverisë e rajonit.

Neni 86.

Dipozitat e përgjithshme shtetërore mbi kontrollin e valutave vlejné edhe në rajon.

Mirëpo, megjithatë, për hirë të kënaqjes së nevojave importuese të rajonti, shteti siguron kuotën e cila paraqet dallim aktiv midis valutave që arrijné nga operacionet valutore të importit e eksportit.

KAPITULLI VII

MARRËDHËNIET MIDIS SHTETIT, RAJONIT DHE KRAHINËS

Neni 87.

Në kuadër të territorit rajonal emërohet përfaqësuesi i plotfuqishëm i shtetit për krahinën e Trentos dhe ai për krahinën e Bolcanos. Ata kanë këto detyra:

- 1) që të koordinojnë, në përputhje me direktivat e qeverisë, ushtrimin e funksioneve shtetërore në krahinë dhe ta mbikqyrin punën e kancelarive, përpos të atyre që merren me administrimin e drejtësisë, mbrojtjes dhe të hekurudhave;
- 2) të mbikqyrin kryerjen e funksioneve të cilat i delegon shteti në krahina dhe autoritetet tjera lokale publike dhe t'ia paraqesin për këtë raportin kryetarit të Këshillit Ekzekutiv Krahinor;
- 3) të ushtrojë detyrat që dikur i ka ushtruar prefekti i rrethit, në qoftë se ato në bazë të këtij statuti apo të ligjeve tjera nuk janë ndarë trupave rajonale apo krahinore ose trupave tjera të shtetit;
- 4) I plotfuqishmi i shtetit për Tronton i kryen detyrat e përmendura në numrin dy të pasusit të mësipërm nga aspekti i rajonit dhe të pushtetit tjetër lokal me kompetenca mbi tërë rajonin.

Neni 88.

I plotfuqishmi i shtetit siguron mbajtjen e rendit publik dhe i përgjigjet Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Për këtë qëllim ai mund t'i shfrytëzojë organizatat shtetërore dhe forcat policore dhe të kërkojë përdorimin e forcave të tjera të armatosura në bazë të ligjit në fuqi dhe të miratojë dispozita të normuar me nenin 2, të Ligjit mbi konsolidimin e sigurisë publike.

Detyrat të cilat me anë të ligjit barten në Ministrinë e Punëve të Brendshme mbeten në fuqi.

KAPITULLI VIII**KATEGORITË E PERSONELIT NË KANCELARITË BOLCANOS***Neni 89.*

Krahina Bolcano ka kategorinë e personelit me struktura të ndryshme të karrierës, në kuadër të kancelarive të shërbimeve publike në Krahinë. Këto kategori caktohen në bazë të vetë personelit të kancelarisë, kurse formohen në bazë të normave përkatëse në rastet kur ndihej nevoja.

Pasuri i mësipërm nuk aplikohet në rastet e karrierve prej menaxheri në shërbimet publike, të nëpunësve të sigurimit publik dhe ndaj pesonelit të Ministrisë së Mbrojtjes.

Vendet administrative dhe prej karriere të përmendura në pasusin e parë janë të rezervuar për qytetarët pjesëtarë të tri bashkësive gjuhësore në proporcion me madhësinë e këtyre bashkësive të cilat zbulohen me anë të regjistrimit zyrtar të popullatës.

Vendet e rezervuara për gjermanofonët dhe ladinofonët plotësohet gradualisht gjithnjë derisa të mos arrihet kuota e përmendur në pasusin e mëparshëm me anë të emërimeve në vendet e zbrazëta për çfarëdo arsye.

Mandatet e sigurta në krahinë janë të siguruar për vendet e përmendura në pasusin e parë për ata të cilët për nga natyra e shërbimit të vet ose të karrierës i nënshtrohet transferimit ose aftësimi të mëtejshëm

Transferët e personelit gjermanofon, ndërkaq do të kufizohet në 10% nga numri i përgjithshëm i vendeve që i zen ai personel.

Dispozitat mbi rezervimin dhe ndarjen proporcionale të vendeve midis sektorit gjermanofon dhe ai talofon të Krahinës Bolcano, kanë të bëjnë edhe me personelin gjuhësor dhe me prokurorët e magistraturave. Mandati i sigurt i është siguruar krahinës për gjyqëtar të cilët flasin gjermanisht, sepse normat gjyqësore mbi inkompatibilitetin ende janë në fuqi. Kriteret për ndarjen e vendeve të rezervuara për qytetarët gjermanofon, të parapërcaktuara në pasusin e katërt të këtij neni, gjithashtu kanë të bëjnë edhe me personelin në magistraturat e Krahinës Bolcano.

KAPITULLI IX**ORGANET GJYQËSORE***Neni 90.*

Në bazë të normave në Trento-Alto Adige ekziston gjyqi rejonal i drejtësisë administrative me degët autonome për krahinën Bolcano.

Neni 91.

Anëtarët e degës së gjyqit të krahinës Bolcano të përmendur në nenin 90, të këtij Statuti, duhet t'u takojnë me numër të barabartë të dy bashkësive kryesore gjuhësore.

Këshilli Krahinor i Bolcanos, e zgjedh gjysmën e anëtarëve të kësaj dege. Gjyqëtarët italofojnë dhe gjermanofonë alternohen në periudhën e njëjtë kohore në vendin e kryetarit të degës. Kryetari zgjidhet midis gjyqëtarëve prej karriere me dekretin e kryetarit të Republikës dhe në bazë të rekomandimit të kryeministrit.

Kryetari i kësaj dege ka votën vendimtare në rastet kur gjatë votimit krijohet patpozicioni midis votave të gjyqëtarëve të dy bashkësive gjuhësore, përpos në rastet kur paraqitet ankesi kundër dispozitave administrative të dëmshme për parimet e barazisë midis gjuhëve të bashkësive në fjalë dhe procedurës për akordimin e buxhetit rajonal e krahinor.

Neni 92.

Ligjet administrative të autoriteteve apo organeve të shërbimeve publike në rajon të cilat konsiderohen të dëmshme për parimin e barazisë qytetare, këshillëtarët rajonal apo krahinorë mund t'i kontestojnë para degës autonome të gjyqit rajonal të drejtësisë administrative të Krahinës Bolcano, ose në rast se dispozitat e "komunave" të krahinës Bolcano para të njëjtës degë i kontestojnë këshillëtarët e qytetit të provincës kur është konfirmuar se ajo "dëmshmeri" është pranuar nga ana e shumicës së bashkësië gjuhësore e cila konsiderohet palë e dëmtuar.

Neni 93.

Këshillëtari gjermanofon nga Krahina Bolcano merr pjesë në mbledhjet e Këshillit të shtetit në të cilat debatohet për zgjidhjen e ankesave kundër vendimit të degës autonome të gjyqit rajonal të drejtësisë administrative të Bolcanos, të përmendur në nenin 90, të këtij statusi.

Neni 94.

Emërimi, pensionimi, pezullimin dhe largimi nga puna të personelit gjyqësor e bënë kryetari i Këshillit Ekzekutiv Rajonal në bazë të lejës së kryetarit të Republikës, me ç'rast respektohen edhe normat tjera nga ana e organeve gjyqësore.

Kryetari i Këshillit Ekzekutiv Rajonal jep autorizime që në vendet e praktikantëve gjyqësor dhe udhëheqësve të kancelarive për caktimin e të drejtës qytetare të vinë ata që kanë kualifikime të normuara nga ana e organeve gjyqësore.

I njëjti kryetar siguron revokimin e suspendimit të përkohshëm të kompetencave në rastet të cilat i kanë normuar organet gjyqësore.

Në "komunat" e krahinës së Bolcanos, personat që dëshirojnë të emërohen për gjyqëtarë, zëvendës të gjyqëtarëve, ndihmësa dhe praktikantë, si dhe për udhëheqës të kancelarive për përcaktimin e të drejtës qytetare, duhet të flasin shkëlqyeshëm gjuhën italiane dhe gjermane.

Neni 95.

Këshilli Ekzekutiv Krahinor mbikëqyr punën e kancelarisë për parapërcaktimin e të drejtës qytetare.

Neni 96.

Në bazë të ligjit krahinor, degët e veçanta gjyqësore dhe kancelaritë mund të formohen në "komunat" e ndara në paralagje dhe fshatra.

KAPITULLI X**KONTROLLI I GJYQIT KUSHTETUES***Neni 97.*

Dispozitat e formuluar në nenet 56 dhe 84, pasusi i gjashtë e i shtatë i këtij statuti e që ende janë në fuqi në bazë të ligjit rajonal apo krahinor, mund të kontestohen para Gjyqit Kushtetues për shkak të shkeljes së kushtetutës, të këtij statuti ose të parimeve të barazisë midis gjuhëve të bashkësisë.

Kontestin mund ta iniciojë edhe qeveria.

Ligji rajonal gjithashtu mund të kontestohet nga ana e njërit këshill krahinor të rajonit. Ligji krahinor mund të kontestohet nga ana e Këshillit Rajonal apo të këshillave të tjera krahinore të rajonit.

Neni 98.

Ligjet e republikës dhe ato akte që kanë fuqinë e ligjit mund të kontestohen nga ana e Kryetarit të Këshillit Ekzekutiv Rajonal ose nga kryetari i Këshillit Ekzekutiv Krahinor, për shkak të shkeljes së statutit ose të parimit të mbrojtjes së pakicave gjuhësore gjermane e ladine, nëse ato këshilla vendosin ashtu.

Ankesën e paraqet kryetari i Këshillit Ekzekutiv Rajonal ose kryetari i Këshillit Ekzekutiv Krahinor nëse ato këshilla marrin një vendim të atillë.

Kopjet e ligjeve të kontestuara dhe të ankesave duhet t'i dërgohen të plotëfuqishmit qeveritar në Trento në qoftë se ky rast ka të bëjë me rajonin ose krahinën Trento, ose të plotëfuqishmit qeveritar në Bolcano nëse rasti i përket krahinës së Bolcanos.

KAPITULLI XI**SHFRYTËZIMI I GJUHËS GJERMANE DHE LADINE***Neni 99.*

Në kuadër të rajonit njihen në mënyrë të barabartë gjuha gjermane e italiane si gjuhë zyrtare të shtetit. Gjuha italiane njihet zyrtarisht në dokumentet ligjore dhe në rastet kur ky statut parashikon verizonin dygjuhësor.

Neni 100.

Popullata gjermanofone e krahinës së Bolcanos, ka të drejtë ta shfrytëzojë gjuhën e vet në kontakt me organet gjyqësore, me organet në kancelaritë e shërbimeve publike në krahinë, në organet rajonale, si edhe me bartësit e koncesioneve të shërbimeve publike në krahinë.

Në mbledhjet e përbashkëta të organeve të rajonit, të Krahinës së Bolcanos dhe me autoritetet lokale në atë krahinë, mund të shfrytëzohen gjuha italiane dhe gjermane.

Kancelaritë, organet dhe bartësit e koncesioneve të përmendura në pasusin e parë e shfrytëzojnë gjuhën e paraqitësit të lutjes dhe i përgjigjen në gjuhën në të cilën janë dërguar dokumentet nga kancelaritë dhe organet tjera, si dhe me rastin e letërkëmbimit dhe raportet gojore; nëse dërgohet "ex officio", letërkëmbimi është i shkruar në gjuhën për të cilën supozohet se është gjuhë e qytetarëve të

cilëve u është drejtuar.

Përveç kur normat urdhërojnë që të dy gjuhët të shfrytëzohen në dokumentet destinuar qytetarëve në përgjithësi, në dokumentat individuale destinuar përdorimit publik dhe në dokumentat destinuar për nevoja të ndryshme, përdorimi i njëres apo gjuhë tjetër është i lejueshëm. Në normat ushtarako-juridike shfrytëzohet gjuha italiane.

Neni 101.

Në krahinën e Bolcanos, shërbimet publike duhet të shfrytëzojnë emrat gjermanë të vendeve duke marrë parasysh popullatën gjermanofone, nëse ligji krahinor e ka pohuar ekzistimin e asaj popullate dhe e ka lejuar atë pretekst.

Neni 102.

Popullata ladine ka të drejtën për formimin e firmave të veta personale, të drejtën për aktivitete kulturore, mediale e rekreative dhe për respektimin e emërave të vendeve e të traditave të veta.

Në shkollat "e komunave" të krahinës së Trentos në të cilat flitet gjuha ladine, është siguruar mësimi në këtë gjuhë dhe ruajtja e kësaj kulture.

KAPITULLI XII**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE***Neni 103.*

Procedura kushtetuese e parashikuar për ligjet kushtetuese aplikohet për modifikimin e ligjit të tashëm.

Këshilli rajonal është gjithashtu përgjegjës për revizionim.

Neni 104.

Dispozita që e përmban neni i mëparshëm mbetet në fuqi, kurse dispozitat e kapitullit VI dhe neni 13 mund të modifikohen me anë të ligjit të zakonshëm shtetëror, në qoftë se këtë me marrëveshje e kërkojnë qeveria, rajoni dhe dy krahinat.

Dispozitat e përmendura në nenet 30 dhe 49, lidhur me shkarkimin e kryetarit të Këshillit Rajonal dhe të kryetarit të Këshillit Krahinor të Bolcanos, mund të midifikohen me anë të ligjit të zakonshëm shtetëror, nëse këtë me marrëveshje e kërkojnë qeveria, rajoni dhe krahina e Bolcanos.

Neni 105.

Ligjet e shtetit aplikohen kur është fjala për çështjet nën kompetencat e rajonit e të krahinës, gjithnjë derisa normat e reja nuk futën në ligjet rajonale e krahinore.

Neni 106.

Ndaj çështjeve të cilat barten nga kompetencat e rajonit në kompetencat e krahinës, do të aplikohen ligjet rajonale të cilët kanë qenë në fuqi kur është miratuar Ligji kushtetues, më 10 nëntor të vitit 1971, gjithnjë derisa ligji krahinor nuk i miraton normat e reja.

Neni 107.

Në dekretin ligjor, pas konsultimeve me komisionin e përbashkët prej 12 anëtarëve, nga të cilët gjashtë e përfaqësojnë shtetin, 2 Këshillin Rajonal, 2 Këshillin Krahinor të Trentos dhe 2 - Këshillin Krahinor të Bolcanos, do të nxirren rregullat për implementimin e këtij statuti. Tre anëtarë të Këshillit duhet t'i përkasin bashkësisë gjermanofone.

Në kuadër të komisionit të përmendur në pasusin e mësipërm formohet komisioni special për rregullat e implementimit që kanë të bëjnë me çështjet që i janë ndarë kompetencave të Krahinës së Bolcanos. Ky komision i dytë do të ketë gjashtë anëtarë, nga të cilët tre e përfaqësojnë shtetin, kurse tre të tjerë krahinën. Njëri nga anëtarët e komisionit i cili do ta përfaqësojë shtetin duhet të jetë gjermanofon, kurse njëri nga anëtarët i cili duhet ta përfaqësojë krahinën lypset të jetë italofoon.

Neni 108.

Përpos në rastet tjera të përmendura prerë, dekretet ligjore të cilat mbajnë rregullat për implementimin e statutit, do të nxirren në fatin prej dy vitesh nga hyrja në fuqi e Ligjit Kushtetues nga 10 nëntori i vitit 1971, nr.1.

Në qoftë se gjatë 18 muajve të parë komisionet e përmendura në nenin e mëparshëm nuk kanë paraqitur plotësisht ose pjesërisht mendimin e tyre definitiv mbi rregullat për implementimin e propozimeve ligjore, qeveria gjashtë muaj pas shpalljes së këtyre dekreteve, do të nxjerrë rregullat e përmendura pa marrë parasysh mendimet e vetë komisioneve.

Duke marrë parasysh faktin se normat për implementimin e rregullave duhet të nxirren në afatin prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të Ligjit Kushtetues, nga 10 nëntori i vitit 1971, nr.1, caktohet që pasuria e përmendur në nenin 68 të këtij statuti në afatin e njëjtë të kalojë në kompetencat e Krahinës.

Neni 109.

Duke marrë parasysh faktin se dispozitat për implementimin e rregullave duhet të nxirren në afatin prej një viti nga hyrja në fuqi e Ligjit Kushtetues, nga 10 nëntori i vitit 1971, nr.1, thesari historik dhe kulturor dhe pasuria me interes nacional, pushojnë të bëjnë pjesë në kompetencat e Krahinës, të përmendura në nenin 8, nr.3, të këtij statuti.

Në periudhën e njëjtë nxirren rregullat e implementimit të nenit 19 të këtij statuti.

Në qoftë se normat e përmendura në pasusin e mësipërm nuk nxirren në afatin e parashikuar, krahinat në bazë të ligjit mund të marrin mbi vete kancelaritë administrative.

Neni 110.

Data e hyrjes në fuqi dhe terminet teknike për aplikimin e normave financiare që i mbanë Ligji Kushtetues nga 10, nëntori i vitit 1971, nr.1, me të cilën plotësohen dhe modifikohen normat e Ligjit Kushtetues nga 26 shkurti i vitit 1948 nr.5, përcaktohen në bazë të rregullave të implementimit të cilat do të nxirren me kohë për të mundur transferin e kancelarive në krahinë dhe gjithësesi jo më vonë nga data e skadimit të përmendur në pasusin e parë të nenit 108 të këtij statuti.

Neni 111.

Lidhur me transferin e kompetencave nga rajoni në Krahinë, në bazë të Ligjit Kushtetues nga 10 nëntori i vitit 1971, nr.1, transferi i kancelarive dhe i personelit nga rajoni në krahinë urdhërohet me dekretin e kryetarit të Këshillit Ekzekutiv Rajonal, pas konsultimeve paraprake me Këshillin Ekzekutiv

Krahinor, pa dëmtimin e pozitave dhe të fitimeve të personelit të transferuar dhe duke respektuar situata e tyre familjare, banesore dhe gjuhësore.

Neni 112.

Konventat e nënshkruara midis rajonit e krahinës sigurojnë rregullimin e çështjeve financiare që kanë të bëjnë me huat shumëvjeçare të parashikuara për kompetencat e bartura me Ligjin Kushtetues nga 10 nëntori i vitit 1971, nr.1, nga rajoni në krahinë dhe rregullimin e marrëdhënieve të tjera të trashëguara financiare.

Neni 113.

Dispozitat që i mbanë Ligji nga 5 janari i vitit 1958, nr.1 të Krahinës së Bolcanos, që kanë të bëjnë me ndihmën studentëve të universiteteve, mbetën në fuqi, përpos që në kompetencat e krahinës mbetet revidimi i shumës së ndihmës dhe numri i burseve.

Neni 114.

Përkthimi në gjermanisht i Ligjit të Konsolidacionit lidhur me statusin special të rajonit të Trento-Aldo Adigjes, do të botohet në "Gazetën zyrtare" të rajonit.

Neni 115.

Dispozitat e përmendura në nenin 25, pasusi 2 dhe 4 të këtij statuti, aplikohen nga dita e parë me skadimin e mandatit të Këshillit Rajonal dhe nga dita e hyrjes në fuqi të Ligjit Kushtetues nga 10 nëntori i vitit 1971, nr.1.

d) 1497 (XV) STATUSI I BANORËVE TË CILËT FLASIN GJERMANISHT NË KRAHINËN E BOLCANOS (BOZEN): ZBATIMI I MARRËVESHJES SË PARISIT TË NËNSHKRUAR MË 5 SHTATOR TË VITIT 1946.

Asambleja e përgjithshme,

Pasi të shqyrtojë kapitullin e 68 të rendit të ditës,

Duke marrë parasysh faktin se statusi i banorëve gjermanofon të krahinës së Bolcanos (Bozen) është rregulluar me marrëveshje ndërkombëtare të cilën e kanë nënshkruar Italia e Austria në Paris më 5 shtator të vitit 1946 (1), dhe meqenëse me marrëveshjen e përmendur vendoset sistemi i cili garanton banorëve gjermanofonë të kësaj krahine "të drejtat plotësisht të njëjta çfarë i shfrytëzojnë edhe banorët të cilët flasin italisht në kuadër të normave të veçanta, qëllim i të cilave është ruajtja e karkaterit etnik dhe e zhvillimit kulturor e ekonomik të gjermanofonëve", e duke pasur parasysh se Austria e Italia kanë pasur kontest lidhur me zbatimin e marrëveshjes së përmendur, dhe me dëshirë që të pengohet që situata e krijuar pas këtyre kontesteve t'i prish marrëdhëniet miqësore midis dy vendeve,

1) Kërkon nga të dy palët e përmendura që t'i vazhdojnë negociatat me qëllim të gjetjes së zgjidhjes për të gjitha mospajtimet lidhur me zbatimin e Marrëveshjes së Parisit, të nënshkruar më 5 shtator të vitit 1946;

2) Rekomandon që, në rast se negociatat e përmendura në pasusin një nuk sjellin rezultate të kënaqshme në afatin e logjikshëm kohor, të dy palët t'i shqyrtojnë mundësitë për të kërkuar zgjidhje me anë të ndonjë mjeti tjetër, sipas zgjedhjes së tyre personale.

3) Gjithashtu rekomandohet që vendet e përmendura të përmbahen nga çfarëdo aksioni i cili do të kishte mundësi të prishte marrëdhëniet e tyre miqësore.

909 Mbledhja plenare

31, tetor 1960.

e) 1661 (XVI): STATUSI I BANORËVE QË FLASIN GJERMANISHT NË KRAHINËN E BOLCANOS (BOZEN)

Asambleja e përgjithshme,

Duke iu referuar rezolutës së vet 1497 (XV) nga 31 tetori i vitit 1960, vërenë me kënaqësi se të dy palët e interesuara i kanë filluar negociatat, por vërenë më tutje se kontesti ende nuk është zgjidhur, prandaj i fton të dy palët që të bëjnë përpjekje edhe më të madhe për gjetjen e zgjidhjes në përputhje me qëndrimet 1, 2 dhe 3 të Rezolutës së lartpërmendur.

1067, Sesioni plenar

28 nëntor 1961

2. SPANJA

PJESË NGA KUSHTETUTA E VITIT 1978

Dispozitat paraprake

Neni 1.

Spanja me këtë Kushtetutë inaugurohet si shtet social e demokratik i nënshtruar sundimit të së drejtës, që si vlerë të lartë të sistemit të vet juridik e shpallë lirinë, drejtësinë, barazinë dhe pluralizmin politik.

Sovraniteti kombëtar, nga i cili rezultojnë kompetencat e shtetit, i takon popullit spanjoll.
Forma e sundimit politik të shtetit spanjoll është monarkia parlamentare.

Neni 2.

Kushtetuta mbështetet në unitetin e pashkëputshëm të kombit spanjoll dhe të vendit të përbashkët e të pandashëm të të gjithë spanjollëve; kushtetuta e njeh dhe e garanton të drejtën për autonomi të nacionaliteteve e të rajoneve nga të cilët përbëhet vendi si dhe solidaritetin midis gjithë atyre.

Neni 3.

Gjuha zyrtare spanjolle e shtetit është gjuha kastiljane. Të gjithë spanjollës kanë detyrim që atë ta njohin dhe ta përdorin drejtë.

Gjuhët tjera spanjolle gjithashtu do të jenë zyrtare në bashkësitë e caktuara autonome në harmoni me statutet e tyre.

Bagëtia e variacioneve të ndryshme gjuhësore të Spanjës është thesar kulturor i cili do të jetë objekt i respektimit dhe i mbrojtjes së veçantë.

PJESA VIII - ORGANIZIMI TERRITORIAL I SHTETIT

KREU I PARË: PARIMET E PËRGJITHSHME

Neni 137.

Shteti është i organizuar territorialisht në komuna, provinca dhe bashkësi autonome të cilat mund të konstituohen. Të gjitha këto njësi do të gëzojnë vetëqeverisjen me qëllim të realizimit të interesave të tyre individuale.

Neni 138.

Shteti granaton aplikimin efikas të parimit të solidaritetit nga neni 2 i Kushtetutës, sigurimin e vendosjes së ekulibirit të drejtë dhe adekuat ekonomik midis pjesëve të ndryshme të territorit të Spanjës, e veçmas, respektimin e rrethanave që janë karakteristike për pjesët - ishuj të vendit.

Dallimet në situatat e bashkësive autonome në asnjë mënyrë nuk mund të jenë bazë për privilegje ekonomike e shoqërore.

Neni 139.

Të gjithë spanjollët kanë të drejta e obligime të njëjta në çdo pjesë të territorit të shtetit.
Asnjë pushtet nuk mund të miratojë masa të cilat drejtpërsëdrejti apo tërthorazi e kufizojnë lirinë e lëvizjes e të popullzimit të njerëzve dhe qarkullimin e mallërave në territorin spanjoll.

KREU I TRETË: BASHKËSITË AUTONOME

Neni 143.

Për realizimin e të drejtës për vetëqeverisje e cila njihet me nenin 2 të Kushtetutës, provincat fqinje me karakteristika të përbashkët historike, kulturore dhe ekonomike, territoret e ishujve dhe të provincave me status historik rajonal, mund të fillojnë realizimin e të drejtës për vetëqeverisje dhe të organizohen në bashkësi autonome, në harmoni me dispozitat që i përmban kjo kaptinë dhe statutet e tyre.

Të drejtën për ta hapur procesin drejtë vendosjes së vetëqeverisjes e kanë këshillat përkatëse të provincës, trupat mesishujve, si dhe dy të tretat e komunave, popullata e të cilave përfaqëson shumicën në njësinë zgjedhore të secilës provincë apo të ishujve. Kërkesat për vendosjen e vetëqeverisjes duhet të plotësohet në afatin prej gjashtë muajve nga arritja e marrëveshjes fillestare rreth kësaj çështjeje brenda cilësdo korporatë lokale në fjalë.

Nëse iniciativa e tillë nuk do të ketë sukses, ajo mund të inicohet sërish pas skadimit të afatit prej pesë vitesh.

Neni 144.

Parlamenti (cortes Generales), në interes dhe me anë të ligjit sistemor mund:

- (a) Të lejojë vendosjen e bashkësisë autonome me kusht që territori i saj të mos kalojë territorin e provincës dhe që ajo të mos ketë vetitë e përmendura në dispozitën 1, të nenit 143;
- (b) të lejojë apo miratojë, varësisht nga rasti në fjalë, statutin e autonomisë në territoret që e përbëjnë pjesën e organizimit të provincës,
- (c) të marrë iniciativën e korporatës lokale për të cilën flitet në dispozitën 2, të nenit 143.

Neni 145.

(1) Me asnjë kusht nuk do të lejohet formimi i federatës së bashkësive autonome.

(2) Me status mund të caktohen kushtet, kërkesat dhe afatet në të cilat bashkësitë autonome mund të arrijnë marrëveshje të ndërsjellë për administrimin dhe kryerjen e shërbimeve në çështjet që u takojnë, si dhe për natyrën dhe efektet e dokumenteve pasuese të cilat do t'ia drejtojë Parlamentit. Në të gjitha rastet tjera marrëveshjet për bashkëpunim midis bashkësive autonome duhet t'i lejojë Parlamenti.

Neni 146.

Projektstatutin e përgatit Kuvendi i përbërë nga anëtarët e Këshillit Provincial ose nga anëtarët e trupave ndërishuj të provincave në fjalë, dhe nga deputetët e senatorët e zgjedhur në territorin në fjalë, dhe ia dërgon Parlamentit që ta miratojë në formë të ligjit.

Neni 147.

(1) Për domethënien e kësaj kushtetute, statutet paraqesin rregullat themelore institucionale të secilës bashkësi autonome, kurse shteti i njeh ato dhe i mbron si pjesë përbërëse të sistemit të vetë juridik.

(2) Statutet e autonomive duhet të përmbajnë:

- (a) emrin e bashkësisë që i përgjigjet më së shumti identitetit të saj historik,
- (b) kufijtë territorialë;

(c) emrin, organizimin dhe selinë e institucioneve autonome;

(d) kompetencat që janë marë brenda suazave të caktuara me kushtetutë, si dhe kushtet themelore për bartjen e kompetencave që u takojnë.

(3) Amandamentet në statut miratohen në përputhje me procedurën e inauguruar këtu dhe për secilin rast veç e veç kërkojnë miratimin e parlamentit në formë të ligjit sistemor.

Neni 148.

(1) Bashkësia autonome mund të marrë kompetencat në këto fusha:

- (I) organizimi i institucioneve të saj të vetëqeverisjes;
 - (II) ndryshimi i kufijve komunalë në territorin e saj si dhe, përgjithësisht, të gjitha funksionet që i përkasin administrimit të shtetit në raport me korporatet lokale, bartja e të cilave do të rregullohet me legjislacion për vetqeverisjen lokale;
 - (III) rregullimi hapsinor dhe banimi;
 - (IV) punët publike në dobi të bashkësisë autonome në territorin e vet;
 - (V) hekurudhat dhe rrugët trasetë e të cilave shtrihen ekskluzivisht në territorin e bashkësisë autonome dhe komunikacionin në këto rrugë ose të teleferikëve që gjithashtu i plotësojnë këto kushte;
 - (VI) portet ajrore, portet rekreative dhe aeroportet dhe, në përgjithësi, të gjitha portet që nuk shfrytëzohen për qëllime komerciale;
 - (VII) produktet bujqësore e blektorale në përputhje me planin e përgjithshëm ekonomik;
 - (VIII) përpunimi i drurit dhe pylltaria;
 - (IX) drejtimi i punëve të mbrojtjes së ambientit të njeriut;
 - (X) planifikimi, ndërtimi dhe shfrytëzimi i projekteve hidraulike, i kanaleve, sistemeve të irigacionit që janë me dobi për bashkësinë autonome; ujrat minerale e termale;
 - (XI) peshkimi në ujërat e brendshëm, industria e prodhimit të guacave dhe bujqësia, gjuetia dhe peshkimi lumor;
 - (XII) panairët lokale;
 - (XIII) përparimi i zhvillimit ekonomik të bashkësisë autonome në kuadër të objektivave që janë përcaktuar me politikën nacional ekonomike;
 - (XIV) zëjtaria;
 - (XV) muzetë, bibliotekat dhe konzervatoriumet muzikore me interes për bashkësinë autonome;
 - (XVI) përmendoret me interes për bashkësinë autonome;
 - (XVII) avancimi i kulturës, hulumtimet dhe, kur është e aplikueshme, mësimi i gjuhës së bashkësisë autonome;
 - (XVIII) avancimi i planifikimit të turizmit në territorin e saj;
 - (XIX) avancimi i sportit dhe i argëtimit;
 - (XX) ndihma sociale;
 - (XXI) shëndeti dhe higjiena;
 - (XXII) kontrolli dhe mbrojtja e ndërtesave e të instalimeve, bashkërendimi dhe autorizimet e tjera që kanë të bëjnë me forcat policore lokale nën kushtet e caktuara me ligjin sistemor.
- (2) Pas skadimit të pesë viteve, bashkësia autonome mundet, me anë të amandamenteve, që në statusin e vet, t'i shtrijë gradualisht kompetencat e veta, por në suazat e caktuara me nenin 149.

Neni 149.

(1) Shteti i mbanë kompetencat ekskluzive në këto fusha:

- (I) rregullimi i kushteve elementare të cilat garantojnë barazinë e të gjithë spanjollëve në ushtrimin

- e të drejtave dhe në përmbushjen e obligimeve të tyre kushtetuese;
- (II) shtetësia, hyrjet e daljet nga shteti, statusi i të huajve dhe e drejta për azil;
- (III) marrëdhëniet ndërkombëtare;
- (IV) mbrojtja dhe forcat e armatosura;
- (V) organizimi i gjyqësisë;
- (VI) legjislacioni tregtar, penal e ndëshkimor; legjislacioni procesor duke respektuar format e mundshme të veçanta të aplikimit të saj që rezultojnë nga karakteristikat specifike të normave elementare të bashkësisë autonome;
- (VII) legjislacioni i punës duke respektuar të drejtat e organeve të bashkësisë autonome që ta ekzekutojë;
- (VIII) legjislacioni civil duke respektuar të drejtat e bashkësive autonome që të mbrojnë, ndryshojnë dhe zhvillojnë të drejtat civile, fueros-e dhe të drejtat speciale të cilat i kanë përcaktuar vetë në secilin nga rastet kur ato ekzistojnë; miratimin e ligjeve të cilët rregullojnë: aplikimin dhe vlefshmërinë e dispozitave ligjore, raportet e të drejtës civile që rezultojnë nga bashkëshortësia, mbajtja e librave të amzës dhe përcaktimin e instrumenteve publike, bazat e obligimeve kontraktuese, rregullat për zgjidhjen e konfliktit të ligjit dhe të caktimit të burimeve juridike në përputhje me, në këtë rast të fundit, rregullat që i përmbajnë fuerosima ose ligjet speciale;
- (IX) rregullimin e pronës intelektuale e industriale;
- (X) rregullimin e doganave dhe tatimeve; tregtia e jashtme;
- (XI) sistemin monetar: monedha e huaj këmbimi dhe konvertibiliteti; bazat e kreditimit, të bankave dhe të sigurimeve;
- (XII) rregullimin e masave dhe peshave, caktimin e kohës zyrtare;
- (XIII) bazat dhe koordinimin e planifikimit të përgjithshëm të aktiviteteve ekonomike;
- (XIV) financat e përgjithshme dhe borxhet e shtetit;
- (XV) përparimin dhe koordinimin e përgjithshëm kërkimeve shkencore e teknike;
- (XVI) masat e jashtme shëndetësore; bazat dhe koordinimin e përgjithshëm të masave shëndetësore; rregullimin e prodhimit dhe të qarkullimit të ilaçeve;
- (XVII) bazat e legjislacionit të sistemit financiar të sigurimit social pa kufizim të të drejtave për ushtrimin e këtyre shërbimeve nga bashkësitë autonome;
- (XVIII) bazat e sistemit juridik të administratës publike dhe të statusit të nëpunësve publikë të cilët në të gjitha rastet do të garantojnë se të gjithë pesonat që i takojnë asaj administrate kanë trajtim të njëjtë; procedura e përbashkët juridike, duke respektuar të drejtat për përcaktimin e formave të veçanta të organizimit të bashkësive autonome; bazat e legjislacionit mbi kontratat dhe koncesionet administrative dhe mbi sistemin e përgjegjësisë të administratës publike;
- (XIX) peshkimi detar duke respektuar autorizimet të cilat, në bazë të rregullativës në këtë sferë, do të barten në bashkësitë autonome;
- (XX) marina tregtare; portet e destinimit të përgjithshëm; aeroportet për destinim të përgjithshëm, kontrolli i hapësirës ajrore, komunikacioni ajror dhe transporti; shërbimi meteorologjik dhe regjistrimi i fluturakeve;
- (XXI) transporti hekurudhor e rrugor i cili kalon nëpër territoret e më shumë se të një bashkësie autonome, sistemi i përgjithshëm i komunikacionit, transporti me automjetet motorike, shërbimet postale e të telekomunikacionit, kabllot ajrore e nëntokësore, dhe radiolidhjet;
- (XXII) legjislacioni, rregullimi dhe koncesionet lidhur me potencialin hidroenergjetik dhe zhvillimi në ujëra që gjenden në territoret e më shumë se të një bashkësie autonome, lejimi i vendosjes së instalimeve hidroelektrike kur vendosja e tyre ka ndikim në më shumë njësi autonome ose kur përçarja e energjisë kalon nëpër territoret e më shumë bashkësive autonome;
- (XXIII) bazat e legjislacionit për mbrojtjen e ambientit duke respektuar të drejtat e bashkësive

- autonome që të caktojnë masa plotësuese mbrojtëse; bazat e legjislacionit mbi pyjet dhe blegtorinë;
- (XXIV) punët publike me dobi të përgjithshme, ose ato, pasojat e të cilave, prekin më shumë se një bashkësi autonome;
- (XXV) bazat e organizimit të xehetarisë e të energjetikës,
- (XXVI) sistemi i prodhimit për shitje, posedimi dhe përdorimi i armëve dhe i eksploziveve;
- (XXVII) rregullat themelore që kanë të bëjnë me organizimin e shtypit, radios e televizionit dhe të komunikacioneve në përgjithësi duke respektuar të drejtat e bartuara në bashkësitë autonome e që kanë të bëjnë me zhvillimin dhe aplikimin e tyre;
- (XXVIII) mbrojtja e trashëgimisë kulturore e artistike spanjolle dhe e përmendoreve nacionale, nga eksportimi dhe shkatërrimi; muzeumet, bibliotekat, arkivat që i takojnë shtetit pa kufizim të të drejtave të bashkësive autonome që t'i drejtojnë ato;
- (XXIX) siguria publike me respektimin e mundësive të arsimimit të forcave policore të bashkësive autonome, sipas mënyrës së caktuar në statutet e tyre dhe në suaza që do të caktohen me ligjin sistemor;
- (XXX) rregullimi i kushteve që kanë të bëjnë me fitimin, dhënien dhe standardizimin e shkallëve akademikë e të kualifikimeve profesionale, dhe rregullat themelore për zhvillimin e nenit 27 të kushtetues me qëllim që të garantohet përmbushja e obligimeve të autoriteteve publike në këtë sferë;
- (XXXI) miratimi i konsultimeve me popullin me anë të mbajtjes së referendumit.
- (2) Krahas me respektimin e kompetencave që mund të marrin bashkësitë autonome, shteti do të shfaq kujdes për avancimin e kulturës që është obligimi dhe funksioni kryesor i tij dhe do të krijojë kushte për komunikimin kulturor midis njësive autonome dhe do të bashkëpunojë me to;
- (3) Çështjet, të cilat me këtë kushtetutë nuk janë vënë theksueshëm në kompetencën e shtetit, mund t'i rregullojnë bashkësitë autonome në bazë të statutit të tyre. Çështjet, për të cilat bashkësitë autonome nuk kanë marrë kompetenca në bazë të statuteve të veta, bëjnë pjesë në kompetencë të shtetit ligjet e të cilit, në rast të konfliktit të ligjit, kanë përparësi mbi ligjet e bashkësisë autonome në gjitha çështjet të cilat nuk janë bartur në kompetencat ekskluzive të këtyre të fundit. Ligji i shtetit në çdo rast do të jetë sublemenatar me ligjet e bashkësisë autonome.

Neni 150.

(1) Çështjet që janë në kompetencën e shtetit, parlamenti do t'i bartë autorizimet në të gjitha ose vetëm në disa bashkësi autonome që në territorin e vet të miratojnë akte në kuadër të parimeve, bazave dhe udhëzimeve të cilat përcaktohen me ligjin e shtetit. Krahas respektimit të kompetencave të gjyqeve, secili nga ligjet themelore do të parashkojë metodat e kontrollit për parlamentin të legjislacionit të bashkësisë autonome.

(2) Shteti mund të delegojë në bashkësitë autonome, në bazë të ligjeve sistemore, kompetencat që i takojnë atij e që për nga natyra e vet janë të përshtatshme për bartje apo delegim.

(3) Shteti mundet kur këtë e kërkon nevoja e mbrojtjes së interesit të përgjithshëm, të miratojë ligjin me të cilin përcaktohen parimet në bazë të të cilave harmonizohen dispozitat e bashkësive autonome pa procedurën e nxjerrjes së akteve, duke përfshirë këtu edhe çështjet për të cilat vendosja është bartur në këto të fundit. Nevojën e vlerëson parlamenti me shumicën absolute të votave.

Neni 151.

(1) Nuk do të nevojitet të pritet skadimi i periudhës prej pesë vitesh, për çka flitet në dispozitën të neni 148, kur pëlqimi mbi paraqitjen e iniciativës për realizimin e vetëqeverisjes e sipas nenit 143, paragrafi 2, është arritur midis këshillave të provincave ose të trupave midis ishujve dhe të tri të katërtave të komunave të secilës nga provincat rreth çështjeve që paraqesin të paktën shumicën e trupit

elektoral të secilës nga ato dhe në qoftë se iniciativa e përmendur është ratifikuar në referendum me shumicën absolute të votave të secilës nga provincat, e nën kushtet e përcaktuara me ligjin sistemor.

(2) Në rastet e parashikuara në dispozitën e mësipërme, procedura për përcaktimin e propozimstatusit është si vijon:

(I) Qeveria do t'i ftojë të gjithë deputetët dhe senatorët e zgjedhur në njësitë elektorale në përbërje të territorit i cili kërkon vetëqeverisje që të tubohen si asamble me kompetenca të vetme miratimi i projektstatutit të autonomisë që duhet ta mbështes shumica absolute e anëtarëve të tij;

(II) Kur projektstatutin ta miratojë asambleja parlamentare, ai i dërgohet komisionit kushtetues të Kongresit i cili do ta shqyrtojë në afatin prej dy muajsh me ndihmën e delegacionit të Asamblesë që e ka përbërë, e me qëllim që të arrihet pëlqimi për verzionin përfundimtar të tekstit;

(III) Kur arrihet pëlqimi i tillë, teksti i jepet në referendum trupit electoral të provincave në territorin e të cilës statuti respektiv duhet të aplikohet.

(IV) Në qoftë se projektstatuti është mbështetur në secilën nga provincat me shumicën e votave të atyre që kanë dalur në referendum, ai i dërgohet parlamentit. Të dy dhomat, në seancat plenare, vendosin për tekstin në mënyrë të njëjtë sikurse që vendosin për ratifikimin. Kur statuti të miratohet, mbreti jep pëlqimin e vet dhe e shpallë si ligj.

(V) Në qoftë se pëlqimi për të cilin flitet në nëndispozitën (II) të këtij neni nuk është arritur, procedura ligjore e cila aplikohet por projektstatutin është e njëjtë me atë që aplikohet ligjet. Teksti që është miratuar në këtë mënyrë i jepet në referendum trupit electoral të provincave që gjenden në territor ku duhet të aplikohet statuti. Në rast se miratohet me shumicën e votave të vlefshme të elektoratit që ka dalur në referendum në secilën nga provincat, ai do të shpallët sipas mënyrës së përcaktuar në nëndispozitën e mësipërme.

(3) Në rastet e përshkruara në nëndispozitat (IV) dhe (V) të dispozitës së mëparshme, mosmiratimi i statutit në një ose më shumë provinca nuk do të pengojë konstituimin e provincave tjera në bashkësinë autonome sipas mënyrës që është përcaktuar me ligjin sistemor për të cilin flitet në dispozitën 1 të këtij neni.

Neni 152.

(1) Në rastin kur statuti është miratuar në bazë të procedurës së caktuar në nenin e mëparshëm, organizimi institucional i bashkësisë autonome do të mbështetet në asamblenë legjislativë të zgjedhur në bazë të të drejtës së përgjithshme të votimit në harmoni me parimin e përfaqësimit proporcional i cili do të sigurojë, përveç tjerash, përfaqësimin e pjesëve të ndryshme të territorit: Këshillin drejtues me funksionet ekzekutive e administrativ dhe kryetari të cilin e zgjedh asambleja nga radhët e anëtarëve të vet të emëruar nga mbreti. Kryetari është përgjegjës për udhëheqjen e Këshillit drejtues të cilin e përbën përfaqësia supreme e bashkësisë respektive si dhe përfaqësuesi i shtetit në bashkësi. Kryetari dhe anëtarët e këshillit drejtues, politikisht i përgjigjen asamblesë.

Gjyqet e larta, pa kufizime të kompetencave të Gjyqit Suprem, do të jenë në krye të gjyqeve brenda territorit të bashkësisë autonome. Statutet e bashkësive autonome do të caktojnë rrethanat dhe mënyrat të cilat bashkësitë autonome do të marrin pjesë në përcaktimin e kompetencave territoriale të organeve gjyqësore, e të cilat duhet të jenë në harmoni me dispozitat e ligjit sistemor mbi kompetencat gjyqësore dhe kompatible me parimet e unitetit të sistemit gjyqësor dhe pavarësisë së gjyqeve.

Krahas respektimit të dispozitave të nenit 123, procedruat e shkallës së lartë zhvillohen para organeve gjyqësore që gjenden në territorin e bashkësisë së njëjtë autonome në të cilën gjendet gjyqi kompetent i shkallës së parë.

(2) Statutet që janë miratuar dhe shpallur mund të ndryshohen me anë të amandamenteve sipas procedurës që është përcaktuar këtu dhe me referendum të elektoratit të regjistruar në njësitë përkatëse

elektorale.

(3) Me bashkimin e komunave që kufizohen, statutet mund të inaugurojnë qarqet e veta të posaçme elektorale të cilët do të gëzojnë aftësinë e plotë juridike.

Neni 153.

Kontrollin mbi punën e organeve të bashkësisë autonome do ta ushtrojë:

(a) Gjyqi kushtetues në çështjet që kanë të bëjnë me kushtetutshmërinë e akteve të tyre të cilat kanë fuqinë e ligjit;

(b) Qeveria, në çështjet e ushtrimit të funksioneve të deleguara për të cilat flitet në dispozitën 2 të nenit 150, e pasi të marrë mendimin e këshillit të shtetit;

(c) Trupat gjyqësore kompetente pa çështjet administrative kur është fjala për administratën e bashkësisë autonome dhe dispozitat e saj;

(d) Gjyqi financiar, kur është fjala për çështjet financiare e buxhetore.

Neni 154.

Delegati, të cilin e emëron qeveria, do të drejtojë administratën shtetërore në territorin e secilës nga bashkësitë autonome dhe do të koordinojë punën e saj me punën e administratës së bashkësisë, kur kjo është e nevojshme.

Neni 155.

(1) Në qoftë se bashkësia autonome nuk i përmbush obligimet e parashikuara me kushtetutë dhe ligje të tjera apo me akte dhe kjo paraqet shkelje serioze të interesave të përgjithshme të Spanjës, Qeveria, pasi t'i paraqes ankesë kryetarit të bashkësisë autonome dhe nuk merr përgjigje të kënaqshme, do të marrë masat e domosdoshme në bazë të pëlqimit nga shumica absolute e votave në senat, me qëllim që ta detyrojë bashkësinë autonome për t'i respektuar obligimet ose do ta mbrojë vetë interesin e përgjithshëm të përmendur më lart.

(2) Me qëllim të zbatimit të masave për të cilat flitet në dispozitën e mësipërme, qeveria mund t'u japë instrukcione të gjitha organeve të bashkësisë autonome.

Neni 156.

(10) Bashkësitë autonome gëzojnë pavarësinë financiare e cila shërben për zhvillimin dhe ushtrimin e kompetencave të tyre, e në përputhje me parimet e koordinimit me ministrinë e financave dhe me solidaritetin midis të gjithë spanjollëve.

(2) bashkësitë autonome mund të paraqiten si delegatë dhe bashkëpunëtorë të shtetit kur është fjala për grumbullimin, drejtimin dhe përcaktimin e të hyrave të tyre tatimore, e në përputhje me ligjin dhe statutin e tyre.

Neni 157.

(1) Burimet financiare të bashkësisë autonome janë:

(a) tatimet që ua ka lënë shteti në tërësi a pjesërisht; tatimet shtesë dhe pjesëmarrja në fitimet tjera të shtetit;

(b) tatimet e tyre vetjake, taksat dhe tatimet e veçanta;

(c) transferet nga përlogaritjet inter-territoriale dhe lokacionet tjera në llogari të buxhetit të përgjithshëm shtetëror;

(d) të ardhurat nga prona e tyre e të tjera në bazë të fitimit të mbështetur në ligj;

(e) të ardhurat që dalin nga operacionet kreditore.

(2) Bashkësitë autonome me kurrfarë kushtesh nuk mund të futin masa të cilat i shtojnë tatimet që gjenden jashtë territorit të tyre ose ato tatime të cilat do të rrezikonin qarkullimin e lirë të mallrave e të shërbimeve.

(3) Ushtrimi i kompetencave financiare të përmendura në dispozitën 1, lart, rregullat për zgjidhjen e konflikteve që mund të lindin dhe format e mundshme të bashkëpunimit midis bashkësive autonome dhe shtetit, mund të rregullohen me ligjin sistemor.

Neni 158.

(1) Nga buxheti i përgjithshëm i shtetit mund të bëhet alokacion i mjeteve në bashkësinë autonome proporcionalisht me vëllimin e kompetencave e të përgjegjësi që i ka marrë ajo nga shteti për kryerjen e tyre, me qëllim të sigurimit të nivelit minimal të ushtrimit të shërbimeve publike në mbarë territorin e Spanjës.

(2) Me qëllim që të barazohen dallimet në zhvillimin ekonomik të disa territoreve, dhe të aplikohet parimi i solidaritetit, do të formohet Fondi përlogaritar për financimin e shpenzimeve investionale, mjetet e të cilit parlamenti do t'i sistemojë midis bashkësive autonome dhe provincave.

Neni 161.

(1) Gjyqi Kushtetues i kryen kompetencat e veta në mbarë territorin e Spanjës dhe është kompetent të vendosë për:

(a) ankesat lidhur me jokushtetutshmërinë e ligjeve e të akteve të tjera të cilët kanë fuqinë e ligjit. Vendimi për jokushtetutshmërinë e dispozitave juridike që kanë fuqinë e ligjit sipas interpretimit gjyqësor do të ketë ndikim në këtë të fundit, por aktgjykimi ose aktgjykimet e arritura nuk do të humbin statusin res iudicata;

(b) kërkesat individuale për mbrojtje (recursos de amparo) nga rastet e shkeljes së të drejtave dhe lirive të garantuara me nenin 53.2 të kushtetutës, nën kushtet dhe mënyrën që do të përcaktohen me ligj;

(c) konfliktin e kompetencave midis shtetit e bashkësive autonome dhe midis vetë bashkësive autonome;

(d) çështjet tjera të caktuara me kushtetutë dhe me ligjin sistemor.

(2) Qeveria mundet para Gjyqit Kushtetues të kontestojë aktet dhe rezolutat e miratuara nga organet e bashkësive autonome, që sjellë suspendimin e atyre akteve ose të rezolutave, derisa gjyqi të mos marrë vendimin. Gjyqi duhet ta konfirmojë apo të heq suspendimin varësisht nga rasti, në afatin i cili nuk mund të jetë më i gjatë se pesë muaj.

DISPOZITAT PLOTËSUESE

Një: kushtetuta mbronë dhe respekton të drejtat historike të territoreve në përbërje të të cilave gjendet "fuerosi".

Ringjallja e përgjithshme e sistemit "fuerosa" do të kryhet, kur kjo të përgjigjet, në kuadër të kushtetutës dhe të statutit të bashkësive autonome.

STATUTI AUTONOM I BASKISË, ligji sistemor 3/1979, nga 18.XI.1979

DISPOZITAT HYRËSE

Neni 1.

Populli i Baskisë ose "Euskal - Herria" me qëllim që të shprehë nacionalitetin e vet dhe të realizojë vetëqeverisjen, konstituon bashkësinë autonome brenda shtetit spanjoll emri i të cilës është "euskada" ose Baskia, e në përputhje me kushtetutën dhe këtë statut me të cilin përcaktohen rregullat themelore institucionale.

Neni 2.

(1) Alava, Guipuscoa e Baskia si dhe Navarra kanë të drejtë për të qenë pjesë e Bashkësisë Autonome të Baskisë.

(2) Territori i bashkësisë autonome përfshinë territoret historike të cilat përputhen me territoret e Alavës, Guipuscos dhe të Baskisë duke respektuar kufijtë e tyre të tashëm si dhe me territorin e Navares në qoftë se kjo vendos për t'ju bashkuar bashkësisë autonome në harmoni me procedurën e caktuar në dispozitat kalimtare të kushtetutës.

Neni 3.

Secili nga territoret historik nga të cilët përbëhet Baskia mundet në territorin e vet t'i ruajë apo, nëse kjo është rast, t'i rithemelojë e riorganizojë organet e veta dhe ato institucione të cilat ekskluzivisht kryejnë autorizime vetëqeverisëse.

Neni 4.

Selinë e institucioneve të përbashkëta të Bashkësisë Autonome të Baskisë do ta caktojë Parlamenti bask me ligj, dhe ajo do të gjendet brenda territorit të Bashkësisë autonome.

Neni 5.

(1) Në flamurin e Baskisë gjenden të vendosur në prapavijë të kuqe, dy kryqa, kryqi i gjelbër diagonal dhe në krye kryqi perpedikular.

(2) Njihen gjithashtu flamujt dhe stemat e territoreve historike që gjenden në përbërje të Bashkësisë autonome.

Neni 6.

(1) "Euskera" gjuha e popullit bask, si dhe gjuha spanjolle ka statusin e gjuhës zyrtare në "Euskadi" (Baski). Të gjithë banorët kanë të drejtë t'i njohin dhe t'i përdorin të dy gjuhët.

(2) Institucionet e përbashkëta të Bashkësisë autonome, duke pasur parasysh veçoritë gjuhësore të Baskisë, do të garantojnë përdorimin e të dy gjuhëve, do të kontrollojnë përdorimin e tyre zyrtar dhe do të miratojnë të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e njohjes së të dy gjuhëve.

(3) Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe gjuhësore.

(4) Akademia Mbretërore e Gjuhës Baske është institucion zyrtar këshilldhënës për çështjet që

kanë të bëjnë me gjuhën "euskere" (baske).

(5) Duke pasur parasysh faktin se "eusquera" është thesar edhe i territoreve dhe bashkësive tjera baske, Bashkësia Autonome e Baskisë mund të kërkojë që qeveria spanjolle, krahas lidhjeve dhe marrëdhënieve tani më ekzistuese midis institucioneve akademike e kulturore të lidhë atje ku ndihet nevoja t'i parashtrijë parlamentit për artifikim kontrata e marrëveshje në bazë të të cilave do të vendoseshin raporetet kulturore me shtetet ku gjenden territoret dhe bashkësitë e tilla e me qëllim të mbrojtjes e të avancimit të gjuhës "euskere" (baske).

Neni 7.

(1) Për nevojat e këtij statuti, statusi politik i baskëve do t'i jepet secilit që jeton, sipas ligjit të përgjithshëm të shtetit, në cilindo komunë që i takon territorit të bashkësisë autonome.

(2) Personat që qëndrojnë në botën e jashtme dhe pasardhësit e tyre të cilët do të kërkojnë kategorikisht këtë do të gëzojnë të drejtat e njëjta politike si edhe at që jetojnë në Baski, nëse qëndrimi i tyre i fundit juridik në Spanjë ka qenë në Euskardi (Baski) dhe me kusht që t'u kthehet shtetësia spanjolle.

Neni 8.

Territoret dhe komunat tjera të cilat në tërësi janë të vendosura në territorin e Bashkësisë Autonome të Baskisë, mund t'i bashkohen bashkësisë në qoftë se i plotësojnë këto kushte:

(a) anëtarësinë duhet ta kërkojë Këshilli i qytetit ose shumica e këshillave të qyteteve në fjalë krahas mendimit të bashkësisë apo të provincës, të cilës i takon territor ose komune.

(b) Banorët e territorit apo të komunës në fjalë duhet të shprehin pëlqimin e vet në referendumin e organizuar vetëm për këtë qëllim. Këtë referendum duhet ta lejojnë sipas dispozitave autoritetet kompetente, kurse vendimi duhet të merret me shumicën e votave të vlefshme.

(c) Vendimin duhet ta miratojë Parlamenti i Baskisë e pastaj parlamenti shtetëror i Spanjës me anë të ligjit sistemor.

Neni 9.

(1) Të drejtat themelore dhe obligimet e qytetarëve të Baskisë janë ato të përmendura në Kushtetutë.

(2) Autoritetet publike të Baskisë në punët nga kompetencat e veta:

(a) përcjellin dhe garantojnë ushtrimin e të drejtave dhe të lirive themelore të qytetarëve;

(b) i kushtojnë kujdes të veçantë politikës të orientuar drejtë avancimit të kushteve të jetës e të punës;

(c) miratojnë masa të cilat do të mundësojnë punësimin më të lartë dhe stabilitetin ekonomik;

(d) miratojnë masat të cilat kanë për qëllim avancimin e kushteve dhe eliminimin e vështirësve për realizimin e vërtetë e efikas të lirive të qytetarëve dhe të barazisë së individëve e të grupeve;

(e) krijojnë kushte për pjesëmarrjen e të gjithë qytetarëve në jetën politike, ekonomike e shoqërore të Baskisë.

KAPITULLI I

KOMPETENCAT E BASKISË

Neni 10

Bashkësia Autonome e Baskisë ka kompetenca ekskluzive në këto fusha:

(1) caktimi i territoreve të komunave duke respektuar autorizimet që u takojnë territoreve historike në harmoni me nenin 37 të statutit;

(2) organizimi, regjimi dhe funksionimi i institucioneve të vetëqeverisjes në përputhje me dispozitat e këtij statuti;

(3) legjislacioni i brendshëm elektoral që ka të bëjë me parlamentin bask (Juntas Generales) dhe me këshillat e provincave nën kushtet e përcaktuara me këtë statut dhe duke respektuar kompetencat që u takojnë territoreve historike në harmoni me dispozitat e nenit 37;

(4) qeveria lokale dhe statusi i nëpunësve publikë të Bashkësisë autonome dhe të administratës së saj lokale, pa kufizime të vlefshmërisë së dispozitave 149.1.18 të kushtetutës;

(5) ruajtja, ndryshimi e zhvillimi i të drejtës tradicionale rajonale dhe i të drejtës speciale qytetare, të shkruar apo kanunore, që janë veçori e territoreve historike në përbërje të Baskisë, dhe përcaktimi i rajoneve territoriale ku ajo aplikohet;

(6) rregullat procesore dhe rregullat që i përkasin procedurës administrative dhe ekonomiko administrative, e që rezultojnë nga karakteristikat e ligjeve themelore dhe të organizimit specifik të Baskisë;

(7) të mirat dhe pasuria publike në pronësinë e Bashkësisë autonome dhe karakteri zyrtar publik mbi pasuritë që janë në kompetencat e saj;

(8) pyjet, pasuritë dhe shërbimet pyjore, vendkalimet blegtorale dhe kullotat, pa kufizime të vlerës dispozitave të nenit 149.1.23 të kushtetutës.

(9) bujqësia dhe mbajtja e kafshëve në përputhje me planin e përgjithshëm ekonomik;

(10) peshkimi në ujërat e brendshme, industria e rritjes së guacave, gjuetia dhe peshkimi në lumenj e liqene;

(11) hidroprojektet, kanalet dhe sistemet e irigacionit, kur lumi me tërë rrjedhën e vet është i vendosur në territorin e Baskisë; stabilimentet për prodhim, sistemi dhe përçuerja e energjisë me kusht që kjo përçarje të mos del nga territori i Bashkësisë autonome dhe përdorimi i kësaj energjie të mos prodhojë pasojat për provincat tjera ose bashkësitë autonome, ujërat minerale, termale e nëntokësore duke respektuar dispozitat e nenit 149.1.25 të kushtetutës;

(12) mirëqenia sociale;

(13) fondacionet dhe shoqatat e natyrës arsimore, kulturore, artistike e bëmirëse, në qoftë se aktiviteti i tyre zhvillohet kryesisht në territorin e Baskisë;

(14) organizimi, regjimi dhe funksionimi i institucioneve dhe i enteve për mbrojtjen dhe kujdesin e të rinjve; burgjet dhe qendrat sociale të rehabilitimit në përputhje me legjislacionin e përgjithshëm mbi çështjet civile, penale e ndëshkimore;

(15) kontrolli i ilaçeve në përputhje me dispozitat e nenit 149.1.18 të kushtetutës dhe higjiena duke pasur parasysh dispozitat e nenit 18 të këtij statuti;

(16) kërkimet shkencore-teknike në bashkëpunim me shtetin;

(17) kultura duke respektuar dispozitat e nenit 149.2 të kushtetutës;

(18) institucionet të cilat merren me avancimin e arteve të bukura dhe me arsimin në këtë fushë;

zejtaria;

(19) trashëgimia historike dhe artistike e përmendoreve arkeologjike e shkencore; Bashkësia

autonome harmonizohet me rregullat dhe obligimet që i krijon shteti për mbrojtjen e kësaj trashëgimie nga eksporti dhe shkatërrimi;

(20) arkivat, bibliotekat dhe muzeumet që nuk janë pronë e shtetit;

(21) odat bujqësore e pronësore, ekonomitë e peshkimit, odat tregtare, industriale e të anijeve, krahas respektimit të kompetencave të shtetit në çështjet e tregtisë së jashtme;

(22) shoqatat profesionale dhe kryerja e profesioneve të cilat nënkupton diplomën, duke respektuar dispozitat e nenit 36 dhe 139 të kushtetutës; emërimi i notarëve publikë në harmoni me ligjin e shtetit;

(23) kooperativat, shoqëritë për sigurime reciproke të cilat nuk u takojnë shërbimeve të sigurimit social, dhe shoqatat tjera kooperative në harmoni me legjislacionin e përgjithshëm tregtar;

(24) sektori publik i cili i takon Baskisë, me kusht që të mos jetë rregulluar ndryshe me dispozitat e këtij statuti;

(25) avancimi, zhvillimit ekonomik dhe planifikimi i aktiviteteve ekonomike në Baski, e në përputhje me planin e përgjithshëm ekonomik;

(26) institucionet kooperative, të kredive dhe kursimoreve publike e territoriale në suzat e udhëzimeve që i jep shteti, e që kanë të bëjnë me rolin e kredive dhe bankave në harmoni me politikën e përgjithshme monetare;

(27) tregtia e brendshme, duke respektuar politikën e përgjithshme të çmimeve dhe lirinë e çarkullimit të mallrave e të shërbimeve në territorin e shtetit, dhe të legjislacionit që rregullon mbrojtjen e konkurrencës; tregu dhe panairët lokale; kontrolli i origjinës së mallrave dhe shpalljet në bashkëpunim me shtetin;

(28) mbrojtja e konsumatorëve dhe e shfrytëzuesve, nën kushtet e caktuara në paragrafin e mëparshëm;

(29) themelimi dhe rregullimi i punës së rezervave të mallërave dhe të qëndrave të tjera që merren me mallërat dhe sigurimet, në harmoni me legjislacionin e tregtisë;

(30) industria, duke përfshirë instalimet, përhapjen dhe çarkullimin i produkteve të cilët u nënshtrohen rregullave të posaçme nga shkaqet e sigurisë të interesave ushtarake apo shëndetësore ose që kërkojnë rregullativë të veçantë për shkak të destinimit të tyre, si dhe ato produkte të cilat kërkojnë kontrata paraprake për transferin e teknologjisë së vjetër. Në zhvillimin e sektorit industrial, Baskia është përgjegjëse për zhvillimin dhe aplikimin e planit të cilin e miraton shteti;

(31) planifikimi në rrypin kontinental të vendit dhe në bregun e detit, planifikimi dhe baninimi urban;

(32) hekurudhat, transporti tokësor, deti, lumenjt dhe kabllot, portet, heliodromet e aerodromet dhe shërbimi meteorologjik i Baskisë, duke respektuar dispozitat e nenit 149.1.20. të kushtetutës; qendrat e inaksimit dhe terminali i shkarkueso-ngarkues për transportimin e mallrave;

(33) punët publike të cilat me ligj nuk janë klasifikuar si punë publike me interes të përgjithshëm ose zbatimi i të cilave juridikisht nuk ndikon në territoret tjera;

(34) lidhur me rrugët dhe taksat e rrugëve, krahas autorizimeve që i përmban paragrafi 5, pika 1 e nenit 148 të kushtetutës këshillat provinciale të territoreve historike mbajnë në tërësi autorizimet të cilat veç i posedojnë, ose që i kanë rimarrë në harmoni me nenin 3 të statutit;

(35) kazinot, lojërat e fatit dhe bastoret, duke përjashtuar sistemin nacional të lojërave të fatit;

(36) turizmi, sporti, pushimi dhe koha e lirë

(37) grumbullimi i të dhënave statistikore që kanë të bëjnë me Baskinë e të cilat i shëbejnë bashkësisë autonome për qëllime të veçanta, apo për qëllime të ushtrimit të kompetencave të veta;

(38) manifestime publike;

(39) zhvillimi i bashkësive të vogla shoqërore; pozita e gruas, Politika e mbrojtjes së fëmijëve, rinisë dhe pesonave të moshuar;

Neni 11.

(1) Bashkëia Autonome e Baskisë është e obligueshme të nxjerrë aktet ligjore e të tjera lidhur me aplikimin e ligjeve kryesore të shtetit në këto fusha:

(a) ruajtja dhe mbrojtja e ambientit;

(b) ekspropriumimi i dhunshëm, kontratat dhe koncesionet qeveritare në pjesët që bëjnë pjesë në kompetencat e administratës së Baskisë;

(c) planifikimi në sektorin e peshkimit në rajonet e Baskisë;

(d) Bashkësia Autonome e Baskisë gjithashtu është e obligueshme të sigurojë zhvillimin dhe aplikimin e legjislacionit themelor në mënyrën e caktuar me këtë statut, në këto fusha:

(a) planifikimi në fushën e kredive, bankave dhe sigurimeve;

(b) rezervimi i kryerjes së shërbimeve themelore nga ana e sektorit publik, sidomos në rastet e ekzistimit të monopolit, si dhe kontrolli i kompanive kur këtë e kërkon interesi publik;

(c) regjimi i minjërave dhe të burimeve energjetike; burimet gjeotermike.

Neni 12.

Bashkësia Autonome e Baskisë është e obligueshme ta ekzekutojë legjislacionin e shtetit në këto fusha;

(1) legjislacioni që rregullon sistemin e burgjeve;

(2) legjislacioni i punës dhe atë me anë të marrjes së autorizimeve të kompetencave të cilat tani i takojnë shtetit në sferën e marrëdhënieve të punës, si dhe autorizimet për organizimin, drejtimin dhe mbrojtjen në bashkëpunim me inspektorët e shtetit; shërbimet shtetërore që merren me aplikimin e legjislacionit të punës, me avansimin e kushteve të punës deri në nivelin që i pëgjigjet shkallës së zhvillimit dhe progresit shoqëror dhe avansimin e kushteve për marrjen e kualifikimeve të punëtorëve;

(3) emërimi i gjyqëtarëve të Katastrit, të ndërmjetësuesve të bursave, mallrave dhe të tregëtisë; intervenimi lidhur me përkufizimet përkatëse kur kjo është e duhur;

(4) të drejtat prej autori dhe patentat;

(5) peshat dhe njësitë; shenjat

(6) panairët tregtare ndërkombëtare që mbahen në Baski;

(7) sektori publik e shtetëror në territorin e Bashkësisë autonome i cili merr pjesë në punët dhe aktivitetet e caktuara kur vlerësohet se kjo është e nevojshme;

(8) porta dhe aerodromet të cilët janë kualifikuar si objekte të interesit të përgjithshëm dhe kur shteti nuk e ka rezervuar për vete drejtimin e këtyre objekteve;

(9) planifikimi i transportit të mallrave e të udhëtarëve -destinacionet nisëse e ardhëse të të cilëve gjendet në territorin e Bashkësisë Autonome, duke përfshirë edhe rastet kur transporti i tillë zhvillohet me anë të objekteve infrastrukturale që i takojnë shtetit dhe për të cilët flitet në pikën 12, dispozita 1 e nenit 149 të kushtetutës, duke respektuar të drejtat e shtetit që ushtrimin e këtyre punëve ta mbajë për vete;

(10) punët shpëtimtare në det dhe heqja e bërlllogut industrial dhe të ndotjeve në ujërat territoriale të shtetit që gjenden brenda Baskisë.

Neni 13.

(1) Në sferën e organizimit të gjyqësisë, përveç gjyqit ushtarak, Bashkësia Autonome e Baskisë kryen, në territorin e saj, autorizimet të cilat ligji sistemor mbi gjyqësinë dhe organizimin e saj i përcakton si autorizime të qeverisë, ose i rezervon ato dhe ia ndanë asaj;

(2) Në përputhje me ligjin e përgjithshëm, e drejta për dhënien e amnistisë dhe organizimi e funksionimi i prokurorive publike është në tërësi në kompetencat e shtetit.

Neni 14.

(1) Kompetencat e Baskisë mbi pushtetin gjyqësor përfshijnë:

(a) kontestet civile në të gjitha shkallët dhe në të gjitha instancat, duke përfshirë kërkesën për rishikimin dhe ankesat gjyqit të lartë për çështjet që dalin nga aktet tradicionale, rajonale e civile të cilat i ka nxjerrë Baskia;

(b) konteste penale e sociale në të gjitha instancat dhe në të gjitha shkallët, përveç kur është fjala për ankesat gjyqeve të larta dhe mbi kërkesat për rishikim;

(c) kontestet administrative në të gjitha instancat dhe në të gjitha nivelet, kur aktet në fjalë i ka nxjerë administrata e Baskisë dhe kanë të bëjnë me çështjet që gjenden në kompetencën ekskluzive të Bashkësisë Autonome; procedurën e shkallës së parë, kur aktin kontestues e ka marrë administrata e shtetit;

(d) zgjidhjen e konflikteve të kompetencave midis organeve gjyqësore në territorin e Baskisë;

(e) ankesat që kanë të bëjnë me kualifikimin e dokumentave në bazë të të cilave dokumentet baske proklamohen si e drejtë e Baskisë, e në bazë të të cilave mund të sigurohet qasja në librat e katastroit.

(2) Në raste tjera ankesat i parashtrihen Gjyqit Suprem të shtetit në përputhje me ligjin. Gjyqi Suprem gjithashtu vendos mbi konfliktin e kompetencave midis organeve gjyqësore të Baskisë me organet tjera të shtetit.

Neni 15.

Baskia ka obligim të zgjedhë parlamentin e vet dhe me anë të ligjit, duke pasur parasysh institucionet e inauguruar me nenin 54 të kushtetutës, të formojë organet të ngjashme të cilat në bashkërendim me organet e shtetit do t'i kryejnë funksionet e përmendura në nenin e më sipërm, si dhe funksionet tjera të cilat do t'ua besojë parlamenti i Baskisë.

Neni 16.

Me rastin e aplikimit të dispozitave kushtetuese nga pjesa e dispozitave shtojcë, Bashkësia Autonome është përgjegjëse për sistemin e arsimit në tërësi, pavarësisht nga shkalla, diploma, lloji apo cilado specifike, duke respektuar dispozitat e nenit 27 të kushtetutës dhe të ligjit sistemor i cili rregullon aplikimin e këtyre dispozitave, të kompetencave që i takojnë shtetit në bazë të nenit 149.1.30, të Kushtetutës si dhe duke respektuar të drejtën e saj për kryerjen e inspektionit mbi zbatimin dhe garantimin e kësaj dispozite.

Neni 17.

(1) Nëpërmjet procedurës së modernizimit të së drejtës tradicionale rajonale, sikurse kërkohet me nenin 1 të dispozitave shtojcë të kushtetutës, institucionet e Baskisë kanë obligim që sipas mënyrës së caktuar me statut të organizojnë në tërësi forcat autonome policore lidhur me mbrojtjen e shtetit, dhe trupat e saj mbajnë për çdo rast përgjegjësinë për shërbimet policore të cilat kryejnë autorizime në fushat që gjenden jashtë kompetencave të Bashkësisë siç janë: siguria e porteve, aerodromeve, e brigjeve të detit dhe e vendkalimeve, e shërbimeve kufitare, kontrolli i hyrjes dhe i daljes së spanjollëve dhe i të huajve nga territori nacional, organizim i përgjithshëm i azilantëve, ekstradimi dhe dëbimi, shpërngulja

dhe vendosja, dhënia e pasaportave dhe të dokumenteve nacionale të identifikimit, çarkullimi i armëve dhe i eksplozivëve, mbrojtja fiskale e shtetit, kontrabanda dhe kundërvajtjet tatimore me të cilat dëmtohet shteti.

(2) Komandën Supreme mbi Forcat Policore Autonome të Baskisë e kryen qeveria e Baskisë duke respektuar autorizimet që mund t'u jepen këshillave policore dhe korporateve lokale.

(3) Policia gjyqësore dhe forcat që kryejnë këtë funksion janë të organizuara si shërbime të administratës gjyqësore dhe gjenden nën kontrollin e saj, e sipas kushteve të caktuara me ligjet procesore.

(4) Për hir të sigurimit të bashkëpunimit midis forcave policore autonome dhe forcave të sigurimit të shtetit, formohet këshilli për siguri i cili përbëhet nga numër të barabart të përfaqësuesve të shtetit dhe të Bashkësisë Autonome.

(5) Forcat Policore Autonome të Baskisë, në fillim, përbëhen:

(a) nga njësitët " Minones" të cilat i takojnë këshillit provincial të Alavës, dhe momentalisht ekzistojnë;

(b) nga njësitët "inones" dhe "miquetes" të cilët drejtohen nga këshillat provinciale të Baskisë dhe Guipuskoës, dhe të cilët me këtë formohen sërisht.

Në periudhat e mëvonshme instiucionet e Baskisë mund të vendosin që këto foca të riorganizohen në organizatë unike ose të zbatohet çfarëdo forme tjetër e organizimit që do të kërkohet për kryerjen e autorizimeve të marra.

E gjithë kjo duhet të kryhet ashtu që të mos priset kontinuiteti i ekzekutimit të njësitëve "minonesa" dhe "miquetes" për qëllime reprezentative.

(6) Forcat shtetërore të sigurisë mund të intervenojnë në territorin e bashkësisë autonome për ruajtjen e rendit publik në këto situata:

(a) me ftesë të qeverisë baske, intervenimi do të pushojë me kërkesë të saj;

(b) me iniciativën e shtetit kur ai e vlerëson se interesi i përgjithshëm i shtetit është sjellur në rrezik; me këtë rast kërkohet leja e Këshillit të Sigurisë i cili u përmend në pikën 3 të këtij neni. Në rastin e urgjencës së jashtëzakonshme e me qëllim që në tërësi t'i kryejnë funksionet që u janë besuar drejtpërsëdrejti me Kushtetutë, forcat e sigurimit të shtetit mund të intervenojnë me urdhëresë të qeverisë e cila për këtë do ta njoftojë parlamentin e shtetit. Parlamenti shtetëror i Spanjës kryen, sipas procedurës së kontaktuar kushtetuese, autorizimet të cilat i janë besuar në këtë fushë;

(7) Me rastin e shpalljes, së gjendjes së alarmit, të gjendjes së jashtëzakonshme apo të gjendjes së shtetërrethimit, të gjitha Forcat Policore të Baskisë kalojnë nën komandën direkte të autoriteve civile e ushtarake të shtetit, e në përputhje me ligjet të cilët i rregullojnë këtë sferë.

Neni 18.

(1) Baskia është përgjegjëse për zhvillimin dhe aplikimin e legjislacionit të shtetit në sferën e shëndetësisë;

(2) Baskia në sferën e sigurimit social është kompetente për:

(a) zhvillimin dhe aplikimin e ligjeve themelore të shtetit, përpos rregullave që kanë të bëjnë me organizimin ekonomik të shërbimit të sigurimit social;

(b) drejtimin e organizimit ekonomik të shërbimit të sigurimit social;

(3) Baskia, gjithashtu, është kompetente për zbatimin e legjislacionit të shtetit në fushën e produkteve farmaceutike.

(4) Bashkësia Autonome mund të organizojë në territorin e vet shërbime të cila merren me shëndetësinë dhe sigurimin social, ato i drejton dhe i mbikqyrë punën e tyre. Shteti i mban kompetencat që të kryejnë inspektionin, me çka sigurohet kryerja e kompetencave që atij i janë besuar.

(5) Autoritetet publike të Baskisë ia përshtatin kryerjen e kompetencave të veta në fushën e shëndetësisë e të sigurimit social, kritereve demokratike, me pjesëmarrjen e atyre me të cilët ka të bëjë kryerja e këtyre shërbimeve duke përfshirë këtu shoqatat e të punësuarve dhe punëdhënësve, të cilat mund të formohen me ligj.

Neni 19.

(1) Baskia është përgjegjëse për zhvillimin e rregullave themelore juridike të cilat i ka inauguruar shteti në sferën e informimit shoqëror e nën kushtet e respektimit të dispozitave të nenit 20 të kushtetutës.

(2) Aplikimi i rregullave për të cilat flitet në paragrafin paraprak bëhet në kordinim me shtetin dhe duke respektuar dispozitat e veçanta të cilat aplikohen për mediumet në pronësinë e shtetit.

(3) Në harmoni me dispozitat e paragrafit 1., Baskia mund të rregullojë themelobjë dhe drejtojë televizionin e vet, radion e shtypin, si dhe mediat tjera e me qëllim të kryerjes së funksioneve të veta:

Neni 20.

(1) Baskia do të ketë pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv edhe në rajonet tjera të cilat me ligjin sistemor ose vendimin e shtetit janë bartur në të në harmoni me kushtetutën dhe me kërkesë të parlamentit bask.

(2) Bashkësia Autonome e Baskisë mund të nxjerrë ligje sipas dispozitave të nenit 150.1. të kushtetutës, pasi që parlamenti shtetëror spanjoll të miratojë ligjet sistemore për të cilat bëhet fjalë në atë dispozitë.

(3) Baskia do t'i kryej kontratat dhe marrëveshjet që kanë ndikim në punët, të cilat me këtë Statut janë bartur në kompetencën e saj. Asnjë kontratë apo marrëveshje nuk mund të prodhojë pasoja për kompetencat e Baskisë, përpos kur është fjala për rastet e parashikuara në nenin 150.2. të kushtetutës, e duke përjashtaur nenin 93 të saj.

(4) Kompetencat ekzekutive që ky statut ia beson Bashkësisë Autonome të Baskisë rreth çështjeve të cilat nuk bëjnë pjesë në kompetencat e saj ekskluzive, përfshinë edhe autorizimet e drejtimit dhe nxjerrjen e akteve të brendshme lidhur me organizimin e shërbimeve në fjalë.

(5) Qeveria baske do të njoftohet për lidhjen e kontratave e të marrëveshjeve dhe të akteve doganore që duhet të nxirren në masën në të cilën këto mund të prodhojnë pasoja për interesat e posaçme të Baskisë.

(6) Të gjitha autorizimet dhe përgjegjësitë që u përmenden në dispozitat e mëparshme dhe në dispozitat tjera të këtij statuti, përpos në rastin e ekzistimit të dispozitave katagorike të përmbajtjes tjetër, kanë të bëjnë me territorin e Baskisë.

Neni 21.

Aktet të cilët i ka miratuar Baskia për çështjet nga kompetencat e saja ekskluzive, kanë prioritet të aplikimit në raport me të gjitha aktet tjera, e në qoftë se aktet e tilla nuk ekzistojnë aplikohen aktet e shtetit.

Neni 22.

(1) Bashkësia autonome mund të lidh marrëveshje me bashkësitë tjera autonome lidhur me aplikimin e akteve që kanë të bëjnë me punët nga kompetencat e tyre ekskluzive. Për lidhjen e

marrëveshjeve të tilla duhet të njoftohet parlamenti shtetëror i Spanjës para se ata të hyjnë në fuqi. Në qoftë se parlamenti i shtetit spanjoll, apo njëra nga dhomat e tij paraqesin kundërshtim në fatin prej tridhjet ditësh, nga dita e pranimit të njoftimit, - marrëveshja duhet të kalojë procedurën e parashikuar me paragrafin tre të këtij neni. Nëse deri në skadimin e këtij afati nuk paraqitet kurrfarë kundërshtimi, marrëveshja hyn në fuqi.

(2) Bashkësia Autonome mund të lidh marrëveshje me territoret tjera historike që kanë privilegje të veçanta rajonale e juridike lidhur me administrimin dhe kryerjen e pushtetit në rajonet nga kompetencat e saj. Njoftimi për lidhjen e marrëveshjes së tillë i dorëzohet parlamentit shtetëror spanjoll. Marrëveshja e tillë hyn në fuqi në afatin prej njëzet ditësh nga dita e ratifikimit.

(3) Bashkësia Autonome mund të lidhë edhe marrëveshje pa bashkëpunimin me bashkësitë tjera autonome dhe atë në bazë të miratimit paraprak të parlamentit të shtetit spanjoll.

Neni 32.

(1) Organizimi i administratës civile shtetërore i është përshtatur rregullimit gjeografik të Baskisë.

(2) Në harmoni me nenin 154 të kushtetutës, delegati të cilin e cakton qeveria, gjendet në krye të administratës së shtetit dhe koordinon punën e saj me punën e administratës së Bashkësisë autonome.

KAPITULLI II

KOMPETENCAT E BASKISË

Kaptina hyrëse

Neni 24

(1) Kompetencat e Baskisë kryhen nëpërmjet parlamentit, qeverisë dhe kryetarit ose Lendakarisë

(2) Territoret historike do të mbajnë dhe organizojnë institucione të mbështetura në privilegjet rajonale e ligjore, e në harmoni me nenin 3, të këtij statuti.

KREU I - PARLAMENTI

Neni 25.

(1) Parlamenti i Baskisë kryen pushtetin legjislativ, miraton buxhetin dhe nxit e kontrollon punën e qeverisë së Bashkësisë Autonome duke respektuar kufizimet e kompetencave të institucioneve të përmendura në nenin 37 të këtij statuti.

(2) Parlamenti i Baskisë është i pacenueshëm.

Neni 26.

(1) Parlamenti përbëhet nga numri i barabartë i përfaqësuesve të secilit territor historik që janë zgjedhur në bazë të të drejtës së votës së përgjithshme të lirë, direkte e të fshehtë.

(2) Njësinë elektorale e përbënë territori historik.

(3) Zgjedhjet mbahen në secilin nga territoret historike në përputhje me kriteret e përfaqësimit proporcional.

(4) Parlamenti zgjedhet për periudhën prej katër vitesh.

(5) Ligji elektoral mbi parlamentin do t'i rregullojë zgjedhjet për anëtarët e vet, do t'i caktojë shkaqet e papërshtatshmërisë për zgjedhje, dhe punët e shërbimit në nivelin autonom ushtrimi i të cilëve është inkompatibile me pozitën e anëtarit të parlamentit.

(6) Anëtarët e parlamentit janë të pacenueshëm kur është fjala për votimin e tyre ose për shprehjen e mendimit në kuadër të ushtrimit të funksioneve të tyre. Gjatë mandatit ata nuk mund të arrestohen ose të burgosen për shkak të kryerjes së veprës penale në territorin e Bashkësisë Autonome, përpos kur janë gjetur në kryerjen e saj. Për secilin rast individual Gjyqi i Lartë i Baskisë vendos mbi ngritjen e aktakuzës kundër tyre, për arrestimin e tyre, për ndjekjen dhe zhvillimin e procesit gjyqësor kundër tyre. Me rastin e përgjegjësisë penale për veprat për të cilat ekziston dyshimi se janë krye jashtë territorit të Baskisë, vendimin për këto çështje e merrë këshilli penal i Gjyqit të Lartë.

Neni 27.

(1) Parlamenti nga radhët e anëtarëve të vet zgjedh kryetarin, byronë dhe komitetin e përhershëm. Puna e parlamentit zhvillohet në plenum dhe në këshilla.

Parlamenti miraton rregulloren e punëve të tij me shumicën absolute të votave të anëtarëve të vet. Parlamenti e akordon buxhetin dhe aktin mbi sistematizimin i cili aplikohet për të punësuarit.

(2) Parlamenti gjendet në sesion të rregullt të paktën tetë muaj në vit.

(3) Parlamenti mund të konvokohet në sesion të jashtëzakonshëm me kërkesë të qeverisë, komitetit të përhershëm apo të një të tretës së anëtarëve të tij. Sesioni i jashtëzakonshëm mund të konvokohet për të shqyrtuar çështjet specifike dhe mbyllet menjëherë pasi t'i shqyrtojë ato.

(4) Të drejtën për të marrë iniciativën ligjore kanë anëtarët e parlamentit, të qeverisë dhe institucionet e përmendura në nenin 37 të statutit, nën kushtet e caktuara me ligj. Anëtarët e parlamentit mundin, edhe në sesionet plenare edhe në këshilla, të paraqesin kërkesa, pyetje, interpelanca dhe propozime sipas mënyrës së caktuar me rregullorën e punës. Parashtrimin e iniciativës popullore e cila përmban kërkesën për miratimin e ligjit, e rregullon parlamenti me ligj i cili duhet të jetë në harmoni me ligjin sistemor që miratohet në bazë të neni 83 të statutit.

(5) Ligjet që i miraton parlamenti i shpallë kryetari i qeverisë së Baskisë, ata botohen në Gazetën zyrtare të Baskisë në fatin prej pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e miratimit të tyre si dhe në Gazetën zyrtare të shtetit. Hynë në fuqi ditën e botimit në Gazetën zyrtare të Baskisë.

Neni 28.

Parlamenti gjithashtu:

(a) emëron, në harmoni me dispozitat e neni 69.5 të kushtetutës, senatorët të cilët e përfaqësojnë Baskinë dhe atë në kuadër të procedurës së caktuar me ligj nga Parlamenti, e në bazë të së cilës duhet të sigurohet përfaqësimi proporcional;

(b) i paraqet kërkesa qeverisë së shtetit për miratimin e akteve të caktuara ose që propozimet për miratimin e tyre t'i dërgohen byrosë së kongresit dhe cakton anëtarët e parlamentit bask të cilët do t'i mbrojnë propozimet e akteve respektive;

(c) paraqet kërkesë për rishikimin e kushtetutshmërisë.

KREU II - QEVERIA DHE KRYETARI

Neni 29.

Qeveria e Baskisë është organ kolektiv i cili kryen funksione ekzekutive e administrative të Baskisë.

Neni 30.

Kompetencat e qeverisë, organizimin e saj të cilat e përfshijnë kryetarin këshillëtarët dhe statusin e anëtarëve të saj, i përcakton parlamenti.

Neni 31.

(1) Qeveria e Baskisë paraqet dorëheqjen pas mbajtjes së zgjedhjeve për parlament, me rastin e votës së mosbesimit në parlament dhe me rastin e dorëheqjes apo të vdekjes së kryetarit të qeverisë.

(2) Qeveria, mandati i së cilës ka skaduar, mbetet në detyrë deri në formimin e qeverisë së re.

Neni 32.

(1) Qeveria i përgjigjet kolektivisht parlamentit për kryerjen e kompetencave të veta pa kufizime të përgjegjësisë individuale të secilit anëtar të pushtetit për punën e tij në sferën përkatëse.

(2) Kryetari i qeverisë dhe anëtarët e saj nuk mund të arrestohen a të burgosen gjatë mandatit të tyre për vepra penale të kryera në territorin e Bashkësisë autonome, përpos nëse janë gjetur në kryerjen e tyre. Gjyqi i Lartë i Baskisë vendos për secilin rast individual, lidhur me ngritjen e aktakuzës kundër tyre, arrestimin e tyre, ndjekjen dhe zhvillimin e procedurës gjyqësore kundër tyre. Me rastin e përgjegjësisë penale për veprat për të cilat ekziston dyshimi se janë krye jashtë territorit të Baskisë vendimin për këto çështje e merr Këshilli penal i Gjyqit Suprem.

Neni 33.

(1) Kryetari i qeverisë emërohet nga radhët e anëtarëve të saj dhe atë e shpallë mbreti.

(2) Kryetari emëron dhe shkarkon këshilltarët e qeverisë dhe drejton punën e tyre. Ai është bartës i përfaqësimit të Baskisë dhe i përfaqësimit të rregullt të shtetit në territorin e Bashkësisë autonome.

(3) Parlamenti, rregullon me ligj mënyrën e zgjedhjes së kryetarit dhe funksionet e tij, si dhe marrëdhëniet midis qeverisë e parlamentit.

KREU III - ORGANIZIMI I GJYQËSISË

(1) Organizimi i gjyqësisë në Baski është i tillë që në krye gjendet Gjyqi i Lartë i Baskisë i cili ka kompetenca në mbarë territorin e Bashkësisë autonome. Ky njëherit është edhe gjyq i shkallës së fundit në procedurën e rregullt gjyqësore dhe është i organizuar në harmoni me dispozitat e ligjit sistemor mbi drejtësinë.

Bashkësia Autonome, në harmoni me dispozitat e neni 152 të kushtetutës, përcakton kufijt e autorizimeve vendore të gjyqeve në nivelin provincial dhe cakton selinë e tyre.

(2) Kryetarin e Gjyqit të Lartë të Baskisë e emëron mbreti.

(3) Në Bashkësinë Autonome krijohen kushtet për ushtrimin e iniciativës së popullit dhe të

pjesëmarrjes së tij në gjykime me anë të institucionit të porotës sipas mënyrës dhe me respektimin e dispozitave të legjislationit procesor.

Neni 35.

(1) Emërimi i gjyqëtarëve, i nëpunësve dhe i sekretarëve kryhet sipas mënyrës së caktuar me dispozitat e ligjit sistemor mbi drejtësinë dhe mbi Këshillin e Përgjithshëm për Judikaturë. Njohja e të drejtës tradicionale baske dhe e gjuhës baske - euskera, është kualifikimi të cilit i jepet përparësi me rastin e emërimit. Kurrfarë përjashtimesh nuk do të bëhen lidhur me origjinën ose vendin e banimit.

(2) Me kërkesë të Bashkësisë Autonome, organet kompetente do të organizojnë provime me konkurse për plotësimin e vendeve të zbrazur të gjyqëtarëve, këshillëtarëve dhe të sekretarëve në Baski, e në harmoni me dispozitat që gjenden në ligjin sistemor mbi drejtësinë. Të gjitha vendet e zbrazura që nuk janë plotësuar në bazë të konkursit për provime do të plotësohen në mbështetje të vendimit të Gjyqit të Lartë të Baskisë, i cili merret në bazë të aplikimit të rregullave që gjenden në ligjin sistemor mbi drejtësinë.

(3) Bashkësia Autonome në territorin e vet është përgjegjëse për vendosjen e bashkëpunimit të nevojshëm me qëllim të sigurimit të funksionit të rregullt të sistemit të drejtësisë në territorin e saj.

Neni 36.

Forcat Policore të Autonomisë së Baskisë, në masën ku vepron si polici gjyqësore, janë në shërbim dhe i nënshtrohen organizatës gjyqësore, e nën kushtet e përcaktuara me ligjet procesore.

KREU IV - INSTITUCIONET E TERRITOREVE HISTORIKE

Neni 37.

(1) Institucionet tradicionale juridike të territoreve historike bëjnë pjesë nën administratën e cila është veçori e tyre.

(2) Dispozitat e Statutit nuk mund të përmbajnë çfarëdo dispozite e cila ndryshon natyrën e regjimit special juridik në cilindo nga territoret historike.

(3) Në secilin rast veç e veç, territoret historike kanë kompetenca ekskluzive në territorin e vet në këto fusha:

- (a) organizimi, pozita dhe funksionimi i institucioneve vetjake;
- (b) propozimi dhe miratimi i buxhetit vetjak;
- (c) kufizimet territoriale të komunave, por jo jashtë territorit të provincës;
- (d) sistemi i pronës provinciale e komunale, edhe në nivelin e sektorit publik dhe i thesarit historik;
- (e) sistemi zgjedhor komunal.
- (f) të gjitha fushat tjera të caktuara me statut, të cilat janë bartur në kompetencën e saj.

(4) Territoret historik janë përgjegjëse për zhvillimin e rregullativës dhe për aplikimin e saj në territoret e veta, në rajonet të cilat ua ka besuar Parlamenti i Baskisë.

(5) Zgjedhja e organeve përfaqësuese të territoreve historike bëhet sipas të drejtës së përgjithshme, të lirë, direkte dhe të fshehtë të votimit, dhe sipas parimeve të përfaqësimit proporcional në njësitë elektorale, të cilat janë vendosur ashtu që të sigurojnë përfaqësimi adekuat të të gjitha pjesëve të atij territori.

KREU V - KONTROLI I USHTRIMIT TË KOMPETENCAVE TË CILAT I TAKOJNË BASKISË

Neni 38

(1) Ligjet që i miraton Parlamenti i Baskisë mund të jenë objekt i kontrollit të kushtetutshmërisë së tyre, që mund ta bëjë vetëm Gjyqi kushtetues.

(2) Në rastet e parashikuar me nenin 150.1. të Kushtetutës aplikohen dispozitat që i përmban neni i përmendur.

(3) Aktet, marrëveshjet, rregullat dhe dispozitat që i miratojnë organet ekzekutive e administrative të parlamentit mund të jenë objekt i ankesës para gjyqeve administrative.

Neni 39.

Çdo konflikt i kompetencave i cili mund të lind midis institucioneve të Bashkësisë autonome dhe secilit nga territoret historike, nxirret për të vendosur para këshillit të arbitrazhit i cili përbëhet nga numri i barabartë i përfaqësuesve të emëruar nga Qeveria e Baskisë dhe Këshilli Provincial i Territorit Historik në fjalë, e që kryeson kryetari i Gjyqit të Lartë të Baskisë, të cilën sipas procedurës me ligj e cakton Parlamenti i Baskisë.

KAPITULLI III - FINANCAT DHE PRONA

Neni 40.

Lidhur me ushtrimin dhe financimin e kompetencave të veta, Baskia ka trezorin e vet të përgjithshëm.

Neni 41.

(1) Raportet midis shtetit dhe Baskisë në sferën e tatimeve rregullohen me sistemin tradicional të marrëveshjeve dhe të konventave ekonomike.

(2) Përmbajtja e regjimit me marrëveshje respektohet dhe ajo u përshtatet këtyre parimeve:

(a) Institucionet kompetente të territoreve historike mund t'i mbajnë, formojnë dhe rregullojnë në territoret e veta sistemet tatimore duke shfaqur kujdes për strukturën e përgjithshme shtetërore të tatimit, për rregullat që i përmban marrëveshja ekonomike e cila ka të bëjë me koordinimin, harmonizimin fiskal dhe bashkëpunimin me shtetin si dhe për rregullat që i ka mirataur Parlamenti i Baskisë me qëllim të njëjtë e që aplikohen në Bashkësinë Autonome. Marrëveshja ekonomike i nënshtrohet ratifikimit.

(b) Grumbullimin, drejtimin, kërkesat, mbledhjen dhe inspektimet e të gjitha taksave, përpos atyre që janë të përfshira në të hyrat doganore dhe të atyre që mbledhen me anë të monopoleve tatimore, kryen Këshilli Provincial në secilin territor historik, dhe bashkëpunon me shtetin kur kjo nevojitet, por duke respektuar të drejtën e shtetit në kryerjen e inspektimit.

(c) Institucionet kompetente të territoreve historike miratojnë marrëveshje përkatëse me qëllim që territoret të veta t'ua mundësojnë aplikimin e rregullave të veçanta dhe të përkohëshme të tatimit të cilat i nxjerr shteti e që vlejné edhe në territoret tjera. Rregullat e tilla mbeten në fuqi aq gjatë sa aplikohen në ato territore tjera.

(d) Baskia e bartë në shtetin kuotën përkatëse e cila përbëhet nga kuotat individuale të secilit nga territoret si kontribut të vetin për taksat e shtetit të cilat nuk janë mbledhur drejtpërsëdrejti në nivel të Bashkësisë Autonome.

(e) Lidhur me caktimin e kuotës për secilin nga territoret historike e që hynë në kuotën e përgjithshme për të cilën flitet në dispozitën e mësipërme, formohet Komisioni i përbashkët i përbërë nga njëra anë prej përfaqësuesve të secilit nga këshillat provincialë, dhe nga numri i përafërt i përfaqësuesve të qeverisë së Bashkësisë Autonome, dhe nga ana tjetër nga numri i barabartë i përfaqësuesve të administratës së shtetit. Kuota që caktohet në këtë mënyrë konfirmohet me ligj në intervalet e caktuara me marrëveshjen ekonomike, duke respektuar mundësinë e ndryshimit të procedurës së konfirmuar me marrëveshjen ekonomike.

(f) Sistemi i marrëveshjes aplikohet në harmoni me parimin e solidaritetit për të cilën flitet në nenin 138 dhe 156 të Kushtetutës.

Neni 42.

Të hyrat e trezorit të përgjithshëm të Baskisë përbëhen nga:

(a) pagesat e këshillave provincialë të cilat paraqesin shprehjen e kontributeve të territoreve historike për shpenzimet e buxhetit të Bashkësisë Autonome; parlamenti cakton kriteret për shpërndarjen e barabartë dhe procedurën e caktimit të lartësisë së kontributeve të secilit territor historik, si dhe për mënyrën e pagesës së tij,

(b) të hyrat nga taksat e vetë Bashkësisë Autonome të cilat i cakton parlamenti në harmoni me dispozitat e nenit 157 të kushtetutës dhe të përmbajtjes së ligjit sistemor mbi financimin e Bashkësisë Autonome;

(c) transferi prej fondit përlogaritar ndërterritorial dhe prej alokacioneve tjera që shkojnë në ngarkesë të buxhetit të përgjithshëm të shtetit;

(d) të hyrat që realizohen nga prona vetjake dhe nga të hyrat private ligjore;

(e) të hyrat nga operacionet kreditore dhe nga operacionet që kanë të bëjnë me borxhet publike;

(f) nga të gjitha të hyrat tjera që mund të formohen në bazë të dispozitave të kushtetutës e të këtij statuti.

Neni 43.

(1) Të drejtat dhe pronat e shtetit dhe e shërbimeve të tjera publike që kanë lidhje me ushtrimin e autorizimeve publike dhe të funksioneve që i ka marrë Bashkësia Autonome, konsiderohen si burime të të hyrave të kësaj të fundit.

(2) Parlamenti e cakton se cilët nga organet e Baskisë e posedon ose e shfrytëzon këtë pronë dhe të drejtën që duhet të bartet.

(3) Parlamenti rregullon me anë të ligjit drejtimin, mbrojtjen dhe sigurinë e thesarit të Baskisë.

Neni 44.

Buxheti i përgjithshëm i Bashkësisë Autonome përbëhet nga të hyrat dhe të dalurat e aktiviteteve të përgjithshme publike. Buxhetin e propozon qeveria e Baskisë dhe e miraton Parlamenti në harmoni me rregullat që i ka caktuar vetë.

Neni 45.

(1) Bashkësia Autonome e Baskisë mund të shpallë hua publike për financimin e shpenzimeve investicionale.

(2) Vëllimi dhe karakteristikat e fletëobligacioneve caktohen në harmoni me planin e përgjithshëm

të politikës kreditore dhe në bashkëpunim me shtetin.

(3) Fletëobligacionet e lëshuara konsiderohen në të gjitha rrethanat fonde publike.

KAPITULLI IV - NDRYSHIMI I STATUTIT

Neni 46.

(1) Ndryshimet e Statutit kryhen sipas kësaj procedure:

(a) të drejtën e marrjes së iniciativës për ndryshimin e statutit e ka parlamenti me propozim të një të pestës së anëtarëve të vet, Qeveria e Baskisë dhe parlamenti i shtetit të Spanjës;

(b) propozimin duhet ta miratojë Parlamenti me shumicën absolute të votave;

(c) ndryshimet duhet t'i konfirmojë parlamenti i shtetit të Spanjës me anë të ligjit sistemor;

(d) pranimi nga zgjedhësit me anë të të referendumit.

(2) Qeveria e Baskisë është e autorizuar që në bazë të autorizimit kategorik të shtetit lidhur me këtë çështje të shpallë referendumin.

Neni 47.

(1) Kur objekti i ndryshimit të statutit është vetëm ndryshimi i organizimit të pushtetit të Baskisë, kur ndryshimi nuk prodhon pasoja për marrëdhëniet Bashkësia Autonome - shteti ose për sistemin ekskluziv të mbështetur në të drejtën tradicionale rajonale të territorit historik, aplikohet kjo procedurë:

(a) përgatitet propozimndryshimi të cilin e ka inicuar parlamenti i Bashkësisë Autonome;

(b) konsultohet Parlamenti i shtetit të Spanjës dhe Parlamenti i Bashkësisë Autonome;

(c) nëse asnjëri nga organet e konsultuara nuk jep vërejtje në afatin prej tridhjetë ditësh, shpallet referendumi në të cilin jepet teksti i propozuar i ndryshimeve;

(d) Parlamenti i shtetit të Spanjës aprovon ndryshimet me anë të ligjit sistemor;

(e) nëse në afatin nga pika (c) secili nga organet e konsultura jep vërejtje, aplikohet procedura e përcaktuar me nenin 46; në këtë rast konsiderohet se fazat që rregullohen me pikat (a) dhe (b) kanë përfunduar.

(2) Në rast të urgjencës, për çka flitet në dispozitën katër (kalimtare) të kushtetutës, Kongresi dhe Senati, në seancën e përbashkët dhe sipas procedurës të cilën e caktojnë bashkë, vendosin me shumicën absolute të votave se cila nga kërkesat e nenit 46 duhet të aplikohen në procedurën e ndryshimit të statutit. Kjo procedurë gjithsesi duhet të përfshijë miratimin nga institucionet kompetente tradicionale, aprovimin nga Parlamenti i shtetit të Spanjës me anë të ligjit sistemor dhe referendumin që zbatohet në territoret në të cilat këto ndryshime prodhojnë pasoja.

(3) Dispozita e paragrafit dy pika (b), dispozita gjashtë e nenit 17 të statutit, mund të mos aplikohet nëse vendimin e tillë e marrin me shumicën e tre të pestave të votave të gjithë anëtarët e Kongresit e të Senatit, e konfirmon Parlamenti i Baskisë dhe referendumi i shpallur për këtë qëllim.

DISPOZITA SHTOJÇË

Pranimi i sistemit të autonomisë në këtë statut, nuk nënkupton se populli bask ka hequr dorë nga e drejta që si e tillë i takon historikisht, dhe e cila sërish mund të jetësohet në harmoni me zgjidhjet në sistemin juridik.

DISPOZITAT KALIMTARE

1. Këshilli i Përgjithshëm i Baskisë, më së largu gjashtëdhjetë ditë nga dita e konfirmimit definitiv të këtij statuti, do të shpallë zgjedhjet për Parlamentin Bask. Zgjedhjet do të mbahen në afatin prej katër muajsh nga dita e shpalljes.

Secili nga territoret historike që gjendet në përbërje të Bashkësisë Autonome paraqet njësinë elektorale. Partitë politike, koalicionet e pative dhe grupet elektorale mund të paraqesin kandidatët në secilën njësi elektorale, në listë të përbashkët. Ndarja e vendeve kryhet në harmoni me parimin e përfaqësimit proporcional. Për secilën njësi elektorale janë nga nëntë anëtarë të Parlamentit.

Pas mbajtjes së zgjedhjeve, Këshilli i Përgjithshëm i Baskisë do të konvokojë parlamentin për konstituimin kurse ky do të emërojë kryetarin e qeverisë së Baskisë.

Zgjedhja e kryetari bëhet me shumicën absolute të votave në fazën e parë të votimeve, e nëse kjo nuk realizohet në fazën e dytë apo në fazat tjera të votimeve, për zgjedhjen e tij mjafton shumica e thjeshtë e votave.

Në qoftë se kryetari i qeverisë nuk zgjidhet në afatin prej gjashtëdhjetë ditësh nga dita e konstituimit të Parlamentit, parlamenti shpërndahet dhe shpallen zgjedhjet e reja.

Si më plotësuese do të aplikohen rregullat që janë miratuar lidhur me rregullimin e zgjedhjeve të përgjithshme spanjolle, të mbajtura më 15 qershor të vitit 1977, si dhe rregullorja në fuqi e punës së Kongresit.

2. Komisioni i përbashkët i përbërë nga numri i barabartë i përfaqësuesve të Qeverisë së Baskisë dhe shtetit, që do të mblidhet më së voni në afatin prej një muaji pas konstituimit të qeverisë së shtetit, miraton rregullat sipas të cilave do të bëhet marrja e kompetencave të cilat në bazë të këtij Statuti i janë besuar Bashkësisë Autonome si dhe marrja e personelit dhe e të mirave materiale që nevojiten për kryerjen e këtyre kompetencave dhe do ta bëjë këtë me kalim.

Me hyrjen në fuqi të këtij statuti, konsiderohet se kompetencat dhe burimet që deri atëherë janë bartur në Këshillin e Përgjithshëm Bask, definitivisht janë bartur në Bashkësinë Autonome.

Rspektohen të gjitha të drejtat, pavarësisht nga lloji dhe natyra, të cilat deri në kohën e marrjes së kompetencave kanë fituar nëpunësit e shtetit dhe personat tjerë që janë të punësuar në shërbimet shtetërore ose në institucionet publike.

3. (1) Marrja e kompetencave në sferën e arsimit, si dhe të pronës e të personelit që tani gjendet në shërbimin e shtetit, kryhet në harmoni me programin dhe orarin të cilin e harton komisioni i përbashkët, e të caktuar në pjesën e dytë të dispozitave kalimtare.

(2) Kompetencat në sferën e arsimit barten ose në Bashkësinë Autonome ose në Këshillat provinciale varësisht nga secili rast individual.

4. Këshilli për siguri i cili do të formohet në bazë të dispozitave të nenit 17, vendos për statusin e Forcave Policore të Autonomisë, për rregulloret e tyre, të punësuarit, numrin e tyre dhe për mënyrën e punësimit. Komandanti i këtyre forcave do të emërohet nga radhët e komandantëve dhe oficerëve të forcave të sigurimit. Ndaj tij, derisa të shërbejë në këto forca, do të aplikohen rregullat të cilat do të përcaktohen me Ligjin mbi Forcat Policore të Bashkësisë Autonome, ose pozita do t'i cakohet sipas rregullave të caktuara nga Ministria e Mbrojtjes dhe e Punëve të Brendshme. Derisa gjendet nën këtë regjim ndaj komandantit të forcave policore të Bashkësisë Autonome nuk do të aplikohet Ligji mbi Ushtrinë.

Dhënia e lejeve për mbajtjen e armëve, në çdo rast, është në kompetencën e shtetit.

5. Komisioni i përbashkët, kompetent për marrje, i cili do të themelohet për aplikimin e këtij statuti, do të lidh marrëveshjen përkatëse në bazë të së cilës Bashkësia Autonome mund të marrë drejtimin e burimeve ekonomike të sigurimit social. Bashkësia Autonome në kryerjen e kësaj pune do të respektojë parimin e unitetit të sistemit të sigurimit social dhe parimin e solidaritetit dhe do ta ushtrojë atë në

harmonit me procedurën, brenda afateve dhe në përputhje me zgjidhjet që vlejné për administrimin e rregullt, e që do t'i mbajë ajo marrëveshje.

6. Koordinimi, për të cilin flitet në nenin 19.2 do të aplikohet atëherë kur shteti ta bartë në Bashkësinë Autonome, mbi baza koncesionale, përdorimin e kanalit televiziv i cili është në pronësi të shtetit, për hirë të emetimit të programit në territorin e Baskisë, nën kushtet që do të caktohen me koncesionin e përmendur.

7. (1) deri në momentin derisa Parlamenti i Spanjës nuk miraton ligjet themelore dhe të përgjithshme që përmenden në këtë statut, ose këtë nuk e bënë Parlamenti i Baskisë në kuadër të kompetencave të veta, në fuqi mbeten ligjet ekzistuese të shtetit duke respektuar të drejtat e Bashkësisë Autonome që ato t'i kryej sipas mënyrës që është rregulluar me këtë statut.

(2) Dispozitat e neni 23.1. të këtij statuti do të interpretohen ashtu që të respektohen veçoritë e caktuara që janë karakteristike, për shkak të natyrës së tyre, e disa shërbimeve të shtetit, e të cilat mund të kërkojnë ushtrimin e autorizimeve të këtyre shërbimeve në territorin e Bashkësisë autonome.

8. Marrëveshja e parë ekonomike që do të lidhet pas miratimit të këtij statuti, do të frymëzohet me përmbytjen e marrëveshjes ekzistuese ekonomike me provincën Alava, me kusht që kjo dispozitë të mos interpretohet në dëm të provincës Alava. Tatimet e shtetit për alkoolin nuk do të përfshihen me këtë marrëveshje.

9. Pas miratimit të ligjit sistemor me të cilin miratohet ky statut. Këshilli i Përgjithshëm i Baskisë do të japë pëlqimin që mbi vetëvete të marrë funksionin e qeverisë së përkohshme të Baskisë, por që përveç kësaj të mbajë edhe funksionet ekzistuese dhe pozitën juridike që janë caktuar me pjesën e parë të dispozitave kalimtare, derisa statuti të mos hyjë në fuqi.

3. REPUBLIKA E FINLANDËS

a. LIGJI MBI AUTONOMINË E ALANDEVE

(16 GUSHT 191/1144)

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

KAPITULLI 1

Autonomia e Alandeve

Ishujt Alande janë autonom siç është përcaktuar me këtë ligj.

KAPITULLI 2

Territori i Alandeve

Alandet kapin territorin të cilin e posedojnë në kohën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji, si dhe ujërat territoriale që kufizohen drejtpërdrejtë me territorin e tyre në përputhje me dispozitat në fuqi që kanë të bëjnë me kufijtë e ujërave territoriale të Finlandës.

Në qoftë se juridiksioni dhe sovraniteti i shtetit shtrihen jashtë kufijve të ujërave territoriale, juridiksioni dhe sovraniteti i Alandeve gjithashtu mund të shtrihet sipas marrëveshjes midis shtetit dhe Alandeve.

KAPITULLI 3

Organet e Alandeve

Kuvendi legjislativ i Alandeve përfaqëson popullin e ishujve Alande në çështjen që kanë të bëjnë me autonominë e tyre.

Drejtimi i Alandeve i është besuar Qeverisë së Alandeve dhe funksionarëve që i janë nënshtruar asaj.

KAPITULLI 4

Gubernatori përfaqëson Qeverinë e Finlandës në Alande. Ai emërohet sipas mënyrës së përcaktuar në paragrafin 52.

KAPITULLI 5

Delegacioni i Alandeve

Delegacioni i Alandeve është organ i përbashkët i Alandeve dhe i shtetit. Përbërja e tij, kompetencat dhe shpenzimet janë rregulluar me paragrafët 55-57.

KREU II

E drejta e qëndrimit në Alandë

KAPITULLI 6

E drejta e qëndrimit sipas ligjit

Të drejtë qëndrimi në Alande kanë këta persona:

- 1) personat që gjatë kohës së hyrjes në fuqi të këtij Ligji kanë pasur të drejtë qëndrimi sipas Ligjit mbi Autnominë e Alandeve (28 dhjetor 1951/670); dhe
- 2) fëmijët në moshë nën 18 vjet, që janë shtetas të Finlandës me banim në Alande, me kusht që njëri nga prindërit të ketë të drejtë qëndrimi.

KAPITULLI 7

E drejta për qëndrim në bazë të kërkesës së paraqitur.

Mbi të drejtën për qëndrim vendos Qeveria e Alandeve.

Me përjashtim, nëse nuk ekzistojnë shkaqe bindës për të kundërtën, qëndrimi në bazë të kërkesës u jepet shtetasve të Finlandës:

- 1) që janë vendosur në Alande,
- 2) që janë vendosur në Alande gjatë periudhës së pandërprerë të paktën prej pesë vitesh, dhe
- 3) që posedojnë njohuri të mjaftueshme të gjuhës suedeze.

Nën kushtet e veçanta e drejta për qëndrim mund t'i jepet personit i cili nuk i përmbush kushtet nga alineja 2 pika 2 e 3, nën kushtet nga dispozitat e ligjit provincial.

KAPITULLI 8

Humbja e të drejtës për qëndrim

Personi që e humbë shtetësinë e Finlandës e humb edhe të drejtën për qëndrim.

Të drejtën për qëndrim, sipas Ligjit provincial, e humbë ai person i cili vendin e qëndrimit të tij të përhershëm e ndryshon nga Alandet.

KAPITULLI 9

E drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur

Vetëm ai person që ka qëndrim mund të marrë pjesë në zgjedhje për Kuvendin legjislativ, këshillat komunale dhe funksionet tjera në administratën e provincës dhe të komunës. Vetëm ata pesona që e kanë të siguar qëndrimin kanë të drejtë të zgjidhen në ato funksione.

E drejta për të zgjedhë dhe për t'u zgjedhur në rastet e caktuara është rregulluar me dispozitat nga paragrafi 67.

KAPITULLI 10

E drejta për blerjen e patundshmërisë

Kufizimet lidhur me të drejtën për të fituar pasuri të patundshme, apo të natyrës së ngjashme në Alande me titull të plotë juridik ose me të drejtë të gëzimit, janë rregulluar me Ligjin mbi fitimin e patundshmërive në Alande (3 janar 1975/3). Kufizimet nuk kanë të bëjnë me personat me të drejtë qëndrimi.

KAPITULLI 11

E drejta e ushtrimit të veprimtarisë ekonomike

E drejta e atij personi që nuk ka të drejtë qëndrimi, për të ushtruar veprimtari ekonomike apo që të merret me profesione të tjera në Alande për dobi personale, mund të kufizohet me ligjet e provincës. Mirëpo, një ligj i tillë i provincës nuk mund të shfrytëzohet për kufizimin e të drejtës së pesonave që kanë qëndrim të përhershëm në Alande për ushtrimin e veprimtarive ekonomike, nëse asnjë person tjetër përpos bashkëshortit dhe fëmijës së mitur nuk është i punësuar në atë veprimtari dhe në qoftë se ajo nuk ushtrohet në lokale afariste, kancelari apo në çfarëdo hapësire tjetër të veçantë për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike.

KAPITULLI 12.

Shërbimi i afatit ushtarak

Personat me të dejtë qëndrimi, në vend të shërbimit të afatit ushtarak këtë obligim mund ta kryejnë adekuat në shërbimin e kapitenerisë së portit apo në fenerin e detit por edhe në ndonjë detyrë tjetër civile në administratë. Shërbimi në kapitenerinë e portit apo në fenerin e detit është e rregulluar me ligjin shtetëror me pëlqimin e Kuvendit legjislativ. Derisa mënyra e tillë e kryerjes së obligimit ushtarak nuk do të rregullohet, banorët e Alandeve do të përjashtohen nga shërbimi i afatit ushtarak, sipas alinesë 1.

Alineja 1 nuk ka të bëjë me personat të cilët vendqëndrimin e përhershëm në Alande e kanë fituar pas përfundimit të moshës dymbëdhjetëvjeçare.

KREU III

Kuvendi legjislativ dhe Qeveria e Alandeve

KAPITULLI 13

Zgjedhja e anëtarëve të Kuvendit legjislativ

Anëtarët e Kuvendit legjislativ zgjidhen me vota të drejtpërdrejta e të fshehta. E drejta e votimit është universale dhe e njëjtë për të gjithë qytetarët.

KAPITULLI 14

Hapja dhe mbyllja e sesioneve të Kuvendit legjislativ

Sesioni i kuvendit legjislativ hapet dhe mbyllet nga kryetari i Republikës apo këtë e bën guvernatori në emër të tij. Guvernatori i paraqet kuvendit legjislativ propozimet dhe qëndrimet e kryetarit.

KAPITULLI 15

Shpërndarja e Kuvendit legjislativ

Pas konsultimeve me kryetarin e kuvendit legjislativ, kryetari i Republikës mund ta shpërndajë kuvendin legjislativ dhe të jep urdhëresën për mbajtjen e zgjedhjeve. E drejta e Kuvendit legjislativ për të vendosur mbi shpërndarjen dhe urdhëresën për zgjedhjet është e rregulluar me ligjin e provincës.

KAPITULLI 16

Qeveria e provincës

Qeveria e Alandeve emërohet në përputhje me dispozitat e Ligjit të provincës.

KREU IV

Kompetencat në Alande

KAPITULLI 17

Organi legjislativ i Provincës

Kuvendi legjislativ nxjerr ligjet për Alandet (ligjet e provincës).

KAPITULLI 18

Kompetencat legjislativ të Alandeve

Alandet kanë kompetencat legjislativ në raport me:

- 1) organizimin dhe detyrat e kuvendit legjislativ dhe zgjedhjen e antares të tij, të qeverisë së Alandeve dhe të funksionarëve të shërbimeve në to, dhe
- 2) funksionarët e Alandeve, kontratat kolektive mbi të ardhurat e të punësuarve në Alande dhe dënimin disiplinor të funksionarëve të Alandeve;

3) flamurin dhe stemën e Alandeve dhe përdorimin e tyre në Alande, shfytëzimin e flamurit të provincës në anijet e Alandeve të marinës tregëtare, objektet e lundrimit të peshkatarëve, anijet turistike dhe në objektet e ngjashme të lundrimit, porti amë i të cilave është në Alande, me çka nuk kufizohet e drejta e zyrave dhe e shërbimeve të shtetit apo e personave privatë për ta shfrytëzuar edhe flamurin e shtetit;

4) kufijtë e komunave, zgjedhjet, administratën dhe funksionarët nëpër komuna, kontrata kolektive mbi rrogat e funksionarëve komunal dhe caktimin e dënimit disiplinor të funksionarëve komunalë;

5) tatimet shtojcë mbi të ardhurat për Alandet dhe tatimet shtojcë të përkoshme mbi të ardhurat, si dhe tatimet mbi veprimtarinë ekonomike dhe tatimet mbi aktivitetet nga sfera e argëtimit, bazat e tatimeve që caktohen për Alandet dhe tatimin komunal;

6) rregullin publik dhe qetësinë, me përjashtime që janë parashikuar në kaptinën 27, me pikat 27, 34 dhe 35, shërbimin e zjarrfikësve dhe të shpëtimit;

7) ndërtimin dhe planifikimin, objekteve përcjellëse, ndërtimin e banesave;

8) fitime nga pasuria e patundshme dhe nga të drejtat speciale për shfrytëzim publik në këmbim për kompenzim të plotë, me përjashtime të parashikuara në kapitullin 61;

9) marrjen me qira të pronave dhe dispozitat mbi qiradhënien, dhënien me qira (qesim) të tokës,

10) mbrojtjen e natyrës dhe të ambjentit të njeriut, shfrytëzimin e natyrës për qëllime rekreative, ligjet mbi ujërat;

11) sendet parahistorike dhe mbrojtjen e godinave dhe të të mirave artistike me vlera kulturore e historike;

12) mbrojtjen shëndetësore dhe kurimin, me përjashtime të parashikuara në paragrafin 27, pika 24, 29 dhe 30; kremacionin;

13) sigurimin social, lejet për toçitjen e pijeve alkoolike;

14) arsimimin, kulturën, sportin dhe punët rinore; shërbimet arkivore, bibliotekare dhe muzeale, me përjashtime të parashikuara në paragrafin 27, pika 39;

15) bujqësia dhe pylltarinë, prodhimin e rregulluar bujqësor, me kusht që funksionorët e shtetit, gjatë përgaditjes, të konsultohen para miratimit të dispozitave me të cilat rregullohet prodhimi bujqësor;

16) gjuetinë e peshkimit, regjistrimin e anijeve të peshkimit dhe dispozitat që rregullojnë industrinë për përpunimin e peshkut;

17) pengimin e sjelljes së egër ndaj shtazëve dhe shërbimet veterinarë, me përjashtim të parashikuara në paragrafin 27, pika 31-33;

18) mirëmbajtjen e kapaciteteve prodhuese, ekonomike bujqësore të pyjeve e ujërave të peshkimit; detyrimet e transferit për ndërrim me kompenzim të plotë të tokave të pashfrytëzuara apo pjesërisht të shfrytëzuara bujqësore ose të ujërave të peshkimit në personin tjetër lidhur me shfrytëzimin për qëllime destinuese në periudhën e caktuar kohore;

19) të drejtën e kërkimit dhe të posedimit të drejtës së shfrytëzimit të burimeve minerare;

20) shërbimet e PTT dhe të drejtën për emetime me anë të radios apo televizionit në Alande, me kufizime që dalin nga paragrafi 27 pika 4;

21) rrugët dhe kanalet, komunikacionin rrugor, hekurudhor dhe ujqor, linjat lokale të anijeve;

22) tregtinë që i nënshtrohet dispozitave të paragrafit 11, paragrafit 27 pikave 2, 4, 12-15, 17-19, 26, 27, 29-34, 37 dhe 40 dhe paragrafit 29 pika 1, 3-5 me përjashtim që Kuvendi legjislativ të ketë kompetenca për të miratuar masa me qëllim të avancimit të ligjshmërisë nga pikat e përmendura më përpara;

23) nxitjen e punësimit;

24) statistikat mbi kushtet në Alande;

25) veprat penale dhe dënimet përkatëse në fushat që bëjnë pjesë në kompetencat ligdhënëse të Alandeve;

26) këcënimin me dënim me para dhe zbatimin e tij si dhe shfrytëzimi i mënyrave tjera të dhunës në raport me çështjet që bëjnë pjesë në kompetencat ligjdhënëse të Alandeve;

27) çështjet tjera për të cilat konsidrohen se bëjnë pjesë në kompetencat ligjdhënëse të Alandeve në përputhje me parimet nga ky Ligj.

KAPITULLI 19

Mbkëqyrja e dispozitave ligjore

Projektligji i Provincës i paraqitet kryetarit të Republikës. Para paraqitjes së projektit, delegacioni i Alandeve prezenton arsyetimin e vet lidhur me këtë çështje.

Pas refuzimit të mendimit të Gjyqit Suprem, kryetari i Republikës mund ta shpall Ligjin e Provincës në tërësi apo pjesërisht të pavlefshme në qoftë se konsideron se Kuvendi legjislativ i ka tejkaluar kompetencat e veta ligjdhënëse ose se Ligji i Provincës ka të bëjë me sigurinë e jashtme e të brendshme të shtetit. Kryetari urdhëron anulimin në fatin prej katër muajve nga dita kur i është paraqitur vendimi i Kuvendit legjislativ.

Për shkak të formës së njëjtë dhe qartësisë, ligji i provincës mund të përmbajë dispozita të çështjeve që kanë të bëjnë me kompetencat ligjdhënëse të shtetit, me kusht që ato, për nga esenca, të jenë në përputhje me dispozitata përkatëse të ligjit të shtetit. Përfshirja e dispozitave të tilla në ligjin e provincës nuk e ndryshon ndarjen e kompetencave legjislative të shtetit dhe të Alandeve.

KAPITULLI 20

Hyrja në fuqi e Ligjit të Provincës

Në qoftë se kryetari i Republikës e ka anuluar Ligjin e Provincës ose në qoftë se a i ka vendosur që të mos e shfrytëzojë të drejtën e vetos, Qeveria e Alandeve do të njoftohet lidhur me këtë.

Kur vetoja e kryetarit ka të bëjë vetëm me një pjesë të Ligjit të Provincës, Qeveria e Alandeve merr vendimin sipas parashikimeve të Ligjit të Provincës se a do të hy në fuqi pjesa tjetër e ligjit apo ligji do të anulohet në tërësi.

Ligjet e provincës i shpallë Qeveria e Alandeve. Nëse Kuvendi legjislativ nuk e ka theksuar ditën e hyrjes në fuqi të ligjit, këtë do ta bëjë Qeveria e Alandeve.

KAPITULLI 21

Vendimet e provincës

Sipas kompetencave që dalin nga Ligji i Provincës, Qeveria e Alandeve mund të miratojë vendime provinciale mbi organizimin dhe aktivitetet e administratës së provincës, mbi zbatimin dhe aplikimin e ligjeve si dhe mbi çështjet tjera nga suazat e kompetencave të Alandeve.

Dispozitat e paragrafit 19, pika 3, mbi ligjet e provincës, aplikohen edhe në vendimet e provincës.

KAPITULLI 22

Nisma e kuvendit legjislativ dhe e qeverisë së Alandeve

Kuvendi legjislativ mund t'i paraqesë iniciativa shtetit lidhur me çështjet nga kompetencat legjislative të shtetit. Këto iniciativa ia paraqet për shqyrtim parlamentit finlandez qeveria e Finlandës.

Qeveria e Alandeve mund të paraqet iniciativa mbi çështjet nga pika 1, e lidhur me shpalljen e dispozitave dhe të normave administrative për Alandet.

KAPITULLI 23

Pushteti administrativ i Alandeve

Funksionarët e provincës janë kompetentë për çështjet e administratës nga fushëveprimi i kompetencave administrative të Alandeve e që janë objekt i:

1) informatave, statistikave të nevojshme për shtetin, e që nuk gjenden tek funksionarët e provincës, vëhen në dispozitë të funksionarëve të shtetit me kërkesë të tyre;

2) të dhënat statistikore për shfrytëzim në Alande grumbullohen në bashkëpunim me funksionarët kompetent të shtetit;

3) para marrjes së masave për vlerat e patundshme parahistorike kulturore, Qeveria e Alandeve është e obligueshme të sigurojë mendimin e funksionarëve kompetentë të shtetit;

4) para se funksionarët e provincës, të komunës dhe zyrtarët kishtarë të marrin vendimin për asgjësimin e dokumenteve që gjenden në Arkivin e Alandeve, Qeveria e Alandeve është e obligueshme të sigurojë mendimin e Arkivit Kombëtar.

KAPITULLI 24

Shtetësia e funksionarëve

Funksionarët në Alande apo në ndonjë komunë të Alandeve mund të jenë shtetas të Finlandës, Islandës, Norvegjisë, Suedisë ose të Danimarkës. Punësimi i të huajve të tjerë në shërbimet e tilla është i rregulluar me ligjin e provincës.

Në polici mund të punësohen ekskluzivisht shtetasit e Finlandës.

KAPITULLI 25

Procedura administrative

Kundër vendimit të administratës që e ka miratuar ndonjëri nga trupat e nënshtruar Qeverisë së Alandeve, mund t'i parashirohen ankesa Qeverisë së Alandeve, me kusht që ato të kenë të bëjnë me tatimet apo taksat. Ankesa kundër vendimit të pushtetit komunal mund t'i parashirohet gjyqit administrativ të rrethit apo instancës së dytë, sikurse është prashikuar me ligjin e shtetit. Pavarësisht nga kjo, me Ligjin e Provincës mund të parashikohet që ankesa kundër vendimit të pushtetit komunal nga kompetencat e Alandeve mund t'i paraqitet Qeverisë së Alandeve.

Ankesa lidhur me ligjshmërinë e vendimit të Qeverisë së Alandeve i paraqitet Gjyqit Suprem Administrativ. Vendimi i Qeverisë së Alandeve mbi emërimet nuk i nënshtrohet ankesës.

KAPITULLI 26

Formimi i Gjyqit Administrativ

Gjyqi Administrativ në Alande mund të formohet me ligjin e shtetit. Pavarësisht nga paragrafi 25, gjyqit të tillë, me Ligjin e Provincës, mund t'i jepet juridiksioni mbi çështjet administrative nga kompetencat e Alandeve.

KREU V

Kompetencat e shtetit

KAPITULLI 27

Kompetencat legislative të shtetit

Shteti ka kompetenca mbi çështjet që kanë të bëjnë me:

- 1) miratimin, nxjerrjen e ndryshimeve e të plotësimeve, interpretimin dhe pezullimin e ligjit kushtetues e të përjashtimeve nga ligji kushtetues;
- 2) të drejtën e qëndrimit në vend, zgjedhjen e vendit të banimit dhe të qarkullimit nga njëri në vendin tjetër, shfrytëzimin e lirisë së të folurit, të lirisë së bashkimit e të lirisë së tubimit, fshehtësinë e postës e të telekomunikacioneve;
- 3) organizimin dhe aktivitetin e funksionarëve të shtetit;
- 4) marrëdhëniet me botën e jashtme, që u nënshtrohen dispozitave të paragrafit 9;
- 5) flamurin dhe stemën e shtetit dhe përdorimin e tyre me përjashtime të parashikuara me paragrafin 18, pika 3;
- 6) mbiemrin e emrin, kujdesjen, dhënien e fletëvdekjeve;
- 7) bashkëshortësinë dhe marrëdhëniet familjare, statusin juridik të fëmijëve, birësimin dhe trashëgiminë, me përjashtime të parashikuara në paragrafin 10;
- 8) asociacionet e fondacionet, kompanitë dhe korporatat e tjera private, mbajtjen e librave;
- 9) kushtet e përgjithshme në shkallë shteti lidhur me të drejtat e të huajve dhe të korporatave të huaja mbi pronësinë dhe posedimin e pasurisë së patundshme e të aksioneve, si dhe me ushtrimin e ndonjë veprimtarie ekonomike;
- 10) të drejtat e autorëve, patentet, të drejtat e autorëve në disejn dhe simbole mbrojtëse, praktikën jolojale afariste, nxitjen e konkurrencës, mbrojtjen e konsumatorëve;
- 11) kontratat mbi sigurimin;
- 12) tregtinë e jashtme;
- 13) marinën tregëtare dhe linjat e anijeve;
- 14) aviacionin;
- 15) çmimet e produkteve të industrisë bujqësore e peshkatore dhe nxitjen e eksportit të prodhimeve bujqësore;
- 16) formimin dhe regjistrimin e parcelave të pronave të patundshme dhe taksat përkatse;
- 17) burimet minerale dhe xehëtarinë, me përjashtime të parashikuara në paragrafin 18, pika 19;
- 18) energjinë bërthamore; mirëpo për ndërtimin, posedimin dhe funksionimin e centraleve bërthamore si dhe drejtimitin e deponimitin e materialit në fjalë, në Alande lypset pëlqimi i Qeverisë së Alandeve;
- 19) njësitë, aparatet e matjes dhe metodat e matjes, standardizimin;
- 20) prodhimin dhe vulojën e metaleve të çmueshme dhe tregëtimin me sendet që përmbajnë metale të çmueshme;
- 21) ligjin mbi marrëdhëniet në punë, me përjashtim të kontratave kolektive mbi rrogat e funksionarëve të provincës e të komunave, që i nënshtrohen dispozitave të paragrafit 29, pika 1, 6 dhe paragrafit 29 alineja 2;
- 22) kodin penal me përjashtime të parashikuara në paragrafin 18 pika 25;
- 23) procedruat gjyqësore që u nënshtrohen dispozitave të paragrafit 26 dhe 26 nga mbrapa, zbatimin e gjykimeve e të dënimeve si dhe ekstradimitin e delikuentëve;
- 24) shkurtimin administrativ të lirisë personale;

- 25) kodeksin kishtar dhe dispozitat tjera që kanë të bëjnë me bashkësinë fetare, të drejtën e ushtrimit të funksioneve publike pa marrë parasysh përkatësinë fetare;
- 26) shtetësinë, dispozitat mbi të huajt, pasaportat;
- 27) armët dhe municionin;
- 28) mbrojtjen civile; mirëpo vendimi për evakuimin e shtetasve të Alandeve në lokacionet jashtë Alandeve mund të merret vetëm me pëlqimin e Qeverisë së Alandeve;
- 29) sëmundjet ngjitëse tek njerëzit, kastrimet dhe sterilizimet, abortuset, mbarsimet artificiale, medicinën gjyqësore;
- 30) kualifikimet e personave që merren me mbrojtjen shëndetësore dhe me dhënien e shëbimeve të tjera medicinale, shërbime farmaceutike, prodhimet medicinale e farmaceutike, ilaçet e prodhimet e helmeve dhe me caktimin e shfrytëzimit të tyre;
- 31) smundjet ngjitëse të shtazëve shtëpiake dhe të bagëtive;
- 32) ndalimin e importimit të shtazëve dhe të prodhimeve shtazore;
- 33) evitimin e hyrjes në vend të substancave që dëmtojnë bimët;
- 34) ushtrinë dhe kufitarët që i nënshtrohet dispozitave të paragrafit 12; aktivitetet e organeve kompetente për sigurimin e shtetit, çështjet e mbrojtjes së shtetit, gadishmërinë për rrethana të jashtëzakonshme;
- 35) substancat ekskluzive në atë pjesë që ka të bëjë me sigurinë e shtetit;
- 36) tatimet dhe taksat me përjashtime të parashikuara në paragrafin 18, pika 5;
- 37) emetimin e parave prej letrës; të devizave;
- 38) statistikat e nevojshme për shtetin;
- 39) materialin arkivor të marrur nga funksionarët e shtetit, që i nënshtrohen dispozitave të paragrafit 30, pika 17;
- 40) telekomunikacionet; funksionarët e shtetit mund të lejojnë aktivitete nga fusha e telekomunikacioneve në Alande vetëm me pëlqimin e Qeverisë së Alandeve;
- 41) çështjet tjera nga sfera e të drejtës private që nuk janë përmendur konkretisht në këtë paragraf, me përjashtim kur është fjala mbi çështjet që drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me sferën e ligjshmërisë në kompetencat e Alandeve e në përputhje me këtë ligj;
- 42) çështjet tjera për të cilat konsiderohet se janë në kompetencat e shtetit, sipas parimeve nga ky ligj.

KAPITULLI 28

Ligjet e shtetit me rëndësi të posaçme për Alandet

Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit kushtetues apo të ndonjë ligji tjetër të shtetit nuk mund të hynë në fuqi në Alande pa pëlqimin e Kuvendit legjislativ, në atë masë në të cilën kanë të bëjnë ato me parimet që rregullojnë të drejtat e personave privatë që të posedojnë patundshmëri apo pronë afariste në Alande.

Para miratimit të Ligjit që është me rëndësi të posaçme për Alandet duhet të merret mendimi i Alandeve.

KAPITULLI 29

Delegimi i kompetencave legislative në Alande

Krahas dispozitave nga paragrafi 27, çështjet e përmendura më poshtë gjithashtu bëjnë pjesë në kuadër të kompetencave legislative të shtetit:

- 1) librat e amzës së popullatës;

- 2) regjistrat e tregëtisë, regjistrat e shoqatave dhe regjistrat e anijeve;
- 3) pensionet në bazë të punësimit dhe llojet tjera të sigurimit social;
- 4) dispozitat tjera që kanë të bëjnë me pijet alkoolike përveç atyre të përmndura në paragrafin 18, pika 13;

5) shërbimet bankare e kreditore;

6) kontratat mbi punësimin dhe bashkëpunimin në ndërmarrje.

Me pëlqimin e Kuvendit legjislativ ligji mund të miratohet dhe të hy në fuqi, ahtu që kompetencat ligjdhënëse nga pika 1 delegon Alandet në tërësi ose pjesërisht. Ligji i tillë mban dispozitat mbi masat që kanë të bëjnë me delegimin e kompetencave.

Personi, në kontratën e të cilit në punën me shtetin ka ndikim delegimi i kompetencave nga pika 2, me pëlqimin e vet do të transferohet në punë për shërbimet e Alandeve dhe atë në vendin e ngjashëm të punës dhe me të drejtë të cilët i ka gëzuar më parë, që përcaktohet me vendim.

KAPITULLI 30

Pushteti administrativ dhe procedura

Funksionarët e shtetit drejtojnë çështjet nga fushëveprimi i kompetencave legjislative të shtetit, e lidhur me sa vijon:

1) me rastin e emërimit të funksionarëve shtetëror në Alande posaçërisht shfaqet kujdes për atë që kandidati të njeh kushtet lokale në Alande apo të ketë qëndrim në Alande;

2) fjala "Aland" është e shkruar në pasaporta të cilat jepen në Alande, në qoftë se bartësi i pasaportës ka të drejtë qëndrimi;

3) funksionarët e provincës marrin pjesë në mbrojtjen civile sikurse është parashikuar me Vendimin mbi marrëveshjen;

4) personi me të drejtë qëndrimi mund të cakohet vetëm në punët civile në kuadër të Alandeve, në bazë të obligimit qytetar të punës;

5) të dhënat statistikore që kanë të bëjnë me kushtet lokale në Alande e që gjenden tek funksionarët e shtetit, do t'u jepen funksionarëve përkatëse të Provincës me kërkesë të tyre;

6) funksionarët e shtetit do të sigurojnë që Alandet të fitojnë të drejtën e marrjes së frekuencave të nevojshme për emetimin e programit të radios e të televizionit;

7) qeveria e Alandeve merr vendimin mbi dhënien e lejeve të huajve apo korporatave të huaja për fitimin e pronësisë ose të posedimit të pronave të patundshme në Alande e me qëllim të ushtrimit të ndonjë veprimtarie ekonomike në Alande; para marrjes së vendimit merret mendim i funksionarit kompetent në Alande;

8) punët, të cilat sipas dispozitave mbi sëmundjet ngjitëse të njerëzve, kapakareve shtëpiake dhe të kafshëve, dispozitat mbi ndalimin e sjelljes në vend të substancave të dëmshme për bimët dhe dispozitat mbi prodhimin dhe shfrytëzimin e helmeve, që bëjnë pjesë në kompetencat e funksionarëve të shtetit, në Alande i kryen qeveria e Alandeve ose funksionari siç është parashikuar me Ligjin e Provincës.

9) Qeveria e Alandeve vendos për atë se a do të mund të marrin lejen për ushtrimin e punëve të përmendura në Alande shtetasit e Finlandës, Islanës, Norvegjisë, Suedisë dhe Danimarkës, të cilët janë kualifikuar për kryerjen e punëve në fushën e mbrojtjes shëndetësore, shërbimeve spitalore e veterinare në vendet nordike përpos Finlandës, dhe që e kanë dhënë provimin të cilin e prashikon Qeveria e Alandeve me dispozitat relative në fuqi në Alande,

10) punët, të cilat në shtet i kryen këshilli për ankesat e konsumatorëve, në Alande i kryen këshilli i veçantë të cilin e emëron qeveria;

11) punët, të cilat sipas dispozitave mbi dhënien e këshillave konsumatorëve që bëjnë pjesë në kompetencat e komunave, në Alande i kryejnë funksionrët e provincës në përputhje me marrëveshjen

midis Alandeve dhe komunave;

12) linja e re e marinës tregëtare mund të hapet në Alande vetëm me pëlqimin e Qeverisë së Alandeve, që u nënshtrohet dispozitave të paragrafit 62;

13) çështjet që kanë të bëjnë me lejet për transport me anije të marinës së huaj tregtare në Alande, ose midis Alandeve dhe pjesës tjetër të Finlandës, dakordohen me qeverinë e Alandeve;

14) kufizimi i shpejtësisë për anijet e marinës tregtare në Alande dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me transportin e mallërave, e që janë me rëndësi të posaçme për Alandet, dakordohen me Qeverinë e Alandeve;

15) çështjet që kanë të bëjnë me të drejtën për kryerjen e komunikacionit ajror në Alande janë në kompetencën e Qeverisë së Alandeve; mirëpo mendimi lidhur me këtë çështje merret nga funksionarët e shtetit;

16) kur është fjala për gjërat nga fushat e komunikacionit ajror që janë me rëndësi të posaçme për Alandet, organet kompetente të shtetit e konsultojnë Qeverinë e Alandeve;

17) materialet arkivore të organeve të shtetit në Alande mund të nxirren nga Alandet vetëm pas negociatave me qeverinë e Alandeve;

18) vendimet e Bankës së Finlandës për të cilat mund të supozohet se janë me interes të veçantë për jetën ekonomike dhe punësimin në Alande, në qoftë se kjo është e mundshme, miratohen vetëm pas negociatave me Qeverinë e Alandeve;

19) Qeveria e Alandeve ka të drejtë që bashkërisht me Këshillin e shtetit, të përfaqësohet në negociatave me organizatat qëndrore të prodhuesve lidhur me të ardhurat nga bujqësia dhe përpunimi i peshkut si dhe mbi dispozitat nga fusha e prodhimit bujqësor dhe të industrisë për përpunimin e peshkut;

20) Qeveria e Alandeve ka të drejtë që, para miratimit të vendimit për ndryshimin e dispozitave të rëndësishme që mund të jenë me rëndësi të veçantë për prodhimin bujqësor apo industrinë e përpunimit të peshkut, të paraqet mendimin e vet;

21) funksionari kompetent i shtetit pra dhënie së lejeve për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike siguron mendimin e Qeverisë së Alandeve;

22) para miratimit të vendimit mbi mbylljen e ndonjë institucioni apo të zyrës së përhershme të administratës së shtetit në Alande, sigurohet mendimi i qeverisë së Alandës;

23) të dhënat statistikore mbi Alandet që i nevojiten shtetit mblidhen në bashkëpunim me funksionarin përkatës të Provincës.

KAPITULLI 31

Obligimet e funksionarit të shtetit për të ndihmuar funksionarët e Provincës

Me kërkesë të Qeverisë së Alandeve, funksionarët e shtetit janë të obliguar që në kuadër të kompetencave të veta të përgjithshme t'u ofrojnë ndihmë funksionarëve të Provincës në kryerjen e detyrave të veta që i përkasin autonomisë.

KAPITULLI 32

Vendimi mbi marrëveshjen

Me pëlqimin e Qeverisë së Alandeve, detyrat që bëjnë pjesë në kompetencat e administratës së shtetit, me vendimin mbi marrëveshjen, mund të barten tek funksionarët e Provincës për periudhën e caktuar kohore deri në njoftimet e mëparshme. Gjithashtu detyrat që bëjnë pjesë në kompetencat e administratës së Provincës mund të barten në funksionarët e shtetit.

Në qoftë se merret njoftimi mbi pëlqimin, vendimi ndryshohet, plotësohet ose pezullohet sa më parë që është e mundur, por për çdo rast në afatin prej një viti nga dita e njoftimit. Me përjashtim, në

qoftë se vendimi nuk është ndryshuar, plotësuar apo pezulluar në afatin e përmendur kohor, konsiderohet se pëlqimi ka përfunduar një ditë pas marrjes së njoftimit. Ligji i provincës që është në kundërshtim me vendimin mbi marrëveshjen nuk do të aplikohet në pjesën e vet që është në kundërshtim gjithnjë derisa vendimi është në fuqi.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi marrëveshjen, mendimi mbi propozimin duhet të sigurohet nga delegacioni i Alandeve.

KAPITULLI 33

Sigurimi i mendimit nga Qeveria e Alandeve

Para se kryetari i republikës ose Këshilli i shtetit të nxjerrin dispozitat që u përkasin ekskluzivisht Alandeve ose në mënyrë tjetër janë me rëndësi të posaçme për alandet, është e nevojshme të sigurohet mendimi përkatës i Qeverisë së Alandeve. Kjo aplikohet edhe në dispozitat që i nxjerrin funksionarët e tjerë.

KAPITULLI 34

Paraqitja dhe miratimi i vendimit

Kryetari i republikës merr vendime mbi çështjet që kanë të bëjnë me autonominë e Alandeve në përputhje me paragrafin 34 të kushtetutës.

Vendimet mbi çështjet që i përkasin autonomisë i paraqiten këshillit të shtetit nga ana e Ministrisë së drejtësisë. Mirëpo, kur vendimet kanë të bëjnë me ekonominë e alandeve, ato i paraqet Ministria e Financave.

Këshilli i shtetit i emëron ata persona të cilët e njohin mirë materien nga fusha e autonomisë së Alandeve, si funksionarë të cilët propozimet e vendimeve përkatëse nga pika 2 i paraqesin për shqyrtim.

KAPITULLI 35

Aplikimi i ligjit

Për aplikimin e ligjit në Alanda kompetentët janë gjyqet dhe funksionarët në harmoni me ligjet dhe dispozitat e shtetit, me përjashtim nëse nuk është parashikuar ndryshe në paragrafët 25 ose 26.

KREU VI

Gjuha

KAPITULLI 36

Gjuha zyrtare

Gjuha zyrtare e Alandeve është suedishtja. Gjuha, të cilën e përdorin funksionarët e shtetit dhe të provincës si dhe administrata komunale është suedishtja.

Gjuha zyrtare e delegacionit të Alandeve është suedishtja. Mendimet dhe vendimet e Gjyqit Suprem nga ky ligj shkruhen në gjuhën suedeze.

Dispozitat nga ky ligj mbi përdorimin e gjuhës në administratën e shtetit, gjithashtu, aplikohen atje ku kjo përgjigjet, edhe te funksionarët e kishës evangeliste luterane, me përjashtim, në qoftë se nuk është e praashikuar ndryshe me kodeksin kishtar.

KAPITULLI 37

Të drejtat për shfytëzimin e gjuhës finlandeze

Në çështjet që i përkasin personalisht atij, shtetasi i Finlandës ka të drejtë që, në gjyqe dhe në komunikim me funksionarët e tjerë të shtetit në Alande të përdorë gjuhën finlandeze.

KAPITULLI 38

Gjuha e letërkëmbimit

Shkresat edhe dokumentat tjera që këmbehen midis funksionarëve të provincës e të shtetit në Alande shkruhen në gjuhën suedeze. Kjo ka të bëjë edhe me letërkëmbimin midis organeve të përmendura kompetente e delegacionit alandez nga njëra anë, dhe Këshillit të shtetit, funksionarëve në qeverinë qendrore të Finlandës dhe të gjyqeve të larta e funksionarëve të tjerë të shtetit nën juridiksionin e të cilëve janë Alandet apo të cilit juridiksion i takon ndonjë pjesë e tyre, nga ana tjetër.

Mirëpo, marrëveshjet nga paragrafi 59, që i paraqiten kuvendit legjislativ në miratim mund të dërgohen në Alande në gjuhën origjinale në qoftë se nuk ekziston obligimi ligjor i botimit të tyre në gjuhën suedeze.

Dispozitat nga pika 1 mbi funksionarët e provincës kanë të bëjnë edhe me funksionarët komunalë në Alande.

KAPITULLI 39

Përkthimi

Me kërkesë të palës, gjyqet dhe qeveria e qarkut në Alande, bashkë me dokumentat që japin bashkangjesin edhe përkthimin në gjuhën finlandeze.

Në qoftë se dokumenti që i paraqitet gjyqit ose funksionarëve të tjerë të shtetit është i shkruar në finlandisht, funksionari nëse është e nevojshme do të kujdeset për përkthimin e tij në suedisht.

Personi privat në Alande ka të drejtë të marrë përkthimin e bashkëngjitur në suedisht, bashkë me ekzemplarin e dokumentit të cilin e shqyrton funksionari i shtetit në shtet, e që u përmend në paragrafin 38, pika 1, sipas të cilit, dokumenti, është shkruar në gjuhën finlandeze në përputhje me dispozitat e përgjithshme mbi gjuhën.

KAPITULLI 40

Gjuha dhe arsimimi

Gjuha e arsimimit në shkolla të cilat financohen apo subvencionohen nga fondet publike, është gjuha suedeze, në qoftë se nuk është parashikuar ndryshe me ligjin e provincës.

KAPITULLI 41

Njohja e mirë e finlandishtes

Personi që ka diplomuar në njërin nga institucionet arsimore në Alande mundet, siç është parashikuar më tutje me vendim, të pranohet në ndonjërin nga institucionet parimore që financohen apo subvencionohen nga shteti e me qëllim të shkollimit të mëtejshëm në gjuhën suedeze, apo në dygjuhësi dhe të konsiderohet se arsimimi e vet e ka fituar në atë institucion, tjetër, bile edhe kur nuk ka njohuri të duhura të finlandishtes që nevojitet për regjistrim dhe shkollim.

KAPITULLI 42

Njohja e mirë e gjuhës nga ana e funksionarëve të shtetit

Dispozitat për njohjen e gjuhës nga ana e funksionarëve të shtetit në Alande miratohen me vendimin dhe pëlqimin e qeverisë së Alandeve.

Shteti për nëpunësit e vet në Alande organizon kurse të gjuhës suedeze.

KAPITULLI 43

Informatat dhe dispozitat në suedishte

Këshilli i shtetit, atje ku është e mundur, ndërmerr masat me qëllim që informatat për ndonjë prodhim apo shërbim për konsumatorët në Alande të distribuohen në suedishte.

Këshilli i shtetit gjithashtu është i obliguar të sigurojë që dispozitat, të cilat vlejné në Alande, të jenë të përshtatshme në suedishte.

KREU I VII

Financimet në Alande

KAPITULLI 44

Buxheti

Buxhetin e Alandeve e miraton kuvendi legjislativ. Të gjitha të hyrat e të dalurat janë të përfshira në buxhet. Kuvendi legjislativ mund të nxjerrë ligje të provincës për formimin e rezervave të cilat nuk janë të përfshira në buxhet.

Me rastin e miratimit të buxhetit kuvendi legjislativ përpiqet të sigurojë që të gjithë qytetarët e Alandeve të gëzojnë shkallë të njëjtë të sigurisë sociale si edhe ata në shtet.

E drejta e kuvendit legjislativ për të nxjerrë dispozita mbi bazat e atyre tatimeve të cilat i cakton administrata e Provincës, është rregulluar në paragrafin 18 pika 5.

KAPITULLI 45

Egalizimi (barazimi)

Alandet marrin çdo vit nga shteti shuma të caktuar të mjeteve për mbulimin e shpenzimeve të autonomisë. Shuma e përmendur (shuma e barazimit) caktohet me procedurën e posaçme barazuese. Egalizimi kryhet retroaktivisht për secilin vit kalendarik. Avancimi i shumës në emër të egalizimit kryhet çdo vit.

KAPITULLI 46

Llogaritja e shumës së egalizimit

Shuma e egalizimit llogaritet me shumëzimin e të hyrave të shtetit për vitin përkatës - duke përjashtuar huat e reja shtetërore, sipas raporteve vjetore financiare të shtetit - me indeksin përkatës (baza për egalizim)

KAPITULLI 47

Baza për egalizimin dhe ndryshimet

Baza për egalizimin kap 0,45%.

Baza për egalizimin ndryshohet në qoftë se bëhet ndryshimi i bazës së përlllogaritjeve financiare.

Baza për egalizimin shtohet në këto raste:

1) kur shpenzimet e alandeve rriten për shkak të bartjes së taksave administrative të shtetit në Alande, ose në qoftë se Alandet në marrëveshje me shtetin marrin plotësisht ose pjesërisht ndonjë aktivitet që është në interes të shtetit;

2) në qoftë se përmbushja e objektivave të autonomisë shkakton shpenzime të konsiderueshme plotësuese;

3) në qoftë se shpenzimet e konsiderueshme që nuk janë marrë parasysh në kohën e miratimit të këtij ligji i shkaktojnë shpenzime administratës së provincës.

Baza për egalizimin pakësohet me rastin e transferimit të takasve administrative nga Alandet në shtet, me çka automatikisht arrihet pakësim i shpenzimeve të Alandeve.

Ndryshimi i bazës egalizimit, të parashikuar me ligjin e shtetit mund të bëhet me pëlqimin e kuvendit legjislativ.

KAPITULLI 48

Mjetet e jashtëzakonshme pa kthesë

Mjetet e jashtëzakonshme pa kthesë mund të akordohen me propozim të qeverisë së Alandeve për shpenzime të jashtëzakonshme të larta, për të cilat nuk ka mundur të parashikohet me arsye që të përfshihen në buxhetin e Alandeve. Mjetet e jashtëzakonshme pakthesë mund të akordohen vetëm për qëllime nga kompetencat e Alandeve.

KAPITULLI 49

Kthimi i tatimeve

Në qoftë se tatimi mbi të ardhurat dhe pasurinë në Alande gjatë vitit fiskal i kalon 0,5% të tatimit përkatës në mbarë vendimin, teprica u kthehet Alandeve (kthimi i tatimit).

KAPITULLI 50

Huat

Mund të emetohen fletëobligime ose të merren huat për plotësimin e nevojave të Alandeve.

KAPITULLI 51

Subvencionit i posaçëm

Shteti i subvencionon alandet me qëllim të:

1) pengimit ose evitimit të çrregullimeve të konsiderueshme ekonomike që ndikojnë posaçërisht në Alande;

2) mbulimit të shpenzimeve të shkaktuara me fatkeqësitë elementare, katastrofat bërthamore, me derdhjen e naftës ose me fatkeqësitë tjera të ngjashme, me përjashtim në qoftë se shpenzimet janë të atilla që mund t'i bartin Alandet.

Qeveria e Alandeve inicon procedurën për marrjen e subvencioneve më së voni një vit nga

momenti i krijimit të shpenzimit të jashtëzakonshëm. Vendimi për këtë çështje, nëse kjo është e mundur, miratohet në afatin prej gjashtë muajve nga dita e inicimit të procedurës.

KREU VIII

Guvernatori dhe delegacioni i Alandeve

KAPITULLI 52

Emërimi i guvernatorit

Guvernator mund të emërohet pesoni i cili ka kualifikime të nevojshme për drejtimin e administratës së Alandeve si dhe për kujdesin mbi sigurinë e shtetit.

Kryetari i Republikës e emëron guvernatorin pasi që lidhur me këtë të arrijë ujdinë me kryetarin e kuvendit legjislativ. Në qoftë se nuk arrihet konsensusi rreth kësaj çështjeje, kryetari për guvernator e emëron njërin nga pesë kandidatët të cilët i propozon kuvendi legjislativ.

KAPITULLI 53

Ushtruesi i detyrës së guvernatorit

Në rastet kur posti i guvernatorit është i zbrazët ose kur guvernatori pengohet në ushtrimin e detyrës së vet, kryetari pas arritjes së marrëveshjes lidhur me këtë çështje me kryetarin e kuvendit legjislativ mund të emërojë personin përkatës për kryerjen e detyrës së guvernatorit.

KAPITULLI 54

Shkarkimi i guvernatorit nga detyra

Para marrjes së vendimit për shkarkimin e guvernatorit nga detyra nevojitet të sigurohet mendimi i kryetarit të Kuvendit legjislativ.

KAPITULLI 55

Përbërja dhe kompetencat e delegacionit të Alandeve

Detyrën e kryetarit të delegacionit të Alandeve e kryen guvernatori apo personi tjetër të cilin e emëron kryetari i Republikës pas marrëveshjes me kryetarin e Kuvendit legjislativ. Kur kryetari është i penguar për ta kryer detyrën e vet, atë e kryen nënkryetari të cilin gjithashtu e emëron kryetari i Republikës në marrëveshje me kryetarin e Kuvendit legjislativ. Këshilli i shtetit dhe Kuvendi legjislativ zgjedhin nga dy anëtarë të delegacionit dhe nga dy zëvendësa për secilin anëtar.

Delegacioni ka kuorum vetëm kur janë të pranishëm të gjithë anëtarët.

Delegacioni mund të kërkojë mendimin e ekspertëve

KAPITULLI 56

Detyrat e delegacionit të Alandeve

Delegacioni i jep mendime këshillit të shtetit, ministrave, Qeverisë së Alandeve dhe gjyqeve me kërkesë të tyre.

Delegacioni vendos për çështjet nga paragrafi 62.

Përveç kësaj delegacioni.

1) kryen egalizimin nga paragrafi 45;

2) përcakton kthimin e tatimeve në përputhje me paragrafin 49;

3) akordon mjete të jashtëzakonshme pa kthim nga paragrafi 48 dhe subvencione nga paragrafi 51, dhe vendos për kushtet eventuale për atë që u përmend më sipër.

Delegacioni përcakton shumën e avansit nga paragrafi 45 alineja 2.

Kryetari i Republikës i konfirmon vendimet e delegacionit lidhur me çështjet nga alineja 3. Vendime në afatin prej tre muajve konfirmohet të pandryshuara ose mbetën të pakonfirmuara. Në qoftë se vendimi nuk është konfirmuar, çështja i kthehet delegacionit në rishqyrtim.

KAPITULLI 57

Shpenzimet e delegacionit të Alandeve

Alandet i bartin shpenzimet e delegacionit të Alandeve, përkatësisht të delegatëve që i zgjedh kuvendi legjislativ. Shpenzimet tjera mbulohe nga fondet e shtetit.

KREU IX

Marrëveshja ndërkombëtare

KAPITULLI 58

Negociatat dhe marrëveshjet ndërkombëtare

Qeveria e Alandeve mund t'i propozojë funksionarit përkatës të shtetit negociata lidhur me marrëveshjen me shtetin e huaj.

Qeveria e Alandeve njofton për negociatat mbi lidhjen e marrëveshjes me shtetin e huaj nëse çështjet të cilat rregullohen me atë bëjnë pjesë në kompetencat e Alandeve. Në qoftë se negociatat mbi marrëveshjen me shtetin e huaj kanë të bëjnë me çështjet me rëndësi të posaçme për Alandet, Qeveria e Alandeve njoftohet për ato. Në qoftë se për këtë ekzistojnë shkaqe të posaçme, Qeveria e Alandeve ka të drejtë, që t'i jepet mundësia, për pjesëmarrje në negociata.

KAPITULLI 59

Hyrja në fuqi e marrëveshjeve ndërkombëtare

Në qoftë se marrëveshja e lidhur midis Finlandës dhe ndonjë shteti të huaj përmban dispozita në kundërshtim me këtë ligj, kjo dispozitë hyn në fuqi në Alande vetëm me kusht që të nxirret ligji përkatës për këtë në përputhje me paragrafët 67 e 69 të ligjit për Parlamentin finlandez dhe me paragrafin 69 të këtij ligji.

Nëse marrëveshja përmban dispozitat të cilat sipas këtij ligji bëjnë pjesë në kompetencat e alandeve, lypset të sigurohet pëlqimi i Kuvendit legjislativ për ligjin me të cilin ajo marrëveshje zbatohet, në mënyrë që dispozitat në fjalë të mund të hyjnë në fuqi në Alande.

Kuvendi legjislativ mund ta autorizojë Qeverinë e Alandeve për dhënien e pëlqimit nga alineja 2.

KREU X**Të ndryshme****KAPITULLI 60***Ligjshmëria e vendimeve të provincës, konflikti i kompetencave*

Në qoftë se dispozita e ndonjë vendimi të Provincës është në konflikt me ligjin e provincës apo të shtetit që aplikohet në Alande, ajo nuk aplikohet.

Kur është fjala për konfliktin e kompetencave midis funksionarëve të provincës dhe shtetit rreth funksionit të dhënë administrativ, vendimin për zgjidhjen e kësaj çështje e merr gjyqi suprem me propozim të Qeverisë së Alandeve ose të funksionarit të shtetit. Para marrjes së vendimit Gjyqi Suprem siguron mendimin e funksionarit përkatës dhe të delegacionit të Alandeve.

KAPITULLI 61*Toka e shtetit dhe objektet*

Në qoftë se shtetit i nevojitet tokë në Alande për nevojat e rregullta të administratës së shtetit, Alandet e japin parcelën përkatëse për këtë qëllim. Nëse Alandet nuk e caktojnë parcelën e përmendur, shteti mund ta fitojë këtë edhe pa bashkëpunim me Alandet.

Në qoftë se toka nga alineja 1 e këtij paragrafi nuk nevojitet më për ushtrimin e punëve të rregullta administrative të shtetit e drejta e shtetit mbi këtë tokë kalon në Alande. Alandet gjithashtu fitojnë godina dhe objekte të cilat më nuk konsiderohen të duhura për nevojat e shtetit, me përjashtim në qoftë se nuk janë shkatërruar.

Ndarja e tokës në përputhje me alinenë 1 të këtij paragrafi si dhe transferi i pasurisë në Alande, në përputhje me alinenë 2 të këtij paragrafi, kryhet në marrëveshje midis ministrisë përkatëse dhe Qeverisë së Alandeve.

Dispozitat e shtetit aplikohen në pagesat e shfrytëzimit me rastin e kompensimit të plotë të pasurisë së patundshme për nevojat e shtetit.

KAPITULLI 62*Kontestet në situatat e caktuara*

Në qoftë se në situatat e caktuara vihet te kontesti lidhur me çështjet nga paragrafi 30 alineja 12 ose paragrafi 61 alineja 1 a 2, për zgjidhjen e tij kompetent është delegacioni i Alandeve.

KAPITULLI 63*E drejta e Alandeve për trashëgimi*

Në qoftë se personi me qëndrim të përhershëm në Alande vdes pa trashëgimtar, trashëgues bëhen Alandet. Mirëpo, patundshmëritë dhe pasuritë e ngjashme që e trashëgojnë Alandet e cila gjendet në vetë Alandet dhe nuk nevojitet për shlyerjen e borxheve që dalin nga shqyrtimi trashëgimor, bartet në shtet.

KAPITULLI 64*Diploma e fituar në ndonjë vend tjetër*

Mund të merret vendimi për atë se diploma e duhur për ushtrimin e funksionit në administratën

shtetërore në Alande, mund të zëvendësohet me diplomën krahasuese të fituar në Islandë, Norvegji, Suedi ose Danimarkë.

KAPITULLI 65*Aktiviteti ekonomik i shtetit dhe shërbimet e caktuara në Alande*

Në qoftë se e drejta për ushtrimin e ndonjë aktiviteti që është i rregulluar me normat e shtetit, në përputhje me paragrafin 27 ose 29 është rezervuar për shtetin, institucionin e pavarur shtetëror ose korporatën atje ku shteti ka të drejtë të vendosjes, mund të merret vendimi, që alandet ose ndonjë korporatë në ato rajone ku Alandet kanë të drejtë të vendosjes, për të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të njëjtë në Alande nëse në të kundërtën nuk ekzistojnë shkaqet thelbësore.

Dispozitat e paragrafit 30 alineja 1, paragrafit 42, alineja 1 dhe paragrafi 64, mbi shërbimet shtetit, aplikohen gjithashtu edhe në punët e institucioneve shtetërore në Alande, siç është parashikuar më tej me vendim, dhe në korporatat atje ku shteti është kompetent për të vendosur.

KAPITULLI 66*Lirimi nga tatimet*

Alandet kanë të drejtat e njëjta për përjashtim nga tatimet dhe lehtësirat krahasuese si edhe shteti.

KAPITULLI 67*Zotimi i të drejtës së përgjithshme për votime në zgjedhjet komunale në rastet e caktuara*

Shtetasve të Finlandës pa të drejtë qëndrimi si dhe shtetasve të Islandës, Norvegjisë, Suedisë dhe Danimarkës do tu jepet e drejta e përgjithshme e votimit dhe mundësia për t'u zgjedhur në detyrat, në zgjedhjet komunale, nën kushtet e parashikuara me ligjin e Provincës.

Për marrjen e vendimit lidhur me miratimin e ligjit të provincës nga alineja 1 e këtij paragrafi është e nevojshme të deklarohen të paktën shumica e dy të tretave të zgjedhësve që kanë votuar.

KAPITULLI 68*Qarku elektoral*

Për qëllimet e zgjedhjeve parlamentare e presidenciale, Alandet përbëjnë një qark zgjedhor. Rregullat për zgjedhjet e përmendura miratohet posaçërisht.

KAPITULLI 69*Miratimi i ndryshimeve dhe plotësimeve të ligjit mbi autonominë dhe miratimin e Ligjit të Provincës me shumicë kualifikuese*

Ky ligj mund të ndryshohet e të plotësohet, të interpretohet, të pezullohe ose të përjashtohet, në raport me aplikimin e tij mund të konfirmohet me vendimet konsekuente të parlamentit të Finlandës dhe kuvendit legjislativ. Në Parlamentin e Finlandës vendimi mbi këtë merret njësoj sikurse parashikohet marrja e vendimeve për ndryshimet e plotësimet, interpretimet ose pezullimet e ligjit kushtetues, kurse në kuvendin legjislativ vendimet e tilla merren me shumicën e dy të tretave të votave.

Mund të nxirret Ligji i Provincës për atë se Kuvendi legjislativ miraton Ligjin e Provincës të paktën me shumicën e dy të tretave të votave. Ligji i Provincës që përmban këtë dispozitë mund të miratohet në mënyrë të njëjtë.

KREU XI

Hyrja në fuqi dhe dispozitat kalimtare

KAPITULLI 70

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi me 1 janar të vitit 1993.

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushon të vlejë Ligji mbi Autonominë e Alandeve (28 dhjetor 1951/60), i cili më vonë është ndryshuar dhe plotësuar (ligji i mëparshëm), Ligji mbi aplikimin e Ligjit mbi ankesat administrative në ishujt Alande (16 shkurt 1979/182) si dhe dispozitat tjera që janë në kundërshtim me këtë Ligj.

Masat e nevojshme për zbatimin e këtij ligji mund të merren edhe para hyrjes së tij në fuqi. Mirëpo, ligji i tillë i Provincës nuk mund të hyj në fuqi para hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

Delegacioni i Alandeve i zgjedhur në përputhje me dispozitat e këtij Ligji ushtron edhe ato detyra që janë parashikuar me Ligjin e mëparshëm.

KAPITULLI 71

Aplikimi i dispozitave të mëparshme

Në qoftë se me këtë ligj ose në baz të këtij ligji ndonjë sferë e ligjshmërisë që më parë ka qenë e rregulluar me ligjin e Provincës bartet në kompetencat ligjdhënëse të shtetit apo ndonjë sferë e ligjshmërisë që kanë qenë e rregulluar me normat e shtetit bartet në kompetencat legjislativë të Alaneve, me ç'rast kjo bartje hyn në fuqi para fuqizimit të këtij Ligji, dispozitat e akteve të mëparshme do të aplikohen në Alande deri në pezullimin e ligjit të Provincës me vendim ligjin e shtetit dhe me sistemin administrativ.

KAPITULLI 72

E drejta për qëndrim

Personi që jeton në Alande në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kërkesë që i bën Qeverisë së Alandeve ka të drejtë të fitojë qëndrimin në përputhje me dispozitat e ligjit të mëparshëm.

E drejta e qëndrimit për fëmijun e birësuar përcaktohet sipas qëndrimit të birësuesit në rastet kur birësimi bështë bërë para fuqizimit të këtij ligji.

KAPITULLI 73

Marrja me aktivitet ekonomik

Personi që jeton në Alande gjatë kohës së hyrjes në fuqi të këtij Ligji, e i cili ka jetuar në Alanda pesë vjet rresht ka të drejtë të merret me aktivitete ekonomike në Alande në përputhje me dispozitat e ligjit të mëparshëm.

Personat fizik, kompanitë, kooperatat, asociacionet dhe korporatat e fondacionet tjera, të cilat në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji ushtrojnë ndonjë aktivitet ekonomik në Alande në përputhje me dispozitat e ligjit të mëparshëm, kanë të drejtë të vazhdojnë me këtë aktivitet në përputhje me dispozitat e ligjit të mëparshëm.

KAPITULLI 74

Zgjidhja e çështjeve mbi bartjen e kompetencave

Kur vie deri te bartja e kompetencave midis funksionarëve në harmoni me këtë ligj, çështjet që dalin nga ajo i zgjidhin ata funksionarë të të cilët gjendet lënda në kohën e bartjes së kompetencave.

Ndaj ankesave kundër funksionarëve, të paraqitura pra bartjes së kompetencave, aplikohet ligji i mëparshëm dhe aktet tjera të cilat në atë kohë kanë qenë në fuqi.

KAPITULLI 75

Funksionarët e shtetit

Funksionari i shtetit, detyrat e të cilit në përputhje me këtë ligj barten në kompetencat e Alandeve, në qoftë se pajtohen, do të transferohet në detyra adekuate në byronë e provincës me beneficione të njëjta. Lidhur me këtë merret vendimi përkatës.

Dhënia e vendimit nga paragrafi 42 alineja 1 e ligjit të mëparshëm, si dhe normat mbi gjuhën që kanë të bëjnë me funksionarët e shtetit, do të aplikohen nga funksionarët e shtetit në Alande në formën në të cilën janë aplikuar gjatë hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

Personi që gjendet në detyrë të funksionarit të shtetit në Alande në kohën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji do të konsiderohet se edhe më tutje i përmbush kualifikimet për kryerjen e asaj detyre, pa marrë parasysh dispozitat e vendimit i cili merret në përputhje me paragrafin 42, alineja 1.

KAPITULLI 76

Revokimi

Dispozitat nga ligji i mëparshëm mbi revokimin e kretarit apo anëtarit të Qeverisë së Alandeve, të ndonjërit nga përfaqësuesit apo funksionarit tjetër të Provincës, aplikohen në formë të pandryshuar derisa me ndonjë formë tjetër nuk parashikohet ndryshe.

KAPITULLI 77

Egalizimi i rregullt, të dhënat e jashtëzakonshme pakthim dhe ndryshimet në bazë të egalizimit

Egalizimi i rregullt i rregulluar me ligjin e mëparshëm do të zbatohet për herë të fundit për atë vit që i prinë vitit në të cilin hynë në fuqi ligji i ri.

Të dhënat e jashtëzakonshme pa kthim të akorduara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, mund të plotësohen dy vjet pas fuqizimit të këtij Ligji.

Baza për egalizimin ndryshohet nëse bëhet ndryshimi i bazës së përlogaritjeve financiare të shtetit para fuqizimit të këtij ligji, sipas mënyrës së parashikuar në paragrafin 47, alineja 2.

KAPITULLI 78

Toka, godinat dhe objektet

Dispozitat nga paragrafi 61, alineja 2, aplikohen edhe për tokat, godinat dhe objektet të cilat shfrytëzohen për punë të rëndomta të administratës së shtetit në kohën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

Mund të merret vendimi për bartjen në Alande edhe të këtyre tokave, godinave apo objekteve të shtetit që përmenden në alinenë 1.

KAPITULLI 79

Pasuria e tundshme

Kur detyrat e funksionarit të shtetit barten në funksionarin e provincës në përputhje me këtë ligj, pasuria e tundshme e shtetit në Alande, që nevojitet për ushtrimin e detyrës së cekur, bartet në Alande pa kompenzim.

b) MARRËVESHJA MBI ALANDET NGA 27 QESHORI 1921

(Procesverbal nga Mbledhja XVII e Këshillit të Lidhjes së Kombeve më 27 qershor 1921)

1. Finlanda, e vendosur për të siguruar garancat popullatës të Ishujve Alande për ruajtjen e gjuhës së tyre, kulturës dhe të zakoneve të tyre lokale suedeze, do të ndërmerret së shpejti dhe do të fus në Ligjin mbi Autonominë e Ishujve Alande nga 7 maji i vitit 1920 këto garanca:

2. Landstingu dhe komunat e Ishujve Alande nuk do të jenë në asnjë rast të obligueshme të mirëmbajnë e as të subvencionojnë shkollat në të cilat gjuha mësimore nuk është suedishtja. Në institucionet shtetërore-shkolllore mësimi do të zhvillohet gjithashtu në gjuhën suedeze. Gjuha finlandeze nuk mund të mësohet në shkollat fillore të cilat i mirëmban dhe subvenconon shteti ose komuna pa pëlqimin e komunës së interesuar.

4. Kur prona e tokës në Ishujt Alande i shitet personit i cili nuk ka qëndrim juridik në Ishuj, secili person i cili ka qëndrim juridik në Ishuj ose Këshilli i Provincës apo komuna ku gjendet prona ka të drejtë ta blejë atë pronë sipas çmimit i cili do të cakohet në gjykatën e shkallës së parë.

(haradstratt) duke marrë parasysh çmimet ekzistuese, në qoftë se nuk arrihet marrëveshja. Rregullativat e hollësishme do të sajohen në ligjin special mbi aktin për blerjen e do të merren parasysh edhe përparësia midis disa ofertave.

Ky ligj nuk mund të modifikohet, interpretohet ose revokohet përpos nën kushtet e njëjta si edhe Ligji mbi Autonominë.

4. Imigrantët në Ishujt Alande që kanë të drejtën e shtetësisë finlandeze do të fitojnë vetëm të drejtat komunale dhe provinciale në Ishuj pas pesë vitesh qëndrimi. Personat që kanë jetuar pesë vjet në Ishuj nuk do të konsiderohen imigrantë.

5. Guvernatorin e Ishujve Alande do ta vendos kryetari i republikës së Finlandës në marrëveshje me kryetarin e Landstigit të Ishujve Alande. Në qoftë se marrëveshja nuk arrihet, kryetari i Republikës do ta zgjedhë guvernatorin nga lista e pesë kandidatëve që i ka nominuar Landstigu e të cilët kanë kualifikime të domosdoshme për administrim të mirë mbi Ishujt dhe sigurinë e shtetit.

6. Ishujt Alande kanë të drejtë që për nevojat e veta të shfrytëzojnë pesëdhjetë për qind të të ardhurave nga tatimi mbi tokën krahas të ardhurave të përmendura në nenin 21 të Ligjit mbi Autonominë. 7. Këshilli i Lidhjes së Popujve do të mbikqyr zbatimin e këtyre garancave, kurse Këshilli për çdo rast ku ekziston çështja e karakterit gjuhësor do të konsultojë Gjykatën e Përherëshme të së Drejtës Ndërkombëtare.

c) REZOLUTA E KËSHILLIT TË LIDHJES SË KOMBEVE NGA 24 QERSHORI 1921

Këshilli në mbledhjen e vet të datës 24 qershor të vitit 1921, duke pasur parasysh faktin se të dy palët e interesuara për fatin e Ishujve Alande kanë dhënë pëlqimin që Këshilli i Lidhjes së Popujve të ftohet të zgjidhë vështirësitë e krijuara dhe se janë të pajtimit të respektojnë këtë vendim;

Pas shqyrtimit të raportit të juristëve i cili ka zgjidhur çështjet e kompetencës dhe të vendimeve të Këshillit nga 20 shtatori i vitit 1920, që ka konfirmuar kompetencën e lartpërmendur;

Duke e kryer revidimin e të gjitha aspekteve gjeografike etnike, politike, ekonomike dhe ushtarake

të dhëna në memorandum të raportuesit që ka ndërmarrë një hulumtim gjithëpërfshirës me kërkesë të Lidhjes së Popujve;

Por edhe duke njohur nga ana tjetër se është e dëshirueshme zgjidhja e cila do të ofronte siguri më të madhe si për popullatën e Alandeve ashtu edhe për palët e ineteresuara;

Vendos:

1. Pranohet se sovraniteti mbi Ishujt Alande i takon Finlandës;

2. Pavarësisht nga kjo, interesat botërore, ardhmëria e marrëdhënieve të mira midis Finlandës dhe Suedisë, prosperiteti dhe kënaqësia e vetë banorëve të Ishujve nuk mund të sigurohen në qoftë se (a) nuk jepen garanca të ardhshme të caktuara për mbrojtjen e Ishujve; dhe nëse (b) nuk lidhen marrëveshjet për mosfortifikim dhe neutralizim të Ishujve;

3. Brezat e rinj të cilët do të përfshihen në ligjin mbi autonominë, posaçërisht kanë për qëllim ruajtjen e gjuhës suedeze në shkolla, ruajtjen e pronësisë mbi tokën në duart e banorëve të Ishujve dhe kufizimin në suzat e logjikshme të dhënies së lejeve njerëzore të sapoardhur, si kujdes për guvernator do të zgjidhet personi i cili gëzon besimin e popullatës.

4. Këshilli pranon se këto breze kanë më shumë gjasë të arrijnë qëllimin e vet në qoftë se për ato bisedojnë dhe merren vesh përfaqësuesit e Finlandës e të Suedisë, nëse ka nevojë me ndihmën e Këshillit të Lidhjes së Popujve e në përputhje me dëshirën e Këshillit, dy palët kanë vendosur që të përipiqen të bien në ujd. Në qoftë se përpjekjet e tyre nuk kanë sukses. Këshilli do t'i caktojë vetë garancat të cilat, sipas mendimit të tij, duhet të inkoopurohen si amandamente në Ligjin mbi Autonominë nga 7 maji i vitit 1920. Për çdo rast Këshilli i Lidhjes së Popujve do të sigurojë hyrjen në fuqi të këtyre garancave;

5. Marrëveshja ndërkombëtare mbi mosaktivimin dhe neutralizimin e Ishullit duhet t'i garantojë popullit suedez si dhe të gjitha palëve të interesuara se Ishujt Alande kurrë nuk do të bëhen burim i rrezikut nga aspekti ushtarak. Për këtë qëllim, Konvetën nga viti 1856 duhet zëvendësuar me marrëveshjen e gjerë të vënë nën garancat e të gjitha fuqive të interesuara, përfshirë edhe Suedinë. Këshilli konsideron se kjo Marrëveshje duhet të jetë në harmoni, në vija të veta kryesore, me projektin suedez të Konventës për neutralizimin e ishullit. Këshilli i jep instruksione sekretarit të përgjithshëm që të kërkojë nga palët pjesëmarrëse për të emëruar, sipas normave, përfaqësuesit e akredituar për bisedime dhe lidhjen e kontratës së propozuar.

4. KONFEDERATA ZVICERANE

A) NGA KUSHTETUTA E 29. MAJIT TË VITIT 1874.
(me ndryshimet dhe plotësimet nga 1.prilli i vitit 1983)¹

PJESA E PARË DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

(me ndryshimet nga vitit 1978)

Popujt e 23 kantonave sovraane të Zvicrës, të bashkuara me këtë aleancë; Zyrihu, Berna, Lucerni, Uri, Shvici, Untervalldi (i Lartë dhe i Ultë) Glarisi, Cugu Friburgu, Soleri, Bazeli (qyteti e fshati), Shafhauzeni, Apenceli, Sen-Gali, Grizoni, Argovi, Tirgovi, Teseni, Vo, Vale, Neshatel, Gjeneva dhe Jura, formojnë bashkarisht - Konfederatën Zvicerane.

Neni 2.

Konfederata ka për qëllim të sigurojë pavarësinë e atdheut ndaj botës së jashtme të ruaj qetësinë dhe rendin e brendshëm të mbrojë lirinë dhe të drejtat e shtetasve të Konfederatës dhe të shtojë mirëqenien e tyre të porgjithshme.

Neni 3.

Kantonet janë sovrane në qoftë se sovraniteti i tyre nuk është i kufizuar me kushtetutën federale: si të tillë, ata ushtrojnë të gjitha të drejtat që nuk janë bartur në pushtetin federal.

Neni 5.

Konfederata u garanton kantoneve territorin e tyre, sovranitetin e tyre në kufijtë e caktuar me nenin 3., kushtetutat e tyre liritë dhe të drejtat e popujve të drejtat kushtetuese të qytetarëve, si dhe të drejtat e autorizimet të cilat populli ia ka besuar pushtetit (autoriteteve).

Neni 6.

1. Kantonet janë të obligueshëm që nga Konfederata të kërkojnë garantimin e kushtetutave të tyre.
2. Kjo garancë jepet me kusht:
 - a) që këtë kushtetuta nuk përmbajnë asgjë në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës Federale.
 - b) që me to sigurohet ushtrimi i të drejtave politike në bazë të formave - republikane, përfaqesuese ose demokratike;
 - c) që ato t'i ketë pranuar populli dhe që të mund të jenë të ndryshueshme kur këtë e kërkon shumica absolute e qytetarëve.

Neni 8.

Vetëm Konfederata ka të drejtën të shpallë luftën dhe të lidh paqen, si dhe që me shtetet e huaja të lidhë aleanca e kontrata, veçmas kontrata doganore e tregtare.

Neni 9.

Me përjashtim kantonet mbajnë të drejtën që me shtetet e huaja të lidhin kontrata për gjërat që kanë të bëjnë me ekonominë, publike, raportet gjyqësore dhe policinë, mirëpo, këto kontrata nuk mund të mbajnë asgjë që është në kundërshtim me Konfederatën ose me të drejtat e kantonave tjera.

Neni 10.

1. Mardhëniet zyrtare midis kantoneve dhe qeverive të huaja dhe të përfaqesuesve të tyre ushtrojnë me anë të Dhomës Federale.
2. Ndërkaq, kantonet mund të komunikojnë direkt me organet më të ulta dhe më nëpunësit e shteteve të huaja kur është fjala për gjërat e përmendura në nenin e mëparshëm.

Neni 31 bis.

(i futur në Kushtetutën e vitit 1947, me ndryshimet e vitit 1980)

1. Në kufijte autorizimeve të veta kushtetuese, Konfederata merrë masa me anë të rrugëve që shtojnë mirëqenien e përgjithshme dhe mbështet sigurinë ekonomike të qytetarëve.

2. Duke ruajtur interesat e përgjithshme të ekonomis popullore Konfederata mund të miratojë norma për ushtrimin e tregtisë dhe të industrisë dhe të marrë masa në favor të degëve të caktuara ekonomike ose të profesioneve. Me rezervën e paragrafit 3., ajo duhet të respektojë parimin e lirisë së tregtisë dhe të industrisë.

3. Kur kjo është me interes të përgjithshëm Konfederata ka të drejtë që nëse është e nevojshme të heqë dorë nga parimi i lirisë së tregtisë dhe të industrisë miraton normat:

a) për mbrojtjen e degëve të rëndësishme ekonomike ose të profesioneve ekzistimi i të cilave është rrezikuar, si dhe për zhvillimin e aftësive profesionale të personave të cilët ushtrojnë veprimtari të pavarur në këto degë ose profesione:

b) për ruajtjen e fshatarësisë së fuqishme, sigurimin e produktivitetit të bujqësisë dhe forcimin e pronës fshatare;

c) për eliminimin e pasojave të demshme të natyrës ekonomike ose sociale të cilat i shkaktojnë kartelet ose grupacionet e ngjashme;

e) për marrjen e masave të preventivës në materien e mbrojtjes ekonomike popullore, si dhe për sigurimin e furnimit të vendit me të mira e shërbime me rëndësi jetike gjatë kohës së mungesave të rënda të cilat ekonomika nuk është në gjendje t'i eliminojë me mjetet vetjake.

4. Degët ekonomike dhe profesionet do të mbrohen me masat e mbështetura në pikat a) dhe b), vetëm nëse kanë marrë të ndihmës reciproke të cilat nga ato mund të kërkohej me arsye.

5. Me ligjet federale të miratuara në bazë të paragrafit 3, pika a) e b), duhet të mbrohet zhvillimi i shoqërisë i mbështetur në ndihmën reciproke.

Neni 31 quater.

(i futur në Kushtetutën e vitit 1974)

1. Konfederata ka të drejtë të miratojë norma mbi regjimin bankar.

2. Ky legjislacion duhet të shfaq kujdes për rolin dhe situatën e posaçme të bankave kantonale.

Neni 41 bis.

(i futur në Kushtetutën e vitit 1917, me ndryshimet nga viti 1958 dhe 1972)

1. Konfederata mund të mbledhë këto tatime:

a) taksat nga letrat e vulosura me vlerë, duke nënkuptuar edhe kuponat, kambialet dhe letrat e ngashme me vlerë, dëftesat nga premitë e sigurimit dhe dokumentat tjera që kanë të bëjnë me operacionet tregtare; mbledhja e këtyre taksave nuk pret dokumentat që kanë të bëjnë me operacionet e patundshmërisë dhe hipotekare.

Një e pesta e të gjitha të ardhurave nga taksat u ndahet kantoneve:

b) tatimi i anticipuar mbi të ardhurat nga kapitali i tundshëm, fitimi nga lojaritë dhe pagesat e sigurimeve;

c) taksat nga duhani i papërpunuar dhe i përpunuar si dhen ga materjet dhe produktet tjera të duhanit që i janë destinuar përdorimit të njejtë si edhe duhani i papërpunuar dhe i punuar;

d) tatimet e veçanta të cilët i paguajnë personat me banim në botën e jashtme, në mënyrë që të kthehen në masa fiskale të cilat i ndërmarrin shtetet e huaja.

2. Sendet të cilat me ligj u nënshtrohet ndonjërit nga tatimet federale të përmendura në paragrafin 1, pika a) b) e c) përkatsisht të cilët shpallen të liruara nga pagimi i tatimit duke u përjashtuar nga çdo ngarkesë në bazë të tatimeve kontonale ose komunale të llojit të njejtë.

3. Me ligjin federal do të rregullohet zbatimi i këtij neni.

Neni 41 ter

(i futur në Kushtetuten e vitit 1925, me ndryshimet e saj në bazë të nenin 41 bis, Konfederata mund të mbledhë:

c) tatimin direkt federal.

5. Tatimi direkt federal sipas paragrafit 1. pika c) do të caktohet në përputhje me këto rregulla:

a) tatimet mund të nënshtrohen fitimet e personave fizike si fitim i pastert, kapitali dhe rezervat e personave juridikë. Personat juridik pavarësisht nga forma juridike në përputhje me aftësitë e veta ekonomike mund të tatimohen sa më shumë që është e mundshme në mënyrë të barabartë;

b) tatimet i mbledhin kantohen për llogarinë e Konfederatës. Tri të dhjetat e fitimeve bruto nga tatimet u ndahen kantoneve;

të pakten një e gjashta e shumës e cila u takon kantoneve duhet të përdoret për barazimë financiar ndërkantonal;

c) me rastin e caktimit të shkallëve, në mënyrë adekuate do të shfaqet kujdes për barrën që krijojnë tatimet direkte të kantoneve dhe komunave.

6. Me ligjin federal do të rregullohet zbatimi i këtij neni.

Neni 42 quinquies

(i futur në kushtetutën e vitit 1977)

1. Konfederata, në bashkëpunim me kantonet, përpiqet të harmonizojë tatimet direkte të Konfederatës të kantoneve dhe komunave.

2. Për këtë qëllim ajo miraton ligjin e veçantë me të cilin caktohen parimet legjislative të kantoneve dhe komunave që kanë të bëjnë me obligimin tatimor, objektin dhe vlerësimin e tatimit në kohë, procedurën dhe të drejtën penale në materjen tatimore ajo kontrollon respektimin e këtyre parimeve. Caktimi i shkallëve, përqindjeve dhe shumës veçmas të tatimeve të liruara, mbetet në kompetencën e kantoneve/

3. Duke miratuar legjislacionin themelor që ka të bëjë me tatimet direkte të kantoneve dhe komunave si dhe legjislacionin mbi tatimin direkt federal, Konfederata do të shfaq kujdes për përpjekjet që bëjnë kantonet me qëllim të harmonizimit fiskal. Kantoneve do t'u lehet kohë e arsyeshme për ta harmonizuar legjislacionin e tyre fiskal.

4. Kantonet marrin pjesë në hartimin e ligjeve federale.

Neni 43.

1. Çdo qytetar i ndonjë kantoni është qytetar i Zvicrës.

2. Sipas kësaj baze, ai në vendin e banimit mund të marrë pjesë në të gjitha zgjedhjet dhe votimet lidhur me materien federale, pasi të dëshmojë sipas normave veçorinë e vet të votuesit.

Neni 45.

(me ndryshimet nga vitit 1975)

Çdo qytetar zviceran mund të banojë kudo në vend.

PJESA E DYTË

ORGANET FEDERALE

I. Kuvendi Federal.

Neni 71.

Nën rezervën e të drejtës së popujve dhe të kantoneve (nenet 89, 89, bis dhe 123) pushtetin suprem të Konfederatës e kryen Kuvendi Federal, i cili përbëhet nga dy dhoma dhe atë:

A. Dhoma Nacionale,

B. Dhoma e Shteteve

C. Autorizimet e Kuvendit Federal

Neni 85.

Në kompetencat e të dy dhomave bëjnë pjesë këto punë:

1. Ligjet mbi organizimin dhe mënyrën e zgjedhjes së organeve federale.

2. Ligjet dhe vendimet në materiet që me kushtetutë janë vënë në kompetencë federale.

3. Rrogat dhe shpërblimet e anëtarëve të organeve të Konfederatës dhe të Kancelarisë Federale; formimi i shërbimeve të përhershme federale dhe caktimi i rrogave.

4. Zgjedhja e Dhomës Federale, Gjyqit Federal dhe e Kancelarit, si dhe zgjedhja e kryekomandantit të Armatës Federale.

Me ligjin federal, Kuvendi Federal mund t'i jepen edhe të drejta tjera lidhur me zgjedhjen ose konfirmimin.

5. Alenacat dhe kontratat me shtetet e huaja si dhe lejimi i kontratave të cilat i lidhin kantonet ndër vete ose me shtetet e huaja: mirëpo, kontratat e kantoneve i paraqiten Kuvendit Federal vetëm nëse Dhoma Federale ose ndonjë kanton tjetër ushtron ankesë.

6. Masat me qëllim të sigurisë së jashtme si dhe me qëllim të ruajtjes së pavarësisë dhe të neutralitetit të Zvicrës; shpallja e luftës dhe lidhja e paqes.

7. Garantimi i kushtetutave dhe të territoreve të kantoneve; intervenimi që rezulton nga kjo garanci; masat me qëllim të sigurimit të brendshëm të Zvicrës me qëllim të ruajtjes së paqes dhe të rendit amnistia dhe e drejta e faljeve.

8. Masat me anë të të cilave sigurohet respektimi i Kushtetutës Federale dhe garancia e kushtetutave kantonale si dhe masat me qëllim që të arrihet përmbushja e zotimeve federale.

9. E drejta e disponimit të Armatës Federale.

10. Miratimi i buxhetit vjetor akordimi i llogarive shtetërore dhe i vendimeve me të cilat lejohet nënshkrimi i huave.

11. Kontrolli suprem mbi administratën dhe gjyqësinë federale.

12. Ankesat kundër vendimeve të Dhomës Federale që kanë të bëjnë me kontestet administrative (neni 113).

13. Konfliktet e kompetencave midis organeve federale.

14. Revidimi i Kushtetutës Federale.

Neni 89.

(me ndryshimet nga vitit 1921, 1939, 1949 dhe 1977)

Ligjet federale dhe vndimet federale mund të miratohen vetëm nëse janë të pajtimit të dy dhomat.

II. Dhoma Federative*Neni 95.*

Pushtetitn suprem direktorial dhe ekzekutiv të Konfederatës e ushtron Dhoma e cila përbëhet nga shtatë anëtarë.

Neni 102.

Autorizimet dhe detyrat e Dhomës Federale, në kufijt e kësaj kushtetute, posaçërisht janë këto:

1. Ajo drejton punët federale, në harmoni me ligjet dhe vendimet e Konfederatës.
 2. Ajo kujdeset për respektimin e Kushtetutës, të ligjeve e të vendimeve të Konfederatës si dhe dispozitat e marrëveshjeve federale (konkordatet); ajo, me iniciativë të veten apo sipas ankesave merrë masat e domosdoshme për respektimin e tyre, në qoftë se ankesa nuk bënë pjesë midis atyre që duhet t'i paraqitet gjyqit federal në përputhje me nenin 113.
 3. Ajo kujdeset për garantimin e kushtetutave kantonale.
 4. Ajo ia paraqet projektet e ligjeve e të vendimeve Kuvendit të federal dhe e jep mendimin e vet për propozimet që ia drejtojnë dhomat ose kantonet.
 5. Ajo siguron zbatimin e ligjeve e të vendimeve të Konfederatës dhe zbatimin e aktgjykimeve të gjyqit federal, si dhe nivelizmin e raportit të aktgjykimeve arbizrazhe me rastin e kontesteve midis kantoneve.
 6. Ajo bën emërimet të cilët nuk i janë besuar Kuvendit Federal ose gjyqit federal, apo ndonjë organi tjetër.
 7. Ajo shqyrton kontratat e kantoneve të lidhura mes veti ose me botën e jashtme dhe i lejon ato nëse për këtë ka vend (neni 85, p.5)
 8. Ajo kujdeset për interesat e Konfederatës ndaj botës së jashtme e veçmas për mbajtjen e marrëdhënieve të saja ndërkombëtare ajo në përgjithësi është e detyruar për lidhje me botën e jashtme.
 9. Ajo kujdeset për sigurinë e jashtme të Zvicrës, për ruajtjen e pavarësisë dhe të neutralitetit të saj.
 10. Ajo kujdeset për sigurinë e brendshme të Konfederatës, për ruajtjen e paqes e të rendit.
 11. Në rast të domosdoshëm (së fundi), Dhoma Federale, nëse Kuvendi Federal nu kështë i tubuar, është e autorizuar të mobiliojë trupat e nevojshme dhe të disponojë ato, por është e detyrueshme që menjëherë të konvokojë Dhomën nëse numri i trupave të mobiluara kalon 2.000 njerëz, ose nëse ato mbeten nën armë mbi tri javë.
 12. Ajo është e ngarkuar me krejt atë që i përket Armatës Federale, si dhe për të gjitha degët tjera të administratës që i përkasin Konfederatës.
 13. Ajo shqyrton ligjet dhe normat kantonale, të cilat duhet t'i paraqiten për lejim; ajo kryen kontrollin mbi degët e administratës kantonale të cilat janë vënë nën kontrollin e saj.
 14. Ajo drejton financat e Konfederatës, propozon buxhetin dhe paraqet llogarinë për të hyrat e të dalurat.
 15. Ajo kryen kontrollin e punës së të gjithë funksionarëve e të nëpunësve të administratës federale.
 16. Ajo i jep llogari për punën e vet Kuvendit Federal në secilin sesion të rregullt, iparaqet asaj raportin për gjendjen e Konfederatës si brenda, por edhe ndaj botës së jashtme, dhe i propozon masat të cilat ikonsideron të dobishme për rritjen e mirëqenies së përgjithshme.
- Ajo gjithasht harton raporte të veçanta kur këtë e kërkon Kuvendi Federal ose njëra nga dhomat e tij.

IV. Gjyqi Federal*Neni 110.*

1. Gjyqi Federal gjykon në kontestet civilo-juridike;
2. midis Konfederatës e kantoneve;
3. midis kantoneve.

Neni 113.

1. Përpos kësaj, Gjyqi federal zgjidh:
 1. kontestet e kompetencave midis organeve feerale, ngan jëra anë dhe të organeve kantonale nga ana tjetër;
 2. kontestet midis kantoneve, kur ato konteste janë ga sfera e të drejtës publike.

V. Dispozita të ndryshme*Neni 116.*

(me ndryshimet nga viti 1938)

1. Gjuhët gjermane, franceze, italiane dhe reto-romane janë gjuhë të Zvicrës.
2. Gjuhë zyrtare të Konfederatës shpallën: gjermanishtja, frengjishtja dhe italishtja.

**B. KUSHTETUTA E KANTONIT TË BERNIT (1893) ME
AMANDAMENTET NGA 26 SHKURTI 1978.**

Neni 1.

1. Kantoni i Bernit është Republikë Demokratike dhe një nga shteti i Konfederatës Zvicerane.
2. Sovraniteti kantonal i takon popullit i cili atë e ushtron drejtpërdrejtë me anë të votimit dhe tërthorazi me anë të organeve të pushtetit.

Neni 2.

1. Në këtë kushtetutë do të shfaqet kujdes për veçoritë e Jurës berne, kur është fjala për çështjet që kanë të bëjnë me gjuhën dhe kulturën e popullatës e cila flet frengjisht në rrathin dygjuhësor Bijen, nga njëra anë, dhe në rrethin Lofone në anën tejtër.
2. Për këtë qëllim banorëve të këtyre rretheve u njihet e drejta e veçantë për bashkëpunim, si dhe e drejta e propozimit dhe e dhënies së mendimit për çështjet që u përkasin atyre në veçanti.
3. Këto çështje do të rregullohen detajisht me ligje he me akte tjera përkatëse.

Neni 2a.

Kantoni bashkëpunon me të gjitha kantonet rreth të gjitha çështjeve nga kompetencat e veta.

Neni 17.

2. Gjuhët zyrtare janë:

- * në Jurinë berne - frengjishtja;
- * në Bijen - gjermanishtja dhe frengjishtja;
- * në rrethet tjera - gjermanishtja.

3. Ligjet, dekretet, urdhëresat dhe aktgjykimet shpallen në gjuhën gjermane në pjesë gjermane të Kantonit dhe në frengjishte në pjesë franceze të Kantonit.

Neni 17a.

1. Autoritetet gjyqësore të cilat kompetencat e ushtrojnë në tërë territorin e kantonit, i kryejnë punët e veta në gjuhën e rrethit respektiv. Para gjyqit, gjyqëtari në bazë të marrëveshjes me palën mund të lejojë përdorimin e gjuhës tjetër nacionale.

2. Gjatë kryerjes së punëve para gjyqit, secila nga palët ka të drejtë të zgjedh njërën nga gjuhët nacionale.

Neni 17b.

Këshilli i lartë me dekret e rregullon përdorimin e gjuhës në rrethin dygjuhësorë të Bijenit.

Neni 20.

Parg. 20. Emëron komisionin e paritetit të cilin e përbëjnë përfaqësuesit e Jurës berne, përfaqësuesit e rrethit të Biejnit të cilët flasin gjuhën frenge nga njëra anë dhe përfaqësuesit e rretheve tjera nga ana tjetër. Ky komision si organ këshilldhënës shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me Juren berne dhe me banorët që flasin gjuhën frenge në rrethin e Bijenit.

Neni 26.

Parg. 20a. Emëron komisionin e paritetit të përbërë nga përfaqësuesit e rrethit të Lofonit nga njëra anë dhe të përfaqësuesve të kantoneve tjera, nga ana tjetër. Ky komision shqyrton, në baza këshilldhënëse, çështjet që kanë të bëjnë me rrethin e Lafonës.

Neni 28a.

Në qoftë se vendimet që kanë të bëjnë me çështjet nga neni 2, nuk fitojnë shumicën e dy të tretave të votave të përfaqësuesve që kanë votuar të Jurës berne dhe të përfaqësuesve të Bijenit të ciëlt i përfaqësojnë banorët të cilët flasin gjuhëfrengje ose përfaqësuesit të Lafonës, përfaqësuesit e këtyre provincave mund të kërkojnë që vendimi i ri të paraqitet në votim.

Neni 33.

4. Një vend është i siguruar për Jurën berne.

Neni 34.

3. Nën rezervën e të drejtës minimale e cila i takon Jurës berne në Këshillin Ekzekutiv janë zgjedhur:

- në turnin e parë të votimeve - kandidatët të cilët fitojnë shumicën absolute të votave që atyre që votojnë, e në bazë të renditjes së numrit të votave që i kanë fituar;
- në turnin e dytë të votimeve e që është i lirë, ata të cilët fitojnë shumicën e votave.

KREU VII**DISPOZITAT KALIMTARE QË KANË TË BËJNË ME NDARJEN E RRETHEVE DELEMON, FRANS-MONTANJ TË PORENTRUIT***Neni 105.*

1. Pas ndarjes, Këshilli i Lartë i përfundon punët që janë në zhvillim e sipër pa anëtarët e rrethit respektiv elektoral.

2. Në punën e Këshillit Ekzekutiv aplikohet neni 34, alinea 2 e kushtetutës kantonale.

Neni 106.

1. Këshilli Ekzekutiv është kompetent për miratimin e vërejtjeve redaktuese në ligjet që kanë të bëjnë me ndarjen.

2. Këshilli Ekzekutiv ia paraqet Këshillit të Lartë raportin që ka të bëjë me miratimin e ndryshimeve për të cilat është kompetent.

Neni 107.

1. Këshilli Ekzekutiv vendos në mënyrë sovraane mbi lidhjen e marrëveshjes për zhvillimin e jashtëzakonshëm të procedurës civile, penale administrative kur kjo çështje nuk gjendet në kompetencën e autoriteteve berne si pasojë e procedurës së ndarjes.

2. Nenet 58. dhe 59. të Kushtetutës nuk gjenden nën rezervë.

Neni 108.

1. Këshilli Ekzekutiv është kompetent për nxjerrjen e rregullave, dhënien e urdhëresave dhe për lidhjen e marrëveshjeve qëllimi i të cilave është që të konfirmojnë dhe garantojnë pozitën ekzistuese, të përcaktojnë kushtet e transferimit ose të përdorimit të përkohshëm të të mirave të Kantonit të Bernës, si dhe të institucioneve dhe korporatave të tija.

2. Këshilli Ekzekutiv e përfaqëson kantonin dhe institucionet e tij në çështjet që kanë të bëjnë me ndarjen.

3. Këshilli Ekzekutiv është i vetmi kompetent, me kusht që për këtë të marrë leje të mëvonshme të Këshillit të Lartë, për lidhjen e marrëveshjeve që kanë të bëjnë me ndarjen e të mirave midis kantoneve të reja.

4. Konventat nga fusha e legjislacionit ose që kanë të bëjnë me transferimin e kontesteve në instancat arbitrazhe ose në organet që merren me dhënien e shërbimeve të mira, mund të nxirren në referendum i cili është fakultativ (neni 6c, Cc).

Ligji i miratuar më 10. prill 1978 (që ka të bëjë me të drejtën e bashkëpunimit të Jurës berne me popullatën gjuhëfolëse frenge të rrethit dygjuhësor Bijen).

A. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Ky ligj e rregullon të drejtën e realizimit të bashkëpunimit të Jurës berne me popullatën e rrethit të Bijenës i cili flet gjuhën frenge.

Neni 2.

1. Të gjitha propozimet e Kushtetutës, të ligjeve e të dekreteve të cilat rregullojnë çështjet e veçanta që kanë të bëjnë me situatën e tyre të posaçme, para se t'i paraqiten Këshillit të Lartë, duhet t'i paraqiten Jurës berne për mendim paraprak. Qëndrimi i organeve të saj duhet të gjendet në raportin të cilin Këshilli Ekzekutiv ia paraqet Këshillit të Lartë.

2. Jura berne, duhet të konsultohet para lidhjes, ndryshimet ose pezullimit të marrëveshjeve dhe dekreteve ndërkantonale të Këshillit Ekzekutiv që kanë të bëjnë me atë.

3. Ajo mund të thirret për të bashkëpunuar në ekzekutimin e ligjeve dhe dekreteve kantonale dhe të marrëveshjeve ndërkantonale.

4. Ajo është e obligueshme të bashkëpunojë në çështjet që kanë të bëjnë me decentralizimin administrativ.

5. Ajo paraqet propozimet për zgjedhjet që kanë të bëjnë me të cilat i shpallë Këshilli Ekzekutiv.

6. Ajo mundet në çdo moment dhe me iniciativën e vet të paraqes propozime lidhur me punët kantonale që kanë të bëjnë me të.

7. Në bazë të vendimit të Jurës berne parashikohet, me anë të urdhëresës, edhe mundësi të tjera të bashkëpunimit.

Neni 3.

Bashkëpunimi i popullatës së rajonit dygjuhësor në Bijen, të cilët flasin frengjisht nënkuptohet në çështjet që kanë të bëjnë me gjuhën dhe kulturën, me çka nënkuptohet edhe shkolla.

Neni 4.

1. Të drejtën e bashkëpunimit e ushtrojnë përfaqësuesit e Jurës berne në Këshillin e Lartë dhe përfaqësuesit e popullatës të cilët flasin frengjisht e që janë zgjedhur në rrethin e Bijenit (neni 26, par. 20 dhe neni 28a i Kushtetutës Kantonale).

2. Në çështjet tjera, banorët e Jurës berne dhe popullata e cila flet frengjisht në rrethin dygjuhësor të Bijenit i realizojnë të drejtat e veta me anë të përfaqësuesve të tyre që janë zgjedhur në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

3. Këshilli presidencial është instancë i cili siguron bashkëpunimin me autoritetet kantonale.

B. KOLEKTIVITETET PUBLIKOJURIDIKE QË I TAKOJNË JURËS BERNE

I. BAZAT

Neni 5.

1. Komunat në rrethet Curteli, Mutie, Lanewil dhe Bijen, në bazë të ligjit janë kolektivitete publikojuridike.

2. Bashkësitë e Biejnit dhe Delivarit nuk janë pjesë të këtyre bashkësive, përpos kur është fjala për çështjet që kanë të bëjnë me gjuhën dhe kulturën duke përfshirë këtu edhe shkollat.

Neni 6.

1. Përpos në rastin kur është caktuar ndryshe me këtë ligj aplikohen dispozitat e ligjit mbi komunat.

2. Përveç kësaj, kolektivitetet e rregullojnë vetë organizimin e tyre dhe me normat mbi organizimin e vet i caktojnë selitë e veta.

Neni 7.

1. Organe të kolektiviteteve janë Kuvendi Përfaqësues dhe Këshilli.

2. Aktet mbi organizimin mund të parashikojnë ekzistimin e organeve tjera.

II. KUVENDI I PËRFAQËSUESVE

Neni 8.

1. Kuvendi i përfaqësuesve është e përbërë nga 40 përfaqësues të Jurës berne dhe përfaqësuesve të rrethit të Bijenit.

2. Numri i përfaqësuesve të rrethit të Bijenit përcaktohet sipas formulës në vijim:

popullata e Bijenit që flet frengjisht

_____ x 40

popullata e Jurës berne

Bazë për llogaritje është regjistrimi i fundit i popullatës.

Pjesa e mbetur prej 0,5 ose më shumë rrumbullakohet në numër të plotë më të madh.

3. Anëtarët e Këshillit të Lartë nga Jura berne dhe ata të zgjedhur në rrethet ku flitet frengjishtja, janë anëtarë të kuvendit përfaqësues sipas detyrës zyrtare.

Neni 9.

Themelohen 9 njësi elektorale për zgjedhjen e deputetëve:

...

Neni 10.

Dyzet vende që janë rezervuar për Jurën berne janë sistemuar midis nëntë njësive elektorale në këtë mënyrë:

a. Klasifikimi paraprak: Numri i banorëve të Jurës berne pjestohet me 40; secili rreth elektorale numri i banorëve të të cilit nuk është dyfish më shumë ga rezultatet e fituara me pjestimin sipas mënyrës së përmendur, ka të drejtën e dy vendeve; ai rreth elektorale nuk merr pjesë në ndarjen plotësuese të vendeve;

b. Klasifikimi kryesor: numri i mbetur i banorëve në njësitë elektorale pjestohet me numrin e vendeve të cilat ende nuk janë klasifikuar (ndarë). Secila nga njësitë elektorale fiton aq vende sa herë të përmbahet numri i banorëve të saj në koeficientin e ri;

c. Klasifikimi i vendeve të mbetura (tjera): njësitë elektorale ku numri i mbetur i banorëve është më i madh, fitojnë vende të cilat ende nuk janë sistemuar (ndarë). Në qoftë se numri i banorëve të mbetur (të tjerë) i dy apo më shumë njësive elektorale është i barabartë, vendi i fundit i ndahet njësisë numri i banorëve të mbetur të së cilës është më i madh, kur numri i banorëve të saj pjestohet me koeficientin për sistemimin paraprak të vendeve.

Neni 11.

1. Këshillat komunale të bashkësive në të cilat gjenden njësitë elektorale, me iniciativën e prefektit ua paraqesin zgjedhësve propozimin më së voni pesë muaj pas mbajtjes së zgjedhjeve.

2. Për secilin vend propozohet bartësi i vendit të deputetit dhe zëvendësi i cili e zëvendëson bartësin nëse ai e braktisë detyrën gjatë zgjatjes së mandatit.

3. Në qoftë se nuk mbahen zgjedhjet popullore kandidatët e propozuar konsiderohen të zgjedhur.

Neni 12.

1. E drejta për të zgjedhur i takon popullit:

- nëse këshillat komunale nuk mund të arrijnë marrëveshje për propozimin e përbashkët ngase atë e refuzon njëri nga këshillat komunale;

- nëse një kërkesë të tillë e paraqet një e dhjeta e zgjedhësve të njësisë elektorale më së voni tre muaj para mbajtjes së zgjedhjeve.

1. Në rast se zgjedhjet i kryen populli aplikohen rregullat analoge për zgjedhjen e Këshillit të Lartë.

Neni 13.

Në kuvendin përfaqësues, si bartës i mandatit ose zëvendës, mund të zgjidhet çdo person që ka vendbanim në njësinë elektorale dhe i cili e gëzon të drejtën e votës në punët që kanë të bëjnë me kantonin.

Neni 14.

1. Vendet e përfaqësuesve për rrethin e Bijenit janë klasifikuar midis bashkësive të Bijenit dhe Davijarit proporcionalisht me numrin e banorëve të tyre të cilët flasin frengjisht. Një vend, për çdo rast është rezervuar për bashkësinë e Devijarit.

2. Secila nga këto dy bashkësi i përcakton rregullat elektorale si dhe kushtet për zgjedhje në territorin e vet.

Neni 15.

1. Anëtarët e kuvendit përfaqësues zgjidhen në periudhën prej katër vitesh. Me normat dhe organizimin e kolektivitetit caktohet data e mbajtjes së zgjedhjeve dhe fillimi i periudhës së mandatit.

2. Pas përtëritjes së plotë të vendeve ku gjendet selia e kolektivitetit, prefekti e konvokon seancën e parë të kvuedit. Në të gjitha rastet tjera seancën e konvokon kryetari.

Neni 17.

1. Kuvendi përfaqësues si organ më i lartë i kolektivitetit:

a. miraton rregullat mbi organizimin dhe miraton rregullorën e punës;

b. debaton për punët mbi të cilat Këshilli Ekzekutiv ia paraqet Jurës berne për mendim paraprak dhe i cakton kahet për t'i dhënë përgjigje Këshillit;

d. kërkon nga Këshilli që t'i paraqesë propozim Këshillit Ekzekutiv;

e. e parapërcakton, nën rezervën e nenit 23, buxhetin dhe e miraton raportin mbi drejtimin e buxhetit si dhe llogarinë përfundimtare;

f. i konfirmon marrëveshjet që i lidh kolektiviteti;

g. i kryen të gjitha punët tjera të cilat i janë besuar në bazë të rregullave mbi organizimin.

2. Rregullat mbi organizimin mund të parashikojnë se, në rastet kur këtë e kërkojnë kushtet, mendimin paraprak mund ta formulojë Këshilli në harmoni me alinejën 1. pika c., Këshilli për këtë e njofton Kuvendin në sesionin e tij të ardhshëm.

3. Secila komunë e cila gjendet në përbërje të kolektivitetit mund t'i paraqesë propozime kuvendit përfaqësues. Rregullat mbi organizimin i rregullojnë detajisht këto çështje.

III. KËSHILLI

Neni 18.

Kuvendi i përfaqësuesve e zgjedh Këshillin. Rregullat mbi organizimin e rregullojnë detajisht këto çështje.

Neni 19.

Këshilli e përfaqëson kolektivitetin nga jashtë dhe merret me të gjitha çështjet të cilat, në bazë të këtij ligji dhe rregullave mbi organizimin, nuk janë në kompetencën ekskluzive të kuvendit të përfaqësuesve.

IV. FINANCIMI

Neni 20.

2. Shpenzimet që këriohen gjatë ushtrimit të së drejtës për bashkëpunim deri në gjysmën e shumës i mbulon shteti, katër të dhjetat kolektivitetit pa komunat në rrethin e Bijenit dhe një të dhjetën rrethi i Bijenit.

3. Kolektiviteti i sistemin shpenzimet midis komunave që gjenden në përbërje të tij. Pjesa që i takon Jurës berne (4/10) klasifikohen midis komunave në bazë të detyrimeve të tyre të përgjithshme të

pjesëmarrjes në financimin e Kantonit, pjesa që u takon komuanve të Bijenit dhe Devijarit (1/10) u takon në bazë të detyrimit të tyre të përgjithshëm të pjesëmarrjes në financimin dhe në bazë të kontributit të popullatës që flet gjuhën frengje midis banorëve të tyre.

4. Kolektiviteti e rregullon financimin e punëve të tjera në harmoni me aktet ligjore federale e kantonale në fuqi dhe në raste të jashtëzakonshme në bazë të pëlqimit të Këshillit Ekzekutiv.

V. MBIKËQYRJA DHE MJETET JURIDIKE

Neni 21.

Mbikëqyrjen e përgjithshme e kryen prefekti në selinë e kolektivitetit.

Neni 22.

Rregullat mbi organizimin e kolektivitetit kërkojnë lejen e Këshillit Ekzekutiv.

Neni 23.

Buxheti dhe llogaria përfundimtare në pjesën që kanë të bëjnë me të drejtën e bashkëpunimit, kërkojnë lejen (miratimin) e Këshillit Ekzekutiv.

Neni 24.

2. Ankesat që u përkasin zgjedhjeve të deputetëve i zgjidh prefekti i cili është kompetent për njësinë respektive elektorale.

3. Ankesat kundër vendimeve që i merr kolektiviteti ose kundër organeve të tyre, i zgjidh prefekti në selinë e kolektivitetit.

4. Në të gjitha rastet tjera ndaj ankeasve aplikohen rregullat të cilat vlejné për ankesat në materjen e punëve komunale.

C. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 25.

Këshilli Ekzekutiv e cakton datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

5. BELGJIKA

A. NGA KUSHTETUTA

KAPITULLI I

Territori dhe organizimi i tij

Neni 1.

Belgjika është e ndarë në provinca.

Provincat e Belgjikës janë: Anntverpreni, Brabanti, Flandrija Perëndimore, Flandrija Lindore, Enoli, Lijeza, Limburgu, Luksemburgu dhe Namuri.

Me ligj mundet, nëse është e nevojshme, të formohet numri më i madh i provincave.

Me aktin e parlamentit mund të veçohen rajonet, kufijtë e të cilave i konfirmon parlamenti, që nuk janë të ndara në provinca dhe të cilat vëhen nën kompetencën e drejtëprdrejtë të pushtetit ekzekutiv. Me këtë akt caktohet edhe statusi i tyre.

Akti i tillë duhet të miratohet me shumicën e votave në secilën nga grupet gjuhësore në çdonjërin nga dhomat, me kusht që me rastin e votimit të jenë të pranishëm shumica e anëtarëve të secilit grup dhe numri i përgjithshëm i votave "pro" brenda çdo grupi gjuhësor të arrijë dy të tretat e votave të anëtarëve të parlamentit që kanë votuar.

Neni 3b.

Belgjika përbëhet nga katër rajone gjuhësore: rajoni gjuhësor francez, rajoni gjuhësor holandez, rajoni dygjuhësor Brukseli - kryeqytet, dhe rajoni gjuhësor gjerman.

Secila komunë në Mbretërinë Begle i takon njërit nga rajonet gjuhësore.

Kufijtë e cilitdo nga katër rajonet mund të ndryshohen apo të korrigjohen me aktin e Parlamentit i cili është miratuar me shumicën e votave të çdo grupi gjuhësor në secilën nga dhomat e Parlamentit me kusht që me rastin e votimit të jetë e pranishme shumica e anëtarëve të çdonjërit nga grupet dhe që numri i përgjithshëm "pro" brenda çdo grupi gjuhësor të arrijë dy të tretat e votave të anëtarëve të parlamentit që kanë votuar.

Neni 3c.

Belgjika përfshinë tri bashkësi: bashkësinë folëse franceze, bashkësinë folëse flamane dhe bashkësinë gjermane.

Secila nga bashkësitë ka kompetenca të cilat i janë besuar me Kushtetutë apo me ligjet e miratuara sipas mënyrës së caktuar me Kushtetutë.

Neni 23.

Përcaktimi i gjuhëve që fliten në Belgjikë është opcional; vetëm me ligj mund të rregullohet përdorimi i tyre dhe atë vetëm kur është fjala për aktet e natyrës juridike të cilat i miratojnë shërbimet që ushtrojnë autorizime publike.

Neni 26b.

Ligjet që miratohen lidhur me aplikimin e nenit 107d. e përcaktojnë fuqinë juridike të rregullave të cilat i zbatojnë organet e formuara në bazë të nenit të lartpërmëtur të Kushtetutës.

Me këto ligje, në organet që kryejnë autorizime publike mund të bartet e drejta që për çështjet nga kompetencat e tyre të miratojnë dekrete që kanë fuqi ligjore sipas mënyrës dhe në suazat që do t'i caktojnë vetë.

Neni 31.

Interesat që konsiderohen interese ekskluzive të komuanëve ose të Provincave i rregullojnë këshillat e provincave në harmoni meparimet e përcaktuara me këtë Kushtetutë.

Neni 32.

Anëtarët e të dy dhomave të parlamentit e përfaqësojnë kombin e jo vetëm Provincën ose pjesën e Provincës në të cilën janë zgjedhur.

Neni 32b.

Në rastet e përcaktura me Kushtetutë, anëtarët e zgjedhur ndahen në grupin folës francez dhe grupin folës holandez sipas mënyrës së caktuar me ligj.

Neni 38b.

Shumica e kualifikuar për miratimin e ligjit mund të kërkohej përveç kur është fjala për buxhetin dhe ligjet për të cilët me Kushtetutë është përcaktuar se miratohen me shumicën kualifikuese; kur është fjala për ligjet të cilat mund të kenë pasoja serioze për marrëdhëniet midis bashkësive dhe kur kërkesën e tillë e kanë nënshkruar tri të katërtat e anëtarëve të një grupi gjuhësor dhe e kanë ushtruar pas paraqitjes së propozimit të ligjit të tillë e para votimit të fundit publik për të.

Në rastet e tilla stopohet procedura parlamentare dhe ligji i propozuar i kthehet kabinetit i cili, në afatin prej tridhjetë ditësh, e jep mendimin e vet mbi kërkesën dhe e thërrret dhomën për të vendosur a për mendimin e kabinetit, ose për projektin apo ligjin e propozuar.

Këtë procedurë grupet gjuhësore mund ta përdorin vetëm njëherë në raport me projektin apo të njëjtin ligj të propozuar.

KAPITULLI III - KËSHILLAT E BASHKËSIVE

Neni 59b.

1. Ekziston këshilli dhe organi ekzekutiv i bashkësisë franceze dhe këshilli e organi ekzekutiv i bashkësisë flamane. Përbërja dhe funksionimi i tyre rregullohet me ligj. Këshillat përbëhen nga përfaqësuesit e zgjedhur.

Lidhur me aplikimin e nenit 107b, të Kushtetutës, këshilli i secilës nga bashkësitë, bashkë me organet e veta ekzekutive, kryejnë kompetencat që janë bartur në rajonin e Valonit, përkatësisht në rajonin e Flaman, sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar me ligj.

Ligjet për të cilët bëhet fjalë në paragrafin e mëparshëm duhet të miratohen me shumicën e votave sikurse që është saktësuar në paragrafin e fundit të nenit 1.

2. Këshilli i bashkësive, secili në territorin e bashkësisë së vet, i rregullon me anë të dekreteve:

(1) çështjet e kulturës,

(2) arsimin, arsimin e detyrueshëm, strukturën e institucioneve arsimore, diplomat, kompensimet, rrogat dhe standardin e popullacionit të studentëve e tjera, duke përfshirë edhe ato çështje që i takojnë këshillit shkollor.

(3) bashkëpunimin midis bashkësive dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e kulturës.

Ligji i miratuar me shumicën esaktësuar në Pjesën I, të paragrafit 3, i cakton çështjet nga fusha e kulturës për të cilat flitet në pikën (1), dhe format e bashkëpunimit për të cilat flitet në pikën (3) të këtij paragrafi.

2b. Këshillat e bashkësive, secili veç e veç, do të rregullojë me dekret çështjet që kanë të bëjnë me punësimin, bashkëpunimin midis bashkësive dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në këtë çështje.

Ligji i miratuar sipas shumicës së caktuar nënenin 1, paragrafi i fundit, do t'i saktësojë çështjet e punësimit dhe format që mund t'i ketë bashkëpunimi.

3. Këshillat e bashkësive, secili në territorin e bashkësisë së vet, dota rregullojë me drekt, përveç kur kihet të bëhet melegjislacionin, përdorimin e gjuhës në këto fusha:

(1) çështjet administrative,

(2) arsimin në shkollat që i ka themelua, ose që i financion apo në ato që i pranon pushteti publik;

(3) raportet midis punëdhënësve dhe të punësuarëve dhe instrumentet afariste e dokumentet miratimin e të cilave e kërkon ligji ose rregullat tjera juridike.

4. Dekretet që miratohen në harmoni me pikën 2, kanë fuqinë e ligjit në rajonin gjuhësor francez, përkatësisht në rajonin gjuhësor holandez, varësisht nga rasti, si dhe në rajonin dygjuhësor të Brukselit - kryeqytet, i cili kur i ushtron kompetencat e veta të caktuara, duhet të konsiderohet si rajon i cili i takon njëres nga bashkësitë.

Këto dekrete pasi të shpallen në harmoni me pikën 3, kanë fuqinë e ligjit në rajonin gjuhësor francez ose në rajonin gjuhësor holandez, varësisht nga rasti, përveç në raport me:

- qarkun elektorale apo grupin e qarqeve elektorale të cilët i janë bashkuar rajonit tjetër gjuhësor dhe ku ligjet rregullojnë ose lejojnë përdorimin e gjuhës tjetër e jo të asaj që është gjuhë e rajonit ku ato gjenden;

- sektorët punët e të cilëve i kalojnë kufijtë e rajoneve gjuhësor ku janë vendosur selitë e tyre;

- institucionet nacionale e ndërkombëtare të caktuara me ligj, aktivitetet e të cilave kanë të bëjnë me më shumë se një bashkësi.

4b. Dekretet e miratuara nën kushtet e caktuara në pikën 2, kanë fuqinë e ligjit respektivisht në bashkësinë gjuhësore franceze e holandeze dhe gjithashtu, përveç kur kihet të bëhet me ligjet që janë miratuar me shumicën speciale të caktuar me paragrafin e fundit të nenit 1, për institucionet që janë krijuar në rajonin dygjuhësor Bruksel - kryeqytet të cilin për shkak të organizimit të vet e konsiderojnë pjesë të njëres nga bashkësitë.

5. Të drejtën e iniciativës e kanë trupat ekzekutive dhe anëtarët e këshillave.

6. Me ligj caktohen mjetet që u jepen në disponim këshillave të çdonjërës nga bashkësitë, të cilat alokimin e këtyre mjeteve e kontrollojnë me anë të dekreteve.

Këto mjete llogariten në bazë të kriterëve objektive që caktohen me ligj. Shuma e njëjtë e mjeteve formohet pr ato fusha që për nga natyra e vet nuk mund t'u nënshtrohen këtyre kriterëve objektive.

Duke respektuar rregullën e njëjtë, me ligj do të caktohet proporcioni i mjeteve të cilat duhet të veçohen për zhvillimin e çdonjërës nga bashkësitë brenda territorit të Brukselit - kryeqytet.

7. Me ligj caktohen masat që aplikohen për ta penguar diskriminimin e mbështetur në shkaqet ideologjike e filozofike.

8. Me ligj caktohet procedura për pengimin dhe zgjidhjen e konflikteve midis ligjeve e dekreteve dhe midis dekreteve e akteve tjera juridike.

Neni 59c.

1. Bashkësia folëse gjermane ka këshillin dhe organin ekzekutiv. Përbërja e tij dhe mënyra e funksionimit rregullohet me ligj.

Këshilli përbëhet nga anëtarët e zgjedhur.

Neni 45 aplikohet analog me anëtarët e këshillit.

2. Këshilli rregullon me dekret këto çështje:

(1) çështjet në sferën e kulturës;

(2) çështjet që kanë të bëjnë me personat e punësuar;

(3) çështjet e arsimit, kur është fjala mbi çështjet e përfshira me nenin 59b, pika 2, dispozita 2;

(4) bashkëpunimin midis bashkësive dhe bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e kulturës si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar rreth çështjeve për të cilat flitet në nenin 59b, pika 2, dispozita 2.

Këto dekrete kanë fuqinë e ligjit në rajonin folës gjerman. Ligji i miratuar me shumicën e saktësuar në pjesën I, paragrafi 3, i përcakton çështjet nga fusha e kulturës për çka flitet në pikën (1), dhe format e bashkëpunimit për të cilat flitet në pikën (3) të këtij paragrafi.

Me propozimin e organit ekzekutiv të njëres nga bashkësitë. Këshilli i bashkësisë folëse gjermane dhe Këshilli Rajonal i Valonisë, munden me anë të marrëveshjes së ndërsjellë ose me dekret të veçantë të rregullojnë, që këshilli dhe organi ekzekutiv i Bashkësisë folëse gjermane brenda rajonit gjuhësor gjerman të kryej plotësisht ose pjesërisht punët të cilat përndryshe i takojnë Këshillit Rajonal të Valonisë.

4. Këshilli dhe organi ekzekutiv i bashkësisë folëse gjermane kryen, me anë të dekreteve apo rregullave, kompetencat që i janë besuar me ligj.

Neni 107 aplikohet në këto dekrete dhe rregulla.

5. E drejta e iniciativës i është esuar organit ekzekutiv dhe anëtarëve të këshillit.

6. Me ligj caktohen mjetet që i vëhen në dispozicion këshillave të çdo njësie nga bashkësitë të cilat alokimin e këtyre mjeteve e kontrollojnë me anë të dekreteve.

Këto mjete llogariten në bazë të kriterëve objektive që caktohen me ligj. Shuma e njejtë e mjeteve formohet për ato fusha që për nga natyra e vet nuk mund t'u nënshtrohen këtyre kriterëve objektive.

Duke respektuar rregulloren e njejtë, me ligj do të caktohet proporcioni i mjeteve të cilat duhet të veçohen për zhvillimin e çdo njëres nga bashkësitë brenda territorit të - kryeqytet.

7. Me ligj caktohen masat që aplikohen për t'u penguar diskriminimi i bazuar në shkaqet ideologjike e filozofike.

8. Me ligj caktohet procedura për pengimin dhe zgjidhjen e konflikteve midis ligjeve e dekreteve dhe midis dekreteve e akteve.

Neni 59c.

Bashkësia folëse gjermane ka këshillin dhe organin ekzekutiv. Përbërja e tij dhe mënyra e funksionimit rregullohet me ligj.

Këshilli përbëhet nga anëtarët e zgjedhur.

Neni 45 aplikohet analog me anëtarët e këshillit.

2. Këshilli rregullon me dekret këto çështje:

(1) çështjet në sferën e kulturës;

(2) çështjet që kanë të bëjnë me personat e punësuar;

(3) çështjet e arsimit, kur është fjala për çështjet e përfshira me nenin 59b, pika 2, dispozita 2;

(4) bashkëpunimin midis bashkësive dhe bashkëpunimin ndërkombëtar rreth çështjeve për të cilat flitet në nenin 59b pika 2 dispozita 2.

Këto dekrete kanë fuqinë e ligjit në rajonin folës gjerman.

Ligji i miratuar me shumicë i saktësuar me pjesën I, paragrafi 3, i përcakton çështjet nga fusha e kulturës për çka flitet në pikën (1), dhe format e bashkëpunimit për të cilat flitet në pikën (3) të këtij paragrafi.

Me propozimin e organit ekzekutiv të njëres nga bashkësitë, Këshilli i bashkësisë folëse gjermane dhe Këshilli Rajonal i Valonisë, munden me anë të marrëveshjes së ndërsjellë ose me dekret të veçantë të rregullojnë që këshilli dhe organi ekzekutiv i Bashkësisë folëse gjermane brenda rajonit gjuhësor gjerman, të kryej plotësisht ose pjesërisht punët të cilat përndryshe i takojnë Këshillit Rajonal të Valonisë.

4. Këshilli dhe organi ekzekutiv i Bashkësisë folëse gjermane kryen, me anë të dekreteve apo rregullave, kompetencat që i janë besuar me ligj.

Neni 107 aplikohet në këto dekrete dhe rregulla.

5. E drejta e iniciativës i është besuar organit ekzekutiv dhe anëtarëve të Këshillit.

6. Me ligj caktohen mjetet që i vëhen në dispozicion Këshillit i cili alokimin e atyre mjeteve i kontrollon me anë të dekretit.

7. Me ligj caktohen masat që aplikohen për t'u penguar diskriminimi i bazuar në shkaqet ideologjike e filozofike.

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Deri në ditën kur fillon aplikimi i ligjit për të cilin flitet në pikën 1, dispozita 1, pikën 2, dispozitën 3; pikën 6 e 7 për Këshillin e bashkësisë folëse gjermane do të aplikohet Ligji nga dhjetë korriku i vitit 1973.

Me përjashtim të Kryeministrit, kabineti përbëhet nga numë i njejtë i ministrave të cilët flasin gjuhën franceze e holandeze.

KREU III - PENGIMI DHE ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE TË LIGJEVE

Neni 107c.

1. Me ligj caktohet procedura për pengimin e konfliktit midis ligjeve, dekreteve dhe rregullave për të cilat flitet në nenin 26b, midis dekreteve si dhe midis dekreteve e rregullave për të cilat bëhet fjalë në nenin 26b.

2. Për territorin e mbarë Belgjikës themelohet gjyqi i arbitrazhit. Përbërja, kompetencat dhe funksionimi i tij rregullohen me ligj.

Dispozitat kalimtare

Neni 107c hyn në fuqi në afatin prej gjashtë muajve nga dita e shpalljes së tij. Si masë kalimtare miratohet ligji i cili e cakton procedurën për tejkalimin ose zgjidhjen e konflikteve midis ligjeve e dekreteve dhe midis dekreteve.

KREU III-C - INSTITUCIONET RAJONALE

Neni 107d.

Belgjika përbëhet nga tri rajone: Valonisë, Flamanisë dhe i Brukselit.

Me ligj, në organet rajonale që do të formohen dhe të cilat do të përbëhen nga përfaqësuesit e zgjedhur, barten kompetencat që në kuadër të autorizimeve të veta t'i drejtojnë çështjet e caktuara me këtë ligj, duke përjashtuar ato për të cilat flitet në nenin 23 dhe 59b, dhe me procedurën e cila do të caktohet.

Ky ligj duhet të miratohet me shumicën e votave të secilit grup gjuhësor në të dy dhomat e parlamentit, me kusht që shumica e anëtarëve të çdo grupi të jetë e pranishme në seancën ku votohet dhe me kusht që numri i përgjithshëm i votave "pro" në të dy grupet gjuhësore të arrijë dy të tretat e votave të atyre që kanë marrë pjesë në mbledhje.

Neni 108.

Puna e institucioneve rajonale e komunale rregullohet me ligj.

Me ligj rregullohet aplikimi i këtyre parimeve:

- (1) zgjedhjet e drejtpërdrejta të anëtarëve të këshillave rajonale dhe të rretheve;
- (2) caktimi i kompetencave të këshillave rajonale e të rretheve për të gjitha çështjet me interes rajonal e të rretheve, duke respektuar rregullat mbi miratimin e akteve të tyre në rastet dhe në procedurat e caktuara me ligj;
- (3) decentralizimi i pushtetit në favor të institucioneve rajonale e të rretheve;
- (4) karakteri pulik i këshillave rajonale e të rretheve në suazat e caktuara me ligj;
- (5) shpallja e të hyrave e të dalurave;
- (6) ndërhyrja e pushtetit mbikqyrës apo e pushtetit gjyqësor për pengimin e shkeljes së ligjeve apo të mosrespektimit të interesave të përgjithshme.

Në aplikimin e ligjit i cili është miratuar me shumicën e përkrahur në paragrafin e fundit të nenit 1, organizimin dhe kryerjen e kontrollit administrativ mund ta rregullojnë këshillat e bashkësive dhe të rajoneve.

Më shumë provinca apo rrethe mundën, nën kushtet dhe në suaza të procedurës së caktuar me ligj, të bashkëpunojnë mes veti apo të bashkohen për realizimin e interesave të bashkësisë ose të rrehit. Mirëpo, është e ndaluar që më shumë këshilla rajonale ose këshilla të rretheve të mbajnë seancën e përbashkët për marrjen e vendimeve.

Neni 108b.

1. Me ligj formohen tërësitë e qyteteve dhe federatat e bashkësive. Ligji i përcakton organizimin dhe kompetencat e tyre duke aplikuar parimet e përmendura në nenin 108.

Secila tërësi e qyteteve dhe federata e bashkësive ka këshillin dhe organin ekzekutiv.

Kryesuesin e organit ekzekutiv e zgjedh këshilli nga radhët e anëtarëve të vet: zgjedhjen e tij e konfirmon mbreti. Me ligj caktohet statusi i tij.

Neni 107 dhe 129, aplikohen edhe në dekretet dhe rregullat që i kanë miratuar tërësitë e qyteteve dhe federatat e bashkësive.

Kufijtë e tërësive të qyteteve dhe të federatave të bashkësive mund të ndryshohen apo të korrigjohen vetëm me ligj.

2. Me ligj formohet organi në të cilin tërësitë e qyteteve dhe federatat më të afërta të bashkësive, shqyrtojnë bashkërisht çështjet me interes të përbashkët të natyrës teknike nga suazat e kompetencave të tyre dhe atë nën kushtet dhe procedurën që janë rregulluar me ligj.

3. Më shumë federata të bashkësive mund të pëlqehen dhe të bashkohen nën kushtet dhe procedurën e caktuar me ligj e me qëllim që bashkarisht t'i realizojnë objektivat që bëjnë pjesë në kompetencat e tyre. Nuk është e lejueshme që këshillat e tyre të mbajnë seanca të përbashkëta për marrjen e vendimeve.

Neni 108c.

1. Neni 108b, aplikohet në tërësinë e qytetit të cilit i takon kryeqyteti i mbretërisë, me të cilin kanë të bëjnë edhe dispozitat në vijim.

2. Për ato raste që janë parashikuar me kushtetutë dhe me ligje, këshillat e tërësive të qyteteve ndahen, sipas mënyrës së caktuar, me ligj në ato që i takojnë grupit folës francez dhe grupit folës holandez.

Organet ekzekutive janë të përbëra nga numri tek i anëtarëve. Përfshijtur kryesuesin, ato janë të përbëra nga numër i barabartë i anëtarëve që i takojnë grupit folës francez, përkatësisht atij holandez.

3. Përveç në rastin kur është fjala për buxhetin mund të paraqitet ankesa e nënshkruar të paktën nga tri të katërtat e anëtarëve të këshillit që i takon njërit grup gjuhësor në këshillin e tërësisë së qytetit dhe atë para votimit të fundit lidhur me dekretin ose rregullën e caktuar, kur propozimi i atij dekreti apo rregulloreje i prish seriozisht marrëdhëniet midis bashkësive. Për çdo rast stopohet procedura në këshillin e tërësisë së qytetit dhe propozimi i kthehet organit ekzekutiv i cili në afatin prej 30 ditësh merr qëndrimin për ankesën në fjalë dhe e fillon ndryshimin e projektit ose të propozimit të dokumentit në fjalë nëse këtë e ka vlerësuar të nevojshme.

Të drejtën për të kryer kontrollin lidhur me rregullat ose dekretet e mirataura pas procedurës së tillë, e ka mbreti me propozim të kabinetit.

Anëtarët e grupit gjuhësor mund të shfrytëzojnë vetëm njëherë procedurën e tillë kur është fjala për një dekret apo rragull. 4. Në tërësitë e qyteteve themelohen këshillat franceze dhe holandeze për kulturë. Të dy këshillat kanë numër të njëjtë të anëtarëve kurse ata i zgjedhin anëtarët e grupit gjuhësor francez përkatësisht holandez.

Këshillat për kulturë brenda bashkësisë së vet kulturore kanë kompetenca:

- (1) në çështjet parashkollore, parashkollore dhe në kulturë,
- (2) në çështjet e arsimit.

5. Komiteti francez për kulturë dhe ai holandez formojnë komitete të përbashkëta. Vendimet e komiteve të përbashkëta mund të miratohen vetëm nëse fitojnë shumicën e votave të atyre që kanë votuar në secilin nga komitetet.

Komitetet e përbashkëta kanë kompetenca në fushat e përmendura në pikën në çështjet me interes të përbashkët ose janë me rëndësi për avancimin e misionit nacional dhe ndërkombëtar të tërësive të qyteteve.

6. Komitetet për të ciëlt flitet në pikat 4 e 5, gjithashtu kryejnë edhe funksione të cilat u janë besuar në bazë të ligjit, ose u janë besuar nga këshilli për kulturë apo nga qeveria.

Me ligj caktohet organizimi dhe procedura në këto komitete.

Neni 132.

Komiteti kulturor francez, pavarësisht nga dispozitat e nenit 59b, pika 4, paragrafi 1, do të ketë kompetenca mbi universitetin katolik në Luven, duke përfshirë edhe paralelet për arsimim të mesëm e teknikë gjithnjë derisa universiteti të mos zhvendoset nga grupi gjuhësor holandez.

Sistemi i gjuhës që aktualisht është në fuqi do të aplikohet edhe në arsim edhe në administratë gjithnjë derisa të mos ndryshohet.

Neni 135.

Derisa të mos nxirret ligji i cili me aplikimin e nenit 59b pika 1, paragrafi 1, do të rregullojë përbërjen e këshillit dhe të forumeve ekzekutive të bashkësisë gjuhësore franceze dhe bashkësisë gjuhësore flamane, Këshilli i bashkësisë franceze do të përbëhet nga anëtarët e grupit gjuhësor francez në të dy dhomat e parlamentit; Këshilli i bashkësisë flamane do të përbëhet nga anëtarët e grupit gjuhësor holandez në të dy dhomat e parlamentit. Të drejtën e inisiativës për miratimin e këtij ligji e ka mbreti dhe Këshilli i Bashkësisë.

6. BRITANIA E MADHE

A. MARRËVESHJE E ARRITUR NË NEGOCIATA SHUMËPARTIAKE

DEKLARATA E MBËSHTETJES

1. Ne, pjesëmarrësit në negociatat shumëpartiake, besojmë se marrëveshja që e kemi arritur ofron rastin e plotë historik për një fillim të tij.
2. Tragjeditë nga e kalura kanë lënë fatkeqësisht një trashëgimi të thellë të vuajtjeve. Ne nuk guxojmë kurrë të harrojmë ata që janë vrarë apo që janë lënduar, e as familjet e tyre. Me anë të fillimit të ri atyre më së miri do t'u nderohemi, sepse me anë të asaj do t'i përkushtohemi plotësisht arritjes së pajtimit, tolerancës dhe të besimit të ndërsjellë, si dhe mbrojtjes e sigurisë së të drejtave njerëzore të të gjithë njerëzve.
3. Ne e shprehim përkushtimin tonë ndaj partneritetit, barazisë dhe mirëbesimit reciprok si bazë për marrëdhëniet në vetë Irlandën Veriore, ndaj atij midis Veriut e Jugut si dhe ndaj atij për marrëdhënie midis atyre ishujve.
4. Ne konfirmojmë përkushtimin tonë total dhe absolut ndaj mjeteve kategorikisht demokratike e paqësore për zgjidhjen e dallimeve në raport me çështjet politike dhe kundërshtimin tonë ndaj asaj që të tjerët ta përdorin dhunën ose të kërcënohen për ta bërë për çfarëdo qëllimi politik, qoftë në raport me këtë marrëveshje apo ndaj diçka tjetër.
5. Ne pranojmë se ekzistojnë dallime të dukshme midis aspiratave tona aktuale e të ardhshme njëlloj legjitime. Mirëpo, ne do të synojmë të gjitha mënyrat e mundshme praktike për ta arritur pajtimin dhe afrimin në kuadër të aranzhmaneve demokratike e të dakorduara. Ne garantojmë se do të punojmë me nder për të arritur sukses në secilin aranzhman veç e veç, i cili duhet të vendoset në bazë të kësaj marrëveshje. Është pranuar që të gjitha aranzhmanet institucionale e kushtetuese - Kuvendi në Irlandën Veriore, Konferenca ministrore Veri-Jug, trupat e implementimit, Këshilli britaniko-irlandez dhe konferenca ndërqeveritare britaniko-irlandeze dhe çfarëdo amendamenti në ligjet e parlamentit britanik dhe në kushtetutën e Irlandës - ndër veti gërshetohen dhe se varen nga njëri-tjetri, e veçmas që funksionimi i Kuvendit dhe Veri-Jug aq janë të lidhura ndërveti sa që sukesi i njërit nga këto organe varet nga sukses i iorganit tjetër.
6. Në harmoni me këtë e në frymën e unitetit, ne u rekomandojmë kategorikisht popujve të Veriut e të Jugut që ta miratojnë këtë marrëveshje.

PJESA E PARË

Institucionet demokratike në Irlandën Veriore

1. Kjo marrëveshje siguron ekzistimin e Kuvendit të zgjedhur demokratik në Irlandën Veriore, përbërja e deputetëve të të cilit përfshijnë përfaqësuesit e të gjithë popujve të Irlandës Veriore, dhe i cili është i aftë të ushtrojë pushtetin ekektiv e legjislativ, dhe të garantojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesat e të gjitha palëve në atë bashkësi.

Kuvendi

2. Kuvendi i cili do të ketë 108 deputetë, do të zgjidhet në bazë të përfaqësimit proporcional (votim strategjik-taktik), nga njësitë ekzistuese zgjedhore të Vestministere.
3. Kuvendi do të ushtrojë në tërësi pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv në raport me ato çështje të cilat momentalisht janë në kompetencën e gjashtë ministrave qeveritare të Irlandës Veriore me

mundësinë e marrjes së përgjegjësisë për çështjet tjera të cilat janë shënuar hollësisht në pjesët tjera të kësaj marrëveshje.

4. Kuvendi - i cili kur kjo të jetë e nevojshme në punën e vet do t'i mbulojë të gjitha pjesët e bashkësisë - do të jetë autoriteti kryesor lidhur me çështjet e të gjitha përgjegjësisë të bartura atij.

Garancat

5. Do të vendosen garancitë të cilat do të sigurojnë që të gjitha pjesët e bashkësisë mund të marrin pjesë me sukses dhe bashkërisht në punën e atyre institucioneve dhe që të gjitha pjesët e bashkësisë të jenë të siguruar, përfshirë:

(a) ndarjen e vendeve të përfaqësuesve në këshilla, pozitat e ministrave dhe vendet anëtare në këshillat, sipas fuqisë së secilës parti;

(b) respektimin e Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut dhe cilindo ligj mbi të drejtat për Irlandën Veriore i cili është plotësuar, ashtu që ata nuk mund t'i shkel as Kuvendi as cilido organ publik. Do të themelohet dhe respektohet Komisioni për të Drejtat e Njeriut;

(c) aranzhmanet të cilat sigurojnë që vendimet dhe ligjet kryesore të miratohen vetëm atëherë kur të konstatohet se ata nuk e shkelin Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut dhe cilindo ligj mbi të drejtat për Irlandën e Veriut;

(d) aranzhmanet të cilat sigurojnë që vendimet kyçe t'i marrin bashkërisht të gjithë anëtarët e bashkësisë;

(i) qoftë me anë të pëlqimit paralel, pra atëherë kur shumica e anëtarëve është e pranishme dhe voton, përfshirë shumicën e unionistëve dhe nacionalistëve të emruar;

(ii) ose shumica e matur (60%) e anëtarëve të pranishëm të cilët votojnë, përfshirë të paktën 40% të deputetëve si nga grupi nacionalist ashtu edhe nga ai unionist.

Më parë do të miratohen vendimet kyçe për të cilat nevojitet mbështetja e të gjithë anëtarëve të bashkësisë, përfshirë ato që kanë të bëjnë me zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit, të kryeministrit dhe të zëvendëskryeministrit, me alokacionet buxhetore, si dhe me pyetjet e rendit të ditës. Në rastet tjera, vendimet e tilla mund të inicohen nëse pakica e konsiderueshme e anëtarëve të Kuvendit (30 anëtarë nga gjithsej 108), paraqet ndonjë peticion.

(e) themelimin e komisionit për barazi i cili do të monitorojë detyrimin statutar për avancimin e barazisë në sferat e caktuara dhe paritetin e respektimit midis dy bashkësive kryesore, kurse do të rishikojë validitetin e ankesave individuale ndaj puëns së organeve publike.

Puna e kuvendit

6. Në mbledhjenë vet të parë të gjithë anëtarëve të Kuvendit do të regjistrohen, kjo d'otë thotë se do ta tregojnë përkatësinë e tyre ndaj grupit - nacionalist, unionist apo grupit tjetër për t'u vlerësuar mbështetja e pjesëve të bashkësisë të cilën ata e përfaqësojnë me rastin e votimit në Kuvend, në bazë të dispozitave relevante të përmendura më sipër.

7. Kryetari ose zëvendëskryetari i Kuvendit do të zgjidhet sipas mënyrës së paraqitur në paragrafin e mësipërm 5. (d).

8. Për të gjitha funksionet kryesore ekektive të administratës së Irlandës Veriore, do të emërohet nga një këshill. Kryetarët ose zëvendëskryetarët e këshillave të Kuvendit do të zgjidhen proporcionalisht sipas sistemiet të d'Hondovit. Anëtarësia në këshilla do të jetë në proporcion të gjerë me forcën e partisë në Kuvend, në mënyrë që të gjithë anëtarëve t'u mundësohet që të kandidohen për vende në këshill.

9. Këshillat do të kenë rolin për ta udhëhequr politikën zhvillimore, kontrolluese e konsultative në raport me ministrinë nënshktruese mbi ata, kurse në fushëvepriminë punës së tyre do të bëjnë pjesë edhe

inicimi i procedurës për miratimin e ligjeve. Do të kenë autorizime që të:

* shqyrtojnë buxhetet e sektorëve dhe planet vjetore dhe të japin këshilla lidhur me të njëjtit në konvekst të alokacioneve gjithpërfshirëse buxhetore;

* aprovojnë akte relevante sekondare ligjore dhe në nivelin e këshillit të shqyrtohen aktet primare relevante ligjore;

* kërkojnë dokumente të caktura dhe ftojnë njerëzhit e caktuar;

* fillojnë hetimindhe do të shkruajnë raporte;

* shqyrtojnë çështjet të cilat Këshilli ia ka prezentuar ministri i tij dhe e këshillon lidhur me atë.

10. Nëse kjo është e nevojshme, kohëpaskohe krahas këshillave, pranë sektorëve mund të formohen edhe këshillat e jashtëzakonshme.

11. Kuvendi mund të emëroj këshillin special i cili duhet të shqyrtojë nëse ndonjë masë ose propozimligj është në harmoni me kushtet mbi barazinë, si dhe me Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, dhe të paraqesë raportin mbi konstatimet e veta. Këshilli do të ketë të drejtën të ftojë njerëzit në bisedime dhe të kërkoj dokumentacionin në mënyrë që ajo të cila u përmend më sipër të konfirmohet sa më mirë. Pastaj Kuvendi do të shqyrtojë raportin e Këshillit dhe do të vendos mbi këtë çështje në harmoni me procedurën për pëlqimin e të gjithë anëtarëve të bashkësisë.

12. Procedura e lartpërmendur do të aplikohet kur atë e kërkon Këshilli ekzekutiv ose këshilli relevant i sektorit, me ç'rast do të votojnë të gjitha segmentet e bashkësisë.

13. Mirëpo, me rastin e paraqitjes së peticionit si nën 5(d), Kuvendi do të votojë për të përcaktuar se a mund të merret masa pa aplikimin e procedurës speciale. Nëse me atë ast nuk arrihet mbështetja etë gjitha segmenteve të bashkësisë, sikurse që është përshkruar me sipër nën 5 (d) dhe (i), atëherë do të duhej të aplikohet procedura speciale.

(...)

Akti ligjor

26. Kuvendi do të ketë autorizimin për ta aprovuar akte primare ligjore për Irlandën Veriore në fushat që janë bartur në të, nën këto kushte:

(a) nëse gjykatat konstatojnë se aktet relevante ligjore janë në kundërshtim me Konventën Evropiane, dhe cilido ligj mbi të drejtat e Irlandës Veriore i cili e plotëson ata do ta anulojnë;

(b) se vendimet janë miratuar me votimin e shumicës së thjeshtë, me përjashtim, nëse është e nevojshme që ndonjë vendim ta marrin të gjithë segmentet e bashkësisë;

(c) se kjo rregullativë ligjore është shqyrtuar detajisht dhe është aprovuar nga ana e këshillit të ndonjë ministrie;

(d) se ekzistojnë mekanizmat të cilat mbështeten në aranzhmanet e propozuara për parlamentin e Skotlandës, të cilat sigurojnë koordinimin adekuat dhe ndihmojnë në evitimin e kontesteve midis Kuvendit dhe Parlamenti Vestminster;

(e) se ekziston opcioni që Kuvendi të kërkojë që parlamenti t'i kyq dispozitat ligjore të Irlandës Veriore Vestminster në legjislacionin e Mbretërisë së Bashkuar, e veçmas ato që kanë të bëjnë me çështjet e bartura të cilat normalsiht ruajnë paritetin (p.sh. sigurimi social, ligji mbi kompanitë, etj.).

27. Kuvendi do të ketë autorizime për të miratuar ligje në fushat e caktura me aprovimin e ministrave për Irlandën Veriore dhe kontrollin parlamentar.

28. Gjykatat do t'i zgjidhin kontestet rreth kompetencave legjislative.

29. Individit, këshilli ose ministri mund të paraqesi propozimligjin për miratim.

Marrëdhëniet me institucionet tjera

30. Aranzhmanet lidhur me atë se si do të përfaqësohet Kuvendi në tërësi në nivelin e Samitit dhe në punën me institucionet tjera do të jetë në harmoni me paragrafin 18, dhe të natyrës ë tillë që do të

mund të sigurojnë aranzhmanin e të gjithë segmenteve të bashkësisë.

31. Përfaqësuesit përkatës të Kuvendit dhe të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar do të harmonizohen rreth kushteve me të cilët do të sigurohet koordinimi efektiv dhe kontributi informativ i ministrave në drejtimin e politikës nacioale, përfshirë edhe atë që ka të bëjë me çështjet e lidhur me Unionin Evropian.

32. Roli i ministrave për Irlandën Veriore.

(a) ai edhe më tutje do të jetë përgjegjës për çështjet me të cilat merret ministria e tij e resorit (Kancelaria për Irlandën Veriore) me konsultime të rregullta me Kuvendin dhe ministrat;

(b) do të aprovojë dhe parashtrijë para parlamentit Vestminster cilido propozim ligjor të Kuvendit lidhur me çështjet e caktuara;

(c) do të përfaqësojë interesat e Irlandës Veriore në Kabinetin e Mbretërisë së Bashkuar;

(d) do të ketë të drejtën e pjesëmarrjes nëmbledhjet e Kuvendit me ftesë të tij;

33. Parlamenti Vestminster (i cili edhe më tutje do të ketë të drejtën për të miratuar ligjet për Irlandën veriore) do të:

(a) aprovojë ligje mbi çështjet e pabartura, pra për ato çështje mbi të cilat vendos Kuvendi, me miratimin e ministrave për Irlandën Veriore dhe kontrollin e Parlamentit;

(b) miratojë ato masa ligjore që nevojiten për përbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të Mbretërisë së Bashkuar ndaj Irlandës Veriore;

(c) shqyrtojë dhe kontrollojë, dhe me anë të këshillave të mëdha dhe regrute të Irlandës Veriore, përgjegjësitë e ministrave për Irlandën Veriore.

34. Do të formohet forumi konsultativ civil i cili do t'i përfshijë përfaqësuesit e qarqeve afariste, të sindikatave, të sektoreve vullnetar e të tjerë me pëlqimin e kryeministrit dhe të zëvendësit të tij. Ai forum do të veprojë si mekanizëm këshilldhënës për çështjet sociale, ekonomike e kulturore. Kryeministri dhe zëvendëskryeministri, me marrëveshje, do t'i ofrojë mbështetje Forumit civil dhe do t'i përcaktojnë direktivat për selektimin e përfaqësuesve në Forumin civil.

Aranzhmanet kalimtare

35. Kuvendi për herë të parë do të konvokohet me qëllim të organizimit pa autorizime legjislative e ekzekutive, për të zgjidhur çështjet e rendit të ditës, për të themeluar praktikën e vet të punës dhe për të kryer përgatitjet për funksionim efikas të Kuvendit, të Këshillit britaniko-irlandez dhe të Këshillit të Ministrave Veri-Jug dhe të trupave shoqërues të implementimit. Në këtë periudhë kalimtare, ata anëtarë të Kuvendit që janë zgjedhur për ministra në kabinetin opozitar, do ta konfirmojnë përkushtimin e vet ndaj parimeve të mosdhunës dhe kategorikisht ndaj mjeteve paqësore e demokratike, si dhe kundërshtimin e tyre ndaj çdo shfrytëzimi të forcës ose të kërcënimit të aplikuar për çdo qëllim politik; do të pnojë me nderë në konkretizimin e aranzhmaneve të reja dhe do t'i përmbahet betimit për përbushjen me nderë të detyrave të veta prej ministri, të cilin e kanë dhënë gjatë emërimit.

Korrigjimi

36. Pas një periudhe të caktuar do të kryhet korrigjimi i këtyre aranzhmaneve, përfshirë detajet e aranzhmaneve elektorale dhe të procedurave të kuvendeve, me qëllim të arritjes së pëlqimit rreth korrekcioneve të aranzhmaneve me interes të arritjes së zgjidhjeve më efektive e më të drejta.

TË DREJTAT, GARANCAT DHE MUNDËSITË E BARABARTA Çështjet ekonomike, sociale e kulturore

1. Gjithnjë derisa kompetenat të mos barten në Kuvendin e Irlandës Veriore, qeveria britanike do të udhëheq politikën e orientuar drejtë arritjes së shtimit më të lartë ekonomik dhe të stabilitetit në Irlandën Veriore, dhe kah avancimi i barazpeshës sociale duke shfaqur veçanërisht kujdes për zhvillimin e bashkësisë e të punësimit dhe për angazhimin më të madh të grave në jetën publike.

2. Në përputhje me konsultimet publike që momentalisht po zhvillohen, Qeveria britanike dotë arrijë përparim të shpejtë në:

(...)

zhvillimin dhe miratimin e masave mbi mundësitë e barabarta për punësim përfshirë Letrën e bardhë të afërt ("Partneritetin për barazi), të cilat mbulojnë vazhdimin dhe fuqizimin e legjislacionit diskriminues, revionimin e aspekteve që kanë të bëjnë me sigurinë nacionale në ligjet e tashme për punësimin e drejtë, marrjen e iniciativës së përqëndruar për nevojat kryesore sociale dhe miratimin e një vargu të tërë të masave të tjera të orientuara në luftën kundër papunësisë midis dy bashkësive nëpërmjet përqëndrimit më të madh në nevojat objektive.

3. Të gjithë pjesëmarrësit pranojnë rëndësinë e respektimit, të mirëkuptimit e të tolerancës kur është fjala për llojllojshmërinë gjuhësore, përfshirë ekzistimin e gjuhës irlandeze në Irlandën Veriore, si dhe të gjuhës Alster-skotlandeze dhe të gjuhëve të bashkësive të ndryshme etnike, të cilat bashkarisht e përbëjnë thesarin kulturor të Ishullit të Irlandës.

4. Në kontekst të rëndësisë aktive që tani i kushtohet efektit se Mbretëria e Bashkuar e ka nënshkruar Kartën e Këshillit të Evropës mbi gjuhët rajonale e të pakicave, Qeveria britanike, kur është fjala për gjuhën irlandeze, kur kjo është e nevojshme dhe kur këtë e dëshirojnë njerëzit, posaçërisht do të:

* bëjë kontakte me bashkësitë në të cilat flitet gjuha irlandeze, do t'i prezentojë pikëpamjet e veta autoriteteve publike dhe do t'i shqyrtojë ankesat;

* t'ia imponojë detyrën statutare Ministrisë së Arsimit që të nixisë arsimin në gjuhën irlandeze në përputhje me dispozitat momentale për arsimin e integruar;

* urgjentisht do t'i shqyrtojë me autoritetet britanike dhe në bashkëpunim me autoritetet radiotelevizive irlandeze, mundësitë për shfrytëzimin më të madh në gjuhën irlandeze në këto media në Irlandën Veriore; dhe

* nxis partitë të sigurojnë që marrëveshjen anglo-irlandeze të mbështet Kuvendi i riashtu që me anë të saj të respektohen dëshirat dhe pikat e ndieshme të gjithë segmenteve të bashkësisë.

5. Të gjithë pjesëmarrësit pranojnë se çështja e shfrytëzimit të simboleve dhe emblemave për qëllime publike veçanërisht është e ndieshme, si dhe ekziston nevoja që të krijohen institucione të reja të cilat do të sigurojnë që simbolet dhe emblemat të shfrytëzohen sipas mënyrës e cila e avancoon respektimin reciprok, e jo përçarjen. Do të hartohen aranzhmane që kjo çështje të monitorohet dhe të shqyrtohen aksionet të cilat ndoshta duhet ndërmarrë.

Çarmatimi

1. Pjesëmarrësit thirren në marrëveshjen e arritur në propozimin procedural ligjor nga 24 shtatori i vitit 1997, se "zgjedhja e çështjes së çarmatimit është element vendimtar i procesit të negociatave", dhe gjithashtu u referohen kushteve të paragrafit 25 të pjesës së parë.

2. Ata vërejnë se Komisioni i pavarur ndërkombëtar për çarmatimin ka shënuar përparim, si edhe qeveritë, sepse kanë zhvilluar skemat të cilat mund të paraqesin bazën e suksesshme për arritjen e qëllimit, domethënë që grupet paramilitare të dorëzojnë armatimin ilegal që e posedojnë.

3. Të gjithë pjesëmarrësit në përputhje me këtë, konfirmojnë përkushtimin e vet ndaj çarmatimit total të të gjitha organizatave paramilitare. Ata gjithashtu konfirmojnë qëllimin e vet që të vazhdojnë punën konstruktive dhe të ndershme në Komisionin e pavarur dhe të ndikojnë sa mundën në grupet paramilitare për t'i dorëzuar armët e veta në afatin prej dy vjetësh pas referendumit në të cilin Veriu dhe Jugu do të konfirmojnë këtë marrëveshje edhe në kontekstin e implementimit të zgjidhjes së përgjithshme paqësore.

4. Komisioni i pavarur do të monitorojë, do të kryejë korrigjimin dhe do të dëshmojë mbi përparimin e arritur lidhur me çarmatimin domethënë me dorëzimin e armëve, dhe do t'u paraqesë raporte relevante të dyqeverive në intervalet e rregullta.

5. Të dy qeveritë do të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për lehtësimin e procesit të çarmatimit, ashtu që të gjitha skemat relevante do t'i opracionalizojnë deri në fund të qershorit.

Siguria

1. Pjesëmarrësit vërejnë se zhvillimi i rrethit paqësor në bazë të kësaj marrëveshje duhet patjetër të nënskuptojë normalizimin e aranzhmaneve dhe të praktikës së sigurisë.

2. Qeveria britanike do t'i afrohet sa më herët qëllimit të vet drejt aranzhmaneve të mundshme normale të sigurisë në Irlandën Veriore e do të jetë konsekuent me nivelin e kërcënimit dhe me publikimin e strategjisë së tërësishme, e cila do të përfshijë:

(I) pakësimin e numrit dhe të rolit të forcave të armatosura të angazhuara në Irlandën Veriore në nivelin kompatibil me shoqërinë normale paqëndashëse;

(II) eliminimin e instalimeve të sigurisë;

(III) elementimin e kompetencave të jashtëzakonshme në Irlandën Veriore; dhe

(IV) masat tjera që përgjigjen dhe janë kompatible me shoqërinë normale paqëndashëse.

3. Ministri për Irlandën Veriore do të konsultohet me qeverinë e Irlandës dhe me partitë politike, kur kjo është e nevojshme për përparimin e arritur dhe do të reagojë ndaj aktiviteteve paramilitare të cilat vazhdojnë edhe më tutje.

4. Qeveria britanike do t'i vazhdojë konsultimet e veta për rregullimin dhe kontrollin e armëve të zjarrit në bazë të dokumentit të shpallur më 2 prill të vitit 1998.

5. Qeveria e Irlandës do të fillojë korrigjimin voluminoz të Ligjit mbi veprat e këqia të bëra kundër shtetit prej vitit 1939-1985, në mënyrë që të referojë ose eliminojë ato elemente të cilat më nuk i imponojnë rrethanat.

B) MARRËVESHJA MIDIS QEVERISË SË MBRETËRISË SË BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS VERIORE E QEVERISË SË IRLANDËS

Qeveria e Irlandës dhe qeveria e Mbretërisë së Bashkuar,

Duke dëshiruar që edhe më tutje të zhvillojnë marrëdhënie unike midis popujve të vet dhe bashkëpunimin e afërt midis vendeve të tyre, si fqinje miqësore dhe partnerë brenda Bashkësisë Evropiane;

Duke respektuar interesin suprem së vendeve të tyre, e mbi të gjitha të popullit të Irlandës Veriore që tëzvogëlohen ndarjet në këtë rajon dhe të krijohet paqja e qëndrueshme dhe stabiliteti;

Duke pranuar nevojën e përpjekjeve në vazhdimësi për t'i pajtuar dhe njohur të drejtën e dy traditave kryesore që ekzistojnë në Irlandë, të përfaqsuara nga njëra anë me ata të cilët nuk duan çfarëdo ndryshimi të statusit ekzistues të Irlandës Veriore dhe nga ana tjetër, të atyre që synojnë krijimin e Irlandës së bashkuar e sovrane e cila do të kuptohet me rrugë paqësore në bazë të marrëveshjes;

Duke konfirmuar refizimin e vet të plotë të çdo përpjekjeje që objektivat politike të realizohen me

dhunë ose me kërcënimin e përdorimit të forcës, dhe vendosmërinë e vet që bashkarisht të punojnë në drejtim të asaj që ata të cilët propagandojnë metoda të tilla të mos kenë sukses në qëllimet e veta;

Duke pranuar se kushti për pajtim t'g jthpërfshijshëm dhepër dialog midis unionistëve dhe nacionalistëve është njohja reciproke dhe njohja e të drejtave që i takojnë njërit dhe tjetrit;

Duke pranuar dhe respektuar identitetin e dy bashkësive në Irlandën Veriore dhe të drejtën e secilës nga ato që të pasojnë synimet e veta me mjete paqësore e kushteuese;

Duke riktheksuar vendosmërinë e vet që në shoqërinë e Irlandës Veriore çdokush duhet të jetojë rehat, që të mos i ekspozohet diskriminimit dhe intolerancës dhe të krijohen kushte që secila bashkësi të marrë pjesë plotësisht në strukturat dhe procesin e administrimit;

Në përputhje me këtë arriten këtë marrëveshje:

A - STATUSI I IRLANDËS VERIORE

Neni 1.

Dy qeveritë:

(a) konfirmojnë se çfarëdo ndryshimi në statusin e Irlandës Veriore do të bëhet vetëm në bazë të përqindjes të popullatës shumicë të Irlandës Veriore;

(b) pranojnë se dëshira momentale e shumicës së banorëve të Irlandës Veriore është që të mos bëhet ndryshimi i statusit të Irlandës Veriore;

(c) njoftojnë se, në qoftë se në të ardhmen shumica e banorëve të Irlandës veriore do të dëshirojë qartë e formalisht formimin e Irlandës së bashkuar, do të parashikojnë dhe kërkojnë në parlamentet e vendeve të veta futjen e ligjit i cili do të mundësonte realizimin e aspiratës së tillë...

B - KONFERENCA NDËRQEVERITARE

Neni 2.

(a) Në kuadër të këshillit ndërqeveritar anglo irlandez i formuar pas takimit të kryetarëve të dy qeverive më 6 nëntor të vitit 1981, inaugurohet Konferenca ndërqeveritare (në tekstin e mëtejshëm: Konferenca) e cila merret me çështjet e Irlandës Veriore dhe me marrëdhëniet midis dy pjesëve të ishullit të Irlandës dhe i shqyrton rregullisht sikurse është përcaktuar me Marrëveshje:

(I) çështjet politike;

(II) çështjet e sigurisë dhe çështjet tjera lidhur me këtë;

(III) çështjet juridike duke përfshirë edhe organizimin e gjyqësisë;

(IV) avancimin e bashkëpunimit përtejkuftar.

(b) Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar pranon që qeveria e republikës së Irlandës të përcaktojë qëndrimet dhe propozimet për çështjet që kanë të bëjnë me Irlandën Veriore në suazat e kompetencave të Konfederatës në masën në të cilën këto çështje nuk janë në kompetencën e administratës së Irlandës Veriore. Për hir të avancimit të paqes e të stabilitetit me anë të konferencës do të bëhen përpjekje të vazhdueshme për eliminimin e të gjitha dallimeve. Konferenca parasegjithash është kompetencë për Irlandën Veriore por disa çështje të caktuara brenda kompetencave të sajë do të kërkojnë aksione të përbashkëta në të pjesët e Ishullit të Irlandës e me siguri edhe në Britaninë e Madhe. Disa nga propozimet që kanë të bëjnë me Irlandën Veriore do të duhej t'i zbatojë qeveria irlandeze. Kjo në asnjë mënyrë nuk prek Sovranitetin qoftë të qeverisë irlandeze qoftë të asaj të Britanisë së Madhe dhe secila nga ato mbanë përgjegjësi për marrjen e vendimeve dhe për kryerjen e pushtetit në kuadër të autorizimeve të veta.

Neni 3.

Konferenca do të mbledhet në nivel ministror ose në nivelin e nëpunësve të lartë varësisht nga rastin konkret. Puna e konferencës do të jetë në qendër të interesimit në nivelin më të lartë. Do të mbahen takime të rregullta e të shpeshta të Konferencës në nivelin ministror; sesionet tjera të jashtëzakonshme të konferencës mund të konvokohen me kërkesën e clës do palë. Nëpunëso mund të mbidhen nëpër grupe. Kur konferenca mbidhet në nivelin ministror bashkëkryetarë të saj janë ministri irlandez i cili është i caktuar si përfaqësues i përhershëm ministrir irlandez dhe sekretari i shtetit për Irlandën Veriore. Në kuadër të konferencës ministrat tjerë irlandezë e britanik mund të amtojnë në sesione ose të konvokojnë mbledhje; kur në rend të ditës shtrohen çështjet juridike në seanca mund të asistojnë prokurorët publik. Në shoqërim të ministrave mund të gjenden nëpunësit e lartë dhe këshilltarët e tjerë profesional bie fjala kur në rendin e ditës gjenden çështjet e sigurisë ose të bashkpunimit në fushën e sigurisë, në shoqërim të ministrave mund të gjenden garda e Siochanit dhe shefi i forcave mbretërore për Alsterin; ose kur në rend të ditës gjenden çështjet e politikës ekonomike e sociale apo bashkëpunimi në këto fusha, në shoqërim të ministrave mund të gjenden zyrtarët nga ministrat përkatës. Dy qeveritë do të formojnë Sekretariatit e konferencës detyra e të cilit do të jetë që mbi baza afatgjata të organizojë dhe lehtësojë punën e konferencës sipas mënyrës e cila është përcaktuar me këtë marrëveshje.

Neni 4.

(a) Konferenca, për çështjet nga kompetencat e veta është suazë brenda të cilës qeveritë e Irlandës dhe të Britanisë së Madhe do të punojnë bashkarisht:

(1) në realizimin e të drejtave e të zhvillimit të identitetit të dy traditave që ekzistojnë në Irlandën Veriore; dhe

(11) në ruajtjen e paqes stabilitetin e prosperitetit të mbarë ishullit irlandez me anë të angazhimit për pajtim respektimin e të drejtave të njeriut, bashkëpunim kundër terrorizmit dhe për zhvillimin e bashkëpunimin ekonomik social e kulturor

(b) Politika e qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar është e tillë që përgjegjësia për disa çështje të caktuara të cilat janë në kompetencën e sekretarit të shtetit për Irlandën Veriore mund të barten në Irlandën Veriore sipas mënyrës e cila do të sigurojë përqafimin e saj në mbarë bashkësinë. Qeveria irlandeze e mbështetë një politikë të tillë.

(c) Të dy qeveritë konfirmojnë se bartja e kompetencave mund të realizohet nëpërmjet bashkëpunimit të përfaqësuesve kushtetues të dy traditave brenda Irlandës Veriore. Konferenca është suazë ku qeveria irlandeze mund të paraqesë pikëpamjet dhe propozimet mbi modalitetin e bartjes së kompetencave në Irlandën Veriore, por në masën në të cilën këto i përgjigjen interesave të bashkësisë minoritare.

C - ÇËSHJTJET POLITIKE

Neni 5.

(a) Konferenca do të merret me çështjet e masave të njohjes dhe të harmonizimit të të drejtave dhe të identitetit të dy traditave në Irlandën Veriore, me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe me preventivën e diskriminimit. Çështjet qqë duhet të shqyrtohen në këto suaza pëfshijnë masat për forcimin e trashëgimisë kulturore të dy traditave ndryshimet në zgjidhjet elektorale, përdorimin e flamurit dhe të simboleve evitimin e diskriminimit ekonomik e social dhe përparësitë e mangësitë e miratimit të Ligjit mbi të drejtat në Irlandën veriore.

(b) Shqyrtimi i këtyre çështjeve ka të bëjë, parasegjithash, me Irlandën Veriore, por nuk do të përjashtojë mundësinë e aplikimit të masave tjera në harmoni me këtë nen të cilat i merr qeveria irlandeze në kuadër të kompetencave të veta.

(c) Në qoftë se tregohet se nuk është e mundshme të realizohet dhe të ruhet bartja e kompetencave mbi bazat të cilat sigurojnë përfaqim të gjërë në mbarë Irlandën Veriore, Konferenca do të jetë suazë brenda të cilës qeveria irlandeze kur interesat e veçanta dhe specifike të pakicës janë prekur, do të mund të paraqesë qëndrime dhe propozime që kanë të bëjnë me legjislacionin dhe çështjet politike që janë në kompetencën e seksionit për Irlandën Veriore dhe të cilat mbeten në kompetencat e sekretarit të shtetit për Irlandën Veriore.

Neni 6.

Konferenca është suazë brenda së cilës qeveria irlandeze mund të paraqesë propozime dhe qëndrime për rolin dhe përbërjen e organeve të cilat i emëron sekretari i shtetit për Irlandën Veriore apo të sektorëve që gjenden nën administrimin ose kontrollin e tij, duke përfshirë këtu:

- Komisionin e përhershëm këshilldhënës për të drejtat e njeriut;
- Agjencinë për barazi në punësim;
- Komisionin për njëjtësinë e mundësive;
- Forcat policore për Irlandën Veriore;
- Drejtorinë policore për ankesa.

D - SIGURIA DHE ÇËSHTJET E LIDHURA ME SIGURINË

(a) Konferenca do të shqyrtojë;

(1) politikën e sigurisë;

(11) marrëdhëniet midis forcave policore dhe bashkësisë;

(111) politikën e cila ka të bëjë me burgjet.

(b) Konferenca do të shqyrtohet në mbledhjet e rregullta çështjet lidhur me sigurinë dhe kështu do të mundësojë shqyrtimin e çështjeve që i përkasin policisë incidentëve serioze dhe ngjarjeve të ardhshme.

(c) Dy qeveritë janë të pelqimit se ekziston nevoja që në Irlandën Veriore të miratohet programi i masave të veçanta me qëllim të avancimit të marrëdhënieve midis forcave të sigurimit dhe bashkësisë e që do të bëjë nga fakti që bashkësia nacionaliste t'i pranojë më lehtë forcat e sigurimit. Programi i tillë do të hartohet dhe shqyrtohet në Konferencë e mund të përfshijë aftësimin e mekanizmit lokal konsultativ aftësimin lidhur me marrëdhëniet në bashkësi, skemat e luftës kundër kriminalitetit e cila përfshinë edhe bashkësinë avancimin e aranzhmaneve që merren me ankesat dhe aksionet për shtimin e numrit të pjesëtarëve të pakicës në përbërje të Gardës Mbretërore të Alsterit. Elementet e këtij programi mund t'i zbatohet edhe qeveria irlandeze atëherë kur ato janë në harmoni me kompetencat e saja.

(d) Konferenca mund të shqyrtojë çështjet politike që u përkasin burgjeve. Rastet individuale atëherë kur është e nevojshme mund të nxirren para Konferencës me qëllim të ardhjes tek informat ose kërkimet e reja.

E - ÇËSHTJET JURIDIKE DHE ORGANIZIMI I GJYQËSISË

Neni 8.

Konferenca do të shqyrtojë çështjet me interes për të dy vendet e që kanë të bëjnë me fuqizimin e legjislacionit penal. Posaçërisht do të shqyrtojë nëse ekzistojnë dallime në legjislacionin penal i cili aplikohet në Veri dhe në Jug të ishullit e i cili mund të harmonizohet. Dy qeveritë janë dakord lidhur me rëndësinë e besimit publik në gjyqë. Konferenca do të kërkojë, me ndihmën e specialistëve përkatës, masat që do të paraqesin shprehjen thelbësore të përpjekjeve të tilla duke shqyrtuar inter alia mundësinë e formimit të gjyqeve të përbashkëta në të dy sistemet gjyqësore për procedurat që zhvillohen në rastete e kryerjes së veprave të caktuara penale. Konferenca do të shqyrtojë gjithashtu çështjet politike të ekstradimit dhe të gjyqësisë eksteritoriale midis Veriut e Jugut.

F - BASHKËPUNIMI PËRTEJKUFITAR NË FUSHËN E SIGURISË, EKONOMISË, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE NË KULTURË

(a) Me qëllim të nxitjes së bashkëpunimit përtejkufitar në fushën e sigurisë, Komisioni do të miratojë programin e punëve që duhet t'i kryejn Komisarit i Gardës së Siochanit dhe shefi i Gardës Mbretërore të Alsterit, e kur nevojitet edhe nëpunësit e lartë lidhur me vlerësimin e kërcënimeve këmbimin e informatave, strukturën e lidhjeve reciproke bashkëpunimin teknik, aftësimin e njerëzve dhe të mjeteve operative.

(b) Konferenca nuk ka përgjegjësi operative; përgjegjësia për operacionet e forcave policore mbetet në duart e komandave të forcave përkatëse policore - komisarit të gardës Siochan i cili mbanë lidhje me Ministrinë e Jurisprudencës dhe me shefin e Gardës Mbretërore të Alsterit i cili mbanë lidhje me sekretarin e shtetit për Irlandën Veriore.

Neni 10

(a) Të dy qeveritë do të bashkëpunojnë mes veti për avancimin e zhvillimit ekonomik e social në ato sfera të dy pjesëve të Irlandës të cilat po përjetojnë më shumë pasoja të jostabilitetit gjatë disa viteve të fundit dhe do të shqyrtojnë mundësinë për sigurimin e ndihmës reciproke, si mbështetje për punën e vet.

(b) Nëse do të tregohet si e pamundshme që të zbatohet dhe ruhet bartja e autorizimeve sipas mënyrës e cila siguron përfaqim të gjerë në mbarë Irlandën Veriore, Konferenca do të paraqesë suazën për avancimin e bashkëpunimit përtejkufitar ekonomik, social e kulturor midis dy pjesëve të Irlandës e në përputhje me atë që ndërmerr sekretari i shtetit për Irlandën Veriore, në ushtrimin e kompetencave të veta.

(c) Në qoftëse barten kompetencat në çështjet e caktuara ekonomike sociale e kulturore të cilat tani i janë besuar sekretarit të shtetit për Irlandën Veriore, do të caktohet mekanizmi i organeve përkatëse në Veri dhe Jug përkitazi me realizimin e bashkëpunimit praktik në zhvillimin e marrëdhënieve përtejkufitare në këto fusha.

G - ARANZHMANET QË DUHET TË SHQYRTOHEN

Neni 11.

Pas skadimit të tre viteve nga dita e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, pse me kërkesë të dy qeverive pra skadimit të këtij afati dy qeveritë do të shqyrtojnë punën e Konferencës dhe do të konstatojnë nëse është e nevojshme të bëhen ndryshime lidhur me vëllimin dhe natyrën e kompetencave të saj.

H - MARRËDHENIET INTERPARLAMENTARE

Neni 12.

Parlamentet në Dublin dhe Westminster duhet të vendosin për nevojën e formimit të trupit parlamentar anglo - irlandez sikurse është propozuar në raportin anglo - irlandez nga nëntori i vitit 1981. Dy qeveritë janë të pajtimit se do të mbështesin punën e një trupi të tillë në qoftë se ai do të themelohet.

I - DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 13.

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi kur dy qeveritë të këmbëjnë notifikimin mbi pranimin e marrëveshjes.

7. KANADA

A) MARRËVESHJA NGA MIÇ LEJKU

AMENDAMENTI KUSHTETUES NGA VITIT 1987 KUSHTETUAT E KANADASË NGA VITI 1867

1. Kushtetuta e Kanadasë nga vitit 1867, përmirësohet ashtu që pjesën e saj të parë i shtohet amendamenti që vijon:
2. (1) Kushtetutat e Kanadasë do të interpretohet sipas mënyrës e cila është konsistente me këtë:
 - a) se njohja e ekzistimit të kanadasë frankofonë të vendosur kryesisht në Kuebek, por edhe gjetkë në Kanada, dhe të kandezëve anglifonë, të cilët jetojnë edhe në Kuebek, ndonëse kryesisht jetojnë jashtë tij paraqet karakteristikën themelore të Kanadasë dhe
 - b) se duhet pranuar se Kuebeku në kuadër të Kanadasë, paraqet shoqërinë e ndryshme.
- (2), Roli i parlamentit të Kanadasë dhe i trupave legjislative të krahinave për ruajtjen e karakteristikave të Kanadasë në paragrafin (1) (a) konfirmohen.
- (3) Roli i trupave legjislativ dhe i qeverisë së Kuebekut për ruajtjen dhe avancimin e identitetit të ndryshëm të Kuebekut të përmendur në paragrafin (1) (b), konfirmohen.
- (4) Asgjë në këtë paragraf nuk e pengon ushtrimin e kompetencave të të drejtave dhe të privilegjeve të parlamentit e të Qeverisë së Kanadasë ose të trupave legjislative krahinore e të qeverive duke përfshirë kompetencat, të drejtat dhe privilegjet që kanë të bëjnë me gjuhën.

GJYQI SUPREM I KANADASË

101 A (1) Gjyqi i cili ekziston me emrin Gjyqi Suprem i Kanadasë me këtë e vazhdon punën e vet si Gjyqi i Përgjithshëm i Apelit të Kanadasë edhe si gjyq plotësues për administrimin më të mirë të ligjeve të Kanadasë kurse edhe punën e vet e ushtron si gjyq i regjistrimit.

(2) Gjyqi Suprem i Kanadasë do të përbëhet nga gjyqtari kresor i cili do të quhet gjyqtari kryesor i Kanadasë dhe nga tetë gjyqtar kurse të gjithë ata do t'i emërojë Guvernatori i përgjithshëm i Kanadasë në bazë të letrave që do të mbajnë vulën e Vulës së Madhe.

101 B (1) Cili do person mund të emrohet gjyqtar i Gjyqit Suprem të Kanadasë në qoftë se me të hyrë ndonjë shoqatë të juristëve të cilës do krahine ose të territorit ka kaluar të paktën dhjetë vjet s gjyqtar i cili do gjyq në Kanada ose ka qenë anëtar i çfarëdo shoqate gjyqësore në cilën do krahinë ose territor.

(2) Të paktën tre gjyqtar nga Kuebeku kur janë bërë anëtar të Shoqatës së Juristëve të Kuebekut dhe kanë qenë anëtarë të saj të paktën dhjetë vjet, ose dhjetë vjet kanë qenë gjyqtarë të cilitdo gjyq në Kanada ose të cilitdo gjyq të cilin e ka themeluar Parlamenti i Kanadasë do të vendosë për gjyqtar të Gjyqit Suprem të Kanadasë.

PROPOZIMET NË PERIU DHËN PAS VITIT 1982

Këto dokumente shërbejnë për ta dokumentuar historinë e propozimeve prej miratimit dhe shpalljes së Ligjit Kushtetues nga vitit 1982.

Marrëveshja nga Miç Lejku (1987) (këtu përmendet raporti i Këshillit)

Në të vërtetë fjala është për marrëveshjen e përgjithshme nga dy pjesë: marrëveshja midis Kanadasë e Kuebekut me të cilën këtij të fundit i delegohet kontrolli i përgjithshëm mbi pranimin dhe integrimin e cilitdo emigrant i cili emigron në Krahinë (kjo marrëveshje më vonë është finalizuar).

Mërrëveshja kushtetuese: Kuebeku ka paraqitur pesë kërkesa të cilat ka qenë dashur të përmbushen para se të nënshkruhet Kushtetuta nga viti 1982 "me dinjitet dhe nder":

Vetoja kushtetuese (me fjalë tjera, është e drejtë e çdo krahine për ta bllokuar cilindo amendament kushtetues)

Njohja e Kuebekut për "shoqëri të ndryshme"

E drejta që në Gjyqin Suprem të Kanadasë të zgjidhen ata gjyqtar nga lista të cilën e paraqet krahina.

Kufizimi i shpenzimeve federale pra dhënia e lejës krahinës që të tërhiqet nga programi nacional për të hartuar programin e vetë nga mjetet federale.

Shumica e kontrtollave krahinore mbi të emigruarit me faktin që automatikisht do ta kontrollojnë marrëveshjen ndërqeveritare lidhur me të njejtën.

Marrëveshja ka skaduar pas tri vjetësh m 23 qershor të viti 1990. Atë ditë Dhoma e Poshtme dhe tetë deri dhjetë organe kegjislative krahinore e kanë ratifikuar këtë marrëveshje. Mirëpo, deputeti indian nga parlamentet e Manitobe, Elixha Harper, e ka bllokuar votimin për ratifikimin e marrëveshjes në atë Krahinë. Kryeministri i Njufaulndit, Klajd vels, i cili e ka hedhur poshtë ratifikimin e qeverisë së njufaulndit e ka shikuar këtë hap si dështim i qartë i marrëveshjes dhe me pasoja refuzon që në organin e vet legjislativ të mbahet votimi mbi ratifikimin e të njejtës.

KONSENSUSI I ÇARLOTANIT

PARATHËNIE

Konsensusi i Çarlotanit është fryt i një varg mbledhjesh mbi reformën kushtetuese që i kanë mbajtur përfaqësuesit e qeverive federale krahinore e territoriale me popullatën autoktone.

Këto mbledhje kanë qenë pjesë e rëndësishme të takimeve kushtuar reformës kushtetuese.

Më 24 shtator, Qeveria e Kanadasë ka paraqitur në parlamentin federal në varg propozimesh kushtuar ripërtrirjes së Federatës së Kanadasë me emrin "Formësimi i përbashkët i ardhmërisë së Kanadasë". Këto propozime i janë dorëzuar komisionit special të përbashkët të Dhomës së Poshtme dhe Senatit, i cili ka udhëtuar anëmbanë vendit duke ekzaminuar disponimin e opinionit publik ndaj propozimeve. Komiteti ka marrë 3. 000 parashtresa dhe kë marrë në pyetje për dëshmi 700 individë.

Gjatë kohës së debateve multilaterale sa herë që ka qenë e nevojshme janë hartuar projektet e kushtetutës për t'u pakësuar pasiguria ose dykuptueshmëria. Projekti më i gjatë i teksteve legale e ka përbërë bazën për diskutime mbi çështjet që kanë të bëjnë me popullatën autoktone. Këto projekte kanë paraqitur bazën e rezolutave formave legale që më pas i janë paraqitur parlamentit dhe organit legjislativ.

Në territoret ku konsensusi nuk ka qenë njëzëri, disa pjesëmarës kanë ra dakord që mospajtimet e tyre të shënohen. Sa herë që kjo është kërkuar ato mospajtime janë futur në shënime kronologjike nga mbledhjet por jo edhe në këtë dokument i cili është rezymeja e tyre.

I. UNITETI DHE LLOJLLOJSHMËRIA

A: POPUJT DHE BASHKËSITË

1. Klauzola mbi Kandadanë.

Klauzola e re e cila do të shprehte vlerat themelore kanadeze do të duhej të përfshihej në kapitullin 2. të Ligjit kushtetor nga vitit 1867. Klauzola mbi Kanadanë të të ardhmen do t'i orientonte gjyqet se si ta interpretojnë tërë kushteutën duke përfshirë Kartën e Kanadasë mbi të drejtat dhe liritë.

Ligji kushtetues nga vitit 1867, ndryshohet ashtu që i shtohet menjëherë pas kapitullit të parë si vijon:

2.(1) Kushtetuta e Kanadasë duke përfshirë Kartën e kanadasë mbi të drejtat dhe liritë do të interpretohet sipas mënyrës konsistente me këto karakteristika:

(a) Kanadaja është demokraci kushtuar sistemit parlamentar e federal të sundimit dhe të autoritetit të ligjit;

(b) Populli autokton i Kanadasë si njerëz të parë që kanë sunduar këtë vend kanë të drejtë për ta avancuar gjuhën kulturën dhe traditën e tyre dhe për të siguruar integritetin e shoqërive të veta, kurse qeveritë e tyre përfaqësojnë njëren nga tri qeveritë në Kanada;

(c) Kuebeku në kuadër të Kanadas paraqet shoqëri të llojlojshme e cila e përfshinë shumicën frankofone kulturën unike dhe traditën e ligjit civil;

(d) Kanadazit dhe qeveritë e tyre janë të përkushtuar vitalitetit dhe zhvillimit të bashkësive zyrtare të pakicave gjuhësore anembanë Kanadasë.

(e) Kanadaja i përshkushtohen barazisë racore dhe etnike në shoqërinë e cila përfshinë qytetarët nga shumë vende që kanë kontribuar e vazhdojnë të kontribojnë në ndërtimin e Kanadasë së fuqishme e cila e manifeston llojlojshmërinë kulturore e racore;

(f) Kanadasit i përkushtohen respektimit të drejtave individuale e kolektive të njeriut dhe lirtë e të gjithë popujve;

(g) Kanadasit i përkushtohen respektimit të barazisë së personave meshkuj e femra dhe

(h) Kanadasit e konfirmojnë parimin e njëjtësisë së krahinave e njëkohësisht i njohin karakteristikat e tyre të ndryshme.

(2) Roli i organit legjislativ dhe i qeverisë së Kuebekut për ruajtjen dhe avancimin e shoqërisë së llojlojshme, konfirmohet.

(3) Asgjë në këtë kapitull nuk e gjymton pushtetin, të drejtat dhe autoritetin e privilegjet e Parlamentit të Kanadasë ose të organeve legjislative të qeverive ose të organeve legjislative të krahinave apo të organeve legjislative a të qeverive të popullatës autoktone të Kanadasë duke përfshirë pushtetin të drejta ose privilegjet që kanë të bëjnë me gjuhën e aq me rëndi është fakti se asgjë në këtë kapitull nuk i gjymton të drejtat autoktone si dhe ato të parashikuara me marrëveshjen për popujt autoktonë në Kanada.

8. RUMANIA

A) PJESË NGA KUSHETUTA

KREU I

PARIMET E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Sheti i Rumanisë

Rumani është shtet sovran i pavarur, unitar dhe i pandarë nacional.

Rumania për nga forma e sundimit është Republikë.

Rumania është shtet demokratik e social në të cilin sundohet në bazë të ligjeve juridike dhe në të cilën dinjiteti njerëzor të drejtat dhe liritë qytetare, zhvillimi i personalitetit të lirë të njeriut drejtësia dhe pluralizmi politik paraqesin vlerat kulminante dhe si të tilla janë tëgarantuara.

Neni 2.

Sovraniteti

Sovraniteti nacional bazohet në popullin rumun kurse ai e aplikon me anë të trupave përfaqësuese dhe me anë të referendumit.

Asnjë grup e asnjë individ nuk kanë të drejtë që në emrin e vet ta aplikojnë atë sovranitet.

Neni 3.

Territori

Territori i Rumanisë është i patjetërsueshëm.

Kufijt e vendit i sanksionon një ligj natyror i harmonizuar me parimet dhe dispozitat e tjera të njohura në përgjithësi të ligjit ndërkombtar.

Territori është i organizuar administrativisht në komuna qytete dhe rrethe. Disa qytete janë të shpallura për komuna në bazë të dispozitave ligjore.

Popullata e huaj nuk guxon të kolonizohet në territoein e shtetit rumun e as të dëbohet nga ai.

Neni 4.

Uniteti i popullit dhe barazia e qytetarëve

Uniteti i popullit rumun paraqet themelet e shtetit.

Rumania është atdhe i përbashkët dhe i pandashëm për të gjithë qytetarët e saj pa diskriminim në baë të racës nacionalitetit, prejardhjes etnike, gjuhës, fesë, gjinisë, mendimit, përkatësisë politike, të pronësisë apo të prejardhjes shoqërore.

Neni 5

Shtetësia

Shtetësia rumane mund të fitohet, të mbahet pse të humbet në bazë të ligjit natyror.

Shtetësia rumune e fituar në bazë të lindjes nuk mund të merret.

Neni 6.

E drejta për identitet

Shteti ua njeh dhe ua garanton të drejtën qytetarëve për t'u takuar pakicave kombëtare dhe për ta ruajtur, zhvilluar dhe shprehur identitetin e vet etnik, kulturor, gjuhësor e fetar.

(2) Masat mbrojtëse që do t'i merrë shteti i Rumanisë për ruajtjen zhvillimin dhe shprehjen e identitetit të personave të cilët u takojnë pakicave kombëtare do të harmonizohet me parimet e barazisë dhe të mosdiskriminimit në raport me shtetasit tjerë rumun.

2. Kontrata midis republikës së Hungarisë dhe Rumanisë mbi mirëkuptimin, bashkëpunimin dhe fqinjësinë e mirë (1996)

9. FEDERAT RUSE

A) NGA KUSHTETUTA

PJESA E PARË

BAZAT E SISTEMIT KUSHTEUTES

Neni 1.

Federata Ruse - Rusia, do të jetë shtet demokratik federal në të cilin do të ekzistojë sundimi i ligjit kurse për nga forma e vet e pushtetit do të jetë republikë. Në dy emërtimet e saj "Federata Rusë" dhe "Rusia" do të jenë ekuivalent.

Neni 2.

Njeriu, të drejtat dhe liritë e tij do të kenë vlerë supreme. Detyra e shtetit do të jetë që t'i njohë respektojë dhe mbrojë të drejtat dhe liritë e njeriut e të qytetarëve.

Neni 3.

1. Populli multinacional i Federatës Rusë do të jetë instrument i sovranitetit dhe i vetmi burim i fuqisë në Federatën Ruse.

2. Populli i Federatës Rusë do ta ushtrojë fuqinë e vet si direkt ashtu edhe me anë të organeve të fuqisë së shtetit dhe të asaj të vetëqeverisjes lokale.

3. Referendumi dhe zgjedhjet e lira do të jenë manifestimi suprem dhe direkt i fuqisë së popullit.

4. Asnjë person nuk mund ta përvetësojë ekskluzivisht për vete pushtetin në Federatën Ruse. Në bazë të Ligjit Federativ përvetësimi tillë i pushtetit ose i kompetencave për marrjen e pushtetit do të ndiqet penalisht.

Neni 4.

1. Sovraniteti i Federatës Ruse shtrihen në mbarë territorin e saj.

2. Kushtetuta e Federatës Ruse dhe ligjet federative do të kenë pushtetin suprem mbi tërësinë të Federatës Ruse.

3. Federata Ruse do të sigurojë integritetin dhe moscenueshmërinë e kufijve të vet.

Neni 5.

1. Federata Ruse do të përbëhet nga republikat, territoret, rajonet, qytetet federale, rajonet autonome dhe provincat autonome, të cilët do të jenë subjekt të barabartë të Federatës Ruse.

2. Republika (shteti) do të ketë kushtetutën dhe legjisllacionin e vet. Teritori, rajoni, qyteti federal, rajoni autonom dhe provinca autonome do të ketë kartën dhe legjisllacionin e vet.

3. Struktura federative e Federatës Ruse do të mbështetet në integritetin e shtetit, sistemin e njejtësuar të pushtetit të shtetit, në vëllimin e kufizuar të kompetencat dhe të fuqisë midis trupave të fuqisë së shtetit të Federatës Ruse dhe trupave të fuqisë shtetërore të subjekteve të Federatës Ruse si dhe në barazinë dhe vetëvendosjen e popullit të Federatës Ruse.

4. Të gjitha subjektet e Federatës Ruse do të jenë të barabarta ndërveti në raport me trupat federale të fuqisë së shtetit.

Neni 15.

1. Kushtetuta e Federatës Ruse do të ketë fuqinë supreme legale dhe efektin direkt, dhe do të aplikohet në mbarë territorin e Federatës Ruse. Ligjet dhe normat tjera ligjore të miratuara nga ana e Federatës Ruse nuk guxojnë të jenë në kundërshtim me Kushtetutën e Federatës Ruse.

KREU II

Të drejtat dhe liritë e njeriut e të qytetarit

Neni 19.

2. Shteti do të garantojë barazinë e të drejtave dhe lirive pavarësisht nga gjinia, raca, nacionaliteti, gjuha, prejardhja, pronësia, punësimi, vendqëndrimi, qëndrimi nfaj religjionit, bindja politike, anëtarësimi në asociacionet publike e të tjera. Ndalohet kufizim i të drejtave të qytetarëve mbi baza shoqërore, racore, nacionale, gjuhësore ose fetare.

Neni 26.

Secili do të ketë të drejtë të caktojë dhe shprehë identitetin e vet nacional. Askush nuk do të jetë i detyruar ta bëjë këtë. Secili do të ketë të drejtë ta shfrytëzojë gjuhën e vet amëtare të zgjedh lirisht gjuhën e komunikimit, të arsimit të aftësimin dhe të punës kreative.

Neni 27.

1. Secili që qëndron legalisht në territorin e Federatës Ruse do të ketë të drejtën e qarkullimit të lirë dhe të zgjidhjes së lirë të vendit të banimit.

PJESA E PARË

KREU III.

Federata Ruse

Neni 66.

1. Statusi i republikës do të definohet në Kushtetutën e Federatës Ruse dhe në kushtetutën e republikës për të cilën është fjala.
2. Statusi i territorit, tajonit, qytetit, federal, rajonet autonom dhe provincës autonome do të caktohet në bazë të Kushtetutës së Federatës Ruse dhe të kartës së territorit, rajonit, qytetit me rëndësi federale rajonet autonom, provincës autonome, të cilin e miraton trupi legjislativ (përfaqësues) i subjektit relevant të Federatës Ruse.
3. Ligji federativ për rajonin autonom ose provincën autonome, mund të miratohet me propozimin e trupave legjislative ose ekzekutive të rajoneve autonome ose provincave autonome.
4. Raportet midis provincave autonome në kuadër të territorit ose rajonet mund të rregullohen me ligjin federal ose me marrëveshje midis trupave të fuqisë së territorit të provincës.
5. Statusi i subjektit të Federatës Ruse mund të ndryshohet vetëm me pëlqimin reciprok të Federatës Ruse dhe të subjektit të Federatës Ruse në përputhje me ligjin kushteues federal.

Neni 67.

1. Territori i Federatës Ruse përfshinë territoret e të gjitha subjekteve detet e brendshme e të jashtme dhe hapësirën ajërore mbi territorin e përmendur.
3. Kufijtë midis subjekteve të Federatës Ruse mund të ndryshohen në bazë të marrëveshjeve të tyre reciproke.

Neni 68.

1. Gjuha shtetërore e Federatës Ruse në mbarë territorin e saj do të jetë gjuha ruse.
2. Republikat do të kenë të drejtë për t'i institucionalizuar gjuhët e veta shtetërore. Ato në organet e fuqisë së shtetit organet pat e vetëqeverisjes lokale dhe në institucionet shtetërore të republikave do të shfrytëzohen bashkë me gjuhën shtetërore të Federatës Ruse.
3. Federata Ruse do t'u garantojë të gjithë popujve të vetë të drejtën për ruajtjen e gjuhës së vet dhe krijimin e kushteve për mësimin dhe zhvillimin e saj.

Neni 69.

Federata Ruse u garanton të drejtat bashkësive më të vogla të popullatës lokale në harmoni me parimet dhe standardet e gjithëpranueshme të ligjit ndërkombtar dhe të kontratave ndërkombtare të Federatës Ruse.

Neni 71.

Nën juridiksionin e Federatës Ruse bëjnë pjesë a) miratimi i Kushtetutës së Federatës Ruse dhe i ligjeve federale, miratimi i amadamenteve relevante dhe supervizioni i zbatimit të tyre;

b) struktura federale dhe territori i Federatës Ruse; c) rregullimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut e të qytetarëve; shtetësia e Federatës Ruse; rregullimi dhe mbrojtja e pakicave kombëtare; d) krijimi i sistemit të tripave federale në sferën legjislativë, ekzekutive dhe gjyqësore si dhe procedurat për organizimin dhe aktivitetet e tyre; federale e shtetërore dhe drejtimi i tyre; f) caktimi i parimeve themelore të politikës shtetit të ekonomisë, mjedisit të njeriut dhe të zhvillimit shoqëror, kulturor e nacional të Federatës Ruse; g) krijimi i kornizave ligjore për tregun unik; për rregullativat financiarë, monetare, kredituese e doganore, emisioni i parave dhe udhëzimet për politikën e çmimeve; servisi ekonomik federal duke përfshirë edhe bankag federale; h) buxheti federal; tatimet federale dhe tagrat tjera; fondet federale për zhvillimin rajonal; i) elektrorrijeti federal, energjia bërthamore, materialet fisive, transporti federal, hekurudhat, informacionet e komunikacionet; programet e gjithësisë; j) politika e jashtme dhe marrëdhëniet ndërkombtare të Federatës Ruse, kontratat ndërkombtare të Federatës Ruse lidhur me çështjet e paqes e të luftës; k) marrëdhëniet e tregtisë së jashtme të Federatës Ruse; k) marrëdhëniet e tregtisë së jashtme të Federatës Ruse; l) mbrojtja dhe siguria; prodhimi i mjeteve mbrojtëse; caktimi i procedurës për shitjen dhe blerjen e armëve, të municionit, të armatimit të rëndë ushtarak dhe të pajisjes tjetër; prodhimi i materialit fision, i supstancave toksike, narkotikëve dhe procedurave për shfrytëzimin e tyre; m) definimi i statusit dhe mbrojtja e kufijve të shtetit të ujërave territoriale, hapësirës ajërore, të zonës ekskluzive ekonomike dhe të rrugëve kontinentale të Federatës Ruse;

n) gjyqet; kancelaria e prokurorit publik; legjislacioni kriminal o-procedural dhe kriminalo ekzekutiv; amnistimi dhe zvogëlimi i denimeve të burgimit; legjislacioni civil, civilo - procedural dhe arbitraro - procedural; rregullimi ligjor i pronës intelektuale;

c) konflikti federal i ligjeve; p) shërbimi materologjik; standardet, modelet, sistemet metrike dhe matja e kohës, gjeodezia zyrtare dhe përllogaritja: përcaktesat shtetërore dhe tutujt e nderit të Federatës Ruse; r) shërbimet federale të shtetit.

Neni 72.

1. Juridiksioni i përbashkët i Federatës Ruse dhe i subjekteve të Federatës Ruse do të përfshijnë:

a) Sigurimin e respektimit të kushtetutës dhe të ligjit të republikës të kartave të ligjeve dhe të normave të tjera rregullative ligjore të territoreve, rajoneve, të qyteteve federale, të rajoneve autonome e të provincave autonome me Kushtetutën e Federatës Ruse dhe me ligjet federale; b) mbrojtjen e të drejtave të pakicave etnike; sigurimin e legalitetit, të ligjit e të rendit, të sigurisë publike; regjimin e zonave kufitare; c) çështjet e disponimit, shfrytëzimit dhe të drejtimit të tokës, të resurseve minerale të ujërave dhe të resurseve tjera natyrore; d) kufizimin e pasurisë shtetërore; e) drejtimin e resurseve natyrore, mbrojtjen e ambientit të njeriut dhe sigurinë ekologjike: rezervatet natyrore të mbrojtura posaçërisht mbrojtjen e përmendoreve historike e kulturore; f) çështjet e përgjithshme të arsimit, adekimit, shkencës, kulturës, kulturës fizike dhe të sportit; g) koordinimin e çështjeve shëndetësore, mbrojtjen e familjes maternitetit, paternitetit dhe të fëmijërisë; mbrojtjen shoqërore duke përfshirë edhe sigurinë shoqërore; h) zbatimin e masave për pengimin e katastrofave të fatkeqësive natyrore të epidemive dhe eliminimin e pasojave të tyre; i) përcaktimin e direktivave kryesore të politikës tatimore në Federatën Ruse; j) legjislacionin administrativ, administrativo - procedural të punës, familjes, banesore si dhe ato legjislativ qe kanë të bëjnë me shfrytëzimin e tokës, ujit dhe pyjeve; ligjet mbi nënshtrësat tokësore dhe mbrojtjen e ambientit të njeriut; k) kuadrot gjyqësore dhe kuadrot e agjencive për aplikimin e ligjeve; avokatura, regjistratura; l) mbrojtja e ambientit origjinal të njeriut dhe e mënyrës tradicionale të jetesës së bashkësisë më të voglas etnike; m) caktimin e direktivave të përgjithshme për organizimin e sistemit të trupave të fuqisë shtetërore dhe të vetëqeverisjes lokale; n) harmonizimin e marrëdhënieve ndërkombtare dhe të jashtme ekonomike të subjekteve të Federatës Ruse, harmonizimin

me kontrata ndërkombtare të Federatës Ruse.

2. Dispozitat e këtij neni njësoj kanë të bëjnë me republikat territoret, rajonet, qytetet federale, rajonet autonome dhe provincat autonome.

Neni 74.

1. Në territorin e Federatës Ruse nuk mund të formohen kufijtë doganor, taksa tatimore, ose bariera tjera të cilat e pengojnë qarkullimin e lirë të mallërave, shërbimeve ose të mjeteve financiare.

Neni 76.

1. Lidhur me çështjet nën juridiksionin e Federatës Ruse do të miratohen ligjet kushtetuese federale dhe ligjet federale të cilët do të kenë efektivitet direkte në mbarë territorin e Federatës Ruse.

2. Lidhur me çështjet që bëjnë pjesë në juridiksionin e përbarshkët të Federatës Ruse dhe të subjekteve të Federatës Ruse, do të miratohen ligjet federale, e në harmoni me ta edhe ligjet dhe normat tjera rregullative ligjore të Federatës Ruse.

3. Ligjet federale nuk guxojnë të jenë në kundërshtim me ligjet kushtetuese federale.

4. Jashtë juridiksionit të Federatës Ruse dhe të juridiksionit të përbashkët të Federatës Ruse dhe të subjekteve të saj territoret, rajonet, qytetet federale, rajonet autonome dhe provincat autonome mund të nxjerrin rregullativen e vet ligjore, duke përfshirë miratomin e ligjeve dhe të normave rregullative ligjore. Ligjet dhe normat tjera rregullative ligjore të subjekteve të Federatës Ruse nuk goxojnë të jenë në kundërshtim me ligjet federale të miratuara në harmoni me paragrafin 1 e 2 të këtij neni. Në rast të disharmonisë midis ligjit federal dhe cilit ligj tjetër të miratuar në Federatën Ruse, do të aplikohet ligji federal.

5. Në rast të kontradiktës midis ligjit federal dhe të normës rregullative ligjore të subjektit të Federatës ruse të nxjerrë në harmoni me paragrafin 4. të këtij neni, do të aplikohet norma rregullative ligjore e subjektit të Federatës Ruse.

Neni 77.

1. Subjektet e Federatës Ruse do të formojnë sistem të pavarur të trupave të fuqisë së shtetit të republikave, territoreve, rajoneve, të qyteteve federale, rajoneve autonome dhe të provincave autonome në harmoni me parimet themelore të sistemit kushtetues të Federatës Ruse dhe të principeve të përgjithshme të organizimit të trupave legjislative e ekzekutive të fuqisë së parashikuar me ligjin federal.

2. Në suazat e juridiksionit të Federatës Ruse dhe të kompetencave të Federatës Ruse rreth çështjeve që bëjnë pjesë nën juridiksionin e përbashkët të Federatës Ruse dhe të subjekteve të Federatës Ruse, organet federale të pushtetit ekzekutiv dhe organet e pushtetit ekzekutiv të subjekteve të Federatës Ruse, do të formojnë sistemin unik të pushtetit ekzekutiv në Federatën Ruse.

PJESA E PARË

KREU IV.
Presidenti i Federatës Ruse

Neni 85.

1. Presidenti i Federatës Ruse mund të zbatojë procedurën e zgjedhjes së konflikteve me qëllim të kapercimit të dallimeve midis organeve të pushtetit shtetëror të Federatës Ruse dhe organeve të pushtetit shtetëror të subjekteve të Federatës Ruse si dhe midis organeve të pushtetit shtetëror të subjekteve të Federatës Ruse. Nëse nuk arrihet zgjidhja atëherë ai mund të përcjellë shqyrtimin nën gjyqin relevant për revizionim.

2. Presidenti i Federatës Ruse ka të drejtë të suspendojë ligjet e organeve të pushtetit ekzekutiv të subjekteve të Federatës Ruse, nëse ata janë në kundërshtim me Kushtetutën e Federatës Ruse dhe me ligjet federale, me detyrimet ndërkombëtare të Federatës Ruse ose i shkein të drejtat dhe liritë e njeriut e të qytetarit, në pritiqe që gjyqi relevant të zgjidh këtë çështje.

Neni 88.

Nën rrethanat dhe procedurat që i parashikon ligji kushtetutes federal, Presidenti i Federatës Ruse mund ta shpallë gjendjen e jashtëzakonshme në territorin e Federatës Ruse ose në ndonjë provincë të tij për çka është i obligueshëm që menjëherë ta njoftojë Këshillin Federal dhe Dumën e Shtetit.

PJESA E PARË

KREU V
Kuvendi Federal

Neni 95.

1. Kuvendi Federal do të përbëhet nga dy dhoma: Këshilli i Federatës dhe Duma e Shtetit.

2. Secili subjekt i federatës do të ketë nga dydeputet në Këshillin e Federatës: njërin nga organi përfaqësues kurse tjetrin nga organi ekzekutiv të pushtetit shtetëror.

Neni 102.

1. Nën juridiksionin e Këshillit Federla bëjnë pjesë: a. leja për ndryshimin e kufijve midis subjekteve të Federatës Ruse; b. lejimi i dekreteve të Presidentit të Federatës Ruse lidhur me shpalljen egjendjes ushtarake; c. lejimi i dekreteve të presidentit të Federatës Ruse mbi shpalljen egjendjes së jashtëzakonshme; d. miratimi i vendimit mbi mundësitë e angazhimit të forcave të armatosura të Federatës Ruse jashtë territorit të Federatës Ruse; e. konvokimi i zgjedhjeve për presidentin e Federatës Ruse; f. revokimin e presidentit të Federatës Ruse për shka ktë tejkalimit të kompetencave; g. emrimin e gjyqtarëve të Gjyqit Kushtetues të Federatës Ruse, të Gjyqit Suprem të Federatës Ruse dhe të Gjyqit Suprem të Arbitrazhit të Federatës Ruse; h. emrimi dhe revokimi i prokurorit të përgjithshëm të Federatës Ruse; i. emrimi dhe revokimi i zëvendëskryetarit të Odës së Kontabilitetit dhe të gjysmës së numrit të përgjithshëm të revizorëve.

3. Dekretet e Këshillit të Federatës do t'i miratojë shumica e të gjithë deputetëve të Këshillit të Federatës përpos nëse Kushtetuta e Federatës Ruse nuk e parashikon ndryshe.

Neni 103.

1. Nën juridiksionin e Dumës së Shtetit bëjnë pjesë: a. dhënia e lejeve presidentit të Federatës Ruse për emërimin e kryetarit të qeverisë së Federatës Ruse; b. nxjerrjen e vendimeve sekrete nga ana e qeverisë së Federatës Ruse; c. emërimi dhe shkarkimi i kryetarit të Bankës Qëndrore të Federatës Ruse; d. emërimi dhe shkarkimi i prokurorëve (të besueshëmve) për të drejtat e njeriut në harmoni me ligjin kushtetues federal; f) dhënien e amnistive; g. akuzin e presidentit të Federatës Ruse për shkak të tejkalimit të autorizimeve.

3. Rezolutat e Dumës së Shtetit do të miratohen me shumicën e votave të deputetëve të Dumës së Shtetit përpos nëse Kushtetuta e Federatës Ruse nuk parashikon ndryshe.

PJESA E PARË

KREU IX

Amandamentet kushtetuese dhe revizionit (rishikimet)

Neni 134.

Propozimet lidhur me amandamentet në dispozitat kushtetuese dhe rishikimet mund t'i jap presidenti i Federatës Ruse, Këshilli i Federatës, Duma e Shtetit, Qeveria e Federatës Ruse, organet legjislativ (përfaqësues) të subjekteve të Federatës Ruse si dhe grupet e deputetëve numri i të cilëve nuk guxon të jetë më i vogël nga e pesta e përbërjes së përgjithshme të Këshillit të Federatës ose të Dumës Ruse.

6. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË TATARISTANIT

I. BAZAT E RREGULLIMIT SHTETËROR DHE SHOQËROR TË REPUBLIKËS SË TATARISTANIT

KREU 1.

Sistemi shoqëroro politik

Neni 1.

Republika e Tataristanit është shtet sovran e demokratik i cili e shpreh vullnetin dhe interesat e tërë popullit shumënacional të Republikës.

Sovraniteti dhe autorizimet e shtetit burojnë nga populli.

Sovraniteti i shtetit është gjendje e patjetërsueshme e Republikës së Tataristanit.

Neni 2.

I tërë pushteti në Republikën e Tataristanit i takon popullit.

Populli e realizon pushtetin e vet drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet sistemit të organeve të pushtetit të shtetit dhe të vetëqeverisjes lokale në përputhje me kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Tataristanit.

Mënyra më e lartë imediate e shprehjes së pushtetit të popullit janë referendumit dhe zgjedhjet e lira.

Kushtetutën e Republikës së Tataristanit e nxjerr Këshilli i shtetit të Republikës së Tataristanit ose

(miratohet) me referendum.

Askush, as individi as grupi, nuk mund ta përvehtësojnë pushtetin në Republikën e Tataristanit. Marrja e pushtetit ose përvetësimi i prerogativave të pushtetit është e dënueshme me ligj.

Neni 3.

Marrëdhëniet midis qytetarëve dhe shtetit mbështeten parasëgjithash në të drejtat e njeriut, si vlera supreme shoqërore dhe në pjesëmarrjen e qytetarëve në drejtimin e punëve të shtetit. Qytetari dhe shteti në marrëdhënie të veta bartin përgjegjësinë reciproke.

Republika e Tataristanit e garanton barazinë e qytetarëve në të gjitha sferat e jetës politike, ekonomike, shoqërore e kulturore.

Respektimi reciprok dhe bashkëpunimi vullnetar dhe i barabartë i të gjitha shtresave të popullatës dhe i qytetarëve të të gjitha nacinaliteteve e përbëjnë bazën e shoqërisë së Republikës e Tataristanit.

Neni 4.

Gjuhët e barabarta shtetërore në Republikën e Tataristanit janë gjuha tatare dhe ruse.

II. INDIVIDIDI DHE SHTETI

KREU 3

Shtetësia e Republikës së Tataristanit. Barazia e qytetarëve

Neni 19

Republika e Tataristanit e ka shtetësinë e vet. Bazat dhe mënyra e fitimit apo e pushtimit të shtetësisë së Republikës së Tataristanit caktohen me Ligjin mbi shtetësinë e Republikës së Tataristanit.

Shtetasit e Republikës së Tataristanit posedojnë shtetësinë e Federatës Ruse - Rusisë.

Shtetasit e Republikës së Tataristanit mund të posedojnë shtetësinë e shteteve tjera nën kushtet e caktuara me marrëveshjet dhe kontratat midis Republikës Tataristanit dhe shteteve tjera. Shtetasit e Republikës së Tataristanit mund ta ruajnë ose të heqin dorë ng shtetësia dytësore.

Secili person ka të drejtë ta zgjedhë shtetësinë dhe /të drejtën/ për ta ndryshuar atë. Ndalohet privimi nga shtetësia ose nga e drejta për ndryshimin e shtetësisë.

Neni 20.

Të gjithë qytetarët e Republikës së Tataristanit kanë të drejta të njëjta dhe obligime të njëjta. Ata kanë të drejtën e barabartë për mbrojtjen shtetërore, pavarësisht nga prejardhja, pozita sociale e pronësore, nga përkatësia racore e nacionale, gjinia, arsimimi, gjuha, pikëpamjet politike, feja lloji dhe karakteri i profesionit, vendi i banimit dhe rrethanat tjera.

Shtetasve u garantohet përdorimi i gjuhës amëtare.

Të drejtat, liritë dhe obligimet e shtetasve që janë të parashikuara me kushtetutë, realizohen direkt në bazë të Kushtetutës.

Mënyra e realizimit, e mbrojtjes dhe e sigurimit të drejtave kushtetuese, të lirive dhe obligimeve përcaktohet me ligj.

Neni 22.

Kufizimi imediat ose i tërthortë i të drejtave apo futja e favorizimeve në bazë të veçorive racore, nacionale e të tjera është e dënueshme me ligj.

KREU 4

Të drejta, liritë dhe obligimet e njeriut e të qytetarit

Neni 29.

Shtetasit e Republikës së Tataristanit kanë të drejtë që në përputhje me bindjet e veta, ta predikojnë lirisht cilën do fe ose të mos e predikojnë asnjë fe, si dhe të merren me veprimtari fetare ose ateiste. Secili njeri është i lirë në kryerjen e ceremonive fetare.

Provokimi i armiqësisë, urrejtjes dhe i përçarjes nacionale mbi baza të bidjes fetare është i ndaluar. Feja dhe bindjet fetare janë të ndara nga shteti në Republikën e Tataristanit.

Neni 31.

Në territorin e Republikës së Tataristanit çdo qytetar ka të drejtë për qarkullim të lirë dhe për zgjedhjen e vendqëndrimit dhe vendbanimit. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm me ligj.

III. RREGULLIMI SHTETËROR I REPUBLIKËS SË TATARISTANIT

KREU 5.

Republika e Tataristanit - shtet sovran

Neni 60

Republika Tataristan është e paprekshme. Kufijtë midis Republikës së Tataristanit dhe shteteve tjera caktohen dhe ndryshohen me pëlqimin e palëve.

Neni 61.

Republika e Tataristanit është shtet sovran dhe subjekt i të drejtës ndërkombëtare e bashkuar me Federatën Ruse - Rusinë në bazë të Marrëveshjes mbi bartjen reciproke të autorizimeve dhe të kompetencave.

Neni 62.

Republika e Tataristanit vendos marrëdhënie me shtetet tjera, lidh kontrata ndërkombëtare, shkëmben përfaqësuesit diplomatikë, konsular, tregtar e të tjerë dhe mer pjesë në punën e organizatave ndërkombëtare duke u udhëhequr nga parimet e të drejtës ndërkombëtare.

Parimet dhe normat e gjithëpranueshme ndërkombëtare kanë përparësi mbi ligjet e Republikës së Tataristanit.

IV. ORGANIZIMI I PUSHTETIT SHTETËROR NË REPUBLIKËN E TATARISTANIT

KRUE 7

Bazat e organizimit të punës së organeve përfaqësuese të pushtetit shtetëror

Neni 64.

Dhoma shtetërore e Republikës së Tataristanit dhe dhomat e vendit të deputetëve popullorë - të rrethit, qytetit (në qytete i nënshtrohen republikës) dhe rajoneve të qyteteve - paraqesin sistemin unik të organeve përfaqësuese të pushtetit shtetëror në Republikën e Tataristanit.

Dhomat e deputetëve popullorë vendosin mëvetësisht për të gjitha çështjet nga kompetencat e veta.

Në njësitë administrativo territoriale të cilat kanë selinë e përbashkët administrative, mund të formohen dhomat e bashkuara të deputetëve popullorë në përputhje me ligjin.

KREU 10.

Dhoma Shtetërore e Republikës së Tataristanit

Neni 89.

Dhoma Shtetërore e Republikës së Tataristanit - Kuvendi i Republikës së Tataristanit - paraqet organin më të lartë përfaqësues, legjislativ dhe mbikëqyrës të pushtetit shtetëror në Republikën e Tataristanit.

Kompetencat e Dhomës Shtetërore të Republikës së Tataristanit janë:

1. Miratimi i kushtetutës dhe i amandamenteve në Kushtetutën e Republikës së Tataristanit;
2. Miratimi i ligjit dhe i amandamenteve në ligjet e Republikës së Tataristanit;
3. Caktimi i politikës së brendshme dhe të jashtme të Republikës së Tataristanit;

...

VI. PUSHTETI GJYQËSOR, MBROJTJA E LIGJSHMËRISË DHE E RENDIT JURIDIK.

KREU 14.

Gjyqet

Neni 140.

Me qëllim të mbrojtjes së rendit kushtetues të Republikës së Tataristanit, të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të ruajtjes së primatit dhe të efektit imediat të Kushtetutës së Republikës së Tataristanit në mbarë territorin e Republikës, Gjyqi Kushtetues i Republikës së Tataristanit shqyrton kushtetutshmërinë:

1. e ligjeve të Republikës së Tataristanit dhe të zgjidhjeve normative të Dhomës Shtetërore të Republikës së Tataristanit;

2. e akteve normative të Presidentit dhe të kabinetit të ministrave të Republikës së Tataristanit;

3. e kontratave ndërkombëtare të Republikës së Tataristanit.

Gjyqi kushtetues shqyrton kontestet mbi kompetencat midis organeve më të larta të shtetit të Republikës së Tataristanit si dhe midis organeve të pushtetit në rrethe dhe qytete të cilët i janë të nënshtroar Republikës.

Me kërkesë të Dhomës Shtetërore të Republikës së Tataristanit, të komisioneve të saja të

përhershme dhe të këshillave të mbikqyrjes së Kuvendit si dhe në bazë të iniciativës së vet, Gjyqi Kushtetues i Republikës së Tataristanit nxjerrë konkluzione mbi harmonizimin e masave e të vendimeve të presidentit të Republikës së Tataristanit me Kushtetutën e Republikës së Tataristanit.

Aktet ose pjesët e tyre për të cilët Gjyqi Kushtetues konstaton se janë jokushtetues në rastet e parashikuara me ligj, pushojnë të vlejshme nga dita e shpalljes së vendimit të Gjyqit. Vendimet e Gjyqit Kushtetues janë definitive dhe nuk i nënshtrohen parashtrimit ose ankesës.

VIII. VLERA E KUSHTETUTËS NË REPUBLIKËN E TATARISTANIT DHE NDRYSHIMET E SAJ

Neni 165.

Kushtetuta e Republikës së Tataristanit është Ligj themelor i Republikës dhe akt me fuqinë më të madhe juridike, i cili zbatohet drejtpërdrejtë. Ligjet e Republikës së Tataristanit dhe aktet e organeve të shtetit të Republikës së Tataristanit nxirren në bazë dhe në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Tataristanit.

Neni 166.

Organet e shtetit, shoqatat shoqërore, personat zyrtarë dhe shtetasit e Republikës së Tataristanit janë të detyrueshëm ta respektojnë dhe t'i përmbahen Kushtetutës të Republikës së Tataristanit.

Neni 167.

Për ndryshimin e Kushtetutës të Republikës së Tataristanit vendos Dhoma shtetërore e Republikës së Tataristanit në qoftë se për këtë deklarohen dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Dhomës shtetërore të Republikës së Tataristanit.

C. MARRËVESHJE

Midis Federatës Ruse dhe Republikës së Tataristanit mbi ndarjen e kompetencave dhe bartjen reciproke të autorizimeve midis organeve të pushtetit të shtetit të Federatës Ruse dhe organeve të pushtetit të shtetit të Republikës së Tataristanit.

Përfaqësuesit fuqiplotë të organeve të pushtetit të shtetit të Federatës Ruse dhe të organeve të pushtetit të shtetit të Republikës së Tataristanit,

- duke u udhëhequr me Kushtetutën e Federatës Ruse dhe të Republikës së Tataristanit;
- duke u nisur nga e drejta e gjithëpranueshme e popujve për vetëvendosje dhe nga parimet e barazisë, vullnetit të mirë dhe të dëshirës së shprehur irisht;
- duke garantuar ruajtjen e tërësisë tokësore dhe unitetin e hapësirës ekonomike;
- duke kontribuar në ruajtjen dhe zhvillimin e traditave historike e nacionale, të kulturës e të gjuhëve;
- duke shfaqur kujdes për sigurimin e qetësisë qytetare, pajtueshmërisë ndërnacionale dhe të sigurisë së popujve;
- duke realizuar prioritetin e të drejtave dhe lirive themelore njerëzore e qytetare pavarësisht nga përkatësia kombëtare, feja, qëndrimi dhe dallimet tjera;
- duke pasur parasysh se Republika e Tataristanit si shtet i bashkuar me Federatën Ruse në bazë të

Kushtetutës së Federatës Ruse, Kushtetutës të Republikës së Tataristanit dhe të Marrëveshjes mbi ndarjen e kompetencave dhe bartjen reciproke të autorizimeve midis organeve të pushtetit të shtetit të Federatës Ruse dhe të organeve të pushtetit të shtetit të Republikës së Tataristanit, merr pjesë në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe të jashtme ekonomike, merren vesh më sa vijon:

Neni I.

Ndarja e kompetencave dhe bartja reciproke e autorizimeve midis organeve të pushtetit të shtetit të Federatës Ruse dhe të organeve të pushtetit të shtetit të Republikës së Tataristanit realizohet në bazë të Kushtetutës së Federatës Ruse, të Kushtetutës së Republikës së Tataristanit dhe të kësaj Marrëveshjeje.

Neni II.

Republika e Tataristanit ka Kushtetutën dhe legjislacionin e vet.

Organet e pushtetit të shtetit të Republikës së Tataristanit realizojnë autorizimet e pushtetit të shtetit, duke përfshirë:

1. kujdesin për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut e të qytetarit;
2. formimin e buxhetit republikan, caktimin dhe grumbullimin e tatimeve republikane;
3. zgjidhjen e çështjeve të avokaturës dhe të noterisë;
4. caktimin juridik të marrëdhënieve administrative, familjare dhe banesore, të marrëdhënieve në sferën e mbrojtjes së ambientit dhe shfrytëzimin e begatave natyrore;
5. faljen e personave të cilët i kanë dënuar gjyqet e Republikës së Tataristanit;
6. zgjidhjen e çështjeve të pronësisë, të shfrytëzimit dhe disponimit të tokës, minierave, të pyjeve dhe të pasurive të tjera natyrore si dhe të ndërmarrjeve shtetërore, organizatave dhe të pasurisë tjetër të tundshme e të patundshme të shtetit që gjendet në territorin e Republikës së Tataristanit dhe paraqet ekskluzivisht pasurinë e popullit të Tataristanit, me përjashtim të objekteve të cilët janë pronë federale.
(Ndarja e pronësisë shtetërore rregullohet me marrëveshje të veçantë);
7. përcaktimin e sistemit të organeve të shtetit të Republikës së Tataristanit, mënyrën e organizimit dhe të punës së tyre;
8. zgjidhjen e çështjeve të shtetësisë republikane;
9. caktimin e mënyrës së shërbimit të afatit civil alternativ në territorin e Republikës së Tataristanit për qytetarët të cilët sipas ligjit federal kanë të drejtën e zëvendësimit të obligimit ushtarak;
10. caktimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve dhe lidhjen e marrëveshjeve e të kontratave me republikat, krahinat, provincat, provincat autonome dhe rrethet autonome, qytetet e Moskës dhe të Sankt Peterburgut në Federatën Ruse në qoftë se nuk janë në kundërshtim me Kushtetutën e Federatës Ruse dhe të Republikës së Tataristanit, me këtë Marrëveshje dhe me kontratat tjera idis organeve të pushtetit shtetëror të Republikës së Tataristanit;
11. pjesëmarrjen në marrëdhënie ndërkombëtare; caktimin e marrëdhënieve me shtetet e jashtme dhe lidhjen e kontratave me to, të cilat nuk janë në kundërshtim me kushtetutën dhe detyrimet ndërkombëtare të Federatës Ruse, me kushtetutën e Republikës së Tataristanit dhe me këtë Marrëveshje, dhe me pjesëmarrjen në punët e organeve përkatëse ndërkombëtare;
12. formimin e Bankës Popullore në sja të marrëveshjes së veçantë;
13. realizimin e veprimtarisë së pavarur të ekonomisë së jashtme. Ndarja e autorizimeve në fushën e marrëdhënieve ekonomike ndërkombëtare realizohet me marrëveshje të veçantë;
14. zgjidhjen e çështjeve të transformimit të ndërmarrjeve që janë në pronësinë shtetërore të Republikës së Tataristanit sipas mënyrës së caktuar me marrëveshje të veçantë;
15. caktimin e çmimeve (shpërblimeve) shtetërore dhe të titujve të nderit të Republikës së Tataristanit.

Neni III.

Organet e pushtetit të shtetit të Federatës Ruse dhe organet e pushtetit të shtetit të Republikës së Tataristanit bashkarisht realizojnë këto autorizime:

1. sigurimin e të drejtave dhe lirive njerëzore e qytetare dhe të drejtat e pakicave kombëtare;
2. mbrojtja e sovranitetit dhe e tërësisë tokësore;
3. organizimi i përgatitjes mobilizuese të ekonomisë kombëtare, drejtimi i zhvillimit dhe prodhimi i armatimit e i pajisjes teknike ushtarake në territorin e Republikës së Tataristanit; çështja e armëve, municionit, teknikës ushtarake dhe të pronës tjetër ushtarake si dhe transformimin e industrisë mbrojtëse. Format dhe pjesëmarrja e palëve në realizimin e autorizimeve përkatëse caktohen me marrëveshje të veçantë;
4. çështjet e përgjithshme dhe kolonizuese të shtetësisë;
5. koordinimi i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të politikës së jashtme;
6. koordinimi i politikës së çmimeve;
7. formimi i fondeve për zhvillimin rajonal;
8. zbatimimi i politikës monetare;
9. drejtimi i objekteve që janë pronësi e Federatës Ruse ose të Republikës së Tataristanit dhe të cilët mund të jenë nën administrim të përbashkët duke shfaqur kujdes për intereshmërinë dhe pajtimin vullnetar dhe reciprok. Format dhe mënyra e administrimit të përbashkët të objekteve konkrete do të caktohet me marrëveshje të veçantë;
10. koordinimi i veprimtarive në fushën e gjeodezisë, shërbimit meteorologjik dhe të llogaritjes së kohës;
11. krijimi i fondeve të përbashkëta për financimin e programeve të përbashkëta, eliminimi i pasojave nga fatkeqësitë elementare dhe të katastrofave në bazë të ujdisë së ndërsjellë;
12. koordinimi i drejtimit të sistemit të përbashkët energjetik, i magjstralave, hekurudharve, komunikacioni ajror e ujqor, ndërlidhjet dhe sistemi i informacionit;
13. sigurimi i regjimit të lëvizjes së papengueshme dhe padogonor të komunikacionit, ngarkesave dhe të prodhimeve me anë të rrugëve ajrore, detare, lumore, hekurudhore e rrugore dhe me anë të tubasjellësve;
14. vlerësimi i gjendjes së ambientit natyror në harmoni me standardet ndërkombëtare, zbatimimi i masave për stabilizimin dhe rimkëmbjen e saj; sigurimi i mbrojtjes ekologjike, koordinimi i masave nëfshëne shfrytëzimit të pasurive tokësore, ujore e të tjera natyrore; pengimi i katastrofave ekologjike; çështja e territore natyrore nën mbrojtje të posaçme;
15. zbatimimi i politikës së përbashkët sociale; punësimi i popullatës, proceset e migrimit, mbrojtja sociale, duke përfshirë edhe sigurimin social;
16. koordinimi i punës në sferën e mbrojtjes shëndetësore, mbrojtjen e familjes, të nënave, etërve dhe fëmijëve; arsimit, shkenca, kultura, edukata fizike dhe sporti; përgatitja e kuadrove nacionale për shkollat, institucionet e arsimit, institucionet e kulturës, mediat publike dhe institucione e organizata tjera; furnizimi i institucioneve parashkollore dhe i institucioneve të arsimit me literaturë në gjuhën amtare; koordinimi i hulumtimeve shkencore në fushën e historisë, kulturës së popujve dhe të gjuhëve të tyre;
17. kuadrot e organeve gjyqësore dhe të organeve për mbrojtjen e rendit juridik;
18. avokatura, arbitrazhi dhe notaria;
19. koordinimi i punës së organeve për mbrojtjen e rendit juridik, bashkëpunimi i organeve të sigurimit, hartimi dhe realizimi i programeve të orientuara kah lufta kundër kriminalitetit;
20. caktimi i parimeve të përbashkëta të organizimit të sistemit të organeve të pushtetit shtetëror dhe të vetëqeverisjes lokale;

21. legjislacioni administrativ, administrativo-procesor, punues, familjar, banesor, tokësor, ujqor, pyjore, legjislacioni mbi resurse minerare dhe mbrojtjen e ambientit natyror;
22. çështjet e shfrytëzimit të përbashkët të tokës, dhe të pasurive minerare, ujore e të tjera natyrore;
23. autorizimet tjera të caktuara me marrëveshje.

Neni IV.

Kompetencat e Federatës Ruse janë:

1. miratimi dhe aplikimi i kushtetutës së Federatës Ruse dhe i ligjeve federale si dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre, rendi federal dhe territori i Federatës Ruse;
2. rregullimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive njerëzore e qytetare; shtetësia në Federatën Ruse; rregullimi dhe mbrojtja e të drejtave të pakicave kombëtare;
3. caktimi i sistemit të pushtetit legjislativ, ekzekutiv e gjyqësor të organeve federale, mënyra e organizimit dhe e punës së tyre, dhe formimi i organeve të pushtetit shtetëror;
4. prona shtetërore federale dhe drejtimi i saj;
5. rregullimi i bazave të politikës federale dhe programet federale në sferën e zhvillimit shtetëror, ekonomik, elologjik, social, kulturor e nacional të Federatës Ruse;
6. caktimi i bazave juridike të tregut unik; politika financiare, devizore, kreditore, rregullative doganore, emetimi i parave dhe bazat e politikës së çmimeve; shërbimet ekonomike federale, përfshirë bankat federale;
7. buxheti federal, tatimet dhe kontributet federale, fondet federale dhe zhvillimi rajonal;
8. sistemi energjetik federal, energjetika bërthamore, materialet fizive; transporti federal, komunikacionet, informacionet e lidhjet; veprimtaritë në kosmos;
9. politika e jashtme dhe marrëdhëniet ndërkombëtare të Federatës Ruse, kontratat ndërkombëtare të Federatës Ruse; çështjet e luftës e të paqes;
10. marrëdhëniet e ekonomisë së jashtme të Federatës Ruse;
11. mbrojtja dhe siguria, prodhimet për mbrojtje, caktimi i mënyrës së shitjes e blerjes së armëve, municionit, të teknikës ushtarake dhe të pronës tjetër ushtarake; prodhimi i mjeteve toksike, të mjeteve narkotike dhe mënyra e shfrytëzimit të tyre;
12. caktimi i statusit dhe mbrojtja e kufijve të shtetit, të deteve territoriale, hapësirës ajrore, të zonave ekskluzive ekonomike dhe të bregdetit të Federatës Ruse;
13. gjyqësia; prokuroria, legjislacioni penal, penalo procesor dhe penalo-ekzekutiv; amnistia dhe faljet e dënimeve; legjislacioni civil, civilo-procesor dhe arbitrazho procesor;
14. e drejta kolezive federale;
15. shërbimi meteorologjik, standardet, normat, sistemi metrik dhe llogaritja e kohës, gjeodezia e hartografia, emrimi i objekteve gjeografike, statistika zyrtare dhe kontabiliteti;
16. çmimet shtetërore (shpërblimet) dhe titujt e nderit të Federatës Ruse;
17. shërbimi shtetëror federal.

Neni V.

Dokumentet juridike që i lejojnë organet e pushtetit, institucionet dhe personat zyrtar të Federatës Ruse dhe të Republikës së Tataristanit në suazat e autorizimeve të atyre organeve, institucioneve e të personave zyrtar, konsiderohen të vlefshme.

Neni VI.

Organet e pushtetit të shtetit të Federatës Ruse as organet e pushtetit të Republikës së Tataristani nuk mund të japin akte juridike rreth çështjeve që nuk bëjnë pjesë në kompetencat e tyre.

Organet e pushtetit të shtetit të Republikës së Tataristanit si dhe organet federale të pushtetit të shtetit kanë të drejtë të barabartë për të ushtruar parashtrime kundër ligjeve të Federatës Ruse dhe të Republikës së Tataristanit nëse me to parashihet kjo Marrëveshje.

Kontestet për realizimin e autorizimeve në sferën e kompetencave të përbashkëta të organeve të pushtetit të shtetit të Federatës Ruse dhe të organeve të pushtetit të shtetit të Republikës së Tataristanit zgjedhen sipas mënyrës së harmonizuar midis tyre.

Neni VII.

Për realizimin e kësaj Marrëveshjeje, organet e pushtetit të shtetit të Federatës Ruse dhe organet e pushtetit të Republikës së Tataristanit, mund të lidhin kontratë plotësuese dhe të formojnë struktura e komisione të përbashkëta mbi baza të paritetit.

Neni VIII.

Organet e pushtetit të shtetit të Federatës Ruse dhe organet e pushtetit të shtetit të Republikës së Tataristanit kanë përfaqësues fuqplotë në Kazani, përkatësisht në Moskë.

Neni IX.

Marrëveshja ose dispozitat e saja të caktuara nuk mund të pezullohen, ndryshohen ose të plotësohen njëanshëm.

Marrëveshja hyn në fuqi 7 ditë nga dita e nënshkrimit të saj dhe i nënshtrohet botimit.

I hartuar në Moskë, më 15 shkurt të vitit 1994, në dy kopje në gjuhën ruse e tatarë, me ç'rast të dy tekstet kanë fuqi të njëjtë.

Presidenti i
Federatës Ruse
B. Jelcin

Presidenti i
Republikës së Tataristanit
M. Shajmiev

Kryetari i qeverisë së
Federatës Ruse
V. Çernomirdin

Kryetari i qeverisë së
Republikës së Tataristanit
M. Sabirov

10. UKRAINA

A. NGA KUSHTETUTA E MIRATUAR NË SESIONIN E PESTË TË VERHOVNE RADE
UKRAJINE MË 28 JANAR TË VITIT 1996.

KREU I

Parimet e përgjithshme

Neni 1.

Ukraina është shtet sovrani, i pavarur, demokratik dhe social i mbështetur në sundimin e ligjit.

Neni 2.

Sovraniteti i Ukrainës mbulon gjithë territorin e saj.

Ukraina është shtet unitar.

Territori i Ukrainës në kuadër të kufijve të saja të tashëm është i pandashëm dhe i pacenueshëm.

Neni 3.

Në Ukrainë, qenia njerëzore, jeta dhe shëndeti i tij / i saj, nderi dhe dinjteti, si dhe moscenimi dhe sigurimi i tyre, janë të pranuar si vlera më të larta shoqërore.

Të drejtat dhe liritë e njeriut, si dhe garantimet e tyre, përcaktojnë esencën dhe kahet e aktivitetit të shtetit. Shteti bartë përgjegjësi para individit për aktivitetet e veta. dEtyra kryesore eshtetit është që t'i konfirmojë dhe sigurojë të drejtat dhe liritë e njeriut.

Neni 4.

Në Ukrainë ekziston shtetësia unike. Ligji e cakton bazën juridike për fitimin ose heqjen e shtetësisë së Ukrainës.

Neni 10.

Gjuha shtetërore e Ukrainës është gjuha ukrainase.

Shteti siguron zhvillimin e gjithpërfshijshëm dhe funksionimin e gjuhës ukrainase në të gjitha sferat e jetës shoqërore në tërë territorin e Ukrainës.

Në Ukrainë është i garantuar zhvillimi i lirë, shfrytëzimi dhe mbrojtja e gjuhës ruse dhe të gjuhëve të tjera të pakicave kombëtare të Ukrainës.

Shteti e avancoon mësimin e atyre gjuhëve të cilat paraqesin mjetin e komunikimit ndërkombëtar.

Shfrytëzimi i gjuhëve në Ukrainë është i garantuar me Kushtetutën e Ukrainës dhe është i caktuar me ligj.

Neni 85.

Verkovne Rade Ukraine ka këto prerogativa:

28. që të pezullojë autorizimet e Verkovne Rade të Republikës Autonome të Krimesë para skadimit të mandatit të saj, në bazë të mendimit të Gjyqit Kushtetutes të Ukrainës se Kushtetuta e Ukrainës dhe ligjet e saj janë shkelur nga ana e Verkovne Rade të Republikës Autonome të Krimesë; që të caktojë zgjedhjet e jashtëzakonshme për Verkovnu Radu të Republikës Autonome të Krimesë.

KREU IX

Republika Autonome e Krimesë

Neni 134.

Republika Autonome e Krimesë është pjesë përbërëse e pandashme e Ukrainës dhe ajo vendos mbiçështejt të cilat bëjnë pjesë në kompetencat e saj, e vëllimi i të cilave është caktuar me Kushtetutën e Ukrainës.

Neni 135.

Republika Autonome e Krimesë ka Kushtetutën e Republikës Autonome të Krimesë të cilin e ka miratuar Verkovna Rade i Republikës Autonome të Krimesë dhe e kanë miratuar më së gjysma e anëtarëve të Verkovne Rades të Ukrainës.

Aktet normative ligjore të Verkovne Rade të Republikës Autonome të Krimesë dhe vendimet e Këshillit të Ministrave të Republikës Autonome të Krimesë nuk do të jenë në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet e Ukrainës dhe miratohen në harmoni me Kushtetutën e Ukrainës, ligjet e Ukrainës, me dekretet e presidentit të Ukrainës dhe të kabinetit ministror të Ukrainës.

Neni 136.

Verkovna Rada i Republikës Autonome të Krimesë, në kuadër të kompetencave të veta, është trup përfaqësues i Republikës Autonome të Krimesë.

Verkovna Rada i Republikës Autonome të Krimesë miraton vendimet e rezoluta të cilat duhet të zbatohen patjetër në Republikën Autonome të Krimesë.

Këshilli i Ministrave të Republikës Autonome të Krimesë është qeveria e Republikës Autonome të Krimesë. Kryetari i Këshillit të Ministrave të Republikës Autonome të Krimesë e emëron në atë pozitë dhe e shkarkon nga pozita, Verkovna Rada e Republikës Autonome të Krimesë me pëlqimin e Presidentit të Ukrainës.

Procedura për formimin dhe aktivitetet e Verkovne Rades të Republikës Autonome të Krimesë dhe për Këshillin e Ministrave të Republikës Autonome të Krimesë, është caktuar me Kushtetutën dhe ligjet e Ukrainës dhe aktet normative ligjore të Verkovne Rade të Republikës Autonome të Krimesë, që kanë të bëjnë me çështjet në suazat e kompetencave të saj.

Në Republikën Autonome të Krimesë drejtësinë e zbatojnë gjyqet të cilët i takojnë sistemit të bashkuar të gjyqeve të Ukrainës.

Neni 137.

Republika Autonome e Krimesë nxjerr norma ligjore për këto sfera:

1. bujqësia dhe pylltaria;
2. xehetaria dhe krijimi i tokës së punueshme;
3. punët publike, zejtaria dhe tregtia, puna bamirëse;
4. ndërtimi i qyteteve dhe i lagjeve të banimit;
5. turizmi, hoteleria dhe panairët;
6. muzetë trashëgimia historike e kulturore;
7. transporti publik, rrugët, rrjeti i ujës-jellës;
8. gjahu dhe peshkimi;

9. shërbimet sanitare dhe spitalore;

Në rast se ekziston mosharmonia midis normave ligjore të Verkovne Rade të Republikës Autonome të Krimesë dhe Kushtetutës e ligjeve të Ukrainës, Presidenti i Ukrainës mund të suprimojë normat e përmendura me apelin e njëkohshëm drejtuar Gjyqit Kushtetutes të Ukrainës për ta shqyrtuar kushtetutshmërinë.

Neni 138.

Në kompetencat e Republikës Autonome të Krimesë bëjnë pjesë:

1. caktimi i zgjedhjeve për Verkovna Rada të Republikës Autonome të Krimesë, lejimi i përbërjes së komisioneve elektorale të Republikës Autonome të Krimesë;
 2. organizimi dhe zbatimi i referendumeve lokale;
 3. drejtimi i pasurisë e cila i takon Republikës Autonome të Krimesë;
 4. elaborimi, akordimi dhe aplikimi i buxhetit të Republikës Autonome të Krimesë në bazë të politikës identike tatimore e buxhetore të Ukrainës;
 5. elaborimi, lejimi dhe zbatimi i programeve të Republikës Autonome të Krimesë që kanë të bëjnë me zhvillimin shoqëroro-ekonomik dhe kulturor, me shfrytëzimin racional të natyrës, dhe me mbrojtjen e ambientit natyror në harmoni me programet nacionale;
 6. njohja e statusit të vendvendimeve të disa lokaliteteve; krijimi i zonave të mbrojtjes sanitare të vendvendimeve;
 7. pjesëmarrja në sigurimin e të drejtave dhe lirive qytetare, të harmonisë nacionale, përparimi i mbrojtjes së rendit ligjor dhe i sigurisë publike;
 8. sigurimi i përdorimit dhe i zhvillimit të gjuhës shtetërore dhe të gjuhëve nacionale e të kulturave në Republikën Autonome të Krimesë; mbrojtja dhe shfrytëzimi i përmendoreve historike;
 9. pjesëmarrja në zhvillimin dhe realizimin e programeve shoqërore që kanë të bëjnë me kthimin e popujve të deportuar;
 10. fillimi i procedurës për futjen e gjendjes së jashtëzakonshme dhe krijimin e zonave të rrezikut të jashtëzakonshme ekologjik në Republikën Autonome të Krimesë dhe në provincat e saja të veçanta.
- Në bazë të ligjeve të Ukrainës, Republikës Autonome të Krimesë mund t'i jepen kompetenca tjera.

Neni 139.

Kancelaria përfaqësuese e Presidentit të Ukrainës, statusin e të cilës e cakton ligji i Ukrainës, operon në Republikën Autonome të Krimesë.

11. LITUANIA

A. NGA LIGJI MBI PAKICAT KOMBËTARE

Lituanian do t'u garantojë të gjithë qytetarëve, pavarësisht nga prejardhja entike, të drejtat dhe liritë e barabarta politike ekonomike e sociale dhe do t'ua njoh qytetarëve të vet identitetin e tyre etnik, të drejtën për zhvillimin e kulturës së tyre dhe do të mbështesë zhvillimin e vetëdijes së tyre etnike dhe shprehjen e përkatësisë kombëtare.

Pjesëtarët e të gjitha grupeve etnike që kanë qëndrim në Lituanian janë të obligueshëm ta mbrojnë Ligjin themelor dhe ligjet tjera të Lituanisë, të mbrojnë sovranitetin mbi integritetin e shtetit lituan, të kontribuojnë në vendosjen e shtetit të pavarur e demokratik të Lituanisë dhe të respektojnë gjuhën, kulturën, traditën dhe doket shtetërore lituane.

Neni 1.

Lituania, besnike ndaj parimeve të barazisë etnike dhe humanizmit, u garanton të gjitha pakicave etnike që jetojnë në Lituanë të drejtën për zhvillim të lirë dhe respektimin e gjuhëve të secilës nga pakicat etnike.

Diskriminimi i mbështetur mbi baza të përkatësisë racore, etnike, nacionale, gjuhësore apo tjetër që është e lidhur me etnicitetin, është i ndaluar dhe i ndëshkuar.

Neni 2.

Shteti i mbrohet gjithë qytetarët e vet pavarësisht nga përkatësia etnike.

Lituania, duke pasur parasysh interesat e të gjitha pakicave etnike, i garanton të drejtat e tyre në:

- marrjen e ndihmës nga shteti për zhvillimin e kulturës dhe të arsimit të tyre;
- shkollimin në gjuhën amtare në harmoni me rregullat që kanë të bëjnë me arsimimin parashkollor, shkollimin fillor e të mesëm si dhe me rregullat që kanë të bëjnë me grupet, sektorët dhe fakultetet në institucionet e shkollimit të lartë në të cilat aftësohen pedagogët dhe specialistët e tjerë të nevojshëm për pakicat etnike;
- gazeta dhe publikime të tjera dhe në përgjithësi në informacione në gjuhën amtare;
- përkatësinë e cilit do religjion ose mospërkatësinë religjionit dhe ushtrimin e ceremonive fetare e popullore në gjuhën amtare;
- themelimin e organizatave kulturore etnike;
- përfaqësimin në organet qeveritare në të gjitha nivelet e ushtrimit të pushtetit në bazë të të drejtës së përgjithshme, të barabartë e të drejtpërdrejtë të votës dhe
- marrjen e cilitdo vendim në organet e pushtetit si dhe në ndërmarrje, institucione e organizata.

Neni 3.

Institucionet lituane, për forma të veçanta të arsimit dhe të shkollave të mesme, varësisht nga kërkesat dhe mundësitë (ekonomike), e me anë të bashkëpunimit me shtetin dhe organizatat publike, do të aftësojnë specialistë me qëllim që t'u përgjigjen nevojave të posaçme të kulturave etnike.

Në rastet kur kjo është e nevojshme, qytetarët e Lituanisë mund të dërgohen për studime në botën e jashtme.

Neni 4.

Në kancelaritë dhe organizatat në viset e banuara me numër të konsiderueshme të pjesëtarëve të pakicave, në punën e vet krahas gjuhës lituane do të shfrytëzojnë edhe gjuhën e atyre pakicave.

Neni 5.

Shenjat që shfrytëzohen në rajonet e përmendura në nenin 4 të këtij ligji mund të jenë në gjuhën lituane dhe në gjuhën që e përdorë pakica respektive.

Neni 6.

Përmendoret historike e kulturore të pakicave konsiderohen pjesë e trashëgimisë kulturore të Lituanisë dhe gjenden në mbrojtje të shtetit.

Neni 7.

Organizatave kulturore të pakicave kombëtare kanë të drejtë që sipas mënyrës së vet, të themelojnë institucione arsimore e kulturore. Shteti u jep ndihmë organizatave e institucioneve të cilat u shërbejnë pakicave për destinime arsimore e kulturore.

KONTRATAT
BILATERALE MBI POZITËN E MBI
PAKICAT KOMBËTARE
(Pjesë të zgjedhura)

**1. Kontrata midis Republikës së Hungarisë dhe Rumanisë
mbi mirëkuptimin, bashkëpunimin dhe fqinjësinë e mirë (1996)**

Neni 15.

(1) a. Palët kontraktuese pranojnë që, në rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të pakicave kombëtare të cilat jetojnë në territoret e tyre, të aplikojnë konventën suazë të Këshillit të Evropës mbi mbrojtjen e pakicave kombëtare, përpos, nëse sistemi i tyre juridik nuk përmban dispozita më të vulltshme në raport me pjesëtarët e pakicave kombëtare.

b. Me kusht që të mos sillen në dyshim përmbajtja e paragrafit të mësipërm, me qëllim të mbrojtjes dhe avancimit të identitetit etnik, kulturor, gjuhësor e fetar të pakicës rumune në Hungari, gjegjësisht të pakicës hungareze në Rumani, palët kontraktuese aplikojnë si obligim juridik dispozitat që kanë të bëjnë me të drejtat e këtyre personave ashtu siç është rregulluar kjo me dokumentet relative të Kombeve të Bashkuara, Organizatës për Bashkëpunimin dhe Sigurimin në Evropë dhe të Këshillit të Evropës, që gjenden në aneksin e kësaj kontrate.

(2). Në përputhje me këtë, palët kontraktuese konfirmojnë se persoant e përmendur në paragrafin e mësipërm kanë të drejtë, që individualisht ose në bashkësi me anëtarët e tejrë të grupit, të shprehin lirisht, të ruajnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre etnik, kulturor, gjuhësor e fetar. Në përputhje me këtë kanë të drejtë të formojnë dhe të mbajnë institucionet, organizatat dhe shoqatat e veta arsimore, kulturore e fetare të cilat kanë të drejtë të kërkojnë kontribute vullnetare financiare e tjera, si dhe mbështetjen publike në përputhje me legjislacionin e brendshëm.

(3) Palët kontraktuese respektojnë të drejtën e pjesëtarëve të pakicës hungareze në Rumani dhe të pakicës rumune në Hungari që privatisht e publikisht, me gojë e me shkrim, të shfrytëzojnë lirisht gjuhën e tyre amtare. Ato do të miratojnë masa të posaçme që këta persona të mund të mësojnë gjuhën e vet amëtare dhe të kenë mundësi adekuate të arsimit në këtë gjuhë në kuadër të sistemit arsimor të shtetit në të gjitha nivelet dhe të gjitha format, në përputhje me nevojat e tyre. Palët kontraktuese do të krijojnë kushte për përdorimin e gjuhës amëtare në raportet me organet lokale të pushtetit he të jurisprudencës në përputhje me dispozitat e brendshme juridike dhe detyrimet ndërkombëtare që i kanë pranuar të dyja palët. Kata persona kanë të drejtë të përdorimit të emrave e mbiemrave në gjuhën amëtare njihet zyrtarisht. Në territoret ku pjesëtarët e pakicave jetojnë në nuëmr të konsiderueshëm, të dy palët sigurojnë mundësi që emrat tradicionalë të lokaliteteve, rrugëve dhe të toponiemve të shkruhen edhe në gjuhën e pakicës.

(4) Palët kontraktuese respektojnë të drejtat e pjesëtarëve të pakicave kombëtare që në gjuhën e tyre amëtare t'u mundësohen informatat në mediat elektronike e të shkruara, si dhe e drejta për këmbimin dhe përhapjen e lirë të informatave. Palët kontraktuese, në kuadër të legjislacionit të brendshëm, do të lejojnë mundësinë e formimit dhe veprimit të mjeteve të tyre publike të iformacionit.

(5) Palët kontraktuese do t'u sigurojnë pjestarëve të pakicave të drejtën që, individualisht ose me anë të partisë apo organizatës së vet, të marrin pjesë aktive në jetën politike, ekonomike e shoqërore e kulturore, si dhe, që me anë të përfaqësuesve të tyre të zgejdhur në organet qëndrore e lokale të psuhtetit të marrin pjesë në zgjidhjen e çështjeve me interes shtetëror e lokal. Të dy palët kontraktuese, gjatë procesit të marrjes së vendimeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe forcimine identitetit kombëtar të këtyre persoanve, do t'i konsultojnë partitë politike, organizatat a shoqatat e këtyre personave në përputhje me procedurën demokratike të miratimit të vendimeve të parashikuara me ligj.

(6) Palët kontraktuese respektojnë trashëgiminë kulturore e historike të pakicave kombëtare e mbështesin përpjekejt për ruajtjen e përmendoreve kulturore e historike, të vendkujtimeve dhe do të marrin masa të duhura që në rajonet ku jeton popullata e përzier, shtetasit mund të njihen me vlerat kulturore hungareze e rumune.

(7) Palët kontraktuese repsketojnë të drejtat e pjesëtarëve të pakicave kombëtare që lirisht t'i mbajnë kontaktet mes veti dhe me qytetarët e shteteve tjera përtej kufirit të vendit të tyre, si dhe të marrin pjesë në aktivitetet e organizatave joqeveritare kombëtare e ndërkombëtare.

(8) Palët kontraktuese janë të pëlqimit që me rastin e aplikimit të të drejtave nga ky nen, secili pjesëtar i pakicës kombëare, si dhe cilido shtetas i atij vendi dueht patjetër të repsketojë ligjet e vendit dhe të drejtat e personave të tjerë. Këta persona kanë të drejta të njëjta si edhe shtetasit e tjerë të vendit ku jetojnë.

(9) Palët kontraktuese me kusht që të mos sillen në pikëpyetje masat e politikës së përgjithshme integruese, do të përmbahen nga politika e praktika e cila do të kishte për qëllim asimilimin e pjesëtarëve të pakicave kombëtare kundër vullnetit të tyre dhe do t'i mbrojnë këta persona nga të gjitha aktivitetet që kanë objektiv asimilimin e tillë. Ato gjithashtu do të përmbahen nga masat e tilla të cilat ndryshojnë raportin e popullatës në rajonet ku jetojnë pjesëtarët e pakicave kombëtare dhe kanë për qëllim kufizimin e të drejtave të tyre që dalin nga standardet ndërkombëtare dhe normat e numëruara në nenin 1 të kësaj kontrate.

(10) Palët kontraktuese i sigurojnë njëra-tjetrës mundësi të përcjellë realizimin e përmbajtjes së këti jneni të kontratës. Për këtë qëllim, në kuadër të konsultimeve të rregullta në bazë të nenit 5 të kësaj kontrate, do të shqyrtohen edhe çështjet bilaterale të bashkëpunimit lidhur me pakicat kombëtare, që dalin nga kjo kontratë dhe do të formohet komisioni ndërqeveritar i ekspertëve. Do të bashkëpunojë për funksionimin e mekanizmave përkatës të OSBE-së dhe të Këshillit të Evropës të cilat kontrollojnë realizimin e detyrimeve që i përmbajnë dokumentet e këtyre organizatave lidhur me pakicat kombëtare.

(11) Palët kontraktuese bashkëpunojnë për zhvillimin e mëtejëm të mbrojtjes së pakicave kombëtare. Janë pajtuar se, si pjesë e kësaj kontrate, do të aplikohen edhe dispozitat mbi mbrojtjen e pakicave kombëtare që do t'i përmbajnë dokumentet e këtyre organizatave lidhur me pakicat kombëtare.

(11) Palët kontraktuese bashkëpunojnë për zhvillimin e mëtejëm të mbrojtjes së pakicave kombëtare. Janë pajtuar se, si pjesë e kësaj kontrate, do të aplikohen edhe dispozitat mbi mbrojtjen e pakicave kombëtare që do t'i përmbajnë dokumentet ndërkombëtare me të cilat ato në të ardhmen do të obligohen.

(12) Asnjë detyrim nga ky nen nuk mund të interpretohet në mënyrën e cila do të jepte të drejtë për çdofarë veprimi apo kryerje të aktit që do të ishte në kundërshtim me objektivat dhe parimet e KB, me detyrimet tjera të së drejtës ndërkombëtare, me Aktin final të Helsinkit dhe Kartën e Parisit të KSBE-së, duke përfshirë këtu parimin e tërësisë tokësore të shtetit.

Aneksi:

Lista e dokumenteve që përmenden në nenin 15 paragrafi 1/b.

1. Dokumenti nga 29 qershori i vitit 1990 nga mbledhja e Konferencës mbi dimensionin njerëzor të KSBE-së në Kopenhagë;

2. Deklarata nga 18 dhjetori i vitit 1992 i Asamblesë së Përgjithshme të OKB mbi të drejtat që u takojnë pakicave kombëtare apo etnike, fetare apo gjuhësore (Rezoluta 47/135);

3. Rekomandimi 1201 (1993) i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës mbi protokolin shtojcë mbi pakicat kombëtare bashkë me Konventën evropiane mbi të drejtat e njeriut (Palët kontraktuese pajtohen se rekomandimi 1201 nuk ka të bëjë me të drejtat kolektive, e as që imponon obligimin që këtyre personave t'u ndahet e drejta për status special të autonomisë territoriale i cili do të bazohet në kriteret etnike).

2. Kontrata mbi fqinjësinë e mirë dhe bashkëpunimin miqësor midis Republikës Sllovaqe dhe Republikës Hungareze (1995)

Neni 15.

(1) Palët kontraktuese konfirmojnë se mbrojtja e pakicave kombëtare dhe e të drejtave e lirive të pjesëtarëve të tyre janë pjesë integrale e mbrojtjes ndërkombëtare të drejtave të njeriut dhe si të tilla bëjnë pjesë në sferën e bashkëpunimit ndërkombëtar, prandaj në këtë kuptim nuk bëjnë pjesë në të drejta të brendshme ekskluzive të ndonjë shteti, por njëkohësisht janë objekt i interesimit legjitim të bashkësisë ndërkombëtare. Palët kontraktuese vërejnë se bashkëpunimi i tyre në këtë fushë kontribuon në forcimin e marrëdhëneve të fqinjësisë së mirë, mirëkuptimit reciprok, të miqësisë e besimit midis shteteve të tyre dhe njëkohësisht, kontribuojnë në forcimin e sigurisë ndërkombëtare, të stabilitetit dhe të integritetit evropian.

(2) Lidhur me mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe të drejtave të pjesëtarëve të tyre, palët kontraktuese do të aplikojnë këto parime:

a. përkatësia pakicës kombëtare është çështje e deklaramit të lirë persoal, e në bazë të këtij deklarimi nuk mund të rezultojë kurrfarë hendikepi për personin në fjalë,

b. të gjithë persoant që u takojnë pakicave kombëtare janë të barabartë para gjyqeve dhe gëzojnë mbrojtjen e njëjtë juridike. Lidhur me këtë, do të ndalohet çdo diskriminim mbi baza të përkatësisë pakicës kombëtare,

c. pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtë që individualisht dhe në bashkësi me anëtrët e tjerë të grupit të tyre, të shprehin, ruajnë ose zhvillojnë identitetin e vet etnik, kulturor a fetar dhe ta ruajnë e zhvillojnë kulturën e vet në të gjitha aspektet e saj,

d. duke konfirmuar politikën e vet të përgjithshme të integritetit, palët kontraktuese do të përmbahen nga politika dhe praktika që ka për qëllim asimilimin e pjesëtarëve të pakicave kombëtare kundër vullnetit të tyre, dhe do t'i mbrojnë këta persona nga çfarëdo aksioni që ka për qëllim asimilimin e tillë. Palët do të përmbahen nga masat që ndryshojnë raportin e popullatës në rajonet e banuara me pjesëtarë të pakicave kombëtare dhe që synojnë kufizimin e të drejtave dhe lirive të tyre të cilat do të ishin të dëmshme për pakicat kombëtare;

e. pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtë që, në përputhje me ligjin e me qëllim të ruajtjes, zhvillimit dhe avancimit të identitetit të vet, të formojnë dhe të drejtojnë orgaizatata e shoqatat e veta, duke përfshirë edhe partitë politike, si dhe entet arsimore, kulturore e fetare. Të dy qeveritë, në këtë kuptim, do të krijojnë hapësirë adekaute ligjore;

f. personat që u takojnë pakicave kombëtare kanë të drejtë për pjesëmarrje efektive në vendimet e nivelit kombëtar, dhe, atje ku zgjidhja e tillë është adekuate, edhe në nivelin rajonal e lokal që ka të bëjë me pakicat në formën e cila nu kështë në kundërshtim me ligjshmërinë e vendit;

g. personat që i përkasin pakicës kombëtare hungareze në Republikën e Sllovakisë dhe ata që i përkasin pakicës kombëtare sllovaqe në Republikën e Hungarisë, kanë të drejtë të shfrytëzojnë individualisht ose bashkë me anëtrët e tjerë të grupit të tyre, verbalisht e me shkrim, gjuhën e vet të pakicës, publikisht dhe privatisht. Gjithashtu kanë të drejtë të shfrytëzojnë, në përputhje me ligjet e vendit dhe detyrimet ndërkombëtare që i kanë marrë të dypalët gjuhën e vet të pakicës në kontaktet me autoritet, drejtuese, administratën publike, në kontestet gjyqësore, që t'i shprehin emrat e qyteteve ku jetojnë, emrat e rrugëve dhe të hapsirave të tjera publike, të toponimeve, njoftimet he informacionet në gjuhën e pakicës, t'i paraqesin emrat e mbiemrat në gjuhën e vet, të kenë mundësi të njëjta në sistemin arsimor të shtetit, dhe që, nëse kjo nuk shkon në dëm të mësimimit të gjuhës zyrtare dhe të mësimimit në gjuhën zyrtare, të kenë mësimin nëgjuhën e tyre amtare, të drejtën e pranisë në mediat publike pa diskriminim dhe të drejtën për mjetet e veta të informimit publik. Palët kontraktuese, në përputhje me

detyrimet e veta ndërkombëtare, marrin të gjitha masat e domosdoshme ligjore, administrative e tjera për aplikimin e të drejtave të përmendura më sipër, pos nëse sistemi i tyre ekzistuese igjor tanimë nuk i përmban këto dispozita;

h. në përputhje me pikën c. të kësaj alineje ato do t'u krijojnë kushte pjesëtarëve të pakicave kombëtare që të ruajnë përmendoret e veta arqitektonike e të tjera dhe vendet tjera që paraqesin trashëgiminë, historinë dhe traditën e tyre,

(3) Palët kontraktuese janë marrë vesh që personat të cilët u takojnë pakicave kombëtare do të kenë të drejta dhe detyrime të barabarta, që dalin nga shtetësia, si edhe qytetarët e tjerë të shtetit në fjalë.

(4) Palët kontraktuese:

a. deklarojnë se lidhur me të drejtat dhe detyrimet e pjesëtarëve të pakicave kombëtare që jetojnë në territorin e tyre do të zbatojnë konventën suazë për mbrojtjen e pakicave kombëtare të cilën të dyja palët e kanë nënshkruar me 1 shkurt të vitit 1995, pos nëse sistemi i tyre i brendshëm juridik nuk siguron mbrojtjen me të gjerë pjesëtarëve të pakicave kombëtare nga konventa suazë, nga momenti kur palët kontraktuese e ratifikojnë këtë marrëveshje dhe konventën suazë,

b. me kusht që të mos sjellë në dyshim përmbajtjen e paragrafit të mëparshëm dhe në interes të mbrojtjes së personave të cilët i takojnë pakicës hungareze në Sllovaki dhe pakicës sllovaqe në Hungari, palët kontraktuese do të aplikojnë normat dhe detyrimet politike që i përmbajnë këto dokumente:

- Dokumenti nga mbledhja e KSBE-së në Kopenhagë i Konferencës mbi Dimensionin Njerëzor të KSBE-së, 9 qershor 1990;

- Deklarata e Asamblesë së Përgjithshme numër 47/135 mbi të drejtat e personave që u takojnë pakicave kombëtare a etnike, fetare a gjuhësore;

- Rekomandimet e Asamblesë parlamentare të Këshillit të Evropës, numër 1201 (1993), të cilat respektojnë të drejtat individuale të njeriut, duke përfshirë të drejtat e pjesëtarëve të pakicave kombëtare.

(5) Asgjë në këtë nen nuk do të interpretohet ashtu që të nënkuptojë cilëndo të drejtë të përfshirjes në aktivitete apo veprime të kundërta me parimet themelore të së drejtës ndërkombëtare, veçmas të barazisë sovrane, tërësisë territoriale dhe të pavarësisë politike të shtetit.

(6) Palët kontraktuese do të bashkëpunojnë mes veti në aplikimin e këtij neni. Ato, në përputhje me këtë, do të shqyrtojnë se si të këmbëjnë përvojat lidhur me aplikimin e këtij neni në kuadër të bashkëpunimit reciprok për të cilën flet neni 5 i kontratës në frymën e marrëveshjes dhe të mirëkuptimit reciprok. Me këtë qëllim ato do të formojnë komisionin e përbashkët ndërqeveritar i cili do të kishte të drejtë të jap rekomandime, dhe anëtarët e të cilit do t'i emëronin palët kontraktuese atëherë kur këtë ta konsiderojnë të nevojshme. Me rastin e mbikëqyrjes së aplikimit të detyrimeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e pakicave kombëtare, palët kontraktuese do t'i aplikojnë normat e Këshillit të Evropës dhe të Organizatës për Sigurim e Bashkëpunim në Evropë të cilat i obligojnë të dy palët.

DOKUMENTET
MBI KRIZËN NË REPUBLIKËN
SOCIALISTE FEDERATIVE TË
JUGOSLLAVISË
(Pjesë të zgjedhura)

1. PROPOZIMI I MARRËVESHJES PËR ZGJIDHJEN E PËRGJITHSHME NË
KONFERENCËS NDËRKOMBËTARE MBI JUGOSLLAVINË, NË HAGË
(NËNTOR 1991)

Të drejtat e njeriut dhe të drejtat e grupeve etnike e nacionale

(PJESA E DYTË)

a. Të drejtat e njeriut

1. Republikat do t'i garantojnë këto të drejta të njeriut:

a. të drejtën për jetë

b. të drejtën e njeriut që të mos i nënshtrohet torturës ose sjelljeve johumane a oshtëruese,

c. të drejtën e njeriut që të mos i nënshtrohet robërisë ose punës së dhunshme,

d. të drejtën e lirisë,

e. të drejtën e njeriut që nga gjyqi joanues të merret në pyetje me respekt dhe publikisht dhe të mos i nënshtrohet ndjekjes retrospektive penale,

f. të drejtën për respektimin e jetës private e familjare, të banesës e të korrespondencës,

g. të drejtën e mendimit të lirë, të ndërgjegjës e të besimit fetar,

h. të drejtën e shprehjes së lirë,

i. të drejtën e tubimit të qetë dhe të bashkimit të lirë,

j. të drejtën për lidhjen e kurorës dhe formimin e familjes,

k. të drejtën në këshilla efikase juridike të caktuar me ligj dhe të mundshme për të gjithë persoat të drejtat njerëzore të të cilëve janë shkelur,

1. të gjitha të drejtat tjera të parashikuara me instrumente të përmendura më poshtë, që i nënshtrohen vetëm përjashtimeve dhe kufizimeve të përcaktuara në ato instrumente, por pa diskriminimin mbi çfarëdo baze, siç janë seksi, raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, bindja politike a tjetër, prejardhja kombëtare a etnike, lidhja me pakicën kombëtare, statusi pronësor, statusi për nga lidhja apo statusi tjetër.

Instrumentet që përmenden më lart janë këta:

- Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut, Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Qytetare e Politike, Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore të Kombeve të Bashkuara;

- Dokumenti final i Konferencës mbi Sigurimin e Bashkëpunimin në Evropë, Karta e Parisit për Evropën e re dhe dokumentet e KSBE-së që kanë të bëjnë me dimensionin e njeriut, veçmas dokumentet e mbledhjes së Kopenhagës të Konferencës mbi Dimensionin Njerëzor të KSBE-së dhe dokumenti i takimit të Moskës së Konferencës mbi Dimensionin Njerëzor të KSBE-së;

- Konventa e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut e të lirisë themelore dhe protokolli i kësaj Konvente.

b. Të drejtat e pjesëtarëve të grupeve nacionale ose etnike

2. Republikat do të garantojnë të drejtat e njeriut që vlejné për grupet nacionale ose etnike e që i përmbajnë:

- instrumentet e Kombeve të Bashkuara, KSBE-së dhe të Këshillit të Evropës që përmenden në paragrafin 1 të këtij neni;

- konventat mbi likuidimin e diskriminimit racor, Konventa mbi Pengimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit dhe Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, e Kombeve të Bashkuara;

- raporti i miratuar në mbledhjen e ekspertëve të KSBE-së mbi pakicat kombëtare, që është mbajtur në Gjenevë.

Duke e vënë në fuqi këtë Konventë, ato gjithashtu do të shfaqin kujdes adekuat për:

- propozimet mbi Dekalratën e Kombeve të Bashkuara lidhur me të drejtat e personave që u takojnë pakicave nacionale, etnike, fetare e gjuhësore.

propozimin mbi konventën për mbrojtjen e pakicave të Komisionit Evropian për Demokraci e Drejtësi në kuadër të Këshillit të Evropës.

3. Republikat do tu garantojnë personave të cilët u takojnë grupeve nacionale ose etnike këto të drejta:

- parimin e mosdiskriminimit ashtu sikurse është i formuluar në instrumentet juridike të përmendura në paragrafin 2 të këtij neni;

- të drejtën për mbrojtjen nga çdo aktivitet i cili mund të rrezikojë ekzistencën e tyre;

- të gjitha të drejtat kulturore, ashtu sikurse janë përcaktuar në instrumentet e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni, posaçërisht të drejtën për identitet, kulturë, besim fetar, përdorimin e gjuhës e të shkrimit si në jetën publike ashtu edhe në atë privat dhe të drejtën për arsimim;

- të drejtën e pjesëmarrjes së barabartë në punët e tilla publike siç janë ushtrimi i lirisë politike e ekonomike në sferën sociale në mjetet e informacionit dhe në sferën e arsimit dhe të çështjes kulturore në përgjithësi;

- të drejtën e individit që të vendos se cilit grup kombëtar apo etnik dëshiron t'i takoj dhe të ushtrojë të gjitha të drejtat që dalin nga kjo zgjedhje si individ apo i bashkuar me tjerët.

Vendimi i personit që ti takoj apo mos i takoj grupit kombëtar a etnik nuk guxon të ketë pasoja.

Kjo e drejtë do të vlejë posaçërisht në rastet e kurorëzimeve midis personave që u takojnë grupeve të ndryshme nacionale apo etnike.

Atyre personave që i takojnë grupit të njejtë nacional ose etnik e jetojnë ndaras nga personat me prejardhje të njejtë bie fjala në katundet e izoluar duhet tu garantohet vetëqeverisja në masën në të cilën kjo është e realizuar.

Parimet e sipërpërmendur duhet gjithashtu të vlejnjë edhe në ato fusha ku pjesëtarët e grupit kryesor nacional ose etnik të republikës janë numerikisht inferior karshi një grupi apo grupit tjetër nacional ose etnik në atë rajon.

4. Përpos të drejtave të prezantuara në paragrafin 3 të këtij neni personave që i takojnë grupit nacional ose etnik të cilët paraqet përqindje të rëndësishme të popullatës në republikën ku jetojnë por nuk e përbëjnë shumicën republikane do tu garantojë të drejtën e përgjithshme të pjesëmarrjes së pjesëtarëve të këtij grupi në punët publike dukepërfshirë pjesëmarrjen në qeveritë e republikave, lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me ta.

c) Statusi special

5. Përpos kësaj, statusin special të autonomisë do ta gëzojnë ato rajone ku personat të cilët i takojnë grupit nacional apo atnik paraqesin shumicën:

a) e drejta për të poseduar dhe ngritur simbolet kombëtare të atij rajoni;

b) sistemi i arsimit i cili shfaq kujdes për vlerat dhe nevojat e atij grupi;

c) I. trupi ligjdhënës (legjislativ)

II. strukturën administrative, duke përfshirë forcat rajonale policore;

III. dhe gjyqet që do të ishin përgjegjës për çështjet në këtë sferë dhe që shprehin përbërjen e popullatës në atë rajon;

d) dispozitat për kontrollin përkatës ndërkombëtar.

Këto fusha janë shënuar në aneksin A...

5A. Këto rajone nëse nuk janë caktuar pjesërisht me kufijtë ndërkombëtar me shtetin i cili nuk

është palë në këtë Konventë duhet të çmilitarizohen përgjithmonë dhe në to nuk do të lejohet prania e kurrfar force ushtarake, kurrfarë stervitje, apo aktivitet në tokë ose në ajër.

5B a) Republikat duhet të mundësojnë kontrollin ndërkombëtar të aplikimit të statusit të veçantë të autonomisë. Për këtë qëllim ato duhet të lidhin marrëveshje me çka një organ permanent ndërkombëtar i mundësohet kontrollimi i aplikimit të këtij paragrafi.

b) Komisionet e kontrollit të formuar në atë formë lypset të paraqesin raporte republikave të interesuara si dhe palëve të tjera të marrëveshjes dhe të formulojnë rekomandimet lidhur me zbatimin e këtij statusi (special);

c) Republikat duhet t'i jetësojnë në vepër këto rekomandime me anë të dispozitave ligjore apo në ndonjë formë tjetër. Në rast të kontekstit, Gjyqi për të Drejtat e Njeriut do të marrë vendimin lidhur me këtë

d) Dispozitat e përgjithshme

7. Personat që i takojnë grupit nacional apo etnik me rastin e zatimit të të drejtave të tyre duhet të respektojnë të drejtat e shumicës dhe të personave që u takojnë grupeve tjera.

8. Republikat duhet që veç e veç ose bashkarisht nëse tregohet nevoja të bëhet pjesë përbërëse të instrumenteve ndërkombëtare në sferën e të drejtave të njeriut përfshirë të gjitha procedurat përkatëse për ushtrimin e ankesës.

9. Republikat duhet që me anë të dispozitave ligjore dhe institucioneve kombëtare, e në përputhje me të drejtat që përmenden në këtë ligj të mundësojnë zbatimin e plotë të të drejtave për shkeljen e cilës do nga këto të drejta.

10. Meqë asnjëra republikë nuk do të ketë popullatën homogjene etnike, ajo do të bashkëpunojë dhe konsultohet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo meqë në të komisionit të përzier, në harmoni me çështjet për të cilat u bë fjalë në paragrafët 3 deri 5 të këtij neni.

2. PLANI Z-4

Projektmarrëveshja mbi Krainën, Sllaveninë, Branjen Jugore dhe Sremin Perëndimore

PJESA E PARË

MARRËVESHJA KUSHTETUESE PËR KRAINËN

KREU 1: THEMELIMI I KRAINËS SERBE

Neni I: 1. Kufijtë

1. Do të themelohet Kraina Autonome Serbe (në tekstin e mëtejshëm "Kraina") nga territoret e caktuara në hartën e ankesit A.1

2. Në çdo moment pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, kufijtë e Krainës mund të ndryshohen në marrëveshjes me republikën e Kroacisë (që duhet të caktohet me normat përkatëse ligjore) dhe organet legjislativ të Krainës. Në periudhën prej gjashtë muajve nga ditat e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, Komisioni për zbatimin i formuar në bazë të Paragrafit 2. të nenit XVIII është autorizuar për t'i ndryshuar kufijtë në gjatësinë jo më shumë se 2 km. në raport me hartën 1 në aneksin A dhe me kusht që të veprojë në bazë të konsensusit të arritur midis qeverive të Republikës së Kroacisë dhe të Krainës.

3. Midis Krainës dhe pjesëve të tjera të Republikës së Kroacisë nuk do të ketë kontroll kufitar

Neni I: 2. Aplikimi i ligjeve dhe i dekreteve të qeverisë

1. Ligjet e miratuara në Saborin e Kroacisë do të aplikohen në Krainë vetëm në masën në të cilën bëjnë pjesë kompetencat ekskluzive të qeverisë qendrore, sikurse që është saktësuar në paragrafin 1, të nenit II. 1 nëse janë bartur në atë qeveri në harmoni me Paragrafin 3 të nenit të njejtë ose në qoftë i ka konfirmuar organi ligjdhënës i Krainës.

2. Kushtetuta e Republikës së Kroacisë dhe të gjitha ligjet e aplikuara për Krainën në harmoni me paragrafin 1 do të zbatohen e aplikohen me besnikëri nga ana e organit kompetent të Qeverisë së Krainës.

3. Të gjitha procedurat që i marrin organet përgjegjëse të qeverisë së Republikës së Kroacisë qeveria e Krainës do t'i pranojë si valide, dhe të gjitha procedurat që i marrin orgaet përgjegjëse të qeverisë së Krahinës qeveria e Republikës Kroacisë do t'i pranojë si të vlefshme.

Neni I: 3. Flamujt dhe stemat

1. Kraina mund të miratojë stemën dhe flamurin që mund të nxirren në territorin e saj, përfshirë të gjithë kufijt e saj në përputhje me ligjet që i ka miratuar Kuvendi i Krainës.

2. Flamuri dhe stema e Republikës së Kroacisë mund të çitën në territorin e Krainës në objektet ku janë të vendosura institucionet e pushtetit kroat, si dhe në kufijt ndërkombëtar.

3. Individët në cilën do pjesë të territorit të Republikës së Kroacisë, janë të lirë për ta nxjerrë stemën dhe flamirin e Republikës së Kroacisë dhe të Krainës.

Neni I: 4. Gjuha

1. Kuvendi i Krainës mund të mundësojë përdorimin e gjuhës serbe dhe të shkrimit cirilikë me kusht që interesat e pakicave në Krainë të janë plotësisht të mbrojtura në harmoni me kaptinën XI.

Neni I: 5. Domicili

1. Secili qytetar i Republikës së Kroacisë me vendqëndrim të përhershëm në Krainë ka të drejtë që nga qeveria e Krainës të marrë dokumentacionin i cili dëshmon për të dhe i cili do të jepet në harmoni me normat e darkoduara me qeverinë e Republikës së Kroacisë.

A: Ky territor do të jetë territor unik i padërprerë i përbërë nga provincat me shumicë serbe në kuadër të zonave nën mbrojtjen e KB (UNAP) sektori Veri dhe sikurse që është definuar me regjistrimin e popullatës me 1991, duke respektuar faktorët gjeografikë dhe ekonomikë.

II: NDARJA E AUTORIZIMEVE MIDIS KUSHTEVE QENDRORE E KRAHINORE LIDHUR ME KRAINËN*Neni II: 1. Ndarja e përgjithshme*

1. Qeveria e republikës së Kroacisë (këtu "pushteti qendror") lidhur me Krainën do të ketë autorizime ekskluzive me sa vijon me përjashtim nëse nuk është saktësuar ndryshe ose nuk lejohet me marrëveshjen e tashme:

a) Udhëheqjen e politikës së jashtme duke marrë parasysh

Neni II: 2;

b) Mbrojtjen e republikës së Kroacisë nga kërcënimet e jashtme;

c) Shtesinë e Republikës së Kroacisë sipas nenit XI;

d) Rregullimin me kusht se Kraina nuk do të jetë e parabartënë raport me pjesët tjera të Kroacisë;

I) tregëtinë ndërkombtare përfshirë edhe doganën;

II) tregëtinë e brendshme nëpërmjet kufijve të Krainës përfshirë shfrytëzimin e drejtimeve kryesore të rrugëve dhe hekurudhave;

III) financat;

IV) pronat intelektuale;

V) standardet e prodhimeve;

VI) komunikacionet;

e) editimin dhe kontrollin e parave, sipas nenit II. 3);

f) ndarjen e frekuencave për radio, televizion dhe qëllime tjera me kusht që Krainës t'i ndahen të paktën aq frekuenca sa i shfrytëzon momentalisht dhe të paktën për një stacion televiziv;

g) Punët postare;

h) Mbrojtjen e ambientit të jetesës, me përjashtim të suazës e cila i kalon kufijtë e Krainës.

2. Autoritetet e Krainës do t'i kenë të gjitha autorizimet të cilat nuk janë përfshirë me paragrafin e mësipërm 1, e veçmas më sa vijon përveç nëse nuk është saktësuar ndryshe ose është lejuar me marrëveshje:

a) arsimit;

b) kultura;

c) ndërtimi i banesave;

d) shërbimi publik;

e) biznesi;

f) aktivitetet vullnetare;

g) energjia;

h) disponimi lokal i tokës;

i) mbrojtja e ambientit të jetës së Krainës në harmoni me e nënparagrafin 1 (h);

j) resurset natyrore;

k) radio dhe televizioni;

l) mbrojtja sociale;

m) turizmi;

n) vërtetimet mbi domiciliun në krahinë, në harmoni me nenin 1, 5;

o) formimi i korporatave dhe i personave të tjerë juridikë;

p) policia, në harmoni me kapitullin VI;

q) politika tatimore, në harmoni me nenin II, 4.

Autoritetet qendrore dhe krahinore mund të merren vesh përkëmbimin reciprok të përfaqësuesve të vet pse për administratën e koordinimin e përbashkët për secilin nga autorizimet e përmendura. Për këtë qëllim mund të formojnë komisione të përbashkëta.

*Neni II, 2***Marrëveshjet dhe përfaqësitë ndërkombëtare**

1. Qeveria e Krainës mund të lidhë marrëveshje lidhur me arsimin, kulturën, aktivitetet bëmirese, radiotelevizionin dhe turizmin, me entitetet tjera ose shtetet me popullatë predominuese serbe dhe mund të lidh marrëveshje tregtaree afariste me entitete e tilla ose me shtetet që i nënshtrohen paragrafeve 1 (d) (I-II)

Neni II.1

Me kusht që të gjitha ato marrëveshje të mos jenë në kundërshtim me interesat e Republikës së Kroacisë.

2. Qeveria e Krainës mund të lidhë edhe marrëveshje tjera ndërkombtare me lejen e Qeverisë qëndrore, e cila (leje) nuk do të pengohet pa arsyetim

3. Qeveria e Krainës mund t'i dërgojë përfaqësuesit e vet në shtetet dhe organizatat ndërkombëtare.

Neni II.3

1. Banka qendrore e Kroacisë do të emetojë para speciale (momenta edhe prej letre e prej metali) për Krainën, vlera e të cilave do të jetë e barabartë me valutën që e emeton për pjesën tjetër të Republikës së Kroacisë emrin dhe formën e të cilës do ta përcaktojë qeveria e Krainës.

2. Nga bankat dhe institucionet tjera financiare anembanë republikës së Kroacisë do të kërkohet që t'i pranojnë të dy format e valutës që i emërton Banka Qendrore e Kroacisë. Mjeti ligjor i pagesave në suazat e Kroacisë do të jetë paraja e emtuar për Krahinën kurse për pagesa në kuadër të pjesëve të tjera të Kroacisë do të jetë valuta tjetër të cilën e emeton banka Qendrore. Individët në harmoni me kontratat dhe nevojat tjera do të jenë të përdorin cilëndo formë ose të dy format e valutave të tilla.

Neni II.4.

1. Qeveria qendrore nuk do të fusë, kurse qeveria e Krainës mund të fusë tatime në:

- a) pronën e cila gjendet në Krainën (duke përfshirë tatimet në patundshmëritë dhe trashëgimitë);
- b) transaksionet që zatohen në kuadër të Krainës (përfshirë shitjen tatimqarkullimin dhe mallrat që hynë në qytet);
- c) fitimet të cilat personat e vendit që jetojnë në Krainën i kanë realizuar në Krainë (përfshirë tatimet e sigurimit social);
- d) fitimet që në Krainë i kanë realizuar personat juridike të formuara sipas ligjeve të Krainës.

2. Qeveria qendrore dhe Qeveria e Krainës mund të lidhin marrëveshje për të penguar ose pakësuar shmangien e pagimit të tatimit dhe tatimin e dyfishtë konsekuentë me kushtet dhe paragrafin 1.

3. Qeveria qëndrore dhe Qeveria e Krainës mund të lidhin marrëveshje për bartjen reciproke nga njëra në tjetrën, të çfarëdo autorizimi për tatime që i mbanë paragrafin 1. dhe për transferin përkatës të përgjegjësi të qeverive sipas paragrafit 3.

*Neni II.1.***KREU III****STRUKTURA E QEVERISË SË KRAINËS***Neni III.1***Legjislacionet**

1. Organet legjislative të Krainës do të zgjidhen demokratikisht mbi baza proporcionale në periudhën prej katër vitesh. Të gjithë qytetarët e Republikës së Kroacisë që banojnë në Krainë të cilët janë më të vjetër se 18 vjeç mund të votojnë në zgjedhjet për organet legjislative dhe mund të jenë kandidatë për vende në organet legjislative.

2. Organet legjislative mund të miratojnë ligje të cilët kanë të bëjnë me:

- a) gjërat që janë në suazat e përgjegjësisë së Qeverisë së Krainës;
- b) organizimin e funksionimit e të gjithë organeve të qeverisë së Krainës përfshirë të gjitha aranzhmanet e domosdoshme buxhetore dhe mbledhjen e tatimeve përkatëse.

*Neni III.2.***Kryetari**

1. Kryetari i Krainës do të zgjidhet demokratikisht në periudhën prej pesë vitesh. Të gjithë qytetarët e Republikës së Kroacisë që banojnë në Krainë, të cilët janë më të vjetër se 18 vjeç, mund të votojnë në zgjedhjet për kryetar dhe mund të jenë kandidatë për atë pozitë.

2. Kryetari i Krainës do të jetë përgjegjës për kryerjen:

a) e atyre dispozitave të kësaj Marrëveshjeje që janë në suazat e përgjithsisë së qeverisë së Krainës;

b) e të gjitha ligjeve e dekreteve të Qeverisë qëndrore që kanë të bëjnë me Krainën;

c) e të gjitha ligjeve që i kanë miratuar organet legjislative të Krainës;

d) e të gjitha dekreteve që i shpallë kryetari i Krahinës;

3. Kryetari i Krainës mund të shpallë dekrete të lejuara me ligjet e qeverisë qëndrore të cilat aplikohen në Krainë ose të miratuara sipas ligjit nga organet legjislative të Krainës.

4. Kryetari i Krainës do t'i emërojë ministrat sipas ligjeve të miratuara nga organet legjislative të Krainës, të cilët do t'i verifikojnë ato organe legjislative dhe të cilët do të kenë detyrë përgjegjësi e autorizime të parashikuara me ato ligje.

Secili ministër mund të largohet në çdo moment nga ana e kryetarit dhe do të eliminohet ashtu që organet legjislative do të votojnë për mosbesimin. Ministrat do të formojnë kabinetin e Krahinës i cili do të mbledhet nën kryesinë e ministrit të cilin do ta caktojë kryetari dhe i cili do të ketë detyra përgjegjësi dhe autorizime të parashikuara me ligj ose me dekret.

*Neni III.3.***Gjyqet**

1. Pushteti gjyqësor në Krainë do të themelohet në gjyqet e shkallës së parë dhe në gjyqe të atilla të apelacionit të cilat do të caktohen me ligjet e miratuara nga organet legjislative të Krainës, e të cilët (ligje) do të caktojnë juridiksionin adekat të këtyre gjyqeve si dhe rrogat dhe kushtet tjera të shërbimit të gjyqtarëve. Gjyqtarët e të gjitha gjyqeve në Krainë do t'i emërojë Kryetari i Krainës kurse do t'i verifikojë shumica në organet legjislative dhe ato do të shërbejnë deri në moshën 70-vjeçare, përpos nëse nuk japin dorëheqje ose nuk largohen për shkak të ndonjë aryeje për çka do të vendosin gjyqtarët e gjyqit të njejtë me konsensus.

2. Vendimet e gjyqeve të aplacionit të Krainës mund t'i paraqiten degës speciale të Gjyqit Suprem të republikës së Kroacisë, anëtarët e të cilit do t'i emëroj kryetari i Gjyqit Special Kushtetues midis gjyqtarëve të Gjyqit Suprem të Republikës së Kroacisë dhe të gjyqit më të lartë të apelacionit të Krainës me konsultime me kryetarin e Këshillit Suprem të Drejtësisë të Kroacisë dhe kryetarit e cilitdo organ përkatës në Krainë.

*Neni III.4.***Pavarësia e nënpunësve**

Asnjë anëtar apo nënpunësi të organeve legjislative, kryetarit, ministrave, gjyqtarëve ose cilitdo organ tjetër të qeverisë së Krainës nuk do t'i nevojitet leja e cilitdo shërbim apo organi të qeverisë

qëndrore për emërimin e tyre dhe asnjë nëpunës ose organ i tillë nuk mund ta heq cilindo anëtar, nëpunës ose zyrtar të qeverisë së Krainës pasi që ata do të mund të heqen nga ana e Gjyqit Special Kushtetues në rast të denimit për krime e që nënkupton burgosjen.

Neni III. 5.

Aranzhmanet kalimtare

1. zgjedhjet e parashikuara në paragrafin 1, të nenit III. 1. dhe në paragrafin I të nenit III. 2. do të mbahet më së voni një vit pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Për periudhën kalimtare derisa nuk mbahen zgjedhjet e përmendura në paragrafin 1, por asesi më vonë se një vit pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje funksionet e organeve dhe të nëpunësve të parashikuar me nenin III. -1-3, do t'i kryejnë organet dhe shërbimet përkatëse të cilët tani i ushtrojnë këto funksione në Krainë.

KREU IV

PJESMARRJA E KRAINËS NË QEVERINË QENDRORE

Neni IV.1.

Zgjedhjet

1. Qytetarët e Republikës së Kroacisë me banim me Krainë do të marrin pjesë në të njëjtën mënyrë si edhe të gjithë qytetarët tjerë në zgjedhjen e anëtarëve të qeverisë qëndrore duke përfshirë edhe zgjedhjet për Saborin e Kroacisë dhe të Presidentit të Republikës.

2. Për qëllimet e zgjedhjeve për Dhomen e Zhupanit të Kuvendit të Kroacisë Kraina do të përbëhet nga dy rrethe kufijsh dhe emërimet e të cilave do t'i caktojnë organet legjislative të Krainës.

3. Deri në zgjedhjet e reja për Saborin e Kroacisë organet legjislative të Krainës do të emërtojnë dhjetë anëtar në Dhomen e Përfaqësuesve të Saborit (Kuvendit) dhe nëntë anëtarë për Dhomen e Zhupanive.

4. Të gjithë personat që shërbejnë në cilindo dhomë të Saborit të Kroacisë e të cilët deklarohen si serbë për nga nacionaliteti do ta përbëjnë këshillin serb në Sabor (Kuvend).

Neni IV.2.

Emërimi në shërbimete qeverisë qëndrore

Me rastin e emërimeve në çfarëdo shërbimi ose në çfarëdo pozite në qeverinë qëndrore, duke përfshirë edhe ato të ministrave të gjyqtarëve, qytetarëve e Republikës së Kroacisë që janë serbë me banim në Krainë do të trajtohen mbi baza të njëjta si edhe të gjithë qytetarët tjerë të Kroacisë dhe ky përfaqësim sipas vendimit të banimit do të prezentohet në shërbimet dhe në pozitat në proporcion adekuat që e përbën midis të gjithë qytetarëve. Të paktën një anëtarë i qeverisë së Krainës do të emërohet anëtar i Qeverisë qëndrore.

Ndonëse termi kroat për "rrethin" është "zhupania", Qeveria e Krainës nuk do të jetë e detyruar ta shfirtëzojë këtë term të dytë.

Në harmoni me paragrafin 2. të nenit IV, Kraina do të ketë gjashtë anëtar në Dhomen e Zhupave; aranzhmani i përkohshëm i propozuar këtu do të shtojë përkohësisht dy vende për sektorin lindje dhe një vend për sektorin Perëndim.

Ky kusht i përgjigjet paragrafit të fundit të nenit 18 të Ligjit Kushtetues mbi të Drejtat e Njeriut etj. të Kroacisë.

KREU V

ÇMILITARIZIMI

Neni V.1.

Çmilitarizimi i Krainës

1. Krahinë nuk do të formojë, mbajë ose të lejojë formimin e çfarëdo forcash ushtarake.

2. Çmilitarizimi i Krainës do të fillojë jo më vonë se tri vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe do të përfundojë jo më vonë se pesë vjet pas hyrjes në fuqi të të njëjtës. Të gjitha armët e larguara nga Krainat do të asgjësohen nga ana e Unproforit ose nën mbikëqyrjen e tij.

3. Përpos në rastin e parashikuar në paragrafin 3, të nenit V, 2, forcat ushtarake të qeverisë qëndrore nuk do të hyjnë në cilën do pjesë të Krainës përveç në bazë të thirrjes speciale të Kryetarit të Krainës.

Neni V.2.

Kufiri me Bosnjën e Hercegovinën

1. Qeveria e Republikës së Kroacisë do të orvatet të lidhë marrëveshje me autoritetet përkatëse në Bosnjë e Hercegovinë për çmilitarizimin e kufirit të tyre të përbashkët.

2. Gjithnjë derisa një marrëveshje e tillë mbi çmilitarizimin e Bosnjës e Hercegovinës nuk lidhet Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara mund të vendos per sistemimin e forcave të Kombeve të Bashkuara në pjesën e kufijve që e përbëjnë kufirin me Krainën. Me lejen e qeverisë së Republikës së Kroacisë dhe të Qeverisë së Krainës në pjesën e atij kufiri mund të sistemohen forca të organizatave tjera ndërkombëtare ose të shteteve.

3. Nëse nuk është e mundur të arrihet qoftë çmilitarizimi ose sistemimi i çfarëdo forcash ndërkombëtare ose të huaja në cilën do pjesë të kufirit kroat në pjesën e Krainës me Bosnjën e Hercegovinën, Qeveria e Republikës së Kroacisë mund t'i sistemojë forcat e veta ushtarake përgjatë pjesës së tillë të kufirit me kusht që ato forca të mos sistemohen më thellë se pesë kilometra nga kufiri ndërkombëtar.

KREU VI

FORCAT POLICORE TË KRAINAVE

Neni VI.1.

Policia e rregullt

1. Forcat policore të Krainës do të themelohen në harmoni me Krainën dhe do të jenë nën kontrollin e kryetarit të Krainës dhe të ligjeve të miratuara nga organet legjislative me anë të ministrit të cilit e cakton Kryetari.

2. Përbërja etnike e forcave policore do të shprehë përbërjen e popullatës së Krainës, ashtu çfarë ka qenë gjatë regjistrimit të vitit 1991, derisa të mos përfundojë regjistrimi i ardhshëm në mbarë vendin, dhe çfarëdo njësie policore e stacionuar në bashkësitë e veçanta do të shprehë përbërjen etnike të atyre bashkësive.

3. Forcat policore do të jenë të pajisura me armatim dhe automjetet të tipit të njëjtë ose përkatës çfarë i shfrytëzon policia në pjesët tjera të Republikës së Kroacisë.

Neni VI.2.

Policia kufitare.

Stacionet në vendkalimet zyrtare përgjatë kufirit të Krainës me Bosnjën e Hercegovinën do të plotësohen me polici kufitare të Republikës së Kroacisë. Patrullat përgjatë këtij kufiri do t'i kryejnë njësitë e përbashkëta të policisë kufitare kroate e të Krainës.

PJESA E DYTË

**ARANZHMANET QË KANË TË BËJNË ME SLLAVONINË,
BARANJEN JUGORE, SREMIN PERENDIMOR DHE ME RAJONET TJERA**

KREU VII

ADMINISTRIMI

Neni VII.1

Pjesa e përgjithshme

Të gjitha këto rajone me përjashtim të atyre që mbulohen me pjesën e parë që i nënshtrohen mbrojtjes së Kombeve të Bashkuara në bazë të Rezolutave 743 (1992) dhe 762 (1992) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (në këtë më tej "Rajoni i pjesës së dytë") do t'i nënshtrohet administrimit nga ana e qeverisë së Republikës së Kroacisë në harmoni me dispozitat e inkorporuara ose përmendura në këtë pjesë.

KREU VIII

DISPOZITAT KALIMTARE

Neni VIII.1.

Forcat dhe vezhguesit ndërkombëtarë

1. Të nënshtroara vendimeve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ose të organeve kompetente të organizatave tjera ndërkombëtare të pranuar nga qeveria e Republikës së Kroacisë dhe e Krainës UNPROFOR-i ose forcat tjera ndërkombëtare si dhe njësitë vezhguese civile do të sistemohen në të gjitha ose në disa pjesë të rajonit të pjesës së dytë në periudhën kalimtare të paktën prej pesë vitesh, në mënyrë që të sigurohet aplikimi i plotë dhe besnik i Pjesës së dytë dhe të dispozitave të aplikueshme të pjesës së tretë të kësaj marrëveshjeje si dhe "Plani i Vensit" i paraqitur në aneksin III në Raportin të sekretarit të përgjithshëm të KB Këshillit të Sigurimit më 11 dhjetor të vitit 1991. (S/23280)

2. Qeveria e Republikës së Kroacisë do t'u ofrojë bashkëpunim të plotë forcave ndërkombëtare të përmendura në paragrafin 1, në mënyrë që të lehtësohet realizimi i qëllimeve të tyre.

Neni VIII.2.

Çmilitarizimi

1. Gjatë periudhës kalimtare të përmendur në paragrafin 1, të nenit VIII.1. rajonet e pjesës së dytë do të çmilitarizohen përveç që forcat ushtarake të republikës së Kroacisë mund të stacionohen në rajonet

prej pesë kilometrash nga kufiri ndërkombëtar dhe mund t'i shfrytëzojnë rrugët e kalueshme deri tek kufijtë e tillë sipas marrëveshjes dhe nën kontrollin e forcave ndërkombëtare të përmendura në paragrafin 1. të përmendur.

2. Çmilitarizimi i rajonit të pjesës së dytë do të fillojë më së voni një muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje dhe do të përfundojë më së voni tre muaj pasi që kjo marrëveshje të hyjë në fuqi. Të gjitha armët e larguara nga rajonet do të asgjësohen nga UNPROFOR-i ose nën kontrollin e tij.

Neni VIII.3.

K Kontrolli i policisë

Gjatë periudhës kalimtare të caktuar me paragrafin 1. të nenit VIII.1. përbërja dhe operacionet e të gjitha forcave policore të cilat do të veprojnë në rajonin e pjesës së dytë do t'i nënshtrohen kontrollit nga pjesa policore e forcave ndërkombëtare të përmendura në atë paragraf.

KREU IX

**ADMINISTRIMI SPECIAL DHE NDARJA E PUSHTETIT NË
SLLAVONINË LINDORE, BARANJEN JUGORE DHE SREMIN PERËNDIMOR**

Neni IX.1.

Administrimi special

1. Gjatë dy viteve të para të periudhës kalimtare të përbashkuar në këtë pjesë, përpos në se periudha e dytë nuk caktohet nga ana e Këshillit të Sigurimit të KB, Sllavoninë Lindore, Banatin e Jugut dhe Sremin Perëndimor (në tekst më tutje provinca lindore), të cilat e përbëjnë territorin e shënuar në hartën 2, aneksi A, në bazë të lejës së Këshillit të Sigurimit, do të administrojnë kombet e Bashkuara në harmoni me dispozitat e aneksit F.

2. Që të sigurohen administrim paqesor plotësues i Sllavonisë lindore dhe aplikimi i aranzhmaneve kalimtare në këtë pjesë, detyra speciale e administrimit do të jetë:

- a) të inkurajojë dhe lehtësojë kthimin e personave që kanë qenë të shtërnguar për t'i lëshuar shtëpitë e veta në provincën lindore pas 1 korrikut të vitit 1991;
- b) të organizojë zgjedhjet për nënpunës dhe ligjdhënës të cilët në harmoni me ligjet e Republikës së Kroacisë do ta administrojnë ose përfaqësojnë Provincën lindore pas përfundimit të periudhës kalimtare speciale të caktuar në paragrafin 1.

Neni IX.2.

Ndarja e pushtetit

Në fund të periudhës së administrimit të KB në harmoni me paragrafin 1. nenin IX.1., të gjitha fshatrat, qytetet ose lagjet e qyteteve në provincën lindore ku serbët përbëjnë shumicën gjuhë, religjion ose predikim fetar, në mendimin politik ose tjetër dhe në prejardhje nacionale apo sociale;

- e) e qëndrimit të drejtë gjatë procedurës kriminalistike;
- f) lirisë nga mundimi dhe trajtimi i vrazhdë e johuman dhe dënimi;
- g) e privatësisë;
- h) e lirisë së qarkullimit;
- i) e azilit;
- j) e mbrojtjes së familjes dhe të fëmijëve;

- k) të drejtën e pronës;
 l) të drejtën e lirive themelore; lirinë e fjalës e të shtypit, lirinë e mendimit, të ndërgjegjës e të bindjes; lirinë e religjionit duke përfshirë edhe lutjet private e publike: lirinë e tubimit të bashkimit duke përfshirë edhe formimi dhe përkatësinë e sindikatave të punëtorëve dhe lirinë e mosbashkimit, si dhe lirinë për punë;
 m) e arsimimit;
 n) e mbrojtjen sociale;
 o) e shëndetit;
 p) e të ushqyerit;
 q) e mbrojtjes;
 r) e mbrojtjes së pakicave dhe të grupeve të ndieshme.
 2. Të gjithë qytetarët e republikës së Kroacisë do t'i gëzojnë të drejtat;
 a) e formimit dhe përkatësisë së partive politike;
 b) e pjesmarrjes në punët publike;
 c) e mundësisë së afrimit të barabartë të shërbimeve publike; dhe
 d) votimit dhe të pjesmarrjes në zgjidhje.

Neni XI.2.

Kthimi i refugjatëve dhe i personave të zhvendosur
 Të gjithë refugjatët dhe personat e zhvendosur kanë të drejtë të kthehen lirisht në shtëpitë e tyre.

Neni XI.3.

Shtetësia

1. Secili person që ka qenë shtetas i Republikës Socialiste të Kroacisë në kuadër të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë në ditët e 21 dhjetori të vitit 1990, nga ajo ditë do të konsiderohet shtetas i Republikës së Kroacisë.
 2. Shtetësia dytësore do të lejohet:
 a) asnjë qytetar i Republikës së Kroacisë nuk do të mundet pa pëlqimin e vet të privohet nga e drejta e shtetësisë vetëm për shkak që posedon edhe shtetësinë e Republikës Federale të Jugosllavisë;
 b) asnjë qytetar i Republikës Federale të Jugosllavisë nuk do të mund vetëm për shkak të asaj shtetësie të pengohet për të marrë shtetësinë e Republikës së Kroacisë ose që nga ai të kërkohet që të heq dorë nga shtetësia e parë si kusht për të fituar shtetësinë tjetër.

Neni XI.4.

Kthimi ose kompensimi i pronës së humbur
 Të gjithë personat do të kenë të drejtë e cila duhet të aplikohet në harmoni me legjislacionin e Republikës së Kroacisë e atje ku është e mundshme edhe të Krahinës, e kthimit të çfarë do prone qoftë të cilat i kanë humbur gjatë spastrimit etnik ose aktet tjera ligjore, pse të marrin kompensimin për çfarëdo prone qoftë e cila nuk mund tu kthehet. Të gjitha deklaratat ose detyrimet e bëra me dhunë veçmas ato që janë të bëjnë me heqjen dorë nga toka ose pasuria do të trajtohen si të anuluar dhe jo të vlefshme.

Neni XI.5.

Pajtueshmëria e organeve qeveritare
 Të gjitha organet e qeverisë dhe agjencitë administrative të republikës së Kroacisë dhe të Krainës do të aplikojnë dhe do t'u përmbahen të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligjin

kushtetues sikurse qëndron në nenin XI.1, dhe të atyre të specifikuar ndryshe në këtë kaptinë ose në instrumentet e numëruara në theksin B.
 në kuptimin e nenit XI.1. do të ketë vetëqeverisjen në harmoni me nenin XI.3.

KREU X

FORCAT POLICORE

Neni X.1.

Përbërja dhe armatimi

1. Të gjitha forcat policore në provincat e pjesë së dytë do të kenë përbërje etnike e cila do të shprehë përbërjen e provincave në të cilat operojnë ato forcave sipas regjistrimit nga viti 1991, derisa të mos zbatohet regjistrimi i mëvonshëm në mbarë vendin.
 2. Forcat policore do të jenë të pajisura me armë dhe automjete të tipit të njëjtë pse përkatës të zakonshme për forcat policore në shtetet evropiane.

PJESA E TRETË

DISPOZITAT E PËRBASHKËTA

KREU XI

TË DREJTAT DHE LIRITË E NJERIUT

Neni XI.1.

Pjesa e përgjithshme

Aplikimi i shkallës më të lartë të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të njohura ndërkombëtare të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Kroacisë, në Ligjin Kushtetues mbi të drejtat dhe liritë e njeriut dhe në të drejtat e bashkësive nacionale dhe etnike ose të pakicave në Republikën e Kroacisë në instrumentet e numëruara në aneksin B, do të sigurohen në mbarë Kroacinë, veçanërisht:

1. Të gjithë personat në Republikën e Kroacisë e gëzojnë të drejtën:
 a) për jetë
 b) për liri në të cilën arrestimi ose internimi do të jenë të lejueshme vetëm me ligj;
 c) e barazisë para ligjit;
 d) e lirisë nga diskriminimi i mbështetur në racë, gjini

Neni XI.6.

Marrëveshja mbi të drejtat e njeriut

1. Republika e Kroacisë sa është e mundshme më herët, do të nënshkruaj të gjitha kontratat ndërkombëtare të numëruara në aneksin B.
 2. Të gjitha organet e qeverisë dhe agjencitë administrative të Republikës së Kroacisë dhe të Krahinës do të bashkëpunojnë me cilin do organ mbikqyrës të themeluar sipas instrumenteve të numëruara në aneksin B.

Neni XI.7.

Gjyqi për të drejtat e njeriut
Republika e Kroacisë do të bëjë aranzhmane me Këshillin e Evropës për themelimin e Gjyqit për të Drejtat e Njeriut në Kroaci në pajtueshmëri me Rezolutën 93 (6) të Komitetit të ministrave të këtij këshilli dhe si është caktuar në aneksin C.

Neni XI.8.

Ombudsmani
Qeveria e republikës së Kroacisë do të mundësojë emrimin e Ombudsmanit i cili duhet të ndihmojë zbatimin e të drejtave dhe lirive të përmendura në këtë kaptinë. Në periudhën fillestare të paktën prej tre vitesh dhe gjithnjë derisa nuk miratohet ligji përkatës në Saborin e Kroacisë me pëlqimin e Këshillit serb në Sabor, dispozitat lidhur me emërimin dhe funksionet e Ombudsmanit do të vendosen në aneksin D.

KREU XII

**VETEQEVERISJA E ADMINISTRATAVE NË PROVINCAT
ME POPULLATË PAKICË**

Neni XII.1.

Provincat me popullatë pakicë (minoritare)
Kurdoherë që në ndonjë fshat, lokalitet ose qytet të Krainës shumicën e popullatës e përbëjnë kroatët, ose serbët në kuadër të provincës së pjesës tjetër (në tekst mëtej provinca e popullatës pakicë), dispozitat e shënuara në këtë kaptinë do të aplikohen për sigurimin e shkallës maksimale të vetqeverisjes për shumën e atillë lokale.

Neni XII.2.

Kufijt e provincës së popullatës pakicë
1. Duke marrë parasysh të gjitha dispozitat e Ligjit mbi vetëqeverisjen dhe administratën lokale nga 29 dhjetori i vitit 1992 (mëtej në tekst "Ligji mbi vetëqeverisjen") ose të Ligjit mbi territorin e zhupanive qyteteve dhe të vendbanimeve në Republikën e Kroacisë nga 29 nëntori i vitit 1992, kufijtë e provincave të popullatës pakicë do të tërheqen në atë mënyrë e cila i përfshinë sa më shumë që është e mundur anëtarë të grupeve për çka ajo provincë duhet të formohet, kurse përqindja e tyre nuk mund të jetë më pak se 60.
2. Provinca e popullatës pakicë nuk mund të përbëhet nga dy apo më shumë provinca të cilat nuk preken.
3. Me rastin e caktimit të kufijve të provincave të popullatës pakicë, do të shfaqet kujdes për mendimet e personave të cilët mund të kyqen pse çkyqen nga provinca në fjalë.
4. Kufijtë e provincës së popullatës pakicë mund të ndryshohen si rezultat i regjistrimit zyrtar.
5. Kontestet që u përkasin kufijve të provincave të popullatës pakicë do të zgjidhen në gjyqin special kushtetues të formuar sipas nenit XIII.1.

Neni XIII.3.

Dispozitat mbi administrimin e provincave me popullatë pakicë
1. Ligji mbi vetëqeverisjen do të aplikohet edhe në Provincat e popullatës pakicë me këto

përjashtime:

a) Të gjitha provincat e popullatës pakicë do të konsiderohen njësi të qeverisë dhe vetëqeverisë lokale:

b) Mbi të gjitha referencat për Gjyqin Kushtetues të Republikës së Kroacisë do të vlerësojë Gjyqi Special Kushtetues i themeluar sipas Nenit XII.1.

c) Të gjitha emrimet nëpunësve pse të zyrtarëve në provincat e popullatës pakicë përfshirë edhe mësuesit do të bëhet ashtu sikurse është parashikuar me Kushtetutë dhe me ligjet e zbatueshme të Kroacisë, me kusht që kur ato emrime nuk i kanë bërë autoritetet në atë provincë atëherë ato autoritete mund të paraqesin ankesën e arsyetuar instancës e cila i ka bërë emrimet dhe nëse nuk mund të gjendet zgjidhje e kënaqshme si për njërin ashtu edhe për autoritetet tjera atëherë çështjet mund ta shqyrtojë Gjyqi Special Kushtetues. Kurdo që kjo është e realizueshme emrimet do të bëhen midis pjesëtarëve të provincës së popullatës pakicë në të cilën ata duhet të shërbejnë kurse përbërja etnike e secilit grup të atyre zyrtarëve do të shprehë sa është kjo e realizueshme përbërjen e popullatës së asaj province.

d) Neni 65. i këtij ligji do të aplikohet vetëm kur njësia lokale është pjesë e provincës së njëjtë të popullatës pakicë si dhe e komunave vendbanimeve ose të qytetit të cilëve u referohet ai Nen.

e) Nenet 71 dhe 82 dhe paragrafi 3. i nenit 83 të ligjit nuk do të palikohen:

f) për shpërndarjen e trupit përfaqësues të njësive të vetëqeverisjes lokale në përputhje me nenin 81, ose për zëvendësimin e prefektit komunal apo të prefektit të qytetit në harmoni me paragrafin e nenit 83, mund t'i drejtohet thirrje nga ana e atyre u përket kjo Gjyqit Special Kushtetues, dhe me atë rast vendim i tillë nuk mund të hyjë në fuqi derisa gjyqi nuk vendos ashtu;

g) Suspendimin e aktit të përgjithshme në bazë të nenit 80.

mund të urdhërojë vetëm, si masë të përkohshme Gjyqi Special kushtetues.

h) Kontestet lidhur me fjalën e dytë të paragrafit të dytë të nenit 87, do t'i paraqiten Gjyqit Special Kushtetues.

2. Para se ndonjë kontest apo lëndë i drejtohet Gjyqit Special Kushtetues në pajtim me paragrafin 1 të lartpërmendur për t'i zgjidhur me marrëveshje të përbashkët çfarëdo dallimesh. Gjyqi mundet në çdo kohë të kërkojë që në këtë rrafsh të bëhen përpjekje plotësuese.

KREU XIII

**GJYQI SPECIAL KUSHTETUES PËR KRAHINËN
DHE PROVINCAT E PJESËS SË DYTË**

Neni XIII.1.

Themelimi, kompetencat dhe procedurat

1. Për Krahinën dhe provincat e pjesës së dytë do të themelohet Gjyqi Special Kushtetues (në tekstin e mëtejme "Gjyqi Special Kushtetues" ose "Gjyqi") të cilit për drejtëm definitiv do t'i dërgohen të gjitha kontestet që mund të dalin nga kjo marrëveshje (me përjashtim të gjërave për të cilat vendoset në bazë të paragrafit 2. Neni XVII.1.) duke përfshirë çfarëdo kontestesh lidhur me interpretimin ose aplikimin e cilësdo dispozitë të Kushtetutës së Republikës së Kroacisë, të Ligjit Kushtetues mbi të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të drejtave të bashkësive nacionale e etnike ose të pakicave në Republikën e Kroacisë ose me cilindo ligj apo dekretiligj tjetër i cili mund të shtohet në përputhje me këtë Marrëveshje ose kërkohet aplikimi i tij.

2. Përveç, nëse nuk është parashikuar ndryshe me këtë Marrëveshje, Gjyqit Special Kushtetues konteste mund t'ia paraqesë presidenti i Republikës së Kroacisë ose kryeministri i saj kryetari ose organi legjislativ i Krahinës dhe kryesori i Këshillit seb në Sabor (Kuvend).

3. Gjyqi Special Kushtetues do të parapërcaktojë procedurën e vet e cila mund t'i kyq dispozitat për

themelimin e degëve gjyqësore dhe mënyrat për shqyrtimin e ankesave në vendimet e degëve të tilla gjyqësore.

4. Të gjitha shpenzimet e Gjyqit Special Kushtetues, përfshirë edhe rrogat e gjyqtarëve, të cilat nuk mund të jenë më të ulta nga ato që i kanë gjyqtarët e Gjyqit Kushtetues të Kroacisë i bartë Republika e Kroacisë.

Neni XIII.2.

Përbërja

1. Gjyqi Special Kushtetues përbëhet nga:

a) dy gjyqtar të Gjyqit Kushtetues të Kroacisë të cilët i cakton kryetari i atij gjyqi;
b) Dy gjyqtar të Gjyqit më të Lartë ose të Gjyqit të Apelacionit të Krahinës të cilët do t'i caktojë kryetari i atij Gjyqi;

c) Tre gjyqtarëve të cilët nuk do të jenë shtetas të Republikës së Kroacisë ose të cilit do shtet fqinj e të cilit do t'i emrojë kryetari i Gjyqit të Drejtësisë së Unionit Evropian

2. Kryetari i Gjyqit Special Kushtetues do të zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve të këtij gjyqi mudis atyre të zgjedhur në bazë të paragrafit 1 (c).

Kryetari i këtij gjyqi duhet të konsultohet para se kjo marrëveshje të përfundojë për të vendosur nëse do të pranojë atë detyrë. Në rastin e kundërt zyrtarët tjerë që mund të përfshihen janë kryetari i gjyqit ndërkombëtare të Drejtësisë kryetari i gjyqit evropian për të drejtat e njeriut pse kryesuesi i OSBE-së.

KREU XIV

AKUAT LIDHUR ME KONFLIKTIN E TASHËM

Neni XIV.1.

Akuzat e vendit

1. As Replika e kracisë as Krahina nuk do ta ndjekin askë më anë të gjyqit për krimet gjoja të kryera gjatë konflikteve në Kroaci pas 1. gushtit të vitit 1990, me përjashtim ashtu sikurse është parashikuar në paragrafin 2.

2. Për nënshtruarit në paragraf 2. të nenit XVI.2. akuzat megjithatë do të inicohen kundër cilit do person të akuzuar për shkeljen serioze të Konventave të Gjenevës nga vitit 1949, për shkeljen e ligjeve dhe të traditave për gjenocid ose krime kundër njerëzimit sipas çdo dispozite të së drejtës së vendit që lejojnë aktakuza të tilla.

3. Procesorët kundër personave të akuzuar sipas paragrafit 2, do t'i zhvillojë ekskluzivisht Tribunali për krime lufte për Kroacinë i cili do të formohet dhe i cili do të punojë nën kontrollin të Gjyqit Special Kushtetues. Ndjekjet me anë të gjyqit në këtë Tribunal mund t'i ushtrojnë të emërtuarit për këtë qëllim çoftë nga Qeveria e Republikës së Kroacisë, çoftë nga qeveria e Krahinës.

Neni XIV.2.

Akuzat ndërkombëtare

1. Të gjitha organet e qeverisë së Republikës së Kroacisë dhe të qeverisë së Krahinës do të bashkëpunojnë me Tribunalin ndërkombëtar për ndjekjen e pesonave përgjegjës për shkelje serioze të drejtës humanitare ndërkombëtare të kryera në territorin e ish Jugosllavisë pas vitit 1991 të themeluar me

Rezolutën 827 (193) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për grumbullimin ose lejimin prokurorit të Tribunalit ndërkombëtar për të tubuar prova mbi krimet në kaudër të juridiksionin të këtij Tribunali ashtu që do t'i dorëzojë dëshmitarët ose personat e akuzuar apo çdo mënyrë tjetër e cila do të kërkohet nga autoritetet kompetente të tribunalit.

2. Nëse këtë e kërkon formalisht tribunali ndërkombëtar Tribunali për krime të luftës në Kroaci do t'i mbështetet kompetencave të Tribunalit të parë kur është fjala për çdo procedurë.

Këto janë krime të njehta për të cilat ka të bëjë kompetenca e Tribunalit ndërkombëtar për krime të luftës në ish-Jugosllavi në bazë të neneve 2-5 të Statusit të Tribunalit.

Mbështetur në paragrafin 2 të nenit 9 të Statusit të Tribunalit ndërkombëtar për krime të luftës në ish-Jugosllavi.

KREU XV

AMANDAMENTET NË KUSHTETUTEN DHE LIGJET E KROACISË

Neni XV.1.

Miratimi i amandamenteve

1. Kushtetuta e Republikës së Kroacisë, Ligji Kushtetues mbi të Drejtat dhe Liritë e Njeriut dhe të drejtat e bashkësive nacionale e etnike dhe të pakicave në Republikën e Kroacisë si dhe ligjet e dekretligjet tjera do të ndryshohen ose plotësohen sipas mënyrës së caktuar në aneksin E, me qëllim të zbatimit të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

2. Amandamentet dhe ligjet të cilët duhet të miratohen sipas paragrafit 1, do të hyjë në fuqi më së voni gjashtë muaj pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje

Neni XV.2.

Ndryshimet e mëtejshme në amandamente

Amandamentet dhe ligjet e miratuara sipas nenit XV.1, si dhe dispozitat ekzistuese të instrumenteve që përmenden në paragrafin 1. Neni XV.1. që kërkohen për aplikimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nuk do të ndryshohen ose revokohen pa lejen e organeve legjislative të Krahinës dhe pelqimit të Këshillit Serb në Kuvendin Kroat (Sabor).

KREU XVI

PANDASHMËRIA E KROACISË

Neni XVI.1.

Pa qëllime për ndryshime

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të interpretohet sipas mënyrës e cila do të ndryshojë natyrën e pandashme të Republikës së Kroacisë të caktuar në nenin 1, të Kushtetutës së saj.

KREU XVII

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni XVII.1.

Hyrja në fuqi dhe zbatimi

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi pasi ta nënshkruajnë të dy palët, një muaj pas hytjes në fuqi të amendamenteve dhe ligjeve që duhet të miratohen sipas paragrafit 1. të nenit XV.1, dhe pas përfundimit të aranzhmaneve me Këshillin e Evropës të caktuar në nenin XI.7.

2. Mbi çdo çështje lidhur me orarin kohor ose mënyrën e aplikimit të dispozitave të kësaj marrëveshjeje, mund të vendos komisioni për zbatimin i cili do të përbëhet nga një përfaqësues të Federatës Ruse, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kombeve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian, nga të cilët dy të fundit do t'i emërojnë bashkëkryetarët e Konferencës Ndërkombëtare mbi ish Jugosllavinë.

Neni XVII.2.

Gjuhët

Kjo marrëveshje do të lidhet në gjuhët angleze, kroate e serbe. Në rastet e mospërputhshmërisë do të vendos teskti anglez.

Përfunduar _____ datë _____ 1995. në _____, tri kopje

Është menduar se komisioni për zbatim mund të jetë vazhdim i grupit të tashëm i cili ka qenë bashkëspozor i negociatave për Marrëveshjen mbi armëpushimin nga 29 marsi i vitit 1994, dhe i procesit negociator në fazat e mëvonshme, duke përfshirë edhe përgatitjen e këtij teksti.

Nga një për secilën nga të dyja palët dhe një kopje për Kombet e Bashkuara.

AUTONOMITË
DHE TË DREJTAT MINORITARE
NË RSFJ
(Pjesë të zgjedhura)

A) NGA KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SOCIALISTE FEDERATIVE TË
JUGOSLLAVISË

PJESA HYRËSE

PARIMET THEMELORE

I

Kombet e Jugosllavisë, duke u nisur nga e drejta e çdo kombi për vetëvendosje, duke përfshirë edhe të drejtën e shkëputjes, në bazë të vullnetit të vet të shprehur të shprehur lirisht në luftën e përbashkët të të gjitha kombeve dhe kombësive në Luftën nacionalçlirimtare dhe revolucionin socialist, e në pajtim me aspiratat e veta historike, të vetëdijshëm se përforcimi i mëtejshëm i vëllazërimit e bashkimit të tyre është në interes të përbashkët, së bashku me kombësitë me të cilat jetojnë, u bashkuan në republikën federative të kombeve e të kombësive të lira e të barabarta dhe krijuan bashkësinë socialiste federative të njerëzve punues - Republikën Federative Socialiste të Jugosllavisë...

PJESA E PARË

REPUBLIKA SOCIALISTE FEDERATIVE E JUGOSLLAVISË

Neni 1.

Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë është shtet federativ si bashkësi shtetërore e kombeve të bashkuara vullnetarisht dhe e republikave të tyre socialiste, si dhe e krahinave socialiste autonome të Vojvodinës e të Kosovës që janë në kuadrin e Republikës Socialiste të Serbisë, e bazuar në pushtetin dhe vetëqeverisjen e klasës punëtore dhe të gjithë njerëzve punues, dhe bashkjësi socialiste vetëqeverisëse demokratike e njerëzve punues e qytetarëve dhe e kombeve e kombësive të barabarta.

Neni 2.

Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë e përbëjnë: Republika Socialiste e Bosnës e Hercegovinës, Republika Socialiste e Maqedonisë, Republika Socialiste e Sllovenisë, Republika Socialiste e Serbisë si dhe Krahina Socialiste Autonome e Vojvodinës dhe Krahina Socialiste Autonome e Kosovës që janë në kuadrin e Republikës Socialiste të Serbisë, Republika Socialiste e Kroacisë dhe Republika Socialiste e Malit të Zi.

Neni 3.

Republika socialiste është shtet i bazuar në sovranitetin e popullit dhe në pushtetin e vetëqeverisjen e klasës punëtore dhe të gjithë njerëzve punues, dhe bashkjësi socialiste vetëqeverisëse demokratike e njerëzve punues e qytetarëve dhe e kombeve dhe kombësive të barabarta.

Neni 4.

Krahina socialiste autonome është bashkësi autonome socialiste shoqërore-politike vetëqeverisëse demokratike e bazuar në pushtetin dhe vetëqeverisjen e klasës punëtore dhe të të gjithë njerëzve punues,

në të cilën njerëzit punues e qytetarët, kombet e kombësitë realizojnë të drejtat e veta sovrane, e kur kjo është në interes të përbashkët të njerëzve punues e të qytetarëve, të kombeve e të kombësive të Republikës si tërësi e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës Socialiste të Serbisë - edhe në Republikë.

Neni 5.

Territori i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë është unik dhe përbëhet nga territoret e republikave socialiste.

Territori i republikës nuk mund të ndryshohet pa pëlqimin e republikës, e territori i krahinës autonome as pa pëlqimin e krahinës autonome.

Kufiri i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë nuk mund të ndryshohet pa pëlqimin e të gjitha republikave e krahinave autonome.

Kufiri në mes të republikave mund të ndryshohet vetëm në bazë të marrëveshjes së tyre, e nëse është fjala për kufirin e krahinës autonome - edhe në bazë të pëlqimit të saj.

KREU III

LIRITË, TË DREJTAT DHE DETYRAT E NJERIUT E TË QYTETARIT

Neni 153.

Liritë dhe të drejtat e njeriut e të qytetarit, të përcaktuara me këtë Kushtetutë, realizohen në solidaritetin reciprok të njerëzve dhe me përmbushjen e detyrave e përgjegjësive të secilit ndaj të gjithëve dhe të të gjithëve ndaj secilit.

Neni 154.

Qytetarët janë të barabartë në të drejta dhe detyra pa dallim kombësie, race, seksi, gjuhe, feje, shkalle të arsimit ose pozite shoqërore.

Të gjithë janë të barabartë para ligjit.

Neni 170.

Qytetarit i garantohet liria e shprehjes së përkatësisë së kombit, respektivisht kombësisë, liria e shprehjes së kulturës kombëtare dhe liria e përdorimit të gjuhës së vet dhe të shkrimit të saj.

Qytetari nuk është i detyruar të deklarohet se cilit komb, respektivisht cilës kombësi i takon, as të përcaktohet që t'i takojë njërit nga kombet, respektivisht njëres nga kombësitë.

Është kundërkushtetues dhe dënohet çdo propagim ose zbatim i pabarazisë kombëtare, raciale ose fetare.

Neni 171.

Pjesëtarët e kombësive, në pajtim me kushtetutën dhe ligjin, kanë të drejtë të përdorin gjuhën e vet dhe shkrimin e saj në realizimin e të drejtave dhe detyrave të veta, si dhe në procedurën para organeve shtetërore dhe organizatave që ushtrojnë autorizime publike.

Pjesëtarët e kombeve dhe kombësive të Jugosllavisë në territorin e secilës republikë, respektivisht krahinë autonome kanë të drejtë për mësim në gjuhën e vet në pajtim me ligjin.

KREU IV

KUSHTETUTSHMËRIA DHE LIGJSHMËRIA

Neni 206.

Kushtetuta e republikës dhe kushtetura e krahinës nuk mund të jenë në kundërshtim me Kushtetutën e RSFJ.

Të gjitha ligjet e dispozitat e tjera dhe aktet e përgjithshme të organeve të bashkësive shoqërore-politike, si dhe aktet e përgjithshme vetëqeverisëse të organizatave të punës së bashkuar dhe të organizatave të bashkësive të tjera vetëqeverisëse, duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën e RSFJ.

Neni 207.

Të gjitha dispozitat dhe aktet e tjera të përgjithshme të organeve federative duhet të jenë në pajtim me ligjin federativ.

Ligji e dispozitat e tjera republikane e krahinore dhe aktete e përgjithshme të organeve të bashkësive shoqërore-politike, si dhe aktet e përgjithshme vetëqeverisëse nuk mund të jenë në kundërshtim me ligjin federativ.

Në qoftë se ligji republikan, respektivisht krahinor është në kundërshtim me ligjin federativ, gjer në vendimin e gjykatës kushtetuese, do të zbatohet përkohësisht ligji republikan, respektivisht krahinor, e nëse për zbatimin e liogjit federativ janë përgjegjëse organet federative - ligji federativ.

Në qoftë se organi që vendos në çështjet individuale konsideron se ligji, dispozita tjetër ose akti i përgjithshëm apo akti i përgjithshëm vetëqeverisës nuk është në pajtim me ligjin federativ, respektivisht se është në kundërshtim me ligjin federativ, ka për detyrë të fillojë procedurën para gjykatës kushtetuese.

PJESA E TRETË

MARRËDHËNIET NË FEDERATË DHE TË DREJTAT E DETYRAT E FEDERATËS

KREU I

MARRËDHËNIET NË FEDERATË

Neni 244.

Në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë kombet dhe kombësitë dhe njerëzit punues e qytetarët realizojnë dhe sigurojnë sovranitetin, barazinë, lirinë kombëtare, pavarësinë, tërësinë territoriale, sigurimin, vetëmbrojtjen shoqërore, mbrojtjen e vendit, pozitën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare të vendit me shtetet e tjera dhe me organizatat ndërkombëtare, sistemin e marrëdhënieve shoqërore -ekonomike socialiste vetëqeverisëse, bazat unike të sistemit politik, liritë dhe të drejtat themelore demokratike të njeriut e të qytetarit, solidaritetin dhe sigurinë sociale të njerëzve punues e të qytetarëve dhe tregun unik jugosllav, dhe harmonizojnë zhvillimin e përbashkët ekonomik e shoqëror dhe interesat e tjera të veta të përbashkëta.

Këto interese të përbashkëta realizohen:

- nëpërmjet organeve federative, me pjesëmarrjen dhe përgjegjësinë e barabartë të republikave e të krahinave autonome në këto organe në përcaktimin dhe zbatimin e politikës së Federatës;

- nëpërmjet organeve federative në bazë të vendimeve, respektivisht pëlqimit të republikave e të krahinave autonome;
- me bashkëpunimin dhe marrëveshjen e drejtpërdrejtë të republikave, të krahinave autonome, të komunave dhe të bashkësive të tjera shoqërore-politike;
- me marrëveshjen vetëqeverisëse, marrëveshjen shoqërore dhe me bashkimin e organizatave të punës së bashkuar e të organizatave dhe të bashkësive të tjera vetëqeverisëse;
- me veprimtarinë e organizatave shoqërore-politike e të organizatave të tjera shoqërore dhe të shoqatave të qytetarëve;
- me aktivitetet e lira dhe të gjithanshme të qytetarëve.

Me Kushtetutën e RSFJ përcaktohet se cilat të drejta dhe detyra në realizimin e interesave të përbashkëta i ushtron Federata nëpërmjet organeve federative, e cilat kuvendet e republikave dhe të krahinave me anë të delegacioneve të veta në Kuvendin e RSFJ dhe me anë të vendosjes së drejtpërdrejtë, në mënyrën e përcaktuar me këtë Kushtetutë.

Neni 245.

Në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë kombet dhe kombësitë janë të barabarta.

Neni 246.

Janë të barabarta gjuhët e kombeve dhe të kombësive dhe shkrimet e tyre në territorin e Jugosllavisë. Në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë në përdorim zyrtar janë gjuhët e kombeve, e gjuhët e kombësive - në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligjin federativ.

Me ligj dhe me statutin e bashkësisë shoqërore-politike dhe me aktet vetëqeverisëse të organizatave të punës së bashkuar dhe të organizatave e bashkësive të tjera vetëqeverisëse, sigurohet realizimi i barazisë së gjuhëve e të shkrimeve të kombeve e të kombësive në përdorim zyrtar në rajonet ku jetojnë kombësitë përkatëse, dhe përcaktohet mënyra e kushtet e aplikimit të kësaj barazie.

Neni 247.

I garantohet çdo kombësie që për realizimin e së drejtës për shprehjen e kombësisë e të kulturës së vet, të përdorë lirisht gjuhën e vet dhe shkrimin e saj, të zhvillojë kulturën e vet dhe që për këtë qëllim të themelojë organizata dhe të gëzojë të drejta të tjera të përcaktuara me kushtetutë.

Neni 248.

Përveç të drejtave që u janë siguruar me kushtetutë në bashkësitë e tjera shoqërore-politike, kombësitë realizojnë të drejtat sovrane edhe në komunë si bashkësi vetëqeverisëse dhe themelore shoqërore-politike.

Neni 249.

Për qytetarët e Jugosllavisë ekziston shtetësia unike e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Çdo shtetas i republikës është njëkohësisht edhe shtetas i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Shtetasi i një republike ka në territorin e republikës tjetër të drejta dhe detyra të njëjta sikurse shtetasit e saj.

KREU VII

GJYKATA KUSHTETUESE E JUGOSLLAVISË

Neni 375.

Gjykata kushtetuese e Jugosllavisë:

1. vendos mbi pajtushmërinë e ligjeve me Kushtetutën e RSFJ;
2. vendos se a është ligji republikan, respektivisht ligji krahinor në kundërshtim me ligjin federativ;
3. vendos mbi pajtushmërinë e dispozitave dhe akteve të tjera të përgjithshme të organeve federative me Kushtetutën e RSFJ dhe me ligjin federativ;
4. vendos a janë dispozitat dhe aktet tjera të përgjithshme të organeve të bashkësive shoqërore-politike dhe aktet e përgjithshme vetëqeverisëse në pajtim me kushtetutën e RSFJ, respektivisht në pajtim me ligjin federativ për zbatimin e të cilit janë përgjegjës organet federative;
5. zgjidh konfliktet mbi të drejtat dhe detyrat midis Federatës dhe Republikës, respektivisht krahinës autonome dhe midis bashkësive të tjera shoqërore-politike nga territori i republikave të ndryshme, në qoftë se për zgjidhjen e konflikteve të tilla me ligj nuk është parashikuar kompetenca e gjykatës tjetër;

6. vendos mbi konfliktin për kompetencë midis gjykatave kushtetuese të republikave, respektivisht gjykatave kushtetuese të krahinave, midis gjykatave dhe organeve federative, midis organeve federative dhe organeve republikane, respektivisht organeve krahinore, midis gjykatave dhe organeve të tjera shtetërore nga territori i dy ose më shumë republikave dhe krahinave autonome.

Gjykata Kushtetuese e Jugosllavisë mund të vlerësojë kushtetutshmërinë e ligjeve dhe kushtetutshmërinë e ligjshmërinë e dispozitave e të akteve të përgjithshme të organeve të bashkësive shoqërore-politike dhe të akteve të përgjithshme vetëqeverisëse që kanë rënë nga fuqia, nëse nga koha e rënies nga fuqia, gjer në fillimin e procedurës nuk ka kaluar më shumë se një vit.

B) NGA KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SOCIALISTE TË SERBISË

PJESA E PARË

Neni 1.

Republika Socialiste e Serbisë është shtet demokratik i bazuar në bashkëqeverisje të klasës punëtore dhe të gjithë njerëzve punonues dhe bashkësitë vetëqeverisëse socialiste demokratike të njerëzve punonjës dhe të kombeve dhe kombësive të barabartë, të mbështetur në vetëqeverisje të pupullit punonjës në organizatat e punës së bashkuar dhe në format tjera të bashkësive vetëqeverisëse si dhe të organizimeve të lira shoqërore.

Republika socialiste e Serbisë është shtet i kombit serb dhe i pjesëtarëve të tjerë të kombeve dhe kombësive, që jetojnë në të dhe i gëzojnë të drejtat sovraane.

Në përbërje të Republikës Socialiste të Serbisë janë Krahina Autonome Socialiste e Serbisë dhe Krahina Autonome e Kosovës.

Republika Socialiste e Serbisë është në përbërje të Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë.

Neni 2.

Populli punonues e qytetarët, kombet dhe kombësitë e Serbisë i realizojnë të drejtat sovraane në Republikën Socialiste të Serbisë dhe në krahinat socialiste autonome në raport me të drejtat e tyre kushtetuese, ndërkaq në Republikën Federative Socialiste të Jugosllavisë kur është në interes të përbashkët të popullit punonjës, të kombeve dhe të kombësive të Jugosllavisë të caktuar me Kushtetutën e Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë.

Neni 3.

Territori i Republikës Socialiste të Serbisë është unik dhe e përbëjnë territoret e komunave të caktuara me ligj.

Kufijt e Republikës Socialiste të Serbisë mund të ndryshohen në bazë të vendimeve të Kuvendit të Republikës Socialiste të Serbisë.

Neni 4.

Qytetarët e Republikës Socialiste të Serbisë kanë shtetësinë republikane.

KREU VIII

KRAHINA AUTONOME SOCIALISTE

Neni 292

Krahina Socialiste Autonome është bashkësi politiko-shoqërore demokratike autonome socialiste e bazuar në pushtetin vetëqeverisës të klasës punëtore dhe të gjithë njerëzve punonues, ku populli punonjës dhe qytetarët, kombet dhe kombësitë i realizojnë të drejtat e tyre sovraane, përveç atyre që me këtë kushtetutë caktohen si të drejta të cilat në interesin e përbashkët të të gjithë njerëzve punonues, qytetarëve dhe të kombeve e kombësive të Republikës si tërësi i realizojnë në Republikë.

Neni 292.

Territoret e krahinave autonome i përbëjnë territoret e komunave të sotme të caktuara me ligj. Territoret e krahinave nuk mund të ndryshohen pa pëlqimin e kuvendeve krahinore.

Neni 293.

Me qëllim të realizimit të obligimeve dhe detyrimeve të veta, krahinat autonome marrëdhëniet shoqërore i rregullojnë vetë në bazë të ligjeve dhe rregulloreve të tjera, përveç atyre marrëdhëniesve të cilat me këtë kushtetutë dhe në bazë të tij rregullohen sipas ligjeve unike për gjithë territorin e Republikës.

Në marrëdhëniet të cilat janë të rregulluara në bazë të ligjeve të Republikës në mënyrë unike për gjithë Republikën, krahinat autonome mund t'i rregullojnë ato çështje të cilat nuk janë të parapara me ligjet republikane.

Nëse në ato marrëdhënie të cilat rregullohen me anë të ligjit republikan në mënyrë unike për gjithë Republikën nuk është aprovuar ligji republikan krahinat autonome mund të nxjerrin ligjet e veta nëse ato paraqesin interes për realizimin e të drejtave dhe obligimeve. Kur nxirret ligji republikan mbi rregullimin e marrëdhëniesve të tilla, pushojnë të vlejnë dispozitat të ligjit krahinor të cilat i mbështeten çështjeve të rregulluara me ligjin republikan, nëse me atë ligj ndryshe nuk është rregulluar.

Neni 294.

Për aplikimin dhe zbatimin e ligjeve republikane dhe të parashtrësive të cilat zbatohen në tërë territorin e Republikës janë përgjegjës organet e krahinave.

Parashtrësit për zbatimin e ligjeve republikane të cilat vlejnë për gjithë territorin e Republikës, si dhe aktet dhe masat tjera për zbatim të atyre ligjeve e që kur është fjala të nxjerrja e atyre akteve kompetent është Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të Republikës së Serbisë, për territorin e krahinave autonome e nxjerr Këshilli Ekzekutiv e Kuvendit të Krahinës Autonome, nëse me ligj nuk është rregulluar ndryshe.

Organet administrative krahinore dispozitat dhe aktet tjera për zbatim dhe aplikim të ligjeve dhe të rregullave të tjera republikane të cilat aplikohen në gjithë territorin e Republikës, kur për nxjerrjen e atyre akteve janë të autorizuar organet administrative republikane, nëse me ligj nuk është rregulluar ndryshe.

Dispozitat për zbatim dhe aplikim të ligjeve që i nxjerr Kuvendi i RSS në pajtim me kuvendet e krahinave autonome, i miratojnë organet krahinore.

Në bazë të përgjegjësisë së organeve të krahinave autonome për zbatimin dhe aplikimin e ligjeve republikane dhe të dispozitave të tjera republikane të cilat përdoren në gjithë territorin e Republikës, marrëdhëniet mes organeve republikane dhe të organeve të krahinave autonome në aspektin e zbatimit të atyre ligjeve dhe të dispozitave tjera bazohen në bashkëpunimin reciprok, në njoftimin e ndërsjellë si dhe në bazë të të drejtave dhe obligimeve të caktuara me këtë ligj.

Nëse organet në krahinat autonome nuk i zbatojnë ligjet republikane dhe dispozitat tjera për të cilat janë kompetent, Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të Republikës së Serbisë do të njoftojë për këtë organet kompetente të krahinave dhe do të ndërmarrë masa të tjera në kuadër të të drejtave dhe obligimeve.

Neni 296.

Organet administrative republikane janë në marrëdhënie me organet komunale në krahinat autonome përmes organeve administrative krahonore të autorizuar.

Në rastet e ngutshme, në punët në kuadër të mbrojtjes popullore, të sigurisë shtetërore dhe në fusha të tjera të rregulluara me ligje republikane që aplikohen në gjithë territorin e Republikës, si dhe në raste të tjera në të cilat mund të ndodhin dëme të pambuluara, organet administrative republikane mund të bashkëpunojnë drejtpërdrejt me organet komunale në krahinat autonome, për çfarë organi administrativ republikan e bën me dije organin gjegjës administrativ krahinor.

KREU IX

TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E REPUBLIKËS

Neni 297.

Njerëzit punonues dhe qytetarët, kombete dhe kombësitë e Republikës Socialiste të Serbisë realizojnë dhe sigurojnë në Republikë: sovranitetin, barazinë dhe të drejtën kombëtare, pavarësinë, tërësinë territoriale, mbrojtjen popullore, sigurinë dhe vetëmbrojtjen shoqërore, marrëdhëniet socialiste, vetëqeverisëse dhe raportet ekonomiko-shoqërore, sistemin politik unik, liritë demokratike dhe të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e njeriut dhe të qytetarit, tregun unik jugosllav, kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë; rregullon marrëdhëniet shoqërore dhe harmonizon interesat e përbashkëta si dhe rregullon zhvillimin shoqëror vetëqeverisës.

KREU XV

GJYQI KUSHTETUES I SERBISË

Neni 401.

Gjuqi kushtetues i Serbisë:

1. vendos mbi harmoninë e ligjeve republikane me Kushtetutën e Republikës Socialiste të Serbisë, përveç ligjeve që nxirren me pajtushmërinë e Kuvendit të RSS dhe kuvendeve të krahinave autonome;

2. vendos mbi pajtushmërinë e ligjit krahinor dhe dispozitave të tjera dhe të akteve të përgjithshme të organeve shtetërore dhe të organizatave të opunës së bashkuar dhe organizatave të tjera vetëqeverisëse dhe të bashkësive në krahinë me Kushtetutën e RSS dhe të ligjeve republikane dhe dispozitave të tjera republikane të cilat zbatohen në gjithë territoretin e Republikës,

3. vendos mbi pajtushmërinë e dispozitave dhe të akteve të tjera të organeve shtetërore, të organizatave të punës së bashkuar dhe të organizatave të tjera vetëqeverisëse dhe të bashkësive me Kushtetutën e RSS, me ligjin republikan dhe dispozitave të tjera republikane, si dhe për atë se a janë ato akte në kundërshtim me ligjet federative për zbatimin e të cilave janë të obliguara organet në Republikë,

4. zgjedh çështjet mbi të drejtat dhe obligimet mes bashkësive shoqërore-politike, nëse për zgjidhjen e atyre çështjeve me ligj nuk është paraparë përgjegjësia e ndonjë gjyqi tjetër,

5. vendos mbi kundërshtitë ndaj përgjegjësisë mes gjyqeve dhe të organeve të tjera në Republikë,

6. kryen punë të tjera të cilat i janë lënë në përgjegjësi në bazë të kësaj kushtetute,

Gjuqi Kushtetues i Serbisë mund të vlerësojë kushtetutshmërinë e ligjeve dhe kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e dispozitave dhe të akteve të përgjithshme të organeve të bashkësive politiko-shoqërore

dhe të akteve të përgjithshme vetëqeverisëse të cilat kanë pushuar të jenë të vlefshme, nëse nga koha që kanë pushuar të jenë të vlefshme e deri te koha e fillimit të procedurës nuk ka kaluar më shumë se një vit.

Neni 410.

Nëse Gjuqi Kushtetues i Serbisë konfirmon se ligji republikan ose krahinor nuk është në harmoni me Kushtetutën e RSS, apo ligji krahinor nuk është në harmoni me ligjin republikan që aplikohet në gjithë territorin e Republikës, reagon me vendim të cilin ia adreson kuvendit kompetent. Kuvendi kompetent është i obliguar që, në afat prej gjashtë muajve nga dita e dërgimit të vendimit nga ana e Gjuqit Kushtetues të Serbisë, të harmonizojë ligjin me Kushtetutën e RSS, respektivisht ligji krahinor të harmonizohet me ligjin republikan më së largu edhe për gjashtë muaj.

Nëse kuvendi kompetent në periudhën e caktuar kohore nuk arrin të harmonizojë me Kushtetutën e RSS, apo nëse ligji krahinor nuk është harmonizuar me atë ligjin republikan që aplikohet në gjithë territorin e Republikës, dispozitat ligjore të cilat nuk janë në harmoni me ligjet republikane pushojnë të jenë të vlefshme dhe për këtë Gjyqi Kushtetues i Serbisë do të nxjerr vendimin e vet.

C) NGA KUSHTETUTA E KRAHINËS SOCIALISTE AUTONOME TË KOSOVËS E VITI 1974

PJESA HYRËSE

PARIMET THEMELORE

I

Të ndërlidhur në të kaluarën e vet dhe me jetën e synimet e përbashkëta për liri e progres social, malazet, myslimanët, serbët, shqiptarët, turqit dhe pjesëtarët e kombeve dhe të kombësive tjera dhe të grupeve etnike, në luftën e përbashkët të të gjitha kombeve e kombësive të Jugosllavisë në Luftën nacionalçlirimtare dhe në revolucionin socialist, të udhëhequr nga klasa punëtore dhe Partia komuniste e Jugosllavisë, përmbysën rendin e vjetër klasor të bazuar në shfrytëzim, shtypje politike e pabarazi kombëtare dhe u gjendën për herë të parë të lirë, të barabartë dhe të vëllazëruar në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës, e cila u bë formë politike e shoqërore si e lidhshmërisë së fortë dhe e barazisë reciproke të tyre, ashtu edhe e barazisë së tyre me kombet e kombësitë e Jugosllavisë.

Krahina Socialiste Autonome e Kosovës u krijua në luftën e përbashkët të kombeve e kombësive në Luftën nacionalçlirimtare dhe në revolucionin socialist të Jugosllavisë dhe, në bazë të vullnetit të shprehur lirisht të popullsisë - të kombeve e të kombësive të Kosovës dhe vullnetit të shprehur lirisht të popullit të Serbisë, u bashkua në Republikën Socialiste të Serbisë në kuadër të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Njerëzit punues dhe kombet e kombësitë e Kosovës realizojnë të drejtate veta sovra në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës, e kur kjo është në interes të përbashkët të njerëzve punues dhe të kombeve e kombësive të Republikës si tërësi e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës Socialiste të Serbisë edhe në Republikë, dhe në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë, kur kjo është përcaktuar në interes të përbashkët me Kushtetutën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Në realizimin e interesave të përbashkëta, njerëzit punues, kombet e kombësitë e Kosovës vendosin në Federatë mbi parimet e marrëveshjes reciproke të republikave e krahinave autonome, të solidaritetit e të reciprocitetit, të pjesëmarrjes së barabartë të republikave e krahinave në organet e Federatës në pajtim me Kushtetutën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe me Kushtetutën e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës si dhe mbi parimin e përgjegjësisë së republikave e të krahinave autonome për zhvillimin e vet dhe për zhvillimin e bashkësisë socialiste të Jugosllavisë si tërësi.

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Krahina Socialiste Autonome e Kosovës është bashkësi autonome socialiste shoqërore-politike demokratike dhe vetëqeverisëse e njerëzve punues dhe qytetarëve, e malazetëve, myslimanëve, serbëve, shqiptarëve, turqëve dhe pjesëtarëve të kombeve e të kombësive të tjera dhe të grupeve etnike të barabarta, e bazuar në pushtetin dhe vetëqeverisjen e klasës punëtore dhe të të gjithë njerëzve punues.

Krahina Socialiste Autonome e Kosovës është në kuadër të Republikës Socialiste të Serbisë dhe të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Neni 2.

Njerëzit punues e qytetarët, kombet e kombësitë e Kosovës, realizojnë të drejtat sovra në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës, e kur kjo është në interes të përbashkët të njerëzve punues, të kombeve e të kombësive të Republikës si tërësi e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës Socialiste të Serbisë edhe në Republikë, dhe në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë, kur kjo është përcaktuar në interes të përbashkët me Kushtetutën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Neni 3.

Territorin e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës e përbëjnë teritorët e komunave të tanishme. Territori i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës nuk mund të ndryshohet pa pëlqimin e Kuvendit krahinor.

Neni 4.

Në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës kombet e kombësitë janë të barabarta dhe kanë të drejta e detyra të njejta.

Për realizimin e barazisë së kombeve e të kombësive garantohet e drejta e zhvillimit të lirë të tyre dhe e të shprehurit të lirë të veçorive kombëtare, të gjuhës, të kulturës, të historisë dhe të simboleve të tjera.

Neni 5.

Në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës sigurohet barazia e gjuhës shqipe, serbokroate e turke dhe e shkrimeve të tjera.

Me këtë Kushtetutë dhe me ligjin krahinor rregullohet dhe sigurohet aplikimi i këtij parimi.

Neni 6.

Në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës është e drejtë e pjesëtarëve të të gjithë kombeve e kombësive që të përdorin flamurin e vet kombëtar.

Kushtet dhe mënyra e përdorimit të flamurit kombëtar rregullohet me ligj.

LIRITË, TË DREJTAT DHE DETYRAT E NJERIUT E TË QYTETARIT

Neni 187.

Qytetarit i garantohej liria e shprehjes së përkatësisë së kombit, respektivisht kombësisë, liria e shprehjes së kulturës kombëtare, dhe liria e përdorimit të gjuhës së vet dhe të shkrimit të saj.

Qytetari nuk është i detyruar të deklarojë se cilin komb, respektivisht cilën kombësi i takon, as të përcaktohet që t'i takojë njërit nga kombet, respektivisht njëres nga kombësitë.

Qytetarit i garantohet liria e shprehjes së përkatësisë së grupit etnik, liria e zhvillimit të kulturës së vet dhe e përdorimit të gjuhës së vet dhe shkrimit të saj.

Është kundërkushtuese dhe dënohet çdo propagim ose zbatim i pabarazisë kombëtare, si dhe çdo mbjellje e urrejtjes dhe e intolerancës kombëtare, raciale ose fetare.

BARAZIA E GJUHËVE DHE SHKRIMEVE

Neni 217.

Në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës aplikohen në mënyrë të barabartë gjuha serbokroate e gjuha e shqipe dhe shkrimet e tjera.

Në rajonet ku jetojnë edhe turqit aplikohet në mënyrë të barabartë edhe gjuha turke dhe shkrimi i saj.

Organet, institucionet, organizatat punuese dhe organizatat tjera në Krahinë janë të obliguara që në punën e vet t'i përmbahen parimit të barazisë së gjuhëve e të shkrimeve të kombeve e të kombësive të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.

Neni 218.

Në shkollat fillore, të mesme, të larta e fakultete, respektivisht në paralelet e tyre sigurohen kushtet për mësim në gjuhën amtare, respektivisht në gjuhën shqipe, serbokroate dhe turke, në pajtim me ligjin. Pjesëtarët e kombeve e të kombësive të tjera të Jugosllavisë, në pajtim me ligjin krahinor, kanë të drejtë mësimi në gjuhën e tyre.

Neni 219.

Gjuha shqipe, serbokroate dhe turke janë të barabarta si lëndë mësimi dhe si gjuhë joamtare mësohen në mënyrën e përcaktuar me ligj.

KREU IX

TË DREJTAT DHE DETYRAT E KRAHINËS

Neni 283.

Në realizimin e të drejtave dhe detyrave të veta Krahina nëpërmjet organeve dhe organizatave krahinore:

2. rregullon sistemin e planifikimit shoqëror dhe përcakton planin shoqëror të Krahinës dhe cakton masat për realizimin e politikës së përcaktuar të zhvillimit ekonomiko-shoqëror të Krahinës;

4. rregullon marrëdhëniet e detyrimeve e të kontraktimit; rregullon marrëdhëniet juridike-pronësore dhe marrëdhëniet e tjera juridike-reale;

6. rregullon sistemin e mbrojtjes e të përparimit të bujqësisë e të pylltarisë, shfrytëzimit të tokës bujqësore e pyjore, të begatave të natyrës e të ujërave, përcakton politikën dhe masat në këto lëmë dhe siguron zbatimin e këtyre masave që janë me interes për Krahinën;

9. rregullon kushtet e përgjithshme dhe sistemin e edukimit e të arsimit, të kulturës dhe të kulturës fizike;

10. rregullon dhe siguron mbrojtjen e rendit të përcaktuar me kushtetutë (sigurimin shtetëror); rregullon dhe organizon shërbimin e sigurimit shtetëror; rregullon dhe siguron sigurimin publik, rregullon sistemin e vetëmbrojtjes shoqërore;

12. rregullon organizimin territorial të komunave; rregullon sistemin e zgjedhjeve;

13. rregullon pozitën e organeve të administratës në Krahinë dhe parimet për organizimin e marrëdhëniet reciproke të tyre; rregullon organizimin dhe mënyrën e punës së organeve të Krahinës;

14. siguron zbatimin e ligjeve dhe të dispozitave të tjera krahinore, republikane e federative në territorin e Krahinës; ushtron mbikqyrjen dhe punët administrative me interes për realizimin e të drejtave dhe detyrave të Krahinës; mbron kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë.

Neni 284.

Me ligjin republikan rregullohen në mënyrë unike për tërë territorin e Republikës marrëdhëniet në lëmët për të cilat kjo është përcaktuar me Kushtetutën e Republikës Socialiste të Serbisë.

Neni 285.

Marrëdhëniet që rregullohen me ligjin krahinor, në bazë të marrëveshjes së organeve përkatëse krahinore e republikane, mund të rregullohen me ligjin republikan në mënyrë unike për tërë territorin e Republikës.

Kuvendi, dhomat e tij ose Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit marrin iniciativë për rregullimin e këtyre marrëdhënieve.

Ligjin për rregullimin e marrëveshjes të marrëdhënieve e nxjerr Kuvendi i Republikës në bazë të propozimit të përbashkët të Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Republikës dhe të kuvendeve të krahinave autonome, me pëlqimin paraprak të kuvendeve të krahinave autonome.

Kur Kuvendi i KSA të Kosovës vendos që me ligjin e vet t'i rregullojë çështjet dhe marrëdhëniet që në bazë të marrëveshjes janë rregulluar në mënyrë unike, ligji mbi rregullimin e këtyre marrëdhënieve mund të nxirret pasi të kalojnë tre muaj nga dita kur për këtë vendim janë njohtuar Kuvendi i RS të Serbisë dhe Kuvendi i KSA të Kosovës. Ligji i këtillë nuk mund të zbatohet para se të kalojnë tre muaj nga dita e hyrjes në fuqi.

Neni 286.

Në lëmët që janë rregulluar me ligjin federativ, si dhe në lëmët që janë rregulluar me ligjin republikan në mënyrë unike për tërë territorin e Republikës, me ligjin krahinor, në kuadër të të drejtave dhe të detyrave të Krahinës, mund të rregullohen çështjet dhe marrëdhëniet që nuk janë rregulluar me këtë ligj.

Në qoftë se në lëmët që rregullohen me ligjin federativ, si dhe në lëmët që rregullohen me ligjin republikan në mënyrë unike për tërë territorin e Republikës, nuk janë nxjerrë ligje të tilla, me ligjin krahinor mund të rregullohen çështjet dhe marrëdhëniet kur kjo është në interes për realizimin e të drejtave dhe detyrave të Krahinës. Kur në këto lëmë nxirret ligji federativ, respektivisht ligji republikan, bien nga fuqia dispozitat e ligjit krahinor që kanë të bëjnë me çështjet e rregulluara, nëse me ligjin federativ, respektivisht me ligjin republikan nuk është caktuar ndryshe.

Neni 288.

Për realizimin e përgjegjësisë së Krahinës në ushtrimin e funksioneve të caktuara të Federatës, Krahina jep pëlqimin për ndryshimet e Kushtetutës së RSFJ-së dhe për aktet e masat e tjera të Federatës të caktuara me Kushtetutën e RSFJ, dhe merr pjesë në përcaktimin e zbatimit e politikës së RSFJ në mënyrën dhe sipas procedurës së përcaktuar me Kushtetutën e RSFJ dhe me këtë Kushtetutë.

Neni 290.

Krahina kujdeset për sigurimin e kushteve materiale dhe kushteve të tjera për nxitjen e zhvillimit më të shpejtë ekonomik e shoqëror të rajoneve jo mjaft të zhvilluara ekonomikisht në territorin e Krahinës.

Për nxitjen e zhvillimit më të shpejtë ekonomik e shoqëror të rajoneve jo mjaft të zhvilluara ekonomikisht në territorin e Krahinës formohet fondi i veçantë e Krahinës. burimet e të ardhurave dhe marrëdhëniet e tjera të këtij fondi rregullohen me ligj.

Neni 292.

Banka Popullore e Kosovës është institucion unik monetar.

Banka Popullore e Kosovës, me Bankën Popullore të Jugosllavisë dhe me bankat popullore të republikave dhe të Krahinës Socialiste Autonome të Vojvodinës, zbaton politikën e përbashkët të misionit.

Banka Popullore e Kosovës, në pajtim me kushtetutën dhe ligjin, në kuadër të politikës së përbashkët të misionit, përcakton kushtet dhe mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve monetare në Krahinë dhe merr masa të tjera të nevojshme për zbatimin e politikës kreditore të Krahinës.

Neni 293.

Krahina Socialiste Autonome e Kosovës, në pajtim me Kushtetutën e RSFJ, merr pjesë në përcaktimin dhe zbatimin e politikës së jashtme të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe të marrëdhënieve të saj me shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare.

Krahina Socialiste Autonome e Kosovës nëpërmjet organeve të caktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj jep pëlqimin për lidhjen e traktateve ndërkombëtare që kërkojnë nxjerrjen e ligjeve të reja ose ndryshimin e ligjeve krahinore në fuqi, ose nga të cilat dalin obligime të veçanta për Krahinën.

Krahina Socialiste Autonome e Kosovës realizon bashkëpunimin dhe zhvillon marrëdhënie me organet e organizatat ndërkombëtare, në pajtim me politikën e jashtme të Republikës Federative të jugosllavisë dhe me traktatet ndërkombëtare.

Neni 294.

Në realizimin e funksioneve të veta Krahina Socialiste Autonome e Kosovës zhvillon bashkëpunimin me republikat socialiste dhe me Krahinën Socialiste Autonome të Vojvodinës në çështjet me interes të përbashkët me qëllim harmonizimi të përgjithshëm shoqëror dhe ekonomik.

Krahina Socialiste Autonome e Kosovës bashkëpunon me republikat socialiste dhe me Krahinën Socialiste Autonome të Vojvodinës në ushtrimin e funksioneve të caktuara të Federatës.

Bashkëpunimin e realizojnë Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës dhe organet e organizatat e tjera krahinore në kuadër të kompetencave të veta.

Krahina nxit dhe ndihmon bashkëpunimin e komunave, organizatave të punës së bashkuar, bashkësive të interesit, organizatave shoqërore-politike, shoqatave e organizatave profesionale dhe të shoqatave e të organizatave tjera me komunat, organizatat e punës së bashkuar dhe me organizatat e tjera në republikat socialiste dhe në KSA të Vojvodinës.

Neni 295.

Për realizimin e bashkëpunimit në zgjidhjen e çështjeve me interes të përbashkët, KSA e Kosovës, në marrëveshje me republikat socialiste dhe me KSA të Vojvodinës, mund të formojë organe dhe organizata të përbashkëta.

Përfundimet e organeve dhe të organizatave të përbashkëta i obligojnë organet dhe organizatat krahinore vetëm në qoftë se ato, në kuadër të të drejtave dhe të detyrave të veta të përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj, e vërteton organi kompetent krahinor.

Neni 296.

Krahina Socialiste Autonome e Kosovës bashkëpunon me republikat socialiste dhe me KSA të Vojvodinës në lëmën e politikës së tatimeve dhe harmonizon me anë të marrëveshjeve reciproke bazat e politikës së tatimeve me sistemin e tatimeve, kur kjo është e domosdoshme për sigurimin e unitetit dhe stabilitetit të tregut jugosllav.

Neni 297.

Vendimet, dokumentet dhe aktet e tjera individuale të lëshuara nga organet shtetërore dhe organizatat e autorizuara në republikat socialiste dhe në KSA të Vojvodinës vlejnjë njësoj në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës sikurse në republika respektivisht në KSA të Vojvodinës ku janë lëshuar.

ORGANET E KRAHINËS SOCIALISTE AUTONOME TË KOSOVËS

KUVENDI I KRAHINËS SOCIALISTE AUTONOME TË KOSOVËS

1. Pozita dhe kompetenca*Neni 300.*

Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës është organ i vetëqeverisjes shoqërore dhe organ më i lartë i pushtetit në kuadër të të drejtave dhe detyrave të Krahinës.

Kuvendi kryen punën nga kompetenca e vet në bazë dhe në kuadër të kushtetutës dhe ligjit.

Neni 301.

Kuvendi si bartës themelor i të drejtave dhe detyrave të Krahinës në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe ekskluzive:

1. vendos mbi ndryshimin e Kushtetutës të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, jep pëlqimin për ndryshimet e Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe të Kushtetutës së Republikës Socialiste të Serbisë;

2. përcakton politikën dhe vendos mbi çështjet e tjera themelore me rëndësi për jetën politike, ekonomike, sociale e kulturore, për mbrojtjen popullore dhe zhvillimin shoqëror të Krahinës;

3. nxjerr ligje krahinore dhe jep interpretime autentike të ligjeve krahinore;

4. nxjerr planin shoqëror, buxhetin dhe llogarinë përfundimtare të Krahinës;

5. nxjerr planin regjinal dhe planin e zhvillimit hapësinor të Krahinës;

6. shqyrton çështjet nga lëma e politikës së jashtme e të marrëdhënieve ndërkombëtare në rastet e parashikuara me Kushtetutën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë; ratifikon traktatet që lidh Krahina me organet e organizatat ndërkombëtare të huaja dhe me organet e organizatat ndërkombëtare, në kuadër të politikës së përcaktuar të jashtme të RSFJ dhe të traktateve ndërkombëtare;
18. jep pëlqimin për ndryshimin e territorit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës;
19. zgjedh dhe revokon delegacionin e Kuvendit të KSA të Kosovës në Dhomën e Republikave dhe të Krahinave të Kuvendit të RSFJ;
20. zgjedh dhe shkarkon anëtarin e Kryesisë së RSFJ nga Krahina Socialiste Autonome e Kosovës;
21. zgjedh dhe shkarkon anëtarët e Kryesisë së KSA të Kosovës.

2. Përbërja dhe zgjedhja

Neni 302.

Kuvendin e KSA të Kosovës e përbëjnë Dhoma e Punës së Bashkuar, Dhoma e Komunave dhe Dhoma Shoqërore-Politike.

3. Fushëveprimi dhe puna

Neni 319.

Në mbledhjen e përbashkët të dhomave të Kuvendit vendoset mbi: ndryshimin e Kushtetutës së KSA të Kosovës; dhënien e pëlqimit për ndryshimin e Kushtetutës së RSFJ dhe Kushtetutën e RS të Serbisë; dhënien e pëlqimit për ndryshimin e territorit të KSA të Kosovës, zgjedhjen e delegacionit të Kuvendit në Dhomën e Republikave dhe të Krahinave në Kuvendin e RSFJ; zgjedhjen e anëtarit të Kryesisë së RSFJ nga KSA të Kosovës, zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë së KSA të Kosovës; zgjedhjen e kryetarëve dhe nënkryetarëve, si dhe anëtarëve të komisioneve dhe forumeve të tjera të Kuvendit; zgjedhjen dhe shkarkimin e kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit; zgjedhjen dhe shkarkimin e kryetarit dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të KSA të Kosovës, zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës; emërimin dhe shkarkimin e sekretarëve krahinorë dhe sekretarit të Kuvendit dhe nxjerrjen e rregullores së punës të Kuvendit.

KRYESIA E KSA TË KOSOVËS

Neni 339.

Kryesia e KSA të Kosovës përfaqëson Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës dhe ushtron të drejtat dhe detyrimet e tjera të përcaktuara me këtë Kushtetutë.

Neni 340.

Kryesia:

1. shqyrton çështjet me rëndësi për jetën politike, ekonomike, sociale e kulturore në Krahinë, resalizimin e barazisë së kombeve dhe kombësive;
4. shqyrton çështjet e përgjithshme dhe çështjet e tjera të bashkëpunimit të Krahinës me republikat socialiste dhe më KSA të Vojvodinës;

5. harmonizon qëndrimet me Kryesinë e RS të Serbisë dhe Kryesinë e KSA të Vojvodinës mbi çështjet që janë me interes të përgjithshëm për Republikën si tërësi.

KËSHILLI EKZEKUTIV I KSA TË KOSOVËS

Neni 349.

Këshilli Ekzekutiv është organ ekzekutiv i Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Këshilli Ekzekutiv ushtron të drejtat dhe detyrat e veta në bazë dhe në kuadër të kësaj Kushtetute dhe ligjit.

Neni 350.

Këshilli Ekzekutiv:

1. përcjell gjendjen dhe realizimin e politikës së Kuvendit dhe i propozon Kuvendit përcaktimin e politikës;
2. propozon ligje e dispozita të tjera dhe akte të përgjithshme dhe ka të drejtë të japë mendimin mbi propozimet e ligjeve e të dispozitave të tjera dhe të akteve të përgjithshme që ia paraqesin Kuvendit propozuesit e tjerë të autorizuar;
3. përcakton propozimin e planit shoqëror të Krahinës, përcakton propozimin e buxhetit krahinor dhe të llogarisë përfundimtare krahinore dhe kujdeset për realizimin e buxhetit krahinor dhe të llogarisë përfundimtare krahinore.

ADMINISTRATA KRAHINORE

Neni 362.

Për kryerjen e punëve të administratës në kuadër të të drejtave dhe detyrave të Krahinës themelohen sekretariatet krahinore dhe organet e tjera krahinore të administratës.

GJYKATA KUSHTETUESE E KOSOVËS

Neni 372.

Gjykata kushtetuese e Kosovës:

1. vendos mbi pajtushmërinë e ligjeve krahinore me Kushtetutën e Krahinës Autonome të Kosovës;
2. vendos mbi pajtushmërinë e statuteve të komunave me Kushtetutën e KSA të Kosovës dhe ligjin krahinor;
3. vendos mbi pajtushmërinë të dispozitave dhe të akteve të tjera të përgjithshme të organeve shtetërore, të organizatave të punës së bashkuar dhe të organizatave dhe të bashkësive të tjera vetëqeverisëse me Kushtetutën e KSA të Kosovës, ligjin krahinor dhe dispozitat e tjera krahinore, ligjin republikan me të cilin rregullohen me marrëveshje marrëdhëniet për tërë territorin e Republikës, si dhe mbi atë se a janë këto akte në kundërshtim me ligjin federativ për zbatimin e të cilit janë përgjegjëse organet e Krahinës;
4. vendos mbi pajtushmërinë e dispozitave të organeve krahinore të nxjerra për zbatimin e ligjeve republikane që aplikohen në tërë territorin e Republikës me ato ligje (...)

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PROKURORIA PUBLIKE E KRAHINËS DHE AVOKATI
SHOQËROR KRAHINOR I VETËQEVERISJES

Neni 390.

Gjykata Supreme e Kosovës:

1. vendos, në kuadër të kompetencës të përcaktuarme ligj, mbi ankesat kundër aktgjykimeve dhe vendimeve të tjera të gjykatave të rregullta;
2. vendos në shkallën e parë kur kjo është caktuar me ligj;
3. vendos mbi mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatave të rregullta në pajtim me ligjin (...)

Neni 391.

Funksionet e prokurorisë publike në kuadër të të drejtave dhe detyrave të Krahinës i ushtron prokuroria publike e Krahinës.

Neni 393.

Funksionin e avokatit shoqëror të vetëqeverisjes në kuadër të të drejtave dhe detyrave të Krahinës, e ushtron avokati shoqëror krahinor i vetëqeverisjes.

Avokatin shoqëror krahinor të vetëqeverisjes e emëron dhe e shkarkon Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.

PJESA E KATËRT

NDRYSHIMET E KUSHTETUTËS TË KSA TË KOSOVËS

Neni 394.

Mbi ndryshimin e Kushtetutës vendos Kuvendi i KSA të Kosovës.

Neni 398.

Ndryshimin e aprovuar të Kushtetutës së KSA të Kosovës e shpall Kuvendi.

Neni 399.

Mbi dhënien e pëlqimit mbi ndryshimin e Kushtetutës së RSFJ dhe Kushtetutës së RS të Serbisë vendos Kuvendi i KSA të Kosovës me shumicën prej du të tretash të të gjithë delegatëve të Kuvendit.

INICIATIVA PËR NDRYSHIMET E KUSHTETUTËS SË RSFJ DHE TË RS TË SERBISË

Vërejtje e autorit

Kriza e përgjithshme në ish-RSFJ (Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë) (bazën e vet e kishte edhe në disa zgjidhje joadekuate kushtetuese që kishin të bënin me sistemin politik dhe ekonomik,

por edhe me marrëdhëniet në Federatë. Nevoja për kryerjen e ndryshimeve të caktuara kushtetuese posaçërisht u manifestua në republikën e atëherëshme të Serbisë, duke marrë parasysh situata konfliktuozë që shkaktoheshin në relacionin Republika - dy krahinat autonome, Kosova dhe Vojvodina.

Për dallim nga republika tjera të RSFJ, Serbia funksiononte si shtet i përbërë, pasi që në përbërje të vet kishte dy krahina të cilët njëkohësisht ishin edhe element të federalizmit jugosllav. Krahinat, nga aspekti i të drejtës kushtetuese ishin në çdo gjë të barazuara me republikat përveç në një: nuk kanë pasur të drejtën e shkëputjes.

Deri tek situatat konfliktuozë në Serbi vihet së pari për shkak të faktit se me Kushtetutë nuk qenë saktësuar qartë isa funksione të përgjithshme (ingerencat) të Republikës si shtet (mbrojtja, plani shoqëror, plani hapësinor, gjyqësia, politika e jashtme e ngjashëm), dhe së dyti, për shkak të paqarëtsive kushtetuese në raport me krahinat pasuan vështirësitë që në mënyrë adekuate të prezentohen interesat e republikës si tërësi në Federatë.

Në mbledhjen e përbashkët të tri dhomave të Kuvendit të RS të Serbisë (14.09.1987), u shqyrtua propozimi i kryesisë së RS të Serbisë për fillimin e ndryshimeve të kushtetutës republikane. Me ato ndryshime do të duhej të eliminohejshin premisat kushtetuese për krijimin e situatave konfliktuozë në marrëdhëniet midis republikës e krahinave, me saktësim më të qartë të prerogativave klasike gjithëshitetore të Republikës dhe me shkallën më të lartë të bashkëpunimit të organeve republikane e krahinore rreth çështjeve me interes për mar republikën. Qëllimi ka qenë që të ndalohen proceset e çintegritit dhe të realizohen masat e domosdoshme të unitetit të Republikës e cila nuk do të ishte në dëm të mëvetësisë së krahinave. Pra, do të duhej që të arrihejshin dy qëllime ambicioze: që pavarësia e vërtetë e krahinave të ndahet nga partikularizmi dhe separatizmi dhe nga ana tjetër, që baza minimale e unitetit të shtetit të Republikës të ndahej nga etatizmi republikan dhe unitarizmi serb.

Duke marrë parasysh aspektin shoqëror të krizës shoqërore edhe Kryesai e RSFJ merr vendimin (21.01.1987) për fillimin e ndryshimeve të Kushtetutës Federative. Me amandamentet kushtetuese të 25. 11. 1988 (dhe para kësaj më 1981), u zëvendësuan, plotësuan ose u pezulluan dispozitat e caktura të Kushtetutës ngaviti 1974. Me pjesën normative të Kushtetutës u zgjeruan bazat për tregun unik jugosllav dhe në masë të mirë u shtuan të drejtat legjislative të Federatës: iu dhanë autorizime më të zgjeruara dhe përgjegjësia e organeve federale në zbatimin e ligjeve federale, etj. Mirëpo, nuk u prek në parimet themelore mbi të cilat janë mbështetur marrëdhëniet e barazisë në Federatë. Parimi i konsensusit lidhur me çështjet thelbësore u ruajt.

Sa i përket Serbisë, Kryesia e RSFJ, ka propozuar "ndryshime të caktura në të gjitha shtatë nenet e pjesës normative të Kushtetutës së RSFJ" (Hamdia Pozderac), me të cilat eliminohej pengesat në marrëdhëniet midis republikës dhe krahinave. U respektuan vërejtjet e Kryesisë së RS të Serbisë që në dispozitat e caktura të atyre zgjidhjeve, "RS e Serbisë reduktohet në të ashtuquajturën rajon të ngushtë", kurse krahiant "në disharmoni me parimet kushtetuese arazohen me republikat me çka u jepen karakteristikat formale dhe esenciale të shtetit" (Gazeta e Kuvendit të RS të Serbisë, numër 334, 09.04.1987). Me atë rast, bie fjala, u propozua edhe amandamenti XXXVI me të cilin RS të Serbisë i kthehet "funksioni në sferën e bashkëpunimit ndërkombëtar". Derisa në Kushtetën e RSFJ, neni 271, thotë se republikat e krahinat e realizojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në kaudër të politikës së caktuar të jashtme të RSFJ, në amandamentin XXVI shtohet "dhe në kuadër të realizimit të bashkëpunimit ndërkombëtar të RS të Serbisë". Me fjalë tjera, me këtë amandament krahiant obligohen që bashkëpunimin e vet ta harmonizojnë përveç me organet e Federatës edhe me organet e Republikës.

Meqenëse iniciativa për ndryshimet kushtetuese nuk kaluan pa rezistenca edhe në Federatë edhe në republika, konsensusi i gjithëpranueshëm se ato janë të domosdoshme ishte premisë e pakapërcyeshme për dalje nga kriza. Posaçërisht është me rëndësi se propozimi i Kryesisë së RS të Serbisë që të fillohet ndryshimi i Kushtetutës republikane, më parë e kaloi procedurën e marrëveshjes dhe de facto mor idritën e gjelbër të të gjithë faktorëve relevant në Federatë, Republikë dhe në dy krahinat. Kuvendi i RS të

Serbisë në mbledhjen e përmendur konkludon se propozimi dhe arsyetimi i kryetarit të Kryesisë së atëhershme, Ivan Stamboliqit t'u jepet të gjitha faktorëve relevantë në Republikë (kuvendeve krahinore parasëgjithash), për marrjen e pëlqimit formal për fillimin e ndryshimit të Kushtetutës. Përgjigja dhe pëlqimi nga këto organe do të duhej të arrijë më së voni deri në fund të vitit 1987.

Kjo rrjedhë, ndërkaq, u ndërpre shpejt. Vetëm dhjetë ditë pas mbledhjes së përmendur të Kuvendit të RS të Serisë, ku u miratua arsyetimi i propozimit për ndryshimin e Kushtetutës së RS të Serisë, si rezultat gati i debatit dhjetëvjeçar me intensitet më të vogël apo më të madh në opinion, Slobodan Milosheviqi i ndihmuar nga fraksioni konservativo-nacionalist dhe ushtarako-policor, në mbledhjen e njohur të VIII të KQ të LKS (23-24.09.1987), bëri puç partiak dhe në kundërshtim me të gjitha përpjekjet që me rrugë paqësore dhe me marrëveshje të bëhen ndryshimet kushtetuese, filloi që me mjete të dhunës ta zgjidh problemin e Kosovës.

Kjo ishte aq më e keqe, që u dëshmuar se për kursin demokratik të ndryshimeve nuk kanë ekzistuar kushtet e domosdoshme objektive e subjektive. Decentralizimi i Federatës nuk u mbështet me reforma radikale të sistemit politik dhe ekonomik, or edhe forcat ekzistuese reformiste e antinacionaliste nuk ishin në shkallën e pjekurisë historike dhe të organizimit ë të mund ta bartnin këtë kërkesë ambicioze. U vërtetua, për befasi të shumicës në vend dhe botë, se forcat e centralizimit burokratik dhe të etnocentralizimit në Republikë dhe në krahina janë shumë më të fuqishme.

Nën parullën "Oj Serbi nga tri pjesë do të bëhesh e tërë", u krye pezullimi me dhunë i autonomisë së Kosovës, dhe u aplikua represioni dhjetëvjeçar mbi popullatën shqiptare, që i dha kredibilitet etnonacionalizmit dhe secesionizmit shqiptar i cili rezultoi paradokohësh edhe me shpërthimin e armatosur të krizës së Kosovës, me kërcënim të pasojave të paparashikuara edhe për popullin serb edhe për atë shqiptar. Aq më parë dhe aq më shumë, nëse cilado palë në konflikt llogarit se me armë mund t'i realizojë disa nga qëllimet e veta - pushteti centralist mbi Kosovën me ndonjë formë të autonomisë kulturore, ose pavarësia e Kosovës.

Duket se para drejtimit të ngjashëm të zgjidhjes së njëjës kosovare (Kosova si pjesë e Serbisë dhe subjekt i federalizmit) gjendemi edhe sot, ndonëse më me pak gjasë dhe më me shumë pa siguri se para dhjetë vitesh. Sot më së shpeshti propozojnë: shkallë të lartë të autonomisë, pa të drejtë për shkëputje. Një pozicion të tillë Kosova e ka pasur edhe në Federatën e mëparshme jugosllave. Bindja jonë është se nuk mund të shkohet nën këtë. Pavarësisht nga modalitetet konkrete të zgjidhjes (statusi special apo diç ngjashëm) nuk do të mund të evitohet ndonjë lloj i statusit dysor të Kosovës. Jo status i njëjtë, sepse me shkatërrimin e RSFJ-së janë ndryshuar rrethanat, por gjithësesi statusi i ngjashëm çfarë e ka pasur Kosova në ish RSFJ. Prandaj jemi të bindur se për kërkimet e zgjidhjeve më të përshtatshme, mund të shfrytëzohen edhe disa njohuri, ide dhe zgjidhje çfarë kanë ekzistuar në ish RSFJ dhe gjithësesi edhe në propozimet për ndryshimin e Kushtetutës federative e republikane, të cilën e ka inicuar udhëheqja e atëhershme e RS të Serbisë dhe të cilat, dorën në zemër, kanë hasur në mbështetje të udhëheqjes së atëhershme të Kosovës dhe të opinionit kosovar.

A. PROPOZIMI PËR FILLIMIN E NDRYSHIMEVE TË KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SOCIALISTE TË SERBISË

13. Në Kushtetutën e RS të Serbisë lypset të shprehet dhe të sigurohet më qartë që Kuvendi i RS të Serbisë në bashkëpunim me kuvendet e KSA të shqyrtojë çështjet me interes të përbashkët për Republikën si tërësi dhe për çdo çështje të marrë konkluzione dhe dokumente të tjera përkatëse.

Në Kushtetutën e RS të Serisë lypset më qartë dhe kategorikisht të shprehet nevoja e bashkëpunimit dhe e dakordimit imediat të Kuvendit të RS të Serisë dhe të kuvendeve të krahinave autonome mbi çështjet me interes të përbashkët që janë nga kompetencat e pavarura të Republikës dhe të krahinave autonome dhe në harmoni me këtë, të parashikohet që Kuvendi i RS të Serbisë dhe kuvendet e

krahinave autonome mund të përcaktojnë bazat e përbashkëta për rregullimin e marrëdhënieve në sferat e caktuara me aktet e veta dhe sipas nevojës të formojnë trupa të përbashkët e të realizojnë forma të tjera të bashkëpunimit.

14. Në Kushtetutën e RS të Serbisë duhet caktuar kategorikisht autorizimet legislative të Republikës për përcaktimin e himnit dhe të përdorimit të flamurit të stemës, uniksht për mbarë territorin e Republikës.

15. Duke u nisur nga parimet e Kushtetutës së RSFJ, se është e drejtë dhe detyrim i komunave, krahinave autonome, republikave dhe i bashkësive të tjera shoqërore-politike, që në përputhje me sistemin e mbrojtjes popullore, secila në territorin e vet të përcaktuar dhe organizojë mbrojtjen popullore dhe të udhëheq mbrojtjen territoriale, mbrojtjen civile dhe përgatitjet tjera për mbrojtje, në rast të sulmit kundër vendit tonë të organizojë rezistencën popullore dhe atë të udhëheq, është e domosdoshme që në Kushtetutën e RS të Serbisë të precizohen qartë të drejtat dhe detyrimet e RS të Serbisë për të përcaktuar unitetin në organizim, planifikim dhe zhvillimin e sistemit të mbrojtjes së përgjithshme popullore në Republikë.

Në Kushtetutën e RS të Serbisë duhet saktësuar:

- që plani i mbrojtjes i Republikës të mbajë edhe çështjet me interese të përbashkët për Republikën si tërësi;

- që RS e Serbisë të rregullojë unik për mbarë territorin e republikës elementet e domosdoshme me interes për Republikën si tërësi që kanë të bëjnë me organizimin, përgatitjen dhe udhëheqjen e mbrojtjes territoriale;

- të drejtat dhe detyrat e Kryesisë së RS të Serbisë për udhëheqjen e rezistencës popullore në rast të sulmit kundër vendit në mbarë territorin e Republikës.

Në krijimin e funksioneve të veta kushtetuese në këtë sferë, Kryesia e RS të Serbisë harmonizon qëndrimet me Kryesinë e KSA mbi: planin e mbrojtjes së Republikës në pjesën e cila përmban çështjet me interes të përbashkët për Republikën si tërësi; përgatitjet për mbrojtje dhe për punë në rastet e rrezikut direkt luftarak apo otë luftës; organizimin e rezistencës gjithëpopullore dhe harmonizimin e udhëheqjes së rezistencës gjithëpopullore në luftë në mbarë territorin e Republikës.

16. Duke u nisur nga parimet e Kushtetutës së RS të Serbisë se njerëzit punues dhe qytetarët, kombet e kombësit në RS të Serbisë realizojnë dhe sigurojnë interesat e përbashkëta, përveç tjerash: sovranitetin, barazinë dhe lirinë nacionale, pavarësinë, tërësinë tokësore, sigurinë dhe vetëmbrojtjen shoqërore, lypset të saktësohen autorizimet e domosdoshme dhe detyrimet e Republikës përkatësisht të organeve të saj, para së gjithash të Kresisë së RS të Serbisë në fushën e sigurisë së shtetit dhe publike.

Duhet saktësuar autorizimet kushtetuese që RS e Serbisë, në kuadër të bazave të sistemit të mbrojtjes me Kushtetutën e RSFJ të rendit të përcaktuar (siguria e shtetit), të cilën e rregullon Federata, në masë të duhur të sigurojë unitetin e sistemit të mbrojtjes së rendit të përcaktuar me kushtetutë me interes për Republikën si tërësi.

Në realizimin e funksioneve të veta në këtë fushë, Kryesia e RS të Serisë i harmonizon qëndrimet me Kryesinë e KSA-ve në vlerësimin e gjendjes së rendit të përcaktuar kushtetues (sigurimi i shtetit), me interes për Republikën si tërësi dhe me interes për harmonizimin e aktivitetit të organeve të punëve të brendshme të Republikës dhe të krahinave autonome me interes për mbrojtjen e rendit kushtetues të Republikës si tërësi.

Në dispozitat përkatëse të Kushtetutës së RS të Serbisë duhet theksuar më fuqishëm nevojën e realizimit të bashkëpunimit, të njoftimit dhe të dakordimit midis organeve republikane e krahinore rreth çështjeve që janë me interes për Republikën si tërësi.

17. Nevojitet që të saktësohet përmbajtja e domosdoshme dhe vëllimi i mbrojtjes penalo-juridike të lirive, të drejtave dhe të detyrave të njerit e të qytetarit, të drejtat vetëqeverisëse të njerëzve punonjës dhe të organizatave të punës së bashkuar dhe të marrëdhënieve tjera të caktuara me Kushtetutën e RS të

Serbisë dhe me ligjin republikan i cili aplikohet unikisht në mbarë territorin e Republikës. Në kuadër të kësaj të shqyrtohet nevoja e unikisht për mbarë republikën të rregullohet çështja e formave të caktuara të kualifikuara të veprave penale të cilat janë të drejtuara kah rrënimi i barazisë nacionale, nëse nuk janë rregulluar me ligjin federativ.

18. Në kushtetutën e RS të Serbisë duhet siguruar që vlerat e mbrojtura me kushtetutë dhe me ligj republikan që aplikohet unikisht, nën kushtet e caktuara, të gëzojnë mbrojtjen gjyqësore edhe të Gjyqit Suprem të Serbisë. Lypset të sigurohet që në kushtet e caktuara të shkëlqes së lirive, të drejtave dhe të barazisë së pjesëtarëve të kombeve, kombësive dhe të grupeve partiake, në Gjyqin Suprem të Serisë, bie fjala, në trupin e veçantë, të zhvillohet procedura mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër plotfuqishmërisë së vendimeve të gjyqeve në territorin e Republikës, kur është fjala për aplikimin e ligjeve të cilët zbatohen unikisht në mbarë territorin e Serbisë.

Në harmoni me paragrafin e mësipërm, në Kushtetutën e RS të Serbisë duhet saktësuar edhe autorizimet e prokurorit publik republikan që funksionet e veta t'i realizojë në mbarë territorin e Republikës kur është fjala për zbatimin e ligjit republikan me aplikim unik.

19. Për shkak të realizimit më të plotë që RS e Serbisë të marrë pjesë organizueshëm në vendosjen dhe realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, në përputhje me politikën e caktuar të jashtëm të RSFJ, duhet përcaktuar të drejtat dhe detyrat e caktuara të Republikës në realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në Kushtetutën e RS të Serbisë, duhet parashikuar se në RS të Serbisë sigurohet bashkëpunimi reciprok dhe aktiviteti i koordinuar i organeve të Republikës dhe të krahinave autonome dhe të subjekteve të tjera të cilët marrin pjesë në organizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në Kushtetutën e RS të Serbisë duhet parashikuar se RS e Serbisë në realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, të prezentohen me tërësinë e vlerave të veta ekonomike, shoqërore, kulturore e tjera në harmoni me të drejtat e detyrat e Republikës.

20. Nisur nga parimi se për kryerjen e ligjeve republikane që aplikohet unikisht, përgjegjës janë organet krahinore, nevojitet që të shprehet më saktësisht në Kushtetutën e RS të Serbisë përgjegjësia e organeve republikane për zbatimin e ligjeve dhe të normave të tjera të cilat aplikohen në mbarë territorin e Republikës, sipas mënyrës e rregullit, do t'i përgjigjej zgjidhjeve që do të zbatohen në Kushtetutën e RSFJ, e në harmoni me pozitën kushtetuese të Republikës dhe të krahinave autonome në përbërje të saj.

21. Në Kushtetutën e RS të Serbisë duhet përcaktuar saktësisht bazën për nxjerrjen e ligjeve me aplikimin unik mbi planin shoqëror të Republikës ku do të rregullohej edhe procedura për përcaktimin e politikës zhvillimore dhe ekonomike me interes të përbashkët.

Nisur nga interesat e përbashkëta të njerëzve punonjës, organizatave të punës së bashkuar, bashkësive vetëqeverisëse të interesit dhe të organizatave e bashkësive të tjera vetëqeverisëse të interesit dhe të organizatave e bashkësive të tjera vetëqeverisëse, të komunave e krahinave, si dhe nga përgjegjësia e Republikës për zhvillimin e et dhe për zhvillimin e krahinave autonome përkatësisht nga përgjegjësia e krahinave autonome për zhvillimin vetjak dhe për zhvillimin e Republikës në tërësi, duhet definuar më qartë përmbajtjen e planit shoqëror të Serbisë, lidhur me çështjet të cilat me zhvillimin e përbashkët dhe me politikën ekonomike përcaktohen me marrëveshje në planin shoqëror të Serbisë. Me planin shoqëror të Republikës, në kushtet e ligjshmërisë së tregut dhe të pavarësisë ekonomike të organizatave të punës së bashkuar, në bazë të mundësive dhe kushteve të vlerësuar bashkërisht të zhvillimit dhe të planeve e programeve zhvillimore të organizatave të punës së bashkuar dhe të organizatave e bashkësive të tjera vetëqeverisëse, përcaktohet politika zhvillimore dhe ekonomike me interes të përbashkët.

Nevojitet që në Kushtetutën e RS të Serbisë të zërthehet më afër përgjegjësia e Republikës për masat plotësuese të zhvillimit më të shpejtë ekonomik e të përgjithshëm të KSA të Kosovës, si pjesë dukshëm e pazhvilluar e RS të Serbisë dhe RSFJ.

22. Duke marrë parasysh faktin se planifikimi shoqëror është element i qenësishëm i planifikimit shoqëror, të shqyrtohet nevoja që në Kushtetutën e RS të Serbisë të përcaktohet baza kushtetuese për nxjerrjen e ligjit mbi planifikimin shoqëror me aplikim unik, me të cilin do të rregullohej edhe mënyra e harmonizimit të çështjeve me interes për Republikën si tërësi.

23. Krahas dispozitave ekzistuese të Kushtetutës së RS të Serbisë me të cilat garantohet barazia e gjuhëve të kombeve dhe kombësive dhe përcaktohet përdorimi i tyre në procedurat para organeve të shtetit, nevojitet që në Kushtetutën e RS të Serbisë të parashikohet kategorikisht se në RS të Serbisë në përdorim zyrtar janë gjuha serbokroate dhe gjuhët e kombësive - shqipja, hungarishtja dhe gjuhët tjera - në harmoni me Kushtetutën, ligjet dhe statutin. Lypset siguruar që ato gjuhë të jenë të barabarta në përdorimin zyrtar në territorin ku janë në zbatim.

Në kushtetutat e krahinave socialiste autonome rregullohet më afër përdorimi i barabartë i gjuhës serbokroate dhe i gjuhëve të kombësive në përdorim zyrtar në territorin e krahinave autonome.

25. Nevojitet që në dispozitat tjera të nenit 300, të Kushtetutës së RS të Serbisë, të cilat nuk janë përfshirë me pikat e mëparshme të Propozimit - nëse gjatë punës në ndryshimet kushtetuese konstatohet se dallimet në interpretim nuk mund të tejkalohen me interpretim unik - të kryhen saktësimet e nevojshme të arritjeve dhe përmbajtjeve të ligjeve të cilët aplikohen unikisht në territorin e mbarë RS të Serbisë dhe të realizimit konsekuent të pozitës së themeluar me Kushtetutë të krahinave socialiste autonome.

26. Me qëllim të sigurimit që Kryesia e RS të Serbisë të realizojë funksionin e vet në mbarë territorin e Republikës në fushën e mbrojtjes popullore, të punëve të brendshme, bashkëpunimit ndërkombëtar, realizimine barazisë së kombeve e të kombësive dhe në fushat tjera, është e domosdoshme që në përputhje me dispozitat e paraqitura në pikat tjera të Propozimit, të saktësohen dispozitat kushtetuese mbi kompetencat e Kryesisë së RS të Serbisë.

27. Autorizimet legjislativ të Republikës duhet plotësuar me këto autorizime: mbrojtjen e tokës nga ndotja; mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të njerëzve nga sëmurjet ngjitëse të cilat rrezikojnë tërë Republikën, si dhe përcaktimin e të mirave kulturore me rëndësi të jashtëzakonshme për Republikën dhe mënyrën e sigurimit të kushteve për mbrojtjen e tyre.

28. Për shkak të realizimit konsekuent të mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë lypset të sigurohet vlerësimi i kushtetutshmërisë së ligjeve republikane të cilat miratohen në bazë të pëlqimit të kuvendeve të krahinave autonome, me respektimin specifikitetit të karakterit dhe të mënyrës së miratimit të atyre ligjeve.

29. Në Kushtetutën e RS të Serbisë duhet saktësuar natyrën dhe karakterin e mendiemve që i japin kuvendit e krahinave autonome në procedurën e miratimit të ligjeve me aplikim unik, si dhe sjelljet ndaj atyre mendiemve.

30. Gjyqi Suprem i Serbisë duhet të vendos një trup të veçantë për delegacionin e gjyqeve, kur është fjala për aplikimin e ligjeve republikane unikisht në mbarë territorin e Republikës.

41. Me qëllim të sigurimit të ushtrimit konsekuent të politikës së caktuar të Kuvendit të RS të Serbisë, të ligjeve politike dhe të normave të tjera duhet përcaktuar:

- që organet republikane të administratës të mund të japin instruksione të detyrueshme dhe që në mënyrë të drejtëprdrejtë të kontrollojnë zbatimin e instruksioneve të dhëna organeve komunale të administratës;

- që organet republikane të administratës në rastet kur organi komunal i administratës nuk e kryen punën e caktuar administrative, e kjo mund të shkaktojë pasoja të rënda të dëmshme, mund ta kryej atë punë dhe për këtë ta njoftojë Këshillin Ekzekutiv të Kuvendit të RS të Serbisë.

- detyrat e organeve komunale që janë përgjegjës për kryerjen e ligjeve dhe të normave të tjera, janë që t'i njoftojnë organet kompetente republikane për kryerjen e tyre si dhe e reja dhe detyra e organeve republikane të administratës që nga organet komunale të administratës të kërkojë të dhënat dhe njoftimet

për zbatimin e ligjeve dhe për gjndjen në serën përkatëse; e drejta dhe detyra e Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të RS të Serbisë që para këshillave ekzekutive të kuvendeve komunale të inicojë çështjen e përgjegjësisë së organit kompetent të administratës për shkak të moszbatimit të ligjit të caktuar, të normës tejtrë apo të aktit të përgjithshëm, dhe për këtë ta njoftojë Kuvendin e RS të Serbisë;

- masat përkatëse që i marrin Kuvendi i RS të Serbisë dhe Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të RS të Serbisë në këtë rast në harmoni me kompetencat e tyre kushtetuese dhe me përgjegjësitë: Lypset krijuar baza kushtetuese që, sipas nevojës, në serat ose punët e caktuara me interes të përgjithshëm për Republikën të mundësojë ekskluzivisht organizimin e organeve republikane të inspektionit.

Duhet përcaktuar edhe të drejtën dhe detyrat e organeve republikane të administratës që të propozojnë iniciimin e procedurës dhe për konstatimin e përgjegjësisë së inspektorëve komunal.

B. PROPOZIMI PËR FILLIMIN E NDRYSHIMIT TË KUSHTETUTËS FEDERATIVE

III. MARRËDHËNIET NË FEDERATË, TË DREJTAT DHE DETYRAT DHE ORGANIZIMI I FEDERATËS

12. Për hir të krijimit të kushteve që realizimi i interesave të përbashkëta me bashkëpunim dhe përgjegjësinë imediate të republikave, krahinave autonome, komuna dhe të bashkësive të tjera politike të zhvillohet vazhdimisht dhe me sukses, duhet përcaktuar karakterin e këtyre ujdive dhe të përgjegjësisë për realizimin e zotimeve të marra eventualisht edhe të emërtohen fushat e dakordimit për të cilat janë të interesaurat të gjitha republikat socialiste dhe krahinat socialiste autonome.

13. Në mënyrë që të sigurohen premiset për funksionim të suksesshëm të tregut unik jugosllav, lypset përcaktuar se bazën e tregut unik jugosllav e përbëjnë edhe:

- bazat unike të sistemit tatimor dhe bazat e përbashkëta të politikës tatimore;
- strategjia unike e zhvillimit shkencor-teknologjik.

Në harmoni me këtë, duhet përcaktuar se bazat e sistemit tatimor rregullohen me Ligjin Federal.

15. Për hir të krijimit të kushteve për zbatimin unik e efikas të ligjeve federative, të normave dhe të akteve të tjera të përgjithshme të cilat i zbatojnë organet në republika dhe krahina autonome, si ato për zbatimin e të cilave përgjegjës janë organet federative, asht uedhe të atyre për zbatimin e të cilëve përgjegjëse janë organet në republika e krahina autonome, nevojitet:

- që të kihet pasqyra e zbatimit të ligjeve federative, të përcaktohet detyrimi i organeve republikane e krahinore që janë përgjegjës për zbatimin e tyre, që t'i njoftojnë organet federative për zbatimin e ligjeve federative dhe të normave të tjera federative si dhe të drejtën e detyrimit të organeve federative të administratës që nga organet republikane e krahinore të administratës të kërkojnë të dhënat dhe njoftimet për kryerjen e ligjeve dhe të dhënat për gjendjen në fushën përkatëse;

- ta autorizojnë Dhomën Federative që para këshillave ekzekutive republikane, përkatësisht të krahinave autonome të inicojë çështjen e përgjegjësisë së organit përkatës administrativ për moskryerjen e ligjit të caktuar federativ, të normës tjetër apo të aktit të përgjithshëm;

- të caktohet e drejta dhe obligimi i Këshillit Ekzekutiv Federativ që, nëse edhe pas tërheqjes së vërejtjes së Këshillit Ekzekutiv të Republikës, përkatësisht të Krahinës Autonome se nuk po zbatohet ligji i caktuar federativ ndonjë normë tjetër apo akti i përgjithshëm, për atë ta njoftojë Kuvendin e RSFJ, dhe të parashikohen masat përkatëse të cilat në këtë rast do t'i marrë kuvendi, si dhe të drejtën e Këshillit Ekzekutiv Federativ që në këtë rast edhe vetë të marrë masat adekuate në përputhje me kompetencat dhe autorizimet e veta kushtetuese, dhe që me masat e marra ta njoftojë menjëherë Kuvendin e RSFJ;

- kur është fjala për ligjet federative, normat tjera ose aktet e përgjithshme të cilat direkt i kryejnë organet në republika dhe krahina autonome, e për kryerjen e të cilave janë përgjegjës organet federative, autorizimet e organeve federative (të cilat sipas zgjidhjeve të tashme kushtetuese mundet por nuk është e

domosdoshme që të caktohen me ligjin federativ) duhet caktuar direkt me Kushtetutën e RSFJ si e drejtë dhe obligim të atyre organeve;

- të shqyrtohet mundësia për shtrirjen e detyrimeve të inspekcioneve federative në fushat e caktuara, në harmoni me të drejtat dhe detyrat e Federatës, dhe të saktësohet e drejta e kontrollit dhe autorizimet tjera të cilat do të përcaktoheshin me ligjin federativ.

18. Me sendërtimin dhe saktësimin e dispozitave përkatëse të Kushtetutës së RSFJ mbi të drejtat dhe detyrat e Federatës duhet mundësuar që në mënyrë unike të rregullohen çështjet e caktuara për të cilat në aplikimin e deritashëm të Kushtetutës së RSFJ u tregua se rregullimi i tyre duhet të jetë në kompetencën e Federatës, sepse pa rregullimin e tyre unik nuk mund të sigurohet sistemi unik i marrëdhënieve vetëqeverisëse shoqërore politike dhe bazat unike të sistemit politik.

Nisur nga ky qëndrim parimor, lypset plotësuar të drejtat dhe detyrat e Federatës, ashtu që Federata:

- të rregullojë bazat e sistemit të administratës së shtetit;

- të rregullojë bazat unike të sistemit tatimor;

- të caktojë bazat e sistemit të rezervave të mallërave;

- të rregullojë bazat e sistemit të informimit publik;

- të rregullojë jo vetëm pozitën dhe funksionet kryesore, por edhe organizimin e Shërbimit të Kontabilitetit Shoqëror;

- të rregullojë bazat unike të organizimit të funksionit edhe të marrëdhënieve vetëqeverisëse shoqërore ekonomike në fushat në të cilat ekziston uniteti i sistemit tekniko-teknologjik, dhe të cilat janë me intres për mbarë vendin (siç janë: PTT, hekurudhat dhe elektro-ekonomia);

- përpos kësaj që rregullon, duhet edhe të sigurojë drejtimin dhe disponimin e mjeteve shoqërore të cilat shfrytëzohen në Armatën Popullore të Jugosllavisë dhe për nevojat e saja;

- përpos asaj që rregullon mbrojtjen dhe avancimin e ambientit të njeriut me interes për mbarë vendin dhe bashkësinë ndërkombëtare, duhet edhe të sigurojë kryerjen e normave federative në këtë fushë;

- përpos asaj që rregullohen prodhimin dhe qarkullimin e drogave helmuese, duhet edhe të sigurojë kryerjen e normave federative në këtë fushë;

- të rregullojë prodhimin dhe shfrytëzimin e energjisë bërthamore dhe mbrojtjen nga rrezatimi i jonizuar;

- të rregullojë bazat e sistemit të bashkimit të njerëzve punues e të qytetarëve në organizatat shoqërore dhe shoqata të qytetarëve;

- të rregullojë kushtet për marrjen dhe transplatimin e pjesëve të trupit të njeriut;

- të rregullojë bazat unike të veprimtarisë gjeodezike me interes për mbarë vendin;

- të rregullojë parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor;

- të rregullojë bazat e organizimit dhe të funksionimit të shërbimit të të ardhurave shoqërore;

- rregullon mënyrën unike të pasqyrimin të produktit shoqëror;

- rregullon bazat e përbashkëta të sistemit të arsimit, në përputhje me nenin 165. të Kushtetutës së RSFJ.

Duke marrë parasysh faktin se është propozuar se bazen e tregut unik jugosllav e përbën edhe strategjia unike e zhvillimit shkencor-teknologjik, Federata duhet ta caktojë këtë strategji. 19. (...)

- të shqyrtohet mundësia e kontributit më të madh të Dhomës Federative për zgjidhjen e disa çështjeve të rëndësishme gjithëshoqërore për të cilat vendos Dhomat e Republikave dhe e Krahinave.

Për hir të eliminimit të paqartësive mbi karakterin e pajtueshmërisë së kuvendeve të republikave, përkatësisht të krahinave autonome, me rastin e miratimit të ligjeve apo të akteve të tjera të përgjithshme në Dhomën e Republikave e të Krahinave në Kuvendin e RSFJ, duhet përjashtuar mundësinë që shprehja e mospajtit me projektin e aktit të pengohet procedura e harmonizimit e cila realizohet në organet

përkatëse të asaj dhome. Njëkohësisht, do të duhej shikuar mundësinë e thjeshtësimit të procedurës së vendosjes në atë dhomë për shkak të efikasitetit të saj.

(...)

22. Realizimi i plotë dhe konsekuent i konceptit kushtetutes të Federatës jugosllave dhe i marrëdhënieve mbi të cilat mbështetet uniteti dhe bashkëjetesa në Republikën Socialiste të Serbisë, supozon realizimin e plotë dhe konsekuent të realizimit të pozitës kushtetuese të Republikës Socialiste të Serbisë si shtet dhe si bashkësi socialiste, vetëqeverisëse e demokratike, dhe realizimin e pozitës kushtetuese të krahinave socialiste autonome si bashkësi autonome socialiste, vetëqeverisëse, demokratike shoqëro-politike në përbërje të Republikës Socialiste të Serbisë dhe elemente konstitutive të Federatës jugosllave.

(...)

Nisur nga kjo, nevojitet që në procedurën e ndryshimit të Kushtetutës së RSFJ, të shqyrtohet se a ka në pjesën normative të Kushtetutës së RSFJ dispozita me të cilat pozita kushtetuese e Republikës Socialiste të Serbisë dhe e Krahinave Socialiste Autonome, nuk shprehet me konsekuencë në harmoni me parimet themelore të Kushtetutës së RSFJ. Kjo ka të bëjë me: nenin 171. paragrafi 2; nenin 250; nenin 254; paragrafi 2; neni 271 paragrafi 2; nenin 281. paragrafi 1, pikat 10 e 15; nenin 369, pika 1, 2 dhe 6; nenin 375 paragrafi 1, pika 5 e 6.

(...)

IV. KUSHTETUTSHMËRIA DHE LIGJSHMËRIA, GJYKATA FEDERATIVE, PROKURORIA PUBLIKE FEDERATIVE DHE GJYKATA KUSHTETUESE FEDERATIVE

23. (...) Të mundësohet që me ligjin federative të caktohet se cilat të drejta dhe liri të njerëzve punonjës dhe të qytetarëve, që janë përcaktuar me Kushtetutën e RSFJ dhe të cilat sigurohen me ligjet federative, do të realizohen me anë të organeve dhe organizatave federative.

24. Për shkak të sigurimit të aplikimit konsekuent dhe unik të ligjeve federative, do të duhej që të:

- siguroheht, në të gjitha kushtet kur Ligji Republikan përkatësisht Krahinor është në kundërshtim me Ligjin Federativ, aplikimin e përkohshëm të ligjit federativ deri në vendimin e Gjykatës Kushtetuese; njëkohësisht të caktohet edhe obligimi i inicimit të procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve të tilla republikane, përkatësisht krahinore;

(...)

- plotësohen zgjidhjet kushtetuese të cilat mundësojnë nxjerrjen e Ligjit Republikan, përkatësisht Krahinor në fushat të cilat rregullohen me Ligjin Federativ, në qoftë se Ligji Federativ nuk është miratuar, ashtu që duhet siguruar që, sipas rregullit, Ligji Republikan, përkatësisht Krahinor të pushojë të vlejë pas miratimit të ligjit federativ me të cilin janë rregulluar marrëdhëniet e caktuara.

25. Të caktohet që Gjykata Federative, si gjykatë më e lartë në kuadër të të drejtave dhe detyrave të Federatës, të sigurojë mbrojtjen unike të marrëdhënieve të caktuara të rregulluara me ligjet e caktuara federative, e veçmas të atyre për kryerjen e të cilëve, sipas Kushtetutës së RSFJ, janë përgjegjës organet e Federatës.

(...)

Për shkak të mbrojtjes efikase të pozitës së barabartë të subjekteve në tregun unik jugosllav, duhet saktësuar kompetencën tani më të caktuar të Gjykatës Federative që në shkallën e fundit ose sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik vendos për kontestet për shkak të shkeljes së tregut unik jugosllav, e veçmas për kontestet ekonomike në të cilat subjektet janë nga republikat e ndryshme socialiste dhe krahinat socialiste autonome (...)

26. Aplikimi konsekuent dhe unik i normave federative imponon shtrirjen e autorizimeve të Prokurorit Publik Federativ lidhur me dhënien e udhëzimeve të detyrueshme prokurorëve publik

republikan e krahinor dhe marrjen e ndjekjes për të gjitha shkeljet e caktuara me Ligjin Federativ, e jo vetëm për ato të caktuara me Ligjin Federativ, e jo vetëm për ato të caktuara me Ligjin Federativ për zbatimin e të cilave janë përgjegjës organet federative.

(...)

27. Për shkak të afirmimit të mëtejshëm të rolit të Gjykatës Kushtetuese të Jugosllavisë në sistem, të saktësohet ndikimi përkatësisht pasojat e vendimit të Gjykatës Kushtetuese Federative me të cili norma (përpos ligjit) dhe akti tjetër i përgjithshëm i organit të bashkësisë shoqëro-politike ose akti i përgjithshëm vetëqeverisës anulohet ose pezullohet.

Gjithashtu, është e domosdoshme të shtrihet kompetenca e Gjykatës Kushtetuese të Jugosllavisë në vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve të përgjithshme vetëqeverisëse të organizatave të punës së bashkuar dhe të organizatave ebashkësive tjera vetëqeverisëse të cilat në përbërjet e veta kanë organizata themelore të punës së bashkuar, përkatësisht organizata punuese në territorin e dy apo më shumë republikave a krahinave autonome, nëse gjykatat kushtetuese të republikave përkatësisht të krahinave autonome vendosin ndryshe për çështjen e njëjtë dhe në këtë mënyrë të eliminohen paqartësitë në caktimin e kompetencave të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë procedurë, Gjykata Kushtetuese e Jugosllavisë do të vendoste për kundërshtimet e akteve të përgjithshme vetëqeverisëse me ligjet federative, pavarësisht nga fakti nëse për kryerjen e ligjeve federative janë përgjegjës organet federative apo organet e republikave përkatësisht të krahinave autonome.

(...)

(...)

Kryesia e RSFJ konsideron se është e nevojshme që sipas procedurës së caktuar me Kushtetutë, të organizohet aktiviteti më i gjithanshëm ideo-politik i forcave të organizuara socialiste në Lidhjen Socialiste të Popullit Punues të Jugosllavisë, i delegacioneve dhe delegatëve në kuvende, në mënyrë që të krijohen kushtet për një angazhim më të madh demokratik dhe kontribut të plotë krijimtar i njerëzve punues, i mendimit më kreativ shkecor, profesioanl e tjetër për përpunimin krijimtar dhe gjetjen e zgjidhjeve kushtetuese-juridike në kuadër të drejtimit të ndryshimeve të caktuara me këtë propozim.

Në këtë procedurë është e domosdoshme të realizohet koordinimi i plotë i punës në ndryshimin e Kushtetutës së RSFJ dhe i punës në ndryshimin e kushtetutave të republikave dhe të kushtetutave të krahinave autonome, për organizimin e aksionit unik shoqëro-politik dhe vetëqeverisës në ndryshimet kushtetuese dhe për ndërtimin e zgjidhjeve të harmonizuara kushtetuese në sistemin tonë kushtetues në tërësi.

Kryetari i kryesisë së
Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë,
Sinan Hasani, d.v.

C) AMENDAMENTET NË KUSHTETUTËN E RSFJ¹

Pasi që me amendamentet në Kushtetutën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të cilat i miratoi Dhoma Federative e Kuvendit të RSFJ në mbledhjen e 22 tetorit të vitit 1988, në kuptimin e nenit 402. paragrafi 1. të Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, janë pajtuar kuvendet e të gjitha republikave dhe kuvendet e krahinave autonome, dhe atë:

- Kuvendi i RS të Bosnjës e Hercegovinës në mbledhjen e përbashkët të të gjitha dhomave, më 22. nëntor të vitit 1988,

Kuvendi i RS të Malit të Zi në mbledhjen e përbashkët të të gjitha dhomave, më 21 nëntor të vitit 1988,

- Kuvendi i RS të Kroacisë në mbledhjen e Dhomës së Punës së Bashkuar, Dhomën e Komunave dhe Dhomën Shoqëro-politike, më 22 nëntor të vitit 1988.

- Kuvendi i RS të Maqedonisë në mbledhjen e përbashkët të të gjitha dhomave, më 22 nëntor të vitit 1988,

- Kuvendi i RS të Sllovenisë në mbledhjen e Dhomës së Punës së Bashkuar, të Dhomës së Komunave dhe të Dhomës Shoqëro-politike, më 22 nëntor të vitit 1988,

- Kuvendi i RS të Serbisë në mbledhjet e Dhomës së Punës së Bashkuar, të Dhomës së Komunave dhe të Dhomës Shoqëro-politike, më 18 nëntor të vitit 1988.

- Kuvendi i KSA të Kosovës në mbledhjen e përbashkët të të gjitha dhomave, më 22 nëntor të vitit 1988,

- Kuvendi i KSA të Vojvodinës, në mbledhjen e përbashkët të të gjitha dhomave, më 22 nëntor të vitit 1988,

Kuvendi i RSFJ, në bazë të nenit 403 të Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, në mbledhjen e Dhomës Federative më 25 nëntor të vitit 1988, mori

VENDIM

Për shpalljen e amendamenteve në Kushtetutën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë

Shpallën amendamentet në Kushtetutën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të cilat i ka miratuar Dhoma Federative e Kuvendit të RSFJ në mbledhjen e 22 tetorit të vitit 1988.

Kuvendi i RSFJ

As. nr. 512
25 nëntor 1988.
Beograd

Kryetari i
Kuvendit të RSFJ
Dushan Popovski, d.v.

Kryetari i
Dhomës Federative
Stjepan Novaković, d.v.

¹ Gazeta zyrtare e RSFJ, nr. 70, Beograd, 26. 11. 1988.

Amendamenti XXVII

1. Me ligj ose nëligjin e mbështetur në vendimin e kuvendit komunal caktohet mënyra e ushtrimit të autorizimeve publike të cilat u besohen organizatave dhe bashkësive të caktuara dhe të drejtat e komunave e të organeve të tjera të bashkësisë shoqëro-politike lidhur me dhënie direktivave atyre organizatave dhe bashkësive dhe lidhur me ushtrimin e kontrollit që kanë të bëjnë me ushtrimin e autorizimeve publike.

2. Me ligj mund të normohet detyrimi i bashkimit ose i sigurimit të mjeteve në mënyrë tjetër për sigurimin material të personave të papunësuar, rikualifikimin e punëtorëve dhe krijimin e kushteve më të volitshme për punësim në përgjithësi.

3. Pjesëtarët e kombeve dhe të kombësive të Jugosllavisë kanë të drejtën e mësimit në gjuhën e vet në harmoni me Kushtetutën dhe ligjin.

4. Të gjitha normat dhe aktet tjera të përgjithshme të organeve federative duhet të jenë në harmoni me ligjin federativ.

Ligji republikan dhe krahinor dhe normat tjera e aktet e përgjithshme të organeve të bashkësive shoqëro-politike, nuk mund të jenë në kundërshtim me ligjin.

5. Me ligjin federativ caktohen parimet për formimin në kuadër të gjyqeve të rregullta edhe të parimeve për zgjedhjen dhe pushimin e funksionit të gjykatësit.

6. Gjyqtarët e gjykatave të rregullta zgjidhen dhe shkarkohen sipas mënyrës dhe kushteve e procedurës me të cilat sigurohet aftësia për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit dhe pavarësia e gjyqtarëve në gjykim.

7. Prokurori publik ka të drejtë dhe detyrë që direkt t'i jap prokurorit të ulët publik e kur kjo është caktuar me kushtetutë edhe prokurorëve të tjerë publikë, udhëzime të detyrueshme për punën e tyre.

Me Ligj Federativ caktohen parimet për formimin e prokurorive publike dhe të parimeve mbi emërimin dhe pushimin e funksionit të prokurorit publik.

8. Me pikën 1. zëvendësohet paragrafi 2. i nenit 152; me pikën 2, plotësohet neni 159; me pikën 3. zëvendësohet paragrafi 2. i nenit 171; me pikën 4. zëvendësohet paragrafi 1 e 2 i nenit 207, dhe pezullohet paragrafi 3. i nenit 207; me pikën 5. plotësohet neni 220; me pikën 6. zëvendësohet paragrafi 2. i nenit 230; me pikën 7. plotësohet neni 235. i Kushtetutës së RSFJ.

Amendamenti XXX

1. Vendimet, dokumentat dhe aktet tjera individuale të dhëna nga organet e shtetit dhe nga organizatat e autorizuar, kanë vlerë të njëjtë në mbarë territorin e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

2. Janë antikushtetuese të gjitha normat dhe aktet tjera e veprimet me të cilat organizatat e punës së bashkuar ose njerëzit punonjës varësisht nga qëndrimi përkatësisht vendbanimi, vëhen në pozitë të pabarabartë.

3. Me pikën 1. zëvendësohet neni 250, me pikën 2. zëvendësohet paragrafi 2. i nenit 254, të Kushtetutës së RSFJ.

Amendamenti XXXI

1. Bazën e tregut unik jugosllav e përbëjnë:
- paraja unike, sistemi unik monetar, kreditor dhe devizor, politika e përbashkët monetare e devizore dhe bazat e përbashkëta të politikës kreditore;
- bazat unike të sistemit tatimor dhe bazat e përbashkëta të politikës tatimore;

- politika e përbashkët e zhvillimit ekonomik e shoqëror e përcaktuar me planin shoqëror të Jugosllavisë dhe strategjia e zhvillimit shkencor-teknologjik e Jugosllavisë.

2. Republikat dhe Krahinat autonome, nëse këtë e kërkon siguri i unitetit dhe i stabilitetit të tregut jugosllav, me marrëveshje reciproke e harmonizojnë politikën tatimore dhe sistemin tatimor, të cilat i përcaktojnë, përkatësisht i rregullojnë në kuadër të drejtave dhe detyrave të veta.

3. Punët në fushën e kryerjes së detyrimeve të pagimit të tatimit të caktuar dhe të tatimeve tjera, përkatësisht të kontributit të pagesave të tatimit, të caktuar me ligj, e kryejnë shërbimet e të ardhurave shoqërore si shërbime shoqërore.

Shërbimet e fitimeve shoqërore punojnë në bazë të ligjit dhe normave të tjera dhe janë përgjegjëse për aplikimin e tyre në harmoni me ligjin.

Me ligjin federativ rregullohen edhe pozita e funksionet themelore të shërbimeve të fitimeve shoqërore.

4. Me pikën 1, paragrafi 1. zëvendësohet paragrafi 2, pika 1. e nenit 252; me pikën 1. alineja 2. plotësohet me paragrafin 1. të nenit 252; me pikën 1. alineja 3. zëvendësohet alineja 6. paragrafi 1. i nenit 252; me pikën 2. zëvendësohet paragrafi 1. i nenit 265; me pikën 3. plotësohet kreu I, pjesa 3 e Kushtetutës së RSFJ.

Amendamenti XXXVI

1. Republikat dhe krahinat autonome e realizojnë bashkëpunimin me organizatat dhe organet e shteteve të huaja dhe me organizatat ndërkombëtare në kuadrin e politikës së caktuar të jashtme të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe të kontratave ndërkombëtare, kurse Krahinat autonome kur kjo është caktuar me Kushtetutën e Republikës Socialiste të Serbisë dhe në kuadrin e realizimit të bashkëpunimit ndërkombëtar të Republikës Socialiste të Serbisë.

Republikat dhe krahinat autonome bashkëpunojnë në mes veti në realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, kurse me organet federative e harmonizojnë realizimin e bashkëpunimit të vet ndërkombëtar. Krahinat autonome e harmonizojnë realizimin bashkëpunimit të vet ndërkombëtar edhe me organet e Republikës Socialiste të Serbisë.

2. Me këtë amendament zëvendësohet paragrafi 2. i nenit 271. i Kushtetutës së RSFJ.

Amendamenti XXXVII

2. Kur organet e administratës në republikën dhe krahinat autonome i kryejnë direkt ligjet federative, normat tjera dhe aktet e përgjithshme për zbatimin e të cilave janë përgjegjës organet federative të administratës, organet administrative të Federatës kanë të drejtë dhe detyrë që organeve kompetente republikane dhe organeve krahinore të administratës t'u japin direktiva të detyrueshme për zbatimin e tyre.

3. Nëse organet kompetente, përveç organeve federative, nuk i kryejnë ligjet federative, normën tjetër apo aktin e përgjithshëm, ose nuk sigurojnë kryerjen e tyre, organi federativ i administratës e paralajmëron për këtë organin përkatës administrativ të Republikës përkatësisht të Krahinës dhe kërkon që në afatin e caktuar të marrë masat përkatëse me të cilat sigurohet zbatimin i tyre. Organi federativ i administratës e njofton për këtë Këshillin Ekzekutiv Federativ, kurse ai e njofton Këshillin Ekzekutiv të Kuvendit të Republikës përkatësisht Këshillin Ekzekutiv të Kuvendit të Krahinës Autonome.

Në qoftë se edhe krahas paralajmërimit dhe marrjes së masave nuk e siguron kryerjen e ligjit federativ, normës tjetër ose të aktit të përgjithshëm për zbatimin e të cilëve janë përgjegjës organet federative, Këshilli Ekzekutiv Federativ do të sigurojë zbatimin e tij dhe lidhur me këtë do ta njoftojë njëkohësisht Kuvendin e RSFJ. Këshilli Ekzekutiv Federativ mund t'i propozojë Kuvendit të RSFJ, që ta

njoftojë Kuvendin e Republikës, përkatësisht Kuvendin e Krahinës Autonome mbi masat e marra dhe të inicijetë çështjen e përgjegjësisë së organit kompetent republikan dhe krahinor, përkatësisht të funksionarit i cili drejton atë organ.

Amendamenti XXXIX

1. Federata me anë të organeve të veta:

(1) rregullon bazat e sistemit të administratës së shtetit; rregullon bazat e sistemit të informimit publik; rregullon bazat e këshillit shoqëror dhe të këshillit shoqëror federativ; rregullon bashkimin e qytetarëve në organizatat shoqërore dhe në shoqata të qytetarëve të cilat formohen në territorin e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë;

(2) përcakton strategjinë e zhvillimit shkencor-teknologjik të Jugosllavisë;

(3) rregullon sistemin devizor dhe siguron kryerjen e ligjeve federative në këtë fushë; përcakton politikën e përbashkët moentare e devizore dhe siguron zbatimin e saj;

(4) rregullon sistemin kreditor e bankar dhe rregullon bazat e përbashkëta të politikës kreditore;

(5) rregullon bazat e sistemit tatimor - burimet, llojet, detyruesit dhe mbështetjen; - që janë me rëndësi për funksionimin e tregut unik jugosllav;

(6) rregullon bazat e rezervave të mallrave;

(7) rregullon kushtet për hapjen e punës të zonave të lira;

(8) rregullon pozitën, bazat e organizimit e të funksionimit të Shërbimit të Kontabilitetit Shoqëror;

(9) rregullon bazat e pozitës juridike dhe të afarizmit të organizatave të punës së bashkuar dhe të subjekteve të tjerë e të afarizmit tregtar në rajonin unik ekonomik të Jugosllavisë;

(10) rregullon mënyrën unike të pasqyrimin të produktit shoqëror;

(11) rregullon dhe siguron drejtimin dhe disponimin e mjeteve shoqërore të cilat shfrytëzohen në Armatën Popullore Jugosllave dhe për nevojat e saj;

(12) rregullon himnin e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë;

(13) rregullon bazat e sistemit të mbrojtjes dhe të avansimit të ambientit të njeriut dhe mbrojtjen e avancimit e ambientit të njeriut me interes për mbarë vendin dhe bashkësinë ndërkombëtare dhe kryen kontrollin e materialit radioaktiv dhe mbrojtjen nga rrezatimi jonizues, dhe bënë kontrollin e zbatimit të normave federative në këtë fushë kur kjo është me interes për mbarë vendin dhe bashkësinë ndërkombëtare; rregullon kushtet për marrjen dhe transplatimin e pjesëve të trupit të njeriut; rregullon qarkullimin e helmeve dhe prodhimet e qarkullimin e drogave helmuese dhe kryen kontrollin mbi zbatimin e normave federative në ato fusha; rregullon qarkullimin dhe transportin e eksplozivave dhe të materieve radioaktive e tjera dhe deponimin e tyre, dhe transportin e lëngjeve djegëse e të gazave dhe kryen kontrollin mbi zbatimin e normave federative në ato fusha;

(14) rregullon regjimin e ujërave me interes për mbarë vendin dhe të ujërave ndërkombëtare dhe bënë kontrollin e zbatimit të normave federative në këtë fushë;

(15) rregullon bazat e veprimtarisë gjeodete dhe gjeologjike me interes për mbarë vendin;

(16) rregullon dhe siguron sistemin e kryerejs së sanksioneve penale të personave aktiv ushtarak dhe të të huajve, të dënuar;

(17) rregullon dhe siguron: sistemin e njërive matëse dhe kontrollin e masave e të metaleve të çmueshme, mbrojtjen e zbulimeve, të përparimeve teknike, të vulave, shenjave të cilësisë, të shenjave të zanafillës së produktive, mostrave dhe modeleve, standardeve, të normativave teknike dhe të normave të cilësisë së produkteve, mallrave dhe të shërbimeve;

(18) rregullon bazat e kërkimeve të atmosferës dhe bazat e veprimtarisë meteorologjike dhe hidrologjike me interes për mbarë vendin;

(19) rregullon zgjidhjen e konflikteve të ligjeve republikane përkatësisht të ligjeve krahinore me

ligjet e republikave tjera, (normat kolizione) dhe konfliktet e kompetencave midis organeve republikane përkatësisht krahinore nga territoret e republikave të ndryshme.

(Me këtë amendament janë bërë ndryshime në nenin 284 të Kushtetutës së RSFJ)

Amendamenti XLV

1. Gjykata federative:

1. vendos, sipas kukshteve dhe mënyrës së caktuar me ligjin federativ, në shkallën e fundit ose sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik mbi kontestet që lindin midis akteve veç e veç kundërkushtetues e kundërligjor dhe veprimeve me të cilat organizatat e punës së bashkuar ose njerëzit punonjës varësisht nga seilia, përkatësisht nga vendbanimi, vëhen në tregun unik jugosllav në pozitë të parabarabartë, ose me të cilat në forma tjera prishet uniteti i tregut jugosllav, përfshirë edhe kontestet mbi kompensimin e dëmit që shkaktohet me atë;

2. vendos që kontestet pronësore midis Federatës dhe republikave, përkatësisht krahinave autonome, si dhe midis republikave përkatësisht krahinave autonome dhe republikës tjetër;

3. vendos për ligjshmërinë e akteve finale juridike të organeve federative, nëse me ligjin federativ nuk është rregulluar ndryshe;

4. vendos për mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të gjykatave të rregullta e vetëqeverisëse, nëse kjo është caktuar me ligjin federativ;

5. vendos në shkallën e fundit për aktgjykimet e gjykatave të republikave e të krahinave autonome, si dhe të gjykatave ushtarake kur është shqiptuar dënimi me vdekje për vepra penale të caktuara me Ligjin Federativ;

6. zgjidh për konfliktet e kompetencave midis gjykatave nga territoret e dy apo më shumë republikave, midis gjykatave nga territori i krahinave autonome dhe gjykatave nga territori i republikave tjera, si dhe midis gjykatave ushtarake e gjykatave tjera;

7. ushtron edhe punë tjera që i janë vënë në kompetencë me Ligjin Federativ, në kuadrin e të drejtave dhe detyrave të Federatës.

2. Me këtë amendament zëvendësohet neni 369 i Kushtetutës së RSFJ.

ZGJEDHJET KUSHTETUESE
NË REPUBLIKËN FEDERALE TË
JUGOSLLAVISË DHE NË
BOSNJË E HERCEGOVINË

A. NGA KUSHTETUTA E RF TË JUGOSLLAVISË
(MIRATUAR NË 27 PRILL 1992)

KAPITULLI I

DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1.

Republika Federale e Jugosllavisë është shtet sovran federal, e mbështetur në barazinë e qytetarëve dhe barazinë e republikave anëtare.

Neni 2.

Republikën Federale të Jugosllavisë e përbëjnë Republika e Serbisë dhe Republika e Malit të Zi si shtete anëtare.

Neni 3.

Territori i Republikës Federale të Jugosllavisë është unik dhe e përbëjnë territoret e republikave anëtare.

Kufiri i Republikës Federale të Jugosllavisë është i pacenueshëm.

Kufiri midis shteteve anëtare mund të ndryshohet vetëm me marrëveshjet e tyre në harmoni me kushtetutat e republikave anëtare.

Neni 6.

Republika anëtare është shtet në të cilin pushteti u takon qytetarëve.

Republika anëtare është sovrane në çështjet të cilat nuk janë përcaktuar me këtë Kushtetutë si kompetenca të Republikës Federale të Jugosllavisë.

Republikat anëtare e përcaktojnë mëvetësisht organizimin e pushtetit në kushtetutat e veta.

Garantohet e drejta e vetëqeverisjes lokale në harmoni me kushtetutën e republikës anëtare.

Neni 7.

Republika anëtare, në suazat e autorizimeve të veta, mund të mbajë marrëdhënie ndërkombëtare, të formojë përfaqësitë e veta në shtetet tjera dhe të anëtarësohet në organizatat ndërkombëtare.

Republika anëtare, në suazat e autorizimeve të veta mund të lidhë marrëveshje ndërkombëtare, por jo në dëm të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe të republikës tjetër anëtare.

Neni 11.

Republika Federale e Jugosllavisë i njeh dhe i garanton të drejtat e pakicave kombëtare për ruajtjen, zhvillimin dhe shprehjen e veçorive të tyre etnike, kulturore, gjuhësore e të tjera si dhe për përdorimin e simboleve nacionale në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

Neni 15.

Në Republikën Federale të Jugosllavisë në përdorimin zyrtar janë gjuha serbe e dialektit ekavik dhe ijekavik dhe alfabeti cirilik, kurse alfabeti latin është në përdorim zyrtar në harmoni me Kushtetutën dhe ligjin.

Në rajonet e Republikës Federale të Jugosllavisë ku jetojnë pakicat kombëtre në përdorim zyrtar janë edhe gjuhët e alfabetet e tyre në harmoni me ligjin.

Neni 45.

Garantohet liria e shprehjes së përkatësisë dhe kulturës nacionale, si dhe përdorimet e gjuhës dhe alfabetit vetjak.

Askush nuk është i detyruar të deklarohet për përkatësinë e vet nacionale.

Neni 46.

Pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtën e shkollimit në gjuhën e vet në harmoni me ligjin. Pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtën për informim publik në gjuhën e tyre.

Neni 47.

Pjesëtrët e pakicave kombëtare kanë të drejtë, në harmoni me ligjin, të formojnë organizatat ose shoqatat arsimore e kulturore, të cilat financohen mbi baza vullnetare kurse shteti mund t'i ndihmojë.

Neni 48.

Pjesëtarëve të pakicave kombëtare u garantohet e drejta për të vendosur dhe mbajtur marrëdhënie reciproke të papengueshme në Republikën Federale të Jugosllavisë dhe jashtë kufijve të saj me pjesëtarët e kombit të vet në shtetet tjera, që të marrin pjesë në organizatat joqeveritare ndërkombëtare, por jo në dem të Republikës Federale të Jugosllavisë ose të republikës anëtare.

Neni 49.

Secilit i garantohet e drejta që në procedurën para gjyqit ose organit tjetër shtetëror apo të organizatës e cila në kryerjen e autorizimeve publike zgjidh të drejtat dhe detyrimet e tija, e përdor gjuhën e vet dhe se në atë procedurë njihet me faktet në gjuhën e vet.

Neni 50.

Është antikushtetuese dhe e dënueshme çdo nxitje dhe provokim i mosbarazisë nacionale, racore, fetare ose tjetër, si dhe nxitja e provokimi i intolerancës dhe i urrejtjes nacionale, racore, fetare e tjetër.

2. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SERBISË (MIRATUAR MË 28 SHTATOR 1990)

I. DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1.

Republika e Serbisë është shtet demokratik i të gjithë qytetarëve që jetojnë në të, i mbështetur në të drejtat dhe liritë e njeriut e të qytetarit, në sundimin e drejtësisë dhe në të drejtën sociale.

Neni 2.

Sovraniteti u takon të gjithë qytetarëve të Republikës së Serbisë. Qytetarët e realizojnë sovranitetin me referendum, iniciativën popullore dhe me anë të përfaqësuesve të vet të zgjedhur lirisht.

Neni 3.

Në Republikën e Serbisë është e lirë gjithçka që nuk është e ndaluar me Kushtetutë dhe ligj. Me Kushtetutë garantohen dhe njihen të drejtat personale, politike, nacionale, ekonomike, sociale, kulturore e tjera të njeriut e të qytetarit.

Neni 4.

Territori i Republikës së Serbisë është unik dhe i patjetërsueshëm. Për ndryshimin e kufirit të Republikës së Serbisë vendosin qytetarët me referendum.

Neni 5.

Republika e Serbisë ka stemën, flamurin dhe himnin. Stema, flamuri dhe himni i Republikës së Serbisë përcaktohen sipas procedurës së parashikuar për ndryshimin e Kushtetutës. Kryeqyteti i Republikës së Serbisë është Beogradi.

Neni 6.

Në Republikën e Serbisë ekzistojnë Krahina Autonome e Vojvodinës dhe Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë, si forma të autonomisë territoriale.

Neni 8.

Në Republikën e Serbisë në përdorim zyrtar janë gjuha serbokroate dhe alfabeti cirilik, kurse alfabeti latin është në përdorim zyrtar sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Në rajonet e Republikës së Serbisë ku jetojnë kombësitë në përdorim zyrtar janë njëkohësisht edhe gjuhët e alfabetet e tyre, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

II. LIRITË, TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E NJERIUT E TË QYTETARIT

Neni 13.

Qytetarët janë të barabartë në të drejtat dhe obligimet e veta dhe kanë mbrojtjen e njëjtë para organeve shtetërore e tjera pavarësisht nga raca, gjinia, lindja, gjuha, përkatësia nacionale, predikimi fetar, bindja politike a tjetër, arsimimi, prejardhja sociale, gjendja pronësore apo të ndonjë vetie personale.

Neni 49.

Qytetari i garantohet liria e shprehjes së përkatësisë nacionale, e kulturës dhe e përdorimit të lirë të gjuhës dhe alfabetit të vet.

Qytetari nuk është i detyruar të dekalohet mbi përkatësinë e vet kombëtare.

VI. ORGANIZIMI TERRITORIAL

Krahina Autonome e Vojvodinës dhe Krahina Autonome e Kosovës e Metohisë

Neni 108.

Krahinat autonome janë formuar në përputhje me veçoritë e posaçme nacionale, historike, kulturore dhe tjera rajoneve të tyre.

Qytetarët në Krahinën Autonome i realizojnë mëvetësisht të drejtat dhe i përmbushin detyrimet e përcaktuara me kushtetutë dhe ligj.

Territori i Krahinës Autonome përcaktohet me ligj.

Neni 109.

Krahina Autonome me anë të organeve të veta:

1. nxjerr programin e zhvillimit ekonomik, shkencor, teknologjik, demografik, rajonal e social dhe të zhvillimit të bujqësisë e të fshatit në harmoni me planin zhvillimor të Republikës së Serbisë, dhe i përcakton masat për zbatimin e tij;

2. nxjerr buxhetin dhe llogarinë përfundimtare;

3. nxjerr vendimet dhe aktet e përgjithshme në harmoni me Kushtetutën dhe ligjin, me të cilat rregullon çështjet e caktuara me interes për qytetarët në Krahinën Autonome në sferat e: kulturës, arsimit, përdorimit zyrtar të gjuhës dhe alfabetit të kombësive, të informimit publik, të mbrojtjes shëndetësore e sociale, të kujdesit shoqëror për fëmijët, të mbrojtjes dhe avancimit të ambientit të njeriut, të urbanizimit dhe të sferave tjera të përcaktuara me ligj;

4.1. zbaton ligjet dhe normat tjera e aktet e përgjithshme të Republikës së Serbisë ekzekutimi itë cilave u është besuar organeve të Krahinës Autonome dhe nxjerr normat për zbatimin e tyre kur kjo është parashikuar me ligj: siguron zbatimin e vendeve dhe të akteve të përgjithshme krahinore;

5. formon organet, organizatat dhe shërbimet e Krahinës Autonome dhe rregullon organizimin e punës e tyre;

6. i kryen edhe punët tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj, si dhe me statusin e Krahinës Autonome.

Republika e Serbisë mund t'ia besojë me ligj Krahinës Autonome kryerjen e punëve të caktuara nga

suazat e të drejtave dhe detyrimeve të veta dhe asaj t'ia bartë mjetet për ato punë.
Krahinës Autonome i takojnë të ardhurat e përcaktuara me ligj.

Neni 110.

Statuti është akti më i lartë i Krahinës Autonome me të cilin, në bazë të Kushtetutës, përcaktohen kompetencat e Krahinës Autonome, zgjedhja, organizimi dhe puna e organeve të saj dhe çështjet tjera me interes për Krahinën Autonome.

Statusin e Krahinës Autonome e miraton Kuvendi i saj me pëlqimin paraprak të Kuvendit Popullor.

Deputetët në Kuvendin e Krahinës Autonome nuk mund të thirren në përgjegjësi për mendimin e shprehur ose dhënien e votës në Kuvendin e Krahinës Autonome. Imunitet të njëjtë gëzojnë anëtarët e Këshillit Ekzekutiv.

Neni 111.

Organet e Krahinës Autonome janë: Kuvendi, Këshilli Ekzekutiv dhe organet e administratës.

Kuvendin e Krahinës Autonome e përbëjnë deputetët e zgjedhur në zgjedhjet e drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.

Neni 112.

Nëse organet e Krahinës Autonome edhe krahas vërejtjeve të organit përkatës republikan nuk e zbaton vendimin ose aktin e përgjithshëm të Krahinës Autonome, organi republikan mund të sigurojë direkt zbatimin e tij.

Ndryshimi i Kushtetutës

Neni 132.

Propozimin për ndryshimin e Kushtetutës mund ta paraqesin të paktën 100.000 zgjedhës, të paktë 50 deputetë popullorë, presidenti i Republikës dhe Qeveria.

Mbi propozimin për ndryshimin e Kushtetutës vendos Kuvendi Popullor me dy të tretat e shumicës nga numri i përgjithshëm i deputetëve popullorë.

Neni 133.

Kuvendi Popullor e miraton aktin për ndryshimin e Kushtetutës me dy të tretën e shumicës nga numri i përgjithshëm i deputetëve popullorë dhe e jep në referendum republikan për konfirmim.

Akti për ndryshimin e Kushtetutës konsiderohet definitivisht i miratuar nëse për të në referendumin republikan deklarohen më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të zgjedhësve.

Aktin për ndryshimin e Kushtetutës e shpallë Kuvendi Popullor.

VIII. RAPORTI NDAJ KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SOCIALISTE
FEDERATIVE TË JUGOSLLAVISË*Neni 135.*

Të drejtat dhe detyrimet që Republika e Sërbisë, e cila është në përbërje të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, i ka sipas kësaj Kushtetute, e të cilat sipas kushtetutës federative realizohen në Federatë, do të realizohen në harmoni me Kushtetutën Federative.

Kur me aktet e organeve të Federatës ose aktet e organeve të Republikës tjetër, në kundërshtim me të drejtat dhe detyrimet që i ka ajo sipas kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë prishet barazia e Republikës së Serisë, ose në mënyrë tjetër rrezikohen interesat e saj emë atë rast nuk është siguruar kompensimi, organet republikane nxjerrin akte për mbrojtjen e interesave të Republikës së Serisë.

LIGJI KUSHTETUES PËR ZBATIMIN E KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË SERISË

3. Aplikimi i dispozitave Kushtetuese mbi organet e krahinave autonome*Neni 12.*

Deri në ditën e hyrjes në fuqi të statutit të Krahinës Autonome, organet krahinore dhe organet tjera në Krahinën Autonome vazhdojnë punën në harmoni me dispozitat përkatëse të kushtetutës së krahinave socialiste autonome.

Me ditën e konstituimit të Kuvendit Popullor dhe të fillimit të detyrës së presidentit të Republikës, organet e Krahinës Autonome e vazhdojnë punën në harmoni me Kushtetutën.

Me ditën e pushimit të punës së Kryesisë së Krahinës Socialiste Autonome, anëtarin e Kryesisë së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë nga Krahina Autonome, në rastet e parashikura me Kushtetutën e RSFJ, e zëvendëson kryetari i Kuvendit Krahinor.

Neni 13.

Kuvendi Popullor do të nxjerrë vendimin e përkohshëm statutet të Krahinës Autonome të Kosovës e të Metohisë dhe do të shpallë zgjedhjet direkte e të fshehta për Kuvendin Krahinor, sipas dispozitave të Kushtetutës dhe të vendimit të përkohshëm statutar.

Kuvendi i ri i zgjedhur i Krahinës Autonome të Kosovës e Metohisë do të miratojë Statutin e Krahinës.

3. B. NGA KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË MALIT TË ZI

PJESA E PARË

DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1.

Shteti

Mali i Zi është shtet demokratik, social dhe ekologjik.

Mali i Zi është republikë.

Mali i Zi është anëtare e Republikës Federale të Jugosllavisë.

Neni 2.

Sovraniteti

Mali i Zi është sovran në çështjet të cilat nuk i ka bartur në kompetencat e Republikës Federale të Jugosllavisë.

Sovraniteti u takon qytetarëve.

Qytetarët e realizojnë pushtetin direkt dhe me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht.

Për ndryshimin e statusit të shtetit, të formës së sundimit dhe për ndryshimin e kufijve nuk mund të vendoset për zbatimin paraprak të referendumit të qytetarëve.

Neni 9.

Gjuha dhe shkrimi

Në Mal të Zi në përdorim zyrtar janë gjuha serbe e dialektit ijekavik.

Janë të barabarta shkrimet cirilike e latine.

Në komunat ku shumicën ose pjesën e konsiderueshme të popullatës e përbëjnë pjesëtarët e grupeve nacionale dhe etnike, në përdorim zyrtar janë edhe gjuhët e shkrimet e tyre.

PJESA E DYTË

TË DREJTAT DHE LIRITË

Neni 34.

Liritë e njeriut

Garantohet liria e bindjes dhe e ndërgjegjes.

Garantohet liria e mendimit dhe e shprehjes publike të mendimit, liria e besimit (fetare), e predikimit publik ose privat të fesë si dhe liria e manifestimit të përkatësisë nacioale, kulturore dhe përdorimi i gjuhës dhe shkrimit vetjak.

Askush nuk është i detyruar që të deklarohet për mendimin, fenë dhe përkatësinë e tij fetare.

Vërejtje: Pjesë nga Kushtetuta e RS të Serbisë kemi dhënë në kapitullin Autonomitë dhe të drejtat minoritare në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë. Kjo kushtetutë nuk është ndryshuar deri më sot.

BOSNJA E HERCEGOVINA
NGA KUSHTETUTA E UNIONIT TË B E H

Neni I

Bosnja e Hercegovina.

1. Vazhdimësia. Republika e Bosnjës dhe Hercegovinës emri zyrtar i të cilës do të jetë "Bosnja e Hercegovina", do të vazhdojë subjektivitetin e vet juridik ndaj të drejtës ndërkombëtare, si shtet, në kufijtë e saj të tashëm të njohur ndërkombëtar, kurse struktura e saj e brendshme do të modifikohet sikurse që është parashikuar me këtë dokument. Ajo edhe më tutje do të jetë shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara dhe do të mundet, si Bosnje e Hercegovinë, të mbetet anëtare ose të kërkojë anëtarësim në organizatat në kuadër të sistemit të Kombeve të Bashkuara dhe në organizatat tjera ndërkombëtare.

2. Parimet demokratike. Bosnja e Hercegovina do të jetë shtet demokratik, e udhëhequr nga sundimi i drejtësisë me zgjedhje të lira e demokratike.

3. Përbërja. Bosnja e Hercegovina do të përbëhet nga dy entitete: Federata e Bosnjës e Hercegovinës dhe Republika Serbe (në tekstin e mëtejme "Entitetet").

4. Qarkullimi i mallrave, shërbimeve e kapitalit dhe lëvizja e njerëzve. Në mbarë Bosnjën e Hercegovinën do të sigurohet liria e lëvizjes. Bosnja e Hercegovina dhe entitetet e saj nuk do të pengojnë lirinë e plotë të lëvizjes së njerëzve dhe qarkullimin e mallrave, shërbimeve dhe të kapitalit në territorin e mbarë Bosnjës e Hercegovinës. Asnjë entitet nuk do t'i kontrollojë kufijtë midis entiteteve.

5. Kryeqyteti. Kryeqyteti i Bosnjës e Hercegovinësdo të jetë Serajevo.

6. Simbolet. Simbolet e Bosnjës e Hercegovinës do t'i rregullojë Kuvendi, kurse shtetësiën e secilit entitet, do ta rregullojë çdo entitet, me kusht që:

- të gjithë shtetasit e secilentitet të jenë shtetas të Bosnjës e Hercegovinës;
- asnjë personi nuk do t'i shkurtohet arbitrarisht shtetësia e Bosnjës e Hercegovinës ose e entitetit, ashtu që ai person të mbetet pa shtetësi. Asnjë personi nuk do t'i shkurtohet shtetësia e Bosnjës e Hercegovinës ose e entitetit në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, gjuhës, predikimit fetar, të qëndrimeve politike e tjera, të prejardhjes nacionale ose sociale, të përkatësisë së pakicës kombëtare, të statusit pronësor dhe të fituar sipas lindjes ose të statusit tjetër;
- të gjithë personat që kanë qenë shtetas të Bosnjës e Hercegovinës direkt para hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, janë shtetas të Bosnjës e Hercegovinës. Shtetësia e personave të cilët shtetësië e kanë fituar pas 6 prillit të vitit 1992 e para hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, do ta rregullojë Kuvendi;
- shtetasit e Bosnjës e Hercegovinës mund të kenë shtetësinë e shtetit tjetër, me kusht që të ekzistojnë marrëveshje bilaterale i miratuar ng ana e Kuvendit në harmoni me neni IV (4) (d) midis Bosnjes e Hercegovinës dhe shtetit respektiv, e cila i rregullon këto çështje. Personat me shtetësi dygjuhësore mund të votojnë në Bosnjë e Hercegovinë dhe në entitetet e saj vetëm nëse qëndrimi i tyre i përhershëm është në Bosnjë e Hercegovinë.

e. shtetasit e Bosnjës e Hercegovinës në botën e jashtme do ta mbrojnë Bosnja e Hercegovina. Secili entitet mund t'u japë pasaporta të Bosnjës e Hercegovinës shtetasve të vet sipas mënyrës që e cakton Kuvendin. Bosnja e Hercegovina mund t'u jap pasaporta shtetasve të vet, të cilëve asnjë entitet nuk u ka dhënë pasaporta. Do të ekzistojë regjistri qendror i të gjitha pasaportave që i kanë dhënë entitet dhe Bosnja e Hercegovina.

Neni II

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut

1. Të drejtat e njeriut. Bosnja e Hercegovina dhe të dy entitetet e saj do të sigurojnë shkallën më të lartë të mundshme të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të njohura ndërkombëtarisht. Për këtë

qëllim do të formohet Komisioni për të Drejtat e Njeriut në Bosnjë e Hercegovinë sikurse që është parashikuar me aneksin 6 të marrëveshjes së përgjithshme suazë.

2. Standardet ndërkombëtare. Të drejtat dhe liritë që i mbanë Konventa Evropiane mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore dhe në protokollet e saj, do të aplikohen direkt në Bosnjë e Hercegovinë. Këto dokumente do të kenë përparësi mbi të gjitha ligjet tjera.

3. Të drejta individuale. Të gjithë personat në Bosnjë e Hercegovinë do t'i gëzojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të përmendura në paragrafin 2; aty bëjnë pjesë:

- e drejta për jetë,
- e drejta për të mos iu nënshtruar mundimit ose trajtimit johuman e poshtues ose ndëshkimit,
- e drejta për të mos u mbajtur në robëri ose në pozitë të nnështruar dhe të mos kryhet punë e dhunshme ose e detyrueshme,
- e drejta për lirinë dhe sigurinë personale,
- e drejta për marrje të drejtë në pyetje në procedurën civile e penale dhe të drejtat tjera lidhur me procedurën penale,
- e drejta për jetën private e familjare, për shtëpi dhe korrespondencë,
- liria e të menduarit, e ndërgjegjes dhe e predikimit fetar,
- liria e të shprehurit,
- liria e tubimit të qetë dhe liria e bashkimit me të tjerët,
- e drejta për themelimin e bashkëshortësisë dhe familjes,
- e drejta e pronës,
- e drejta për arsimim,
- e drejta për lëvizje dhe banim të lirë.

4. Mosdiskriminimi. Gëzimi i të drejtave dhe lirive të përmendura në këtë nen ose në marrëveshjet ndërkombëtare në aneksin 1 të kësaj Kushtetute, do t'u sigurohen të gjithë personave në Bosnjë e Hercegovinë, pa diskriminim mbi cilëndo bazë qoftë, siç janë gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, gjuha, predikimi fetar, qëndrimet politike e tjera, prejardhja nacionale e sociale, përkatësia e pakicës kombëtare, statusi pronësor, statusi i cili fitohet sipas lindjes ose statusi tejtër.

5. Refugjatët dhe persoant e zhvendosur. Të gjithë refugjatët dhe personat e zhvendosur kanë të drejtë për t'u kthyer lirisht në shtëpitë e veta. Ata kanë të drejtë, në harmoni me aneksin 7 të marrëveshjes së përgjithshme suazë, që t'u kthehet pasuria nga e cila janë privuar gjatë armiqësisve duke filluar nga viti 1991 dhe që t'u kompensohet e gjithë pasuria e cila nuk mund t'u kthehet. Të gjitha detyrimet e marra ose deklaratat lidhur me atë pasuri të dhëna nën presion, janë të pavlefshme dhe anuluese.

6. Zbatimi i të drejtave të njeriut. Bosnja e Hercegovina dhe të gjitha gjyqet, oganet e administratës dhe instrumentet të cilat i administrojnë entitetet ose që funksionojnë në entitete, do t'i zbatojnë dhe respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut nga paragrafi 2.

7. Marrëveshjet ndërkombëtare. Bosnja e Hercegovinadotë mbetet ose do të bëhet palë nënshkruese e marrëveshjeve ndërkombëtare të përmendura në aneksin I të kësaj Kushtetute.

8. Bashkëpunimi. Të gjitha autoritetet në Bosnjë e Hercegovinë do të kenë mundësi të pakufizuar të afrimit dhe dotë bashkëpunojnë me: të gjithë mekanizmat ndërkombëtar për mbikëqyrjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Bosnjë e Hercegovinë; me të gjitha trupat vëzhguese të themeluar me cilëndo marrëveshje ndërkombëtare të përmendur në aneksin I të kësaj Kushtetute; me Tribunalin ndërkombëtar për ish Jugosllavinë (e posaçërisht do t'i respektojë urdhëresat e dhëna në harmoni me nenin 29. të Statutit të këtij Tribunali), dhe me secilën organizatë tjetër të cilës Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara i ka dhënë mandat e që ka të bëjë me të drejtat e njeriut ose me të drejtën humanitare.

Neni III

Kompetencat dhe marrëdhëniet midis institucioneve të Bosnjës e Hercegovinës dhe të entiteteve.

1. Kompetencat e institucioneve të Bosnjës e Hercegovinës

Këto fusha bëjnë pjesë në kompetencat e institucioneve të Bosnjës e Hercegovinës:

- a. politika e jashtme,
- b. tregtia e jashtme,
- c. politika doganore,
- d. politika monetare në harmoni me nenin VII
- e. financimi i institucioneve dhe i obligimeve ndërkombëtare të Bosnjës e Hercegovinës,
- f. politika e imigracionit, e refugjatëve dhe dhënia e azilit dhe rregullativa e saj,
- g. zbatimi i të drejtës penale ndërkombëtare dhe i të drejtës penale e cila vlen midis entiteteve, përfshirë edhe raportet me Interpolin,
- h. ndërtimi dhe funksionimi i objekteve dhe lidhjeve të përbashkëta ndërkombëtare të komunikacionit,
- i. rregullimi i komunikacionit midis entiteteve,
- j. kontrolli i komunikacionit ajror.

2. Kompetencat e entiteteve

(a) Entitetet do të kenë të drejtë për të themeluar marrëdhënie speciale paralele me vendet fqinje duke respektuar sovranitetin dhe tërësinë tokësore të Bosnjës e Hercegovinës.

(b) Secili entitet do t'ia jep tërë ndihmën e nevojshme qeverisë së Bosnjës e Hercegovinës, mirëpo detyrimet financiare që i ka pranuar njëri entitet pa pëlqimin e entitetit tjetër para zgjedhjes së Kuvendit dhe presidencës së Bosnjës e Hercegovinës, do të jetë detyrime të atij entiteti, përpos në qoftë se ato detyrime nuk janë kusht për t'u vazhduar anëtarësia e Bosnjës e Hercegovinës në ndonjë organizatë ndërkombëtare.

(c) Entitetet do të mundësojnë kushte të sigurta për të gjithë personat nën juridiksionin e vet me atë që do të kenë organe civile për ruajtjen e rendit e të qetësisë të cilët do të funksionojnë në harmoni me standardet e njohura ndërkombëtare dhe do të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njohura ndërkombëtare të njeriut, të përmendura në nenin II, edhe ashtu që do të marrin masa tjera përkatëse.

(d) Secili entitet mund, gjithashtu, të lidhë marrëveshje me shtetet dhe organizatat ndërkombëtare, me lejen e Kuvendit. Kuvendi mundet të parashikojë me ligj tipe të caktuara të marrëveshjeve për të cilat nuk do të nevojitet pëlqimi i tillë.

3. Të drejtat dhe përgjegjësitë e entiteteve dhe të institucioneve

(a) Të gjitha funksionet e pushtetit dhe të gjitha autorizimet të cilat nuk u janë ndarë kategorikisht me këtë Kushtetutë institucioneve të Bosnjës e Hercegovinës, do t'u takojnë entiteteve të saj.

(b) Entitetet si dhe provincat në të cilat ato do të ndahen eventualisht, do të respektojnë në tërësi këtë Kushtetutë, e cila ka prioritet në raport me dispozitat ligjore të Bosnjës e Hercegovinës dhe me kushtetutat e ligjet e entiteteve të cilët nuk janë në harmoni me të, si dhe vendimet e Bosnjës e Hercegovinës. Parimet e përgjithshme të drejtës ndërkombëtare do të jenë pjesë përbërëse e të drejtës së brendshme të Bosnjës e Hercegovinës dhe të entiteteve.

4. Koordinimi

Presidenca mund të vendos për ta lehtësuar koordinimin midis entiteteve lidhur me çështjet të cilat nuk bëjnë pjesë në kompetencat e Bosnjës e Hercegovinës sipas kësaj Kushtetute, përpos nëse ndonjë entitet nuk ushtron ankesën për cilën do raste konkret.

5. Kompetencat plotësuese

(a) Bosnja e Hercegovina do t'i marrë kompetencat për çështjet tjera për të cilat merren vesh

entitetet për të cilat ekzistojnë dispozitat në aneksin prej 5 deri 8 të Marrëveshjes së përgjithshme suazë, ose të cilat janë të domosdoshme për t'u ruajtur sovraniteti, tërësia tokësore, pavarësia politike dhe subjektiviteti ndërkombëtar i Bosnjës e Hercegovinës, në harmoni me ndarjen e kompetencave midis institucioneve të Bosnjës e Hercegovinës. Gjithashtu, nëse ndihet nevoja, mund të formohen edhe institucione tjera për përmbushjen e atyre detyrimeve.

(b) Në afatin prej gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi e kësaj Kushtetute, entitetet do t'i fillojnë negociatat me qëllim që në kompetencat e Bosnjës e Hercegovinës të përfshihen edhe çështjet tjera siç janë shfrytëzimi i energjisë elektrike dhe projektet kooperative ekonomike.

Neni IV

Kuvendi

Kuvendi do të ketë dy dhoma: Dhomën e Popujve dhe Dhomën e Përfaqësuesve.

1. Dhoma e Popujve

Dhoma e Popujve do të përbëhet nga 15 delegatë, nga të cilët dy të tretat do të jenë nga Federata (pesë kroatë dhe pesë boshnjakë) kurse një e treta nga Republika Serbe (pesë serbë).

(a) Delegatët kroatë e boshnjakë nga Dhoma e Popujve e Federatës. Delegatët nga Republika Serbe do t'i zgjedh Kuvendi Popullor i Republikës Serbe.

(b) Për kuorumin e Dhomës së Popujve do të jetë e duhur nëntë anëtarë - të paktën tre boshnjakë, tre kroatë e tre delegatë serbë.

2. Dhoma e përfaqësuesve.

Dhoma e Përfaqësuesve do të ketë 42 anëtarë, nga të cilët dy e treta do të zgjidhen nga territori i Federatës, kurse një e treta nga territori i Republikës Serbe.

(a) Anëtarët e Dhomës së Përfaqësuesve do të zgjidhen drejtpërdrejtë nga entiteti i vet në harmoni me ligjin zgjedhor në të cilin do të miratojë Kuvendi. Mirëpo, zgjedhjet e para do të mbahen në harmoni me aneksin 3 të Marrëveshjes së përgjithshme suazë.

(b) Kuorumin do ta bëjnë shumica e të gjithë anëtarëve të Dhomës së Përfaqësuesve.

3. Procedura

(a) të dy dhomat do të mblidhen në Sarajevë më së voni tridhjetë ditë pas përfundimit të zgjedhjeve.

(b) Të dy dhomat do të miratojnë me shumicë votash rregullat interne dhe do të zgjedhin mesvete një serb, një kroat e një boshnjak i cili do të ketë funksionin e kryetarit e të nënkryetarit, ashtu që në funksionin e kryetarit do të ndërrohen me rotacion tre anëtarët e zgjedhur.

(c) Të gjitha ligjet do t'i miratojnë të dy dhomat.

(d) Të gjitha vendimet në të dy dhomat do të miratohen me shumicën e votave të të pranishmëve që votojnë. Delegatët dhe anëtarët do të përpiqen që ajo shumicë të përfshijë të paktën nga një të tretën e votave të delegatëve ose të anëtarëve nga territori i secilit entitet. Në qoftë se shumica e votave nuk e përfshinë nga një të tretën e votave të delegatëve ose të anëtarëve nga territori i secilit entitet, kryetari dhe nënkryetari do të mblidheshin komisionin dhe do të përpiqen të sigurojnë miratim në afatin prej tri ditësh pas votimit. Nëse kjo përpjekje nuk jep sukses, vendimet do t'i marrë shumica e të pranishmëve që votojnë, me kusht që të dy të tretat ose më shumë delegatë apo anëtarë të zgjedhur nga secili entitet të mos votojë "kundër".

(e) Vendimet që i propozon Kuvendi mund të shpallën si të dëmshme për interesat vitale të popullit boshnjak, kroat ose serb nga ana e shumicës së delegatëve/boshnjakë, kroatë ose serbë, të zgjedhur në

përputhje me paragrafin 1 (a). Propozimet e vendimeve të tilla duhet të akordohen nga shumica e delegatëve boshnjakë, kroatë ose serbë që janë të pranishëm dhe votojnë në Dhomën e Popujve.

(f) Kur shumica e delegatëve boshnjakë, kroatë ose serbë protestojnë kundër referimit në paragrafin (e), kryetari i Dhomës në popujve do ta konvokojë menjëherë Komisioni i përbashkët e cila përbëhet nga tre delegatë, nga të cilët çdo njëri është zgjedhur nga ana e delegatëve boshnjakë, kroatë ose serbë në mënyrë që të zgjidhet problemi. Nëse ky Komision nuk ia del ta zgjidhë problemin në afatin prej pesë ditësh, problemi do t'i paraqitet Gjyqit Kushtetues i cili me procedurë të përsheptuar do të përcaktojë rregullësinë e procedurës.

(g) Dhomën e Popujve mund ta shpërndajë Kryesia ose Dhoma e Popujve me kusht që këtë vendim për shpërndarje e ka miratuar shumica e cila e përfshinë shumicën e delegatëve nga të paktën dy prej tre popujve - boshnjakë, kroatë ose serbë. Mirëpo, Dhoma e Popujve e zgjedhur në zgjedhje e para pas hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, nuk mund të shpërndahet.

(h) Vendimet e Kuvendit nuk do të hyjnë në fuqi para shpalljes.

(i) Të dy dhomat do t'i shpallin në tërësi proceverbalet nga diskutimet dhe diskutimet do të jenë të hapta përpos në kushtet të jashtëzakonshme të parashikuara me rregullore.

(j) Delegatët dhe anëtarët nuk mund të thirren në përgjegjësi qytetare ose penale për veprat e kryera gjatë ushtrimit të detyrave të veta në Kuvend.

4. Autorizimet

Kuvendi do të jetë kompetentë për:

(a) nxjerrjen e ligjeve që janë të nevojshme për zbatimin e vendimeve të Presidencës ose për përmbushjen e detyrimeve nga kompetencat e Kuvendit sipas kësaj Kushtetute,

(b) të vendosur mbi burimet dhe shumën e të ardhurave të cilët do të sigurojnë funksionimin e institucioneve të Bosnjës e Hercegovinës, dhe përmbushjen e obligimeve ndërkombëtare të BeH,

(c) miratimin e buxhetit për institucionet e Bosnjës e Hercegovinës

(d) të vendosur mbi pëlqimin për ratifikimin e marrëveshjeve

(e) çështjet tjera që duhet të zgjidhen në mënyrë që Kuvendi të mund t'i kryej detyrat dhe çështjet e veta të cilat entitetet me marrëveshje reciproke i kanë vënë në kompetencat e tij.

Neni V

Presidenca

Presidenca e Bosnjës e Hercegovinës do të përbëhet nga tre anëtarë: një boshnjak, një kroat nga të cilët të dy do të zgjidhen direkt nga territori i Federatës, dhe një serb i cili do të zgjidhet direkt nga territori i Republikës Serpska.

1. Zgjedhjet dhe mandati.

(a) Anëtarët e Presidencës do të zgjidhen direkt në secilin entitet (secili votues do të votojë për një vend në presidencë) në harmoni me ligjin elektoral të miratuar në Kuvend. Zgjedhjet e para, ndërkaq, do të mbahen në harmoni me aneksin 3 të Marrëveshjes së përgjithshme suazë. Secili vend i zbratur në Presidencë do të plotësohet nga ana e entitetit relevant në harmoni me ligjin të cilin do ta miratojë Kuvendi.

(b) Mandati i anëtarëve të Presidencës të zgjedhur në zgjedhjet e para do të jetë dy vjet: mandati i anëtarëve të zgjedhur në të gjitha zgjedhjet e ardhshme do të jetë katër vjetë. Anëtarët do të mund të zgjidhen dy herë radhazi, por nuk mund të zgjidhen në periudhën prej katër vjetësh të ardhshme.

2. Procedura

(a) Presidenca do të nxjerrë rregulloren e vet e cila do të parashikojë se sa kohë mund të kalojë midis dy konvokimeve dhe mbajtjes së mbledhjeve të presidencës.

(b) Anëtarët e Presidencës do të emërojnë Presidentin mes veti. Në mandatin e parë të Presidencës, kryesues do të jetë ai anëtar i cili fiton më shumë vota. Pas kësaj kryesuesi do të zgjidhet midis anëtarëve të Presidencës ashtu që secili nga ata atë funksion ta ushtrojë në periudhë të njëjtë kohore gjatë mandatit katërvjeçar. Pas kësaj, kryesuesi do të zgjidhet sipas mënyrës që do ta caktojë Kuvendi në harmoni me nenin IV (3).

(c) Presidenca do të orvatet të miratojë të gjitha vendimet e kryesuesit (pra të atyre vendimeve që kanë të bëjnë me çështjet e parashikuara në nenin III (1) (a)-(e), me konsensus. Mirëpo, këto vendime megjithatë mund të miratohen në harmoni me paragrafin (d) i cili pason, të miratohen nga ana e dy anëtarëve kur të gjithë orvatjet për t'u arritur konsensusi mbetën pa sukses.

(d) anëtari i Presidencës mund ta shpallë vendimin presidencial të dëmshëm për interesat jetike të entitetit në territorin e të cilit është zgjedhur, me kusht që këtë ta bëjë në afatin prej tre ditësh pas miratimit të vendimit. Vendimi i tillë do t'i dërgohet menjëherë Kuvendit Popullor të Republikës Serbe, nëse vendimin e ka shpallur të dëmshëm anëtari i Presidencës i cili vjen nga territori i saj: delegatëve boshnjakë të Dhomës së Popujve të Federatës nëse vendimin e ka shpallur të dëmshëm anëtari boshnjak ose delegati kroat të atij organi nëse vendimin e ka shpallur të dëmshëm anëtari kroat i Presidencës. Në qoftë se në afatin prej dhjetë ditësh pas dërgimit të vendimit, dy të tretat e votave të këtyre organeve konfirmojnë se vendimi është i dëmshëm, ky vendim i Presidencës nuk do të hyjë në fuqi.

3. Autorizimet.

Presidenca do të jetë përgjegjëse për:

(a) udhëheqjen e politikës së jashtme të Bosnjës e Hercegovinës.

(b) emërimin e ambasadorëve dhe të përfaqësuesve të tjerë ndërkombëtarë të Bosnjës e Hercegovinës, nga të cilët më së shumti dy të tretat do të zgjidhen nga territori i Federatës,

(c) përfaqësimin e Bosnjës e Hercegovinës në organizatat e institucionet ndërkombëtare dhe evropiane dhe kandidimin për anëtarësim në organizatat dhe institucionet anëtare e të cilave nuk është Bosnja e Hercegovina,

(d) negociatat, hudhje poshte dhe me leje të Kuvendit për ratifikimin e marrëveshjes të Bosnjës e Hercegovinës,

(e) zbatimin e vendimeve të Kuvendit,

(f) propozimin e buxhetit vjetor të Kuvendit me rekomandim të Këshillit të Ministrave,

(g) paraqitjen e raportit Kuvendit mbi shpenzimet e Presidencës, sipas kërkesës, të paktën një herë në vit,

(h) koordinimin, sipas nevojës, me organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare në Bosnjë e Hercegovinë.

(i) kryerjen e funksioneve tjera që janë të nevojshme për ushtrimin e detyrave të cilat presidencës mund t'ia urdhërojë Kuvendi, por për të cilat mund të merren vesh entitetet.

4. Këshilli i Ministrave.

Presidenca do të emërojë kryearin e Këshillit të Ministrave i cili e merr detyrën pas miratimit të Dhomës së Përfaqësuesve. Kryetari i Këshillit të Ministrave do të emërojë ministrin e Punëve të Jashtme, Ministrin e Tregëtisë së Jashtme dhe ministrat e tjerë sipas nevojës, të cilët do a marrin detyrën pas miratimit të Dhomës së Përfaqësuesve,

(a) Kryetari dhe ministrat e përbëjnë bashkarisht Këshillin e Ministrave i cili do të obligohet për udhëheqjen e politikës dhe zbatimin e vendimeve të Bosnjës e Hercegovinës në fushat e përmendura në

nenin III (1), (4) dhe (5), dhe për paraqitjen e raportit Kuvendit (përfshirë edhe raportet mbi shpenzimet e Bosnjës e Hercegovinës të paktën një herë në vit).

(b) Më së shumti dy të tretat e numrit të përgjithshëm të ministrave mund të zgjidhen nga territori i Federatës. Kryetari do të emërojë gjithashtu nismëministrat (të cilët nuk do t'i përkasin popullit të njëjtë konstitutiv si ministrat e tyre), e të cilët do ta marrin detyrën pas miratimit të Dhomës së Përfaqësuesve.

(c) Këshili i Ministrave do të japë dorëheqje nëse Kuvendi në çdo moment i shprehë mosbesimin.

5. Komiteti i përhershëm.

(a) Secilit anëtar i Presidencës do të ketë, në kuadër të funksioneve të veta, autorizimet e komandimit civil të forcave të armatosura. Asnjë entitet nuk do të kërcënohet me forcë e as të përdorë forcën kundër entitetit tjetër, dhe me asnjë kusht forcat e armatosura të një entiteti nuk do të hynë e as nuk do të qëndrojnë në territorin e entitetit tjetër pa lejen e qeverisë së atij entiteti dhe të Presidencës së Bosnjës e Hercegovinës. Të gjitha forcat e armatosura në Bosnjë e Hercegovinë do të funksionojnë në harmoni me sovranitetin dhe tërësinë tokësore të Bosnjës e Hercegovinës.

(b) Anëtarët e Presidencës do të zgjedhin komitetin e përhershëm për çështje ushtarake i cili do të koordinojë aktivitetet e forcave të armatosura në Bosnjë e Hercegovinë. Anëtarët e Presidencës do të jenë edhe anëtarë të Komitetit të përhershëm.

Neni VI

Gjyqi Kushtetues

1. Përbërja.

Gjyqi Kushtetues i Bosnjës e Hercegovinës do të ketë nëntë anëtarë.

(a) Katër anëtarë do t'i zgjedhë Dhoma e Përfaqësuesve e Federatës, kurse dy anëtarë do t'i zgjedh Kuvendi i Republikës Serbe. Tre anëtarë tjerë do t'i zgjedh kryetari i Gjyqit Evropian për të Drejtat e Njeriut, pas konsultimeve me Presidencën.

(b) Gjyqtarët do të jenë juristë me autoritet dhe me kritere të larta morale. Secili votues i cili i përmbush këto kushte mund të jetë gjyqtar i Gjyqit Kushtetues. Gjyqtarët të cilët i zgjedh kryetari i Gjyqit Evropian për të Drejtat e Njeriut nuk do të jetë shtetas i Bosnjës e Hercegovinës, e as nga ndonjëri nga vendet fqinje.

(c) Mandati i gjyqtarëve të parë të emëruar do të zgjasë pesë vjet, përpos në qoftë se nuk japin dorëheqje ose nëse ata nuk i shkarkojnë me konsensus gjyqtarët tjerë nga shkaqet e arsyeshme. Gjyqtarët e parë të zgjedhur nuk do të mund të rizgjidhen. Gjyqtarët të cilët do të zgjidhen pas skadimit të mandatit të gjyqtarëve të parë të zgjedhur, do të mbeten në funksion deri në moshën 70-vjeçare, përpos nëse nuk japin dorëheqje ose nëse ata nuk i shkarkojnë gjyqtarët tjerë me konsensus nga shkaqet e arsyeshme.

(d) Për emërimin e gjyqtarëve me kalimin e pesë viteve pas emërimit të parë, Kuvendi i Bosnjës e Hercegovinës mund të caktojë me ligj metodën tjetër të zgjedhjes së tre gjyqtarëve të cilët i zgjedh kryetari i Gjyqit Evropian për të Drejtat e Njeriut.

2. Procedura

(a) Kuorumin do ta bëjë shumica e të gjithë anëtarëve të këtij Gjyqi.

(b) Ky Gjyq do ta miratojë rregulloren e vet me votat e shumicës së të gjithë anëtarëve. Proceset gjyqësore do të jenë publike (të hapta), dhe Gjyqi publikisht do ta kumtojë arsyetimin e vendimeve të veta.

3. Kompetencat

Gjyqi Kushtetues do të shfaq kujdes për zbatimin e kësaj Kushtetute.

(a) Gjyqi Kushtetues do të ketë kompetencë ekskluzive për të vendosur në secilin kontest i cili, sipas kësaj kushtetute, shkaktohet midis entiteteve ose midis Bosnjës e Hercegovinës dhe të njëjtit apo të dy entiteteve, ose midis institucioneve të Bosnjës e Hercegovinës përfshirë midis tjerash edhe këto konteste:

- se a është vendim i njërit nga entitetet për vendosjen e marrëdhënieve paralele speciale me ndonjërin vend fqinj, në harmoni me këtë Kushtetutë, përfshirë edhe dispozitat mbi sovranitetin dhe tërësinë tokësore të Bosnjës e Hercegovinës.

- se a është cilado dispozitë kushtetuese e ligjore e entitetit në harmoni me këtë Kushtetutë.

Kontestet mund t'i inicojë vetëm anëtar i Presidencës, kryetari i Këshillit të Ministrave, kryetari ose nënrkryetari i cilësdo dhomë të kuvendit të Bosnjës e Hercegovinës, ose një e katërta e cilësdo dhomë të trupit legjislativ të entitetit.

(b) Gjyqi Kushtetues do të ketë edhe kompetencën e apelacionit në kontestet të cilat shkaktohen sipas kësaj Kushtetute për shkak të aktgjykimit të cilit do gjyq tjetër në Bosnjë e Hercegovinë.

(c) Gjyqi Kushtetues do të jetë kompetent për zgjidhjen e kontesteve të cilat ia drejton cilido gjyq në Bosnjë e Hercegovinë, lidhur me çështjet nëse ndonjë ligj, nga vlefshmëria e të cilit varet vendimi i atij gjyqi, është në harmoni me këtë kushtetutë, me Konvetën Evropiane mbi të Drejtat dhe Liritë themelore të Njeriut dhe me protokollin e saj, ose me ligjet e Bosnjës e Hercegovinës; apo mbi çështjet e ekzistimit ose të vëllimit të rregullave të përgjithshme të të drejtës publike ndërkombëtare relevante për vendimin e atij gjyqi.

4. Vendimet.

Vendimet e Gjyqit Kushtetues do të jenë definitive dhe të detyrueshme.

B) KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SERBE¹

DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1.

Neni 1 është zëvendësuar me amendamentin XLIV i cili thotë:
"Republika Serbe është shtet i popullit serb dhe i të gjithë qytetarëve të saj".

Neni 2.

(...)

Paragrafi 2 i nenit 2 është zëvendësuar me amendamentin LV i cili thotë:
"Marrëveshja për ndryshimin e kufirit midis Republikës Serbe dhe të Federatës së Bosnjës e Hercegovinës, mund të paraqitet në konfirmim me anë të referendumit në Republikë".

¹ Ministria Federale e Drejtësisë, Sarajevë, 1997.

Neni 3.

Neni 3 është zëvendësuar me pikën 1 të amendamentit LV i cili thotë:
"Republikës i takojnë të gjitha funksionet dhe kompetencat shtetërore, porpos atyre të cilat me Kushtetutën e Bosnjës e Hercegovinës janë bartur kategorikisht në institucionet e sajë".

Neni 4.

Neni 4 është zëvendësuar me pikën 2 të amendamentit LV i cili thotë:
"Republika mundet, në bazë të Kushtetutës së Bosnjës e Hercegovinës, të vendos marrëdhënie të posaçme paralele me Republikën Federative të Jugosllavisë dhe me republikat e saj anëtare".

Neni 5.

Rregullimi kushtetues i Republikës bazohet në:
- garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në harmoni me standardet ndërkombëtare;
- sigurimin e barazisë kombëtare;
- drejtësinë sociale;
- ekonominë e tregut;
- sistemin shumëpartiak;
- demokracinë parlamentare dhe ndarjen e pushtetit;
- zgjedhjet e lira;
- vetëqeverisjen lokale;
- mbrojtjen e të drejtave të grupeve etnike dhe të pakicave tjera.

Neni 6.

(...)
Neni 6 është plotësuar me amendamentin xxx i cili thotë:
"Qytetari i Republikës nuk mund të privohet nga shtetësia, të ndiqet ose të ekstradohet".

Neni 7.

Në Republikë në përdorim zyrtar është gjuha serbe me dialektin ijekavik dhe ekavik dhe me alfabetin cirilik, kurse alfabeti latin sipas mënyrës së caktuar me ligj.

Në rajonet ku jetojnë grupet e tjera etnike në përdorim zyrtar janë gjuhët dhe alfabetet e tyre, sipas mënyrës të caktuar me ligj.

Neni 8.

Republika ja flamurin, stemën dhe himnin.
Pamja e flamurit dhe e stemës dhe teksti i himnit rregullohen me ligjin kushtetues.

Neni 9.

Kryeqyteti i Republikës është Sarajevo.

II. TË DREJTAT DHE LIRITË E NJERIUT

Neni 10.

Qytetarët e Republikës janë të barabartë në liritë, të drejtat dhe detyrat; të njëjtë janë para ligjit dhe gëzojnë mbrojtjen e njëjtë juridike pavarësisht nga raca, gjinia, gjuha, përkatësia kombëtare, predikimet fetare, prejardhja sociale, lindja, arsimimi, gjendja pronësore, bindja politike e tjetër, pozita shoqërore ose veçoria tjetër personale.

Neni 21.

Qytetarët mund të lëvizin lirisht, të banojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës, që ta lëshojnë lirisht atë territor dhe në të të kthehen lirisht.
Me ligj mund të zbatohen kufizime të lëvizjes vetëm nëse kjo është e domosdoshme për shkak të zhvillimit të procedurës penale apo për shkak të mbrojtjes së sigurisë dhe shëndetit të njerëzve.
Nuk mund të themelohen kurrfarë kufizimesh për shkaqe politike.

Neni 34.

Qytetarit i garantohet liria e të shprehurit të përkatësisë dhe kulturës nacionale dhe përdorimi i plotë i gjuhës dhe alfabetit amëtar.
Askush nuk është i detyruar për t'u deklaruar për përkatësinë e tij nacionale.
Paragrafi 3 i nenit 34 është shlyer në bazë të pikës 6 të amendamentit LVII.

IV. TË DREJTAT DHE DETYRAT E REPUBLIKËS

Neni 68.

Neni 68 është zëvendësuar me amendamentin XXXII, i cili thotë:

"Republika rregullon dhe siguron:

1) integritetin, rendin kushtetues dhe tërësinë teritoriale të Republikës;

Në nënpikën 1. të amendamentit XXXII, fjalët "suvereniteti dhe pavarësia" janë zëvendësuar me fjalët "integriteti, rendi kushtetues" (pika 1. amendamenti LVIII).

2) mbrojtjen dhe sigurinë;

3) masat në rast të gjendjes së luftës, të rrezikut të drejtpërdrejtë të luftës dhe të gjendjes së jashtëzakonshme;

5) realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut;

(...)

V. ORGANIZIMI I REPUBLIKËS

1) Kuvendi Popullor

Neni 70.

Kuvendi Popullor:

1. vendos mbi ndryshimin e Kushtetutës;

2. miraton ligjet, normat tjera dhe aktet e përgjithshme;

3. miraton planin e zhvillimit, planin hapësinor, buxhetin dhe llogarinë përfundimtare;

4. përcakton organizimin territorial të Republikës;
5. shpall referendumin republikan;
6. shpall huan publike republikane dhe vendos për hyrjen borxh të Republikës;
7. shpall zgjedhjet për deputetët popullor dhe për kryetarin e Republikës;
8. zgjedh, emëron dhe shkarkon funksionarët, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin;
9. kryen kontrollin e punës së Qeverisë dhe të organeve tjera të cilat i përgjigjen atij në harmoni me Kushtetutën dhe ligjin.

10. jep amnisti;

11. ushtron edhe punë të tjera në harmoni me Kushtetutën dhe ligjin.

Neni 70 është plotësuar me amendamentin LIX i cili thotë:

"Kuvendi Popullor:

1. zgjedh delegatët e Republikës në Dhomën e Popujve të Asamblesë Parlamentare të Bosnjës e Hercegovinës;

2. ratifikon marrëveshjet të cilat Republika i lidh me shtetet dhe organizatat ndërkombëtare me pëlqimin e Asamblesë Parlamentare të Bosnjës e Hercegovinës".

(...)

3. Qeveria dhe administrata republikane

Neni 90.

Qeveria

1. propozon ligjet, normat tjera dhe aktet e përgjithshme;
2. propozon planin e zhvillimit, planin hapësinor, buxhetin dhe llogaritë përfundimtare;
3. siguron zbatimin dhe ekzekutim ligjet, normat tjera dhe aktet e përgjithshme;
4. nxjerr dekrete, vendime dhe akte të tjera për ekzekutimin e ligjeve;
5. jep mendime mbi propozimin e ligjeve, të normave të tjera dhe të akteve të përgjithshme, të cilat Kuvendit Popullor ia paraqet propozuesi tjetër;
6. përcakton parimet mbi organizimin e brendshëm të ministrive dhe të organeve të tjera republikane të administratës dhe të organizatave administrative, vendos dhe shkarkon funksionarët nëpër ministri, në organet tjera republikane dhe në organizatat administrative;
7. harmonizon dhe orienton punën e ministrave dhe të organeve të tjera republikane dhe të organizatave administrative;
8. kryen kontrollin e punës së ministrave dhe të organeve të tjera republikane e të organizatave administrative dhe pezulon ose anulon aktet e tyre të cilat janë në kundërshtim me ligjin ose normat e qeverisë;
9. kryen edhe punë tjera në harmoni me Kushtetutën e ligjin.

Neni 90.

Neni 90 është plotësuar me pikën 1 të amendamentit XLI dhe amandamenti i ndryshuar XLI thotë:
"Qeveria vendos për formimin e pëëfaqësive të Republikës në botën e jashtme".

5 Shërbimi mbi qarkullimin e pagesave dhe kontrollin financiar

Neni 99.

Republika ka shërbimin dhe qarkullimin e pagesave dhe kontrollin financiar.
Statusi, organizimi, administrimi dhe afarizmi i shërbimit për qarkullimin e pagesave dhe të kontrollit financiar rregullohet me ligj.

VI. ORGANIZIMI TERRITORIAL

Neni 100.

Organizimi territorial i Republikës rregullohet me ligj.

VII. MBROJTJA

Neni 104.

Është e drejtë dhe detyrë e gjithë qytetarëve ta mbrojnë territorin dhe rendin kushtetues të Republikës Serbe.

Në paragrafin 1 të nenit 104 janë shlyer fjalët "sovrانيتit" dhe "pavarësia" (amendamenti LXIII)
Të drejtat dhe detyrat e mbrojtjes rregullohen me ligj të veçantë.

Neni 105.

Republika Serbe ka ushtrinë e vet, të cilën e përbëjnë formacionet e përhershme dhe rezerviste.
Formacionet e përhershme i përbëjnë ushtarët profesionalë dhe ushtarët në shërbimin e afatit ushtarak.

Për ushtrinë e Republikës Serbe miratohet ligj i veçantë.

Neni 106.

Ushtrinë e Republikës Serbe në paqë e luftë e komandon Kryetari i Republikës në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.

Kryetari i Republikës cakton, avason dhe shkarkon oficerët e uishtrisë së Republikës Serbe në harmoni me ligjin, cakton dhe shkarkon kryetarët, gjyqtarët dhe gjyqtarët porotë të gjykatave ushtarake dhe prokurorët ushtarakë.

IX. GJYKATA KUSHTETUESE

Neni 115.

Gjykata Kushtetuese:

1. vendos mbi harmoninë e ligjeve, të normave tjera dhe të akteve të përgjithshme me Kushtetutë;
 2. vendos mbi harmoninë e normave dhe të akteve të përgjithshme me ligjin;
 3. zgjidh konfliktet e kompetencave midis organeve të pushtetit legjislativ, ekzekutiv e gjyqësor.
- (...)

Neni 119.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të gjithobligueshme dhe ekzekutuese në mbarë territorin e Republikës.

Në paragrafin 1 të nenit 119 prapa fjalës "ekzekutive" janë shtuar fjalët "në territorin e Republikës" (amendamenti LXIV).

Ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës e sigurin Qeveria.

X. GJKATAT DHE PROKURORITË PUBLIKE

Neni 121.

Gjykatat janë të mëvetshme dhe të pavarura dhe gjykojnë në bazë të Kushtetutës e ligjit.
Gjykatat mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, të drejtat dhe interesat e caktuara të subjekteve juridike dhe ligjshmërinë.

Neni 123.

Gjykata Supreme e Republikës, si gjykatë më e lartë në Republikë, siguron aplikimin unik të ligjit.

XI. NDRYSHIMET KUSHTETUESE

Neni 132.

Propozimin për fillimin e ndryshimit të Kushtetutës së Republikës mund ta paraqesin kryetari i Republikës, Qeveria dhe të paktën 30 deputetë të Kuvendit Popullor.

Për vendimin mbi fillimin e ndryshimit të Kushtetutës vendos Kuvendi Popullor me shumicën e votave të deputetëve popullorë.

XII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 138.

Neni 138 është zëvendësuar me amendamentin LI dhe është plotësuar me amendamentin LXV i cili thotë:

"Kur me aktet e institucioneve të Bosnjës dhe Hercegovinës ose me aktet e Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës Serbe dhe me Kushtetutën e Bosnjës e Hercegovinës, prishet barazia e Republikës Serbe, ose në ndonjë formë tjetër rrezikohen të drejtat e saj dhe interesat e ligjshme, kurse me atë rast nuk është siguruar mbrojtja e tyre, organet e Republikës, përkatësisht deri në vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës e Hercegovinës dhe në rastet kur mund të paraqiten pasojat e pa evitueshme të dëmshme, miratojnë akte dhe marrin masa për mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave vtë Republikës".

REGJISTRI LËNDOR

1. Nacionalizmi
 - etnik
2. Globalizmi
3. Internacionalizmi
4. Kosmopolitizmi
5. Komunizmi
6. Imperializmi
7. Secesionizmi
8. Bllokovizmi
9. Konfederata
10. Federata
 - federata socialiste
11. Vetëvendosja
 - e brendshme (autonomia)
 - e jashtme (shkëputja, ndarja-secesioni)
12. Identiteti
 - nacional
 - qytetar
13. Etnosi, etniciteti
14. Autonomia
 - territorialo-politike
 - kulturore
15. Statusi special
16. Shteti kombetar, kombi - shteti
17. Asociacioni
 - transnacional
18. Demokracia (demokracia vestministrore)
 - qytetare
 - etnike
 - etnokracia
19. Pakica kombëtare
20. Popujt pakicë
21. Të drejtat kolektive
 - nacionale
22. Të drejtat qytetare
 - individuale
23. Kombi
 - çështja kombëtare
 - kombi amë
24. Asimilimi
 - demokratik
 - etnovrasja
 - spastrimi etnik
25. Unitarizmi
26. Populli
 - kombësia (pakica kombëtare)
27. Sovraniteti
 - shtetëror
 - kantonal
28. Tranzicioni
 - procesi i tranzicionit
29. Centralizmi
30. Liberalizmi i ri
31. Rregullimi kantonal
32. Konsociacioni
33. Ksenofobia
34. Etnocentrizmi
35. Stalinizmi
36. Diktatura e Frankos
37. Terrorizmi
38. Referendumi
39. Parimi i shumicës
 - shumica e kualifikuar (speciale)
40. Majorizimi
41. E drejta ndërkombëtare
42. Diaspora
43. Vetëqeverisja (vetësundimi)

REGJISTRI I EMRAVE

1. Tiroli i Jugut
2. Hungaria
3. Italia
4. Shqipëria
5. Luftërat ballkanike
6. Greqia
7. Serbia
8. Mbretëria serbe, kroate e sllovene
9. Lufta e Dytë Botërore
10. Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB)
11. Evropa
 - Perëndimore
 - Lindore
 - Juglindore
12. Sllovakia
13. Çekosllovakia
14. Ukraina
15. Çeçenia
16. Abhazia
17. Osetia Jugore
18. Ingushetia
19. Azerbejxhani
20. Krimeja
21. Osetia Veriore
22. Hobsbavm, Eric
23. Transdjenstria
24. Republika Federale e Jugosllavisë (RFJ)
25. Nagorni-Karabah
26. Gruzia
27. Federata Ruse
28. Bashkimi Sovjetik (BS)
29. Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë (RSFJ)
30. Valonët
31. Flamanët
32. Belgjika
33. Kanada
34. Baskia
35. Irlanda Veriore
36. Uellsit
 - uellsjanët
37. Britania e Madhe (Mbretëria e Bashkuar)
38. Kvebeku
39. Skotlanda
 - skocezët
40. Francezët
 - kanadezë
41. Anglezët
 - shumica anglosaksone kanadeze
42. Deklarata mbi të Drejtat e Njeriut të KB
43. Dokumneti Final i Helsinkut
44. Konferenca në Gjenevë
45. Shqiptarët
 - e Kosovës
46. Popoviç Koça
47. Islanda
48. Portugalia
49. Republika e Irlandës
50. Myslimanët-boshnjakët
51. Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin Evropian (OSBE)
52. Marrëveshja e Dejtonit
53. Pakistani
54. Turqia
 - qipriot
55. Gali Butros Butros
56. Zaireja
57. Lihtenshtajni
58. Kurdët
59. Republika baltike
60. Lituania
61. Armata Republikane e Irlandës (IRA)
62. ETA
63. UÇK
64. Iraku
65. Irani
66. Tamilët
67. Sri-Lanka
68. Sikët
69. Panxhabi
70. India
71. Bashkimi Evropian (BE)
72. Somalia
73. Kroacia
74. Sllovenia
75. Bosnja e Hercegovina (BeH)
76. Maqedonia

77. Japonia
78. Shoqëria e Popujve
79. Finlanda
80. Ishujt Alanade
81. Bërna (kantoni)
82. Katallania
83. Galicia
84. Suedia
85. Zvicra
86. Austria
87. Holanda
88. Ballkani
 - Luftërat ballkanike
89. Vudri Vilson
90. Rumania
91. V.I. Lenini
92. Hros, Miroslav
93. Norvegjia
94. Evropa e Rajoneve
95. Grozni
96. Bashkortostani
97. Jakutia
98. NATO
99. Qeveria Laburiste
100. Tatarstani
101. Republika Serbe
102. Plani Z-4
103. Republika e Kraines Serbe
104. Vojvodina
105. Milosheviq, Slobodan
106. Kosova
107. Traktati i Sen-Zhermenit
108. Hitler, Adolf
109. Musolini, Benito
110. Degasperi
111. Gruber
112. Bashkësia e Shteteve të Pavarura (BSHP)
113. Stamboliq, Ivan
114. Anglezët
 - kanadezë
115. Mitohell, Georg
116. Suares, Adolf
117. Gorbaçov, Mihail